Esh-Shejh Muhamed Muteveli Esh-Shaëraviju

PËRGJIGJET (FETAVAT) E SHEJH SHAËRAVIJUT NDAJ ÇDO PYETJEJE TË MUSLIMANIT

(Që i nevojitet në jetën e tij për të sotmen dhe për të nesërmen)

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

Korrektoi: Daut Shehu

Kaçanik, 2015

FETAVATË E SHAËRAVIJUT

PJESA E PARË

I

HYRJE

Falënderojmë Allahun, Zotin e gjithë botëve. Përshëndesim me selam Pejgamberin besnik, i cili është dërguar prej Allahut me udhëzimin dhe fenë e vërtetë, i dërguar mëshirë për tërë njerëzimin. Nuk ka forcë as fuqi të ndryshojë dikush diçka, pos Allahut, të Lartit të Madhit.

Dhe ...

Sot, në kohën bashkëkohore ku bota është zhvilluar me shpejtësi të madhe, me asi shpejtësie, sa që atë zhvillim nuk e ka paramenduar më parë. Zhvillim, i cili i ka tejkaluar parashikimet, si të të paditurve, ashtu edhe të dijetarëve. Kjo çështje, ky zhvillim ia tërheq vërejtjen mendjes që të mos e teprojë në zbulimin e të vërtetave shkencore.

Në secilën epokë të njerëzimit nuk mund të vërejmë program më të mirë se të sheriatit islam, po ashtu edhe sot ndihet nevoja dhe domosdoshmëria për të.

Pra, edhe në kohën kur njeriu ka arritur shkallën më të lartë të zhvillimit. Specifikë e Kur'anit është që prej fillimit të ekzistencës së saj i flet të gjitha mentaliteteve dhe të gjitha rrethanave të çdo vendi, sepse është gjithëpërfshirës, burim i pa shterur prej fillimit e deri në mbarim të kësaj bote. Kur'ani i flet bujkut, i cili punon tokën, jeton dhe vdes në të, mirëpo ai befasohet, sepse edhe te ai zë vend gjuha e thjeshtë, e pastër, sqarimi i drejtë, i përpiktë dhe i thukët, i cili depërton thellë në shpirtin e tij. Kështu, Kur'ani ndërlidh të gjitha poret e shoqërisë, të cilat nuk do të mundnin të afroheshin me ide dhe mendime disproporcionale. Mirëpo ai i bashkon me precizitet dhe renditje të mrekullueshme.

Kjo është ajo që vërteton se Krijues i njeriut është zbritësi i Kur'anit, i Cili po ashtu sqaron në përpikëri dhe thellësisht çdo gjë. Ky është shkaku se nuk mund të japim përgjigje të sigurt, sepse pas të gjitha sqarimeve dhe pasi që të gjithë njerëzit kuptojnë sekretet dhe fshehtësitë, secili thotë: "Unë jam i kënaqur me këtë sqarim, unë jam i qetësuar". SUBHANALLAH!

Shembull konkret: I flet intelektualit ashtu siç i flet njeriut të rëndomtë. Kjo është mënyra e cila i përshtatet zbulimeve shkencore dhe metodologjisë mësimore të zbulimeve më të larta të fizikës, sepse nëse ato zbulime i shikon dhe i zbërthen në bazën e tyre thelbësore, do të përfundosh në teoremën e thjeshtë.

Pasi që ligjet e Kur'anit janë obliguese, janë stabile dhe nuk janë të

përkufizuara vetëm në një grup njerëzish, apo vetëm në një gjeneratë, apo vetëm për një epokë, atëherë është e patjetërsueshme që të çlirohet dhe të zhvillohet të kuptuarit mendor. Sepse ne ndodhemi në mes të dy çështjeve të domosdoshme në të njëjtën kohë, apo qartë të ndërlidhura njëra me tjetrën, atëherë kushtëzohet që t'i përmbahemi kushteve dhe rrethanave të caktuara dhe të sqaruara. Ngase, nëse njëra vërtetohet e tjetra eliminohet ose ndryshohet, ose shpjegohet në formën e vet të veçantë, të përshtatshme dhe harmonike, por kuptohet gjithmonë duke iu përmbajtur bazave themelore dhe çështjeve kryesore.

Për këtë arsye është e domosdoshme të ndodhë ndryshimi i të kuptuarit dhe zhvillimi mendor që të përfshihet teorema me logjikën shkencore, ose e kundërta, përfshirja e logjikës shkencore në teoremë, përndryshe logjika e njeriut do të mbetej e ngurtë; zhvillimi mendor është pika kulminante e të gjitha sukseseve shkencore edhe pse zhvillimi shkencor (mendor) ka kaluar me mijëra etapa, prapëseprapë ka mbetur e paplotësuar, duhet që të mos kërkohet paralelizëm që të çlirohet prej njërës, sepse kjo e ka burimin prej Atij, i Cili nuk ndryshon kurrë.

Gurëzimi dhe ngrirja e mendjes nuk i ndihmon kulturës dhe etikës kur'anore, dhe nuk i nevojitet, sepse atëherë do të ishte imagjinatë e gurëzuar, por nëpërmjet shkëndijave të imanit shërues të bëhet shoqërimi i modernizimit dhe civilizimit.

Qëndrimi i gurëzimit mendor nuk i sjellë dobi kulturës dhe etikës kur'anore dhe nuk ka nevojë për një qëndrim të tillë, sepse një gjë e tillë nuk është asgjë tjetër, pos një gur.

Librat e tefsirit dhe tekstet e fikhut, dhe udhëpërshkrimet e Muhamedit a.s., të gjitha janë në duart tona. Nuk ka çka të hulumtohet kur teksti veçse ekziston, por hulumtimi dhe përpjekja bëhet në çështjet që nuk janë të definuara saktësisht, dhe nuk janë të sqaruara definitivisht. Atëherë patjetër mendja duhet të anojë në një kahe pas hulumtimit dhe përpjekjes, duke e krahasuar me veçoritë e dispozitave tjera të ngjashme, nëse është i mundur harmonizimi i tyre ose duke i shikuar me rrjedhshmërinë e realitetit të logjikës dhe mendjes, por kuptohet pa e tepruar dhe pa tejkaluar në paragjykim. Kjo është çka ligjësimi e lejon.

Ndryshimet kanë ndodhur, nevojitet hulumtimi dhe shikimi se si e parasheh ligji i sheriatit dhe fesë në qenien e tij të re, e cila po ashtu ka marr pjesë në zbulimin e çështjeve tjera.

Dhe përfundimisht duhet të zhvillohet mendja në krah të këtyre çështjeve, për të sqaruar dhe argumentuar edhe më mirë, dhe ta zgjerojë hapësirën e tij që ta zë vendin e tij në civilizimin islam sot, ashtu siç e ka pasur në të kaluarën, duke u zhvilluar me program të fortë jo artificial, me program kontinuel, se në të kundërtën do të mbesim mbrapa dhe do të mbesim të harruar.

Aishja r.a. ka thënë:

"I Dërguari i Allahut gjithmonë kur ishte çështja që të zgjedhë në mes të dy çështjeve, e zgjidhte atë e cila ishte më e lehta për umetin e tij".

Me të vërtet ai ka qenë mëshirë për të gjithë botët! Ka shkuar një njeri dhe i ka thënë Pejgamberit s.a.v.s.:

"O i Dërguar i Allahut, çka mendon nëse largohem definitivisht prej haramit dhe praktikoj hallallin, a do të hyj në Xhenet? I është përgjigjur: Po".

Kjo është hallall; kjo është haram; pra program i thjeshtë, i lehtë, i kompletuar dhe jo ekstrem. Po ashtu përmbajtje me seriozitet i planprogramit të drejtë ose angazhim dhe edukim për t'iu përmbajtur me seriozitet.

Imami, Muhamed Muteveli Shaëraviju, na ka sqaruar pika të shumta, i ka afruar dhe tërhequr shumë kuptime të luhatshme, ka zgjedhur shumë çështje enigmatike të njerëzve, të cilët kanë qenë ekstrem në tavolinën e tij të shijshme, me sqarimet e tij mahnitëse, me të cilat sqarime i qetëson zemrat dhe na lehtëson çështjet, na lehtëson rrugën e thirrjes në islam, para vështirësive të injorantëve dhe kompleksëve.

Allahu i ka dhuruar atij metodologji të sqarimit të qartë dhe të thjeshtë, dhe të pakomplikuar, nga kjo ai arriti kulminacionin e fuqisë, besnikërisë dhe ndershmërisë. Ndërsa ne shkruajmë prej tij, përmbledhim idetë e tij, transmetojmë prej tij, përshkruajmë prej tij.

Të shkruash histori është prej çështjeve më të vështira dhe më të komplikuara, posaçërisht të këtij umeti, e të këtij dijetari të madh, ngase patjetër duhet të ruhet trashëgimia e këtij imami të njohur me sinqeritet, përkushtim dhe të kompletuar, por pa e tepruar.

Kërkojmë mbrojtje prej Allahut nga dituria e padobishme, sepse e mira e diturisë është dobia dhe përfitimi.

Çdo dijetar të njohur patjetër duhet ta regjistrojë historia ose të shkruhen bashkëkohanikët, për të mos lejuar të fshihen gjurmët e gjeneratave, sepse vdekja, fatkeqësitë dhe tragjeditë janë çështje që i nënshtrohen harresës

dhe anashkalimit.

Është fjalë boshe të themi se s'kemi nevojë për akide, por mendjelehtësi më e madhe është të mendohet që akideja të jetë pa ngarkesa me obligime dhe pa projekt, i cili tregon rezultatin. Dhe kur ndjenjat gërshetohen, atëherë pëlqehet planprogrami qiellor. Kjo është pengesë dhe moslejim i lajthitjeve dhe zbrazëtisë.

Ka njerëz, të cilët polemizojnë për të mos u kuptuar, por të tjerët nuk polemizojnë për të kuptuar, por këta polemizojnë, sepse dëshirojnë të tregojnë se janë të kuptueshëm dhe nëpërmjet debatit dhe polemikës zbulohen fshehtësitë e njerëzve.

Ata të cilët u ligjërojnë njerëzve atë që e dinë, as nuk festojnë, as nuk kanë çka të fshihen e të mos dëgjon, sepse atyre nuk u sillet diç e re. Ndërsa ai i cili sqaron atë çka nuk e dinë tjerët apo depërton në mendjen e tyre dhe e pranojnë me seriozitet dhe përgjegjësi, dhe dëshmojnë pjekuri të gjenialitetit, atëherë ata gëzohen dhe dëgjojnë me vëmendje atë projekt. Ndërsa nëse ndërlikohet diçka apo pështillet dhe nuk ka sukses për ta treguar atë që dëshirojmë të depërtojë në zemrat e tyre, pra për të mbushur zbrazëtinë e diturisë, sipas tyre nuk ka dobi prej diturisë së tij, sepse i afërt është ai i cili sjellë dobi së afërmi.

I kam telefonuar profesorit tonë, Imamit të mirënjohur - Shejh Muhamed Mutevelij Shaëravijut, i kemi forcuar marrëdhëniet tona, dhe e ka hapur zemrën e tij, shpirtin e tij dhe shtëpinë e tij. Gjithmonë më ka dhënë shpresa kur kam ndier mosrealizim të qëllimit. Dhe siç e kam pasur zakon, nuk kam kursyer kohë, qoftë e shkurtër apo e gjatë, të jetës sime, por e kam ditur se është dituri dhe për mësim, dhe dobi të përgjithshme. I jam përkushtuar të gjithë kohës dhe nuk kam dëshirë që t'i dëgjoj vetëm unë dhuntitë e Shejhut të mirënjohur. Nuk dëshiroj që influentimi të jetë vetëm tek unë, por influenca të jetë edhe te të tjerët. Për këtë arsye kam dëshiruar që t'i përmbledh dhe t'ia përcjelli gjeneratave të ardhshme atë çka më ka mundësuar Allahu, për dobi të përgjithshme dhe për të mirën e fesë.

Kur fliste Shejh Shaëraviju për mjekësinë, ndërsa, edhe pse jam mjek, kam vërejtur se i shpjegon të vërtetat mjekësore me precizitet të rrallë, të cilat as që i kam dëgjuar në fakultetin e mjekësisë, por vetëm pas specializimit, dhe për çudi ai diskutonte me mua për mjekësi si mjek specialist, i cili teoritë shkencore i vendosë në praktikë me bindje të thellë, të cilat ne mjekët nuk i kemi ditur, por i kemi kuptuar vetëm pas një analize, elaborimi dhe mësimi të

gjatë. Prej tij kam mësuar shumë çështje dhe kam marrë prej filozofisë mjekësore, të cilat nuk i kam ditur më parë, sa që kam menduar se Shejh Shaëraviju ka studiuar mjekësinë, dhe është specializuar në atë drejtim. Kur përgjigjesha në pyetjet e lexuesve në revistën "Livaul Islam", po ashtu për çështje të operacionit kur isha redaktor në revistën "Hilal" dhe "Tesavuf Islami", dhe isha kryeredaktor i revistës "Minberul Islami", gjithashtu kisha rubrikën "Mjeku i juaj specialist", e kam kuptuar vlerën e fjalës, prandaj respektoj mendimet e tjerëve, andaj unë jam në dialog me ta në librat që i kam botuar edhe më herët. E kam parë të arsyeshme dhe të domosdoshme se ka ardhur koha për t'iu përgjigjur letrave të lexuesve, të cilët kërkojnë fetva bashkëkohore për çështje, si p.sh.: përdorimi i mjeteve për mosshtatëzani dhe si e parasheh sheriati këtë. Po ashtu më kanë ardhur pyetje, si: Çfarë qëndrimi ka feja për bankat aksionare me xhirollogari bankare, çeqet investuese; pyetje rreth martesës së përkohshme, çfarë dispozite ka, dhe ligji për martesë të tillë - a është shfuqizuar apo jo; po ashtu martesa Urfij – Tradicionale, çfarë dispozite ka, se a është e lejuar apo e ndaluar.

Po ashtu pyetje të shumta për femrën, për çështjet ku nuk ka vendim të prerë, ku mendja nuk mund të definojë saktësisht se a është gabim apo jo, por luhatet dhe është në dyshim.

Pasi që këto çështje kanë rëndësi të posaçme dhe pasi që dijetarët kanë folur shumë, kam dëshirë t'u përgjigjem lexuesve të nderuar, me pyetjet e tyre të vazhdueshme, ashtu si mendon Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju në këto çështje. Mirëpo ka qenë e patjetërsueshme që takimet të jenë të vazhdueshme. Mirëpo besimtari i mençur këto çështje i kupton në bazë të rrethanave dhe gjendjes, dhe në bazë të bisedës së rëndomtë mundet t'i perceptojë çështjet e caktuara.

Ndonjëherë dijetari jep vendim për një çështje të caktuar kur t'i bie ndërmend gjatë bisedës për një çështje tjetër, duket se është lëvizje jo e dëshiruar, mirëpo ajo sinjalizon në vërtetimin apo mohimin e ndonjë çështjeje. Për këtë arsye patjetër duhet pasur parasysh dhe duhet përqendruar vëmendjen në çdo imtësi dhe në çdo çështje të madhe, të cilën e thotë ky personalitet me famë.

Çdo herë kur jam ulur dhe kam biseduar me të dhe kemi parashtruar së bashku një ligj prej ligjeve apo një çështje prej çështjeve për të treguar dispozitën për të, apo sqarimin e ndonjë sekreti prej sekreteve të tij, menjëherë në brendi të mendjes sime është paraqitur gjendje e

jashtëzakonshme dhe është hapur memoria dhe është qetësuar mendja, e cila nuk ngopet.

Sqarimi i tij është i ëmbël, ai i tregon gjërat me ngrohtësi, burimet e tij janë të kulluara dhe të pastra, që përputhen me natyrshmërinë dhe i pranon intelekti, e cila ngritet lulëzon dhe jep fryte.

O Zoti im, prej këtij libri sill dobi, bëre prej veprave që peshojnë në fletushka dhe vendose në kandarin e veprave të mira, atë Ditë kur do të takohemi, bëre prej veprave të cilat na afrojnë te Ti, dhe të jetë prej sqarimit të librit Tënd fisnik, dhe sunetit të Pejgamberit Tënd besnik, i cili do të bëjë shefaat në Ditën e Vështirë, atë Ditë kur njeriu do të thotë: Mjerë për mua, po pse kam tejkaluar dhe nuk iu kam afruar Allahut; Atë Ditë kur njeriu thotë: Mjerë për mua çka paskam vepruar në jetën time; Ditën kur çdo njëri do të konfrontohet me veten e tij; atë Ditë çdo çështje është vetëm e Allahut!

O Zoti ynë! Pranoje prej nesh se vërtet Ti dëgjon dhe je i Ditur.

Kajro, Janar, 1981
Rebiul Evel, 1401
Dr. Sejid Xhemil

SHAËRAVIJU DHE SËMUNDJET NGJITËSE

U zhvillua një bisedë në mes të Imamit të nderuar dhe të mirënjohur, Muhamed Muteveli Shaëravijut dhe të tjerëve që ishin të pranishëm. Tema ishte për një çështje në lëmin e medicinës dhe tepër e thellë. Unë u befasova kur shejhu shpjegonte medicinën si të ishte i specializuar në atë drejtim, sikurse të ishte ai i cili ka studiuar medicinën thellë dhe ka një përvojë të madhe. Sqaron bukur, flet i sigurt, hyn në detaje. Ne veç kemi qenë në fakultet të medicinës, kemi dëgjuar ligjërata, pastaj atë që e kemi dëgjuar e kemi përcjellë në praktikë. Profesorët na shpjegonin temat kryesore, mirëpo, në shumicën e rasteve, shumë tema bëheshin të paqarta për ne, pastaj ata mundoheshin me një angazhim të madh për të na sqaruar në detaje, derisa e kuptonim mirë, derisa ngulitej në mendjet tona dhe pas një kohe ne gjatë jetës në praktikë hasnim në shumë vështirësi. Mirëpo, ja unë mjek i specializuar, prapë student i medicinës pranë prof. dr. Muhamed Muteveli Shaëravijut!

I thashë: Sëmundjet ngjitëse dhe trashëguese fillojnë si sëmundje shëruese (të përkohshme) dhe nuk shoqërohen me temperatura të larta, e kjo për shkak të neglizhencës, pakujdesisë dhe përtacisë, sepse i sëmuri nuk ndien dhembje në to. Dhembja gjithmonë është rruga e cila të nxitë për shërim dhe për ta kërkuar ilaçin.

Imami i mirënjohur tha:

Për këtë arsye Islami kujdeset për shëndetin e muslimanit duke ndaluar prostitucionin, për të mos u përhapur këto sëmundje, që muslimani të mos e zbrazë përbërjen (farën) e tij vetëm se në familjen (bashkëshorten) e tij, se përndryshe kanoset rreziku i përgjithshëm dhe kanoset rreziku i katastrofës.

Për këtë arsye shohim se i sëmuri lëngon me qarkullimin e madh të qelbit me urinë me vite të tëra, kurse ai heziton për t'u shëruar dhe nuk interesohet për shërim, sepse ajo nuk është e shoqëruar me dhembje ose temperaturë.

KANCERI DHE DHEMBJET E TIJ

Shejh Shaëraviju më pyeti:

A e di, pse kanceri paraqitet (identifikohet) befasisht?

A e di, pse nuk ndien i sëmuri prej kancerit dhimbje në fazën e parë të tij?

A e di, pse i sëmuri kanceroid ndien dhimbje të madhe në fazën e fundit?

Pasi i dëgjova këto pyetje me vëmendje, e riktheva mendjen time në të kaluarën dhe menjëherë m'u kujtuan pyetjet disi të ngjashme, të cilat m'i ka parashtruar komisioni i mbrojtjes së diplomës së fakultetit kirurgjik. Ishte në pyetje kanceri i gjinjve dhe shkaqet e infektimit të tyre. Pastaj të sëmurën e sjellën në sallë të operacionit për t'i bërë disa analiza. Prej operimit të mëhershëm u vërtetua se infektimi ishte përhapur në tërë gjirin, i shoqëruar me puçrra limfatike nën kraharor, dhe kjo u kuptua se është përhapur për shkak të operimit të mëhershëm në këtë pjesë.

Pyetjet e komisionit kanë qenë:

- *Cili është shkaku i përhapjes së kancerit gjatë operimit?*
- Për shkak të kancerit femëror (rrënjëve të tij) – u përgjigja.
- *Çka nënkuptohet me fjalën rrënjë (femëror)?*
- Infektimi prej puçrrave limfatike.
- *Po pse?*
- Sepse është prekur, ndikuar prej elementeve kancerogjene dhe kështu është përhapur, dhe kjo për arsye se identifikimi është bërë vonë.
- *Cili është shkaku i identifikimit tepër vonë?*
- Sepse kanceri i gjinjve nuk shkakton dhimbje të konsiderueshme në fillim dhe për këtë arsye nuk i kushtohet vëmendje, dhe nuk shikohet.
- *Pse në shumicën e rasteve të kancerit dhembjet e mëdha paraqiten në fazën e fundit?*
- Sepse ajo përhapet gradualisht dhe arrin në masën më të madhe, dhe kështu bën presion në hapësirën përreth, dhe aty shkakton ngushtim dhe lodhje, e nga aty rezulton dhimbja e madhe.

Shejh Shaëraviju më sqaroi mua se si kanceri shkakton dhimbje të madhe në fazën e fundit të tij: Allahu i Lartmadhëruar ka bërë që çdo organ të ketë hapësirën e vet të lëvizjes në trupin e njeriut. Allahu i Lartmadhëruar e

ka strukturuar në hollësi që çdo pjesë organike të jetë harmonike me pjesët tjera. Gjoksin e ka bërë për ta mbrojtur zemrën prej çdo fërkimi apo ndeshjeje, po ashtu edhe mëlçinë dhe mushkëritë, përqendrimi i tyre brenda gjoksit u siguron atyre që të mos qahen (pëlcasin), sepse ndeshja me çdo trup fizik ato do të pëlcitnin, pra do të qaheshin mushkëritë dhe mëlçia.

Kur të lëngon një organ prej organeve prej kancerit, atëherë ajo zbrazëti funksionon jonormal dhe shkaktohet çrregullim. Kështu përhapet shumëfish kanceri nga hapësira e mëparshme dhe çrregullon hapësirën e tjetrit organ, i bën presion atij, ia zë frymën, e kjo është shtrëngim i madh dhe mizori e madhe ndaj organit tjetër, e atëherë bërtet i sëmuri, sepse ka filluar konflikt mes organeve të brendshme, e kjo dhimbje shumëfishohet pasi që ato pjesë janë plasaritur dhe janë thyer.

POZITIVITETI I MASHKULLIT DHE NEGATIVITETI I FEMRËS

Zoti i Lartmadhëruar ka vendos lidhjen seksuale në trupin e njeriut me qenë fshehtësi prej fshehtësive dhe urtësi prej urtësisë së Tij.

Dhe kontaktin fizik seksual e ka bërë prej çështjeve më të mëdha, në të cilat anon mendja, epshi dhe shpirti. Ajo është kërkesë shpirtërore, trupore dhe mendore. Nëse para një njeriu kalon një femër e bukur, me pamje të zbukuruar e tërheqëse, por bukuria e saj këtij njeriu nuk ia tërheq ndjenjat, atëherë mjekësia konstaton se ai njeri është i sëmurë, pa ndjenja të epshit dhe mangësi seksuale. Në medicinë ky person menjëherë duhet t'i nënshtrohet shërimit, sepse ai është pa ndjenja seksuale në aspekt mjekësor dhe sëmundja duhet të shërohet, sepse nuk ka kurrfarë ndjenja. Kjo është sëmundje prej sëmundjeve kyçe të trupit të njeriut. Seksualiteti në trupin e njeriut është çështje që duhet të jetë në kulminacion të ndjenjave dhe në kulminacion të kënaqësisë. Allahu e ka bë këtë, sepse nëpërmjet saj shtohet lloji dhe nuk zhduket, por mbetet njeriu si krijesë normale e llojit të pazhdukur. Kur i fola shejh Shaëravijut për këtë çështje, ai u paraqit si mjek specialist, diskutoi me logjikë shkencore për praktikën mjekësore, të cilën e kisha lexuar dhe e kisha studiuar me vite të tëra.

I nderuari tha:

Kur të ndodh kontakti në mes mashkullit dhe femrës, mashkulli e ka rolin pozitiv, sepse ai e hedh *menin (farën)*, e cila bashkëdyzohet. Ai për këtë i nevojitet mund dhe angazhim i madh, ndërsa për të bërë këtë femra e ka rolin negativ, sepse ajo bën vetëm hapjen për lirimin e rrugës, për hyrjen e organit të mashkullit, që me lehtësi të depërtojë dhe të mos ketë vështirësi.

Nuk ndodh shtatzënia derisa të mos bëhet bashkëdyzimi i mashkullorit dhe vezores, mirëpo çdo kontaktim seksual i femrës nuk lëshon vezoret, mirëpo vezoret lëshohen njëherë në çdo muaj, dhe atë në mënyrë të rregullt. Për këtë arsye roli i mashkullit është pozitiv, ndërsa i femrës negativ ose më pak pozitiv.

Ky shpjegim dhe ky sqarim i të nderuarit shejh Shaëravijut më ka mahnitur, dhe më ka befasuar, sepse njësoj e ka sqaruar edhe profesori ynë i njohur dhe i mrekullueshëm, dr. Muhamed Talat, Zoti e mëshiroftë, i cili ka qenë profesor i funksionimit të pjesëve të trupit në fakultetin e medicinës.

Sa i përket kësaj çështjeje (vol. IV) - KOMENT I DR. SEJID XHEMIJLË:

Ndoshta dikush thotë e pyet: Pasi që mashkulli është aktiv e femra pasive, atëherë pse procesi i shtatzënisë të mos ndodhë vetëm me spermën e mashkullit, e të mos ketë nevojë femra fare për pjesëmarrje në atë proces, sepse kuptimi i negativitetit do të thotë *mospasja nevojë fare*?

I përgjigjem atij me shpejtësi: Jo, kurrsesi jo! Ky element negativ është i domosdoshëm, patjetër duhet të marr pjesë në këtë proces, ai është element negativ, por që plotëson dhe është pjesë kryesore dhe e domosdoshme. Shembull për këtë kemi lidhjen elektrike: nuk bën dritë poçi elektrik pa u lidhur ana e kundërt. A mund të qarkullojë rryma elektrike apo patjetër duhet të lidhet pozitivi dhe negativi që të bashkohen, e pastaj të formohet rryma, e cila bën dritë?

Njësoj është edhe me trupin, i cili ka lëvizje dinamike. Mashkulli për çdo kontakt seksual hedh spermën, e cila mbarëson kur të dojë dhe ku të dojë. Mirëpo femra nuk është në gjendje që të mbarësohet për çdo kontakt seksual të burrit të saj. Sepse fazat e mbarësimit të saj janë të përcaktuara në epoka të caktuara.

MJETET E MOSSHTATZËNISË

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për "Azlin" (tërheqja e organit mashkullor prej vagjinës para ejakulimit), ai ka thënë: ***"Pse a po e praktikoni një gjë të tillë".*** **Këtë e ka përsëritur tri herë, e pastaj ka vazhduar:** ***"Çdo shenjë gjallese që e ka parapa Allahu të jetë deri në Ditën e Kijametit, do të jetë e krijuar gjallesë". (Mutefikun Alejhi)***

Në sahihun e Muslimit: ***"Vetëm se ju nuk e veproni (përfundimin e plotë seksual), Allahu prapë se prapë atë gjallesë që e ka shkruar të jetë e krijuar deri në Ditën e Kijametit, do të jetë e krijuar ajo gjallesë."***

Po ashtu në një rast tjetër kur është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për *azlin* (tërheqja e organit mashkullor prej vagjinës para ejakulimit), është përgjigjur: ***"Çdo spermë nga e cila është caktuar të lindet fëmijë dhe që Allahu dëshiron që të krijojë fëmijën (diçka), nuk mund ta pengojë askush".***

Koment:

Dr. Sejid Xhemil mendon se është domosdoshmëri që të vendoset ligj i rreptë për përdorimin e çfarëdo mjeti për pengimin e shtatzënisë, përpos në rastet kur lejon sheriati islam për shkak të domosdoshmërisë, për të mos u përhapur dukuritë me të cilat nuk është i kënaqur Allahu i Lartmadhëruar. Allahu na mbron nga lajthitjet dhe nga rënia në humnerë nga mëkatet.

Një ditë ishim duke ngrënë drekë së bashku me shejh Shaëravijun në shtëpinë e tij, me ç'rast ia parashtrova pyetjen në lidhje me ata, të cilët i përdorin mjetet e mosshtatzënisë për shkak se fëmijët e shumtë u sjellin vështirësi dhe probleme në jetë, me arsyetim se nuk mund t'ua sigurojnë rrizkun, kjo sipas mendimit të tyre, e ai m'u përgjigj:

Ne shohim se, shumë njerëz vdesin dhe lënë pas tyre fëmijë të vegjël, mirëpo Allahu cakton që të u përkushtohet përkujdesje, dhe Allahu përkujdeset për ta, e kështu ata fëmijë rriten dhe arrijnë shkallët më të larta në jetën e tyre, gjë që kurrë nuk do ta arrinin po të kishin qenë gjallë baballarët e tyre.

FEMRA DHE MBULESA

Sa i përket çështjes së mbulesës, shejh Shaëraviju ka qëndrim të butë dhe të lehtë. Sikurse e dimë ai gjithmonë në qëndrimet e tij është praktik, i natyrshëm, modest, i ngrohtë dhe flet me logjikë dhe intelekt të të madhështorëve, pasi që ai është i flaktë në fenë e pastër dhe thirrje të suksesshme për ta pranuar njerëzit në përgjithësi planprogramin e Zotit të vërtetë dhe të Lartmadhëruar. Përkundër asaj se, koha moderne lëngon me dukuri të shëmtuara, ai prapëseprapë thërret me urtësi, me këshilla praktike, polemizon për gjëra të cilat sjellin rezultat dhe janë të suksesshme, pa ngarkesa dhe pa fanatizëm.

Sa i përket formës së mbulesës së femrës muslimane, shejh Shaëraviju, në emisionin televiziv, sqaron në detaje çdo gjë, mirëpo ai është njeri praktik, ai gjithmonë përqendrohet dhe angazhohet në studimin dhe elaborimin e çështjeve në thellësi, në brendësi, ai është njeri i cili depërton në brendësi të njeriut. Derisa ishte musafir i emisionit tim televiziv, më ka thënë:

Ne dëshirojmë që në zemrën e femrës muslimane ta rrënjosim Imanin dhe kur të forcohet rrënja e imanit në brendësinë e saj, ajo vetë do ta kërkojë mbulesën, dhe bindet se mbulesa është mjet i shkëlqyeshëm për t'u mbrojtur nga shigjetat dhe lajkat e shejtanit.

Shejh Shaëraviju vërteton parimin e rëndësishëm. E ai parim është bindja dhe qetësimi i bazës dhe i asaj mbi të cilën mbështetet tërësia e qenies në brendësi. Nga kjo vërtetohet se imani buron nga brendësia, e pastaj tregohet dhe plotësohet në pjesën e jashtme.

Imani i pjesëve të brendshme ka prioritet dhe është më parësor se imani i pjesëve të jashtme. Hapësira e shpirtit dhe e zemrës patjetër duhet të mbushet me elemente të jetës së besimit. E nga aty, ajo angazhohet dhe kërkon të jetë e qëndrueshme, edukative dhe sa më e qëndrueshme edhe me pjesët e jashtme, pasi që besimi jonë i plotë është në mbulesën e plotë të femrës islame, sipas sheriatit, sepse kjo e ruan dhe e siguron familjen islame, e me të e mbron shoqërinë islame.

Koment:

Për të vërtetuar mendimin e shejh Shaëravijut themi: Dëshira e seksit për mashkullin është njësoj edhe te femra; e para e forcon të dytën, ndërsa e

dyta e tërheq të parën. Ky është një sekret interesant i instinktit dhe e gravitimit të dy gjinive, të mashkullit dhe të femrës, dëshirë e cila është pa dëshirën e tyre, sepse hormonet seksuale janë shkaktarë tek të dytë. Kur femra vishet me mbulesën islame dhe mbulohet tërësisht, pra i mbyll dyert e bukurisë dhe dyert indikativë dhe tërheqëse, ndërsa ajo veç i ka sytë e saj, me të cilat sheh gjithçka.

Këtu paraqitet një pyetje mjekësore, shpirtërore dhe filozofike: *Çka është ajo që ndërprenë apo pengon fatkeqësinë dhe e ulë tensionin dhe ndjenjat te ajo?*

Procesi i ndjenjave të femrave është pa lajka, sepse ajo është procesi i dëshmimit dhe shikimit. Kur ajo e sheh një djalë të ri, të pashëm, me trup të përkryer, të ndriçuar dhe të bukur, atëherë menjëherë hormonet femërore e nxisin epshin e saj për ta pëlqyer dhe për ta dashur, mirëpo përmbajtja e saj në planprogram dhe obligueshmëria ia ndërprenë asaj dhe nuk e lejon në mëkat.

Po të mos ishte kjo, atëherë problemi do të vazhdonte kur të fillonte nxitja edhe prej vet mashkullit. Ende topi është në anën e femrës, sepse ajo e sheh dhe ajo ende posedon elementet epshore dhe ndjenjat për seks, dhe nuk mund t'i kryej nga vetvetja e saj. Për këtë arsye, ashtu siç Allahu i ka urdhëruar meshkujt për ta ulur shikimin e tyre, ashtu i ka urdhëruar edhe femrat për uljen e shikimit të tyre, me qëllim që të ndërpritet rruga që shpie në tërheqje dhe në imoralitet.

Dhe, përderisa imani është i fortë dhe i ndritur, dashuria ndaj Allahut depërton në trupin e njeriut dhe atë e ngrit në piedestalin më të lartë, që do të thotë se: e ngrit trupin e njeriut në pastërtinë e melaqeve, të cilat nuk janë të njollosura me asnjë mëkat. Dhe çdo herë që shpirti ngrihet në qiell, në horizontin sa më të lartë, çdo herë epshet e trupit radhiten nën të dhe shndërrohet në mjet, në shërbim, dhe i mbikëqyrë e i kontrollon, dhe ndien qetësi kur ta përkujton Allahun. "Pra, duke përkujtuar Allahun qetësohen zemrat".

Çfarë vlere ka trupi para shpirtit shkëlqyes dhe të pastër? Normalisht nuk ka kurrfarë vlere, kur trupin e dobësojnë ditët dhe e shkatërrojnë vitet, dhe e harxhojnë aksidentet. Mirëpo, sa i përket shpirtit, sado që kalojnë vitet e jetës dhe sado që trupi vjetërsohet, shpirti ripërtërihet, forcohet e nuk dobësohet.

BARAZIA E FEMRËS DHE MASHKULLIT NË PUNË

Pyetje:

Pasi që femra merr pjesë në të gjitha fushat e punës, puna e saj na kërkon që ajo të barazohet me mashkullin, saqë në këtë shekull femra garon me mashkullin në punë, pasi që ajo është bashkëpjesëmarrëse në punë, ajo ka të drejtë të kërkojë barazi në të gjitha çështjet. A nuk është kjo në kundërshtim me ajetin Kur'anor, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Dhe meshkujt kanë shkallë më të lartë mbi ta (femrat)."** Dhe po ashtu në ajetin tjetër: **"Meshkujt janë më të fuqishëm dhe më prioritarë se femrat, në atë çka i ka vlerësuar Allahu, disa prej tyre mbi të tjerët, dhe në atë çka shpërndajnë ata prej pasurisë së tyre".**

Muhamed Muteveli Shaëravi përgjigjet:

Bashkëshortja thotë: Do të punoj me qëllim që burrit tim t'ia lehtësojë vështirësitë. Mirëpo, përkundrazi ajo ia shton vështirësitë atij, ashtu qysh ia shton vështirësitë vetes. Ajo nuk i ka lehtësuar atij asgjë, ai nuk e ka reduktuar përgjysmë orarin e punës së tij, por ai punon me orar të plotë.

Si mundet që ajo t'ia lehtësojë burrit të saj, kur ai punon pandërprerë dhe me orar të plotë! Njeriu duhet, pikë së pari, të shikojë punën e tij, ta dijë kufirin e punës dhe aftësisë së tij, e tek pastaj të angazhohet si të dojë, e pas kësaj e përcakton standardin e jetës së tij në bazë të të ardhurave të tij. Mirëpo, nëse e përcakton kufirin se sa dëshiron të ketë të hyra për të jetuar, mirëpo ato nuk mund t'i realizojë, atëherë ai orientohet në çështje tjera, mirëpo mund të lakojë dhe të mëkatojë, kështu që ai korruptohet dhe jep mito me qëllim që ta arrijë atë standard. Mirëpo ne themi: Jo! Standardi nuk përcaktohet derisa ta dish fuqinë dhe aftësinë tënde në punë. Me fjalë të tjera, derisa ta dish sasinë e të hyrave tua dhe nivelin e jetës tënde, e pastaj ti e përcakton sasinë e nevojave tua.

Nëse femra dëshiron ta ngreh nivelin e jetës së saj, më atë çka nuk e largon nga roli i saj si bashkëshorte dhe nga roli i saj si nënë, e cila përkujdeset për fëmijën e saj, dhe nuk e largon prej fushës së natyrës së saj, ajo ka të drejtë të punojë, por përbrenda aftësive të saj.

Femra duhet ta dijë llojin e punës së saj dhe mos të kalojë mbi aftësitë e saja. Kur'ani na tregon rastin e Musa a.s. me dy vajzat e pejgamberit Shuajb. Tregim, i cili përcakton domosdoshmërinë e punës së saj brenda

kufijve: **“Dhe babai ynë është shumë plak”.** Kjo ka qenë domosdoshmëri, e cila i ka shtyrë ato të punojnë, por brenda kufirit të tyre: **“Nuk mund t’iu jap ujë bagëtisë derisa të shkojnë barinjtë”.** Ndërsa detyrë e shoqërisë është: **“Dhe u ka ndihmuar atyre që bagëtia të pinë ujë”.** Pastaj, për të ardhur gjërat në vend: **“O babai ynë, shpërbleje atë”.** Babai i tyre e ka fejuar njërën vajzë me Musa a.s. për siguri, për shpagim të punës dhe për plotësimin e ndjenjës së vajzës së saj: **“Vërtetë unë dëshiroj të të martoj me njërën prej këtyre dy vajzave të mia”.**

SUNETIA DHE HAFADI

Suneti quhet rrethprerja e organit gjenital te meshkujt. Hafad quhet prerja (shkurtimi) i buzëve të organit gjenital te femrat.

Te hafadi prehet (hiqet) e tërë teprica e buzëve të organit gjenital të femrave, këtë e kanë praktikuar edhe egjiptasit e vjetër.

Imam Kurtubiju transmeton se Pejgamberi s.a.v.s. ka lind i bërë sunet, kështu ka lind edhe Ibrahimi a.s., ndërsa ai e ka bërë sunet Ismailin a.s..

Thuhet se feja e pastër, pra është e çiltër, dhe thuhet Ibrahimi i pastër, pra Ibrahimi i çiltër, që do të thotë i bërë sunet.

Muhamedi a.s. ka thënë: ***“Sunetia është sunet për meshkujt, ndërsa e pëlqyeshme për femrat”.***

Dijetarët mendojnë, se për këtë çështje dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme. Disa mendojnë se sunetia është vetëm për meshkujt.

Disa mendojnë se sunetia është vetëm për femrat. Disa nuk janë pajtuar për asnjërën.

Shejhu Mahmud Sheltuti nuk e ka pëlqyer Hafadin - sunetin për femrat.

Shafiijt mendojnë se sunetia është për të dy gjinitë.

Hanbelijtë mendojnë se sunetia është për meshkujt e jo për femra, ndërsa Hanefijtë dhe Malikijtë mendojnë ashtu siç ka thënë i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: ***“Sunet për meshkujt e pëlqyeshme për femrat”.***

Kur mjeku Sejid Xhemilë e ka pyetur Imamin e nderuar, Shejhun Muhamed Muteveli Shaëravijun, është përgjigjur: Sunetia për meshkujt, Hafadi (heqja e tepricës) për femrat, e që vetë emërtimi e tregon këtë. Hafad

do të thotë: Heqja e tepricës, e jo heqja. Për këtë arsye Muhamedi a.s. i ka thënë Umi Atijes, e cila ishte nga gratë muhaxhire dhe e cila i bënte sunet femrat: *Heqja tepricën, pra vetëm pjesën shtesë"*.

Nëse në organin xhenital femëror nuk ka buzë të mëdha, nuk ka nevojë të bëhet sunetia.

PASTRIMI PREJ XHENABETIT

Dr. Sejid Xhemilë:

Sipas asaj që në Kur'an është e sqaruar me ajete të qarta, ende neve nuk na është e qartë dispozita apo urtësia e obligimit të pastrimit nga xhenabeti (pas kontaktit seksual). Mirëpo ekziston urtësia medicinale e cila ka rëndësi të posaçme, e ajo është se pastrimi pas kontaktit seksual është domosdoshmëri për të penguar sëmundjet e lëkurës, ose sëmundjet tjera trupore. Sa i përket urtësisë së obligimit të pastrimit Shejh Shaëraviju tha:

Për atë i cili beson, urtësi (arsye) e çdo obligimi prej Allahut është vet obligimi, dhe nuk pyetet urtësia (arsyeja) për çdo çështje. Urtësia shikohet vetëm atëherë kur urdhërdhënësi dhe urdhërmarrësi janë të të njëjtit rang apo kategori.

Siç thotë Shaëraviju:

Imani është arsye (urtësi) e çdo dispozite, e cila vjen prej Zotit të Lartmadhëruar.

Absolutisht, kjo nuk e mohon atë se dispozita nuk ka arsye apo urtësi, mirëpo urtësia është më specifike se obligueshmëria. Po të kishte qenë pastrimi prej xhenabetit shkak medicinal do t'ia kishte ndaluar Allahu të sëmurit ta prekë mus-hafin. Shejh Shaëraviju nuk e parasheh se është shkak apo arsye e fort medicinave, por ai vazhdon e thotë:

Urtësia e një dispozite apo një obligimi vërehet tek pas përmbajtjes apo mospërmbajtjes së atij obligimi, mirëpo asnjëherë nuk mund të paraprijë, pse po t'i paraprinte urtësia veprës, atëherë përmbajtja e atij urdhri është për arsye të urtësisë dhe shkakut, ndërsa Imani është dëgjueshmëri ndaj urdhërdhënësit. Për këtë arsye, arsyeja apo shkaku i ndonjë obligimi, i cili buron prej Allahut paraqitet pas një kohe të caktuar për të vërtetuar atë obligueshmëri, sepse për çdo çështje që nuk e di arsyen, e ka arsyen. P.sh.

Mishin e derrit, a ka qenë dashur për ta pezulluar urdhrin deri sa të vijnë analizat mjekësore, e të na sqarojnë se është i dëmshëm për njeriun dhe shëndetin e tij?! Mirëpo ne njëherë kemi thënë: Ne kemi besuar në ndalimin e mishit të derrit, pirjen e alkoolit, vetëm pse ka qenë urdhër për t'u ndaluar.

Ndërsa gjetja e shkakut dhe arsyes tani është dëshmi se çdo vepër apo dispozitë e ka arsyen dhe urtësinë, e pastaj të bëjmë krahasim në mes të asaj që dimë dhe në mes të asaj që nuk dimë. Nëse çdo dispozitë e shikojmë vetëm për shkak të arsyes, atëherë Imani nuk ka kurrfarë vlere.

Ata të cilët e kanë lejuar shkurorëzimin, ndërsa nuk u kanë besuar në lejimin e shkurorëzimit atyre të cilët e kanë lejuar, ata kanë vepruar ashtu janë shkurorëzuar, sepse e kanë parë se vetëm në atë mënyrë mund t'i zgjedhin problemet e tyre, atëherë shkurorëzimi i tyre nuk ka të bëjë me Imanin, sepse ata nuk kanë besuar në lejimin e shkurorëzimit, mirëpo në momentet e fundit domosdoshmëria i ka sjellë deri te një veprim i tillë.

Xhunubi as nuk lexon Kur'an, as nuk e prek Muh-hafin, as nuk lejohet të falet deri sa të jetë xhunub.

Një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: ***"Unë jam pastruar nga xhenabeti, dhe e kam falur namazin e sabahut, mirëpo pastaj kam parë një pjesë në trup sa e thoit, të cilën pjesë nuk e kisha pastruar (me një fjalë nuk e kishte përfshirë uji). Muhamedi a.s. i tha: Nëse e ke prekur, e ke lëmuar me dorë, atëherë të pranohet". (E KA REGJISTRUAR IBN MAXHE)***

Tregon Thuëbani:

Kanë kërkuar përgjigje prej Muhamedit a.s. për pastrimin prej xhenabetit. E ai është përgjigjur:

"Sa i përket mashkullit ai pastron kokën deri sa t'i arrij uji në rrënjë të flokëve. Ndërsa femra nuk i prishë bishtalecat e saj, mjafton të hedhë ujë në kokë tri herë me grushte të dorës".

(E KA REGJISTRUAR EBU DAVUDI)

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për mashkullin, i cili gjen shenja të lagies (në brekët e tij), mirëpo nuk e di se ka pa ëndërr. Muhamedi a.s. ka thënë: Pastrohet. Po ashtu është pyetur për mashkullin, i cili ka pa ëndërr mirëpo në rroba nuk ka shenja të spermës (lagies). Muhamedi a.s. ka thënë: Ai nuk pastrohet.

E ka pyetur Umu Selmete Muhamedin s.a.v.s.: ***"O i Dërguari i Allahut, unë i kam bishtalecat e gjatë, a ti prishi kur të pastrohem nga***

xhenabeti? Iu është përgjigjur: Jo! Të mjafton me hedhë ujë në kokë tri herë, pastaj me përfshi me ujë." (E KA REGJISTRUAR MUSLIMI)

FËMIJA I EPRUVETËS

"Dhe Ai di çka ka në mitër". Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"S'ka dyshim se vetëm All-llahu e di kur do të ndodhë Kijameti, Ai e di kur e lëshon shiun. Ai e di se ç'ka në mitra (të nënave), nuk e di kush pos Tij se ç'do të ndodhë (çka do të punojë) nesër, dhe askush nuk e di, pos Tij, se në ç'vend (ose kohë) do të vdesë. All-llahu është më i dijshmi, më i njohuri". (El-Lukman, 34)

Dituria e të Lartmadhëruarit i parapriu çdo gjëje dhe është i papërkufizuar me ndonjë vend apo ndonjë kohë. Para dy viteve kam mbajtur një temë shkencore ku ishin prezent studentët e dy fakulteteve. Kam bë pyetje lidhur me fëmijën e epruvetës. Pra, formimi i fëmijës prej spermës së mashkullit dhe vezores së femrës, duke i vendosur që të dyja në kushte të volitshme, pra të ngjashme me mitrën e femrës, me temperaturë të ngjashme, e pas një kohe bartja e atij bashkëdyzimi në mitrën e nënës, ku vazhdon të rritet dhe të zhvillohet.

Parashtrohet pyetja:

A është në kundërshtim kjo me ajetin kur'anor:

"Dhe Ne veç e kemi krijuar njeriun", dhe ajetit tjetër **"Dhe ai di çka ka në mitër"**. A është kjo në kundërshtim me zbulimet mjekësore ku duhet gjinia e fëmijës, a mashkull a femër në barkun e nënës?

Imami i mirënjohur thotë:

Të gjitha këto zbulime janë bërë në bazë të eksperimenteve ku shkaqet i ka caktuar Allahu, marrjen e mashkullorit te mashkulli, i cili është i krijuar prej Allahut, dhe po ashtu marrjen e vezores te femra, e cila është e krijuar gjithashtu prej Allahut, dhe në vendin ku e ka caktuar urtësia e Allahut. E pse nuk janë në gjendje për ta gjetur një vend tjetër për t'u zhvilluar embrioni, por e rikthejnë në mitrën e nënës, pra kthehet prapë në bazë.

Sqarimi i parë:

Asnjë e arritur shkencore nga çfarëdo çështje nuk arrihet pa vullnetin e Allahut të Lartmadhëruar, i Cili e ka parapa dhe e ka përcaktuar me diturinë e

përhershme pa fillim. Po mos të kishte dashur Allahu nuk do të zbulohej dhe nuk do të arrihej asnjë e arritur shkencore. Me zbulimet mjekësore dhe me sukseset madhështore, për ta ditur gjininë në barkun e nënës nuk shohim se ka ndonjë kundërshtim me fjalën e Zotit të Lartmadhëruar: **"Dhe Ai di çka ka në mitra"**.

Sipas mendimit të Shaëravijut: Ky zbulim shkencor i njeriut nuk do të ishte arritur pa u bërë analiza, dhe pa bë eksperimente, e tek pastaj është paraqitur suksesi apo e arritura mjekësore për ta njohur gjininë e fëmijës në barkun e nënës. Mirëpo dituria e Allahut është e papërkufizuar dhe nuk është e varur prej analizave dhe eksperimenteve, ajo është dituri pa fillim, dituri dhe njohuri para se të ndodhë embrioni në mitër. Pastaj vazhdon e shton Shejh Shaëraviju duke thënë: Mjekësia nuk mund t'i dijë të gjitha çështjet sekrete që janë të ndërlidhura me fëmijën.

Për shembull, për ta ditur se a do të jetë: i gjatë apo i shkurtër; i mençur apo mendjelehtë, apo i çmendur; besimtar apo pabesimtar. Kjo është dituria të cilën Allahu e di, e dituria njerëzore nuk mund ta dijë, sa do që të zhvillohet dhe ngritet.

Ky është mendimi global i të nderuarit Shejhut Muhamed Muteveli Shaëravijut në lidhje me këtë çështje.

Komenti i Dr. Sejid Xhemilit

Fëmija i parë i epruvetës ka lindur në vitin 1978, pastaj ka vazhduar me sukses kjo e arritur mjekësore, posaçërisht në Angli.

Edhe pse Britania e Madhe e ka filluar këtë të arritur, edhe shumë shtete tjera e kanë kryer me sukses këtë të arritur, bile edhe e kanë zhvilluar më shumë, duke i siguruar fëmijës ambient shumë të përshtatshëm.

Australia është e para, e cila nëpërmjet epruvetës ka arritur që të lindin binek. Kjo e arritur, pra për lindjen e binekëve është bërë kësisoj:

Merret vezori prej vezorëve, bëhet bashkëdyzimi në epruvetë me mashkullorin, pastaj vendoset në mitër, dhe fillon shtatzënia normale. Kjo është mënyrë e cila praktikohet te femrat sterile, të cilat i kanë kanalet e mbyllura, përkundër kësaj ky proces është shumë i vështirë dhe tepër i ndërlikuar. Dijetarët (mjekët) australian kanë zbuluar formë tjetër që në vend se të pritet që te femra të formohen vezoret një herë në muaj, ata i japin femrës kapsula, të cilat ndikojnë që te femra të prodhohen më shumë vezore,

bile edhe shumë vezorë në të njëjtën kohë, për këtë arsye asaj i jepet mundësia në prodhimin sa më të shumtë të vezorëve, pra bëhet vendosja në mitër. Nëse Allahu ka vullnet, kjo eksperiencë, u jep raste të volitshme për të bërë lindje binekësh femrave sterile.

MARTESA MUT 'ATUN (E PËRKOHSHME)

Martesë "MUT'ATUN" quhet martesa e kushtëzuar apo e përcaktuar në një periudhë kohore, që do të thotë se me skadimin e asaj periudhe kohore akti i kurorëzimit ç'vleftësohet, dhe secili prej bashkëshortëve vazhdon jetën e vet të lirë. Dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme për këtë lloj martese. Disa mendojnë se Muhamedi a.s. e ka lejuar këtë lloj martese dhe nuk e ka ç'fuqizuar këtë ligj. Në krye të këtij mendimi është komentuesi njohur Imami Fahrur Rraziju, i cili këtë mendim e jep në tefsirin e tij "TEFSIRUL KEBIRË". Disa dijetarë kanë shtuar: Nëse ky lloj kurorëzimi ndalon dukurit neveritëse dhe amorale, atëherë nuk ka pengesë për të. Mirëpo pjesa më e madhe e dijetarëve thonë se ky lloj martese absolutisht është e ndaluar, sepse akti i kurorëzimit bëhet për t'u ç'fuqizuar, e për këtë nuk ekzistojnë hadithe të vërteta dhe autentike.

Ne veç vërtetuam atë se nuk ka nevojë të polemizohet aq shumë, sepse këtë lloj martese nuk e pranon askush, pos një numri të vogël të njerëzve labil dhe në kushte të paqarta, dhe të turbullta, dhe që në esencë ligjësimi nuk parasheh mëshirë, dashuri dhe qetësi, gjë që këto tri elemente nuk lejojnë ligjësimin e një akti të tillë, prandaj konsiderohet akt i pavlerë dhe jo i plotfuqishëm.

Ishte e patjetërsueshme që këtë çështje t'ia parashtrojmë Imamit të nderuar Muhamed Muteveli Shaëravijut, i cili me të shpejtë me ngulm u përqendrua në programin e Allahut, ku tha: Përkufizimi (në kohë) i aktit të kurorëzimit është prej çmendurisë së njerëzve. Pse Muhamedi a.s. ka thënë: ***"Unë atë që ua pata lejuar më parë martesën e përkohshme, tani ua ndaloj atë".***

Imami i nderuar pastaj vazhdon e thotë:

Nuk po hyj në atë se a është shfuqizuar ai ligj apo jo, por martesa e

përkohshme (MUT- ‘ATUN) është anomali dhe injorancë, pasi që njeriu ka të drejtë të lëshojë kë të dojë kur të dojë. Ndërsa, disa e bëjnë nijet vetëm dëfrimin dhe kënaqësinë epshore të përkohshme, jo të përgjithmonshme; disa thonë se kur një njeri martohet pa kusht kohor, atëherë në çdo kohë mund ta lëshojë bashkëshorten. Kjo i shkon përshtati mashkullit për ta tejkaluar problemin e tij, po si është e mundur që femra të jetë kënaqësi e përkohshme epshore për mashkullin i cili dëshiron ashtu?!

Një çështje tjetër: Po kush mund t’i sigurojë ato që të bashkëjetojnë vetëm në kushte të tilla të posaçme?

Komenti i Dr. Sejid Xhemilë

A nuk e dinë ata mendjelehtë se ligjet e sheriatit janë në favor të tyre, pra për ta lënë në kompetencën e tij shkurorëzimin në çfarë do kohe dëshiron, kjo është bë për lehtësim, ndërsa ata vetë ia ngushtojnë rrethin vetës së tyre. A nuk është kjo mendjelehtësi e vërtetë?! A nuk është çmenduri që njeriu t’ia ngushtojë rrethin vetes së tij përderisa Allahu ua ka zgjeruar dhe i ka favorizuar ??!! Nëse njëri sot martohet e nesër shkurorëzohet, ai nuk ka mëkat.

Nuk mund të zgjatë lumturia në jetë deri sa ajo jetë nuk është mirësi e ndërsjellët dhe e vazhdueshme, dhe bashkim i sinqertë mes femrës dhe mashkullit. Islami i ka mbjellë dhe i ka rrënjosur parimet e dashurisë dhe respektit të lirë në vend se me qenë dashuri e imponuar, me kontratë dhe lidhje të shenjtë, njëherit e ka fisnikëruar qiftin me nijet të vazhdueshëm, dhe të përgjithmonshëm, që të jetë respekti i ndërsjellët, dhe ka tërhequr vërejtjen për të pasur kujdes që kontrata martesore të mos jetë si ushqimi dhe pija, ngase ushqimi dhe pija nuk ka të përbashkët me dashurinë e sinqertë, sepse në ushqim dhe pije njerëzit gjithmonë dëshirojnë të freskët dhe joshëse, ndërsa dashuria e epshit është shtyllë martesore që në themel duhet të ketë vendosmëri, duke mos lejuar që epshi të dominojë.

MARTESA URFIJ (TRADICIONALE)

Martesa "URFIJ" është martesa në mes dy palëve, në pajtueshmërinë mes tyre dhe dy dëshmitarëve, mirëpo (dija për këtë martesë) nuk zgjerohet më shumë se te ata dëshmitarë, kështu që, në shumicën e rasteve, specifike dhe kryesore është të mbajturit sekret. Mirëpo, kryesore në sheriatin Islam dhe rukn i martesës është që martesa të mos mbahet sekret.

Kur dr. Sejid Xhemilë e ka pyetur Imamin Shaëravijun për këtë çështje është përgjigjur:

Konsiderohet martesë ligjore-legjitime e sheriatit me kusht që të mos mbahet sekret dhe të lejohet që të jetë e lajmëruar martesa në çdo rast.

Ligji laik është ligj që e pranon vetëm aktkurorëzimin, që të jetë bazë sipas të cilit rezultojnë të drejtat dhe obligimet. Për këta arsye gjykohet trashëgimtari edhe nëse ndonjëherë nuk ka pasur aktkurorëzim zyrtar.

Koment:

Islami ka ardhur për ta ruajtur nderin e njerëzve prej njerëzve. Kusht i patjetërsueshëm është lajmërimi, prandaj martesa duhet bërë haptazi, që do të thotë të shpërndahet lajmi se filani e ka fejuar filanen, me qëllim që të ruhet nderi prej thashethemeve, sepse në çdo shoqëri dhe në të gjitha kohërat ka pasur gjuhë të cilët kanë akuzuar të pafajshmit, kështu që çdo njeri me lajmërimin e aktkurorëzimit merr përgjegjësitë në vijim. Kështu ai edhe moralisht në të ardhmen nuk mund t'i ikë përgjegjësisë së martesës.

DHURIMI I VETVETES

Dhuratë (VEHBETU) quhet atëherë kur një femër ia dhuron një njeriut veten e saj në momentet kur nuk ka regjistrues e as dëshmitarë, siç ndodhte në vendet e largëta shkretinore. Në këtë akt ekziston oferta dhe pranimi i ofertës. Shembull konkret për këtë kemi kur zonja Haxhere ia ka ofruar dhuratë veten e saj Ibrahimit a.s.

Dhurimi i vetvetes ekziston drejtpërsëdrejti në Kur'an, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Ose një femër ia dhuron veten e saj pejgamberit"**.

Për këtë lloj martese Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë:

Me rëndësi është që fuqizimi i martesës të jetë ruajtja e nderit të njerëzve prej njerëzve, andaj kjo është degë e martesës URFIJ (tradicionale), ndërsa kushtëzimi i dëshmitarëve është që e njëjta është martuar me të njëjtin, dhe kush dëshiron për t'u martuar me dikë le të martohet dhe kujdestari i saj (prindi, vëllai) ta dëshmojë këtë dhe ta kryejë atë aktkurorëzim, sepse në të kundërtën kush do ta dinte se një femër është martuar me një mashkull nëse nuk ndodh kështu?

SHKURORËZIMI DHE POLIGAMIA

Cilat janë shkaqet kryesore të poligamisë (martesës me dy, tri, apo me katër gra)? Pse e lejon sheriati këtë, cila është urtësia e lejimit poligamisë në Islam?

Shejh Shaëraviju mendon:

Ka çështje të cilat i definon ligji, por ato nuk janë prej tij, kështu akuzohet faktori njeri për poligaminë në njërën anë dhe shkurorëzimin në anën tjetër. Shejh Shaëraviju mendon se njerëzit martohen edhe pse Allahu nuk kërkon prej tyre të martohen mes vete, ata e kanë futur veten e tyre pa shikuar barometrin Islam, kështu që nuk është e drejtë që çështja të shërohet duke anashkaluar Islamin.

Shejh Shaëraviju mendon:

Ai i cili pranon të martohet ashtu siç e kërkon Allahu, nuk do të ishte paraqitur nevoja për shkurorëzim të asaj martese dhe nuk do të kishte faktorë të dëmshëm në bashkëjetesë dhe martesë. Drejtësi është që të mos ndodhë mosmarrëveshje martesore, sepse po të ndodhte një gjë e tillë atëherë do të ishte në kundërshtim me programin e Allahut dhe do të paraqitej dyshimi tek ne për programe të tilla.

<u>Koment i Dr. Sejid Xhemijlë:</u>

Jeta bashkëshortore mundet të jetë e mundimshme gjatë tërë jetës. Unë nuk mund ta paramendoj që në jetën bashkëshortore t'i përmbahen rregullave

të ligjit dhe disiplinës së programit të Allahut të Lartmadhëruar pa mos u kundërshtuar urdhrat e Tij.

Kam shumë shokë prej dijetarëve me famë, të cilët janë të devotshëm, të ndershëm, për të cilët jam i sigurt se i përmbahen disiplinës së ligjit të Allahut të Lartmadhëruar dhe që të gjithë janë të lumtur në shtëpitë e tyre me gratë e tyre dhe me fëmijët e tyre. Dhe asnjë anëtar i familjes së tyre nuk është për të bërë ndonjë problem brenda familjes, ndërsa tek të tjerët, pos tyre, po. Kjo dëshmon prerë se e mira është tërësi, mirësi në programin e Allahut dhe qetësia e zemrës dhe e shpirtit është në dëgjueshmëri dhe respektimit të Krijuesit të Lartmadhëruar.

USHQIMI (MISHI) PREJ IMPORTIT

Gazeta "IËTISAM" e ka rrahur problematikën, e cila ka rëndësi të posaçme, e ajo problematikë është mishi prej importit dhe konservat e importuara, të cilat mishra janë të ngrirë, ndërsa në tiketë është e shkruar "Është e prerë sipas sheriatit Islamik", tiketë e cila të bënë me dije dhe të heq dyshimin se është haram, mirëpo, përkundrazi në të ka mish derri dhe mishra tjerë të ndaluar sipas sheriatit Islam. Pra gazeta "IËTISAM" ka nxjerr në pah ajo çka është parësore në fe dhe ajo çka feja e pastër nuk lejohet të njolloset.

Këtë çështje ia kam parashtruar Imamit të nderuar Muhamed Muteveli Shaëravijut, i cili sqaron:

Në konserva ka edhe çështje tjera, të cilat shpijnë në dyshim, sepse në disa konserva është e shkruar "Është e prerë sipas sheriatit Islam", mirëpo pas hapjes së atyre konservave kanë parë konservë të "SIRDINIT", i cili nuk është mish fare, por vetëm bimë. Një gjë e tillë të vë në pozitë që ta humbësh besimin në konserva në tërësi, prandaj vijmë në konkludim se kjo është tregti e cila synim ka vetë arritjen deri te profiti, në çfarëdo lloj mënyre dhe në çfarëdo forme qoftë. Në etiketa i shkruajnë ato gjëra për të na joshur neve, ndërsa në brendësi është e kundërta. Prandaj, rregull është: *Ai i cili të gënjen në atë që ti e di, të mos i besosh asaj që ai e thotë, e ti nuk e di.*

Zoti e shpërbleftë Dijetarin tonë të njohur, ia shtoftë diturinë, të mirat dhe fisnikërinë.

DHËNIA E GJAKUT GJATË OPERACIONIT DHE PAS OPERACIONIT

Pyetje: A ka mëkat dhënia e gjakut (bartja) prej një personi në personin tjetër gjatë operacionit dhe pas operacionit?

Përgjigje: Nuk ka mëkat për dhënien e gjakut (bartjen) prej një personi në tjetrin.

Kjo veç është e njohur tek ne mjekët, nuk ka asgjë, absolutisht, të keqe, mirëpo ajo çka më shtyri në këtë pyetje është që ta marr mendimin e Shejhut të mirënjohur, e ajo është se ky lloj operacioni kryhet në momente specifike të vështira, atëherë kur pacienti është në momentet e rrezikut të jetës, ndërsa dhënia e gjakut atij, prej grupit të tij, është ndihmë për jetë. Qëllimi fisnik është nijeti i mirë. Pra, qëllimi është shëndeti dhe shërimi, sepse Muhamedi a.s. gjithmonë e ka lutur Allahun për shëndet dhe falje në këtë botë, dhe në botën tjetër.

NDALESA E ALKOOLIT

Edhe sot e kësaj dite ka të atillë, të cilët thonë se alkooli nuk është i ndaluar, sado që angazhohesh për t'i bindur se është i ndaluar.

Përgjigjet: Po të ishte e ndaluar në mënyrë të prerë Zoti i Lartmadhëruar do të kishte thënë:

"U është ndaluar juve alkooli", sikurse ka thënë: **"U është ndaluar juve cofëtina, gjaku dhe mishi i derrit ...".** Por, për alkoolin Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"Nuk ka dyshim se alkooli dhe putat janë fëlliqësirë e prej veprimeve të shejtanit ..., andaj largohuni ...".

Cili është mendimi i Shejh Shaëravijut në ndalimin e alkoolit?

Imami i nderuar, Shejh Shaëravijut thotë:

Nuk ka dyshim se alkooli në Kur'an është i ndaluar rreptësisht dhe në mënyrë të prerë. Për këtë nuk ka çka të diskutohet. Mirëpo, përdorimi i fjalës

së Zotit të Lartmadhëruar "LARGOHUNI" ka kuptim më të fortë se ndalimi duke përdorur thënien "Ju është ndaluar juve alkooli".

Pra, fjala "LARGOHUNI" ka kuptimin për të mos iu afrua "kurrë". Gjithmonë duhet larguar nga ndalesat që i ka ndalu Allahu, mos me iu afrua kufirit të ndalesës asnjëherë, sepse nëse i afrohesh mund të mashtrohesh, e pastaj sprovohesh. Pra, fjala "LARGOHUNI" është më e fuqishme se sa fjala "MOS E VEPRO".

E njëjta çështje qëndron me prostitucionin, siç është përdorimi i fjalës "Dhe mos iu afroni prostitucionit". Pra, mos iu afroni vijës (derës), sepse shpërthen dera e epshit dhe e shejtanit. Nga këtu shihet se: Nuk ka dyshim se forma "MOS IU AFRONI" është më e fuqishme dhe më e prerë se forma e ndalimit. Sepse, po të më kishte thënë mua Zoti i Lartmadhëruar: Ju është ndaluar alkooli, atëherë do të më ishte lejuar për të shërbyer alkool me gotë alkoolistin, dhe nuk do të kisha qenë në kundërshtim me ligjin e ndalimit të alkoolit. Po ashtu do të më ishte lejuar për të prodhuar alkool, për të bërë tregti me alkool, për të hapur restorant të alkoolit, për të mbajtur në shtëpi për gosti të të tjerëve, për të qenë në mesin ku pihet alkooli dhe nuk do të kisha pasur kurrfarë mëkati për gjërat e tilla, etj.

Mirëpo, fjala e Zotit të Lartmadhëruar "LARGOHUNI" ka kuptimin se muslimani e ka të ndaluar që të jetë në vendin ku përdoret alkooli ose për ta bartur, ose të bëj tregti me të. Pastaj vjen hadithi, i cili sqaron në detaje, ku Muhamedi a.s. thotë: ***"Allahu e ka mallkuar alkoolin, alkoolistin, shërbyesin e bartësin ...",*** *deri në fund të hadithit.*

Si është dispozita e atij i cili trashëgon alkool?

Përgjigjja: ***"Ka pyetur Ebu Talha (Muhamedin a.s.) për jetimët, të cilët kanë trashëguar alkool. Iu është dhënë përgjigjja: "Derdheni". Ka thënë: - Po, a ta shndërroj në uthull? - I ka thënë: "Jo!" (SAHIHË).***

Në një transmetim tjetër të Ebu Talhas qëndron:

Ebu Talha i ka thënë Muhamedit s.a.v.s.: - O i dërguari i Allahu, kam blerë alkool për jetimët deri sa kam qenë i izoluar. Muhamedi s.a.v.s. i ka thënë: "Derdhe alkoolin dhe thyeji bidonët". I DËRGUARI E KA THËNË TË VËRTETËN

Tarik Ibn Said e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. për prodhimin e alkoolit, ndërsa Muhamedi a.s. ia ka ndaluar. Ai i thotë: - Po e

prodhoj për ilaç. Iu përgjigj: ***"Ai alkooli nuk është ilaç, por përkundrazi sëmundje", (i dërguari e ka fol të vërtetën).***

KOMENTIMI I DR. SEJID EL XHEMILIT

Prej çështjeve të mrekullueshme që ka sjell Islami është pastërtia e shoqërisë dhe individit, kështu që prej elementeve të para është të ndaluarit e alkoolit, sepse unë, as që mund ta imagjinoj që një besimtar musliman ta dehë mendjen e tij, të jetë i shtrirë nëpër rrugë ose të jetë në pranga të policisë!

Të palogjikshmit dhe mendjelehtët thonë se pirja e alkoolit i sjell të mira trupit, e bën aktiv, të mprehë në të folur, sqarues të të vërtetës, e forcon zemrën, e trimëron frikacakun, ndërsa harrojmë se alkooli sjell varfëri, sëmundje, plogështi, çmenduri dhe hidhërimin e Allahut.

Kam parë shumë njerëz, të cilët jetojnë në errësirën e injorancës dhe në stres të epshit, prandaj dëfrimi dhe epshi i alkoolit nuk është prej kënaqësive natyrore, por, po mos ta shijonin njerëzit, nuk do ta kërkonin. Ashtu siç thotë Shejh Shaëraviju: Ka adet të keq dhe ibadet të nderuar. Njeriu mund të jetojë tridhjetë vite apo katërdhjetë vite në një vend të qetë, të pastër, ku nuk sheh kurrë alkool me sy, as nuk dëgjon për pijen e tij asnjëherë në jetën e vet. Kjo sikur adeti (zakoni) nuk është zakon pa e përdorur atë, ndërsa ai në jetën e tij ka qenë larg këtyre rrjedhave.

Ndërsa tjetri e sheh (alkoolin) për çdo ditë, por i largohet vetëm pse e do Allahun dhe i frikohet hidhërimit të Tij. Ky është adhurimi i nderuar dhe i respektuar. Kjo ka vlerë dhe rëndësi të posaçme te Allahu i Lartmadhëruar. Lum për atë i cili shkon te Allahu me zemër të pastër, të çiltër dhe të shëndoshë!

Më kujtohet njëherë kur isha mjek në një spital prej spitaleve të mëdha dhe isha kujdestar. Kur erdh polici me një njeri me pozitë të lartë, polici më dha një letër nga zotëria (zëvendës kryeministër), i cili kërkonte prej meje nënshtrimin e një analize mjekësore të dr. Filanit, avokat. Menjëherë u rrëqetha, më kapluan dridhjet e u mahnita. Njeri me pozitë të lartë, në pranga të policisë, i cili më tregoi se ky njeri është prangosur, sepse ka qenë i dehur dhe ka sulmuar pa kurrfarë shkaku! Vizitorët e hotelit, të cilin banonin në të, ishin në vend të qetë ku nuk ka zhurmë, kah ora 2 e mesnatës ai e ndryshoi gjendjen, shkaktoi trazirë, e prishi atmosferën, mendja e tij ishte dehur, sillej i pakontrolluar, thuaja se e ka veshur kapelën e firaunit. Ai e kishte prishur

rendin publik. Unë e dija se ai ishte i pikëlluar dhe i mërzitur, ishte i penduar dhe i vinte shumë keq, pse e kishte sjellë veten në një pozitë ku polici e sillte kah dëshironte. Kur e pyeta atë njeri, ai ma ktheu duke qarë me lot që i rridhnin në faqet e tij, me fjalë në gjuhën angleze: Të lutem zotëri mjek, më fal, kam bërë gabim të madh në dëm të vetes sime, dhe të premtoj se kurrë më nuk do të bëjë një gjë të tillë!

Në gjuhën angleze i thash: Kam shpresë ta kuptosh se i madhi zmadhohet me pikëllimin e tij, dhe në momentet e dobësisë së tij ka ku të mbahet. Po pse je dorëzuar kaq lehtë dhe ke dalur jashtë lëkurës sate. Me të shpejtë më tha: Unë jam avokat me reputacion, nga një familje e njohur dhe jam daja i dr. Filanit, i cili është profesor në fakultetin e medicinës, jam i afërt me filanin, filanin, e me filanin. Dhe filloi të më numërojë personalitete në gjuhën angleze. I thashë: ARE YOU A LAWYER OR A LIAR (a jeni avokat apo rrenacak)? Ai ma ktheu: - Jo nuk jam rrenacak, por avokat. I thash atij: A nuk është turp, ti je njeri i ligjit, e ke sjell veten në këtë pozitë?! Duhesh t'i biesh kokës tënde me çekiçin e drejtësisë.

Kështu alkooli i sjell njerëzit në pozita të palakmueshme.

DROGA, AFIONI DHE HAPAT PËR GJUMË

Pyetje: Si është çështja me shërimin e të sëmurëve, të cilëve u jepen hapa për gjumë, të cilat kanë elemente të drogës, si p.sh. hapat "MORFION, ELFAUMFIJNE", pas operacionit të vështirë.

Muhamedi a.s. ka thënë, në hadithin Sahihë:

"Çdo gjë që dehë, qoftë e shumtë, qoftë e paktë është e ndaluar edhe nëse e pakta nuk dehë".

Përgjigjja: Këtë çështje ia kam paraqitur Imamit të mirënjohur, Muhamed Muteveli Esh Shaëravijut, i cili ka thënë: Nuk është e ndaluar, për këtë e bie shembullin: Kur Abdullah bin Xhaëferi r.a. ka shkua në Siri për te Halifja, në mes të rrugës fillon t'i dhembë shumë këmba, të cilën e kishte pasur të lënduar, kështu iu paraqit GANGARINA. Kur shkon në ambulantë, mjekët vendosin për t'ia prerë këmbën. I thonë atij: Shtrihu për tokë. Ai u thotë: Jo, unë nuk dëshiroj që ta humb mendjen në Zotin tim asnjë çast. Pra, mpirja nuk është prej llojit të ndalesave. SUBHANELLAH

JASHTËQITJA E NJERIUT DHE E KAFSHËVE

Çështje interesante tregon dijetari i mirënjohur, Shaëraviju: Njeriu është krijesë që zgjedhë llojet e ndryshme të ushqimit, planifikon dhe merr ushqim të rregullt, të kontrolluar e të organizuar. Përkundër gjithë kësaj, jashtëqitja e tij ka erë të rëndë, të urryer dhe të paparashikuar. Ndërsa kafshët, përkundër asaj çka hanë prej bimëve të ndryshme, aty-këtu me insekte, me mikrobe, e të papastra, jashtëqitja e tyre është më pak e urryer se sa e njeriut.

Siç mendon Shaëraviju, shkak i kësaj është se llojet e ndryshme të bimëve kanë elemente kimike, mjekësore, të cilat i eliminojnë helmet dhe bëjnë pastrim kimik të organizmit të tretjes, sepse specialistët dhe zbuluesit e medicinës, farmaceutët të gjitha barërat i zbulojnë prej bimëve, edhe të maleve të dendura edhe jo të dendura.

Ibn Mes'udi r.a. në një transmetim ka thënë:

"Për çdo sëmundje Allahu ka zbritur ilaç dhe shërim, e ju ta keni parasysh qumështin e lopës, sepse ajo i mbledh elementet e të gjitha bimëve dhe lisave". (TRANSMETON NESAIJU)

A MARTOHEN BANORËT E XHENETIT?

Pyetje: A martohen banorët e xhenetit? Meshkujt a do të ejakulojnë apo jo?

Përgjigjja: Është pyetur Pejgamberi s.a.v.s.: ***A bëjmë marrëdhënie seksuale në xhenet? Është përgjigj: Po, për Zotin në dorën e të Cilit është shpirti, do të bëjnë marrëdhënie fort, fort (dahmen-dahmen). Dhe pasi të kryejë marrëdhënie mashkulli, femra kthehet përsëri e pastër, virgjëreshë". (TRANSMETUESIT E NDËRLIDHUR SIPAS KUSHTIT TË SAHIH IBNI HABANIT)***

Në koleksionin e Taberanit është e regjistruar se është pyetur Muhamedi a.s.: ***A kryejnë marrëdhënie banorët e xhenetit? Është përgjigj: Me organet të cilat, asnjëherë, as nuk dobësohen, as nuk paaftësohen, por gjithmonë kontaktojnë fort, fort".***

Xhevheriu e tregon fjalën dahmen-dahmen, si fortësi, tepër e fortë.

Po ashtu në këtë koleksion: Është pyetur: A kryejnë marrëdhënie banorët e xhenetit? Është përgjigj: ***"Po, fort, shumë fortë, mirëpo nuk lëshon spermatozoid dhe femra nuk lëshon vezorë (për formim të embrionit)".***

Pyetje: A martohet kur e sheh se nusja është shtatzënë, si duhet vepruar në këtë rast?

Imami i mirënjohur, Shaëraviju përgjigjet: Pasi që po e bën këtë pyetje, përgjigjja është se nuk vazhdon jeta martesore dhe nuk lejohet martesa me grua të tillë, për të mos u mbjellur fara e huaj në arën e tij.

Pyetje: A e ka Pejgamberi s.a.v.s. Zotin e tij?

Përgjigjja: Po. Në të gjitha sferat, të cilat i pranon mendja, pa e ngarkuar mendjen në atë çka nuk mund ta përfshijë mendja, dhe me besimin e tij të mos gjykojë në të ose në atë.

Pyetje: A ka fshehtësi, për të cilat Muhamedi a.s. nuk është urdhëruar t'i shpalosë edhe pse i ka ditur?

Imami i mirënjohur përgjigjet: Po kjo është e qartë në fjalën e Zotit të Lartmadhëruar: **"Dhe e frymëzoi dhe e inspiroi robin e Tij, me atë që e frymëzoi dhe e inspiroi". (EN-NEXHM, 10)**

Kjo vlen për çështjet, të cilat nuk kanë të bëjnë me obligimet dhe detyrimet e njerëzve, sepse këto çështje patjetër ka pasur për t'i treguar Muhamedi a.s.

Pyetje: A ka në xhenet kuaj dhe deve?

Përgjigjja: Po, gjithashtu aty ka çka dëshiron, si dëfrimi dhe zbavitja, pra sipas kërkesës dhe dëshirës. Kënaqësitë e xhenetit nuk mund të krahasohen me kënaqësitë e kësaj bote.

Pyetja: Si ka zbritur Kur'ani komplet dhe përnjëherë, kur thotë Zoti i Lartmadhëruar: "Ne e kemi zbritur atë (Kur'anin) në natën më të vlefshme (natën e kadrit)"? Po ashtu thotë: "Muaji i Ramazanit është muaji në të cilin ka zbritur Kur'ani".

Kjo vërteton se ka zbritur komplet. Mirëpo, është e njohur në ETHER, se Kur'ani ka depërtuar, pra i ka zbritur Muhamedit s.a.v.s. pjesë-pjesë, gradualisht, brenda 23 viteve.

Shejh Shaëraviju përgjigjet: Kur'ani ka zbritur komplet në qiellin e kësaj bote, për ta kryer misionin e tij në të, pastaj ka zbritur pjesë-pjesë, prej qiellit të dynjasë te Pejgamberi s.a.v.s. dhe te umeti ynë Islam.

Pyetje: A i përkujton njeriu familjarët e vet në Ditën e Kiametit?

Përgjigje: Po, njeriu i përkujton familjarët e vetë në Ditën e Kiametit dhe, po ashtu, do të jetë së bashku me ta. Këtë e vërteton ajeti Kur'anor:

"Ata dhe bashkëshortet e tyre janë në hije e vende të larta, të mbështetur qëndrojnë". Po ashtu ajeti: **"Ata të cilët kanë besuar dhe i kanë pas pasuar pasardhësit e tyre në Iman të plotë, do t'i bashkojmë ata me familjarët e tyre".**

Pyetje: "Medhi (lëng orgazme)" a e obligon abdestin apo gusulin?

Përgjigje: Medhi (lëng orgazme)" e obligon abdestin.

Emiri i besimtarëve, Aliu, Zoti e fisnikëroftë atë, e ka pyetur Muhamedin a.s. për "MEDHIN". Muhamedi a.s. i është përgjigjur:

"Për shkak të mëdhit (lëng orgazme) merret (obligim është) abdesti, ndërsa për shkak të mënisë (sperma) merret (obligim është) guduli". Në një transmetim tjetër: "Nëse e sheh "MEDHIN" e pastron organin seksual dhe merr abdest, ndërsa nëse e sheh se lëngu është i bardhë dhe i fortë, atëherë merr gusël". (E KA REGJISTRUAR AHMEDI)

Pyetje: Shërimi me barëra, terapi të mjekut a hynë në sferën e Kaderit të Allahut?

Përgjigjja: Po gjithsesi, sepse shërimi prej mjekut hyn në sferën e

Kaderit të Allahut, sepse ai është shkak nga shkaqet e shërimit.

Është pyetur Muhamedi a.s.: Se barërat dhe rukjet a e ç'vleftësojnë Kaderin e Allahut? Muhamedi a.s. është përgjigjur: "Po ajo veç është Kaderi i Allahut".

E kanë pyetur: A ndihmojnë barërat? Ka thënë: "Subhanallah! Po a nuk ka zbritur Allahu i Lartmadhëruar për çdo sëmundje në tokë dhe ilaçin për të?!".(E KA REGJISTRUAR AHMEDI)

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për shërimin me barëra e terapi, se a ndryshon në Kaderin e Zotit ndonjë send. Pejgamberi s.a.v.s. është përgjigj: "Po ajo veç është prej Kaderit". Është pyetur Pejgamberi s.a.v.s.: "Barërat, ilaçet dhe shërimi medicinal a ndihmon ndonjë send?

Është përgjigj: Qoftë i Lartësuar Allahu (SUBHANELLAH)! Pse, a ka zbritur Zoti i Lartmadhëruar ndonjë sëmundje në fytyrë të tokës e që në të njëjtën kohë nuk e ka lënë që të gjendet ilaçi-shërimi?!" (E KA REGJISTRUAR AHMEDI)

XHINËT JANË TË KRIJUAR PREJ ZJARRIT, PRA SI DËNOHEN NË ZJARR?

Pyetje: Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Dhe më herët i kemi krijuar xhinët prej zjarrit të flakëruar".** Njeriu është i krijuar prej balte, atëherë si është e mundur që krijesa prej balte ta nënshtrojë krijesën prej zjarrit?

Si është e mundur kjo dhe si dënohet xhini prej zjarrit, përderisa është i krijuar prej zjarrit?!

I nderuari, Shejh Muteveli Shaëraviju përgjigjet:

Po. Përderisa xhinët janë të krijuar prej zjarrit, ndërsa njeriu prej baltës, natyrshmëria e krijimit të tyre është natyrshmëri e elementeve të tyre. Ekzistojnë elemente, të cilat kur të kompozohet sjellin mjegulli dhe errësirë, dhe kompozim të elementeve që jep ndriçim. E para është për njeriun, kurse e dyta ka të bëjë për xhinët.

Pra, xhinët janë krijuar me ligje më të forta se krijimi i njeriut. Ligji i xhinëve është më i ndritur se ligji i njeriut. Ashtu sikurse është rregull, dukuri që njerëzit të dallohen nga njëri-tjetri, ashtu është rregull, dukuri që edhe xhinët të dallohen nga njëri-tjetri.

Këtë çështje e ka përshkruar Zoti i Lartmadhëruar, kur e ka treguar tregimin e Sulejmanit me Belkisën. Sulejmani ka dëshiruar që t'ia sjellin atij frontin e Belkises, kur thotë: **"Cili prej jush më sjell frontin e saj, para se të bëhen muslimanë"**. Thënia: "Para se të bëhen muslimanë", tregon se ai e ka ditur se ata veç janë në rrugë për ta pranuar Islamin. E kjo do të thotë se është parashtruar pyetja: Kush e sjell frontin e Belkisës, para se të dorëzohet ajo. Për këtë kanë qenë të nevojshme dy fuqi: fuqia e besimit dhe fuqia e shpejtësisë.

Pra, të shkojë për ta sjellë frontin, para se të vijnë ata, e kjo nuk është fuqi e njeriut, por fare edhe fuqi mbinjerëzore. Për këtë arsye nuk ka folur njeriu i rëndomtë, sepse ligji njerëzor i Sulejmanit nuk e ka kërkuar atë, sepse për ashtu ai do të ishte nisur për në atë drejtim.

Shpejtësia, e cila është kërkuar për sjelljen e frontit, është shpejtësi mbi mundësinë e qenies së dheut.

"Tha Ifriti, i cili ishte prej xhinëve: Unë e sjelli te ti para se të ngritesh nga vendi". Ifrit do të thotë xhin me shpejtësi të jashtëzakonshme, e jo xhin i rëndomtë.

"Dhe tha ai, të cilit i është dhënë dituri nga libri: unë e sjelli te ti para se ta lëvizësh këmbën". Pra, ai i cili ka dituri nga libri, edhe pse ai është prej njerëzve, ai ka ligj dhe fuqi më të madhe se ligji dhe fuqia e Ifritit, i cili është prej xhinëve.

Çka është dituria prej librit?

Ajo është dituria e sekretëve të librit dhe të kuptimit të tyre. Nga kjo mund të konkludojmë se çdo lloj ka ligj të veçantë.

Njeriu është i krijuar prej ujit, por ai nuk mund të ecë mbi ujë, mirëpo, përkundrazi ai fundoset dhe mbytet, ashtu sikurse zjarri shihet, por xhinët nuk shihen.

KRIJIMI I SË KEQES

Pyetje: Allahu I Lartmadhëruar E KA KRIJUAR TË MIRËN. Ai nuk pajtohet dhe nuk është i kënaqur që e keqja të përhapet. Pse Allahu e krijoi të keqen, pasi që Ai nuk është i kënaqur me pabesimin, kurse Ai dëshiron që e mira të përhapet në ekzistencë?

Imami i mirënjohur përgjigjet:

Nuk ka dyshim se Zoti i Lartmadhëruar dëshiron që të jep – të lejojë diçka prej të keqes në ekzistencë, jo për ta përhapur në tërësi dhe të dominojë, por që të sprovohen njerëzit për t'u larguar prej saj. Sepse, po mos ta kishte krijuar Zoti i Lartmadhëruar të keqen, atëherë si dhe me çka do të ishin sprovuar dhe do të ishin ditur të mirat?!

TESAVUFI

Imami i mirënjohur thotë:

Tesavufi (misticizmi) i vërtetë është të jetosh në treg, të merresh me tregti dhe të merresh me të gjitha veprimtaritë në jetë. Poeti thotë: Nuk është misticizëm që të izolohesh dhe t'i ikësh sprovave jetësore.

Por, tesavufi (misticizmi) kuptohet në treg, kur ke pasuri, ke lakmi dhe ke sprova.

Kjo është bindja e Imanit, sepse shëndetin ndonjëherë nuk e ke. Njeriu, i cili nuk anon ka shkatërrimi dhe nuk bie në të, deri sa veç ballafaqohet drejtpërdrejtë me të, është më i dashur tek Allahu. Ngase adhurimi më i lavdëruari është, atëherë kur zakonisht je i ballafaquar me vështirësi dhe sprova, ndërsa ti i largohesh të këqijave dhe ndalesave.

Nuk quhet Tesavuf (misticizëm) i vërtet kur ndonjë dijetar i njohur dhe i ditur heq dorë prej kësaj bote dhe izolohet. Është vërtetuar se Imam Ebul Hasen Esh-Shadhiliju ka qenë njeriu më i shkëlqyer në tregti.

HULUMTIMET E BESIMIT DHE HULUMTIMET SHKENCORE

Pyetje: Ekzistojnë pyetjet (në çështjet) shkencore, por, po ashtu edhe pyetjet që kanë të bëjnë me besimit (Imanit), e këto ndryshojnë prej atyre (shkencore).

Shejhu Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë:

Pyetjet e besimit (Imanit) dhe çështjet e saj, edhe pse që të gjitha janë fshehtësi, ata janë të dukshme dhe nuk ka nevojë për të hulumtim. Pra, për fshehtësitë, për të cilat ka treguar Kur'ani dhe i Dërguari i Allahut, i cili ka vërtetuar për Allahun e Lartmadhëruar.

Ndërsa, sa i përket pyetjeve (çështjeve) shkencore ato janë materiale, për ta pyetet: "Si?" dhe nuk pyetet "Pse?".

Për këtë arsye Ibrahimi a.s. ka thënë: "O Zoti im! Më trego në praktikë se si i ngjallë të vdekurit".

Kështu që Allahu i Lartmadhëruar i ka treguar praktikë shkencore-shqisore.

SIHRI DHE NËNSHTRIMI I XHINËVE, DHE SHEJTANËVE

A shndërrohet xhini në forma të ndryshme, dhe a ka ndikim në jetën e njeriut?

Po, xhini shndërrohet në shpejtësi grabitëse, sepse ai kur të shndërrohet në diçka i nënshtrohet ligjit të asaj që është shndërruar. Ai kur të shndërrohet në formë lëndore i nënshtrohet ligjit të lëndëve, që do të thotë, mund të vritet me fishek (armë) ose mund të pritet me thikë.

Kur shejtani është shndërruar , Muhamedi a.s. ka thënë:

"Unë veç synova për ta lidhur në një shtyllë të xhamisë, për të luajtur me të fëmijët e Medinës".

Kur të lidhet shejtani ai nuk mund t'i zgjidhë duart, sepse për shkak se ai i është nënshtruar ligjit të materies.

Pyetje: Si e bën xhini ndarjen në mes burrit dhe gruas, ashtu siç e

tregon edhe Kur'ani?

Përgjigje: Specifikë e xhinit është se ai ndërron. Është e mundur që xhini të shndërrohet në formën e majmunit, në trupin e gruas, kështu që burri i saj e urren. Po ashtu shejtani formësohet si egërsirë në trupin e burrit, kështu që gruaja e tij ikë prej tij.

Pyetje: Si e nënshtron njeriu xhinin, kur dihet se ligji i xhinëve është më i lartë se i njeriut?

Imami i nderuar Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë:

Po Allahu i Lartmadhëruar me fuqinë e Tij absolute mund ta bëjë që lloji më i ulët ta nënshtrojë llojin më të lartë dhe ta mbizotërojë atë. Kjo është prej madhështisë se Krijuesit, e jo domosdoshmëri e elementit. Allahu ka dëshiruar që njerëzit, të cilët nuk janë xhin, të kalojnë në ligjin e tyre, ashtu që ua afron shkaqet, me të cilat shkaqe i nënshtrojnë xhinët.

Pastaj Imami i nderuar e përfundon duke thënë:

Atëherë kur nuk mund ta definojmë dhe nuk kemi mundësi për të arsyetuar diçka të fshehtë, vërtetohet Imani në të nëpërmjet të sinqertit, i cili transmeton nga Zoti i tij, nga Allahu i vërtetë, andaj pranoje çështjen, e mos e konsidero përfundimtare mendjen tënde, sepse mendja jote është ajo, e cila i ka besuar Allahut në atë që ai e ka transmetuar dhe që e ka zbritur. Mos bjer në kundërshtim vet me mendjen tënde.

DHE NUK KA SUKSES MAGJIA NGA DO QË VJEN

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"... por pa lejën e All-llahut me atë askujt nuk mund t'i bënin dëm ...".(EL-BEKARE, 102)

Pra, fuqia absolute!

O Zoti Im, vërtet Ti ke dashur dhe Ti di.

Shkaku vetvetiu nuk mund t'i dëmtojë. Mirëpo, Allahu e ka bë atë shkak, dhe ai është me lejen e Tij. Ata kanë përgjegjësi pse e kanë përdorë atë leje. Allahu e ka caktuar atë dhe ajo është me lejen e Tij. Allahu e ka parapa dhe e ka informuar njeriun se do të jetë i sprovuar. Por, dëmi është me lejen e Tij.

Pyetje: Cili është shërimi i atij, të cilin e ka zënë magjia dhe është prekur prej shejtanëve dhe xhinëve?

Shejh Shaëraviju thotë:

Shërimi i të magjepsurit bëhet duke lexuar "Kul Eudhat", pra "Kul eudhu birabil felek" dhe "Kul eudhu birabin-nasi".

Kështu Allahu i Lartmadhëruar e ç'vleftëson dhe e shkatërron kurthin e magjistarit. Mirëpo, ajo çka e dëmton njeriun është vetvetja e tij. Ai i bënë padrejtësi vetes së tij kur të besojë se magjistari është ai i cili e ka në dorën e tij shërimin e tij nga magjia. Ai duhet të thotë: *Unë frikohem nga Ti (unë mbështetem tek Ti) për atë që ke parapa, nga e keqja të cilën e kanë mësuar, dhe kryelartësisë së tyre ndaj Imanit, nga fytyrat e magjistarëve që janë plot mllef e urrejtje, dhe nga të gjithë ata që sjellin lodhje e mundime.*

"Dhe se ka pasur burra prej njerëzve, që kërkonin ndihmë prej disa xhinëve dhe ashtu ua shtonin atyre edhe më shumë arrogancën". (EL-XHIN, 6)

Pra, u shtua mundimi dhe lodhja e tyre . . ., për këtë arsye te ta shohim vetëm urrejtje.

Pyetje: Cili është sekreti? Pse të gjitha çështjet e besimit janë të fshehta dhe të padukshme?

Përgjigjja: Nëse njeriu ndalet në çdo çështje sekrete të jetës së tij, atëherë as jeta, as kjo botë nuk do ta kishte pasur vlerën dhe nuk do të ishte qenë e përshtatshme për të folur për madhështinë e Allahut.

Po nëse ti do t'i kishe ditur të gjitha çështjet në ekzistencë, atëherë krijimtaria e Allahut do të kishte qenë brenda aftësive dhe mundësive tua. Po mos të kishin qenë disa gjëra, atëherë mendja do të ishte stopuar. Kjo është madhështia e ekzistencës dhe prej madhështisë së Allahut është, se *Ai është Krijuesi i gjithçkaje.*

Pyetje: Si dënohen xhinët në zjarr, kurse ata janë të krijuar prej zjarrit?

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **"Dhe xhinët i kemi krijuar më herët nga zjarri i flakëruar".**

Shejh Shaëraviju përgjigjet: Xhini dënohet me zjarr edhe pse është i krijuar prej zjarri, ashtu siç njeriu fundoset në ujë, kurse ai është i krijuar prej balte.

Dr. Sejid Xhemilë në lidhje me këtë thotë: Rrushi lejohet të hahet, mirëpo alkooli është haram, edhe pse është i prodhuar prej tij.

ZILIA DHE SHËRIMI PREJ SAJ

E vërteta është, se të ekzistuarit e një çështje dhe ndikimi i saj në çështje tjera janë dy çështje që duhet ndarë.

Imami i mirënjohur thotë: Nuk ka diçka faktike (lëndore) të saktë, mirëpo siç është e njohur: Çdo gjë që zbutet, forcohet dhe çdo gjë që lehtësohet, vështirësohet. Fanatizmi nuk ka kurrfarë ndikimi në aspekt fizik, por reflekton, ngacmon në nerva dhe ndikon në psikikën e njeriut.

Sëmundjet psikopatike janë ato sëmundje, që deri më tani njeriu nuk ka arritur t'i zbulojë saktësisht ato mikrobe apo viruse, të cilat janë shkaktarë.

Nëse një njeri e përdor armën e zilisë, atëherë cili është mjeti shërues kundër tij?

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **"Nga e keqja e ziliqarit"**, pra kjo nuk është domosdoshmëri (pra e keqja e ziliqarit), nuk është e patjetërsueshme, sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **"Kur të bën zili"**.

Pra, çdo njeri mund të bën zili, të xhelozojë, por është e mundur që njeriu të shohë një begati te tjetri, e të mos ia ketë zili atij, pra nuk i përdor rrezet radioaktive të zilisë vrasëse. Kjo kënaqësi i mbyll dritaret e të këqijave, e kur ai të thotë: *"MASHALLAH LA KUVETE IL-LA BILAH"* - *"Çka ka dashur Zoti, nuk ka fuqi që mund të ndryshojë diçka, pos Tij".* Në atë moment zilia mposhtet automatikisht.

Shejh Shaëraviju thotë: Te ziliqarët janë rrezet radioaktive të së keqes, të cilat nuk shihen, ashtu siç i janë zbuluar rrezet laser nga mjekët specialist,

me të cilat kryejnë operacione pa gjakderdhje. Kjo është njësoj me rrezet e syrit të ziliqarit. Mos të harrojmë të themi: po çfarë faji ka i lënduari fizikisht me mjete lëndore. Çfarë faji ka i varuri, çfarë faji ka i mbyturi me shkop, çfarë faji ka i vrari me revole?

Esma, bija e Amisit r.a., e ka pyetur të Dërguarin e Allahut:

"O i Dërguari i Allahut: Djalin e Xhaëferit frikohem se po e marrin mësysh. A ta fsheh, ta ruaj që mos ta shohin? Muhamedi a.s. i tha: "Po, se po të kishte pasur diçka që do ta kishte shpejtuar kaderin e Zotit, do të ishte mësyshi". (E KA REGJISTRUAR AHMEDI)

TELEVIZIONI, HALLALL APO HARAM?

Për shumicën e aparateve, të cilat i ka krijuar Allahu, nuk themi se kjo është haram, e kjo është hallall ...

Për shembull thika. Për të, as nuk themi se është hallall, as se është haram, por varet për çka e përdorim? Çështja pra qëndron në atë, se për çfarë drejtimi ti e përdorë. Kështu është televizioni. Nuk themi se është hallall as haram, derisa të përcaktohet orientimi se për çka përdoret. Përdorimi pra është ajo për çka themi hallall apo haram. Ky është mendimi i Shaëravijut.

Kam pasur shumë kundërshtime, me shumë dijetarë prej vëllezërve tanë, për çështjen e televizionit, sepse ata e ndalojnë në mënyrë kategorike dhe e konsiderojnë se është prej fitneve më të dëmshme, mirëpo unë gjithmonë u kam thënë, se unë shikoj nga këndi që më ka mësuar profesori (Shejhu) im dhe inspiruesi i ideve të mia. Gjithmonë shikoj me syrin e mendjes dhe logjikës, dhe patjetër duhet definuar se për çka përdoret, e pastaj të gjykojmë. Pra, duhet shikuar nijetin, ashtu siç ka thënë Pejgamberi ynë fisnik ...

Nuk ka dyshim se veprat shpërblehen sipas qëllimit dhe çdo njeri shpërblehet për atë që ka pasur për qëllimin.

Televizioni bëhet hallall atëherë kur e ke nijetin e sinqertë në përdorim. Po mos të ishte kështu ne nuk do të kishim pasur mundësi t'i shohim shumë të arritura shkencore, të cilat flasin për vërtetësinë e Imanit, siç janë programet e biologjisë, gjallesave, të cilat paraqesin shembuj të ndryshëm të krijesave të llojllojshme në ekzistencë. Të gjitha këto janë

krijesat e Allahut, të cilat dëshmojnë për fuqinë e Allahut.

PSE DHE SI?

Çështjet e Imanit dhe çështjet shkencore

Çështjet e Imanit janë sekrete, të padukshme, sepse po të ishin të dukshme nuk do të kishte qenë nevoja për të besuar. Çdo gjë që e sheh syri nuk quhet sekret.

Çështjet sekrete janë çështjet, për të cilat nevojitet Imani. Sekret quhen çështjet, për të cilat na ka treguar Kur'ani dhe na ka treguar Muhamedi a.s. prej Zotit të Lartmadhëruar.

Edhe nëse gjendet SI-ja nuk gjendet PSE-ja. Në çështjet sekrete ekziston SI-ja e jo PSE-ja.

Sepse SI-ja tregohet sipas eksperiencës së materies. Në shkencat natyrore dhe besimin në to pyetet SI? e nuk pyetet PSE. P.sh. Përbërja e ujit prej dy komponentëve H_2O - Hidrogjenit dhe Oksigjenit.

Për ujin, pra bëhet pyetja: **Si** komponohet uji? Ndërsa nuk kemi çka të pyesim: "**Pse** kështu". Dhe kështu Ibrahimi a.s. ka thënë: "O Zoti Im! më trego në praktikë si i ngjallë të vdekurit".

Zoti i Lartmadhëruar përgjigjet me shembull praktik. Pra SI i ngjall të vdekurit, për të parë qartë dhe në praktikë.

PLOTËSIMI I KËRKESAVE TË TRUPIT

Nëse e parashikojmë jetën e njeriut, ai bazohet dhe qëndron me ushqim, i cili i ka elementet kryesore që mundëson jetesën, mirëpo ky parashikim është i thjeshtë dhe sipërfaqësor dhe nuk është studim i thellë shkencor.

Kur themi: Njeriu ka nevojë për kaq *gr* Yndyrë, kaq *gr* proteina, kaq *gr* karbohidrate, kaq *gr* vitamina, e kështu me radhë. Në vend se të ushqehemi me ushqime të llojllojshme ne mundemi që të gjitha këto vitamina t'i përmbledhim në një kapsulë të vogël. Mirëpo, pastaj bëjnë pyetje, pasi që njeriu ta përdor këtë kapsulë, a do të ndihet i ngopur. Natyrisht se jo, sepse ka pjesë të organizmit i cili është i zbrazur e dëshiron të mbushet, e ai është lukthi me pjesët e tij.

Këtë njeriu mund ta eliminojë me operacion, mirëpo pastaj menjëherë paraqiten pasojat e pjesëve tretëse, të cilat trupi nuk mund t'i përballojë. Kjo është ajo që quhet ngopja e ndjenjave, e cila është baza e jetesës dhe natyrshmëria. Ashtu siç kanë thënë në të kaluarën: "I frikohemi zbrazëtirave, prandaj angazhohemi për t'i mbushur". Mirëpo, patjetër ai angazhim duhet të jetë, për mbushjen e plotë dhe të mirë dhe formave të ndryshme për t'i plotësuar kërkesat e trupit me përpikëri.

KULMINACIONI I SHKATËRRIMIT DHE TRAZIRAVE

Imam Shaëraviju thotë thënie shumë të rëndësishme dhe impresionuse, e ajo ka të bëjë me çështjen e imponimit dhe selektimit.

Shkatërrimi dhe trazirat nuk ndodhin prej asgjëje tjetër, përpos në ato çështje që ka të bëjë dora e njeriut.

Nëse shikojmë krijesat, te të cilat nuk ka arritur dora e njeriut, shohim se ato janë të harmonizuara në mes vete me jetën e tyre, me natyrën, dhe te ta nuk ka zbrazëtirë, tollovi apo shkatërrim. Rregullimi i qarkullimit dhe çështjet tjera natyrore në hapësirë dhe në faqen e dheut janë stabile dhe të qëndrueshme, sepse të gjitha ato janë mbi fuqinë e njeriut, dhe njeriu nuk ka dorë në ta në harmonizimin, sistemin dhe qarkullimin e tyre.

Shkatërrimi dhe trazirat ndodhin vetëm në çështjet ku dora e njeriut ka

ndërhyrë, i cili prej natyrshmërisë ua ka shndërruar pamjen e tyre në jo natyrshmëri (artificiale), dhe nga aty ka filluar disharmonia në mes të jetës së njeriut dhe programit dhe ligjit të ekzistencës. Duke u nisur nga kjo, shohim se çështja e imponimit dhe selektimit është një çështje, me të cilën janë marrë njerëzit qysh në kohërat e hershme, e ajo është: Njeriu a është gjallesë "IMPONUESE" apo "I IMPONUAR"?

Ai është selektues aty ku ka të bëjë me jetën e tij, dorën e tij dhe me çështjet e jetës së tij, dhe ekzistencës së tij. Për çdo gjë që njeriu nuk ka mundësi apo çdo çështje sekrete ku njeriu nuk e di arsyen, shkakun dhe urtësinë e obligueshmërisë, apo sekretin e urdhërimit, apo sekretin e ndalimit, atëherë ai patjetër duhet të ketë të drejtë zgjedhjeje (selektimi).

Patjetër njeriu duhet të urdhërohet në një çështje prej çështjeve ku ka të drejtë zgjedhjeje (veprim-mosveprim) dhe liri të zgjedhjes, dhe ku logjika njerëzore mundet të ketë alternativë për të zgjedhur. Pra, trazirat dhe shkatërrimi nuk ndodhin në çështje ku njeriu është i imponuar, por në çështje ku ka të drejtë zgjedhjeje. Kështu që ne shohim p.sh. çdo gjë që njeriu shkakton shkatërrime, ndotje të ambientit. Trazirat janë çështje, në të cilat njeriu ka të drejtë zgjedhjeje, ngase nuk do të ndodheshin gjëra të tilla, e Allahu ta pengonte lojën dhe zbavitjen e njeriut, dëfrimin, kuriozitetin e tij.

Çështjet detyruese apo imponuese i shohim se ato janë në harmoni mes vete. Zemrën që e posedon njeriu, të cilën nuk mund ta ndal me dorën e tij, ne e shohim se ajo rrahë edhe kur është fjetur, dhe rrahjet e tij janë gjithmonë në harmoni, të vazhdueshme, të pandërprera dhe gjithmonë e kryen detyrën e saj fiziologjike, pa përtesë, përkundër asaj që njeriu është fjetur (pushon) dhe është jashtë rrjedhave të jetës së tij, dhe aktiviteteve të tija jetësore.

Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Kush do le të besoj, e kush do le të mohojë"**, na dëshmon neve se besimi dhe mosbesimi janë çështje me të drejtë zgjedhjeje, pa detyrim apo imponim.

E vërtet është, Ai (Allahu) udhëzon cilin do, mirëpo e ka përkufizuar dëshirën e udhëzimit të Tij në atë i cili nuk e mohon, nuk bën padrejtësi dhe është i dëgjueshëm.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Allahu udhëzon cilin do në rrugën stabile, të drejtë dhe të qëndrueshme".**

Allahu i Lartmadhëruar udhëzon cilin do dhe ia lehtëson rrugën e udhëzimit, pasi që kjo dëshirë, në esencë, nuk ka të bëjë me të. Për këtë arsye,

duke u bazuar në argumentimin e ajetit Kur'anor: **"Dhe (pasha) shpirtin dhe Atë (i cili) e ka përsosur atë. Ai e ka lënë të lirë rrugën e kriminalitetit dhe devotshmërisë".**

I ka bashkuar dy të kundërtat në një shpirt të njeriut: Dëgjueshmërinë (devotshmërinë) dhe mosdëgjueshmërinë. SUBHANELLAH

Imami i mirënjohur, Shejh Shaëraviju vazhdon e thotë: Zoti i Lartmadhëruar nuk ka lejuar që njeriu të ketë të drejtë zgjedhjeje që të lindë apo të mos lindë, por me dëshirë apo pa dëshirë ai ka lindur edhe rritja e trupit të tij gjithashtu. Po ashtu organet e tij rriten dhe zhvillohen pa dëshirën e tij, ndërsa sa i përket besimit (Imanit) e ka lënë të lirë të zgjedhë. Parashtrohet pyetja: Pse? Sepse Allahu dëshiron që ta pranojë robin e Tij, e robi i Tij e ka zgjedhë dhe e ka pranua për Zot, kurse ka pasur mundësi për të mos e besuar, pra ai ta dëgjojë Zotin e Tij, e në të njëjtën kohë të ketë mundësi për të mos e dëgjuar. Nga kjo rrjedh se Imani (besimi) është liri e veprimit, e jo imponim i veprimit.

KONTAKTI SEKSUAL TE NJERIU DHE KAFSHËT

Sa i përket kontaktit seksual tek njerëzit, Imami i mirënjohur Shejh Shaëraviju thotë:

Është proces i shtimit të llojit dhe ekzistencës së tij dhe po ashtu kënaqësi, sepse njeriu edhe pse kënaqet nëpërmjet aktit seksual ai ka mundësi ta pengojë shtatzëninë.

Për këtë arsye duhet bërë dallim në mes të kënaqësisë që shpie në shtatzëni dhe asaj që kemi folur rreth urtësisë së martesës për tu shtuar lloji, por në të njëjtën kohë edhe përjetimit të kënaqësisë. Ndërsa, sa i përket kafshës ajo është e përcaktuar dhe kryen instinktivisht pa të drejt zgjedhjeje. Dhe kur vezorja të bie prej vendvezorëve të kafshës, ajo menjëherë e kërkon, me shpejtësi, mashkullin, sepse vezorja ka kaluar në vendin e zgjedhjes, e cila i jep kënaqësi aty për aty. Përderisa kafsha është e garantuar për t'i mbetur lloji s'ka nevojë për këtë.

Për të vërtetuar këtë që e thotë i nderuari ynë, profesori dhe Imami i mirënjohur, duke e bërë më të qartë thotë: Posa të bëhet bashkëdyzimi në mitrën e femrës, ajo i largohet mashkullit në mënyrë absolute dhe nuk e lejon

të afrohet, sepse veç u sigurua krijimi i një lloji (trashëgimtari) te femra dhe ajo më s'ka ndjenja, apo nevojë për kontaktim seksual, gjithashtu deri sa të jetë ajo barsë (shtatzënë) s'ka nevojë për ndjenja të kontaktit seksual. E kjo është ajo që dëshmon se gjatë kontaktimit seksual te kafsha nuk ka kurrfarë kënaqësie. Ndërsa te njeriu, femra përderisa është shtatzënë, pra gjatë shtatzënisë, vazhdon kontaktimin seksual dhe ndien kënaqësi seksuale, dhe asnjëherë nuk e refuzon dhe nuk e kundërshton kontaktin seksual gjatë tërë shtatzënisë së saj. Në shumicën e rasteve burri i saj refuzon kontaktin seksual, mirëpo ai e refuzon dhe nuk do edhe pse ai dhe ajo kanë ndjenja për një gjë të tillë.

Logjika e shëndoshë dhe mendja e ndriçuar patjetër duhet të bëjë dallimin mes SUDUD dhe DILAL, sepse që të dyja pajtohen njëra me tjetrën në aspekt të jashtëm, dhe e kundërshtojnë njëra-tjetrën në aspekt të brendshëm. Ai i cili shikon vetëm anën e jashtme e jo thelbin e asaj çështje, ai nuk ka analizuar mirë.

NDALIMI I MISHIT TË DERRIT

Sa i përket ndalimit të mishit të derrit, njerëzit e mëhershëm nuk e kanë ditur arsyen dhe urtësinë e ndalimit. Mirëpo mjekësia bashkëkohore e ka zbuluar shkakun, e ai është se mishi i derrit përmban vezoret e skrajave të quajtura TIJNIJASULIM, të cilat e sëmurin njeriun dhe i shkaktojnë dëm të madh.

Nëse nisemi nga këtu, shohim sikur muslimanët do të donin të dinë ndonjë kusht të besimit të tyre për arsyen e ndalimit të mishit të derrit, në fillim të thirrjes në islam nuk do ta kishin pasur asnjë arsye, por arsye e vetme do të kishte qenë se ndalimi është bërë për asgjë, dhe besimi i tyre do të ishte shumë shumë i mangët. Mirëpo urtësi është që për çdo çështje obliguese apo ndalesë duhet pranuar pa kurrfarë dyshimi dhe pa kurrfarë polemika, sepse është prej Allahut, ky është Imani i të paaftëve dhe adhurimi i njerëzve të rëndomtë.

Për këtë çështje Shejh Shaëraviju thotë:

Imani është rotor (shkak) i çdo dispozite, e cila vjen prej Allahut. Pastaj vazhdon e thotë: Mundet që shkaku dhe urtësia të jenë më specifike se

obligimi dhe gjithmonë urtësia apo shkaku vjen pas veprimit, apo pas kryerjes së obligimit e asnjëherë më herët, sepse po t'i paraprinte shkaku dhe urtësia e kryerjes së veprimit, atëherë ne iu kemi përgjigjur urtësisë apo shkakut, ndërsa besimi (Imani) i përgjigjet drejtpërsëdrejti urdhërdhënësit.

Ndërsa, paraqitja e shkakut dhe arsyes së një urdhri pasi që ai obligim burimin e ka prej Allahut, pas një kohe të kaluar, vërteton se çdo obligim, të cilit nuk ia di shkakun dhe arsyen, ajo e ka shkakun dhe arsyen.

Shejhu na sjelli një shembull, praktikë shkencore, duke e ilustruar me mishin e derrit, kur tha: A ka qenë dashur me hezituar, pra me ngrënë mishin e derrit deri sa të na vijnë analizat mjekësore, e ato analiza të na e bëjnë me dije se mishi i derrit është i dëmshëm për organizmin e njeriut?!

ÇËSHTJA E LIGJIT TË DOMOSDOSHMËRISË DHE ZGJEDHJES

Filozofët dhe dijetarët e kohërave të kaluara, por edhe të sodit, i preokupon çështja se njeriu a është i vullnetshëm (me të drejt zgjedhjeje) apo i detyrueshëm. Nëse është i detyrueshëm atëherë pse të japim llogari për çështjet, të cilat ia ka shkruar Allahu?

Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Në disa raste (gjendje) njeriu është i detyrueshëm, e në disa raste jo. Kjo, sepse njeriu dallohet nga krijesat tjera me mendje dhe logjikë. Ai është i lirë t'i zgjedhë çështjet, sepse për çështjen e cila nuk ka të drejtë zgjedhjeje, nuk ka çka të zgjidhet dhe nuk ka çka të mendohet apo logjikohet për të. Sepse, mendja (logjika) është mjeti i zgjedhjes së çështjeve, ndërsa çështja e cila nuk ka alternativë tjetër aty nuk ka çka të kërkohet për t'u zgjedhur.

Çka do të thotë mendje? Mendja është mjeti krahasues, i cili dallon çështjet mes vete dhe çështjet, të cilat duhet zgjedhur, të cilat munden për t'u vepruar ose munden për t'u mos u vepruar. Përderisa çështjet ekzistojnë, mendja jote ekziston, atëherë ti ke të drejtë për të vepruar dhe për të mos vepruar.

Zgjedhja dhe seleksioni i sendeve, çështjeve bëhet nëpërmjet mendjes. Për këtë arsye i çmenduri nuk është i obliguar (krijesë obligative). Pse Allahu nuk e obligon atë, po ashtu psikopatin?

Allahu e ka krijuar njeriun, njeriu nuk mund ta krijojë veten dhe po ashtu ta bënë veten të vdes, po ashtu nuk ka asgjë në dorë në vdekjen e tij. Pse edhe e para edhe e dyta janë Kader (përcaktim) i Allahut. Kaderi i Allahut nuk zhvishet prej kaderit të Allahut, por Allahu çështjen e Imanit (besimit) e ka bërë çështje zgjedhëse. Kjo, për arsye se Allahu i Lartmadhëruar dëshiron që robi i Tij ta dojë me vullnetin dhe dëshirën e Tij. Allahu dëshiron që robi i Tij ta dojë atë edhe atëherë kur ka mundësi që robi të largohet prej tij dhe të kundërshtojë.

KOMENT DR.SEJID XHEMIL

Njeriu ndonjëherë bënë mirë, e ndonjëherë keq. Por, kush e di të fshehtën? Ndoshta në të parën bën keq, e në të dytën mirë. Por, kush e di esencën e gjykimit? Gjykimi duhet të jetë diçka më e lartë dhe më e ditur se kjo dhe ajo. Dituria më e lartë (qiellore) e di të fshehtën dhe çka fshihet pas perdes së sekreteve, prej fshehtësive të kaderit.

TEVESUL (SHËRIMI) ME PEJGAMBERËT DHE NJERËZIT E MIRË

Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë:

Shkuarja sipas shkaqeve nuk është në kundërshtim me mbështetjen në Allahun, se për ndryshe si të thuhet për mjaltin e bletës (është ilaç dhe shërim për njerëzit). Thënia e Zotit të Lartmadhëruar shërim për njerëzit, do të thotë që: njerëzit të shkojnë në atë që mendojnë se është shërues, ose e dinë se është shërues. Ka dallim të madh në mes të asaj që intervenon mjeku (shëron) dhe thënies së Allahut (Dhe kur të sëmurem, Ai më shëron), sepse mjeku është mjet shërimi, ndërsa Allahu shërues. Mjeku mund t'ia qëllojë ose mund të gabojë. Dhe askush nuk duhet të mendoj se mjeti shërues (mjeku) është në kundërshtim me Kadanë e Zotit ose me ia vonua vdekjen njeriut. Për këtë arsye ne shohim se shumë e shumë të sëmur vdesin në duar të mjekëve dhe në proces të operacionit.

Poeti thotë:

Gabimi i mjekut është jogabim (e qëlluara) e kaderit.

Zoti e mëshiroftë Shefkijun i cili për vdekjen ka thënë: *Nëse nuk ke për të vdekur, çdo mjek është i mirë dhe i dobishëm, por nëse ke për të vdekur, mjeku është vdekjeprurës (shpend me kthetra).*

Mjeku i cili shëron nuk ka dalë jashtë kornizave të kaderit, sepse shërimi është vetë kaderi i Allahut, dhe nuk është jashtë kaderit të Allahut.

Kur ndodhi thatësi e madhe në gadishullin arabik, Omeri r.a. thoshte: Më herët derisa ishte i Dërguari i Allahut s.a.v.s. me ne, i kërkonim atij të lutej për shi dhe binte shi, ndërsa tani kërkojmë të lutet për shi prej axhës së të Dërguarit të Allahut: O Abas, ngrihu dhe lute Allahun të na zbret shi dhe është ngrit Abasi r.a. dhe ka ra shi.

Ky ndërmjetësim është me të gjallët, sepse dobia prej tyre vazhdon, ndërsa i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka ndërruar jetë dhe me vdekjen e tij është ndërprerë zbritja e shiut prej tij, mirëpo çështja ka kaluar në familjen e tij, sepse ai ka qenë axha i pejgamberit.

Kur Omeri r.a. ka shkuar me krye haxhin, Pejgamberi s.a.v.s. i ka thënë: ***"Mos na harro me lutje o vëlla Omer."***

LIRIA DHE PARIMI I FESË

Cili është definicioni i termit "Liri"? Çfarë qëndrimi ka Islami për të? Liria qytetare a është në kundërshtim me fe-tarinë? Cili është qëllimi i lirisë së njeriut në suazat e praktikimit dhe përmbajtjes së programit të Zotit për obligimet e tij?

Këto janë mendimet të cilat sillen në mendjet e njerëzve për parimet e gabuara, keqkuptimet dhe pretendojnë se parimet e fesë janë të gabuara. Ata diçka që e kanë kuptuar është gabim, ndërsa e vërteta është e drejtë, e nuk e kuptojnë të drejtën, por të drejtën e quajnë gabim dhe krim.

Për këtë profesori Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë: Parimi "Liri e njeriut" në fakt është në kundërshtim me parimet fetare. Me qenë fetarë do të thotë me iu nënshtrua parimeve dhe programit. Liria të çliron dhe nuk të lejon me iu përmbajt obligimeve të cilat ka dashur Allahu me i krye ?!

Këto janë keqkuptime dhe ide te gabuara.

Këtë çështje na shpjegon prof. Dr. Shejh Muhamed Muteveli

Shaëraviju i cili thotë: Në esencë fjala "Liri" bie ndesh me parimin e fesë. Fetar do të thotë të përmbajturit e parimeve dhe planprogramit. Liri do të thotë i liruar dhe i papërmbajtur në diçka. Kjo është ajo çka kuptohet prej fjalës liri, mirëpo feja ka ardhur për me ngritur lart fjalën "Liri". Pse ti je i lirë të veprosh çka të duash, por edhe të mos veprosh çka të duash. Mirëpo liria jote mos me qenë ajo e cila u bënë padrejtësi tjerëve.

Pse, për të mos i dhënë liri absolute vetes tënde, e tjetrit me ia cungu. Jo, kurrsesi jo. Nëse ky njeri ka liri absolute, por edhe ky ka liri absolute atëherë vjen deri te përzierja e tyre, dhe ndeshja në mes tyre.

Nëse i japim lirisë këtë kuptim atëherë i fuqishmi, mizori dhe krimineli vepron çka të doje dhe të dobëtin e eliminon, atëherë vjen deri te trazirat dhe shkatërrimi.

Pra fjala patjetër duhet të përkufizohet.

E drejta jote është: të besosh, ose të mos besosh, ti ke liri absolute me zgjedh mirëpo që nga çasti kur të besosh, ti duhet t'i përmbahesh planprogramit, pse ti ke hy në suazat e besimit (Imanit) me mendje të pastër, dhe me të zgjedhurit tënd dhe t'i iu ke përmbajt bazës-lirisë së zgjedhjes së besimit. Allahu besimin e ka lënë të lirë e jo të imponuar sepse Allahu i Lartmadhëruar dëshiron që robi ta pranoj planprogramin e tij, kur ai ka mundësi mos me pranua. Allahu dëshiron që ta dëgjojë dhe t'i nënshtrohet atëherë kur ai ka mundësi për të mos e dëgjuar dhe për të mos iu nënshtruar.

Qeveritari duhet me mbrojt këtë liri, për të shikuar kënaqësinë e Allahut, e ndonjëherë mundet me harruar, e i tërhiqet vërejtja.

Shembull: Omeri r.a. ka thënë: "Nuk ka dobi prej jush nëse nuk flisni e nuk jepni vërejtje, ndërsa nuk ka dobi prej nesh nëse nuk dëgjojmë (nëse nuk i pranojmë vërejtjet)."

Omeri nuk ka gabuar, por ka dashur t'u tregoj dhe t'ua mësoj tjerëve për me ua tërheq vërejtjen njëri-tjetrit, por edhe vet atij. Omeri ua mësonte tjerëve duke u thënë: Nëse unë pak e lakoj kokën, ju ngriheni shpatën dhe më thoni: Ki kujdes! E ai pastaj me thënë: Po, po, gabova!.

E ai pastaj ka thënë: E falënderoj Allahun i Cili ka bërë umetin të tillë, që nëse gaboj, tjetri e ngrit shpatën kundër padrejtësisë. Ai na ka mësuar se qeveritari nuk guxon në asnjë çast të jetë neglizhent, e nëse harron atëherë tjerët (qytetarët) duhet t'ia tërheqin vërejtjen menjëherë.

Kjo liri, e cila është brenda suazave të përmbajtjes së parimeve të fesë është liri esenciale dhe atë të cilën e parasheh feja, ndërsa fjala liri absolute

nuk ekziston në fjalorin e fesë.

Koment i Dr. Sejid Xhemilit:

Në kuptimin e femrës, fjala liri ka për qëllim që ajo të veproj çka e sheh se është e drejtë dhe që ajo të jetë e kënaqur me vendimin e saj, pa ndërhy pala tjetër rreth marrjes së vendimit të saj, kushdo që të jetë, burri i saj apo ndonjëri i familjes, apo i farefisit. Sepse ajo me mendimin e saj dhe vizionin e saj, nuk ka nevojë që tjetri ta orientoj, sepse ajo është e pjekur, e mençur dhe e logjikshme.

Po nëse puna është kështu, atëherë zemrat të cilat ndryshojnë dhe epshet tërheqëse, atëherë bëhet pyetja prej çfarë prizmi me i shikuar. Në bazë të kësaj lirie, i lejohet që secili me pas shokë e shoqe, e asnjëri nuk ka të drejtë t'i ndërhy tjetrit për lidhjen e shoqërisë me tjetërkënd. Kështu që, femra e cila shoqërohet me një mashkull, ajo shoqëri sjell simpatinë, simpatia sjell dashuri, dhe shtohet ajo dashuri dhe sirtari rritet e shtohet. Dashuria është hija e njerëzve në thellësi të njerëzve, e rrënjosur në trupin e njerëzve.

ISRAJA ME TRUP APO ME SHPIRT

Israja a ka qenë vetëm me shpirt, siç mendojnë disa dijetarë? Edhe sot ka mendime të ndryshme rreth asaj se Israja, a ka qenë ëndërr apo me shpirt, apo ka qenë edhe me trup edhe me shpirt.

Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju përgjigjet:

Nuk është Muhamedi s.a.v.s. ai i cili ka bë vet Isranë, andaj rrini larg ligjeve njerëzore (natyrore), rrini larg ligjeve të tokës dhe ngrini çështjen tek Allahu i Lartmadhëruar.

Pastaj Shejh Shaëraviju vazhdon e thotë:

Nuk ka të bëjë me ëndërr, sepse po ta shoh unë një ëndërr, duke shkuar në Londër këtë natë, askush nuk e diskuton këtë çështje, sepse çdokush e di se është vetëm ëndërr, e jo realitet. Pasi që qëndrimi i urrejtjes i pabesimtarëve ka qenë se kanë thënë: A ti po thua se për një natë ke shkuar e ke ardhur nga një lartësi, të cilën ne nuk mund ta ecim me deve vetëm për një drejtim, një

muaj të plotë. Jep me kuptuar se ata e kanë kuptuar se nuk është në pyetje ëndrra, e as udhëtimi vetëm me shpirt, por ka qenë zgjuar dhe edhe me trup, edhe me shpirt. Sepse po të ishte ndryshe nuk kanë pasur nevojë me kundërshtua.

Pabesimtarët me urrejtjen dhe zilinë e tyre na kanë ndihmuar neve shumë sot, sepse ne themi: Po të kishte qenë ëndërr nuk do ta kishte diskutua askush, sepse ligjet e ëndrrës janë mbi ligjet e materies zgjuar.

Komenti i Dr. Sejid Xhemilë:

Fanatizmi si cilësi e urrejtur, zakonisht është shkak i injorancës së madhe: Ngjarja e Israsë ka qenë një ngjarje e cila i ka thye krejtësisht ligjet natyrore, e kjo ka ndodhur me fuqinë absolute të Allahut, e cila ia tejkalon fushës së logjikës njerëzore, e cila është e kufizuar dhe ka kaluar në horizontin e diturisë së Allahut, e cila është e pakufishme dhe e pafund, pa fillim dhe pa mbarim.

Nuk ka dyshim se kjo ngjarje i ka ulë dhe i ka nënçmua pabesimtarët e Mekës, me të gjitha ndodhitë tjera në të. Ndoshta kjo ka qenë çështja e qëlluar, e cila logjikën e ka përkufizua vetë në hapësirën e saj. E kjo ka qenë urtësi, e cila me madhështinë e saj ka shkaktuar mendime të kundërta, të ndryshme dhe të shumëllojta. Kjo është ajo se një gjë e tillë ndodhë te të gjitha çështjet tepër interesante, e pra le të kundërshtojnë kundërshtarët.

MARKSIZMI DHE OPIUMI I POPUJVE

Disa kanë shkruar për Islamin dhe Marksizmin, më ka ardhur shumë keq kur në ato libra kundërshtohet planprogrami i Zotit të Lartmadhëruar, të cilin Allahu e ka paraparë ligj për njerëzimin, ndërsa ata bëjnë krahasim me logjikën e tyre njerëzore, ligjet të cilat i kanë paraparë njerëzit, e pastaj hulumtojnë shkaqet të cilat sjellin mirëqenie ashtu siç dëshirojnë epshet e tyre, në çfarëdo forme, pa shkuar më larg, nuk e praktikojnë dhe nuk e shikojnë programin e Allahut, i cili në tërësi është mirësi, por orientohen rrugëve të cilat i parasheh njeriu, por për çka, për çështjet të cilat janë të prera me tekst kur'anor dhe janë të qarta.

Imami i mirënjohur Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë:

Mjerë për ata njerëz, të cilët i marrin idetë komuniste, i marrin idetë, të cilat janë larg dhe në kundërshtim me çështjet të cilat i ka paraparë i Lartmadhërishmi, dhe i Patjetërsueshmi në ekzistencë.

Kur dikush të thotë: Unë jam marksist. A nuk do të thotë se ai beson atë që ka besuar Marksi? Çka ka thënë Marksi në lidhje me fenë? Ka thënë: Feja është opium për t'i sunduar popujt.

Atëherë si me i thënë atij se është musliman? Vërtetë ata dëshirojnë që ta kenë islamin si peng, sepse ata kanë marrë urdhra prej eprorëve (të mëdhenjve), e zotërinjve të tyre, sa ende nuk ka ardhur koha ta sulmojnë islamin. Ky tentim i tyre veç ka dështuar, mirëpo kjo neve nuk na intereson. Nëse është ashtu, ata janë kundër vetes së tyre, (Mos ma tregoni mua islamin tuaj, pse përkundrazi Allahu do t'ju tregoj juve se a ju ka udhëzuar në islam apo jo). Kur ata thonë se Kur'ani nuk është i përshtatshëm për këtë kohë, sepse i ka kaluar koha, ne u kundërpërgjigjemi: Ti je ateist, sepse e ke akuzuar programin e Allahut, në atë se Allahu ka parapara planprogramin, i cili nuk është i përshtatshëm për njeriun!

ISLAMI DHE SOCIALIZMI

Islami ia ka tejkaluar socializmit. Islami është sistem shembullor dhe i përkryer i shoqërisë. Me parimet ateiste bie ndesh në planprogramin e Zotit të Lartmadhëruar.

Sa i përket socializmit Imami i nderuar Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë:

Ai nuk i akuzon jomuslimanët pse hulumtojnë për një sistem, i cili siguron jetë të lumtur në çfarëdo forme, në çfarëdo mënyre, mirëpo akuzon muslimanët, sepse për ta Islami në tërësi është mirësi. Dhe përderisa muslimani në fenë e tij i ka të gjitha të mirat, pse me pas nevojë për ato parime dhe atë sistem të prodhimit tokësorë.

A mundet që njeriu në të njëjtën kohë me qenë edhe musliman edhe komunist!! Ata arsyetohen dhe thonë se në Islam dhe Kur'an në fakt nuk ka asgjë, sepse ata fare nuk e njohin as Islamin e as Kur'anin. Ne po i sfidojmë,

nëse ndonjëri e ka lexuar Kur'anin, ose e ka studiuar, ose ka nxjerr ndonjë ligj prej tij. Atëherë ai gjykon për diçka çka nuk e di dhe pa e menduar fare. Ai ka lexuar për Marksin, ka shkruar një e më shumë libra dhe nuk ka lexuar fare për Kur'anin, e as për Islamin kur është praktikuar, për gjysmëshekulli çka ka sjellë feja për jofetarët. E kanë pranuar si sistem. E kanë pranuar se në të ka pasuar dobi dhe të mira.

Pra, të analizojmë dhe të bëjmë dallimin në mes të gjysmëshekullit ku është praktikuar Islami dhe gjysmëshekulli ku është praktikuar socializmi?

RIZKU

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"Dhe në qiell është i përgatitur rizku juaj dhe ajo çka u premtohet."

Ashtu siç e ka zakon dhe siç ka eksperiencë, dhe mendje të mprehtë, dhe fjalë të urta me ndikim, ai gjithmonë e nxitë dhe e zgjon mendjen time. Kësaj radhe përsëriti thënien e tij të njohur:

"Vërtet rizku yt, qoftë pasuri apo reputacion, e di më mirë se ti vendin e rizkut tënd".

Po ta dinin mirë këtë çështje të gjithë njerëzit, nuk do ta kishin munduar veten, nuk do ta kishin shtrënguar zemrën e tyre, nuk do t'i kishte tërhequr jeta, që kur u ndodh diçka, të fillojnë të preokupohen, e po të mos ishte ashtu, nuk do të ishte kështu. Le të qetësohen. Le të dinë se rizku çoftë pasuri apo reputacion ose pozitë, nuk e gabon atë e cila iu është caktuar. Ka dallim të madh në mes të punës me pjesët e trupit dhe mbështetjes në Allahun për të fituar rizkun (sa e sa punëtorë ditë e natë kanë punuar dhe nuk kanë asgjë).

E përkujtoj po ashtu fjalën, të cilën ma ka thënë mua, i nderuari shejh, Muhamed Muteveli Shaëraviju, kur isha duke e shkruar librin tim për jetën e tij, fikhun e tij. Atëherë më pat thënë: Nuk ke ardhur për të më bërë të njohur atëherë kur isha i ri dhe kisha nevojë për pasuri, por po vjen tani në pleqëri kur unë më nuk kam nevojë.

Kur e kam pyetur Shejhun për atë se njerëzit mundohen, me të gjitha mjetet e mundshme dhe rrugët e mundshme, për ta penguar shtatzëninë, më

pat thënë: *"Ata i frikësohen jetës dhe pakësimit të rizkut, ndërsa shumica prej tyre nuk e dinë se me sjelljet e tyre do ta bllokojnë rizkun e tyre dhe të fëmijëve të tyre".*

Ne me përvojën dhe jetën tonë në praktikë shohim se si njerëzit vdesin dhe lënë fëmijët jetim, dhe ditët ndërrohen dhe ata fëmijë jetim rriten dhe arrijnë në pozita të larta dhe shkallë të larta.

Ndoshta, po të kishin qenë të gjallë prindërit e tyre, ata nuk do të kishin arritur këto shpresa dhe dëshira e as ato pozita, e ato grada. Le t'ia lënë caktimit ashtu siç janë dhe le t'u kthehen çështjeve të tyre, dhe le ta shikojnë vetëm jetën e tyre. Sa e sa fëmijë kanë jetuar në gjirin e prindërve të tyre dhe në përkujdesje shumë të mirë, ndërsa në jetë kanë dështuar, janë bërë parazit dhe të padobishëm.

Pas tij filloi të komentojë edhe i nderuari, Shejh Halili, i cili ndër tjerash tha:

"Shumica e të mençurve, intelektualëve, i godet varfëria dhe jetojnë në gjendje të vështirë. Po nëse shikojmë jetën e tyre, nuk kanë arritur pasuri, as nivel të lartë të ekzistencës, përkundër dhuntisë së mendjes dhe diturisë së tyre".

Poeti i njohur Mutenebiu thotë:

Po të ishin furnizimet për shkak të punës e njohurisë,
Do të zhdukeshin kafshët për shkak të paditurisë së tyre.
Luani ngordh prej urie në shkretëtirë,
Derisa mishin e lopës e hanë qentë.
Injoranti flenë në shtrat të mëndafshit,
Derisa i dituri flenë për toke.

PSE NUK E SHOHIM ALLAHUN

Cila është arsyeja, urtësia apo më mirë të themi: Pse nuk e shohim Allahun?

Pyetje e natyrshme, mirëpo në ndjenja të njerëzve duket sikur diçka e tepruar dhe e panevojshme. Dhe a është e mundur për njeriun, i cili nuk e sheh shpirtin, i cili është në brendi të trupit të tij, me të cilin jeton dhe ia mundëson jetën, me qenë më afër vetes së tij se sa vetja e tij. E si atëherë kërkon apo si dëshiron për ta parë Allahun e Lartmadhëruar?!

Imami i mirënjohur Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë:

Prej Madhështisë së Allahut është se ti nuk mundesh ta shohësh Allahun, po ta kishe parë nuk do të kishte qenë Zot, sepse kur mendja përkufizon diçka apo syri përkufizon diçka, atëherë kuptimi merr kahe tjetër dhe ajo çështje bëhet e përkufizuar dhe e zvogëluar.

Ti nëse e sheh Zotin e Lartmadhëruar, atëherë shndërrohet I Pakufishmi në të përkufizuar, ndërsa Ai është i papërkufizuar, e ti po ta shohësh e ke përkufizuar atëherë.

Për këtë arsye, prej Madhështisë së Allahut të Lartmadhëruar është se ti nuk mund ta përkufizosh me sy. Kur Zoti i Lartmadhëruar e ka cilësuar veten e Tij: **“Allahu është dritë e qiejve dhe tokës.”,** dhe kur prej dritës vijnë rrezet e dritës, drita si dritë nuk përfshihet, por shihen sendet në dritë. E ne themi për Atë i Cili ka krijuar këtë (diellin), si është e mundur të përfshihet?! Mundet e nuk mund të përfshihet, sepse edhe prej krijesave të Tij ka çka nuk shihet e nuk mund të përfshihet. E si atëherë ti ta përfshish me shikimin tënd Atë.

Atëherë vetë mospërfshirja e tërësishme me shikim vërteton se Ai është Zot i vërtetë dhe absolut.

LUTJA

Gjithmonë njerëzit pyesin: Unë i lutem Allahut, por Ai nuk më përgjigjet. A do të thotë kjo se është në pyetje devotshmëria ime dhe moskënaqësia e Allahut ndaj meje, apo mos përgjigja ndaj duas sime është e kushtëzuar me çështjet tjera të cilat nuk i di.

Imami i mirënjohur Shaëraviju thotë:

Vërtetë Allahu dëshiron që njeriu t'i lutet me fjalën: "O Zoti im!", ashtu që ai të ketë shpërblim të madh, sepse ai e pranon planprogramin e Allahut me vullnetin e tij dhe me dëshirën e tij. Kjo është ajo çka do Allahu prej njeriut.

Ndonjëherë njeriu kërkon prej Allahut diçka që është shumë e dëmshme për të, edhe pse në shikim të tij i duket e mirë. P.sh., ndonjëherë kërkojmë pasuri, mirëpo ajo pasuri do të na kishte shkatërruar dhe do të na kishte larguar nga Allahu, do të na kishte bë kryelartë dhe kriminal, e do të kishte qenë ndonjë humbje e madhe.

Allahu dëshiron të na mbrojë dhe të na jep shpërblime të ahiretit dhe me na dhënë të mirën e begatshme. Këtu është çështja e pranimit të duasë. Këtu paraqitet mëshira e Allahut të Lartmadhëruar. Një njeri ka dëshirë me udhëtuar diku, mirëpo ai vend është dëmtim i perspektivës së tij.

Ndonjëherë njeriu dëshiron me arrit diçka, e kur ta arrij, ajo është e keqe e madhe për të. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Ndoshta urreni diçka, por prej asaj që e urreni Allahu ju jep të mira të shumta."

Po ashtu thotë: "Allahu e di e ju nuk e dini." Ndoshta ne duam diçka, në të cilën veç Allahu ka parapa të keqe të madhe. Duhet ta dimë se dashuria për diçka ose urrejtja për diçka nuk mundet me qenë mirë për ne.

Zakonisht njerëzit shikojnë çështjet sipërfaqësisht, ndërsa nuk i shikojnë çështjet në thelb. Pasi që Zoti i Lartmadhëruar ka përmendur pejgamberët në suretul Enbija, për pranimin e duave të tyre, ka thënë: **"Vërtetë ata kanë nxituar dhe kanë bërë gara në punë të mira dhe na janë lutur neve me frikë e me shpresë dhe kanë qenë të përulur ndaj Neve."**

Këto janë shkaqet e pranimit të duasë: Gara në punë të mira, duaja me frikë e me shpresë dhe përulshmëria ndaj Allahut.

BANKAT ME KAMATË DHE INVESTITUESE

Ka mendime të shumta dhe kundërthënëse të dijetarëve rreth Bankave, çeqeve investituese me përqindje të caktuar të fitimit. Disa mendojnë se çeqet "A" dhe "B" nuk janë të lejuar, ndërsa çeqet "C" janë lejuar, sepse këtu nuk kushtëzohet profiti i caktuar, por është bashkëpjesëmarrje, e me një fjalë shoqëri aksionare, ku mund të ketë fitim, por mundet edhe mos me pas fare fitim, ndërsa edhe për këtë disa kanë thënë se është veprimtari e dyshimtë.

Ata të cilët lejojnë deponimin në Banka, thonë: Të hollat në Bankë nuk janë të ngrira, apo të bllokuara, por investohen në projekte zhvillimore të ndryshme, kështu pra është me njërën anë qarkullimi i mjeteve, ndërsa në anën tjetër deponuesi nuk kushtëzon përqindje të caktuar, por Banka është ajo që vet për vete ka përcaktuar përqindje të kamatës. Kështu janë ashpërsuar polemikat dhe është bërë bujë e madhe rreth kësaj çështjeje në mes të përkrahësve dhe kundërshtarëve, lëvizin mendimet andej e këndej pa ndërprerë.

Kur e kam pyetur Sheh Muhamed Muteveli Shaëravijun për këtë çështje m'u përgjigj:

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: ***"Hallalli është i sqaruar. Harami i sqaruar. Mirëpo në mes tyre ka çështje të dyshimta. Sikurse një bari i cili ruan bagëtinë e tij rreth një gremine për mos me i ra bagëtitë në të. Kush largohet nga çështjet e dyshimta ai e ka pastruar (e ka ruajtur) fenë e tij, pasurinë e tij dhe nderin e tij." I Dërguari e ka thënë të vërtetën***

Imami i mirënjohur thotë:

Robi i cili vepron kështu është mostër dhe shembull, pastaj tërhoqi vërejtjen në Bankën Islame të Fejsalit, pastaj Masraf Islami. Në këto dy Banka muslimani mund të deponoj mjetet e tij. Me këto mjete veprohet me veprimtari islame, ku janë të tubuara mjetet e Zekatit.

Shejhi theksoi se ka dëgjuar se njësoj vepron edhe "Banka Egjiptase", e cila në kuadër të saj ka degën e cila merret me veprimtari islame. Fjala përfundimtare në lidhje me këtë çështje është se themelimi i Bankave Islame është e dobishme për sigurimin e mjeteve, ku edhe investimi në to pushon zemra dhe qetësohet shpirti.

SQARIM

Kohëve të fundit janë themeluar 11 Banka dhe Kompani Investitive për të qenë bashkëpjesëmarrës në planifikimin zhvillimor të tyre, për të realizuar planprojektet industriale, ekonomike dhe tregtare të ndryshme. Këto Banka kanë vendosur sistemin e shoqërive aksionare, që do të thotë investitorët marrin profitin i cili është hallall në Islam. Po ashtu Bankat Islame kryejnë të gjitha veprimtaritë bankare, dhe nuk kryejnë shërbime me kredi amatore, sikurse bankat tjera.

Në Egjipt në këto Banka Islame muslimani mund të investoj kapitalin e tij dhe të realizoj profitin e lejuar të papërcaktuar, duke hapur xhirollogaritë, apo format tjera të veprimeve dhe aktiviteteve Bankare. Prej këtyre bankave është Banka Islame Fejsal, me seli në Egjipt, Masraf Islami për investim dhe zhvillim ndërkombëtar, shoqëria investituese islame e kufizuar, po ashtu të Bankave tjera Islame që tashmë janë të njohura.

Këto Banka në të gjitha veprimtaritë e tyre, angazhohen në tubimin e kapitalit dhe aktivizimin e tij në veprimtari dhe investime të lejuara, duke u bazuar në dispozitat e Sheriatit Islam, dhe atë në të gjitha format, e ndër ta më e rëndësishmja shoqëria aksionare, duke shfrytëzuar kapitalin në realizimin e projekteve industriale, ekonomike, bujqësore, por me veprimtari hallalle, e jo harame, apo në donacione për projekte industriale dhe prodhuese. Duke filluar prej prodhimit, shitblerjes, sigurimin e plasmanit në treg të prodhimit të punëtorëve të këtyre Bankave dhe atë duke u bazuar në ndarjen e profitit të këtyre projekteve në bazë të bashkëpjesëmarrjes, eksperiencës, bashkëpjesëmarrjes në mes të shoqërive aksionare, të cilat në të njëjtën kohë i lejojnë mundësi qytetarëve hapjen e xhirollogarive, shërbimin ndaj qytetarëve për tërheqjen dhe deponimin falas – pa kamatë.

PYETJE DHE PËRGJIGJE

- **A ka të tillë që hynë në Xhenet pa llogari?**

- Po, janë ata të cilëve Allahu ua ka lejuar shkaqet, por ata nuk i kanë përdorur, nuk shikuan shkaqet, vetëm e vetëm me respektuar Kadanë dhe Kaderin që Allahu e ka caktuar për të.

- Ai i cili betohet se do të agjëroj, por vdes para se me realizuar përbetimin?

- Një grua e ka pyetur të Dërguarin e Allahut se i ka vdekur nëna e saj, dhe ka pa agjëruar agjërimin e përbetimit. Muhamedi s.a.v.s. i ka thënë: ***"Le të agjëroj në vend të saj kujdestari." (E ka regjistruar Ahmedi)***

Po ashtu është vërtetuar nga ai: ***"Kush vdes dhe ai ka për obligim agjërim, le të agjëroj për të kujdestari i tij."***

Nuk i lejohet përbetimi në mëkat ndaj Allahut, dhe ai përbetim të cilën nuk e posedon, nuk ka mundësi të kryhet.

Sead bin Ubadete e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: Nëna ime ka vdekur, por ka pasur agjërim të përbetimit, a lejohet që unë të liroj një rob – si kompensim? Muhamedi s.a.v.s. iu është përgjigjur: ***"Liroje një rob për nënën tënde." (E ka regjistruar Ahmedi)***

Në hadithet të cilat i ka përmbledhur Maliku:

Nëna ime ka vdekur, a i bën dobi asaj nëse e liroj një rob për të? Iu është përgjigjur: "Po."

- Pyetje: Zekati për familjarët të cilët janë nevojtarë.

- Përgjigje: Zekati, për familjarët për të cilët e ke obligim me u përkujdesur, nuk konsiderohet zekat, po ashtu nuk konsiderohet zekat për të ngritur standardin e të afërmit. Po ashtu është e ndaluar me e rezervuar dhe me e bllokuar zekatin për një kohë të caktuar, ashtu siç veprojnë disa.

- A lejohet Sadakaja për të vdekurin?

- Jo, sepse i vdekuri nuk përfiton prej asaj sadakaje.

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: ***"Njeriu kur të vdes, i ndërpriten të gjitha shpërblimet e punës së tij, përpos tri gjërave: Sadakaja rrjedhëse, dituria prej së cilës përfitojnë të tjerët dhe familjen e mirë, i cili lutet për të." (I Dërguari e ka fol të vërtetën)***

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për sadakanë më të vlefshme, e ai është përgjigjur: "Të dhënit e sadakasë përderisa je shëndosh dhe ke pasuri e i frikësohesh varfërisë, e shpreson pasurinë."

- Dënimi me Sheriat a ndikon mos me u dënua në botën tjetër për atë krim?

- Po, sepse për ndryshe atëherë do të barazoheshin krimineli me atë të cilit i është bërë krimi.

Për këtë arsye dënimet me pa të drejtë faljeje (Hudud) quhen *Xhevabire em Zevaxhire*. E vërteta është se ai i cili ka bërë mëkat quhet Xhevabir, e ai i cili nuk ka bërë mëkat Zevaxhir.

Një njeri i ka thënë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: Një grua më ka puthur. Për këtë shkak ka zbritur ajeti Kur'anor:

"Fale namazin në një pjesë të ditës dhe në thellësi të natës. Nuk ka dyshim se punët e mira i zhvleftësojnë punët e këqija."

Njeriu i ka thënë Muhamedit a.s.: Ky ajet ka zbritur vetëm për mua? Muhamedi a.s. i ka thënë:

"Përkundrazi, për të gjithë umetin tim."

- Pyetje: Si e ka krijuar Allahu botën?

- Përgjigje: Kur është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: Si e ka krijuar Allahu botën. ***"Ka qenë Allahu atëherë kur nuk ka pasur asgjë pas Tij, fronti i Tij ka qenë në ujë dhe në veten e tij ka shkruar dhe ka krijuar çdo gjë." (E ka regjistruar Ahmedi)***

- Si ka qenë Allahu i Lartmadhëruar para se të krijoj qiejt e tokën?

- Muhamedi a.s. ka thënë: ***"Ka qenë në hapësirën, ku mbi të ka qenë ajri, e nën të ajri." (E ka regjistruar Ahmedi)***

- A i fshin sëmundja mëkatet?

- I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: ***"Më të sprovuarit prej njerëzve janë pejgamberët, pastaj pasuesit e ngjashëm me ta, pastaj të ngjashmit me ta. Derisa robi i Allahut të jetë dhe ecë në tokë sprovohet, që të jetë i pastër (t'i fshihen) prej gabimeve."***

- Dënimi në varr me trup apo me shpirt, apo me të dyja?

- Zoti i Lartmadhëruar tregon për popullin e faraonit: **"Ata i ekspozohen zjarrit në mesditë dhe në mesnatë."**

Po ashtu ka thënë: **"Dhe ditën kur të ndodh çasti i kijametit (u**

thuhet) shpine familjen e faraonit në dënim më të ashpër."

Dy vdekje: Jeta pas vdekjes, ringjallja, pastaj dënimi pas ringjalljes

Kur është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për dënimin në varr ka thënë: ***"Po dënimi në varr është i vërtetë." (MUTEFIKUN ALEJHI)***

- A lejohet për muslimanin me prezantuar në kufomën e pabesimtarit?

- Jo, kurrsesi jo, por vetëm për respekt të njeriut (trupin), të cilin e ka krijuar Allahu.

- Të marrit me medicinën, pa qenë mjek (pa ditur), a jep ai njeri përgjegjësi?

- Shejh Shaëraviju thotë: Kjo është çmenduri, dhe ai i cili bën një gjë të tillë është i çmendur. Muhamedi s.a.v.s. ka treguar se ai i cili merret me medicinë e nuk është shumë i specializuar, ai jep përgjegjësi. Nga kjo kuptohet se, ai i cili është mjek por gabon në diagnozë dhe nuk ia ka qëlluar, ai nuk dënohet, me fjalë të tjera, nuk jep përgjegjësi.

- Në revistën "Livaul Islam" na kanë ardhur shumë pyetje për ata që falen në shtëpi përshkak të nevojave të tyre të posaçme, gjë që nuk iu le hapësirë për të shkuar në Xhami për t'u falur.

- Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an qartë tregon për namazin e xhumasë:

"O ju të cilët keni besuar. lëreni shitblerjen (dhe veprimtaritë tjera), e shpejtoni në përkujtim të Allahut (namaz)."

- Çka do të thotë shkurorëzimi vetëm pas kurorëzimit?

- Shkurorëzim do të thotë zhvleftësimi i aktit të kurorëzimit. Një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: Unë jam martuar me filanen, e cila ka qenë e shkurorëzuar tri herë. I ka thënë: ***"Martoje."***

Për arsye se ajo është shkurorëzuar pasi ka qenë e kurorëzuar.

Muhamedi s.a.v.s. është pyetur për një njeri, i cili është martuar me filanen, e cila ka qenë e shkurorëzuar. Ka thënë: ***"E ka shkurorëzuar atë, të cilën e ka në kompetencë." (E ka regjistruar Darukutniju)***

- **Pyetje: Pesimizmi dhe optimizmi?**

- Përgjigje: I Dërguari i Allahut s.a.v.s. dëshironte që te Hasani gjithmonë të mbillte optimizëm, e urrente pesimizmin.

Po ashtu ka thënë: ***"S'ka vend për pesimizëm, më së miri është me qenë optimist dhe me fol për optimizëm." I kanë thënë: O i Dërguari i Allahut, po ç'është optimizmi? Është përgjigjur: "Ajo që dëgjohet vetëm për ardhmëri të mirë, fjalë të bukura." (MUTEFIKUN ALEJHI)***

- **Është pyetur Muhamedi s.a.v.s. për TAUNIN – KOLERËN.**

- Ka thënë: ***"Dënim kundër atyre që kanë qenë para jush, e pastaj e ka bërë mëshirë për besimtarët. Çdo njeri i cili gjendet ne një qytet ku është përhapur, le të duroj, e mos të dalë, por ta dijë se nuk mund t'i ndodh vetëm se ajo që e ka shkruar Allahu, e nëse vdes atëherë do ta ketë shpërblimin e dëshmorit." (E ka regjistruar Buhariu)***

- **A është obligim abdesi për shkak të ngrënies mishit të bagëtive dhe deveve?**

- Vetëm mishin e devesë. Qëllimi është i përgjithësimi i dispozitës, e jo specifika e rastit, pse Muhamedi s.a.v.s. i ka urdhëruar Sahabët me marrë abdes.

- **Nëse femra sheh ëndërr (duke kontaktuar), a merr gusël?**

- Po, nëse veç ka ejakuluar dhe sheh shenja në rroba.

Umu Selmete i ka thënë Muhamedit s.a.v.s.: Allahu nuk turpërohet nga e vërteta. Gruaja nëse ëndërron (kontaktim seksual), a merr gusël? Muhamedi s.a.v.s. i ka thënë: "Po, nëse sheh shenja në rroba (të lagura)." Umu Selmete i ka thënë: Ose me ëndërrua gruan? Muhamedi a.s. i ka thënë: Të lumshin duart! Po kujt i ngjason fëmija i saj?

Në një transmetim tjetër:

Umi Selmete e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. për femrën, e cila sheh në ëndërr atë që e sheh burri. Është përgjigjur: ***"Nëse femra e sheh atë (ëndërron dhe pastaj sheh shenja në rroba), merr gusël."***

Në MUSNED qëndron se Havlete bint Hakimë e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. për femrën e cila sheh në ëndërr atë që sheh burri. Ka thënë: ***"Nuk merr gusël derisa të mos ejakulojë, ashtu sikurse edhe burri nuk merr gusël derisa të mos ejakulojë."***

- Pyetje: Lëkura e deles së ngordhur a është e lejuar apo e ndaluar?

- Përgjigje: Çdo lëkurë e cila teret është e pastër, përpos lëkurës së njeriut, i cili është veç i nderuar, dhe lëkura e derrit, e cila është e papastërti (e terur apo e paterur).

ISTIHAREJA DHE ËNDRRA E MIRË

Disa mendojnë se Istihareja e cila është sunet nga pejgamberi s.a.v.s. nuk është e vërtetë dhe e refuzojnë absolutisht, dhe kot e ke me i bindur disa prej tyre. Për këtë e kam pyetur shejh Shaëravijun se çka mendon për këtë.

Ai beson plotësisht.

Po ashtu beson në ëndrrat e vërteta. Ai mendon se nëse pabesimtari sheh ëndërr, nuk përputhet pabesimi i tij me ëndrrën e vërtetë të tij, por ëndrra e mirë përputhet me interpretimin e mirë.

Në suretu Jusuf, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Dhe tha mbreti: Kam parë ëndërr, se shtatë lopë të shëndosha i hanin shtatë lopë të dobëta dhe shtatë kallinj gruri të njomë, shtatë të tjera të tharë. O njerëz të shquar! Ma shpjegoni ëndërrën time, nëse jeni që i shpjegoni ëndrrat". (Jusuf,43)

Mbreti i Egjiptit, firaoni i Egjiptit, në atë kohë ka qenë pabesimtarë, por kjo ëndërr ka qenë nderim për të burgosurin e tij, Jusufin a.s., i cili e ka interpretuar ëndrrën nga burgu.

"Jusufi tha: Për shtatë vjet rresht do të mbillni si zakonisht dhe çka të mblidhet, lene në kallinj (rezervojeni) , përveç një sasie të vogël që mund ta hani (ta harxhoni). Se pastaj do të pasojnë shtatë vite të vështira (ku nuk do të ketë të lashta), të cilët do të gllabërojnë të gjithë atë që keni lënë menjë anë (rezervuar) qysh më parë për këto vite, përveç një pakice të asaj që keni ruajtur. Pastaj, mbas kësaj do të vijë një vit në të cilin do të ketë për njerëzit shi të bollshëm në të cilin do të shtrydhin (rrush e vaj)". (Jusuf,47-49)

Dhe Jusufi siç e ka interpretuar edhe ka ndodhur.

Kur Muhamedi s.a.v.s. është pyetur për domethënien e ajetit: **"Për ta ka përgëzime në këtë botë dhe në botën tjetër"**, është përgjigjur: ***"Është***

ëndrra e mirë e besimtarit, të cilën e sheh, ose shihet për të."

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: ***"Është ndërprerë lidhja e pejgamberisë, dhe nuk ka mbetur lidhje tjetër përpos përgëzimeve."*** **E kanë pyetur: Po çka janë ato 'përgëzime', o I Dërguari i Allahut? Ka thënë:*"Ëndrrat e vërteta. Apo është pjesë prej dyzet e gjashtë pjesëve të pejgamberisë."***

SIGURIMI NË ISLAM

Sipas mendimit të Shaëravijut, sigurimi i jetës për ta ditur njeriut ndjenjën e imanit të tij, që kur t'i ndodh ndonjë aksident në vend se me thënë: O Zot! më ndihmo, ai thotë: Erdhën paratë, fitova paratë. Aksidenti i cili më ndodhë mua, apo në pasuri apo në diçka tjetër, ndoshta qëllimi i Allahut është që të më pastrojë. Njerëzit nëse fëmijët e tyre i lënë të dobët (pasi vdesin), kur t'i pashë pas një kohe të lumtur. Kur Islami praktikohet në tërësi, nuk ka nevojë për policën e sigurimit absolutisht. Islami është ndërtesë, e cila duhet të jetë e ndërtuar në tërësi prej themelit e deri në kulm, pa lënë kurrfarë zbrazëtire.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Dhe le të brengosen e ta kenë parasysh që sikur të linin pasardhës të dobët pas vetes së tyre do të ishin të frikuar ata për veten e tyre. Kështu le të kenë frikë Allahun dhe le të flasin fjalë të drejta".(En-Nisa, 9)

Shejh Shaëraviju përkujton se gjatë fundit të jetës së tyre Muaviju dhe Amër ibn Asi ishin ulur e po bisedonin. Muaviju i thotë Amrit: Sa i përket të mirave ushqimore jam ngopur, sa i përket rrobave, më janë neveritur. Fati dhe kënaqësia ime tani është në pirje të ujit të ftohtë në ditën e verës së nxehtë nën hije të pemës.

Po ty o Amër, çka të ka mbetur prej të mirave të kësaj bote?

Ai i tha: Toka Huvaruhu, e cila i ka rojet, të cilat sillen në jetën time dhe të fëmijëve të mi pas vdekjes sime. Rojtari i quajtur Virdan, i cili u shërbente me pije, deshi të mahitej me Muavijun, e i tha: O Verdan, ti shumë mirë po punon dhe po rregullon ushqimet në shpinë të popullit, i cili nuk më jep mua asgjë në jetën time, por as pas tyre. Ai tha: Sot na mundi robi o

Amër.

Tregohet se zotëriu ynë Omer ibnu Abdul Azizë dhe Hisham bin Abdul Melik, që ne e dimë se si ka qenë puna, e kur Mukatil bin Selmani ka hyr te Mensuri për me ia uruar hilafetin, i ka thënë:

Më këshillo o Mukatil. Ai i tha: Me të këshillua për atë që kam parë apo atë çka kam dëgjuar? I tha. Për atë çka ke parë. I tha: O emirë i besimtarëve Omer bin Abdul Azizë, e kanë trashëguar njëmbëdhjetë fëmijë dhe i ka lënë trashëgimi tetëmbëdhjetë dinarë. Me pesë dinarë është blerë kefini, dhe iu është paguar varri katër dinarë, ndërsa të tjerat iu ndanë fëmijëve. Ndërsa kur vdiq Hisham bin Abdul Meliki, hisja (pjesa) e njërës prej grave të tij, ka qenë katër nukud (pare) dhe tetëmbëdhjetëmijë pallate. Për Zotin o Emiri i besimtarëve, për Zotin e kam parë me sytë e mi për një ditë një djalë i Omer bin Abdul Azizit, i kishte njëqind kuaj, me të cilët luftonte në rrugën e Allahut me gjithë ata kuaj, ndërsa në anën tjetër e kam parë djalin e Hishamit duke lypë rrugës. Pra, çka me siguruar unë.

LEJLETUL KADRI

Një çështje të cilën e përfolin disa: A e ka pa i Dërguari i Allahut s.a.v.s. natën e kadrit, dhe a e ka pa atë ndonjëri prej njerëzve të mirë natën e vërtetë të Lejletul Kadrit?

Imami i nderuar, shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë:

Kanë thënë se asnjë prej krijesave të Allahut nuk e kanë pa natën e Lejletul Kadrit, përpos të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.. Kjo është specifikë me të cilën e ka dalluar Allahu të Dërguarin e Tij, e pas tij e kanë parë prej njerëzve ata të cilët e kanë pa, i kanë treguar Muhamedit a.s. se e kanë pa në ëndërr. Siç është rasti kur i kanë treguar: E kam pa sikurse jam duke ra në sexhde në ujë dhe kur ka aguar agimi në natën e tridhjetë e tretë kanë mbetur në Xhami tërë natën, se ka ra shumë shi nga qielli, dhe ka ra në sexhde i Dërguari i Allahut s.a.v.s..

Nga kjo kuptojmë se atë vit në atë natë ka qenë nata e Lejletul Kadrit.

Hadithi tjetër: Është vërtetuar nga i Dërguari i Allahut s.a.v.s., se ai ka dalë për në Xhami kur ishin sahabët dhe i sheh duke u ngatërruar me vete. Atëherë ka thënë: ***"Erdha për t'u treguar se kur është nata e Kadrit, mirëpo***

pasi që ndodhi konflikti mes filanit dhe filanit, saktësia e asaj nate është ngritur (u bë e panjohur). Por ju kërkojeni atë natë në dhjetë netët e fundit."

Po të ishte ngritur dituria e mosnjohjes në tërësi të Lejletul Kadrit, nuk do të kishte thënë: "Kërkojeni në dhjetë netët e fundit", mirëpo ajo çka është ngritë (është fsheh) përcaktimi i saktë në mes dhjetë netëve të fundit.

Mirëpo hadithet të cilat tregojnë: *Kërkojeni në natën e njëzet e shtatë* i kanë shpjeguar se të gjitha ata hadithe kanë të bëjnë për natë e njëzet e shtatë të vitit të njëjtë, pra të një viti, pra kërkojeni në këtë natë, ndërsa në vitin tjetër kërkojeni në këtë natë (jo të njëzet e shtatën) . Për këtë arsye e dimë se transmetimet e ndryshme kanë të bëjnë për në vite të ndryshme, ndërsa nuk kanë të bëjnë transmetimet e ndryshme për të njëjtin vit.

Pas kësaj kanë ardhur sahabët e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. dhe një pjesë e tyre kanë treguar se e kanë pa në ditën e shtatë të dhjetë netëve të fundit, që do të thotë njëri e ka pa në këtë natë, tjetri në atë natë dhe në përgjithësi e kanë pa në të shtatën e fundit. Muhamedi a.s. i ka thënë: po shoh ëndrrat e juaja, që do të thotë janë përputhur ëndrrat. Kërkojeni në ditën e shtatë të dhjetë ditëve të fundit, por të atij viti, e jo edhe për vite te tjera. Dhe çdo transmetim që ka ardhur për përcaktimin e natës, ka ardhur me përcaktim të asaj nate.

Disa kanë thënë se nata e Lejletul Kadrit ecë (ndryshon) për çdo vit.

DHE KUR IBRAHIMI NGRITI THEMELET E QABES

Thuhet se Ibrahimi a.s. është ai i cili e ka ndërtuar Qaben, mirëpo disa thonë se Melekët e kanë ndërtuar Qabën.

Shejh Shaëraviju mendon se:

Shtëpia e Allahut, Qabja, është ndërtuar shumë e shumë kohë para Ibrahimit a.s., mirëpo Ibrahimi a.s. është ai i cili i ka ringritur themelet, saktësisht ai me të birin e tij, Ismailin.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Dhe përkujto kur themelet e shtëpisë (së shenjtë – Qabes) i ka ngrit Ibrahimi dhe Ismaili."

Fjala "I ka ngritur" ka kuptimin se, Qabja veç ka ekzistuar para asaj

kohe, mirëpo ka ardhur Ibrahimi për ta rindërtuar, për të ngritur themelet përsëri.

KOMENT

Dhe duaja e tyre është: dëgjimi dhe shikimi për çdo kohë dhe çdo gjeneratë.

"O Zoti ynë! Na bën neve dyve muslimanë te Ti, po edhe pasardhësit tanë, bëji popull muslimanë te Ti, dhe na mëso rregullat e fesë sonë dhe na falë neve. Vërtetë Ti je Falës, i Mëshirshëm."

Mrekulli artistike, fotografi e gjallë, e cila flet gjallërisht, shtëpia ka ekzistuar para Ibrahimit a.s., pse argumentet për këtë kemi fjalën e Zotit të Lartmadhëruar:

"(Ibrahimi tha:) Zoti ynë! unë një pjesë të familjes sime e vendosa në një luginë, ku nuk ka bimë, te shtëpia jote e shenjtë..."(IBRAHIM, 37)

Pjesa e ajetit: **"Te shtëpia jote e shenjtë"**, ndajfolja e fundit na vërteton neve se shtëpia ka qenë derisa Ismaili a.s. ka qenë duke pi qumësht para se të rritej.

Po kjo është ashtu, Allahu e di më së miri.

KTHEHU TE ZOTI YT

NJË PYETJE ME DY PËRGJIGJE

Sa i përket ndodhisë Isra dhe Miëraxhi, siç tregojnë transmetuesit, shejh Shaëraviju thotë:

Kur iu është bërë obligim namazi, pastaj Muhamedi a.s. ka kaluar pranë Musa a.s. kur ia tregon obligueshmërinë e namazit. Ai thotë: Kthehu te Zoti yt dhe kërko le të reduktohet (të lehtësohet). Kështu Muhamedi a.s. është kthye dy tri herë deri sa ka arrit në pesë namaze farze me shpërblime të pesëdhjetë kohëve. Për këtë kanë shkruar librat e udhëpërshkrimit të Muhamedit a.s. për këtë janë pajtuar pjesa dërmuese e fukahave, duke u bazua në mendimin e shumicës dhe transmetimeve të shumta. Mirëpo njëri prej dijetarëve më ka pyetur: Si është e mundur që Musa a.s. me thënë: "Kthehu te Zoti yt". A do të thotë kjo se Zoti i Lartmadhëruar nuk ka qenë me

ta sepse e dimë se ai është, gjendet në çdo vend. Ka qenë dashtë që më mirë me thanë: "Lute Allahun drejtpërdrejtë", sepse fjalia "Kthehu te Ai" nënkupton se Ai nuk ka qenë aty saktësisht. Ndërsa Allahu është prezent në çdo vend dhe drita e Tij është e shpërndarë te të gjitha krijesat dhe në ekzistencën në përgjithësi. Këtë çështje ia parashtroi Sejid Xhemilë Imamit të mirënjohur Muhamed Muteveli Shaëravijut i cili u përgjigj në mënyrë të mrekullueshme. "Kthehu te Zoti yt" nuk nënkupton vendin, por qëllimi është kthehu dhe analizoje çështjen të cilën e ke pranuar. Këtu pra: Kthimi te Allahu ka për qëllim kthehu në vet çështjen, analizoje çështjen. E nuk e ka për qëllim me u kthye në vendin e ekzistimit të Tij.

KOMENT I DR. SEJID XHEMILË

Sejid Xhemilë jep përgjigje tjetër ku thotë:

Kur Allahu dëshiron për ti falë ose për ta obliguar, ndonjë pejgamber prej pejgamberëve të tij, ose të Dërguar prej të Dërguarve të tij pa kurrfarë ndërmjetësimi apo pa e frymëzuar patjetër duhet t'i paraqitet. Ashtu siç iu ka paraqitur Musa a.s. në Turisina. Mëshira e Allahut për të gjithë njerëzimin që Ai mos me iu paraqitur atyre, sepse kur iu është paraqitur kodrës, kodra është bë copë e grimcë, po t'iu paraqitet njerëzve, të gjithë do të digjeshin nga drita e fortë e Allahut.

Para se t'i paraqitet Zoti i Lartmadhëruar ndonjë pejgamberi ose të Dërguari patjetër ai pejgamber duhet të kaloj në gjendje hyjnore, me u zhvesh nga cilësitë njerëzore, për tu përgatitë dhe për të qenë në gjendje për ta pranuar nga Allahu. Kështu ai shndërrohet në një gradë të lartë, jashtë kategorisë njerëzore. Me një fjalë: Në përgjithësi Allahu ekziston dhe është prezent në çdo vend dhe në të gjitha anët, por nuk paraqitet në çdo vend por në disa vende. Dhe kur Musa a.s. ka thënë: "Kthehu te Zoti yt" dhe kërko lehtësim për vete. Ka për qëllim kthehu te vendi ku të është paraqitur dhe ke folur me Të dhe kërko lehtësim.

Çështja është se ka dallim të madh në mes të ekzistimit të Tij në çdo vend dhe në mes të paraqitjes së Tij i cili është nder dhe respekt i atij të cilit iu është paraqitur. ALLAHU E DI MË SË MIRI.

SHEMBULLI I DRITËS SË TIJ

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"All-llahu është dritë (ndriçues, udhëzues) i qiejve e i tokës. Shembulli i dritës së Tij i gjason kandilit të vendosur në një zgavër të errët. Kandili gjendet brenda një qelqi si të ishte yll flakërus e që ndizet prej (vajit të) një druri të bekuar, prej ullirit që nuk mund të quhet as i lindjes e as i perëndimit, e vaji i tij ndriçon pothuajse edhe pa e prekur zjarri. Dritë mbi dritë. All-llahu udhëzon kah drita e Vet atë që do Ai. All-llahu sjell shembuj për njerëzit. All-llahu çdo gjë di shumë mirë." (EN-NURË, 35)

Kur është pyetur pejgamberi s.a.v.s.: A e ke parë Zotin Tënd? Është përgjigjur: ***Vërtet e kam pa, sikurse me pa dritë të fortë***. Ndonjëherë nuk shihet drita për shkak të fortësisë, pra dritës së fortë. Përderisa dielli i cili është krijesë prej krijesave të Allahut, nuk mund të shihet. Po si është e mundur që syri i thjesht me thjerrëza me pa dritën e Allahut të fortë i cili posedon të gjitha cilësitë. Cilësitë e emrave, cilësitë vetanake dhe është i cilësuar dritë përmbi dritë.

FEMRA, TRASHËGIMIA DHE TESTAMENTI PËR TRASHËGIMTARIN

Një lexuese e gazetës "Livaul Islam" ka parashtruar një pyetje: Babi im ka ndërruar jetë kur i kam pasur pesë vite, e kam axhën (vëllanë e babës) Zoti e pastë mëshiruar i cili ka fëmijë, mirëpo gjyshja ime ende është gjallë. Mirëpo gjyshja ime, Zoti ia lehtësoftë asaj, të gjithë pasurinë ia ka bartë djalit të saj (Axhës tim) dhe nuk më jep asgjë nga trashëgimia e cila është e drejt legjitime e imja. A kam të drejtë të paraqes në gjyq për ta fituar të drejtën time, sepse ajo arsyetohet se ajo frikohet mos vallë nëna ime do të martohet me tjetërkënd.

Këtë pyetje ia parashtrova të nderuarit Shejhut Muhamed Muteveli Shaëravijut i cili u përgjigj:

Kjo vajzë nuk ka të drejtë trashëgimie, sepse axha i saj nuk ia ka lejuar

këtë.

E pyeta Imamin: Edhe pse kjo vajzë ka qenë fëmijë i të vdekurit, a nuk ka hise? I nderuari u përgjigj:

Edhe nëse është fëmijë .

Imami i nderuar Muhamed Muteveli Shaëraviju vazhdoi:

Kjo vajzë nuk ka të drejtë të trashëgoj edhe nëse është fëmijë, por ajo ka të drejtë testamentin vaxhib, i cili nuk mundet me tejkaluar një të tretën, dhe ky testament është i kushtëzuar me qenë për trashëgimtarin. Kushtëzimi i testamentit të trashëgimtarit do të thotë që të gjithë trashëgimtarët me ra në dakord për atë testament.

LYPËS QUHET EDHE NËSE ËSHTË NË KALË TË SHALËS

Njëri prej vëllezërve mysliman e ka pyetur Shejh Shaëravijun si është dispozita e lypësit për të cilin e dimë mirë se s'ka nevojë për të lypur, mirëpo ai e ka traditë me lyp. Me i dhënë apo jo?

Imami i nderuar u përgjigj:

Lypës është edhe nëse është hipur në kalë të shalës. Përderisa ai ka pranuar, e ka lejuar veten me qenë lypës. Ti as nuk ke mëkat nëse i jep, por gjithashtu ke të drejtë mos me i dhënë. Ti ke shpërblim për atë çka jep dhe qëllimin për çka jep.

Muhamedi a.s. nuk e ka kthye lypësin.

NAMAZI DHE FALJA E TYRE PASI TË I KALOJË KOHA (NAMAZET KADA)

Është pyetur Imami i mirënjohur për faljen e namazit të cilit i kanë kaluar deri sa ka qenë i ri. Me i falë apo jo. Pra a me i falë kada dhe si me i falë ose si me i falë edhe sunetet, nafilet sepse ato janë borxh i kaluar (i hershëm). A nuk tolerohet mos me i falë për borxhin e hershëm?

Shejh Muhamed Muteveli esh-Shaëravi është përgjigj:

"Nuk ka dyshim, se sa i përket namazeve që nuk i ka falë fare në të kaluarën, sunetet nuk i falë fare, por pas çdo farzi të namazit të cilën e falë ia bashkëngjit edhe një farz të të njëjtës kohë, të cilën nuk e ke falë në të kaluarën. Patjetër duhet me falë namazin që nuk e ke falë më herët, sepse nuk ka arsyetim për mosfalje të namazit.

Nuk i shpëton Imamit të njohur pa treguar për dispozitën e namazit dhe lëshimin e namazit dhe si lënësi i namazit është dy llojesh:

1. Njeriu i cili nuk e refuzon obligimin për faljen e namazit, pra e pranon, por për shkak të përtacisë, neglizhencës nuk e falë. Këtij përtaci i themi patjetër duhet të falesh.
2. Ndërsa, njeriu i cili nuk falet dhe nuk e pranon obligimin e namazit fare ai është pabesimtarë.

NAMAZI PARA KRIJUESIT

Dr. Sejid Xhemilë tha: Namazi është shtyllë e fesë, sepse në të ka begati të shumta dhe dhurata të mrekullueshme. Namazi është bë obligim me argument të qartë ku Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Dhe fale namazin e jepni zekatin**". Në namaz është qetësimi i zemrës, shërimi i shpirtit, pastrimi i mendjes sepse është ndërlidhshmëri mes robit dhe Krijuesit të Tij. Ky raport, kjo lidhshmëri ka rëndësi të posaçme në të është edukimi trupor, elasticiteti i nyjeve të trupit, për këtë arsye konsiderohet shërim terapik i reumatizmit dhe djegieve të nyjeve të pjesëve të trupit, forcon boshtin kurrizor dhe disa sëmundje të eshtrave, dhe disa sëmundje tjera të eshtrave që nevojitet të shërohen vetëm me terapi.

Abdullah Ibn Sead e ka pyetur Muhamedin a.s.: ***Cili namaz është më i vlefshmi, në shtëpinë time apo në xhami? Muhamedi a.s. iu është përgjigjur: A po e sheh se shtëpia ime është afër xhamisë? Më e dashur për mua është që të falem në shtëpi se sa në xhami, përpos namazeve farze.***

E KA REXHISTRU IBN MAXHE

Është pyetur Muhamedi s.a.v.s.: ***Kur duhet të fillojë të falet fëmija? Është përgjigjur: Kur ta kuptoj se cila dorë është e djathtë e cila e majta, urdhëroni për namaz.*** Nëse për ndonjë person i cili nuk ka mundësi të falet (namazet farze) në xhami, kurrfarë pengese nuk ka që të falet në shtëpi, sepse ajo çka është e përmendur është se përfundimi i namazit të bëhet në xhami, ndërsa vetëm namazi i Xhumasë nuk lejohet në shtëpi sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"O ju të cilët keni besuar, kur të thërritet ezani për namaz në ditën e Xhumasë, shpejtoni në përkujtimin e Allahut (faljen e namazit) dhe ndërpriteni shitblerjen (dhe çdo veprimtari tjetër)". (El-Xhumua, 9)

Muhamedi a.s. ka thënë: ***Nga bota juaj, më së shumti janë të dashura për mua tri gjëra: Gratë, aroma e mirë, ndërsa qetësim i shpirtit tim është namazi.***

Shejh Shaëraviju mendon se namazi i përmbledhë të gjitha shtyllat e Islamit e ato janë pesë: E para: Kur të thotë: Esh-hedu en Lailahe il-lallah ve ene Muhamedun resulullah, e dyta: Zekati, sepse ai e jep një pjesë të kohës së tij. Pra e njëjta kohë që shpenzohet në namaz, po e njëjta është koha kur ndokush ka përfituar pasuri, pra namazi është që ka shpenzuar elementin e dhënies (kohës), pra falësi ka dhënë zekatin.

Shejh Shaëraviju thotë se namazi i Zekatit është sikurse me pas dhënë pasuri. Po ashtu në namaz është edhe shtylla tjetër e Islamit agjërimi, sepse agjërimi të ndalon nga epshi i barkut, dhe i organeve seksuale gjatë ditës së ramazanit. Namazi të ndalon po ato gjëra të cilat t'i ndalon agjërimi sepse nuk të lejon as me fol. Po ashtu edhe shtylla e pestë Haxhi, sepse në namaz e ke kthye fytyrën tënde në drejtim të Qabes dhe ajo sikurse me qenë para vetes tënde. Për këtë arsye namazi ka rëndësi të posaçme dhe nuk lirohesh nga ky obligim asnjëherë, sepse të gjitha shtyllat e Islamit janë në ta.

Është pyetur Muhamedi a.s. për namazin e Xhumasë dhe vlerën e tij. E Ai ka thënë pesë gjëra: ***Në atë ditë është krijuar Ademi, në atë ditë ka zbritur në tokë, në atë ditë ka ndërruar jetë, në të është një çast ku Allahu e pranon lutjen e lutësit, përpos nëse është mëkat apo shkëputje të ndërlidhjeve***

farefisnore jo, në atë ditë do të ndodh kiameti. Çdo melek i afërt, qielli, toka, kodrat, gurët të gjitha këto shkëlqejnë në ditën e xhumasë. **(E KA REGJISTRUAR AHMEDI DHE SHAFIIJU)**

Pyetje: Agjërimi për mua... Pse?

Përgjigje: Sepse njeriu mundet me ngrënë në vetmi, ndërsa para njerëzve me u tregu se është agjërueshëm, për këtë arsye është vepër e posaçme, dhe Allahu i Lartmadhëruar shpërblen Vetë, pa angazhuar askënd tjetër në atë shpërblim.

Cila është dispozita për njeriun i cili hanë dhe pinë me harresë në Ramazan?

Asgjë, përpos asaj që Muhamedi a.s. ka thënë: ***E ka ushqyer dhe i ka dhënë ujë me pi Allahu, e ai le të vazhdojë agjërimin.***

Një njeri e ka pyetur Muhamedin a.s.: Me qenë koha e namazit, ndërsa unë jam i papastër (xhunub) dhe jam agjërueshëm. Iu është përgjigjur: Po edhe unë ashtu, me qenë koha e namazit, ndërsa unë jam i papastër (xhunub) dhe jam agjërueshëm: I tha ai njeri: Po ti o I Dërguar nuk je si ne, sepse Allahu t'i ka falë mëkatet e kaluara dhe të ardhshmet. Muhamedi a.s. i tha: Për Allahun, kam shpresë se unë jam ai i cili më së shumti i frikohem Allahut, e po ashtu kam dëshiruar tu mësoj juve kulminacionin e devotshmërisë.

TATIMET DHE ZEKATI

Të gjithë e dimë se shteti parasheh dhe cakton tatime për shtetasit, për tu zhvilluar, për shërbime, për infrastrukturë dhe projekte të mëdha të cilat individët nuk mund t'i realizojnë, këto projekte të cilat i shfrytëzon shoqëria në përgjithësi. Këto tatime a kanë lidhje me zekatin ... apo ato janë investime, tatime të cilat nuk kanë të bëjnë dhe nuk kanë lidhje me zekatin.

Shejhu Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë:

Nuk lejohet që fondi i tatimeve të paralelizohet si fond i zekatit, sepse ka të varfër, të uritur dhe nevojtarë.

Çka vepron shteti? Shteti obligon tatimet si kundërvlerë e shërbimeve

ndaj qytetarëve, sepse rrugët i shfrytëzojnë automjetet.

Pra shërbimet publike i merr në përgjegjësi shteti. Nëse prej tatimeve individuale shteti nuk mundet me realizuar projekt-buxhetin ose nuk mund të ndërtoj shkolla. Në shkollë shkon djali i të pasurit, në xhami falen të gjithë njerëzit, të pasur e të varfër. Pra zekati mund të destinohet në këto investime, atëherë kur nuk mjaftojnë apo nuk ka fonde për këto investime.

Pra, për projektet të cilat janë në shërbim të të gjithëve nuk jepet zekati asnjëherë, mirëpo zekati është për të varfrin nëse plotësohen të gjitha nevojat e të varfërve, atëherë mirë se janë ato fonde të zekatit, lejohet për nevoja tjera shoqërore sepse shteti ka burime të shumënumërta dhe të shumëllojta, si ganime (pasuria prej luftës) enfal (pasuria prej luftës), Haraxhi (tatimet). E nëse shteti nuk mundet me i realizua me sukses projektet e tyre, parasheh prej tatime në bazë të mundësive materiale të tyre.

PYETJE DHE PËRGJIGJE

Deri sa ishim në shtëpinë e tij, njëri prej prezantuesve ia parashtron një pyetje shumë të rëndësishme.

Supozojmë se një njeri tubon një shumë të konsiderueshme për shpenzime të martesës së vajzës së tij. P.sh. 1000 lira egjiptase, ose më shumë ose më pak. Mirëpo ai e ka gjendjen e vështirë ekonomike, ai e ndjen primare me e ruajt atë shumë dhe çdo herë kur deponon në atë arkë një ditë prej ditësh arrin shumën e Nisabit e cila shumë e obligon që ta jep zekatin. A e ka për obligim me dhënë zekatin apo jo?

Shejh Shaëraviju është përgjigj:

Po, e ka për obligim dhënien e zekatit se dihet me arritjen e vlerës së Nisabit, bëhet obligim zekati.

Komenti i Dr. Es-Sejid d. Xhemijli

Mendoj se kjo çështje është përhapur shumë në ditët e sotshme, sa që mendojnë njerëzit se për tubimin e mjeteve për këto çështje nuk jepet zekati, mirëpo duhet që sa më shpejtë me u çliruar prej këtyre iluzioneve dhe le ta japin hakun e Allahut (zekatit), pra të drejtën e tyre për ta fituar kënaqësinë e

Allahut të Lartmadhëruar se e drejta e Allahut ka prioritet mbi çdo gjë.

Një prej fatkeqësive njerëzore është zbavitja me logjikën e tij që do të thotë me mendua me vepruar njeriu në diçka çka është në kundërshtim me dobinë e tij apo është në kundërshtim me atë çka është faktike. Xhemal Safi shkruan se kjo i ngjason përzierjen e lotëve të buzëqeshjes me lotët e të qajturit p.sh. Me mendua se rruga qorre është rrugë tejkaluese dhe rruga tejkaluese rrugë qorre. Ata hanë para të fëlliqura dhe nuk e dinë. Ata nuk kanë mundur të na sjellin kurrfarë arsye as dëshmie, ashtu siç nuk kanë mundur që me lënë të lejuarën apo atë që e ka lejuar sheriati, as me na bind me u larguar nga ligji i sheriatit.

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: Përpos zekatit a ka obligime tjera të pasurisë?

Është përgjigj: ***Po***, dhe e ka lexuar ajetin Kur'anor: **"Dhe e jep pasurinë e tij për dashurinë e Tij(ndaj Allahut dhe për të mirën e tij)"**. ***(E ka përshkrua Darukutni)***

Një njeri e ka pyetur të Dërguarin s.a.v.s.: Unë ia kam dhënë nënës time sadaka një rob mirëpo nëna ka vdekur. Muhamedi a.s. i ka thënë: ***E ke për obligim zekatin, sepse tani ai rob është trashëguar te Ti.***

Ebu Dherri e ka pyet të Dërguarin s.a.v.s.: Si të jap sadaka atëherë kur nuk kam pasuri? Është përgjigj: Prej sadakasë është TEKBIRI, SUBHANALLAHI, ELHAMDULILAHI, dhe LA ILAHE IL-LALLAHU dhe ESTEGFIRULLAHI, po ashtu këshilla për punë të mira, ndalesa nga punët e këqija, me i larguar mbeturinat që i neveritin kalimtarët, si eshtrat, e gurët, po ashtu udhëzimi (ndihmesa) për të verbrin, sqarimi i çështjeve (ndihmesa) për memecët dhe shurdhët (me i ndihmua atyre që kanë aftësi të kufizuara). (I Dërguari i Allahut e ka folur të vërtetën)

Një grua e ka pyet të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.:

"Nëna ime ka vdekur, mirëpo unë për të kam dhënë një robëreshë sadaka?

Muhamedi a.s. iu është përgjigj: ***Ajo tani është paraardhëse prej së cilës ke trashëguar, për të cilën duhet dhënë sadaka. (E ka përshkruar Muslimi)***

RRUGA PËR NË SHOQËRINË ISLAME

Dëgjohen zëra të fuqishëm ku kërkojmë praktikimin e sheriatit që të jetë bazë e fortë e shoqërisë, sepse shoqëria islame është shembull tipik se si duhet të jetojnë pasuesit e tij, të lumtur, të zhvilluar e jo me jetë të vështirë ekonomike, kriza shpirtërore, sikurse në vendet tjera dhe shoqëritë tjera të cilat nuk e praktikojnë sheriatin i cili është rezultat i mos praktikimit të programit të Zotit të Lartmadhëruar i cili i ka vendos rregullat më mirë, bazat më të forta, dhe ligjet më të qëndrueshme për të përforcuar familjet në shoqëri. Të tjerët thonë se praktikimi i sheriatit islam u bën padrejtësi disave (apo tjerëve). Cili është mendimi i Shejh Shaëravit për këtë?

Imami i mirënjohur thotë: Angazhohu për islamin faktik edhe pse nuk praktikohet, sepse pas kësaj praktikohet islami në veten tënde. Nëse çdonjëri prej neve e praktikon islamin në vetvete, qeveritarit të cilët nuk e praktikojnë sheriatin do të rrëzoheshin vetvetiu, dhe sikurse qeveritarët do ta kuptonin se populli e do programin e Zotit dhe e parashohin zgjidhje për ta, ata edhe vet do ta praktikonin dhe për me iu afrua popullit do ta praktikonin programin e Allahut.

Shejh Shaëraviju mendon se qeveritarët në kohën bashkëkohore angazhohen me vendos ligje me të cilat populli pajtohet dhe sikur të dinin se populli e praktikon planprogramin e Allahut, qeveritarit do t'iu afroheshin popullit duke e praktiku planprogramin e Allahut sepse populli e praktikon sheriatin islam në ato çështje në të cilat qeveria nuk mund të ndërhyjë.

Detyra e jonë në jetë për të shkuar në drejtim të shoqërisë islame është në dy mënyra:

E para: Që të angazhohemi, të përpiqemi dhe ta praktikojmë sheriatin islam.

E dyta: Nëse nuk realizohet praktikimi i sheriatit islam, ne duhet ta paraqesim teorinë shkencore të sheriatit islam. Shkencën për ta paraqit besimin islam të pastërt, të vërtetën e Kur'anit dhe çka ka në të prej thesarit të pastër dhe të shtrenjtë dhe se Kur'ani nuk është fjalë njeriu, sepse në të ka thesare të fshehta, sekrete të panjohura, të paditura, të cilat ia tejkalojnë aftësisë së njeriut. Momentalisht aktiviteti dhe veprimtaria jonë është që islamin ta kemi besim dhe adhurim.

HAXHI DHE DOBITË E TIJ

Një lexues i cili kishte lexuar revistën "Livaul Islam" për pranimin apo mospranimin e Haxhit në shtëpinë e Allahut, deri sa gjendet apo shkon si punëtorë në vendet e shenjta të Hixhazit, pra duke lidh kontratë me ndonjë organizatë atje.

E vërteta është se në ditët e haxhit shumica shkojnë për punësim më vende tjera(në vendet e shenjta), shkuarja e tyre është për të kërkuar profit dhe furnizim, shumica e tyre e kryejnë haxhin, mirëpo në vetvete në shpirt e ndien se në esencë nuk ka shkuar për haxh, por për punë, mirëpo kryerja e haxhit në vend të dytë, a i pranohet haxhi apo jo?

Kur ia kam parashtruar këtë pyetje Shejh Muhamed Muteveli esh-Shaëravit: Ai vërtetoi se Haxhi është i plotë sepse shkuarja e tij në punësim sezonal nuk është në kundërshtim me pranimin (plotësimin e haxhit) sepse haxhi nuk plotësohet pa dobi dhe profite të shumëfishta.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: Për t'i realizuar (dhe për t'i prezantuar) profitet e tyre.

PËRFUNDIM DHE PËRKUSHTIM

Pasi e përfundova shkrimin e këtij libri, ia paraqita të nderuarit Imamit të mirënjohur Shejh Muhamed Muteveli Shaëravijut. Ai kërkoi nga unë që ta lexoj. Interesimi i tij në lëndën e librit e ishte shumë i madh ndërsa edhe unë dëshiroja të isha i përpiktë që t'ia lexoj në tërësi, që atë çka e ndiej obligim për të përhap idetë e këtij dijetari pse e ndjeja veten si djalë dhe nxënës i tij, në duar të tij për të ruajtur pastërtinë dhe thellësinë e mendimeve të tij në librin tim me lapsin tim të thjeshtë.

Pasi që të dy dëshironim dobinë e përgjithshme Islame dhe të muslimanëve ne kemi shpenzuar shumë kohë dhe mund për t'i harmonizuar mendimet apo afrimin e mendimeve kundërthënëse të çështjeve bashkëkohore si në besim i cili është thelbi i fesë, për të cilat disa janë neglizhent dhe indiferent, dhe disa tjerë bëhen dhe dëshirojnë të jenë neglizhent dhe indiferent.

Libri patjetër duhet të përfshinte çështje të reja dhe që rrahë

problematikën bashkëkohore. T'i sqaroj ato në frymën e sotshme, për të cilat disa dyshojnë, gjë që e cila na hamend neve me i paraqit apo jo. Ende në zemra ka njolla, hamendje dhe tronditje. Pjesa dërrmuese e çështjeve bashkëkohore sa i përket esencës së tyre ato janë statike, pra të palëvizshme dhe janë të pandryshuara, mirëpo sa i përket degëve të tyre ato mund të ndryshojnë, apo mund të kenë sqarime shtesë mirëpo prapëseprapë mendja e mprehtë dhe logjika e shëndoshë patjetër duhet të mbështetet në bazë e pastaj duke i përcjell degët e bazës i sqaron çështjet të cilat kanë të bëjnë me planprogramin e Allahut të Lartmadhëruar.

Rrushi a po rrushi i thatë nuk ka dyshim se është i lejuar hallall, mirëpo shtrydhja e tij dhe shndërrimi në alkool nuk ka dyshim se është i ndaluar, haram, e kjo është bazë për çdo degë të tillë.

Kështu është puna me ata të cilët lejojnë kartat kreditore investuese nga shkaku se ato janë pasuri dhe qarkulluese dhe qarkullojnë me jetën me zhvillimin e jetës. Atyre u kundërvihemi, kjo është se sipas mendimit tuaj harami duhet pasur arsyen, shkakun dhe urtësinë e ndalimit, por çka do të thoshit se urtësia e ndalimit nuk është kjo për çka po mendoni!?. Çështja e hallallit dhe haramit për të cilat dijetarët bazohen në formë të veçantë dhe pastaj vendosin dispozitën për atë çështje. Mirëpo, a e di ti se Imani çdo herë nuk është i ndërlidhur me shkaqe të dukshme apo të kapshme sipas shikimit të prizmit njerëzor. Kjo për arsye se vet Imani është shkak i çdo dispozite i cili burimin e ka nga Allahu, qoftë ajo veproje ose mos e vepro. Kjo është haram ose kjo është hallall, pa marr parasysh njeriu a e di atë shkak apo nuk e di.

O Zot! Të lutemi na falë për atë që kemi harruar ose kemi gabuar, na frymëzo dhe na ndihmo ta gjejmë të vërtetën, faqet e këtij libri bëni që të na zdrit neve me takimin tënd.

Përshëndetjet qofshin për zotërinë tonë, Muhamedin, për familjen e tij dhe gjithë shokëve të tij.

Dr. Sejid Xhemil Kajro, Xhumadel Ahire, 1401 H

Mars, 1981

FETAVATË E SHAËRAVIJUT

PJESA E DYTË

II

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

Kaçanik, 2015

HYRJE

Falënderimi dhe lavdërimi i takon Allahut, Zoti të gjithë botëve, përshëndetjet dhe selamet qofshin mbi Pejgamberin besnik, zotërinë tonë, Muhamedin s.a.v.s., familjen e tij, shokët e tij, tabiinëve, dhe të gjithë ata, të cilët i pasuan ata me sinqeritet deri në Ditën e Gjykimit. Nuk ka forcë e as fuqi të ndryshoj dikush diçka, pos Allahut, të Lartit, të Madhit.

Tregohet se, derisa imami Ebi Hanifete Nuëman mësonte studentët e tij, hyri në klasë një ateist dhe ia parashtroi tri pyetje filozofike, me të cilat pyetje janë marrë mendimtarë e filozofë të kohërave të kaluara, e edhe të sodit, dhe çështje të cilat vazhdimisht e nxisin mendjen e njeriut.

Pyetja e parë: Si ta adhuroj Allahun kur nuk e shoh?!

Pyetja e dytë: Si dhe pse të jap përgjegjësi për gjërat, të cilat veç m'i ka shkruar Allahu dhe unë jam i detyruar në veprimin e tyre?!

Pyetja e tretë: Si dënohen xhinët në zjarr, kurse ata janë të krijuar prej zjarrit?!

Si iu përgjigj Shejhu në këto tri pyetje? Ashtu siç e dimë dijetarët kanë aftësi të posaçme, mprehtësi të mendjes, shkathtësi të gjuhës, japin shpjegime të qarta, i përdorin metodologjitë e veçanta. Ai nuk iu përgjigj me përgjigje të zakonshme, mirëpo me shpejtësi në tri pyetjet iu ka përgjigjur me përgjigje praktike.

Imami mori një topth të fortë prej dheu, i cili ishte afër dhe i bie ateistit me një të rënë të fortë, e cila ia shpërtheu gjakun mbi lëkurën e fytyrës. Ateisti mendoi në vetvete, nëse e sulmon dijetarin, nuk do të ketë sukses, sepse nxënësit e tij në klasë do ta mbronin ose edhe do t'i ktheheshin në kundërsulm dhe do të vritej. Kështu e zgjodhi alternativën për ta paraqitur te gjykatësi. Gjykatësi me të shpejtë të dy i nxori në gjykatë dhe e pyeti shehun se pse e kishte sulmuar. Shejhu iu përgjigj: Kjo e rënë iu është përgjigjur në tri pyetjet, të cilat m'i ka parashtruar:

E para: Ankohet për dhembjen, të cilën nuk e sheh fare, atëherë pse të mos e adhuron Allahun edhe pse nuk e sheh.

E dyta: Kur i rashë me topth të dheut, ai ka pasur të drejtë të zgjedhë: të më ofendojë ose të më mëshon, ose të ankohet te gjykatësi. Mirëpo ai e ka ditur se po të më ofendonte ose sulmonte studentët do t'i kundërviheshin, po të më sulmonte studentët do ta mbytnin, prandaj e zgjodhi mënyrën tjetër për

t'u ankuar te gjykatësi. Ai është i vullnetshëm për disa çështje, ndërsa i detyruar, pa vullnetin e tij, në çështjet tjera.

E treta: Njeriu është i krijuar prej dheut të pjekur, e unë i rashë prej një topthi dheu i pjekur, i cili është lëndë bazë e krijimit të njeriut. E kështu xhinët dënohen me zjarr edhe pse janë të krijuar prej zjarrit.

Këto pyetje, të cilave iu është përgjigjur shejhu edhe sot i sillen vërdallë shumicës së njerëzve. Këto pyetje kalojnë nëpër kohëra të ndryshme gjeneratë pas gjenerate shekull pas shekulli, kalojnë prej një vendi në vend tjetër, pa hasur në përgjigje, e cila i kënaqë shpirtrat e tyre të shqetësuar dhe mendjet e tyre të luhatura dhe të turbullta. Nuk ka kryeneçësi më të madhe se kryeneçësia e mospranimit të arsyes, sepse ajo kryeneçësi asnjëherë nuk është stabile.

Në pjesën e parë të këtij libri i jemi përgjigjur shumicës së pyetjeve, shumë pika i kemi sqaruar për të qenë të vendosur në fenë e pastër dhe të natyrshmërisë, për t'iu përmbajtur obligimeve me argumente dhe arsye të shëndoshë dhe realitetit, e cila është shkalla më e lartë e moralit dhe karakterit të cilën e ka pastruar islami.

Kur u botua libri i parë i FETAVAVE mendjet dhe shpirtrat e njerëzve e pranuan me shpejtësi dhe libri aq shumë i tërhoqi, gjë që na ngrohi edhe neve, na qetësoi shpirtin dhe na bindi se e mira dhe dobishmja veç ekziston. Ashtu ka thënë edhe i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për këtë umet. E kjo veç tregon se në zemrat e muslimanëve veç ka filluar zgjimi islam, i cili është i bekuar dhe i sigurt në suksese dhe se vazhdimisht forcohet dhe është i interesuar për të ditur qëndrimin e ligjit të sheriatit dhe të fesë për të ditur këtë e atë.

Allahu ka caktuar që zemrat e njerëzve ta pranojnë dhe shumica e dijetarëve, fukahave dhe njerëzve të fesë kanë pasur dobi prej këtij libri, pasi që veç në të është shpenzuar angazhim i sinqertë vetëm për të fituar kënaqësinë e Allahut.

Për këtë na kanë ardhur shumë mirënjohje dhe falënderime, mirëpo ato falënderime e mirënjohje nuk janë të miat, por mirënjohja dhe falënderimi i takon vetëm Allahut, e pastaj imamit të nderuar Shejhut Muhamed Muteveli Shaëravijut, i cili na ka përkrahur, na ka ngrohur dhe është angazhuar maksimalisht për këtë libër.

Libraritë, Firma e Distribucionit ka kërkuar nga ne që të ribotojmë sa më shpejtë pjesën e parë dhe të botojmë pjesët tjera, për ta mbuluar tregun,

pasi që i tërë tirazhi ka kaluar në zemrat, shpirtrat dhe mendjet e lexuesve. Falënderojmë Allahun fillim e mbarim.

Pasi që ka vend për mirënjohje për të nderuarit, shfrytëzoj rastin t'i përshëndes ngrohtësisht dhe t'u shprehi mirënjohje edhe dijetarëve të njohur, të cilët i kanë dhënë mendimet e tyre nga dijetarët e universitetit të El Ez-herit. Nuk do të harroj t'i përshëndes edhe vëllezërit, kolegët e mi, mjekë dhe Profesorë Doktorë të universiteteve, gazetarët, të cilët më kanë ndihmuar dhe më kanë përkrahur vazhdimisht, deri sa e kam përgatitur dhe ka dalë në dritë ky libër, emrat e të cilëve nuk do t'i përmend se janë të shumtë.

Pikësynim kryesor kam pasur paraqitjen e shumë çështjeve dhe problemeve shumë të rëndësishme, të cilat janë të ndërlidhura me fenë tonë të pastër.

Unë nuk kam dëshirë të flas për gjërat, të cilat veç kanë folur të parët, përpos disa pjesëve dhe disa rasteve, edhe pse këtë e kanë kërkuar shumica e lexuesve, por dëshira ime e flaktë dhe interesimi im i madh ka qenë në ndriçimin e temave shoqërore bashkëkohore të reja, nëpërmjet sqarimit dhe mendimit të Shejhut Muhamed Muteveli Esh-Shaëravijut.

Ligjet janë të sqaruara ashtu qysh i ka definuar Ligjvënësi dhe ashtu siç janë pajtuar për ata ligje dijetarët e jurisprudencës Islame dhe ashtu qysh janë të përputhura me mendjen e pjekur dhe logjikën e shëndoshë. Ashtu siç më ka treguar njëri prej historianëve të mëdhenj Islam dhe më ka thënë: Shejh Shaëraviu ka ide mahnitëse dhe të mrekullueshme, ai shpalos velin e shumë çështjeve të rëndësishme. Pastaj nuk ka kurrfarë dyshimi se Shejh Shaëraviu është njeri i gjuhës së pastër dhe orator i çështjeve të mprehta në shkallën më të lartë.

Natyrshmëria e njeriut islam është se ka ndjenja të thella dhe vizion të qartë nëse lakon në mendime pa qëllim në ndonjë çështje prej çështjeve, atëherë të gjitha njësitë bashkohen dhe ta bëjnë me dije që kjo është jo e sigurt dhe t'i mbyllin dyert e mënjanimit apo lakimit.

Ende ka gjëra që mendja e njeriut nuk ka as qëndrim të prerë, e as devijues, por gjatë studimit dhe analizës vlerësohen në bazë të prioriteteve, sepse po të mos ishte kështu shkon jeta pa gjetur përgjigjen fare, apo pa hasur në përgjigje përfundimtare. Studimi dhe hulumtimi vazhdon, pandërprerë, por pa përgjigje të plotë e të sigurt, e cila të qetëson shpirtin, për shkak të mënyrave të ndryshme të të kuptuarit të cilat sillen rreth e rrotull mendjes.

Shejh Shaëraviu, na afron të kuptuarit e çështjeve, të cilat vështirë kuptohen, ai këtë e bën me metodologji të së kaluarës, por në formë të re të sqarimit, dhe me thellësi të të menduarit me metodologji të thjeshtë. Ai i tubon të gjitha elementet dhe pastaj i sqaron

ato të cilat njeriun e mundojnë dhe e luhatin, të cilat mendime njeriun vetëm e luhatin dhe nuk e shpijnë askund.

Një prej ideve, në të cilat mendja e njeriut lëkundet është çështja e besimit, gjë që shumica e atyre ideve shpijnë në idhujtari të fshehtë, Zoti na mbrojttë. Nga kjo pikënisje dhe nga kjo logjikë (Zoti e di, por unë e dëshmoj në veten time) ajo që më brengos dhe më mundon është që ky libër t'i forcojë mendjet dhe logjikën e shëndosh dhe t'i shpëtoj njerëzit nga sprovat, deri sa të stabilizohen dhe të shndrisin zemrat e tyre.

Po të mos ishin zemrat dhe mendjet, të cilat e njohin vlerën e etikës, në tokë nuk do të kishte njerëz, të cilët do ta kuptonin vlerën e të mirës. Nuk ka dyshim se e mira vjen vetëm prej shpirtrave të mirë.

Vullnetmirët dhe guximtarët nuk ndalen në rrugën e tyre drejt lumturisë, dhe drejtë rrugës, e cila siguron atmosferë për dituri dhe edukim, por përkundrazi çdo pengesë ata i bën që të jenë më të vendosur dhe më të lumtur drejt rrugës së tyre. Kush ka për qëllim të lavdërohet para njerëzve, atij puna i paralizohet, mjetet largohen, ylli i perëndon dhe fletët i teren. Po mos të ishin ndjenjat dhe brengat që këto çështje të akides, të cilat e vënë mendjen në dyshim të sqarohen dhe të zhvillohen, atëherë njerëzimi do të çrregullohej, jeta do të varfërohej nga shpirtçiltërsia dhe kjo gjithësi do të ishte e zbrazët, nuk do të ndërtohej dhe nuk do të kishte lulëzuar.

Shpirtrat e sëmurë dhe parazit gjithmonë janë dinak dhe mundohen t'i lajkatojnë shpirtrat e mirë, mirëpo fatmirësisht ata janë të dobët dhe në fund dalin humbës dhe të përbuzur. Atëherë si ngritet, si zhvillohet dhe si përhapet e forta? Isa a.s. ka thënë: "Kam shëruar leprosët, të shurdhët dhe të verbrit, e pas shërimit nuk kanë qenë mirënjohës ndaj meje, ndërsa kur i kam shëruar të çmendurit më kanë përkrahur".

Të këqijtë, të cilët nuk dëshirojnë të shpërndahet e mira në shpirtrat, gjithmonë janë dëshmitarë kundër vetes së tyre, ata dëshmojnë të vërtetën, sepse e vërteta patjetër triumfon, forcohet, e trupi prapëseprapë mbetet i shëndoshë, ndërsa ata të dobëtit prapë vazhdojnë të jetojnë me iluzionet e tyre të vjetra, të cilat pastaj i merr era.

Ata përgënjeshtrojnë Allahun si një plak i vetmuar.

Burrërori i bën punët haptazi dhe krenohet, e jo fshehurazi, sepse puna fshehurazi dhe pas shpine është cilësi e mendjelehtëve.

I urti ka thënë:

Kujdes! E keqja të kaplon kur të mençurin e nënçmon, e të mallkuarin e nderon, e mendjelehtin e respekton.

I urti gjithmonë fjalën e ka prej zemre, ndërsa mendjelehti zemrën e fsheh pas gjuhe.

Mjafton dënimi kur penguesi i zhvillimit të mendjes nuk mund t'ia arrijë qëllimit dhe nuk mund ta pengojë, sepse ata janë injorant, e injoranca te ta është natyrshmëri. Ndërsa të mençurit dhe intelektualët janë shpirti i ligjeve, bartës të fesë, dhe sqarues të ligjeve të Allahut, ata për punën dhe angazhimin e tyre shpërblehen, e shpërblimi i tyre është sa ngjyrë të lapsit që kanë hargjuar matet me gjakun e dëshmorëve.

Po të mos kishte qenë ngurtësia, nuk do të ishte kuptuar ngritja mendore, as toleranca, e as zemërgjerësia.

Fatkeqësisht kryeneçësia paraqitet, sepse njeriu në vetvete posedon dëshirën dhe epshin, e cila e kundërshton. Ah, sikur ky njeri të kishte qenë i pavullnetshëm në çdo çështje, dhe çdo lëvizje e aktivitet i tij të kishte qenë i imponuar, atëherë do të kishte qenë i liruar prej ngarkimit me obligime, i liruar prej vështirësive, nuk do ta kishte lodhur veten, nuk do ta kishte dobësuar trupin e tij në çështjet e vullnetshme, as në çështjet me të

drejtë seleksionimi, nuk do të kishin ndodhur trazirat e shkatërrimet, nuk do të ishte përhapur krimi dhe nuk do ta kishte përjetuar kënaqësinë e kësaj bote.

Ëmbëlsira e Imanit nuk shijohet pa vendosmëri, me labilitet e neglizhencë, por me bindje të thellë, besim të plotë dhe përmbajtës i projektit, i cili qetëson zemrën dhe zgjeron kraharorin.

Komentuesi dhe përpiluesi i këtij libri mirëpret çdo kritikë, qoftë përkrahëse, qoftë kundërshtuese. Fjalës së mirë nuk ia humb vlerën kundërshtimi, përderisa ajo fjalë ka qëllim të mirë, kompletimin apo qëllimin për të kompletuar, për të përsosur, për të sqaruar. Ndërsa përsosmëria absolute i takon vetëm Allahut fuqiplotë, e sa na përket neve, ne jemi vetëm kalimtarë. O Zoti ynë, nëse kemi qëllim të mirë në veprën tonë, Ti e di më së miri dhe shpërblimin e presim vetëm prej Teje, ndërsa nëse kemi harruar ose kemi gabuar diçka na fal. Largoje shejtanin nga ne dhe nga ajo që na ke dhënë prej të mirave të sinqeritetit. Për madhërinë dhe fisnikërinë Tënde,

bëna që të jesh i kënaqur me ne.

O Zoti im, bëje këtë libër që të jetë i dobishëm dhe me vlerë te Ti që të jetë prej veprave të mira. Fletët e këtij libri, regjistroji në regjistrat e veprave tona atë Ditë kur do të dalim para Teje. Shpërbleje Imamin, Shejhun dhe fetvadhënësin e këtij libri, të nderuarin tonë, Muhamed Muteveli Shaëravijin me të mira në këtë botë dhe në botën tjetër. Na bashko të gjithëve nën hijen e mëshirës Tënde.

O Zoti ynë, pranoje, vërtet Ti dëgjon dhe je i ditur. Përshëndetjet qofshin për zotërinë dhe ndërmjetësuesin për ne, Muhamedin s.a.v.s. dhe selamet qofshin për të sinqertit. Në fund falënderoj Allahun, Krijuesin e gjithësisë.

Kajro,
32 Rexhep, 1401.
27 Maj, 1981.

ASKUSH NUK POSEDON "BËHU" DHE "U BË"

Ia kemi parashtruar imamit te nderuar këtë pyetje: Ka dëgjua robi im kur i është thënë "bëhu" dhe është "bë". Cilat janë fushat që e bën robin e pa strehë të çiltër, të sinqertë për të cilat Allahu ka thënë "bëhu" dhe është "bë"?

Imami i mirënjohur fuqishëm dhe me bindje të plot sqaron:

Ajo çka krijon (prodhon) Allahu është planifikim absolut dhe urtësi e Zotit, ndërsa çka krijon njeriu mbetet e ngurtë dhe në suaza ashtu qysh e prodhon njeriu...

Njeriu e prodhon gotën mirëpo gota nuk zhvillohet, nuk martohet, nuk rritet, nuk prodhon (lind) gota tjera. Pra e prodhuara e njeriut mbetet në kufijtë të cilat e ka prodhua njeriu. Njeriu nuk posedon asgjë prej shpirtit, sepse shpirti është prej çështjes së Allahut.

Isa i përket prodhimit të Allahut, ajo riformohet, rritet, zhvillohet, lëviz, nuk ka kufij në prodhimet e Allahu i Lartmadhëruar. Krijesat e Allahut janë të pakufishme dhe ato krijohen me fjalën "bëhu" dhe bëhen.

Këtë mundësi nuk e posedon asnjë njeri (Bëhu dhe u bë).

Asnjë njeri nuk e posedon aftësin dhe fjalën e krijimit "Bëhu dhe menjëherë me u bë".

A JEP PËRGJEGJËSI NJERIU PËR MËKATIN, PËR SHKAK TË HARRESËS

Është transmetua nga Muhamedi a.s. se ka thënë: ***Umetit tim nuk i shkruhen mëkatet për shkak të lëshimit të gabuar, për shkak të harresës, dhe për shkak të detyrimit me dhunë.***

Pyetja është: Harresa mos është lehtësim për njeriun, që t'i falen mëkatet, me fjalë tjera a hiqet obligueshmëria e njeriut në ato momente dhe pranohet arsyetimi, pse ai veç ka harruar?

Imami i mirënjohur Shaëraviju përgjigjet:

Kur Allahu e ka ligjësua pendimin, dhe e ka hapur derën e pranim pendimit, ka dëshirua që njeriut t'i jep rast për arsyetim te gabimit për shkak te harresës. Arsyetimi i njeriut se ka gabuar, është arsyetimi i njeriut se ka bë

mëkat, mirëpo kjo nuk do të thotë se ai duhet me bë mëkat, e për këtë arsye është ligjësuar pendimi. E ka sqaruar se ai gëzohet më shumë se kur gëzohet njeriu i cili e ka pasur devenë e ngarkuar me të gjitha të mirat, dhe i ka humbur e pastaj e ka humbur shpresën se mund t'i gjej, e kur befasisht i vjen deveja atij njeriu, ai gëzohet. Sa i përket Allahut ai është shëmbëlltyra më e larta, kështu Ai gëzohet kur robi i Tij kthehet dhe e pranon gabimin e pendohet. Kjo është për tu siguruar paqja në jetë.

Imami i nderuar vazhdon e thotë:

Sa i përket fjalës "Harresë". Kjo ka qenë dashtë që Ademi mos me u dënuar, sepse Allahu urdhëron vetëm për çështje në të cilat kanë dobi, dhe ka qenë e ndaluar vetëm një çështje në të cilat kanë dobi, dhe ka ndalu vetëm një çështje, e ajo ka qenë pema e ndaluar. Pra ka qenë në mesin e shumë ndalesave e ka harruar. Kjo është një çështje se, pasi që e ka harruar një çështje, që të mos thuhet se Ademi ka qenë në mesin e shumë ndalesave e ka harruar.

Kjo është një çështje se, pasi që e ka harruar një çështje ai e ka harruare tërë obligueshmërinë, ka qenë dashur që Ademi mos me harruar atë urdhër i cili ka qenë tërë obligueshmëria.

Pastaj vazhdon Shaëraviju:

Ka të atille që thonë, se Ademi ka qenë pejgamber, ndërsa pejgamberët janë të mbrojtur, e pse ai me gabua, e për atë gabim me u dënua me zbritjen në tokë prej xhenetit.

Ne themi Ademi është baba i njerëzimit, njerëzit janë dy llojesh në pejgamber të cilët e përcjellin shpalljen e Zotit dhe në njerëz të cilët e dëgjojnë dhe e pranojnë shpalljen e Zotit, pejgamberët duhet me qenë të mbrojtur, sepse ata janë shëmbëlltyrë, e nuk duhet që shëmbëlltyra e tyre të jetë e keqe, mirëpo lloji i dytë janë të tjerët që prej atyre ka të shkëlqyeshëm dhe të padëgjueshëm. E Ademi është baba i të dy llojeve, pra duhet me qenë i sprovuar për ti përfaqësuar të dy llojet. Llojin e të mbrojturve siç janë pejgamberët dhe llojin e gabimtarëve siç janë njerëzit e rëndomtë.

Kur Ademi a.s. e ka ngrënë pemën, ka harruar, por a ka gabuar?

Iblisi kur e ka mashtruar, ka thënë: Allahu ta ka ndalu me ngrënë prej kësaj peme që të mos bëhesh prej të përjetshmëve, sepse nëse e hanë këtë pemë do të bëhesh i përjetshëm dhe nuk do të vdesësh. Kinse ai është i cili dëshiron me i tregu se Allahu është duke e tradhtuar: **"Nuk ju ka ndaluar nga kjo peme, vetëm e vetëm që të mos bëheni melek, dhe që te mos**

bëheni te përjetshëm."

Pra nëse nga ajo peme do të bëheni të përjetshëm dhe do të bëheni melek.

LUTJA E PRANUAR DHE E REFUZUAR

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **Lutmuni mua, ua pranoj lutjen.**

Po ashtu ka thënë: **Dhe nëse të pyesin robërit e mi për Mua, unë jam afër, i përgjigjem lutjes së lutësit kur më lutet.** Sadakallahul Adhim

Cila lutje është e pranuar? Cilët janë faktorët e pranimit, dhe cila është e pa pranuar, dhe pse shumica e njerëzve e lutin Zotin e tyre e ai nuk ua pranon, a do të thotë kjo se ata nuk janë të sinqertë, apo nuk i kanë plotësuar kushtet e pranimit.

Imami i mirënjohur Shejhu Muhamed Muteveli Shaëraviju na qetëson me përgjigje të bukur, na freskon gjoksin, na qetëson zemrat dhe na çliron mendjen duke thënë:

Disa njerëz i ngritin duart lart në qiell e luten por lutja nuk u pranohet, sepse Zoti i Lartmadhëruar i përgjigjet të mirës së robërve besimtarë. Ndonjëherë ose më mirë me thënë në shumicën e rasteve lutemi dhe kërkojmë atë që është e keqe dhe e dëmshme, edhe pse në shikim të parë dhe në pamjen e jashtme mendojmë se është e mirë, në të vërtetë do të na kishte shkatërruar, do të na kishte larguar nga Allahu dhe do të bëheshim arrogant ndërsa Allahu dëshiron të na ruaj dhe të na shpërblej në botën tjetër dhe të na jep më të mirën. E këtu veç është përgjigjja e lutjes dhe përputhshmëria e mëshirës se Zotit të Lartmadhëruar ndaj neve. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Dhe, ndoshta e urreni ndonjë çështje (gjë), por faktikisht ajo është dobi në ju." (EL-BEKARE, 216)

"Allahu e di e ju nuk e dini." (EN-NURË, 19)

Ndonjëherë ne duam diçka në të cilën gjë Allahu ka vendos të keqen dhe dëmin e madh.

Shejh Shaëraviju tregon me rregull retorike dhe sqaron:

Duhet ta dini një çështje. Dashuria për një gjë apo urrejtja për një gjë tjetër nuk është e dobishme për ne. Ndoshta unë dua të kem shumë pasuri,

mirëpo ajo pasuri më shpie në shkatërrim dhe në të keqe, ajo e keqe nuk është vetëm për në botën tjetër por edhe në këtë botë gjithashtu.

Këtë çështje Shejh Shaëraviju e sqaron duke thënë:

Në çdo apartman të bukur dhe në çdo pallat nuk ka jetë të lumtur, por përkundrazi ndoshta jeta më e palumtur është në ta.

Po cilit ia pranon Zoti lutjen?

Kjo është e qartë në Kur'anin fisnik në suretu "El-Enbija", ku pas pranimit të lutjes se pejgamberëve Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Vërtetë ata kanë shpejtuar (garuar) në punë të mira dhe na janë lutur neve me frikë e shpresë dhe kanë qenë tepër të dëgjueshëm ndaj nesh."**

Kusht i pranimit të duas (Lutjes) është shpejtimi (të bërit gara) në punë të mira, Zoti nuk ja pranon robit të keq i cili angazhohet në punë të këqija e ofendim sepse ai ashtu dëshiron me çrregullua sistemin e jetës.

Shpejtimi (të bërit gara) në punë të mira është pjesë e imanit dhe çështja më e rëndësishme pse? Sepse është imani (besimi) i shpërblimit në botën tjetër dhe me caktimin dhe fuqinë e Zotit të Lartmadhëruar kush shpejton në punë të mira i pranohet lutja.

SHIKIMI SHQISOR DHE SHIKIMI SHPIRTËROR

EL BESAR DHE BESIRË

Verbërimi i syrit fizik dhe verbërimi i syrit shpirtëror është sikur i verbëti dhe injoranti secila prej tyre ka kuptim të veçantë dhe sqaron diçka të veçantë.

Cili është mendimi i Shaëravijut në këto terminologji?

Imami i mirënjohur thotë:

Verbërim është verbërimi i syrit, ndërsa jovizionar është ai i cili sheh, por nuk sheh larg dhe fjala "jeamehun" do të thotë nguliten për toke. Sepse ngjitja për toke është si rezultat i ndaljes fizike në rrugë për shkak të verbërisë, ose ngulitja (ngjitja) për toke në çështje abstrakte si karakteri negativ dhe mospërfillja e programit jetësor pra jovizionar. Por më e

rëndësishmja është shikimi shpirtëror, sepse te shikimi shpirtëror, sytë nuk janë të verbët, por verbërohen zemrat të cilat janë në gjokse.

Kur njeriu nuk sheh me sy, mund ta shfrytëzojë shikimin e tjetrit kur të kërkoj ndihmë prej tij gjë që nuk ndodh kur njeriu e ka verbëruar zemrën. Zoti i Lartmadhëruar thotë: "JEAMEHUNË" që do të thotë nguliten, ngjiten për toke. Sa do që ti u tregon, çka do që tu thuash për gjërat që janë në kundërshtim me jetën ata nuk dëshirojnë me kuptua.

PSE ËSHTË E LEJUAR POLIGAMIA PËR MESHKUJT E JO PËR FEMRAT

Disa student të studimeve islame më kanë pyetur:

Pse është lejuar poligamia për meshkujt, e jo për femra?

Në bazë të statistikave në Amerikë dhe Evropë është e vërtetuar se përqindja më e madhe e përhapjes së kancerit në mitrat e femrave është te ata te cilët kanë fjet me shumë meshkuj, për shkak të grumbullimit të spermave të ndryshme në një vend (në organin seksual të femrës).

E kjo sikur të ishte ndëshkim në këtë botë, para ndëshkimit në botën tjetër.

Kur ia kam paraqitur këtë pyetje imamit të mirënjohur Shaëravijut na tha se te njëjtën përgjigje e ka dhënë kur është pyetur në Amerikë pastaj vazhdoj duke sqaruar:

Nuk mund të ketë poligami të meshkujve vetëm nëse ka tepricë të femrave. Të supozojmë po të ishte numri proporcional në mes të meshkujve dhe femrave, dhe unë dëshiroj t'i marr dy gra, a do të kisha gjetur. Natyrisht jo, nuk do të kisha mundur, pra derisa gjendet e dyta, e treta kjo do të thotë se ka më shumë se një.

Statistikat tregojnë se numri i meshkujve është më i vogël se i femrave, te të gjitha gjallesat numri i gjinisë femërore është më i madh se i meshkujve gjithmonë, meshkujve u ndodhin fatkeqësi si në fushën e veprimtarive dhe punës se tyre, ashtu edhe në luftëra.

Dhe derisa numri i femrave është më i madh se numri i meshkujve, atëherë ekzistojnë dy zgjidhje: ose dy femra me jetuar në një kurorëzim dhe të

jetojnë jetë të ndershme, ose përndryshe nuk hiqen ndjenjat e epshit të saj nëse jeton e shfrenuar ajo është më e dëmshme për të, dhe atëherë paraqitet shkatërrimi, dhe degjenerimi i shoqërisë.

Për këtë arsye sheriati e ka lejuar poligaminë e meshkujve për të mos ekzistuar ky lloj apo kjo fazë e jetës së vështirë në shoqëri, mirëpo për këtë ka parapa kështu. Përpos kësaj ka edhe raste kur sëmuret bashkëshortja e parë ose është sterile, të cilat janë të rëndomta në çdo shoqëri, për këtë arsye themi se feja islame është fe e natyrshmërisë së pastër, fe e jetës, dhe e arsyes e cila sundon gjithmonë.

DËNIMI I PAPËRCAKTUAR – TEAZIRI NË ISLAM

Kur Allahu vendos ligj ne themi: Edhe jobesimtarët përpos Allahut kanë vendos ligj për dënim, po ashtu edhe fetë tjera kanë vendosë ligj të dënimit, sepse ata kanë ditur se ndodhin krime, dhe patjetër krimin dhe kriminelët duhet ndëshkuar dhe eliminuar. Te ne është parimi: Nuk ka dënim pa krim, dhe nuk ka ligj pa krim. Askush nuk ka të drejtë ta dhunojë dhe të bën krim në dikënd, vetëm nëse thuhet se ai veprim apo ajo punë është krim, pra askush nuk mund të quhet kriminel i një vepre deri sa nuk ekziston ligji për atë vepër, dhe a e konsideron kryerjen e asaj vepre krim, e nëse nuk ka ligj ai nuk mund të ndëshkohet.

Ligjësimi i dënimeve prej Allahut, është ligjësim i cili buron drejtpërsëdrejti për shkak të krimit dhe i precizuar lloji i krimit. Ajo e cila është ligjësuar prej Allahut ose mundet me qenë dënim pa të drejtë faljeje (hudud) ose dënim me të drejt faljeje (kisas). Dënimet pa të drejt faljeje (hudud) janë dënimet të cilat i ka parapa Allahu dhe askush nuk ka të drejt në to, dhe askush nuk ka të drejt faljeje. Kisasi (dënimi i përcaktuar me të drejt faljeje) hakmarrja dënimi proporcional i cili është përcaktuar për vrasësin.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **Ne veç i kemi dhe kompetencë të plotë kujdestarit të të vrasin, dhe mos ta teprojë në vrasje (të hakmarrjes) sepse ai veç është i dënuar.**

Dënimet munden me qenë: ose dënime krimi pa të drejtë faljeje ose dënime kisasi me të drejtë faljeje. Sa i përket Kisasit ai ka të drejt me falë: “**Dhe kujt i falet diçka prej vëllait të tij”. (El Bekare, 178)**

Ndërsa dënimin të cilin e ka parapa Allahu, askush nuk ka të drejt me falë, ose mos me e ekzekutuar, as me e lehtësua.

Nëse për dënim të vjedhjes e cila është nën NISABIN, pra nëse vjedh më pak se 25 kurush dënimi i papërcaktuar (teaziri) në islam është i llojit ku gjykata ka të drejt faljeje që do të thotë ka të drejt me marrë vendim i cili nuk e arrin shkallën e dënimit të përcaktuar.

Teaziri është lloj dënimi të cilin e parasheh dhe e përcakton gjykata në veprimet kundërligjore të cilat nuk janë të përcaktuara (hudude). Dënimet janë parandalim i krimeve dhe i gabimeve, ndonjëherë mjafton qortimi, ndonjëherë izolimi, ndonjëherë tërheqja e vërejtjes. Ose ndonjëherë me i ra me shkop, kjo ndryshon, varësisht prej njeriut dhe formës se edukimit të cilin e meriton ai. Teaziri-dënimi i papërcaktuar ndryshon prej përsonit në person varësisht prej tyre.

Me një fjalë Teaziri është ndëshkim të cilin e parasheh gjykatësi suprem islam për një çështje (vepër) e cila nuk e ka arritur masën të cilën e parasheh islami në formë precize.

A SHPËRBLEHET NJERIU PËR MUNDIMET DHE VËSHTIRËSITË QË I PËRJETON NGA PROFESIONET (PUNIMET) E LEJUARA

Ka njerëz të cilët nuk kanë lumturi në jetë, jeta e tyre si shkak i punës së tyre është plot vështirësi e përplot mundime. Çfarë faji apo cili është mëkati i atij i cili pa dëshirën e tij jeton jetë të mundimshme si p.sh. Fëmiu i cili nuk ka një pjesë të trupit (si pankreasin) kështu që ai tërë jetën e tij duhet të marr infuzion, tërë jetën e tij prej fëmijërisë e deri në vdekje. Çfarë faji ka ai për të gjitha këto fatkeqësi dhe paaftësi, dhe këto që i ndodhin njeriut a janë çështje për të cilat Allahu do t'i shpërblej?

Imami i mirënjohur Muhamed Muteveli Shaëeaviju thotë: Zoti i Lartmadhëruar dëshiron të na tërheq vëmendjen se çdo gjë çka ndodh prej Allahut të Lartmadhëruar dhe nuk është prej çështjeve që ka të drejt zgjedhjeje për njeriun, ajo goditje për besimtarin është hajr. Kjo është e theksuar qartë në ajetin fisnik ku Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Thuaj: nuk na godet asgjë neve pos atë që e ka shënuar për ne."** pra Zoti i Lartmadhëruar

nuk ka thënë atë që e ka shënuar për shkak tonin. Fatkeqësia bie në dëm të njeriut e jo në dobi të tij, ndërsa fatmirësia bie në dobi të tij e jo në dëm të tij. Po ta kishte përdorur Zoti i Lartmadhëruar formën "mbi ne" (kundër nesh) atëherë do të kuptohej se çdo gjë çka ndodh është e dëmshme, por Zoti i Lartmadhëruar ka përdorë formën "për ne" pra është çështje që e ka llogaritë për ne. Kur Allahu dëshiron të na jep diçka, ndonjë herë ne me kandarin tonë e konsiderojmë se është e dëmshme, por në esencë ajo është e dobishme, pra ajo është për ne, e jo kundër nësh.

Anijen të cilën e ka shpërthyer robi i mirë e ka dëmtuar për ta mbrojtur dhe për ta siguruar mos me ra në dorën e kriminelit. Muri është ndërtuar, që popullatës së mallkuar të fshatit të mos i bjer në duar thesari i cili ka qenë pronë e dy fëmijëve jetim.

Lumturia në këtë botë është çështje e cila matet me kandarin e njeriut, mirëpo lumturia e vërtetë e botës tjetër është në fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar, dhe jep gjithçka posedon dhe mbetet duarthatë vetëm e vetëm për ta fituar lumturinë e vërtetë të cilën e ka përcaktuar Allahu i Lartmadhëruar për të.

AGJËRIMI I PASINQERTË

Agjërimi është prej ibadeteve më të rëndësishme, me të cilin ibadet Allahu e ka lartësuar njeriun, dhe e ka bë ibadet vetëm për Të dhe vetëm Ai shpërblen për të. Po ashtu dimë se agjërimi ka qenë obligim edhe për popujt e mëhershëm për të cilin Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"U është bë obligim agjërimi juve ashtu siç iu është bë obligim atyre".**

Kjo tregon qartë, dhe na bën me dije rëndësinë të cilën Zoti i Lartmadhëruar i ka dhënë këtij ibadeti. Për këtë arsye këtë ibadet duhet ta kryejmë pastër si loti, dhe me qenë plotësisht vetëm për Allahun, si çështje e domosdoshme, dhe me rëndësi të posaçme.

Por si mund ta dijë besimtari se agjërimi i tij është i sinqertë dhe si mund ta dijë se agjërimi i tij është i pasinqertë.

Imami i mirënjohur Shaëraviju thotë:

Urtësia dhe arsyeja e çdo vepre obligative është për atë i cili beson në

atë obligim dhe duke e ditur pse është obligim. Besimtari vepron kështu sepse Allahu e ka urdhëruа të veprojë kështu, ndërsa nuk vepron ashtu sepse Allahu e ka urdhëruar të mos veprojë ashtu. A mund ta dijë fëmija urtësinë dhe arsyen e përdorimit të ilaçit të idhët gjatë përdorimit për shërimin e sëmundjes së tij.

E vërteta është se mjeku i cili i ka dhënë recetën e ilaçit është ai i cili e di arsyen e atij ilaçi dhe reagimin e atij ilaçi.

Muslimani agjëron se Allahu ka thënë agjëro, për këtë arsye duhet pasur kujdes kur te sqarojmë urtësinë dhe shkakun e agjërimit pse ai agjëron, sepse agjërimi është shkaku i shërimit të tij. Atij i themi: Agjërimi yt nuk është ibadet, dhe nuk buron prej imanit (besimit) mirëpo agjërimi yt është besim në shkakun e agjërimit tënd, e jo besimi në vet agjërimin. Pra esenciale te besimtari duhet me qenë që ta pranoj urdhrin, dhe nuk duhet ta vendosë, ta bazojë veprën e tij në atë shkak ashtu që urdhërimi i tij t jetë i sinqertë dhe agjërimi i tij t jetë thjesht agjërim i pastër vetëm për Allahun.

A KONSIDEROHET MOSFALËSI PABESIMTAR

Namazi është bazë e fesë dhe shtyllë kryesore e tij. Namazi është obliguar me argument të qartë, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë**: "... dhe faleni namazin, e jepeni zekatin"**. Mirëpo disa e kundërshtojnë dhe nuk e falin këtë detyrë obligative. Mirëpo pyetja jonë është: Lënësi i namazit a konsiderohet pabesimtarë?

Imami i nderuar Shejh Shaëraviju thotë:

Namazi është shtylla kryesore për çdo besimtar, i cili nuk tolerohet të lihet pa marrë parasysh kushtet, rrethanat dhe situatën. Nëse nuk mundet të falet në këmbë, falet ulur, nëse jo ulur atëherë shtrirë, nëse nuk mundet shtrirë me lëvizje trupore atëherë vetëm me shenja dhe lëvizje të syve, nëse nuk mundet me lëvizje të syve atëherë vetëm me mendje, por duke i menduar pjesët e namazit në kokën e tij.

Pra namazi është çështje e domosdoshme, prej së cilës besimtari asnjëherë nuk guxon të shkëputet prej tij, për këtë arsye edhe namazi është shtyllë e islamit.

Lënësi i namazit është dy llojesh:

Lloji i parë: ai i cili nuk e pranon namazin si obligim prej Zotit dhe kundërshton Allahun ai person është pabesimtar.

Lloji i dyte: Shmanget prej namazit për shkak të përtacisë mirëpo ai e beson se namazi është shtyllë kryesore dhe obligim i tij para Allahut. Të tillët i urdhërojmë për t'u falur dhe t'i falë ato namaze të cilat nuk i kanë falë me parë.

KUR LIROHET NJERIU NGA OBLIGIMET

E dimë se të gjitha shpalljet qiellore kanë zbritur me program të fortë, për t'i bërë të lumtur njerëzit dhe për t'i qetësuar zemrat e tyre dhe secili program në vete ka pas metodologjinë e shpresdhënies dhe kërcënimit, dhe secili program ka zbritë me obligime konstruktive dhe të pastra, dhe secili program ka zbritë me urdhra të cilat aftësia njerëzore ka mund me i përballu me i kryer dhe me i realizuar, sepse obligimet po të kishin qenë mbi aftësinë njerëzore Allahu nuk do t'i kishte urdhëruar me i kry. Mirëpo, kush është ai i cili vendos apo gjykon se këta obligime janë brenda kufijve dhe brenda aftësisë njerëzore. Ai është Krijuesi i gjithçkaje, sepse Ai është i Cili i di të fshehtat e trupit njerëzor dhe shpirtit të tij të cilit ia ka dhënë sepse Allahu i Lartmadhëruar është ai i cili i ka tubuar të gjitha elementet dhe komponentët në njeriun, ia ka bashkëngjitur të fshehtat dhe e ka konstruktuar në formën e bukur dhe për të qenë në rrugë të drejtë.

Asnjë program nuk ka ardhur pa obligime dhe asnjë obligim nuk ka ardhur për me dëmtuar njeriun, por për me i sjell lumturi njeriut, rregullimin e shoqërive, sjelljen e të mirave dhe qetësimin e shpirtrave.

Parashtrohet pyetja: Kur lirohet njeriu nga obligimet? Imami i nderuar Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Obligimi që në fillim e ka të drejtën e zgjedhjes dhe njeriu e ka mundësinë me veprua dhe mundësinë mos me veprua.

Për këtë arsye i detyruari me dhunë është liruar prej obligimeve, i çmenduri ose mendjelehti, ose fëmija para se të arrijë moshën e pjekurisë.

Pastaj imami i mirënjohur vazhdon:

Nuk ka obligim pa arritur pjekurinë dhe shkallën e mendjepjekurisë ose pa i arritur vetëdija të çmendurit. Sepse ligji i "zgjedhjes dhe lirisë" nuk ekziston te jo të pjekurit.

Sfera e obligimeve duhet të jetë në çështjet e të drejtës për zgjedhje, sepse në çështjet në të cilat nuk ka të drejtë zgjedhjeje nuk ka obligim, sepse njeriu nuk merr pjesë në ato çështje. Pastaj imami Shejh Shaëraviju thotë:

Të gjitha shkatërrimet në tokë ndodhin për shkak të çështjeve për të cilat njeriu ka të drejt zgjedhjeje dhe për të cilat njeriu ka marr obligim me veprua, dhe ka urdhër për të mos vepruar, dhe vetëm këto çështje janë burim dhe bazament i çdo kryeneçësie, çdo shkatërrimi dhe çdo zbrazëtie ndërsa për çështjet për të cilat nuk ka qasje njeriu nuk ka kompetence njeriu janë të ndërlidhura dhe harmonike dhe janë të natyrshme. Shkatërrimi dhe zbrazëtia ndeshet atëherë kur njeriu i kundërshton dhe ndërhyn në çështjet natyrore.

CILAT JANË TË MIRAT E XHUMASË

Cila është vlera e ditës së xhumasë?

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: O i Dërguari i Allahut, na trego për ditën e xhumasë dhe të mirat në të.

Është përgjigjur: ***Pesë çështje: në këtë ditë është krijuar Ademi, në këtë ditë ka zbritur në tokë, në këtë ditë e ka caktuar Allahu që Ademi me vdekë, në të është një çast (moment) që nëse robi i Allahut e lut Allahun ia pranon lutjen, nëse nuk lutet për mëkat ose për ndërprerje të lidhjeve farefisnore, në të do të bëhet Dita e Kijametit. Nuk ka asnjë melek i afërt, as qielli as toka, as kodrat, as gurët e që nuk kanë druajtje ose frikë për Ditën e Kijametit. (E ka regjistruar Ahmedi dhe Shafiju).***

IHRAMI I FEMRËS

Pyetje: Cili është ihrami i femrës në haxh?

Përgjigjja: Veshja e rëndomtë e femrës është vetë ihrami i saj.

MUSLIMANËT DHE KRISHTERËT

Cila është largësia mes muslimanëve dhe të krishterëve?

Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Islami i ka pranuar pasuesit e librit prej krishterëve i ka pranuar me nderë dhe tolerancë. I ka pranuar që të jetoj ma ta në paqe, dhe siguri. Islami e ka nderu dhe e ka ngrit në shkallë të lartë Isaun birin e Merjemes. Islami nuk e pranon dhe refuzon çdo gjë e cila e nënçmon dhe akuzon, apo shpif për Isaun.

Islami e nderon krishterimin, dhe këtë për arsye thjesht për tu bashkuar qielli me tokën.

Për këtë arsye Persianët janë më të largët sepse ata përfaqësojnë idhujtarinë dhe ateizmin.

Romakët të cilët përfaqësonin pasuesit e librit kanë qenë me afër zemrës së Muhamedit a.s. dhe besimtarëve të cilët e besonin të Dërguarin e Allahut, kjo nga shkaku se Romakët kanë qenë pasues të librit.

Kur ishin në luftë mes veti romakët dhe persianët, dhe persianët fituan kundër romakëve Muhamedi a.s. është pikëlluar shumë, e me të janë pikëlluar edhe muslimanët të cilët besonin në të Dërguarin e Allahut.

Kjo sepse takimi i qiellit me tokën dhe nënshtrimi i tokës programit qiellor është çështje praktike dhe harmonike. Për këtë arsye zemra e të Dërguarit të Allahut dhe besimtarëve të tij ka qenë në anën e romakëve kur persianët fituan kundër tyre.

Islami dhe i Dërguari i islamit i ka dashur ata të cilët nuk e kanë besuar Muhamedin a.s. si pejgamber por kanë besuar në Zotin, më shumë se ata të cilët nuk besuar në Zotin fare. Pra, lidhshmëria e Muhamedit a.s. me Zotin e tij ka qenë më e fuqishme se lidhshmëria me veten e tij, për këtë arsye pejgamberi dhe muslimanët janë pikëlluar për disfatën e romakëve.

Zoti i Lartmadhëruar në Kur'anin fisnik thotë:

"Elif, Lam, Mim. Bizantinët (rumët) u mundën, në tokën më afër (tokës së arabëve), po pas disfatës së tyre, ata do të ngadhënjejnë, brenda pak viteve. Çështja është vendim i All-llahut, fillim e mbarim (për disfatë dhe për fitore). E atë ditë (kur do të fitojnë bizantinët) besimtarët do të gëzohen". (Rum 1, 2, 3)

Në këtë rast është mirë të ceket një ndodhi tjetër:

Një krishter fanatik ka hy te Shejh Muhamed Abduhu dhe e ka pyetur: si e ka përjetuar Ajshja kur është shpif për të në Medinë për prostitucion?

Muhamed Abduhu me shpejtësi i është përgjigjur:

Fytyra e saj ka qenë ngjashëm, si fytyra e Merjemes kur ka ardhur me fëmijën e saj para popullit të saj.

NUK KA DHUNË NË FE

Askush nuk mundet që zemrën e njeriut me detyruar me dashur.
Askush nuk mundet me urdhërua dikë tjetër: Më duaj.
Pra nuk ka dhunë në besim.

Nga ky parim i nderuari Shejh Shaëraviju plotëson me ajetin Kur'anor:

"A mos vallë (o Muhamed) do ta mbytësh veten, ngaqë ata nuk duan të besojnë. Sikur të donim Ne, do të zbritnim nga qielli një shenjë, para së cilës ata do të përulnin kokat". (Esh-Shuaraë, 3-4)

Pastaj sqaron:

Ti je i lirë të besosh e të mos besosh, mirëpo nëse ti beson patjetër duhet t'i përmbahesh urdhrave të atij të cilit i beson pa hyrë në detaje, se përndryshe ti ke kaluar prej besimit. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Nuk ka dhunë në fe. Vërtet rruga e drejtë është e qartë dhe thellësisht dallohet nga rruga e gabuar. Kushdo që mohon shejtanin (Tagutin) dhe beson në Allahun, ai është kapur për mbajtësin e fortë, të sigurt që nuk thyhet kurrë. Allahu dëgjon dhe është i ditur (për gjithçka)". (El-Bekare, 256)

Askush nuk mundet ta detyroj dikë me hy në fe sepse programi i të vërtetës është i qartë, dhe programi i të pavërtetës është i qartë.

PUTHJA E AGJËRUESIT

Umer Bin Selmete e ka pyet të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: A lejohet me e puth bashkëshorten agjërueshëm?

Ume Selmete i ka tregu se Muhamedi a.s. e bënë atë (puthjen) edhe kur është agjërueshëm.

Umer Bin Selmete pastaj i thotë t Dërguarit te Allahut s.a.v.s.: o i Dërguari i Allahut, Allahu t'i ka fale mëkatet e kaluara dhe mëkatet e ardhshme.

Muhamedi a.s. i thotë: Po, unë jam më i devotshmi dhe më së shumti i frikohem Allahut.

Muslimi dhe Ahmedi në koleksionet e tyre kanë regjistruar hadithin se një djalosh e ka pyet të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: A të puthi bashkëshorten kur të jem agjërueshëm? Muhamedi a.s. i thotë:***"JO"***.

Një plak e ka pyet të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: A te puthi bashkëshorten kur të jem agjërueshëm? Muhamedi a.s. i thotë: ***"PO",*** pastaj Muhamedi a.s. ka tregu: ***Plaku është në gjendje me frenu epshin e tij.***

Kontakti seksual i agjëruesit me bashkëshorten e tij

Një njeri i ka thënë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. jam shkatërruar, sepse kam kontaktuar seksualisht me bashkëshorten time deri sa kam qenë agjërueshëm.

Muhamedi a.s. i ka thënë: A ke rob me lirua:

- ***JO***
- ***A mund t'i ushqesh 60 të varfër***
- ***JO***
- ***Muhamedi a.s. i thotë: Ulu dhe rri këtu.***

Deri sa ishim në atë vend kur Muhamedi a.s. ka ardhur me një kusi (furek) me hurma dhe tha ku është pyetësi?

Pyetësi lajmërohet dhe thotë: Ja ku jam.

Merri këto hurma dhe jepi sadaka.

Ai njeri thotë pse a ka ndonjë i cili është më i varfer se unë. Për Zotin familja ime është më e varfër se çdo familje tjetër.

Muhamedi a.s. qeshi në atë masë sa që iu dukën dhëmballët e tij,

pastaj i thotë: Ushqeji me këto familjen tënde. (Mutefikun Alejhi)

KUSH VDES DHE KA VAXHIB AGJËRIMIN E PËRBETIMIT

Një grua i thotë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: Ka vdekur nëna ime, ndërsa ajo e ka pas vaxhib me agjëruar agjërimin e përbetimit.

Muhamedi a.s. i thotë: Çka mendon, po të kishte pasur nëna jote ndonjë borxh, a do t'ia kishe kryer.

Ajo i thotë: PO

Atëherë, agjëro për nënën tënde. (Mutefikun Alejhi)

Tranmeton Davudi se një grua ka hipur në anije dhe është përbetuar: Për Zotin, nëse Zoti e shpëton (prej rrezikut te detit) do të agjëroj një muaj. Pasi që Allahu e ka shpëtuar ajo nuk e ka agjëruar atë muaj derisa ka vdekur. Pastaj vajza e saj, apo motra e saj shkojnë te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe i tregojnë rastin e saj. Ndërsa Muhamedi a.s. i ka urdhërua me agjëruar për të.

AGJËRIMI VULLNETAR

Transmeton Ahmedi se Hajsa e ka pyet të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: Unë dhe Ajshja kemi filluar të agjërojmë agjërim vullnetar, mirëpo kur na është dhuruar ushqim e kemi prishur agjërimin si të veprojmë?

Muhamedi a.s. u thotë: Agjëroni kada një ditë tjetër. (E ka regjistruar Ahmedi)

Kjo nuk është në kundërshtim me: Agjëruesi, vullnetar është udhëheqës i vetes se tij Pse agjërimi kada është më i vlefshëm.

KUSH HA DHE PI ME HARRESË NË RAMAZAN

Një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: ***"O i Dërguar i Allahut, kam ngrënë dhe kam pirë ujë me harresë deri sa kam qenë agjërueshëm. Muhamedi a.s. i ka thënë: Të ka ushqyer Allahu, dhe të ka dhënë me pi ujë Allahu." (E ka regjistruar Ebu Davudi)***

Në koleksionin e Davudit me Ismadit Sahih teksti i hadithit është: ***...plotësoje agjërimin tënd, sepse Allahu të ka ushqyer dhe të ka dhënë ujë me pi, e nuk ke nevojë me plotësuar këtë ditë***. Kjo ka qenë dita e parë e Ramazanit.

Derisa një grua ka qenë me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. e cila duke ngrënë e ka ndërprerë ushqimin, e Muhamedi a.s. i thotë: Çka ke? Ajo i thotë: Kam qenë agjërueshëm dhe kam harruar. Një njeri aty pranë i thotë: Po tani pasi që je ngopur? Muhamedi a.s. i thotë vazhdoje dhe plotësoje agjërimin, se kjo është furnizim me të cilin të ka ushqyer Allahu. (E ka regjistruar Ahmedi)

XHAMI E PARË E NDËRTUAR PËR NJERËZIT

Pyetje: cila është xhamia e parë e ndërtuar për njerëzit në fytyrën e tokës?

Përgjigjja: Ebu Dharri e ka pyet të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. për "Mesxhidi Haramin".

Muhamedi a.s. i ka thënë: ***"Nuk ka dyshim se shtëpia (xhamia) e parë e ndërtuar dhe e vendosur për njerëzit është ajo në Meke (Beke) e cila është e bekuar."***

A FLENË BANORËT E XHENETIT

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. : A flenë banorët e xhenetit? Është përgjigjur: ***Gjumi është vëlla i vdekjes, e banorët e xhenetit nuk flenë.***

NUK PAKËSOHET PASURIA DUKE DHËNË SADAKA

Pyetje: i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë:
"Nuk pakësohet pasuria duke dhenë sadaka." Si është e mundur kjo?

Përgjigjja:Ashtu shtohet uji i bunarit sa më shumë të thellosh bunarin dhe të marrësh ujë aq më shumë i shtohet burimi dhe rritet uji.

GRUAJA MUSLIMANE UDHËTARE

Gruaja muslimane e devotshme e cila i përmbahet rregullave islame, mirëpo ajo del në qytet, udhëton e lirë. Si është puna me të?

Shejh Shaëraviju thotë:

Femra e cila thotë se feja e ka mbyllur në rroba, në bukurinë e saj, në jetën e saj duhet ta dijë mirë se feja ka dashur që të besoj se në pleqërinë e saj, kur t'i arrij vitet në të cilat i ndërpritet menstruacioni përfundimisht, në fillim të atyre viteve i ndodh trauma e parë, në ato vite fillon të vyshket bukuria e saj, e prej atyre viteve ka nevojë për ledhatimin e burrit të saj, afrinë e tij, mirësinë e tij, ngrohtësinë e tij, sepse atëherë ajo është e dobët dhe e vetmuar, e cila kujtohet shumë për situatën faktike të dhimbshme të saj, sepse ajo tashme nuk mund t'ia plotësojë dëshirat e burrit të saj.

Femra duhet ta dijë se islami seriozisht ka dashur që ajo të besojë në pleqërinë e saj, në dobësinë e saj dhe ka dashur që atë ta siguroj dhe ta shpëtojë.

Femra duhet ta dijë se nuk do të jetë e bukur përgjithmonë dhe nuk do të jetë në formë gjithmonë.

Në moment kur t'i zbehet bukuria, dhe fillojnë vitet e pleqërisë, ajo nuk mund t'i plotësojë ndjenjat e burrit të saj e kur të del në rrugë dhe sheh një vajzë tjetër në moshën e rinisë, me të gjitha stolitë, me gjithë manëkerin fillojnë epshet e burrit me bë krahasim në mes të asaj çka sheh në rrugë dhe asaj që sheh në shtëpi, atëherë fillon me u brengos, me u pikëlluar për atë çka ka në shtëpi. Në besojmë se asnjë grua nuk do ta gëzonte një krahasim i tillë.

Shikimi i burrit në bukurinë kalimtare në rrugë ndikon në zbehjen e

dashurisë në mes të burrit dhe gruas, me fjalë tjera shpie në shkatërrimin e familjes, po mos ta shihte në rrugë nuk do t'i ndizeshin ndjenjat, nuk do t'i ngritej epshi. Nga këtu shkatërrohet jetesa bashkëshortore, përçahet familja dhe humbet simpatia në mes tyre.

Oj vajzë, ta dish se ai i cili të ndalon ty të dalësh pa mbulesë të ka ndaluar për të mirën tende. Ai të ndalon për të të mbrojtur dhe për të të siguruar ty.

Shejh Shaëraviju thotë:

Sa më shumë që femra është e ndershme dhe nuk tradhton aq më shumë meshkujt interesohen për të dhe sa më shumë që burrat dëshirojnë me pa femrën e zbuluar largohen dhe neveriten prej saj.

Sa më shumë që të anojnë epshet e njeriut Allahu e ultëson botën tjetër të tij në këtë botë, që secili prej tyre me u largu dhe me e nënçmuar tjetrin. Ai i cili ka dashur që të arrij ta shohë së paku njëherë një vajzë kur ta sheh atë, ajo e pështynë në fytyrë.

CILËT I URREN ALLAHU

Pyetje: Cilët i urren Allahu?

Përgjigjja: Hadithi Kudsij i tregon kategoritë e atyre të cilët i do Allahu dhe ata të cilët i urren?

Tri kategori të njerëzve i dua, por tri tjera edhe më shumë.
E dua pasanikun fisnik, por të varfrin fisnik edhe më shumë;
E dua të varfrin modest, por pasanikun modest edhe më shumë;
E dua plakun e devotshëm, por të riun e devotshëm edhe më shumë.
Ndërsa i urrej tri kategori të njerëzve, por tri tjera edhe më shumë:
E urrej pasanikun kryelartë, por të varfrin kryelartë edhe më shumë;
E urrej të varfrin koprrac, por të pasurin koprrac edhe më shumë;
E urrej të riun mëkatar, por plakun mëkatar edhe më shumë.

Shejh Shaëraviju e parasheh se shoqëri shembullore është ajo shoqëri e cila i ka të varfrit fisnikë, të pasurit modest, dhe të rinjtë e dëgjueshëm dhe të devotshëm.

Ndërsa shoqëria e keqe është ajo shoqëri e cila ka të varfrit kryelartë, të pasurit koprracë dhe pleqtë të pa moralshëm dhe mëkatarë.

DHE AI (ALLAHU) E KA SHKATËRRUAR POPULLIN AD TË HERSHËM (TË PARË)

Pyetje: Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"dhe, vërtetë ai (Allahu) ka shkatërruar popullin AD të parë."**

Çfarë domethënie ka fjala "të parë", dhe a ka pas popull Ad te dytë?

Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Ndonjëherë fjala "të parë" ka domethënien e "mëhershme" dhe kur Zoti i Lartmadhëruar thotë se e ka shkatërruar popullin Ad të parë ka për qëllim popullin Ad të mëhershëm e jo popullin Ad të dytë ose të tretë.

A DËNOHET KRIMINELI MENJËHERË NË KËTË BOTË

Shumica pyesin:

A e vonon Allahu dënimin e kësaj për në botën tjetër apo krimineli për disa krime a dënohet menjëherë në këtë botë?

I nderuari Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Allahu i Lartmadhëruar shumicën e çështjeve nuk i vonon për në botën tjetër, sepse po të vonoheshin të gjitha çështjet (krimet) për në botën tjetër, atëherë pabesimtarët do të bënin shkatërrime të mëdha në tokë.

Po mos t'i dënonte Allahu ata të cilët nuk e zbatojnë planprogramin e Allahut në këtë botë, atëherë shumica e njerëzve do të dyshonin në planprogramin e Allahut.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

Dhe Në kështu, i zëvendësojmë dhe bëjmë që kriminelët të mbisundojnë mbi kriminelët për shkak të veprimtarive të tyre.

Dhe kështu, ata të cilët bëjnë shkatërrime në fytyrën e tokës, Allahu i bënë që ata të mbisundohen me kriminel po si ata, dhe nuk i bën që ata t'i

sundojnë të sinqertit sepse të ndershmit do të silleshin me ta me zemërbutësi, me lehtësi dhe me mëshirë. Por krimineli dënon kriminelin i cili e ka zhvesh veten e tij prej mirësisë dhe butësisë.

SHTYLLAT E ISLAMIT DHE ANGAZHIMI PËR JETË

Nënshtrimi i plotë i trupit dhe dorëzimi i plotë i shpirtit janë specifike e Islamit prej ku buron dhe reflektohet drita e zhvillimit dhe progresivitetit njerëzor.

Islami është fe dhe sistem, që në ta zhvillohet jeta. Cila është lidhja në mes të shtyllave të Islamit dhe aktivitetit jetësor?

Shejh Shaëraviju thotë:

Armiqtë e Islamit e identifikojnë Islamin vetëm me shtyllat e Islamit. Ata mundohen edhe pse kanë ra në grackë që jetën ta organizojnë ose ta definojnë sipas apetiteve të tyre, dhe ashtu qysh nuk e ka definua Islami dhe çka thonë: "Xhamitë janë të hapura, le të falet aty kush dëshiron, dhe zekatin le ta jep kush të donë, dhe haxhin le ta kryej ai i cili ka mundësi ndërsa përpos këtyre tjetër send s'keni të drejtë".

Atyre të cilët dëshirojnë me identifikua Islamin vetëm me ibadet (adhurim) ne u themi Jo! Ju me këtë jeni duke thënë vetëm për shtyllat e Islamit ndërsa po i anashkaloni ajo çka ndërtohet në këto shtylla!

Ne fuqishëm dhe me zë të lartë u themi atyre: Islami ka ardhur me mbrojt dhe me sigurua jetën dhe qëllimi kryesor i muslimanit është që mbi shtyllat e Islamit me ndërtua jetën në përgjithësi.

A LEJOHET BASHKËPJESËMARRJA NË KURBAN

Deri sa ishin shtatë shokë me Muhamedin a.s. Ai i urdhëron që secili të jep nga një dirhem për ta blerë një deve kurbani. Ata i thonë: O i Dërguari i Allahut por po na del shtrenjtë (nga një dirhem). Pejgamberi s.a.v.s. u thotë atyre: ***Kurbani më i vlefshmi është më i shtrenjti, dhe i cili ka më së shumti mish***. Pastaj Muhamedi a.s. i ka marr për dore dhe i ka thënë ta kapen për dore dy nga dy dhe deri te i shtati i cili e ka marr kurbanin dhe e ka pre ndërsa që të gjithë kanë thirr "Allahu Ekber" me një zë. (E KA REGJISTRUAR AHMEDI)

Të gjithë këta janë konsiderua si një familje në një shtëpi të vetme ku lejohet një dele për atë familje sepse ato kanë qenë si një familje.

Një njeri e ka pyet të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.:

"Unë kam një kurban të madh (ID-HIJETUL) (ajo ka qenë lopë ose ka mund me qenë deve, disa fukaha (dijetarë) kanë thënë ka qenë deve), dhe kam nevojë për ta, kam ndjenjë të madhe për ta, dhe nuk po gjëj tjetër me ble.

Muhamedi a.s. i thotë që ta shes, dhe pastaj me ato mjetë t'i blejë shtat dele dhe t'i pret shtatë kurbana. (E KA REGJISTRUAR AHMEDI)

PËRPOS ZEKATIT A KA OBLIGIME TJERA TË PASURISË

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. "Përpos Zekatit e ka obligime tjera për pasuri? E ai është përgjigj: Po, dhe e ka lexua ajetin Kur'anor: **"Dhe jep prej pasurisë me dëshirën dhe dashurinë e tij (për të dhënë)".** E KA REGJISTRUAR DARUKUTNI

Po ashtu, një grua e ka pyet të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. "Unë kam stoli, ndërsa burri im është i varfër, po ashtu edhe një djalë të vëllait. A më lejohet që të ndaj në pjesë të pasurisë së stolisë për ta?

Muhamedi a.s. iu është përgjigj: Po.

ISLAMI, IMANI DHE IHSANI

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për Islamin ka thënë:

Me dëshmua se nuk ka Zot tjetër pos Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij. Falja e namazit, dhënia e Zekatit, agjërimi i ramazanit dhe kryerja e haxhit.

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për Imanin ka thënë:

"Të besosh në Allahun", "në Melekët e Tij", "në të Dërguarin e Tij", "në ditën e fundit (ditën e kiametit) dhe "në përcaktimin preciz të Allahut në çdo gjë (Kadanë dhe Kaderin)".

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për Ihsanin, ka thënë:

"Që ta adhurosh Allahun sikurse e sheh, se nëse ti nuk e sheh Ai të sheh". SADEKA RESULULLAH

KUSH ZGJOHET XHUNUB AGJËRUESHËM

Kush zgjohet xhunub agjërueshëm, a i është prishur agjërimi?

Përgjigjja: Asgjë nuk është me u zgjua xhunub agjërueshëm, Muhamedi a.s. në hadithin Sahihë ka thënë:

"Tre personave lapsi nuk ua regjistron veprat, e ata janë: I çmenduri deri sa të vetëdijësohet, ai i cili është në gjumë deri sa të zgjohet, dhe familja deri sa të arrijë pjekurinë." (MUTEFIKUN ALEJHI)

NDJENJAT E BRENDSHME DHE AGJËRIMI

Agjërimi i ngjall ndjenjat e brendshme, pastron lukthin, lehtëson trupin nga elementet e tepërta, zvogëlon yndyrën, heq yndyrën. Muhamedi a.s. në hadith Sahihë ka thënë: ***"Agjëroni shëroheni"***.

Agjërimi lehtëson ngarkimin e veshkëzave, zvogëlon sasinë e sheqerit dhe lehtëson ngarkimin e mëlçisë.

PSE NUK KA QENË VETËM MIËRAXHI

Pyetje: Pse ka qenë edhe Israi edhe Miëraxhi, e jo vetëm Miëraxhi. Pra, Pse Allahu e ka bartë të Dërguarin e Tij për një kohë shumë të shkurtë nate prej Mesxhidi Haramit deri në Mesxhidi Aksa e pastaj e ka ngritë në qiell.

Pasi që iu është bërë kjo pyetje Shejh Shaëraviju është përgjigjur kështu:

Kjo është urtësi e cila dëshmon muëxhize. Për shkak se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka pas për detyrë me transmetua atë çka ka qenë i obliguar prej Zotit të Tij.

Allahu i Lartmadhëruar nuk e ka obligua me transmetua misionin e tij vetëm para një grupi të njerëzve, apo vetëm për umetin e tij, por e ka obligua edhe për umetin e tij edhe për të gjithë të tjerët. Duke u nisur nga kjo del qartë se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka qenë besnik për të transmetua atë çka e ka obligua Allahu. Pra për me qenë mjet për të tregu Allahu që ta njohin krijesat e Tij. Për këtë arsye Allahu i Lartmadhëruar ia ka mundësua më parë Isranë për ta besuar pastaj mundësinë e Miëraxhit.

Isra-ja është shenjë-argument tokësor pra udhëtim prej Mekës në Mesxhidi Aksa. Në atë kohë udhëtimi prej Meke në Mesxhidi Aksa nuk ka qenë çështje e pa imagjinueshme, por ka qenë udhëtim të cilën e kanë kaluara karvanët për disa ditë apo disa javë . . . Me rëndësi ka qenë që ta kaloj rrugën prej Mekes në Mesxhidi Aksa, pa marrë parasysh në çfarë mjeti. Pra Muëxhizja e Israsë është shkurtimi i largësisë (së kohës dhe gjatësisë). Pra ky ka qenë qëllimi i Israsë.

Për Allahun e Lartmadhëruar nuk janë të përkufizuar as koha as vendi! Për këtë arsye ia ka mundësua Isranë, pastaj e ka ngritë në qiell pastaj e ka kthyer në të njëjtën natë. Sa i përket Muëxhizes së kohës (afrimit, shpejtësinë e largësisë) njerëzit kanë fillua mos me i besu. Për këtë arsye ka kaluar në çështje tjetër duke iu tregua atyre për karvanët duke u kthyer në Meke, sendet dhe mallrat të cilat i ka pa te ta dhe sendet tjera të cilat i ka pa në tokë gjatë Israsë prej Mekes e deri në Mesxhidi Aksa dhe anasjelltas. Pastaj ua ka tregu formën dhe gjendjen e Mesxhidi Aksas. Pra u ka dhënë atyre fakte tokësore, të dukshme dhe të kapshme të Muëxhizes dhe ky ka qenë qëllimi . . .

Me një fjalë Israja është Muëxhize tokësore ndërsa Miëraxhi është

Muëxhize qiellore.

PSE ALLAHU I KA KRIJUAR SHEJTANËT

Allahu ka krijuar çdo gjë: I Lartmadhëruari ka krijuar tokën, qiejt, malet, sendet e ngurta, gjallesat, njeriun, Shejtanët. . .

Pasi që Shejtani është i krijuar, siç është krijuar njeriu, dhe ai është armik i tij, e pasi që Allahu ia do njeriut të mirën, atëherë pse Allahu i ka krijuar Shejtanët?

Cila është arsyeja e ekzistimit të Shejtanëve, dhe a është Shejtani me zbehë krijesën njeri?

Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë: Po të mos ishte dikush i cili të nxitë në mëkate, atëherë dëgjueshmëria do të kishte qenë çështje e rëndomtë, mirëpo madhështia e dëgjueshmërisë është atëherë kur ndonjëri vjen me të tërheq dhe me të mashtrua që me kundërshtua mirëpo ti i thua: Jo.

Pra ekzistimi i Shejtanëve është për tu vërtetuar ngrohtësia e kryerjes së obligimeve përball adhurimit të Allahut në diçka çka e ka krijuar Allahu. Po mos të ekzistonin Shejtanët atëherë dëgjueshmëria do të kishte qenë instiktive-retabetun, pra domethënia "retabetun"- instiktive. Çka do të thotë instiktive-retabetun? Ndoshta çdo njërit prej nesh as që do t'i shkonte mendja me ngrënë mishin e derrit, dhe me kalimin e kohës do të bëhej normale apo traditë dhe instinktivisht nuk do ta hante askush. Allahu dëshiron që ti atë ta bësh prej frikës së Tij dhe të jetë adhurim, jo për shkak të instiktit apo për shkak të veprimit të rëndomtë. Patjetër duhet me qenë dikush që të të nxitë ty në rrugën e humnerës dhe me të të pengu nga rruga e adhurimit.

Paraprakisht përkujto armiqësinë e Shejtanit (Ai është armiku yt dhe i bashkëshortes tënde), dhe mos lejoni që t'ju nxjerr juve nga xheneti. Pra kjo është forma e adhurimit edhe me të gjithë në deri në ditën e kiametit pra: Urdhëresa, ndalesa dhe kujdes prej Shejtanit i cili paraprakisht ka qenë dhe është armik i njeriut. Çka është kjo armiqësi?

Allahu u ka thënë Melekëve: Bëni sexhdet Ademit. Ata nuk i kanë bë sexhde Ademit, por i kanë bë respekt dhe kanë dëgjua urdhrin e Allahut për me i bë sexhde Ademit.

Mirëpo Iblisi ka kundërshtua me i bë sexhde Ademit, sepse sexhdeja (dëgjimi) i bëhet Allahut, mirëpo ka qenë i urdhëruar për sexhde vetëm prej Allahut. Mos sexhden e tij e ka arsyetua: A t'i bëj sexhde atij, të cilin e ke krijuar prej balte. Pastaj ka thënë: Unë jam më i mirë se ai, më ke krijuar prej zjarrit, ndërsa atë (Ademin) e ke krijuar prej balte. Pra kjo është ajo kryelartësia dhe arroganca dhe kundërshtimi i urdhrit të urdhërdhënësit të Lartmadhëruar, e nga ky shkak është dëbua nga mëshira e Allahut deri në ditën e ringjalljes.

Arsye e krijimit të Shejtanëve është e njëjta arsye e krijimit të njerëzve.

I nderuari Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë: Allahu ka dëshirua që të krijoj diçka prej sherrit që të ekzistoj në ekzistencë, por jo për tu përhapur dhe me dominua e keqja, por për tu sprovua njerëzit e me u largu prej tij.

Mesazhi i sherrit (të keqes) është që njerëzit ta pranojnë të mirën dhe nëpërmjet të njohjes së keqes me dominua e mira. Ne tek pas laboranteve frikohemi prej kolerës, dhe e zbulojmë virusin kundër kolerës apo antitruptha e kolerës, tifos etj. Pse i japin mikrob trupit me injeksion që ti kundërvihen? Pra po të mos ekzistonte e keqja në trupin tim nuk do të dominonte e mira.

SI NA KA KRIJUAR ALLAHU PREJ NJË SHPIRTI

Imami i nderuar Shejh Shaëraviju thotë:

Kjo çështje e cila preokupon mendjen, është çështje për të cilën jobesimtarët e humbur thonë çështje që qojnë në humbje edhe më të thellë: thonë çështje si p.sh. njëlloj është zhvilluar prej një llojit tjetër (si teoria e Darvinit për evolucionin). Thuaj se Allahu ka problem në krijimin e llojeve, ndërsa Zoti i Madhëruar ka thënë:

"Qoftë i Lartmadhëruar Allahu i cili ka krijuar çifte të çdo lloji ku prej tyre që mbinë në tokë (bota bimore) dhe në vet juve dhe në atë çka nuk e dini."

Kjo është e vërtetuar se i Lartmadhëruar çdo gjë ka krijuar çift pra prej mashkullit dhe femrës të cilat janë bazë e shtimit dhe ekzistencës së llojit.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"O ju njerëz frikohuni Zotit tuaj i Cili u ka krijuar juve prej një

shpirti dhe ka krijuar prej saj çiftin e saj, dhe prej tyre ka shtua meshkuj shumë, e po ashtu femra. Dhe frikohuni Allahut tek i cili do të jepni përgjigje për farefisni. Vërtet Allahu është mbikëqyrës dhe kontrollues mbi ju." (EN-NISA, 1)

Këtu Zoti i Lartmadhëruar na sqaron fillimin e fillimit të njeriut pra të Ademit a.s. dhe prej shpirtit të tij ka krijuar Havan, dhe prej atyre dyve pastaj është shtuar njerëzimi, meshkuj e femra.

NE IA KEMI PARASHTRUAR EMANETIN

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"Ne ia kemi parashtrua emanetin qiellzave, tokës dhe kodrave por ata nuk e pranuan obligimin, pse janë frikuar e pastaj (atë emanët) e mori përsipër njeriu. Vërtet ai (njeriu) është i padrejtë ndaj vetes dhe është i paditur."(El-Ahzab, 72)

Çka është dhe për cilin emanet bëhet fjalë?

I nderuari Shejh Shaëraviju thotë:

Fjala "Nuk pranuan" nuk tregon për mëkatimin e qiejve e të tokës dhe kodrave ndaj urdhrit të Allahut, sepse çështja nuk ka qenë ofertë obligative. Por oferta ka qenë ofertë e zgjedhjes së veprimit, për të vepruar ose për të mos vepruar. Ata nuk e pranuan ofertën, nuk do me thënë se e kanë kundërshtuar urdhrin e Allahut, pse nuk e kanë pranuar, sepse ka urdhër që mospranimi i tij nuk është në shkallën e mëkatit.

Çështja është se, sikurse paraqitet problemi në pranimin e çdo emaneti në jetë, e ai problem është se qielli, toka dhe malet janë frikësuar, dhe nuk i kanë besuar vetes së tyre në kryerjen e emanetit; janë frikësuar se do ta pranojnë e nuk do të jenë në gjendje me krye. E, çështja ka qenë se, që në fillim nuk kanë pas lirinë e zgjedhjes, andaj ato e kanë pranuar detyrën e moszgjedhjes së tyre, por çka t'iu urdhërohet me krye, e jo me zgjedh diçka me krye. Mirëpo njeriu e ka llogarit vetëm se mundet me pranua emanetin, mirëpo nuk e ka llogarit se mundet me i dalë në krye. Nuk ka llogarit në mashtrimet e jetës.

Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Vërtet ai u tregua injorant dhe i padrejtë ndaj vetes së tij. ”(El-Ahzab, 72)

Pra, i paditur në atë se, nëse e merr përgjegjësinë me krye a do të jetë në gjendje me krye, apo jo. E i padrejtë ndaj vetes së tij, sepse ai ka marr një barrë mbi vete të cilën nuk mund ta mbaj, vetëm se me vendosmëri, dhe atë me pasiguri në të, dhe sikurse Zoti i Lartmadhëruar donë të na thotë: Mos u mashtro me veten tënde, vetëm në pranim të emanetit (detyrës), por shiko veten tënde, a mund ta kryesh atë.

Për këtë arsye, Zoti i Lartmadhëruar kur flet në Kur’an për çështjen e borxhit, thotë: **“Dhe kur të merrni e jepni borxh për ndonjë afat të caktuar shkruajeni.”** Kur’ani pra nuk e mbron vetëm borxhdhënësin, por e mbron edhe borxhmarrësin gjithashtu. Sepse borxhmarrësi kur ta dijë se patjetër duhet me krye, ai e kryen dhe patjetër angazhohet e punon për me krye. Mirëpo nëse nuk e shënon, atëherë në momentin e caktuar nuk e kryen, e nëse borxhmarrësi shpëton, apo ia arrin qëllimit mos me krye borxhin, atëherë veprimtaria e kontratave dhe punët, marrëdhëniet dështojnë në tërësi.

Sipas mendimit të Shaëravijut emaneti është liri zgjedhjeje apo pranimi i emanetit është e drejtë zgjedhjeje dhe vendi i tij është mendja të cilën Zoti ia ka dhënë birit të Ademit (njeriut) për me e nderua atë.

ISLAMI DHE ZHVILLIMI (MODERNIZIMI)

Është pyetur për zhvillimin bashkëkohor dhe planprogramin apo projektin islam bashkëkohor. Dhe si është e mundur se Kur’ani përfshin njohuri, rregulla dhe ligje shumë e shumë të rëndësishme, me të cilat ia ka tejkaluar të gjitha kohërave?

Përgjigjja: Çdo sistem bashkëkohor dhe zhvillimor në botë ka kaluar në faza të përvojës dhe eksperiencës. Pra, e ka provuar në praktikë këtë metodë apo atë. Dhe kur ka arritur në shkallën më të lartë të zhvillimit, kur befasisht iu është afrua programit islam.

Imami i mirënjohur ka bërë një krahasim në mes të sistemeve shoqërore në botë dhe Islamit, ku është vërtetua se ata veç e kanë praktikuar Islamin, pra me fjalë të tjera kanë qenë në harmoni me Islamin dhe ajo ka ndikuar që ata janë zhvilluar vetëm pse e kanë praktikuar programin islam.

SI E URDHËRON SHEJTANI JOBESIMTARIN

Në e dimë se aktiviteti i Shejtanit është përqendruar gjithmonë në largimin e njerëzve prej programit të Allahut. Qëllimi kryesor i programit të Allahut është qetësia dhe lumturia e njeriut. A mundet Shejtani me ndikua në robin besimtarë?

I nderuari Shejh Shaëraviju thotë:

Projekti i Shejtanit është që me të pengua ty mos me bë asgjë për botën tënde tjetër, për këtë arsye ai ta hijeshon këtë botë me të mirat dhe kënaqësitë e kësaj bote, dhe tenton me ta harruar botën tjetër dhe të mirat e botës tjetër. Këtë e arrin apo e plotëson me lejen të cilën ia ka dhënë Allahu, ku Allahu thotë se Shejtani ka thënë: **Dhe me lejen tënde që ma ke dhënë do t'i mashtroj që të gjithë!** Por pastaj Shejtani prapë ka thënë **"përpos robërve tu të sinqertë ata kur nuk mund t'i mashtroj"**. Pra do t'i mashtroj krijesat tua, përveq atyre që Ti dëshiron dhe i ke veçua me i udhëzua, unë mbi ta kurrë nuk mundem të kem pushtet. Sepse fjala e Allahut është më e larta dhe askush nuk mund të qëndrojë para fuqisë dhe pushtetit të Allahut. Pra, ti o Zot e ke lënë çështjen e udhëzimit te disa prej njerëzve me zgjedhë, mirëpo atë që Ti dëshiron me udhëzua aty shejtani s'mund të depërtoj.

Nga këtu pushteti i Shejtanit mbi jobesimtarin është i vërtetuar, ndërsa Shejtani mbi besimtarin e sinqertë nuk ka pushtet.

KTHIMI NË PABESIM PA E DITUR

A mund të kthehet njeriu në pabesim pa e ditur? Për këtë çështje Shejh Shaëraviju thotë:

Nëse për diçka çka të ka urdhëruar Allahu, e ke në tavolinë por ti fillon me hulumtua dhe me studiua në imtësi, ta dish se ti je kthyer në fazën e parë të besimit (pabesim).

Ti je i lirë të besosh apo të mos besosh, mirëpo nëse beson në Allahun, dhe pranon çdo çështje që të ka urdhëruar Allahu pa kurrfarë diskutimi, dhe pa hy në detaje se për ndryshe ti je kthye në fillim (mosbesim). Kjo është thelbësore në çështjen e besimit.

Shejh Shaëraviju shton dhe thotë:

Allahu i Lartmadhëruar dëshiron që ne me pranu atë që na urdhëron me saktësi dhe dorëzim të plotë sepse ti paraprakisht veç i ke besuar Atij. Për këtë arsye kur Allahu i obligon robërit e tij me diçka nuk u thotë: po urdhëroj, apo po ju obligoj me këtë, por thotë: "O ju të cilët keni besuar ju është bë obligim", që donë të thotë: O ti i cili veç më ke besuar për Zot, të Ditur, të Urtë, të Fuqishëm Unë të obligoj për këtë.

KUSH JANË FASIKËT

Nëse ti e ndërprenë dhe nuk ndërlidhë atë çka ka urdhërua Allahu me ndërlidhë. Ti ke dal nga besimi në Allahun dhe je bë Fasik. Pse Zoti i Lartmadhëruar i ka gjykuar fasikët.

"Dhe ndërprenë atë çka Allahu ka urdhërua me ndërlidhë".

Në këtë bënë pjesë moskryerja e premtimeve. Pse kjo është ndërprerje çka ka urdhërua Allahu me ndërlidhë, pra ndërprerjen e lidhjes mes robit dhe Allahut dhe të Dërguarit të tij. Ndërlidhja mundet me qenë në mes të njeriut dhe tjerëve e kjo është ndërlidhja ndërnjerëzore. Transmetohet se Muaviju Bin Ebi Sufjanë ka qenë ulur dhe i thonë: "O emirë i besimtarëve në derë është një njëri i cili po thotë se është vëllai yt". Ai i thotë: Po si është e mundur që të jetë vëllai im e unë të mos e njoh. Lëreni të hyjë. Kur hynë një njëri, Muaviju e pyet: Çfarë vëllai im jeni ju? Ai i thotë: Vëllai yt për nga Ademi a.s. . Atëherë Muaviu ka thënë: Pra qenka ndërprerë ndërlidhja vëllazërore. Por për Zotin do të jem i pari i cili do të ndërlidhë dhe do ta mbaj të ndërlidhur gjithmonë, dhe ia ka krye nevojën atij.

Për këtë arsye Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: "Besimtari është vëlla e besimtarit". Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë: "Nuk ka dyshim se besimtarët janë vëllezër".

Për këtë arsye themi çdo gjë e cila shpie në ndërprerje të asaj çka ka urdhërua Allahu me ndërlidhë prej relacioneve ndër njerëzore dhe humane është dukuri prej dukurive të fasikut, dalje prej besimit (imanit). Dhe çdo gjë e cila shpie në ndërlidhje është prej besimit (Imanit).

Imami i mirënjohur thotë:

Si mundet me qenë Allahu me ty derisa ti e ndërprenë atë çka Allahu ka urdhërua me ndërlidhë.

RRUGA E TRASUAR E IBLISIT NË MËKATE

Rruga dhe mënyra e Iblisit për me shti njeriun në mëkatin është shumë i hershëm, e ajo është dobësia e njeriut dhe neglizhenca e njeriut në planprogramin e Allahut të Lartmadhëruar. Iblisi nuk mund ta nënshtrojë askënd pos njeriun me Iman (besim) të dobët, pra aty Shejtani gjen rrugën e përshtatshme, rrugën për të depërtua në trupin, mendjen dhe shpirtin e tij.

Pra cila është rruga të cilën e trason Shejtani për të depërtua në brendi të njerëzve.

Imami i mirënjohur Shejh Shaëraviju thotë:

Shejtani e tregon rrugën dhe kahjen në mëkatin kur thotë: **"Pastaj do t'iu shkoj atyre, para duarve, pas shpinë, nga ana e djathtë e tyre dhe nga ana e majtë".**

Pra Iblisi i shkon njeriut përpara duarve, pas shpinë, nga ana e djathtë dhe nga ana e majtë, mirëpo përpos këtyre 4 anëve nuk thuhet në ajet se i shkon njeriut nga lartësia mbi kokë dhe nga poshtë. Pse ai (Shejtani) e di mirë se lartësia është fuqia e Zotit, ndërsa nënsia (poshtë) është robëria (adhurimi) pra sexhdeja e njeriut. Dhe kur Shejtani nuk mund të jetojë në nivelin e lartësisë, nga vjen fuqia e Allahut e as nga niveli i nënsisë (pjesa e poshtme) nga i cili drejtim bëhet sexhdeja dhe nënshtrim ndaj Krijuesit.

EPSHI DHE SHEJTANI

Prej të këqijave të kësaj bote, prej dukurive negative në këtë botë kalimtare është se në të ekzistojnë kundërshtime të rrepta, të cilat asnjëherë nuk ndalen. E drejta dhe e kundërta e së drejtës. Në fushën e kësaj fushëbeteje e cila nuk përfundon gjatë tërë jetës, e cila është përplot mëkate, e cila t'i prish nervat. Këto dy elemente të fuqishme, fuqia e logjikës dhe mendjes në njërën anë dhe fuqia e epshit dhe Shejtanit në anën tjetër. Në të gjitha fazat e njeriut shohim se këto dy forca tërheqin njëra tjetrën. Në fazën e fillimit të jetës së tij dominon epshi dhe i afrohet Shejtanit, po ashtu edhe gjatë fazës së rinisë e tërheq epshi dhe nuk i ndahet. Ndërsa kur të fillojë faza e pleqërisë, kur bukuria vyshket, trupi i tij dobësohet, dalngadalë i afrohet mendjes apo arsyes dhe logjikës. E kur njeriu i kthehet arsyes dhe mendjes i ngjason apo

është i përafërt me melaqet. Ndërsa kur të dominojë elementi tjetër (epshi dhe Shejtani) bëhet i përafërt me kafshët, apo mes melekëve dhe kafshëve, dhe bie në nivel të dëgjueshmërisë dhe mosdëgjueshmërisë.

Çka mendon Shejh Shaëraviju për ndjenjat e epshit në raport me Shejtanin.

Cila është ndërlidhja mes tyre në mëkate?

Allahu ka dëshirua që Ademit dhe bashkëshortes së tij tu jep përvojë praktike, lëndore, derisa ta pranojë hilafetin në tokë, hilafet të cilin e pranon pas ushtrimit dhe eksperiencës që ata dy të jenë bashkëshortët prej të cilëve shtohet njerëzimi, që prej tyre të vijnë pasardhësit e tyre të cilët do të jenë mëkëmbës në tokë. Për këtë arsye patjetër ka qenë dashtë që Ademi me bashkëshorten e tij t'i njohin dhe t'i mësojnë barrierat me të cilat do të ballafaqohen gjatë hilafetit në tokë siç janë:

Dëshira e trupit dhe epshit të pangopur.

Cytjet e Shejtanit, vesveset e tij në epshin i cili dëshiron kënaqësi të shpejtë.

Vazhdon më tutje Imami i mirënjohur duke sqaruar:

Mëkatin të cilin e bën njeriu dhe i bënë padrejtësi vetes së tij, a është vepër e tij apo vepër prej veprave të një grupi Shejtanësh. Për të dalluar njërën prej tjetrës patjetër duhet ta pyesësh vetëm:

A është kjo çështje prej çështjeve që Allahu ka dashur, e ka përcaktua dhe ka dhënë urdhër "vepro" ose mos vepro, apo është prej çështjeve tjera?

Kjo, për arsye që Shejtani të mos bëhet armik në çështjet joarmiqësore. Nëse mëkati është prej çështjeve që njeriun e tërheq vetvetiu, që do të thotë sa herë që mundohet të largohet nga ai mëkat epshi e thërret në të. Njeriu duhet ta dijë se ky mëkat është mëkat i llojit të ndjenjave të epshit. Sepse epshi dëshiron që njeriu të mëkatoj mëkat të llojit të veçantë si p.sh. me shikua në haram. Njeriu duhet të largohet, me fjalë tjera ta largoj epshin nga ajo që ai e kërkon, e që më vonë bëhet burim i mëkatit, pra epshi kënaqet dhe pajtohet me mëkatin të pjesshëm.

Ndërsa sa i përket Shejtanit, me të është çështja ndryshe, ai dëshiron që gjithmonë të jetë mëkatarë, e asnjëherë nuk pajtohet me mëkatin të pjesshëm. Nëse njeriu e refuzon urdhrin e Shejtanit e nuk e bën atë mëkat. Ai merr masa tjera, hy për dere tjetër, për të bërë tjetër mëkat, pasi që në të parën nuk ka mundur.

KUR'ANI IA KA TEJKALUAR EDHE KËTIJ SHEKULLI

Islami i ka vendosur ligjet dhe parimet për me harmonizua aktivitetin e jetës në shoqëri në kohëra të ndryshme dhe rrethana të ndryshme.

Kjo është specifikë e projektit të Krijuesit për ta harmonizuar shoqërinë, për me ndërtua atë, për me përforcua dhe për me zhvillu në shtylla të forta dhe stabile. Të gjitha sistemet të cilat i kanë provua shoqëritë shpijnë vetëm në një pikë, vetëm në një sistem të cilin e shohin të përkryer i cili krijon kështu për qëtësi dhe lumturi në jetë.

Kulminacioni i këtyre sistemeve dhe pikësynimi i zhvillimit të secilit program të cilin e paraqesin dhe e praktikojnë të gjithë popujt, në fund e sheh se ata i janë afruar shumë afër islamit.

Kjo dëshmon me argument të fortë se shoqëri e përkryer është ajo shoqëri apo sistem i cili është harmonik dhe i përshtatshëm për çdo kohë dhe për çdo vend. Ky është mendim i Shejhut Muhamed Muteveli Shaëravijut.

PËR ÇDO POPULL PREJ JUVE KEMI PARAPA LIGJ DHE PLANPROGRAM

Një hulumtues i trashëgimisë kulturore islame në bibliotekën islame në libër të trashëgimisë kulturore kishte hasur në fjalën "MENHEXH" planprogram dhe më ka pyetur:

Çka ka për qëllim fjala "MENHEXH-planprogram"?

Shejh Shaëraviju gjithmonë kur flet për "MENHEXHIN" planprogramin edhe pse fjala "MENHEXH" planprogram nuk ndërlidhet me Allahun e Lartmadhëruar, por planprogram (MENHEXHI) është ajo që ka të bëjë me jetën e njeriut, dhe është gabim të përzihet me Allahun xh. sh. sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë **"Për çdo popull prej juve kemi parapa ligj dhe planprogram"**. Unë nuk kam hasur në ndonjë fetëva e cila na bind neve se fjala "planprogram-MENËXH" është të larguarit prej obligimeve të Allahut të Lartmadhëruar. Vepro ose mos vepro. Dhe nuk kam hasur sqarim më të mirë të kësaj fjale se sa sqarimin të cilin e ka bërë Shejh Shaëraviju ku thotë:

E tërë fjala "MENHEXH"-planprogram përqendrohet në ajetin Kur'anor: **"Dhe nuk i kam krijuar xhinët dhe njerëzit për diçka tjetër, por vetëm të më adhurojnë".**

Pra fjala "MENHEXH"planprogram do të thotë adhurim.

Adhurimi është përqendrimi i njeriut në dy fjalë "vepro (këtë) dhe mos vepro (atë)".

Nëse njeriu i përmbahet këtij Planprogrami, jeta e tij është e qëndrueshme. Allahu i Lartmadhëruar është Ai i cili ka parapa për neve planprogram. E ka zgjedhur që njeriu të jetë mëkëmbës në tokë, e për këtë ka dërgua Pejgamber dhe të Dërguar në planprogram.

Planprogrami i sjell njeriut jetë të lumtur, me plotë të mira, me plotë bukuri, plotë befasi, njeriut nuk i humb asnjë begati, dhe asnjë begati nuk humb në jetë.

Për këtë Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"Dhe, kjo botë nuk është asgjë tjetër por lojë e zbavitje, ndërsa me të vërtetë, jetë e mrekullueshme dhe e vërtetë është bota tjetër, po sikur ta dinin !?"

Kështu jeta pa planprogram e mashtron njeriun në kënaqësi të përkohshme, ndërsa jeta me planprogram është jetë e vërtet dhe komplete, pa mangësi. Këto të vërteta nuk mund t'i përceptoj vetëm njeriu i urtë dhe i mençur.

Allahu i Lartmadhëruar fjalën planprogram-"MENHEXH" e ka llogarit prej specifikave më të larta të karakterit saqë e ka quajtur "shpirt".

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Dhe kështu Ne ia shpallëm atij shpirtin (Ruhan) me përcaktimin tonë. **Nuk ke mund ta dish ç'është libri dhe as Imani, mirëpo Ne i kemi bë atij dritë me të cilën e udhëzojmë cilin të duam prej robërve tanë. Nuk ka dyshim se ti udhëzon në rrugë të drejtë.**

Kështu Zoti i Lartmadhëruar planprogramin e Kur'anit e ka quajtur shpirt.

SHPËRBLIMI I SHKENCËTARËVE

Pabesimtarët, të cilët nuk besojnë në Muhamedin a.s. as në Kur'anin, mirëpo ato janë dijetarë. Shkencëtar të cilët kanë zbulua mikrobet, ilaçet etj. prej të arriturave shkencore të cilat të arritura njeriut i shërbejnë dhe i sjellin dobi, mirëpo pyetja është: Çfarë shpërblimi kanë ata te Zoti i tyre?

Imami i mirënjohur Shaëraviju përgjigjet:

Nuk ka dyshim se njeriu e merr pagën-shpërblimin prej atij te i cili ka punuar. Pra, a ka qenë Allahu (besimi) në mendjet e tyre, apo në mendjet e tyre ka qenë njeriu, bota, reputacioni dhe krenaritë e tyre. Për këtë arsye mos thuaj se Allahu ia ka humbur atyre shpërblimin ose ata vet e kanë humbur, dhe kanë humbur për shkak se kanë tregu kryeneçësi dhe kanë bë mëkat.

FASIK - mëkatar është ai i cili del prej sferës së përgjegjësisë dhe detyrave të përcaktuara.

PSE ALLAHU E KA KRIJUAR KËTË BOTË

Imami i mirënjohur pyet:

Pse Allahu e ka krijuar këtë botë?

Ishte pyetje madhështore dhe me vlerë shumë të rëndësishme pas së cilës Shejhi u përgjigj:

Ai i cili prodhon diçka të bukur, e ekspozon para njerëzve për me tregu çka ka punua me duart e tij. Allahu ka krijuar këtë botë me të gjitha bukuritë për të parë njerëzit madhështinë e krijimit të Tij dhe përsosmërinë e krijimit të Tij.

Shejh Shaëraviju sjell shembull për këtë:

Ai i cili pikturon një pikturë, e sjell vizatimin (fletën), lapsat (ngjyrat) pastaj pllakën e pikturuar e përfundon me të gjitha finesat dhe në fund lenë, pa përfitua dije prej saj, mirëpo më vonë vjen ndonjë njeri e merr atë pikturë, e shet dhe përfiton (të holla) prej saj ndërsa i pari e ka pikturuar pa qëllim që të përfitoj prej asaj pikture.

Edhe pse krahasimi të cilin e bëmë, për Allahun ky krahasim është

dallim i madh, sepse shëmbëlltyra e Allahut është më e larta, Ai është i pavarur për të gjithë botën, dhe nuk ka nevojë për askënd që njerëzit me bukurinë e krijimtarisë së tij, përsosmërinë e kësaj bote. Mirëpo bëhet pyetja: ku ka qenë Allahu para se ta krijoj botën?

Imami i mirënjohur thotë:

Kjo është fshehtësi të cilën nuk e di askush tjetër, pos Allahut të Lartmadhëruar.

Sa i përket Krijuesit dhe krijesat për njeriun janë fshehtësi të cilat njeriu nuk i di. Është e vërtet se kur është pyetur Muhamedi s.a.v.s.: Ku ka qenë Zoti ynë para se të krijoj qiejt dhe tokën? Muhamedi a.s. nuk e ka refuzua pyetjen por ka thënë: ***Ka qenë në hapësirën ku mbi të ka pasur ajër dhe nën të ajër. (E KA REGJISTRUAR AHMEDI)***

Kur është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për fillimin e krijimit të botës është përgjigjur: ***Ka qenë Allahu dhe s'ka pas asgjë pos tij dhe arshi i tij ka qenë në ujë dhe ka shkruar të jetë e krijuar çdo gjë. (E KA REGJISTRUAR AHMEDI)***

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **Dijetari i të fshehtave dhe i të dukshmëve.**

Po ashtu ka thënë: **Dijetari i të fshehtave, ai nuk ia tregon fshehtësinë e tij askujt, përpos atij që do prej të dërguarve të tij. Atë botë ai vë roje edhe para edhe prapa tij (kur ia shpall fshehtësinë). (SURETUL XHIN; 26,27)**

Imami i mirënjohur Shaëraviju thotë:

Nuk kemi ndonjë njohuri paraprake për çfarë diturie do të jetë i njohur njeriu. Ajo është dituri sekrete.

Allahu nuk ka lënë paranjohuri për me ditur për çfarë fshehtësi është fjala, por Allahu vet tregon për atë se do ta tregon atë fshehtësi përderisa paranjohuri në rastin e parë për njerëzit tregohet në fjalën e tij "dhe nuk mund të përfshin nga dituria e tij".

Ndërsa për rastin e dytë, rasti i njohurisë së fshehtësive. Zoti i Lartmadhëruar ka tregua gjithë përfshirjen e diturisë vetëm te ai ku thotë dijetari i fshehtësive dhe fshehtësitë e tij të veçanta nuk ia tregon (nuk ia shpalos askujt).

Njeriu dhe logjika njerëzore patjetër duhet me pranu dhe duhet me besu si burim prej burimeve të diturisë, diturinë të cilën ia jep Allahu atij (njeriut).

Kjo na shpie te çështja se aty nuk mund të arrin asnjëherë, pra nuk mund të arrijmë aty ku: Si është krijuar njeriu, si është krijuar qielli?

Këto çështje nuk i dimë për arsye se në nuk i kemi parë, dhe nuk posedojmë përvojë dhe eksperiencë.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **Ju nuk keni prezantuar në momentin e krijimit të qiejve dhe tokës, e as në krijimin e vet "tuajin". (EL-KEHF, 51)**

Imani është burimi kryesor i diturisë siç mendon Shaëraviju. Ai mendon se njeriu kur të beson, arrin në burimin e madh të diturisë i cili i jep dituri të plotë, e nëse nuk beson ai përkufizohet vetëm në materie, dhe nuk mund të dal jashtë sferës së materies, për këtë arsye ai nuk mund të di çka ka pas materies. Pse rruga e vetme për dituri dhe njohuri se çka ka pas materies është Imani (besimi).

TË PADUKSHMET DHE BESIMI NË TA

Të gjitha çështjet e Imanit janë të padukshme, sepse po të ishin të dukshme nuk do të kishte qenë e nevojshme (e domosdoshme) të besohej në to. Kështu mendon imami i nderuar Muhamed Muteveli esh-Shaëraviju.

Parashtrohet pyetje: Imani në të padukshmen a është bazë për t'iu përmbajtur atij programi?

Dhe sa është e kërkuar, me fjalë tjera cila është shkalla e besimit në të padukshmen për të arritur kulminacionin e Imanit?

Imami i mirënjohur Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë: Ka thënë Zoti i Lartmadhëruar: **Ky është libri në të cilin kurrë nuk duhet pasur dyshim, është udhëzim për të devotshmit (për ata) të cilit besojnë në të padukshmen. (EL-BEKARE, 2)**

Këta janë ata të cilët Allahu i ka cilësuar, sepse ata besojnë në të padukshmen, të cilat për ta janë të parapara, duke besuar në Allahun, të Fuqishmin, Krijuesin. Pastaj besojnë melekët e Tij, në librat e Tij, në pejgamberët e Tij. Besojnë në ditën e fundit, pra të gjitha këto janë çështje të padukshme. Çështjet e pa dukshme përfshihen në kulminacionin e të Padukshmit, besimi në Allahun, e pastaj me besua ata të cilat ka thënë Allahu

me i besuar.

Kur Allahu thotë "Melekët" ti edhe pse nuk i sheh thua: Po, pranoj zemërgjërësisht se ka melekë, edhe pse nuk i sheh ato sepse Ai i cili po më lajmëron dhe po më tregon është Ai të cilit i kam besuar me logjikën time, e i kam besuar Atij se është Allahu.

Dhe për derisa Allahu i Lartmadhëruar ka thënë: **"Unë i kam krijuar melekët"**, nuk kemi çka të diskutojmë fjalën e Allahut se nuk jemi duke i parë melekët, sepse atëherë sytë tanë janë duke gjykuar në Allahun. Allahu dëshiron që ti të besosh me tërë qenien dhe me tërë logjikën tënde. Mos parja e melekëve është çështje në vete dhe ekzistimi i melekëve është çështje në vete. Ti ke shpirt me të cilin jeton, por a e ke pa? A e ke dëgjuar? A e ke shijuar? A e ke ndier erën e tij? A e ke prekur me çfarëdo organi prej organeve tua?

Pra ti nuk e ke pa shpirtin tënd, por ti e përjeton nëpërmjet gjurmëve (Indikacioneve) në lëvizjen e trupit tënd ashtu që nëse largohet shpirti nga ti, ti bëhesh kufomë. Ti e njeh nëpërmjet gjurmëve të tij në ty, ajo është e krijuar e nuk e sheh e si me pa Krijuesin i cili e ka përsosur atë?!

Zoti i Lartmadhëruar për të devotshmit thotë: **"Ata të cilët besojnë"**, nëse ne kemi besuar në kulminacionin e të padukshmes kemi besuar edhe besojmë në çdo çështje që na thotë Allahu me besu edhe pse nuk e shohim.

Allahu i Lartmadhëruar ka pru shembull në vetë trupin e njeriut para se të zbulohej mikrobi, njerëzit i shihnin vetëm shenjat e sëmundjeve, ata nuk kanë kuptuar gjë tjetër pos temperaturës e të ngjashme, mirëpo nuk kanë ditur për diçka që është quajtur mikrob. Mirëpo kur është zhvilluar shkenca dhe Allahu i Lartmadhëruar ka dhënë leje që krijesa e krijuar prej Allahut të bëhet e dukshme dhe po ashtu ka dhënë leje që krijesa mendje e krijuar prej Allahut të zbuloj deri atëherë çështjen e pazbuluar, e kemi pa dhe po e shohim në formën e zmadhuar me mikroskop.

Pra mos parja e një çështje nuk do të thotë se ajo çështje nuk ekziston, por mjeti shikues është i paaftë për ta parë.

Të parëve tanë, po tu kishim treguar në të kaluarën për mikrobin, ato nuk do të kishin besuar. Natyrisht se nuk do të kishin besuar. Pra, Allahu ka lënë që disa krijesa të mos shihen në një kohë, sepse ato do të jenë në nivel më të ultë të shikimit, pastaj ia bënë të mundur që në një kohë tjetër me pa, dhe ne e shohim, e kjo sikurse dëshiron të na thotë Allahu: mos e moho të padukshmen, sepse një çështje ka qenë e padukshme në të kaluarën, pastaj

janë prodhua mjete teknike (mikroskopët) për t'i parë vetëm e vetëm me qenë argumentim për të padukshmen sepse ka gjëra të cilat ekzistojnë por ti nuk i sheh.

Pra ata të cilët besojnë në të padukshmen, kulminacioni i besimit të tyre është besimi në Zotin, dhe me besua në atë që ai ka urdhëruа me besuar.

Pastaj Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Dhe falin namazin"** për të krye dhe tregu nënshtrimin dhe adhurimin ndaj Allahut dhe atë duke e përsëritë pesë herë në ditë.

KRIJIMI PREJ ASGJËJE

Zoti i Lartmadhëruar në hapësirën e kosmosit (gjithësisë) ka parapa shkaqet të cilat janë të ndërlidhura fort me shkaktuesin nga këtu, ligjet në natyrë dhe natyrshmëria përputhen dhe janë në harmoni në sendet që ekzistojnë dhe e konkretizojnë njëra-tjetrën, vetëm se dëshira e Allahut dhe fuqia e Tij absolute nuk varen nga këto shkaqet, çka mendon Shejh Shaëraviju në lidhje me këtë:

Imami i mirënjohur thotë:

Çdo gjë që ekziston e ka krijuar Allahu, dhe për të ka parapa shkak, mirëpo është e pamundur që shkaqet të cilat i ka krijuar Allahu me qenë pengesë për dëshirën e Allahut të Lartmadhëruar. Nga këtu, edhe pse ekzistojnë shkaqet në shumicën e rasteve shohim ndodhi dhe ngjarje të cilat ndodhin në kundërshtim me shkaqet. Me fuqinë e Tij absolute Allahu i jep sundim një njeriu dhe ai e largon nga fronti tjetrin i cili ka fuqi pushtet edhe pse i ka shkaqet e fuqisë dhe sundimit, mirëpo të gjitha ato paralizohen dhe zhduken para fuqisë absolute të Allahut.

Allahu ka vendos ligjet mbi të cilat bazohet gjithësia, mirëpo këto ligje nuk munden me qenë barrierë për fuqinë e Tij absolute. Dëshira e Allahut është mbi të gjitha ligjet. Dëshira e Allahut është e pandryshueshme, ajo gjithmonë ekziston dhe gjithmonë është aktive, për me u fitua e drejta dhe me dështua e padrejta.

Pasi që shkaqet janë të krijuara, atëherë çështjet e krijuara nuk munden me qenë barrierë e Krijuesit.

Allahu i Lartmadhëruar i hap derën e furnizimit një njeriu dhe i jep shumëfish nga ajo që ka punuar, ndërsa tjetrit ia ngushton derën e furnizimit dhe fiton pak edhe pse angazhohet, lodhet dhe punon për së tepërmi, kjo ndodh para syve dhe parashikimeve tona.

Pra, edhe pse ne shkojmë sipas shkaqeve prapëseprapë nuk duhet harruar fuqinë absolute të Allahut. Nuk duhet të na mashtrojnë shkaqet sado që ato shkaqe na japin furnizim.

Herët është thënë: Sa e sa punëtorë kanë mbet të fikur.

Urtësia e Allahut ka përcaktua që dëshira e Tij absolute me qenë mbi shkaqet, sepse sa herë që njeriu është bazua vetëm në shkaqet ai është largu nga rruga e Allahut të Lartmadhëruar sepse ai shkaqet i ka marrë si Zot dhe ka adhurua rezultatin e shkaqeve e jo shkak Krijuesin.

SHKAQET DHE SPROVAT

A ka ndonjë sprovë e cila i prishë shkaqet për ta sprovuar jetën?

Në lidhje me këtë Shejh Shaëraviju thotë:

Të konsiderojmë se toka është tharë, të konsiderojmë se bimët e arës tënde janë sëmurë prej ndonjë sëmundje, pra duhet që të mos shikosh vetëm ndonjë shkak prej shkaqeve.

Pjesët e trupit punojnë ndërsa zemrat e besimtarëve mbështeten në Allahun krijues të shkaqeve. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar njerëzve të cilët kanë mbjell, i kanë ujitë të mbjellat e janë bë fryte, pak para se me i mbledh frytet i rrok ndonjë sëmundje dhe s'mbetet asgjë. Çka dëshiron që Allahu të tregoj me këtë?

Allahu dëshiron të tregoj, mos me u bazua vetëm në shkaqe.

Kjo çështje shihet në librin fisnik ku Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Dhe kush i frikohet Allahut, i bënë rrugëdalje, dhe e furnizon nga aty ku nuk llogaritë fare"**. Për mos me mendua se furnizimi vjen vetëm nëpërmjet angazhimit tënd.

Njeriu asnjëherë nuk nevojitet të mbështetet vetëm në shkaqet, kjo për shkak të sigurimit prej sprovave në shkaqe. Atëherë kur ta dish se pas shkaqeve është Krijuesi i shkaqeve i cili në të njëjtën kohë jep dhe furnizon

pa shkaqe dhe furnizon nga aty ku njeriu nuk llogaritë fare, njeriu ka fitua fuqinë e imanin kulminant, fuqia e imanit në Krijuesin e shkaqeve i cili kur dëshiron të jep, jep furnizim edhe pa shkaqe.

MUËXHIZJA DHE KERAMETI

Shejh Shaëraviju thotë:

Zoti i Lartmadhëruar dëshiron që ne të besojmë në ligjet e jashtëzakonshme, që do të thotë me besuar në mundësinë e ndodhisë së tyre. Pasi që çështja është në fuqinë e Tij, atëherë edhe ato ndodhin, ndërsa sa i përket ndodhisë së muëxhizës askush nuk ka të drejtë të thotë se si iu është dhënë kjo muexhize për me besua tjetri në të.

Shejh Shaëraviju pretendon:

Ai i cili sheh muëxhize ajo është argument për të, dhe kur të lajmëron për të ai i beson në bazë të vetëbesimit në të. Sipas Shejh Shaëravijut muëxhizja është një shkallë më e lartë se kerameti, bile është shkalla më e lartë e kerametit.

Dikush mund të pyet: Pse Allahu nuk e ka dallua Muhamedin a.s. me muëxhize shqisore, ashtu siç i ka dallua pejgamberët tjerë. Në i kundërpërgjigjemi: Po iu është dhënë, por gjatë tërë jetës së tij i janë dhënë pak muëxhize të tilla, nëse ti u beson. Kjo është mirë për ty, nëse jo, hulumto për vërtetësinë e tyre. Muëxhizet shqisore janë argument për atë i cili prezanton drejtpërsëdrejti në ato raste, ndërsa ai i cili nuk i ka parë për të është mirë me u besua.

Ka mjaftua pak ushqim i të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. me u ngopë shumë e shumë njerëz, kush ka prezantua në atë ushqim është argument për ta.

Kështu themi edhe për kerametet janë ndodhi për ata të cilët i shohin drejtpërdrejtë. Nëse ndonjëri të tregon për kerametin e ndonjërit për të cilën ka lexuar apo ka dëgjuar, për ty nuk kërkohet me thënë është e vërtetë apo nuk është e vërtetë, sepse ajo nuk është e dedikuar për ty. Për ty është e dedikuar vetëm kerameti të cilën e sheh ti me sy drejtpërsëdrejti për me ta forcua Imanin.

Pra kerameti është për këtë arsye, disa prej njerëzve e pranojnë me

tallje, disa tjerë me bindje të fortë, kush beson me bindje të fortë, ajo muëxhize është për atë vetë, i cili e ka parë, ndërsa ti i cili nuk e ke parë me sy je i lirë me besua ose mos me besua. Ti je jashtë kësaj kornize.

Kerameti është argument për atë që e ka pa ndërsa Kur'ani është argument për të gjithë.

FUQIA ABSOLUTE

Shejh Shaëraviju mendon se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka triumfua në misionin e tij me fuqinë absolute të Allahut. Mirëpo kur e kemi pyetur: Çdo herë kur në botë arrihet me diçka të jashtëzakonshme atëherë është në pyetje fuqia absolute dhe zhvleftësohet shkaqet dhe rrethanat dhe lidhjet natyrore. Pse atëherë ka ardhur në pyetje fuqia absolute e Allahut dhe zhvleftësimi i shkaqeve por në të njëjtën kohë ka pas raste ku Muhamedi a.s. ka triumfua kundër pabesimtarëve dhe ateistëve me ndikimin e shkaqeve.

Imami i mirënjohur Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë se triumfi i Muhamedit a.s. është plotësua me fuqinë absolute të Allahut në kombinim me shkaqet, pra me të dyja. Për këtë ai na sjell shembull: Muhamedi a.s. është mbrojtur prej pabesimtarëve me fuqinë absolute të Allahut që ata as mos ta shohin as mos ta prekin Muhamedin a.s. me Ebu Bekrin (kur ishin në shpellë). Po ashtu edhe pabesimtarët pas tyre ka qenë dashtë me ecë nëpër shkretëtirë qindra e mijëra kilometra.

Në luftën e Bedrit është kombinua fuqia absolute me shkaqet. Melekët ua forconin këmbët muslimanëve, ndërsa në të njëjtën kohë pra paralel në shkaqet, ata veç kanë marrë pjesë në fushëbetejë. Në luftën e Hendekut është arritur fitorja me fuqinë absolute kundër fiseve kurejshite të cilët ishin në anën tjetër të Hendekut dhe jehudëve të cilët ishin brenda qytetit, të cilët veç kishin lidhur aleancë për me zhduk Islamin.

Çlirimi i Mekës ka qenë argument i fuqishëm, sepse fuqia absolute e Allahut nuk ka lejuar që sytë e pabesimtarëve të shohin ushtrinë muslimane deri sa të grumbullohen rreth e përqark qytetit të Mekës, dhe ata janë befasua kur i kanë pa përnjëherë, sepse Kurejshit kanë mundur me i parë deri sa të shpërndahen rreth e rrotull, mirëpo fuqia e Allahut i ka verbërua shikimet e tyre.

Imam Shaëraviju tregon parimin e përgjithshëm dhe të fuqishëm se shkaqet dhe fuqia absolute e Allahut janë dy çështje të cilat kombinohen deri në ditën e kiametit për të fituar të dobëtit kundrejt të fuqishmëve. Padrejtësia dhe kriminaliteti i cili nuk mund të zhduket në asnjë mënyrë, dhe prej asnjë shkak prej shkaqeve, që do të thotë se atij të cilit iu është bë e padrejtë nuk mund ta kthej të drejtën e tij, atëherë kombinohet, me fjalë tjera ndërhynë fuqia absolute e Allahut për të fituar e drejta ndaj të padrejtës.

PËRMBAJTJA E PLANPROGRAMIT DHE VËSHTIRËSIA E OBLIGIMEVE

Sëmundjet e njerëzve si ato shëruese ashtu edhe ato të pashërueshme janë si rezultat i mospërmbajtes së tij rregullave apo ligjit të jetës.

Sepse ai dëshiron shfrenim, dëfrim dhe liri shtazarake edhe pse përmbajtja në rrugën e Allahut është në dobi të tij, sepse Shejtani qarkullon së bashku me qarkullimin e tij në trupin e tij. Çdo shpallje prej qiellit ka zbritur me obligime dhe çdo obligim nga qielli është për dobi të njeriut, pra mirësi nga qielli për shërimin e zemrës dhe qetësinë e shpirtit, mirëpo njeriu mendon se obligimet ia ngushtojnë dhe ia kufizojnë jetën e tij mirëpo përkundrazi çdo gjë çka ka ardhur prej pejgamberit është vërtetuar humanitet dhe se ato janë në dobi të njeriut, dhe ku humb i humburi, dhe është largu i larguari, dhe çdo gjë çka ka ardhur prej pejgamberëve ka ardhur çka është në përputhshmëri me jetën e njeriut dhe në dobi të jetës së tij.

Atëherë, pse njeriu gjithmonë ndien vështirësi në kryerjen e obligimeve, me fjali tjera heziton në kryerjen e tyre.

Imami i mirënjohur thotë se zbrazëtitë dhe ngatërresat në gjithësi të gjitha janë si rezultat i çështjeve të cilat janë në kompetente të lirisë së njeriut me fjalë tjera si rezultat i çështjeve për të cilat ka të drejtë të zgjedhë ndërsa çështjet për të cilat nuk ka liri veprimi ato janë çështje stabile të qëndrueshme ndërsa tjerat ku ka zgjedhje e kanë shkatërruar botën.

Dhe sikur njeriu të zgjidhte planprogramin e Allahut nuk do të ndodhte shkatërrimi, nuk do të kishte lajthitje dhe nuk do të ishte i humbur.

Zakonisht obligimet përkufizojnë tejkalimin e ndjenjave të epshit, ia ndalojnë lirinë e shfrenuar, mirëpo në përgjithësi ai i cili i kryen obligimet, e

nuk ndien vështirësi dhe beson ë Allahun me besim të sinqertë dhe bindje të thellë, ai në besim ka gjetur bazë të fortë për ardhmërinë e tij. Ai i cili sot e kupton se obligimet janë në dobi të tij, ai ka kuptuar të vërtetën sot, ai i cili nuk ka kuptua sot se obligimet janë në dobi të tij do t'i kuptoj më vonë. Ndonjëherë arsye e obligimit është në vet moskuptimin e arsyes së obligimit. Kështu qetësimi i zemrës arrihet vetëm në pasimin e planprogramit të Allahut. Dhe ai i cili nuk ndien lodhje dhe vështirësi në kryerjen e obligimeve ai e ka arrit Imanin e plotë dhe e ka realizua nijetin e sinqertë në Allahun e Lartmadhëruar.

A KRYEJNË NEVOJË PERSONALE BANORËT E XHENETIT

A kryejnë nevojë personale (jashtëqitje dhe urinim) banorët e xhenetit?

Nëse nuk kryejnë nevojë natyrale, atëherë si tretet apo ku shkojnë mbeturinat (teprica) e trupit?

Imami i mirënjohur Shaëraviju përgjigjet: Banorët e xhenetit nuk kryejnë nevojë natyrale, kjo nga arsyeja se në xhenet do të ushqehemi në mënyrë krejt tjetër nga ushqimi i kësaj bote.

Në këtë botë njeriu ushqehet me dëshirën e tij ndërsa në botën tjetër njeriu han çka i pëlqen atij prej dëshirës dhe urdhrit të Allahut.

Në botën tjetër nuk ka lodhje, mund dhe angazhim për furnizim dhe ushqim, ashtu siç ndodh lodhja, mundi dhe angazhimi në këtë botë. Në botën tjetër shkaqet e furnizimit nuk ekzistojnë. Aty jetojmë aty për aty **"Çdo gjë është shkak dhe furnizim në të njëjtën kohë"**. Allahu i Lartmadhëruar me fuqinë e Tij ka mundësi që njeriut t'i mundësoj shije dhe kënaqësi në ushqim dhe ushqimi të jetë në të njëjtën kohë tretës në vetvete dhe mos me i mbet asnjë grimcë e ushqimit tepricë.

Çka quhet tepricë e ushqimit? Ajo është teprica në barkun e njeriut prej të cilës trupi nuk ka dobi por përkundrazi është e dëmshme për shëndetin.

Krijuesi i diçkaje (Allahu) dhe i çdo çështje ka mundësi që të krijojë mundësinë që kur të depërtojë ushqimi në brendësi, mos me mbet kurrfarë teprice nga nevoja jote dhe mos me mbet asgjë e cila është e dëmshme.

KUR'ANI DHE LEXIMI I TIJ I CILI KONSIDEROHET ADHURIM

Pyetje: "A konsiderohet adhurim (ibadet) leximi i Kur'anit?

Përgjigjja: Po.
VALLAHU TEALA EALEMU

Shejh Shaëraviju nuk pranoi asgjë shpërblim për botimin e këtij libri që prej tij të kenë dobi lexuesit musliman, Zoti e shpërbleftë me të mira.

PËRFUNDOI PJESA E DYTË DHE DO TË PASON PJESA E TRETË NËSE DËSHIRON ALLAHU

Pasi që përfundoi përgatitja për botim, botuesi ia paraqiti Imamit të mirënjohur Shejhut Muhamed Muteveli Shaëravijut i cili e lexoi, e përmirësoi çka pat nevojë dhe e lejoi për botim, Zoti ndihmoftë që të ketë dobi Islami dhe muslimanët. Falënderoj Allahun fillim e mbarim.

FETAVATË E SHAËRAVIJUT

PJESA E TRETË

III

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

Kaçanik, 2015

HYRJE

O Zoti im, të falënderoj dhe kërkoj mbështetje te Ti. Të falënderoj për të mirat e Islamit dhe bindjen e Imanit dhe dorëzimit tim vetëm para madhërisë Sate, për besimin në madhështinë Tënde, për forcën Tënde të pakufishme dhe për ekzistencën Tënde pa fillim e pa mbarim.

Të lutem ty o Zoti Im, me lutje të përulur para madhërisë Tënde, me lutje para mëshirës Tënde. Përshëndes me selam krijesën më të mirë, dhe vulën e të dërguarve të Tu dhe ndërmjetësuesin për ne, zotërinë, të Dërguarin Tënd, Muhamedin s.a.v.s., ndërmjetësuesin në Ditën e Tubimit dhe paraqitjes para Teje.

Dhe . . .

Vazhdimësi e pa fund, dhe pa fund i pafilluar i kësaj kohe ku janë prishur peshojat dhe vagat. Por erdh përfundimi se e mira ende ekziston. Ende ka shpirtra të mirë në hapësirën e fushëbetejës, ashtu siç ka thënë i Dërguari i Allahut s.a.v.s.:

"E mira në mua dhe në umetin tim është deri në Ditën e Kijametit".

Dëshmi për këtë është interesimi dhe parashtrimi i pyetjeve të shumta, dhe kërkesat për shpjegime të çështjeve prej lexuesve tanë të nderuar, në revistat tona Islame, e posaçërisht në revistën "Livaul Islam" dhe "Minberul Islam", dhe në revistat tjera. Ata dëshirojnë sqarime të çështjeve të fesë së tyre të pastër, duke dashur edhe botën tjetër. E gjithë kjo na tregon qartë për interesim të planprogramit të Allahut, për këtë duhet falënderuar vetëm Allahun. Ndoshta kjo është si shkak se janë paraqitur shumë sisteme e shumë metodologji e nuk është gjetur shoqëri shëmbëlltyrë, dhe më stabile e më të pastër dhe më harmonike se programi islam, sepse Islami ka ardhur për të gjitha shoqëritë, dhe për të gjitha kohërat.

Dua të përmend dhe të shpreh mirënjohje të veçantë dhe falënderim të sinqertë për të gjithë ata që na kanë përkrahur dhe na kanë dhënë forcë, gjë që nuk duhet mohuar assesi.

Ndërsa sa i përket shokëve të sinqertë e kam vaxhib të falënderoj pa masë, mirëpo nuk mjafton vetëm falënderimi për shkak se ata janë në shkallën më të lartë të sinqeritetit, mjafton ajo se ata e kanë nderuar dhe e kanë fisnikëruar veten e tyre, e cila është vlera më e lartë, të cilën e arrin njeriu, dhe se do të mbeten të lavdishmit më të zgjedhurit prej njerëzve, të cilët kanë krenarinë dhe burrërinë gjatë tërë jetës së tyre nga të gjitha anët e botës.

Dëshmia e mëkatarit nuk vlen për askënd, përpos për veten e tij, sepse mëkatari është i drejtë vetëm për veten e tij, e për tjetërkënd asnjëherë nuk i pranohet dëshmia.

Nuk ka sjellje dhe edukatë ai, i cili është i kënaqur vetëm me injorancë, e me mendjelehtësi, ose që dëshiron të lavdërohet pa vepruar.

Jeta na ka mësuar dhe e kemi vërtetuar në praktikë, se ziliqari nuk arrin asgjë dhe i ulëti s'ka burrëri, e hipokriti s'ka qetësi.

Ndërsa sheh se të mirët dhe të mirat janë më të nevojshmit dhe më të dobishmit. Ata gjithmonë angazhohen, korrin suksese dhe rruga e tyre është e qëndrueshme.

Sipas dijetarëve të hershëm, por edhe të sodit nuk është kurbetçi kur njeriu emigron prej vendit të tij në një vend tjetër, por kurbetçi është ai, i cili e ngurtëson dhe e burgos mendjen e tij në vetvete, dhe nuk shkon paralel as fizikisht, as psiqikisht me shoqërinë dhe rrethin e tij.

Unë nuk e kritikoj poetin Mutenebi për vargjet e tij, kur thotë:

Edhe pse gjenerata jote shkon
Ti prapë je në mesin e tyre
Por ti je i vetmuar
Vetëm atëherë kur prej tyre je i izoluar
Mos iu ndaj atyre, shko me ta
Edhe atëherë kur ato shkojnë përpara.

Mirëpo e pëlqej poetin me një përvojë më të madhe dhe i cili i shikon gjërat me larg se Muenebiu, i cili thotë:

Nëse shekulli në të cilin jeton ti ec përpara, ndërsa ti je i vonuar për një shekull,
atëherë ti je kurbetçi në mesin e tyre.

Popujt e fuqishëm dhe të sinqertë janë kurbetçinj në vendin e tyre, atëherë kur prej tyre ndahen ata që i duan, atëherë kur ndahen prej fëmijëve dhe farefisit të tyre.

Peshku prishet në kokë, e ndërtesa shkatërrohet nga themeli.

Për të qenë i suksesshëm patjetër duhet pasur ushqim të mirë dhe të vazhdueshëm, e ky ushqim bëhet nëpërmjet llojeve të veçanta të ushqimit, të cilat i parasheh Allahu me sundimin e Tij absolut si në aspekt të gjerësisë ashtu edhe të thellësisë e gjatësisë.

Njerëzit e mirë sakrifikohen për të mirën e tjerëve ashtu sikurse qiriu, i cili shkrihet për t'u dhënë dritë tjerëve dhe për t'u bërë mirë të tjerëve.

Mendimtarët, njerëzit me vlerë, intelektualët dhe njerëzit me reputacion, më së shumti kanë vështirësi në jetë, ata nuk kanë qetësi prej tjerëve, sepse jeta dhe aktiviteti i tyre i vazhdueshëm është me pengesa, kështu ata nuk kanë kohë të rrinë të qetë për shkak të ideve dhe idealit të tyre.

Ndonjëherë mirë është për shpirtin që të ketë vështirësi në jetë. Çka më ka mbetur të them në lidhje me këto fetva?

Mendimin përfundimtar po e lë në kompetencën tënde o lexues i dashur, kritikat, komentimet dhe mendimet tua të pastra, të çiltra, të sinqerta dhe shkëlqyese do të kenë rëndësi të posaçme, do t'i mirëpresim dhe do t'i kemi në konsideratë, sepse ne kemi nevojë për mendimin tuaj të sinqertë. E nuk kemi nevojë për mendimin e atyre, të cilët nuk i lexojnë, por vetëm kritikojnë, ata kritikojnë atë që vet nuk e kuptojnë. Pra nuk kemi nevojë as për kritikën e atyre, të cilët i lexojnë e nuk i kuptojnë, e as të atyre që i keqkuptojnë, e as të atyre të cilët nuk i dinë çështjet e fesë, sepse në esencë ata nuk kanë ide fare.

Pa marrë parasysh mendimet e tyre të pakta apo të shumta i konsideruam apo nuk i konsideruam ata kanë qëllim të keq.

Prej tragjedive njerëzore është se njerëzit e sëmurë, në vend se të përdorim barëra për shërim, përdorin barëra për sëmundje edhe më të madhe.

O Zot, na bën më të mirë se sa të tjerët mendojnë.
Na fal neve për atë që nuk e dimë.
Vërtet Ti dëgjon dhe pranon lutjet.

ALKOOLI DHE PIJET ENERGJIKE

Shumica e njerëzve thonë se pija e quajtur "Kenia" është pije energjike dhe jep fuqi, sepse ka lëndën e alkoolit dhe hekurit. Ndërsa është e sigurt se lënda e alkoolit te *Kenia* nuk arrin shkallën e dehjes. Pra, *Kenia* a është haram apo hallall, pasi që ka alkool edhe pse ajo sasi nuk dehë.

Kur ia paraqita këtë pyetje Shejh Shaëravijut, dhe pasi që i tregova se është pyetje me rëndësi, sepse shumica e njerëzve pinë pije të tillë dhe bien në mëkat pa i kushtuar rëndësi, u përgjigj:

Është *Haram* me fjalën e Muhamedit a.s.:

"Çdo gjë e cila dehë me shumicë, edhe pakica është e ndaluar, edhe pse ajo sasi e vogël nuk dehë."

Rregull i përgjithshëm i nxjerrë prej thënies së Muhamedit a.s.: ***"Çdo pije dehëse është alkool, dhe çdo alkool është haram."***

Mirëpo patjetër duhet përqendruar vëmendjen te një çështje, e ajo është se Zoti i Lartmadhëruar ka urdhëruar për t'u larguar nga alkooli, e kjo do të thotë *hiperbolizim në ndalesë.*

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar. (El Maide, 90)**

Fjala *"Largohuni"* do të thotë *"Mos iu afroni kurrë",* sepse afrimi ju tërheq dhe ju mashtron më shumë, ndërsa thënia e të Dërguarit fisnik*:* **"Çdo gjë që dehë me shumicë, edhe pakica është e ndaluar, edhe pse nuk dehë.",** na bën me dije për ndalesë absolute.

Në këtë kontekst, shejh Shaëraviju na sqaron vërtetësinë e ndalimit:

Ai i cili pi alkool kështu a mund të jetë i sigurt në vetvete se ka mundësi që ta kufizoj veten deri në atë masë sa që nuk do të dehet, dhe para dehjes në çdo çast ta parandaloj veten? Pastaj, a ka mundësi që ai të përdorë deri në atë masë pijen, pra në sasi të vogla, të cilat nuk dehin, sepse kur të arrijë deri në atë shkallë e ka edhe më vështirë me e parandalua veten, sepse ka hy në fazën e paradehjes.

Nuk ka pikë të caktuar, që po të vazhdosh më tutje do të deheshe, e dehja është e ndaluar.

MBAJTJA E QENVE

Familjet moderne edhe gjysmë moderne mbajnë qenë në shtëpi dhe përkujdesen për ta, dhe qëllimi i mbajtjes së tyre është për dëfrim, lojë dhe zbavitje. Ndërsa në *"Ether"* është gjurma prej Haditheve me zinxhirë të fortë se Muhamedi a.s. ka thënë:

"Mos mëkatoni ashtu qysh kanë mëkatuar jehudët duke lejuar atë çka e ka ndaluar Allahu me kafshët e imta (qentë)."

Transmeton Ibn Beta në librin "Ibtalul Hijel", fq.24, Senedi i mirë. Kështu mendon edhe Ibn Tejmije dhe Ibn Kethiri.

Kur iu është parashtruar kjo çështje, Shaëraviju është përgjigjur:

Është e ndaluar për t'i mbajtur të gjitha llojet e qenve, përpos qenit të gjuetisë dhe ruajtës, por edhe ata mbahen jashtë shtëpisë.

Muhamedi a.s. ka thënë:

"Më ka ardhur Xhibrili a.s. dhe më ka thënë: Erdha dje te ti, por nuk hyra, pasi që te dera e shtëpisë pashë skulpturë njeriu dhe po ashtu skulptura tjera, dhe po ashtu në shtëpi ishte një qenë, pra urdhëro që skulptura e njeriut të thyhet dhe të bëhet pluhur, dhe urdhëro që të largojnë qenin prej shtëpie se ne (melekët) nuk hyjmë në shtëpi ku ka qenë dhe skulptura.

Dhe kur shkon, sheh një qen (Xhurvun) i Hasanit dhe Husejnit, që e kishin pasur te jastëku i tyre [pra nën dyshekun (krevatin) e tyre], dhe i thotë: "Oj Aijshe, por kur ka hy ky qen këtu? Aijshja i thotë: Për Zotin nuk e di. Menjëherë ka urdhërua që të hiqet prej aty, pastaj ka marrë ujë dhe me dorën e tij e ka pastruar atë vend." (Hadith Sahihë, Mutefikun alejhi)

SI E TREGON VAJZA DËSHIRËN E SAJ PËR MARTESË

Si ia shpreh vajza prindit të saj dëshirën për martesë?

Përgjigje: Disa kanë thënë indirekt, të tjerët direkt. Për këtë arsye Kujdestari i Shtëpisë duhet me qenë i mençur edhe i kujdesshëm. Pse kur i ka thënë vajza e Shuajbit babës së saj: "O Prindi im, shpërbleje atë." E ka kuptuar qëllimin e shprehjes së saj, dhe menjëherë ka thënë Musës a.s.: "Vërtet, unë dëshiroj që të të martoj me njërën prej këtyre dy vajzave të mia."

Femra pa marrë parasysh a është beqaresh apo e vejë, e drejt e saj është që vet ta zgjedh bashkëshortin e saj.

Në koleksionin e Nesaiut, transmetohet nga Ajshja r.a. se si një grua është ankuar te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për atë se prindi i saj e ka martuar me djalin e vëllait të tij pa dëshirën e saj. Ndërsa i Dërguari i Allahut s.a.v.s. i ka thënë asaj: ***"Ke të drejtë ta pranosh, ke të drejtë të mos e pranosh"***, ndërsa ajo i përgjigjet: O i Dërguar, po e pranoj ashtu siç ka dashur prindi im, por unë desha që ta dinë femrat se nuk kanë të drejtë prindërit t'u imponojnë atyre diçka.

Në Sahihun e Muslimit, Sunenin e Ebi Davudit, Tirmidhiut, Nesaiun dhe në Muveta, transmetohet se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: ***"E veja ka përparësi për veten e saj ndaj kujdestarit të saj, ndërsa beqarja kërkon leje prej kujdestarit për veten e saj."***

Transmeton Ebi Hurejrete r.a. se pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: ***"Nuk martohet e veja derisa të thotë: Po – haptazi, ndërsa nuk martohet beqaresha derisa të kërkohet leje prej saj."***

Sarhasiu në librin "El Mebsut" tregon se Ebu Bekri r.a. e ka martuar vajzën e saj Ajshen r.a. me të dërguarin e Allahut s.a.v.s. pa arritur moshën e pjekurisë, mirëpo kur ka arritur moshën e pjekurisë, nuk i është lënë hapësirë që ajo me pranua apo mos me pranua martesën, ndërsa po të kishte qenë e rritur, do të kishte zgjedhur ashtu qysh kanë pasur të drejtë të zgjedhin kur ka zbritur ajeti i të drejtës për zgjedhje." Shiko librin "Mebsut", fq. 214

TË FEJUARIT DHE KOHA BASHKËSHORTORE

A lejohet të takohet i fejuari me të fejuarën para martesës, ashtu qysh po praktikohet në kohën bashkëkohore, dhe cili është kufiri, që lejon ta shoh i fejuari të fejuarën e tij?

Përgjigje: Kur ia kam parashtruar këtë pyetje Shejh Shaëravijut u përgjigj:

Takimi dhe shëtitja e të fejuarit me të fejuarën, siç po praktikohet në kohën bashkëkohore është një traditë e cila nuk përkon me sheriatin.

Imami i mirënjohur sqaron më tutje se: Sa më shumë që të zgjasë afati i kohës së fejesës, Allahu dëshiron që ajo (martesë) të mos realizohet.

TË ZBULUARIT TË ORGANEVE GJENITALE NË MES TË BASHKËSHORTËVE

A është mëkat që bashkëshortët me i zbuluar organet gjenitale para njëri-tjetrit, dhe me shikuar lakuriq njëri-tjetrin?

Më së miri për njeriun është që ai me qenë i arsyeshëm, i ndërgjegjshëm dhe i turpshëm. Kështu ka qenë Aliu dhe kështu si Aliu (Zoti e zbardhtë fytyrën e tij), edhe ne të jemi.

A KONTAKTOJMË SEKSUALISHT ME GRATË TONA NË XHENET

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s., se: A kontaktojmë seksualisht me gratë tona në xhenet? Në një tekst tjetër: A arrijmë te gratë tona në xhenet?

Është përgjigjur: ***"Pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti im, njeriu kontakton për një ditë me njëqind femra të pastra."***

Hafidh Ebu Abdullah el Makdisiju ka thënë: Transmetuesit janë të ndërlidhur sipas kushteve të hadithit Sahihë.

A PASTROHET PROSTITUTI ME EKZEKUTIMIN E TIJ

Cili është dënimi i prostitucionit, i cili pastron prostitutin?

Dallon dënimi i prostitucionit varësisht prej individit.

Nëse prostituti është i pamartuar, pra ai i cili asnjëherë nuk ka pas bashkëshorte, dënohet me njëqind të rëna dhe internim një vit. Edhe e pamartuara dënohet njësoj, për dallim nga i pamartuari, e pamartuara nuk internohet një vit nëse internimi i saj shkakton pasoja më të mëdha. Për këtë Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Prostitutën dhe prostitutin dënojeni secilin prej tyre me nga njëqind të rëna."

Argument tjetër për këtë kemi thënien e Omerit r.a. se "Muhamedi a.s. i ka dënuar me njëqind të rëna dhe i ka internuar. Po ashtu Ebu Bekri r.a. i ka dënuar me njëqind të rëna dhe i ka internuar. Kështu ka vazhduar edhe Omeri r.a., i ka dënuar me njëqind të rëna dhe i ka internuar." (Buhariju)

Nëse prostitucioni është prej të martuarit, ose prej të martuarës, dënohet me gurëzim deri në vdekje.

Kjo nga shkaku se ajeti është lexuar, por pastaj është shfuqizuar të shkruarit dhe ka mbetur ligji: **"I martuari dhe e martuara nëse bëjnë prostitucion, atëherë dënoni me gurëzim deri në vdekje, si ndëshkim prej Allahut. Allahu është i fuqishëm, i urtë."**

Po ashtu argument kemi se, Muhamedi a.s. i ka gurëzuar Gamidijën dhe Maizin, pra ashtu i ka dënuar dy jehuditë. Këto argumente të hadithеve janë të vërtetuar në hadithe Sahihë.

SHPIRTI I NJERIUT DHE LËVIZJA E GJALLESAVE

Çka është shpirti dhe kur depërton në embrion?

Këtë pyetje ia kanë bërë Muhamedit a.s., ndërsa atij i është thënë prej Allahut: **"Thuaj: Shpirti është prej çështjeve të Zotit, e juve u është dhënë vetëm pak dituri."**

Mbetet çështja e pazgjidhur sepse nuk ka mënyrë, e cila përkufizon shpirtin, mirëpo vetëm e kuptojmë në bazë të ekzistimit në gjallesë apo në trup i cili ka shpirt. Edhe në botën fizike, ka shumë çështje të cilat edhe me

eksperiencën tonë nuk mundemi me i definua, por i njohim vetëm në bazë të dukurisë së tyre. P.sh. ti deri më sot nuk mundesh ta përkufizosh dritën e rrymës elektrike, por e di vetëm në bazë të asaj se bën dritë.

Pyetja: Zhvillimi a është argument i ekzistimit të Shpirtit?

I nderuari Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Jo, kurrsesi jo. Kjo është një përzierje e çështjes, sepse ato e konsiderojnë çdo gjë që rritet e zhvillohet, por nuk kanë shpirt, edhe pse kanë jetë. Pra jeta ekziston në bimë edhe pse në to nuk ka shpirt, megjithatë, ato rriten dhe zhvillohen.

Po si qëndron shpirti në kafshë?

Kur ia parashtruam këtë pyetje Muhamed Muteveli Shaëravijut, u përgjigj:

Mos thuaj se në kafshë ka shpirt. Sepse edhe pse ka zhvillim dhe gjallëri të kafshëve, gjallëria në to është i ngjashëm me gjallërinë e bimëve, e kjo do të thotë gjallëria e bimëve nga poshtë lartë (vertikalisht). Pra, në to ka zhvillim, lëvizje dhe çështje tjera me të cilat e kuptojmë se bimët janë të gjalla. Po lulja e plastikës a thahet, jo sepse në të nuk ka jetë, e, prej specifikës së lules natyrale është se ajo thahet, e kjo dëshmon se në të ka jetë (gjallëri).

Këtë e sqaron Shejh Shaëraviju edhe më shumë kur thotë:

Njerëzit mundohen, me fjalë tjera, dëshirojnë të thonë se: "jeta është shpirt." Jo nuk është ashtu. Duhet të bëhet dallimi mes jetës dhe shpirtit.

Ka dallim të madh në mes të jetës dhe gjallërisë së kafshëve dhe jetës dhe gjallërisë së bimëve.

Pyetje: Po cila është gjallëria e kafshëve?

Përgjigje: Është zhvillimi dhe gjallëria e embrionit në 120 ditët e para të shtatzënisë.

Kjo është jeta, pas së cilës Muhamedi a.s. ka thënë (se pas 120 ditëve) pastaj Allahu i dërgon një melek dhe e frymon me shpirt.

Ky është shpirti i njeriut, shpirti i cili depërton apo vendoset në

embrion pas 120 ditëve të shtatzënisë, mirëpo, para kësaj ka pas zhvillim dhe rritje por nuk ka pas shpirt në të.

Pyetje: Cilat janë dukuritë apo shenjat e shpirtit në trup?

Përgjigjja: Lëvizjet dhe zhvillimi, e pastaj i vjen njeriut shpirti dhe logjika. Kur shtatzënia ndien lëvizjet e foshnjës në trupin (barkun) e saj, mund të themi se në embrion është vendos shpirti? Jo, kurrsesi jo. Aty është zhvillimi i gjallesës.

Dukuritë e shpirtit të njeriut kuptohen, apo me fjalë të tjera, është specifika e logjikës. Kjo është specifika e shpirtit të njeriut, gjë e cila nuk është te kafshët.

Pastaj Imami i mirënjohur shton:

Pjesët organike të lepurit janë të ngjashme me të njeriut, cili është dallimi në mes tyre?

Dallimi mes njeriut dhe lepurit është mendja dhe logjika. Imami i njohur thotë: Unë kam mundësi ta mësoj majmunin, pra ai merr diturinë prej meje, mirëpo ai nuk mund t'ia përcjell tjetrit majmun atë që e mëson, dhe nuk mund ta trashëgoj diturinë.

VEZORJA E FEMRËS

Cili është roli i femrës në procesin seksual?

Kur ia parashtruam këtë pyetje Shejh Shaëravijut tha:

Kam lexuar një punim shkencorë të ri në lidhje me vezoren e femrës gjatë kontaktit martesorë në lidhje me atë se çfarë roli ka në formim të embrionit apo nuk ka fare.

Pastaj foli për përzierjen dhe formimin e embrionit, kur të bashkëdyzohen mashkullori (x y) dhe femërori (vezorja) (x x), dhe tha se, sperma e femrës – vezorja e saj nuk është prodhuese e embrionit por prodhues është sperma – mashkullori i mashkullit.

Për këtë arsye edhe Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"Dhe ka bërë prej tij dy gjinitë: mashkullin dhe femrën." Pra, Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: *"prej tij"* (gj.m.) e nuk ka thënë *"prej saj"* (gj.f.).

Ndërsa në lidhje me vezoren e femrës, Imami i nderuar thotë: Vezorja (sperma e femrës) është indiferente – jo aktive në shtatzëni, pra jo parësore. Pastaj, vazhdon e thotë: Pejgamberi a.s. ka thënë: **"Kur mashkulli derdhet para femrës, foshnja i ngjason atij, ndërsa nëse femra derdhet para mashkullit, i ngjason asaj."** Këtë pikë Shaëraviju e sqaron kur thotë: Nuk thuhet pra nuk është qëllimi kush derdhet përpara, mashkulli apo femra, por ka për qëllim formimin e embrionit prej x y ose x x.

Ky shpjegim dhe arsyetim biologjik dhe medicinal është i shkëlqyeshëm.

KU ËSHTË DALLIMI NË MES TË DITURIT DHE DIJETARIT?

Përgjigjja: I dituri është a i cili ka bagazh të çështjeve dhe i sqaron ato, ndërsa dijetari (eksperti) i shikon gjërat shumë shumë më larg se i dituri.

Shejh Shaëraviju pastaj thotë: Njerëzit mendojnë se dijetarë janë vetëm ata që veshin shallat e bardhë dhe e kryejnë Universitetin e Ez-herit. Jo. Jo! Secili që mëson ndonjë dispozitë prej dispozitave islame dhe atë ua sqaron të tjerëve, ai është i ditur për atë çështje.

Muhamedi a.s. ka thënë: ***Zoti e ndriçoftë njeriun i cili e dëgjon fjalimin tim, e ruan, e pastaj e përcjell. Ndonjëherë përcjellësi i diturisë është më ruajtës se vetë dëgjuesi (i cili e mban në vete).***

ÇKA THOTË ISLAMI PËR MISHIN E KAFSHËS SË ÇMENDUR?

"Juve u janë ndaluar (t'i hani): ngordhësirat, gjaku, mishi i derrit, ajo që theret jo në emrin e All-llahut, ajo që furet, e mbytura, e rrëzuara, e shpuara (nga briri i tjetrës), ajo që e ka ngrënë egërsira, përveç asaj që arrini ta therni (para se të ngordhë), ajo që është therur për idhuj dhe (u është e ndaluar) ta kërkoni me short fatin. Kjo është mëkat ndaj All-llahut." (El Maide, 3)

Imami i mirënjohur, Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë:

Në supermarket jehudët e hanë trurin e viçit, me fjalë tjera, pasi që ta humbin vetëdijen dhe të bien për toke. Ata nuk munden me pre, për shkak se janë të fuqishme, për këtë arsye i mëshojnë në tru për ta dobësuar, për t'ia humbur baraspeshën, që me ra në tokë, e pastaj me lehtësi e prenë, e pastaj e hanë atë mish.

Por, për ne, na mjafton që ata nuk e përmendin emrin e Allahut kur e prenë.

Koment:

Disa kafshë të egra nuk mund ta bindin gjininë femërore të llojit të tyre, që me to vullnetarisht të kontaktojnë seksualisht, për këtë arsye ato me brirët e mprehtë të tyre i detyrojnë ato që të dorëzohen dhe vetëm me dhunë mund të bëjnë marrëdhënie seksuale. Veterinarët këtë kontakt seksual e quajnë "Arma e seksualitetit".

Duhet të dallojmë këtë, sepse nuk është njëjtë marrëdhënia seksuale te kafshët dhe te njeriu, sepse njeriu kënaqet seksualisht atëherë kur kontakti bëhet me pëlqimin e dy palëve. Për këtë arsye ai kontakt seksual shton bukurinë, kënaqësinë dhe lumturinë e të dyja palëve.

ABORTIMI SIPAS MJEKËSISË DHE FESË

Pyetje: Cili është mendimi i Islamit për abortimin?

Përgjigjja: Asnjëherë nuk lejohet, pos nëse është çështja e cila ndërlidhet më shëndetin e shtatzënës.

Ka mjete tjera për mos-shtatzëni, p.sh. mos ejakulimi i mashkullit në mitër (tërheqja e organit mashkullor para ejakulimit). Pra, për këtë ka të drejtë, pasi që pajtohesh me bashkëshorten.

Dhe çka tjetër është e pranuar në abortim?

Patjetër duhet të jetë para 120 ditëve të shtatzënisë, sepse para kësaj kohe nuk ka depërtua shpirti në embrion.

Shejh Shaëraviju sqaron çështjen se dijetarët e kanë lejuar abortimin

në 120 ditët e para të shtatzënisë, pra, para se me i ardhur shpirti fëmijës.

Këtë e argumenton me hadithin e Muhamedit a.s. të cilin e transmeton Ibn Mes'udi: ***"Çdo njeri formësohet në barkun e nënës së tij, kështu: nutfetun (gjak i ngjizur) 40 ditë, pastaj alekatun (copë mishi), pastaj mudgatun (eshtra të mbuluara me mish), pastaj e dërgon një melek, i cili e frymon me shpirt."***

Pyetje: A nuk do të thotë se abortimi para 120 ditëve është krim për embrionin?

Shejh Shaëraviju përgjigjet: Për këtë shikojmë nëse njeriut i bëhet padrejtësi në trupin e tij, apo në të si njeri. Njeri me trup është njeriu i cili vetëm quhet njeri, ndërsa njeri i vërtetë bëhet vetëm pas 120 ditëve, kurse para 120 ditëve është paranjeri, apo përgatitja për njeri.

Në këtë Shejh Shaëraviju argumentohet me lavrat e bletës. Ai thotë:

Lavrat e bletës, unë atyre u them lavra. Pra unë nëse e vendosi lavrën për t'u bë bletë, mirëpo a është me të vërtet bletë, natyrisht se jo.

Pyetje: Mirëpo, shuarja e jetës së diçkaje a nuk është haram?

Përgjigje: Kur ti i thyen lavrat e bletës, a do të thotë se ti ke bërë krim ndaj bletës?

Pyetje: Pra, kjo do të thotë se nuk ka ndërlidhje shpirti me lëvizjen trupore ...

Përgjigje: Shpirt i njeriut do të thotë atëherë kur njeriu funksionon me të gjitha pjesët e trupit të tij, sikurse kafsha, mirëpo pastaj më nuk është kafshë. Lepuri i cili me konstruktin e tij është i përafërt me njeriun, ai nuk është njeri, sepse meleku nuk e ka frymëzua me shpirt për të qenë njeri, ndërsa tjetri trupi kur meleku e frymëzon me shpirt bëhet njeri, sepse ai ka cilësinë e intelektit, mendjes dhe mësimit, ai ka cilësi mbi epshin.

Shejhu na sjell rregull të fortë shkencore: Të gjitha çështjet që rriten dhe zhvillohen si bimët, po ashtu edhe gjallesat tjera pos njeriut, detyra e tyre është instinkti dhe nuk ka të bëjë mendja me ta, njeriu me mendjen e tij zgjedh çështjet, ndërsa zhvillimi i bimëve dhe gjallesave jo.

Imami i mirënjohur na jep edhe dispozitë të sheriatit dhe fetva të rëndësishme dhe shumë serioze kur thotë: Abortimi assesi nuk lejohet pos nëse është në pyetje shëndeti i femrës(nënës). Ndërsa siç vërteton Shejhu i mirënjohur se gjallesat dhe bimët tjera nuk e kanë funksionin e zgjedhjes.

Nëse i mëshon maces, ajo nuk të përgjigjet, ajo e ka vetëm një funksion me bë "miau", ndërsa sa i përket njeriut ai është i konstruktuar me i zgjedh çështjet, e kjo është si rezultat i trurit të mendjes.

STERILITETI ME QËLLIM DHE SPIRALJA PËR MOSSHTATZËNI

Cili është mendimi i sheriatit në lidhje me sterilitetin me qëllim dhe vendosjen e spirales.

Përgjigje: Haram, haram, haram, dhe ky është mendim unanim i të gjithë ekspertëve jurist islam, pa marrë parasysh kushtet dhe rrethanat, pos nëse është në pyetje (konstatohet) dëmtimi i vet mitrës së femrës, sepse dituria e mjekut nuk është si dituria e Allahut, femra nuk është mjet mekanik. Mjekët asnjëherë nuk munden me ditë se kur Allahu mund t'ia rikthej shëndetin.

Ai i cili furnizon me fëmijë, mund t'i merr të gjithë ata (të vdesin) dhe njeriu ka nevojë për fëmijë përsëri.

Ndodh që femra lind dy apo tri herë por me operacion nga barku, pastaj ne mendojmë se nëse edhe njëherë lind i kanoset rreziku i vdekjes, e për këtë arsye nevojitet me ndërhy në mitër me vendos spiralen.

Përgjigje: Shejh Shaëraviju, prapëseprapë qëndron kategorik në mendimin e tij dhe thotë: Kjo është sipas llogarive tua, ndërsa Krijuesi i ka llogaritë e tij mbi tuat, dhe ti nuk ke kompetenca aty.

Kështu është përgjigjur në këtë pyetje e cila ka rëndësi të madhe dhe që është serioze.

Pyetje: po si të lejohet abortimi kur është në pyetje shëndeti i shtatzënës ndërsa nuk lejohet steriliteti me qëllim, kur është e mundur që nëse

edhe njëherë jetë shtatzënë i dëmtohet shëndeti?

Përgjigje: Dëmtimi, rreziku i shëndetit te shtatzëna është e sigurt ndërsa për atë se çka ndodhë në të ardhmen (nëse jetë shtatzënë) është në diturin e Allahut, dhe është çështje e Allahut, e ti nuk ke njohuri për të, me fjalë tjera nuk është çështje e jotja.

PËRDORËZIMI I MASHKULLIT ME FEMRËN

Pyetje: Pa marr parasysh qëllimin, a lejohet që femra të përdorëzohet (të përshëndetet për dore) me mashkullin?

Përgjigje: Femra nuk lejohet të përdorëzohet me mashkullin. Po nijeti qëllim para selamit apo pas selamit.

Natyrisht nijeti para selamit e jo pas tij.

Pastaj Imami i mirënjohur shton:

Po supozojmë se ndonjëri e ka nijetin e mirë, mirëpo ligji ligjësohet për shkak të shumicës.

Femra duhet të jetë e ndërgjegjshme dhe e turpëruar për të gjithë. Kjo është vija e prerë dhe e trashë për ti ngacmua ndjenjat e nxehta.

RREGULLIMI (HEQJA E QIMEVE) I VETULLAVE TË FEMRËS

Pyetje: Heqja e vetullave për bukurinë e fytyrës haram apo hallall?

Përgjigje: Sikurse zgjatimi i flokëve nëse pengon lejohen të shkurtohen.

Muhamedi a.s. ka thënë:

"I ka mallkuar Allahu heqëset e vetullave të tyre, heqëset e vetullave të tjerëve, tetoviruesit dhe të tetoviruarat, vendosëset e parukave dhe ata të cilët i ndryshojnë krijesat e Allahut." (E ka regjistrua Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu)

Pyetje: Rrobat e gjëra, a janë domosdoshmëri për femrën?

Përgjigje: Me kusht që mos të jenë të tejdukshme dhe tërheqëse.

Kjo për arsye se të gjitha moshat dhe strukturat e shoqërisë e përcjellin atë kur shkon e vjen, e me atë ajo mund t'i provokoj ndjenjat dhe epshet e të gjithëve, e edhe të pafajshmit, sepse i nxen ndjenjat e të gjithëve, gjë që e cila shkakton shtrëngimin e gjoksit dhe të shpirtit.

Për këtë arsye Islami ka për pikësynim që femra të jetë e moralshme, që gjatë ecjes të jetë e matur dhe fisnike, po që se është plakë, ose jo e bukur dhe e rrudhur.

ZGJATIMI I THONJVE

Ishim në shtëpinë e Shaëravijut, kur një motër muslimane e pyeti: Zgjatimi i thonjve a është haram apo hallall?

Imami i nderuar u përgjigj: Njeriu është qenie në shkallën më të lartë të humanitetit, pra të mirëqenies. Shkurtimi i thonjve është ligjësua sepse thonjtë dhe zgjatimi i tyre është për bishat dhe egërsirat dhe pasi që ka arrit civilizimi nuk ka thonj të gjatë, sikurse çdo mjet tjetër i cili nuk përdoret vetëm për atë çka është i destinuar, ndërsa nuk përdoret për diçka tjetër.

Muhamedi a.s. ka thënë:

Pesë çështje janë natyrshmëri: Sunetia (rrethprerja)...Me një transmetim tjetër***... të rruarit e pjesëve të turpshme, shkurtimi i mustaqeve, shkurtimi i thonjve dhe të rruarit e nënsqetullave.***

(E ka regjistruar Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi dhe Ahmedi)

Enesi r.a. ka thënë: Na ka përkufizuar, në një transmetim tjetër "Na është përkufizuar", prej të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. shkurtimin e mustaqeve, shkurtimin e thonjve, të rruarit e nënsqetullave dhe të rruarit e vendeve të turpshme, që mos të jetë më shumë se 40 net.

Transmeton Muslimi, Ebu Davudi, Nesaiju dhe Tirmidhiu

NJË FEMRËS TË CILËS I PËLQEN NJË MASHKULL

Pyetje: Një femër e pëlqen një mashkull dhe dëshiron të martohet me të, si duhet të veprojë? A t'ia paraqet atij dëshirën e saj apo jo?

Përgjigje: Ia tregon kujdestarit (prindit) të saj çështjen dhe dëshirën e saj.

SHOQËRIMI I BASHKËSHORTIT ME BASHKËSHORTEN NË UDHËTIM

Sot është shumë lehtë me udhëtuar prej një vendi në një vend tjetër, pa lodhje e pa probleme. Vrapimi për risk, pasuri dhe sigurimi i ekzistencës për të parët tanë ka qenë në hulumtime shkencore, çështje politike, diplomatike, haxh dhe në çështje tjera të përfitimit të diturisë.

Është bë shumë lehtë edhe për çdo njeri të rëndomtë qoftë edhe jo tepër i zgjuar me u sjell rreth botës, qytet për qytet, sa që mundet mos me e kthyer në shtëpi disa muaj, bile edhe vite të tëra.

Këtë pyetje ia kam parashtruar Muhamed Muteveli Shaëravijut i cili është përgjigjur:

Për burrin nuk lejohet për të udhëtuar vetëm nëse nuk është i sigurt për vetën e tij, është haram, e mos të flasim për femrën.

ZËRI I FEMRËS

Pyetje: Zëri i femrës a konsiderohet pjesë e turpshme?

Po, nëse ai zë është për me tërheq mashkullin.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Dhe mos flisni me fjalë tërheqëse dhe zë tërheqës e që me atë zë të lakmoj ai i cili e ka zemrën e sëmurë."

A LEJOHET QË PRINDI ME FEJUA VAJZËN E TIJ

Kjo shihet qartë me qëndrimin e Shuajbit me Musa a.s.:

Tha: "Vërtet unë dëshiroj që të të martoj me njërën prej këtyre dy bijave të mia, me kusht që të më shërbesh tetë vite, ndërsa nëse ti dëshiron mund t'i plotësosh dhjetë vite."

Omeri, po a e di kush ka qenë Omeri, Dalluesi i Islamit, Ai me të cilin Allahu e ka nda të mirën prej të keqes, të vërtetën prej të pavërtetës. Vajzën e tij Hafsen ia ka ofrua me fejuar Ebu Bekrit, mirëpo ai se ka pranuar, pastaj ia ka ofruar për ta fejuar Uthman Bin Afanit, por edhe ai ka refuzuar. Omeri r.a. për këtë çështje ka ndie dhembje të madhe, dhe mërzi pas mërzie, pastaj e ka martuar për Muhamedin a.s.. E kjo ka qenë nderë për të sepse është bë nëna e besimtarëve.

Ebu Hurejre r.a. transmeton se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: ***Nuk martohet e veja pa e marr pranimin prej saj dhe nuk martohet beqarja pa u pajtuar ajo.***

SHKURTIMI I FLOKËVE

Pyetje: A lejohet që femra t'i shkurtojë flokët e saj?

Përgjigje: Jo kurrsesi, ... pasi që në ta e sheh bukurinë e saj (është bukuria e saj).

DËGJIMI I KËNGËVE

Pyetje: Cili është vendimi i sheriatit për dëgjimin e këngëve prej këngëtarëve dhe këngëtareve?

Përgjigje: Të largojnë nga devotshmëria, dhe dëgjimi i urdhrave të Allahut, dhe ia humb njeriut drejtpeshimin.

Nuk ka mirësi prej të mirës pas së cilës është zjarri dhe nuk ka të keqe prej të keqes pas së cilës është xheneti.

Patjetër duhet me i vendos në peshojë fillimin e çështjeve me përfundimin e tyre.

DUAJA MË E MIRA

Cila është duaja më e mira për me iu lutur Allahut?

Kur iu është parashtruar kjo pyetje Shejh Shaëravijut është përgjigjur: Është duaja të cilën ia ka mësuar Pejgamberi s.a.v.s. Aishes :

" O Zoti im, vërtet ti je Falës (Ai që i shlyen mëkatet), i do falësit, më falë mua."

BURRI I SËMURË PSIKIKISHT

Një grua muslimane më ka dërguar një letër ku kërkonte sqarim, si të bisedoj dhe si të vazhdoj jetën me burrin e saj, pasi që jeta e saj me të është bë e padurueshme dhe xhehenem. Ajo është martuar me të kur ai ka qenë i shëndoshë psiqikisht, i mençur dhe i logjikshëm, mirëpo papritmas është sëmurë psiqikisht, dhe ka kaluar në skizofreni, kështu që ai nuk e kontrollon veten, ndërsa edhe mua më është bë jeta e padurueshme dhe xhehenem.

Si të veproj nuk di?

Unë dëshiroj shkurorëzim, por pyetja është a kam të drejtë apo jo?

Kjo pyetje më ka impresionuar shumë, dhe kam thënë "Subhanallah". Kur njeriu çmendet, nuk vlenë asgjë, dhe farefisi më i afërt ikin dhe largohen prej tij.

Ia kam parashtruar këtë pyetje Shejh Shaëravijut i cili u përgjigj:

E parashtron kërkesën te Kadija (gjykatësi), pastaj tha: Kjo është e metë, e cila nevojitet të identifikohet.

FOTOGRAFIMI

Disa dijetar vëllezër muslimanë thonë se fotografia është absolutisht e ndaluar-haram, sepse fotografia i pengon Melekët me hy në shtëpi, sikurse i pengon qeni, ashtu sikurse i ka thënë Xhibrili alehjis selam Pejgamberi s.a.v.s. "Ne nuk hyjmë në shtëpinë ku ka fotografi dhe qenë". Këtë çështje e kan marrë në mënyrë absolute. Mirëpo ne nëse shikojmë urtësinë e fikhut dhe të sheriatit shohim se Hadithi ka pas për qëllim në pikturat të cilat i pikturon njeriu.

Për këtë arsye këtë pyetje ia kam parashtruar Imamit të mirënjohur Muhamed Muteveli Shaëravijut i cili u përgjigj:

Fotografimi është harmonizim dhe në përputhshmëri me origjinalitetin, në të nuk ka cungim, mangësi apo ndryshim nga origjinaliteti.

Shejh Shaëraviju mendon se fotografimi nuk është gjë përderisa nuk i shmanget dhe nuk cungohet nga origjinaliteti.

NGRËNIA HAPTAS DITËN NË RAMAZAN

Cili është vendimi i sheriatit për personin i cili han haptazi ditën gjatë muajit ramazan?

Përgjigje: I tërhiqet vërejtja (dënim për kundërvajtje).

TËAZIRË, është dënim edukues, me të rëna, me mallkim, ndërprerja e marrëdhënieve me të ose me internuar.

Aktivizimi i këtij dënimi (TEAZIRIT) është obligim në çdo mëkat, dhe sheriati nuk e ka përkufizua këtë lloj dënimi, për këtë arsye nuk ka kompensim siç është rasti i vjedhjes, kur nuk e arrin shumën për t'iu pre dora (NISABIN), apo prekja e femrës së huaj, puthja e saj, sharja e muslimanit (po jo akuzim për prostuticion), të mëshuarit, rrahja pa lënduar ose pa u thyer ndonjë pjesë trupi.

Ligjet e TEAZIRIT janë: Nëse është rrahje mos me qenë më shumë se dhjetë të rrahura me shkop. Kjo, nga thënia e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. ku thotë: ***"Asnjëri mos të shkopohet më shumë se me 10 shkopinj, përpos***

me dënim prej dënimeve që i ka parapa Allahu". (MUTEFIKUN ALEJHI)

Gjykatësi duhet të marrë përcaktimin e dënimit të TEAZIRIT sipas asaj që ai e parasheh më të përshtatshme. Nëse është sharje, mjafton masa ndëshkuese nënçmim, por nëse është burgim një ditë e një natë, të jetë ndëshkim për edukim, pra si masë edukuese.

USHQIMI I PARË I BANORËVE TË XHENETIT

Cili është ushqimi i parë me të cilin do të ushqehen xhenetlinjtë?

Kur është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për këtë çështje është përgjigjur: ***"Yndyra e mushkërive të peshkut".***

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. : cili është ushqimi në përgjithësi:

Është përgjigj:***"U përgatitet atyre mështjerrë e xhenetit e cila është ushqye prej xhenetit". (MUTEFIKUN ALEJHI)***

Cila është pija e tyre:

Është përgjigjur: ***Pije nga burimi i quajtur Selsebilë. (MUSLIMI)***

DËNIMI NË VARR PËR TË PËRMBYTURIT NË UJË, TË DJEGURIN DHE TË COPËTUARIN (TË CILËT NUK VARROSEN)

A dënohet në varr i përmbyturi në ujë, i djeguri, i copëtuari të cilën e han egërsira dhe ia shpërndajnë pjesët e trupit?

Përgjigje: Po, jep përgjigje në varr me të gjitha pjesët e tij, Zoti i Lartmadhëruar në Kur'anin fisnik ka thënë: **"Ne veç e kemi ditur sa dhe çka prej tyre pakëson dhe tretë toka, dhe te Ne është libri i sigurt dhe i ruajtur."**

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: O i Dërguari i Allahut: Si do të na tuboj Zoti ynë pasi që të na bartin erërat pjesët tona dhe të hajn egërsirat prej trupave tonë?

Muhamedi a.s. është përgjigj: ***"Po ju tregoj se kjo është e gjithë në***

kompetencën e Allahut. E tërë toka shikohet (kontrollohet) nga qielli dhe ajo është si copëz e lagur dhe i thuhet: Mos gjallëro fare, pastaj Allahu i thotë qiellit, nuk të kanë mbetur vetëm pak ditë, pastaj Allahu e kontrollon atë dhe ajo është si një gllënjkë (pikë uji). Për Zotin, Ai ka mundësi të ju tubojë prej uji, ashtu siç i tubon bimët në tokë".(E ka regjistruar Ahmedi)

NAMAZI I MESËM

Është pyetur Muhamedi s.a.v.s. për namazin e mesëm, ka thënë: ***Ai namaz është namazi i ikindisë.***

Është pyetur: Cili namaz është më i vlefshmi?

Është përgjigj: ***Më i gjati me lutje e përkushtueshmëri.(AHMEDI)***

A ka ndonjë moment ku robi i Allahut është më afër Allahut se në momentet tjera?

Muhamedi a.s. ka thënë: ***Po, momenti i thellë dhe i mesit të natës. (NESAIJU)***

VLERA E DITËS SË XHUMASË

Cila është vlera e ditës së xhumasë?

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për çfarë arsye është vlerësua dita e xhumasë nga ditët tjera?

Është përgjigj: ***Sepse në këtë ditë është krijua Ademi prej dheut, në këtë ditë do të jetë dita e krismës së kiametit, në të do të bëhet ringjallja, në tri orët e fundit është një orë në të cilën Zoti e pranon duanë e lutësit.***

Po ashtu Muhamedi s.a.v.s. për orën në të cilën pranohet duaja në ditën e xhumasë.

Është përgjigj: ***Prej kur fillon falja e namazit e deri të përfundon.***

Nuk ka kundërthënie në mes të këtyre dy haditheve sepse ora e pranimit të lutjes është ora e fundit të ditës, pra pas ikindisë, koha (ora) në të cilën falet namazi i xhumasë është koha e cila ka përparësi për pranimin e lutjes, ashtu sikurse xhamia e parë e cila është ndërtua për lutje e devotshmëri është Mesxhid Kuba, ndërsa Mesxhide i Pejgamberit s.a.v.s. ka përparësi, pra nëse është në pyetje falja e namazeve nafile në ndonjërën prej këtyre dy xhamive, përparësi ka xhamia e Pejgamberit s.a.v.s. .

ZEKATI I FITRIT

Zekatul fitri është vaxhib ajn për muslimanët, kjo argumentohet me thënien e Ibn Umerit r.a.: Muhamedi a.s. e ka bë obligim Zekatul fitrin e Ramazanit një sa prej hurmeve, një sa prej grurit qoftë për robin, të lirin, mashkullin, femrën, të voglin ose të madhin prej muslimanëve. (MUTEFIKUN ALEJHI)

Pyetje: Urtësia apo arsyeja e Zekatul fitrit?

Përgjigje: Pastrimi i muslimanit prej çështjeve të cilat kanë pasur lidhje me fjalët e kota dhe të ndyta, e gjithashtu mos me ndodh që në ditën e Bajramit të varfrit me kërkua lëmoshë, por para kohe me iu ndihmua atyre.

Ibn Abasi r.a. transmeton se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka bë obligim për pastrimin e agjëruesit nga fjalët e kota dhe të ndyta dhe ushqim për të varfrit. (E ka regjistruar Ebu Davudi, Ibn Maxhe dhe e ka vërtetuar Hakimi)

Muhamedi a.s. ka thënë: ***"Në këtë ditë mos lejoni që të kërkohet lëmoshë prej tyre (të varfërve)".(Bejhekiu me sened të dobët)***

URINA NË VENDURINIM (FSHIKËZ)

Urina tubohet në trupin e njeriut (në qesen e urinës) dhe për të shpërthyer nuk e lejon rregullimi i organizmit, i cili vepron nën komandën e sistemit nervor, SEMPTAVIJ dhe GJARISEMPTAVIJ.

Nga kjo, sistemi nervor është baza qendrore, e cila jep urdhër të drejtpërdrejtë kanalit të urinës, për t'u hapur (liruar) ose për t'u mbyllur, në kushtet e rëndomta. Dhe nuk lejon që urina të kalojë nga ato, pos nëse ndodhë ndonjë sëmundje psikike (e sistemit nervor) ose sëmundjet tjera të kanalit të urinës, ose ato pjesë të sistemit nervor dobësohen ose shkatërrohet dhe nuk mund të dirigjoj apo të kontrolloj urinën.

Shumica e të sëmurëve prej sëmundjes prostate, të cilët lëngojnë nga ndezjet e tepërta, të cilat janë të pashërueshme ose vetëm të sëmurët me Prostatë ankohen me daljen e pikave të urinës pa dëshirën e tyre, gjë që shkakton prishjen e abdesit të tyre. Ky është shkaku pse e pyes të nderuarin Imam Shejh Shaëravijun.

Përderisa urina është në kanalin e urinës nuk e prish abdesin dhe gusulin, e cila veç është në trup të njeriut, atëherë pse pikat e urinës prishin abdesin, pasi që dalin nga organi seksual pas marrjes së abdesit. A nuk është kjo njësoj sikurse urina në kanalin e urinës, i cili nuk ndikon në prishjen e abdesit?

Imami i nderuar, Shejh Shaëraviju u përgjigj:

Përderisa urina është në kanalin e urinës, pra në trup ajo e luan rolin dhe detyrën e tij, gjë që është e domosdoshme të jetë aty, përderisa del prej kufijve të brendshëm në kufijtë e jashtëm bëhet i pavlefshëm dhe i pa përdorur, e që trupi më nuk ka nevojë për të.

Për këtë arsye, urina e prish abdesin nga arsyeja e daljes nga brendësia, pasi që është shndërruar në tepricë, fëlliqësirë dhe e papërdorshme, të cilën e ka dëbuar trupi i njeriut nga brendësia. Shembulli i saj është si shembulli i mbeturinave.

Zoti e shpërbleftë imamin, dijetarin dhe Shejhun tonë me të mira.

PUTHJA E HAXHERUL ESVEDIT

Pasi që ia kam parashtrua këtë pyetje të nderuarit Muhamed Muteveli Shaëravijut është përgjigj: "Puthja e haxherul esvedit është ligj i vërtetuar". Pastaj sqaron: Adhurimi edhe pse nuk i dihet shkaku e ka urtësinë e tij.

Urtësia dhe arsyeja e adhurimit është në atë se mjafton që është prej Allahut. Allahu nuk e obligon askënd tjetër, pos ato që i do.

Obligimi prej Allahut është nder për robin e tij.

Shejh Shaëraviju në fund thotë: Është shumë interesante çështja e besimtarit me Zotin e tyre. Allahu e obligon atë që e do, dhe secili obligim nuk ka vështirësi.

DËNIMI ME BURG NË ISLAM

Pyetje: A ka dënim me burg në Islam?

Përgjigje: Jo, nuk ka pas burgje në kohën e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s., por ka pas internim dhe ka qenë i caktuar vendi i internimit.

Për këtë arsye, burg në kuptimin bashkëkohorë nuk ka pasur.

Muhamedi a.s. e ka burgos mëkatarin në atë formë (pa e burgosur) sepse askush nuk i ka fol atij, ka ardhur e ka shkuar pa i folur askush, sikurse ka qenë rasti me tre të cilët nuk kanë shkuar në luftë.

Ebu Lubabete e ka burgos veten e tij vetë, në atë formë, sa që e ka lidh veten në një vend, pra e ka burgos veten dhe shtëpinë e tij dhe ka thënë: Nuk do të zgjidhem, dhe nuk do të lëvizë nga këtu derisa të vjen i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe më zgjidhë dhe më liron nga këtu.

TË NDALUARIT E ARIT DHE MËNDAFSHIT PËR MESHKUJT

Pyetje: Cila është arsyeja e ndalimit të arit dhe mëndafshit për burra e jo për femra?

Përgjigje: Kjo është dituri e cila edhe nëse dihet nuk të bënë dobi, po edhe nëse nuk mësohet nuk do të dëmton.

Mos pyet për arsyen (urtësinë) sepse kusht është te pyetja për ligjësimin e një çështje që urdhërmarrësi me qenë i barabartë me urdhërdhënësin. Njeriu patjetër duhet të pranoj urdhrin, sepse Allahu e ka urdhëruar ashtu.

Urtësia e çdo çështjeje është se Fukahatë në rend të parë kanë vepruar (e kanë krye urdhrin) pastaj e kanë kuptuar shkakun, arsyen dhe urtësinë, pastaj kanë thënë dhe nuk kanë dyshua asnjëherë në atë çka kanë veprua, pra për ta kuptua shkakun dhe arsyen.

Esenciale është se unë në rend të parë e pranoj urdhrin, i përmbahem asaj sepse Allahu më ka urdhërua për atë çështje, e tek pastaj hulumtoj për shkakun, arsyen dhe urtësinë e atij urdhri.

Transmeton Buhariju, Muslimi dhe Ahmedi se "i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka ndalu unazën e arit".

Transmetohet nga Ibn Abasi r.a. se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka pa unazën e arit në dorën e një njeriu dhe ia ka hequr e ia ka gjuajtur dhe ka thënë: ***"A dëshiron që ndokush prej juve me u djeg në gaca të Xhehenemit, për shkak se e mban në dorën e tij".***

Pasi që ka shkua i Dërguari i Allahut s.a.v.s. i kanë thënë atij njeriu merre unazën dhe shfrytëzoje për diçka tjera, por ai ka thënë: Jo, për Zotin nuk e marr kurrë, pasi që veç e ka gjuajtur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. (Transmeton Muslimi, Ibn Habani, dhe e ka vërtetuar Taberaniju).

Transmetohet nga Abdullah Ibn Umeri se Pejgamberi s.a.v.s. i ka pa disa prej Sehabeve me unazë të arit, dhe ia ka hequr atyre, dhe e ka gjuajt, dhe e ka marrë unazën e hekurit, e ka thënë: Kjo (unaza e arit) është sherr, kjo është stoli e banorëve të Xhehenemit, për atë arsye edhe e ka gjuajtur. Kur njëri prej Sehabeve e ka marrë unazën e argjendit, ka heshtur. (Transmeton Ahmedi, Buhariu me senedin e mirë dhe të vërtetë)

Po ashtu transmetohet se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: ***"Kush beson në Allahun dhe në ditën e gjykimit mos të vesh rroba të mëndafshta dhe mos të***

mbaj ari".(Transmeton Ahmedi nga Ebi Imameti Merfuan me sened hasen)

MOSAGJËRIMI I RAMAZANIT GJATË UDHËTIMIT

Pasi që në kohët e sotshme udhëtimi është i lehtë, komod dhe me pa vështirësi pasi që janë mjetet e transportit të cilat për një kohë të shkurt kalohen me qindra e mijëra kilometra, a e ka të drejtën e lehtësimit për mos me agjërua në udhëtim gjatë ramazanit?

Përgjigje: Mos e krahaso udhëtimin e djeshëm me udhëtimin e sotëm por krahaso: Udhëtimin e djeshëm me vendqëndrimin e djeshëm.

Udhëtimin e sotëm me vendqëndrimin e sotëm.

NJË MASHKULL KONTAKTON SEKSUALISHT ME NJË FEMËR E PASTAJ MARTOHET ME TË

Një njeri ka bë zina me një grua pastaj martohet me të, fëmija i lindur është i tij në sheriat, apo vetëm si respekt sikur ndaj çdo fëmije, e mos me marrë mbiemrin e tij.

"Ai është i tij dhe e merr mbiemrin e tij". Kjo me mendim unanim të dijetarëve (IXHMAË).

PRANIMI I ADHURIMIT DHE SHEJTANËT

Kam një shokë të mirë, të sjellshëm dhe personalitet i rrallë, ai bën adhurim të sinqertë vetëm për Allahun e Lartmadhëruar .

Gjuha e tij është e pastër, asnjëherë nuk flet fjalë amorale, nuk i afrohet punëve të këqija asnjëherë. Ndoshta kjo edukatë është shkak i rrethit të pastër ku është rritur e edukuar. Dhembshuria për të, dhe dashuria për të më ka shty ta pyes Imamin e nderuar Shejh Shaëravijun: A është e mundur që adhurimi i sinqertë vetëm për Allah, dhe nijeti i pastër i adhurimit me qenë, mirëpo përkundër kësaj Allahu mos ta pranojë?

Po !! shejtani ndërhynë në njeriun e mirë, ndërhynë në punën dhe aktivitetin e tij, sepse shejtani vazhdimisht tenton në ibadetin e të devotshmëve dhe të sinqertëve.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: Do të qëndroj te ta, dhe derisa ata janë në rrugën tënde të drejtë. Pra, është e mundur që shejtani të ndërhynë dhe ta ç'vleftësoj adhurimin e robit të mirë, Zoti na ruajt nga e keqja e shejtanit. O Zot na prano veprat, vërtet Ti je i ditur i dëgjon.

Cila është arsyeja e obligimit të xhematit në namazin e xhumasë?

Obligimi i xhematit në namazin e xhumasë, siç mendon Shaëraviju është se Allahu ka dëshirua që së bashku me dashur Zotin e Lartmadhëruar vazhdimisht, ndërsa me dashur Zotin veç e veç në namazet tjera, e kjo se adhurimi dhe dashuria duhet të manifestohet para Allahut të Lartmadhëruar pa dallim dhe të gjithë së bashku, nga kjo rezulton se njerëzit duhet me qenë të barabartë, dhe nuk lejohet kryelartësia dhe apriori.

Pastaj Imami i nderuar vazhdon:

Sikurse Allahu i Lartmadhëruar dëshiron të na thotë: Unë dëshiroj që të gjithë së bashku ta tregoni dashurinë dhe adhurimin ndaj meje, ashtu që të mos e sheh i dobëti të fortin, dhe të gjithë së bashku të përulur në sexhde, dhe se të gjithë njerëzit janë të barabartë para Allahut në adhurim. Për këtë arsye e ka ligjësua, me fjalë tjera e ka bë farz që të jetë xhemati në namazin e xhumasë, që do të thotë një herë në javë me pastrua veten nga kryelartësia sepse kryelartësia është cilësi e rrezikshme e njeriut.

Pastaj Imami i mirënjohur vazhdon:

Këtë adhurim Zoti i Lartmadhëruar veç na ka tregu në suretu "FATIHA" ai na mëson në këtë sure me thënë: **"Vetëm ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë"**. Pastaj pason duaja **"Na udhëzo në rrugën e drejtë"**. Mirëpo ti bën dua për veten dhe për tjetrin, tjetri bën dua për veten e tij dhe për ty. Dhe secili prej xhematit ka bë dua për njëri-tjetrin, pse ndoshta, njëri prej atij xhemati ka qenë i mirë dhe i sinqertë, e atij i pranohet lutja, e kur ti pranohet lutja atij, ai ka bë lutje për të gjithë. Zoti i Lartmadhëruar me fisnikërinë e tij ia pranon lutjen të gjithëve për nder të disa të mirëve në atë xhematë.

Pse Zoti i Lartmadhëruar ka urdhërua me u shpërnda në fytyrën e

tokës pas namazit të xhumasë. A do të thotë se për këtë ka ndonjë urtësi?

Imami i nderuar Shejh Shaëraviju thotë:

Nëse përqendrohemi në ajetin e Zotit të Lartmadhëruar:

"O ju të cilët keni besuar, kur të thërritet ezani për namazin e xhumasë shpejtoni me zell në përkujtimin e Allahut (faljen e namazit) dhe ndërpriteni shitblerjen (dhe çdo veprimtari tjetër). Kjo është më e mira për ju nëse e dini. Dhe pasi të përfundojë namazi shpërndahuni nëpër tokë dhe hulumtoni të mirat e Allahut, dhe kujtojeni Allahun shumë që të bëheni fitimtarë" (El-Xhumua, 10)

Shohim se koha e njeriut duhet të jetë e përqendruar në dy çështje: Në mes shfrytëzimit të begatisë, pra përfitimi prej tij dhe angazhimit në vet begatinë.

Çështja e parë: Kur të bëhet thirrja për namaz ditën e xhumasë, shpejtoni në falje të namazit duke përkujtua Allahun, dhe çështja e dytë: Dhe shpërndahuni në tokë. Shpërndarja në tokë ka për qëllim udhëheqjen në tokë. Pra aktiviteti dhe puna në tokë është pjesë e planprogramit të Allahut të Lartmadhëruar, dhe përderisa shpërndarja në tokë për jetesë duhet të jetë për atë çka i nevojitet njeriut në rend të parë, e ajo është rizku-furnizimi.

Pastaj Zoti i Lartmadhëruar thotë: **Dhe ecni mbi sipërfaqet dhe anët e saj (tokës) dhe hani prej furnizimit të tij.**

A është aktiviteti i njeriut dhe ecja nëpër sipërfaqen e tokës e cila sjell rizkun-furnizimin?

Imami, Shejh Shaëraviju thotë: Jo... Sa njerëz duke punua kanë dështua. Mos mendo se angazhimi dhe puna në tokë të sjell rizkun-furnizim, por ajo të shpie te rizku-furnizimi i cili është i krijuar dhe përgatitur në tokë.

Allahu për këtë na sqaron:

Dhe sikur dëshiron të na tregon se rizku-furnizimi është i fshehur në tokë, ndërsa puna jote nuk e krijon atë-rizkun, por vetëm të shpie tek ajo.

Dhe kjo arrihet me adhurimin e përbashkët dhe të vazhdueshëm në ditët e xhumasë.

GJUHA E KUR'ANIT A ËSHTË PO E NJËJTA GJUHË E ALLAHUT

Kur'ani i shkruar në mus-haf, të cilin e kemi sot a është po e njëjta fjalë e Allahut të Lartmadhëruar, apo ndoshta Allahu ka tjetër të folur e jo këtë të cilën e kemi të shkruar dhe e kemi në duart tona?

Jam përgjigjur në këto pyetje në librin tonë: "Mrekullia logjike në Kur'an" dhe e kam sqarua mendimin e Ibni Sinas në lidhje me këtë çështje i cili nuk e pranon atë fjalët e Kur'anit të shkruara në mus-haf janë po të njëjta fjalë (gjuhë) të Allahut. Ai mendon se Allahu ka të folur të cilën ne njerëzit nuk e dimë.

Zë quhet fonimi i prodhuar prej shtrëngimit të zërit.

Shkronjat nuk janë asgjë tjetër, pos tingull formues të cilat fillojnë prej pikënisjes së formimit të zërit, e cila është cilësi e prodhuar prej gjuhës së njeriut, e cila posaçërisht është për formim zërimi dhe nëpërmjet përbërjes së tij organike dhe fiziologjike e cila bllokohet në trup përkufizohet për të formuar organin për të kryer rolin e tij prej organeve të gojës, fytit, gjuhës, tejzave të zërit, të gjitha këto janë mjete të të folurit dhe mjete që formojnë zërimin dhe fjalë.

Pastaj Ibn Sina thotë: Është e pamundur që fjala e Allahut të Lartmadhëruar të përkufizohet apo të përcaktohet me organet fiziologjike në formë dhe mënyrë mekanike, pra trupore.

Do të ishte mirë që këtë pyetje t'ia parashtroj Imamit të mirënjohur, Muhamed Muteveli Shaëravijut, për ta shikuar çka mendon ai ë lidhje me këtë.

Imami i mirënjohur tha: Kur'ani është i shkruar në Mus-haf me shkronjat dhe formën e tij prej Allahut të Lartmadhëruar, me të njëjtën gjuhë dhe na ka sjellë argumente mendore, logjike dhe filozofike. Ai pastaj vazhdon e thotë: Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"Thuaj Ai Allahu është Një". Pra, ti e pranon prej Atij, i Cili të ka urdhëruar dhe Ai është sipëror ndaj teje kur thotë: Thuaj kështu ... Mjafton për ty që Ai ka thënë fjalë me të cilën të është drejtuar ty.

Thanësi e ka thënë një fjalë, por nuk është tërësia e të folurit të tij në përgjithësi. Mirëpo metodologjia e Kur'anit nuk është kështu, thotë: "Thuaj: o ju besimtarë, ...". Dhe thuaju se i Dërguari i Allahut nuk ka të bëjë me këtë,

absolutisht në këtë çështje. Nuk ka qasje në këtë, por vetëm e pranon këtë fjalë (urdhër) prej Allahut dhe e përcjellë prej Allahut tek njerëzit. Për këtë arsye Ai na thotë fjalë, të cilat janë drejtpërdrejtë fjalë të Tij, pra ligjëratë e drejtë prej fjalës së Allahut të Lartmadhëruar.

Pra të ekzistuarit e tekstit kur'anor në shumicën e ligjeve "Thuaj" është argument se i Dërguari i Allahut e ka marrë atë fjalë tekstualisht, e nuk e ka marrë vetëm kuptimin e tekstit. Nuk është se i ka ardhur në zemër siç është rasti me hadithin. Jo. Por është fjalë me të cilën Allahu ka urdhëruar "Thuaj".

Isha i kënaqur më parë me mendimin e filozofit të mençur të kohës së tij Ibn Sinasë. Mirëpo pasi bisedova për këtë çështje me Shejh Shaëravijun, u pajtove me mendimin e tij dhe i jap prioritet mendimit të tij, sepse është më i përafërt me mendjen dhe logjikën.

Kur t'i kthehesh në drejtim të Atij i cili është më i lartë se ti dhe ai të drejtohet me "Thuaj kështu". Kjo mjafton që ai është duke t'u orientua me fjalë të të folurit.

DREJTËSIA ËSHTË BAZË E SUNDIMIT

Një ditë isha në shtëpinë e Muhamed Muteveli Shaëravijut dhe diskutonim për një çështje shumë të rëndësishme e ajo çështje është prej tregimeve më të mira dhe më të bukura të Kur'anit. E keni lexuar dhe e keni mësuar atë gjuhësisht, shkencërisht, e kemi shikuar edhe në aspektin shoqëror dhe në të gjitha anët tjera.

I kam thënë Imamit të nderuar: Të gjithë e dimë se Sulejmanit iu është dhënë pushtet dhe pejgamberi. Kjo është nderë dhe dallim prej Zotit të Lartmadhëruar. Mirëpo ai me Hud-hudin (pulëbardhën) është ndodhë në një pozitë shumë të vështirë, sa që ka thënë: **"Nëse ajo (pulëbardhë) nuk vjen me ndonjë lajm që e arsyeton vonimin e saj, dhe që ai arsyetim të jetë i fuqishëm do ta dënojë me një dënim të rëndë ose edhe do ta presë, në të kundërtën nëse vjen me arsyetim të fuqishëm do të jetë e lirë."** Kjo është drejtësia, me fjalë tjera ashpërsia për drejtësi.

Iu afrua pulëbardha dhe qëndroi jo fort larg prej tij, pra nuk ka thënë u

afrua dhe qëndroi afër tij. Cili është dallimi në mes të "jo fort larg" dhe "afër". Hudhudi iu afrua frontit të Pejgamberit dhe i tha: Kam shkel dhe kam depërtua në një vend ku ti nuk ke shkel dhe nuk ke depërtuar. Kjo tallje e madhe e Hud-hudit, na tregon se ajo e ka kritiku dhe i ka thënë se ai është i paditur, pse ka pasur për qëllim me thënë: Ti, me gjithë atë se je Pejgamber, ke sundim i ke nënshtruar xhinët dhe shejtanët.

Prapëseprapë unë di atë që nuk di ti, me gjithë përgatitjen dhe fuqinë tënde.

Lirisht mund të themi se sundimi i Sulejmanit a.s. ka qenë sundim i drejtësisë dhe lumturisë, dhe është vërtetuar se po të kishte qenë Sulejmani mizor, do ta kishte prerë (ekzekutuar) Hud-Hudin, dhe nuk do t'i kishte dhënë mundësi me bë bla-bla zotërisë së tij. Të cilit Allahu i ka dhuruar asi sundimi që në sundim i ka pasur xhinët dhe shejtanët.

Me këtë gjuhë të ashpër prej Hud-Hudit kuptojmë se sundimi me forcë në shtetin e drejtë, i lejohet të shprehurit e lirë, diskutimi i lirë, paraqitja e mendimit dhe refuzimi i ndonjë mendimi.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Ai bëri kontrollin e rreshtave të shpendëve dhe tha: Çka është puna me mua që Hud-Hudin nuk po e shoh? Apo është prej atyre që mungojnë. Pa dyshim se kam për ta ndëshkuar ose do ta therri, ose (zgjidhja e saj është) do të më sjellë arsyetim të qartë". (El-En'amë, 20-31)

Pastaj vazhdon me paraqitjen skenike të Kur'anit mrekullueshëm, duke sqaruar: **"Por pupëza nuk u vonua gjatë (veç arrit dhe) tha: Kam qëndruar, kam shkelur dhe kam siguruar lajm që ti atë lajm nuk e di dhe atë vend nuk e ke shkelur, pra po vij tek ti nga vendi Sebei me lajme të vërteta"**. **(En-Neml, 22)**

Imami i mirënjohur, Shaëraviju thotë:

Me të vërtet kjo është ngjarje, e cila tregon drejtësinë dhe cilësinë e sundimtarit të drejtë. Fuqia vërtetohet me drejtësi. Në tregimin e shpendit është e akuzuara, mirëpo Sulejmani a.s. nuk ka mundur ta ndëshkojë shpendin me ndëshkim të padëshiruar edhe pse ka pasur fuqi, sundim dhe ka qenë Pejgamber.

Sulejmani a.s. patjetër ka qenë dashur t'i kuptojë rrethanat e të gjykuarve të qytetarëve të tij, edhe pse nuk kanë qenë njerëz, e pastaj atë që e

ka kuptuar ta realizojë në praktikë, për këtë arsye Sulejmani a.s. nuk ka marrë vendim në mungesë të Hud- Hudit kur e ka akuzuar, por ka pritur deri sa të kthehet, të jetë prezent, e tek pastaj të fillojë gjykimi.

E kur u kthye Hud-Hudi prej perandorisë së Sebeit ka sjellë befasi, ka pa aty diçka çka e ka neveritur, pra ka pa njerëz duke adhuruar të tjerë pos Allahut, pra kanë adhuruar diellin në vend të Allahut. Pastaj Shejh Shaëraviju sqaron befasinë e Hud-Hudit, sepse ajo ka qenë befasi natyrshmërie, sepse ajo ka pasur të drejtë, dhe e drejta është e fuqishme dhe ajo është bërë e fuqishme, dhe fuqinë e saj e paraqiti dhe dëshmoi në gjyq.

Pyetje: Njeriu i cili sheh diçka çka është e dobishme për popullin e tij dhe për shoqërinë e tij, a duhet të kërkojë leje, apo duhet të veprojë, e mos ta humbë rastin për të bërë punë të hajrit?

Përgjigje: Shejh Shaëraviju, Zoti e nderoftë thotë: Kur njeriu sheh se është mirë për umetin dhe popullin e tij le ta punojë pa kërkuar leje për atë punë të mirë, për të mos e humbur rastin.

PERSONALITETI I MUSLIMANIT NË ISLAM

Islami ka ardhur për ta harmonizuar jetën e njeriut në gjithësi, për t'i harmonizuar raportet shoqërore dhe për ta ngritur shoqërinë prej injorancës verbuese. Pasi që besimtari është guri themelor i shoqërisë, struktura e tij është strukturë natyrore, precize dhe prej elementeve më të rëndësishëm të shoqërisë komplete.

Duke u nisur nga kjo logjikë parashtrohet një pyetje: Cila është përbërja e besimtarit në islam si gur i parë dhe shtyllë kryesore dhe element i gjallë i shoqërisë islame?

Imami i mirënjohur, Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Struktura e islamit është i tërë aktiviteti prej aktiviteteve të jetës për të adhuruar Allahun. Për këtë arsye shohim se Islami parashtron çështje, për të cilat as që u ka shkuar mendja atyre të cilët dëshirojnë për të përpiluar kushtetuta për të mirën e njerëzimit.

Shembull: Islami e obligon udhëheqësin Islam që të verbrit t'i caktohet

një udhërrëfyes që sheh, e ai udhërrëfyes të ketë pagë prej arkës shtetërore.

Pa ashtu ai i cili ua shkurton flokët njerëzve, patjetër ai nuk duhet të punoj berber ditën të cilën ha hudhër apo qepë, sepse frymëmarrjet e atij i cili i shkurton flokët, pra frymëmarrjet e berberit dhe hundorëzimi i tij gjatë shkurtimit të flokëve të myshteriut kalon te hunda e myshteriut.

Po ashtu Islami e ka parapa që njeriu, i cili gatuan miellin për t'i përgatitur bukë njerëzve, patjetër ta vendosë mburojën në gojë dhe në hundë, ashtu siç veprojnë mjekët gjatë operacionit, se ndoshta mund të teshtijë, e teshtima ngjitet në brumë të bukës.

Pyetje: Cili është qëllimi që në dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit të qëndrohet në Iëtikaf?

Përgjigje: Kur shohim se Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë Pejgamberit s.a.v.s. që në dhjetë ditët e Ramazanit të qëndrojë në Iëtikaf, gjë që është sunet; kjo për të ngritur dhe lartësimin e ngarkesës me obligime dhe dëshira që muslimani të jetë sa më i pastër. Për arsye se Ramazani e ushtron njeriun për t'u larguar prej ushqimeve të cilat kanë qenë hallall më parë.

Pasi që qëndrimi i dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit në Iëtikaf është sunet. Njeriu ka të drejtë të zgjedhë ose të qëndrojë në shtëpinë e tij pranë familjes së tij, ose të tërhiqet prej bashkësisë familjare. E kjo për arsye që njeriu të ushtrohet që disa ditë t'ia kushtojë Allahut që të ushtrohet ta pastrojë shpirtin dhe ta bëjë të kulluar që të ngritet edhe me trup edhe me shpirt lartë.

Pyetje: A do të thotë kjo që të ushtrohet njeriu për udhëtim tjetër ose për ndonjë qëllim tjetër?

Përgjigje: Po, është ushtrim për udhëtim tjetër, e ai udhëtim është udhëtimi për në Haxh, në shtëpinë e Allahut. Nga kjo shohim se Iëtikafi është ushtrim devotshmërie për kryerjen e detyrave të Haxhit në shtëpinë e Allahut në Bejtul-Haram.

DËSHIRA DHE FUQIA

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **Vërtetë, çështja e Tij është që kur të dëshiron diçka, vetëm thotë bëhu dhe ajo bëhet.**

Po ashtu thotë: **Dënon cilin do, dhe falë cilin do, dhe furnizon cilin do.**

Fuqia absolute në dëshirën e tij a ka ndonjë urtësi dhe cila është urtësia e kësaj dëshire në çështjen e besimit?

I nderuari Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Ky është kulminacioni i fuqisë. Këto ajete na tërheqin vërejtjen dhe na tregojnë se për Allahun nuk ekzistojnë shkaqet të cilat dirigjojnë apo përcaktojnë diçka. Po të kishte pas ndonjë shkak Zoti i Lartmadhëruar do të na kishte thënë neve: Kur të dëshiron diçka, e përgatitë atë ia përcakton shkaqet për ta bërë. Por fjala "bëhu" do të thotë se aty nuk kanë çka të kërkojnë shkaqet dhe se sendet krijohen vetëm duke thënë "bëhu".

Zoti i Lartmadhëruar i dhuron cilit do (fëmijë) vajza dhe i dhuron cilit do (fëmijë) meshkuj dhe thotë "dhe e bën cilin do steril (pa fëmijë)".

Përkundër asaj se Zoti i Lartmadhëruar e ka përcaktua shtatzëninë e cila nuk bëhet pa bashkimin e mashkullit dhe femrës, mirëpo fuqia e Tij e bën cilin do steril që do të thotë ndërpriten shkaqet me dëshirën e Allahut-Subhanallah.

Fuqia e Tij absolute, nuk komplikon asgjë, sepse Ai vet i krijon shkaqet dhe se Zoti i Lartmadhëruar është Ai i cili krijon me dhe prej shkaqeve, por Ai në të njëjtën kohë mund të krijoj edhe pa shkaqe.

LIDHJET DHE FRYRJET NË NYJE

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Thuaj: I mbështetem Zotit të agimit, prej dëmit të çdo krijese që Ai e krijoi. Dhe prej errësirës së natës kur ngryset plotësisht. Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryejnë nyja. Edhe prej dëmit të smirëkeqit kur sipas smirës vepron”. (Felek: 1-5)

Çka janë këto “nefathati fil ukad”?

Në lidhje me komentimin e këtij ajeti fisnik Imami i mirënjohur, Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë:

Nëse këtë e interpretojmë se janë magjitë-sihret apo nyejt e sehirbazëve, dijetarët kanë marrë këtë qëndrim. Po ashtu kanë marrë të njëjtin qëndrim në lidhje me ajetin “dhe nga ziliqari i cili bën zili”, i cili ajet pason pas ajetit të lartpërmendur.

Dijetarët kanë dhënë mendim se këtu janë paraqitur dy pika në të cilat të logjikshmit janë përqendruar në to. Si me qenë diçka çka bën magji dhe diçka që bën zili. Pasi që të logjikshmit nuk e pranojnë magjinë, kanë thënë se magjia nuk ekziston absolutisht, sepse sipas tyre nuk e pranon logjika e tyre. Po ashtu nuk e pranojnë termin “zili”, sepse nuk e pranon logjika e tyre.

Dhe ashtu siç mendon “drejtimi logjik” ata me këtë kanë për qëllim nijetin e mirë. Mirëpo civilizimi, kultura e sotme dhe zhvillimi bashkëkohorë në lindje e në perëndim të vendeve islame, të cilat janë të varura prej pasojave dhe shkaqeve të perëndimit, i sfiduan mendjet (logjikën) në këto çështje. E tek pas kësaj të logjikshmit filluan të pranojnë apo më mirë t’i rikthehen çështje të imanit, dhe çështjeve sekrete, për t’i afruar dhe për t’i harmonizuar çështjet e besimit, të cilat nuk kanë qenë në harmoni me teoritë shkencore (të tyre) dhe realitetin praktik, dhe logjikës, e filluan të interpretojnë. Kështu, ata dëshirojnë që të gjitha çështjet e fesë t’ia nënshtrojnë eksperiencës. Po të kishte qenë që këto çështje t’iu nënshtrohen eksperiencës, atëherë njerëzimi nuk ka pasur nevojë t’i dërgohet pejgamber, as për të besuar në Allahun.

Pra, nuk është mendja jote argument ajo çka është e krijuar. Sa e sa çështje janë që nuk ke mundur t’i prekësh e t’i paramendosh me shqisat e tua dhe që shkenca më herët nuk i ka zbuluar, mirëpo më vonë ti ke arritur për t’i prekur dhe janë bë zbulime shkencore.

Çështjet të cilat në të kaluarën kanë qenë fshehtësi, e pastaj janë bë të

kapshme dhe sot janë të arritura shkencore. Kjo është argument se mendja e njeriut nuk është kandari i kuptimit të çështjeve, mendja nuk është asgjë tjetër, pos të besojë në të, pa marrë parasysh se a e ka burimin ajo çështje prej Allahut apo jo.

E pastaj Ai (Allahu) thotë: "**A nuk të kam thënë ty?!...**" Nëse thotë: Pranoje, pra sikurse Zoti i Lartmadhëruar t'i kishte thënë: "Pranoje", e pas kësaj vjen hulumtimi dhe angazhimi dhe udhëzimi, orientimi i mendjes tënde për disa fshehtësi (sekrete), e cila të bën të besosh me bindje të thellë dhe bindje për çështjet të cilat më parë nuk i ke ditur dhe nuk i ke pasur të dëshmuara.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"All-llahu është një, nuk ka zot tjetër përveç Atij. Ai është mbikqyrës i përhershëm dhe i përjetshëm. Atë nuk e kap as kotja as gjumë, gjithçka ka në qiej dhe në tokë është vetëm e Tij. Kush mund të ndërmjetësojë tek Ai, pos me lejen e Tij, e di të tashmen që është pranë tyre dhe të ardhmen, nga ajo që Ai di, tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar, Kursija e Tij (dija-sundimi) përfshinë qiejt dhe tokën. Kujdesi i Tij ndaj të dyjave, nuk i vjen rëndë, Ai është më i larti, më i madhi". (El-Bekare, 225)

Përfshirja, të arriturit e diturisë bëhet me lejen e Allahut. Kjo është sikurse të bën të kuptojmë çdo gjë që është fshehtësi për njeriun ka përgatitje dhe paraprirje për t'u paraqitur dhe për t'u dëshmuar.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Ai di të fshehtën dhe fshehtësitë e Tij nuk i tregon askujt tjetër, përpos atyre që frikohen prej të Dërguarve". Pra, për njeriun shpjegimet paraprake të të Dërguarve kanë përparësi për t'i besuar.

Disa dijetarë mendojnë se "Nefathati fil ukad" nuk ka kuptimin e magjisë. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"(E hodhën librin e Zotit) E ndoqën atë që e thonin djajt në kohën e sundimit të Sulejmanit. Po Sulejmani nuk ishte i pafé, djajt ishin të pafé, sepse u mësonin njerëzve magjinë. (ndoqën) Edhe çka u zbriti në Babil dy engjëjve, Harutit dhe Marutit. E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t'i thonin: "Ne jemi vetëm sprovë, pra mos u bën i pa fé!" E, mësonin (njerëzit) prej atyre dyve atë (magji) me çka ndanin burrin prej gruas së vet, por pa lejen e All- llahut me atë askujt nuk mund t'i bënin dëm dhe ashtu mësonin çka u sillte dëm e nuk u sillte dobi

atyre. E ata (jehuditë) e kanë ditur se ai që (hodhi librin) e zgjodhi atë (magjinë), ai në botën tjetër nuk ka ndonjë të drejtë (në mëshirën e Zotit). Po ta dinin, ata se për ç'ka e shitën vetveten, ajo është shumë e keqe". (El-Bekare, 102)

Sihri nuk është veprim i njeriut, baza apo prejardhja është nga lart, nga qielli. Shejtanët janë ata të cilët ia kanë mësuar njeriut magjinë, e pastaj njeriu e ka përcjellë dhe e ka vazhduar një veprim të tillë:

"… (ndoqën) Edhe çka u zbriti në Babil dy engjëjve, Harutit dhe Marutit. E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t'i thonin: "Ne jemi vetëm sprovë, pra mos u bën i pa fé!" E, mësonin (njerëzit) prej atyre dyve atë (magji) me çka ndanin burrin prej gruas së vet, por pa lejën e All -llahut me atë askujt nuk mund t'i bënin dëm dhe ashtu mësonin çka u sillte dëm e nuk u sillte dobi atyre. E ata (jehuditë) e kanë ditur se ai që (hodhi librin) e zgjodhi atë (magjinë), ai në botën tjetër nuk ka ndonjë të drejtë (në mëshirën e Zotit). Po ta dinin, ata se për ç'ka e shitën vetveten, ajo është shumë e keqe.(El-Bekare, 102)

Koha dhe çështja janë dy çështje të cilat te njeriu kanë peshojë, por ato nuk kanë peshojë për xhinin. Njeriu nuk mund të tejkalojë (të depërtojë në mur e të dal), ndërsa xhini ka mundësi të bëjë një gjë të tillë.

TË PYESIN ...

Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë Muhamedit s.a.v.s.: **"Të pyesin për alkoolin dhe putat ...";**

"Të pyesin për hënën e re ...";

"Të pyesin për menstruacionin ..."; "Të pyesin çka me shpërnda ..."; "Të pyesin për kodrat ...";

"Të pyesin për çastin e (Kijametit) ...".

Imami i nderuar Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë:

Çdo pyetje të cilën e parashtron Zoti i Lartmadhëruar, shohim se i urdhërohet Muhamedit a.s. me thënë: Thuaj p.sh. "Të pyesin ty për

menstruacionin. “Thuaj menstruacioni është papastërti”. Thuaja se çështja, nuk është çështje e cila i takon njeriut, por Ai (Allahu) është i cili thotë kështu, e ti pyetesh si?

“Të pyesin ty çka me shpërnda?” Njëherë Zoti i thotë: “Thuaj tepricën”, herën tjetër: “Thuaj çka do që shpërndani, jepni prej të mirës për prindërit”.

“Të pyesin ty për hënën e re?” “Thuaj ajo është për t’i kuptuar fazat e kohës”, kohëpërcaktim për njerëzit dhe për haxh. Pra i Dërguari i Allahut ka marrë urdhër për obligime me fjalën urdhërore “Thuaj”. Ndërsa vërejmë vetëm njëherë se në Kur’an ka ardhur “Dhe do të të pyesin ty për kodrat”, “Dhe thuaj: Zoti Im **...**”. Këtu shohim se pyetjen e ka bërë i Dërguari i Allahut ndërsa është përgjigj Allahu menjëherë pas pyetjes i ka thënë: Se ti do të më pyesësh mua por unë do të pyeti dhe do të jap përgjigje para se të më pyesësh. Pra parafjala “F” tregon se kjo pyetje është prej Allahut. I ka thënë: Nëse ti do të pyesësh atëherë thuaj: Nuk ka bërë pyetje para përgjigjes, mirëpo kjo është çështje që na mbetet neve se se parafjala “F” se Kushti në fjali është përpara, e që do të thotë:

E kur të pyesin ty për kodrat, atëherë thuaj ... që do të thotë: Nuk janë duke të pyetur tani, por ndoshta do të të pyesin më vonë. Ne kemi thënë edhe më herët se paralajmërimet e atij i cili i ka çështjet në dorë tregon për mrekullinë e Kur’anit”, dhe çdo “Thuaj” në Kur’an pa parafjalën “F” vetëm me këtë ajo vjen parafjala F “Fekul”. Vetëm te një ajet nuk e ka as parafjalën “F” as fjalën thuaj: “Dhe kur të pyesin për Mua, thuaj jam afër me të vërtetë”, pra nuk ka ardhur në formën “Dhe thuaj vërtetë unë jam afër”.

Kjo dëshmon ndërlidhjen e robit me Krijuesin, pra ndërlidhjen e të dyve në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa ndërmjetësues.

LUTJE

O ZOT NA BËNË MË TË MIRË SE SA MENDOJNË, DHE NA FAL NEVE PËR ATO TË CILAT NUK I DIMË.

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

“Kush mëson për me u krekos me dijetarët, ose me i nënçmua të paditurit, ose me ia kthye shpinën njerëzve, Zoti do ta shpie në xhehenem.” (TRANSMETON IBN MAXHE)

FETAVATË E SHAËRAVIJUT

PJESA E KATËRT

IV

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

Kaçanik, 2015

HYRJE

Falënderojmë Allahun – Krijuesin e gjithësisë, përshëndesim dhe dërgojmë salavate për pejgamberin besnik, ndërmjetësuesin e Ditës së Gjykimit. Qëllimi kryesor i yni të jetë rruga drejt Allahut. Nuk ka forcë, as pushtet të ndryshojë dikush diçka, pos Allahut.

Njerëzit e kësaj kohe, kush punon nuk fiton dhe kush fiton nuk ka fituar. Nuk frikohem prej njerëzve kur frikësohen, por frikësohem se ata nuk frikësohen. Kush frikësohet shpëton. Fatkeqësia është te botëkuptimi, i cili është fatkeqësia më e madhe e shpirtit të njeriut, sepse kriminelët, por edhe të tjerët e dinë se janë gabim, por paraqiten thuaja se nuk ka ndodhur asgjë, dhe se ata janë të drejtë, e kështu ata tregohen kryeneçë, kryelartë dhe ziliqarë. Dhe kur t'i kthehen vetes së tyre e kuptojnë vetë se ata janë duke e tradhtuar vetveten e tyre. Tragjedia është në atë se një pjesë të madhe të jetës së tyre e kalojnë në zbavitje e dëfrim. Nuk e pranojnë dhe nuk i dorëzohen realitetit, por vazhdojnë me avazin e tyre, derisa të kalojë pjesa më e madhe e jetës së tyre, e kur të plaken, dhe kur qëllimi dhe mendimet e tyre marrin fund dhe fillon faza e fundit e fazës së tyre, e kuptojnë realitetin, pasi që veç paralizohen dhe dobësohen plotësisht; paaftësohen dhe nuk kanë mundësi për t'i përcjellë ngjarjet dhe rrethanat me të tjerët.

Kur ndjenjat pasojnë imoralitetin, e ngopen me të, mbushen me të, dhe përzihen me shpirtin, vështirë është për t'u larguar prej saj, edhe pse njeriu arrin shkallën më të lartë të zhvillimit.

Për këtë arsye devotshmëria në rini është më e dashur se devotshmëria në pleqëri. Në shumicën e rasteve, shumicën e brengave njerëzit nuk mund t'i mënjanojnë, për shkak se luftën e madhe dëshirojnë ta fitojnë me angazhim të vogël, ndërsa harrojnë se po që se lidhen fortë me fuqinë më të lartë të tyre, do të dilnin ngadhënjimtarë dhe do të çliroheshin nga vështirësitë e tyre, pa mund dhe lodhje dhe për një afat shumë të shkurtër.

Besimtari është fortifikatë e fortë, lidhje e fortë, të cilën e forcon gjithmonë, dhe kudo që shkon e vjen, e di se Allahu është me të, dhe se praktikimi i planprogramit ti siguron qetësi shpirtërore, fizike dhe psikike. Allahu i mbron ata të cilët i besojnë Atij dhe se Imani i fortë është arma me të cilën tejkalohet çdo pengesë, të cilën historia as që mund ta ketë parë asnjëherë, pos në historinë Islame, posaçërisht para njerëzve mizor dhe kriminelë me pozita të larta, siç ka qenë rasti i Haxhaxh Ibn Jusuf Eth-

Thekafiju, i cili ka qenë i rreptë, mizor dhe agresiv.

Një ditë prej ditëve e pyet një njeri prej Havarixhëve: "A e ke tubuar (mbajtur në kokë) Kur'anin"? - Ai i është përgjigjur: Pse, a mos ka qenë i shpërndarë, e unë ta tuboj! - E Haxhaxhi e pyet atë: "A e lexon ti përmendësh"? Ai i përgjigjet: përkundrazi, unë e lexoj duke e shikuar. - Ai prapë e pyet: "A e di përmendësh (a e ke ruajtur në mendje)"? Ai i përgjigjet: Pse, a mos po frikësohesh se ai ikë (humb), e unë ta ruaj. - Ai e pyet: "Çka mendon për emirin e besimtarëve, Abdul Melikun"? Ai ia kthen: Allahu e mallkoftë atë me gjithë ty! - Ai i thotë: "Tash do të të mbys, e si do ta takosh Allahun"!? E takoj me veprën time, ndërsa ti do ta takosh me gjakun tim!

Kjo ka qenë trimëri e vërtetë, ndaj kriminalitetit të vërtetë të Haxhaxhit, që para mizorisë së tij nuk ka pasur frikë dhe dorëzim, por sqarim dhe guxim, sepse ajo ka qenë forcë e vërtetë, e jo formale apo false. Kështu çdo i drejtë nuk frikësohet, e as nuk trembet dhe nuk përgjigjet ndryshe, pos me dituri, drejtësi dhe bindje të sigurt.

Le ta dijë njeriu, se e kaluara para njeriut mbetet dhe shpërblimi i durimtarëve, të cilët durojnë kur i godet diçka është i madh dhe begati për të.

E tërë jeta është sprovë: edhe e mira edhe e keqja janë sprovë; edhe pasuria edhe varfëria janë sprovë; edhe shëndeti edhe sëmundja janë sprovë. Njeriu sprovohet me të mirë për tu vërtetuar se a është falënderues, ndërsa tjetri sprovohet me të keqe, për ta shikuar se a po mohon apo është durimtar.

Atë që Allahu e tubon, njeriu nuk mund ta ndajë. HIDE dhe TESHENUXH është alegori për injorancën. I urti për injorantin me përbuzje ka thënë: Merr vendim të prerë pa ditur fare, hidhërohet para se të kuptojë. Po ashtu unë mendoj se prej cilësive kryesore të injorantit është se ai ngarkohet pa kurrfarë shkaku dhe nënçmon pa kurrfarë arsye.

Te Allahu i poshtëruar në këtë dunja është ai, i cili zhytet në të, ndërsa nuk arrin mirësi pa u larguar prej saj.

Për këtë arsye, mendoj se e mira do të jetë gjithmonë deri në Ditën e Kijametit, e mira në shpirtra dhe në ekzistencë harmonizohet në shumë çështje të jetës.

Poeti Shevki, Zoti e mëshiroftë, ka thënë:

Kur dunjaja e zë vendin e së mirës, e ajo falënderohet, atëherë poshtërsia del në shesh. Mirëpo, qëllimi dhe dëshira jonë është që të përhapet e mira në zemra. Sepse jam i pikëlluar për ta dhe ardhmërinë e tyre, aq sa

kemi pasur mundësi dhe për t'i zgjedhur dhe për t'i tubuar, e cilës prej tyre duhet dhënë përparësi. Sepse shumë mendime të cilat na kanë ardhur kanë qenë të pakuptueshme dhe të paargumentuara. Parim e kemi pasur atë se gjithmonë Allahu është me ne dhe që gjithmonë Ai të jetë i kënaqur me ne, dhe Ai të na udhëheqë, duke u bazuar me lutjet e sinqerta të shokëve tanë të sinqertë, prej dijetarëve të cilët e kanë preokupim thirrjen islame, me metodologji të shëndoshë, dhe me vendosmëri, pa neglizhencë, as artificialisht dhe larg komplikimeve dhe ekstremitetit.

Mjeku e rren pacientin duke mos ia treguar rrezikshmërinë e sëmundjes, që të mos mashtrohet në jetë dhe të mos e mashtrojë jeta, sepse realiteti dhe e vërteta në këto qëndrime dhe jo në këto vende nuk e di se rrena mund të jetë e mirë apo e lavdëruar. E vërteta jo në këto fusha nuk ka nevojë tjetër, përpos bindje dhe sinqeritet.

Dhembjet e forta janë më të vështira se vdekja, më të ashpra, dhe më të dëmshme, p.sh. thellësia e dhembjeve është më e fuqishme se vetë dhembja.

Mjeku patjetër duhet pasur parasysh këtë që dhembjet e sëmundjes mos t'i bëjë më të dhembshme se sa janë.

O Zot, mos na bën prej konfrontuesve, na lehtëso rrugën për te Ti, me ndihmën Tënde, dhe na largo injorancën dhe lajthitjen. Na bën zemrat të sinqerta, të pastra.

Edhe pse armiqtë tanë janë rrenacak, pa kurrfarë arsye, fali ata, udhëzoji edhe pse kanë arsyetime. Na fal neve dhe fali ata, dhe na bën që të jemi të kuptueshëm edhe ne edhe ata.

Çka është e dëmshme na shpëto prej saj dhe çka është e dëmshme prej neve shpëtoji ata. Çka posedojmë prej të mirave: sinqeritetin, besnikërinë na bashko dhe na afro nëpërmjet tyre që ta ngritim lartë të vërtetën dhe fenë, larg nga ekstremizmi dhe mbrona nga lajthitjet dhe gabimet, sepse feja jonë është e qartë, është thirrje me urtësi dhe me këshilla të mira, dhe diskutim në çështje të mira dhe të dobishme.

Allahu qoftë i kënaqur. Falënderoj Allahun, Zotin e gjithë botëve.

Kajro, 11 Dhulkade, 1401 h. 9 Shtator, 1981. Isa a.s., Sejid Xhemil

HAXHI PARA ISLAMIT

Pyetje: A ka ekzistua Haxhi para Islamit, dhe forma a ka qenë e tillë siç e kryejmë sot?

Imami i nderuar Shaëraviju përgjigjet:

Shihet qartë në tregimin e Ibrahimit a.s. me Qaben në ajetin kur'anor:

"Dhe thirr njerëzit për haxh, do të vijnë në këmbë". Urdhri i Ibrahimit është i qartë se ka bërë thirrje për haxh, e Ibrahimi e ka krye praktikisht. Kjo është e vërtetë. Mirëpo nëse dëshirojmë që fjalën e Zotit me kuptua në thellësi kuptojmë se: Allahu e ka urdhërua Ibrahimin me ngrit themelet, e domethënia e ngritjes së themeleve është se Qabja ka ekzistua më herët, ndërsa Allahu ka urdhërua që të ringritet. Ringritje do të thotë se hapësira ka ekzistua, themelet kanë ekzistua, konstruksioni ka ekzistua pasi që edhe në ajet tjetër Zoti i Lartmadhëruar në mënyrë të përgjithshme e ka tregu **"Nuk ka dyshim se shtëpia e parë e cila është ndërtua për njerëzit, është ajo në Meke, e cila është e bukur dhe udhëzim për njerëzimin".** Pasi që veç ka qenë e paraparë dhe e vendosur për njerëzimin, prej se ka ekzistua njerëzimi, dhe përderisa ka qenë Qabja, ka ekzistua haxhi.

Ai i cili thotë se haxhi është prej Ibrahimit a.s. dhe se Qabja është prej Ibrahimit a.s. nuk është e vërtetë, por e vërteta është se Qabja ka ekzistua edhe më herët se Ibrahimi a.s., por edhe haxhi ka ekzistua më herët se Ibrahimi a.s.

Pse? Sepse është e mundur që Qabja është rrënua, prej ndonjë shkak prej shkaqeve, ndërsa Allahu ka dashur ta qes në sipërfaqe prapë këtë çështje, dhe pasi që Ibrahimi a.s. e ka rindërtua, prapë ka bë thirrje për haxh. Për të treguar rindërtimin konkret të Qabës, dhe riprogramimin e haxhit si obligim. Allahu ka dashur me i rikthye themelet e Qabës për me krye haxhin njerëzit. Sepse Ibrahimit a.s. i ka ndihmua Ismaili me i ringrit themelet: **"Dhe përkujto kur Ibrahimi i ka ngritë themelet e Qabës me Ismailin"**. Nga kjo kuptohet se Ismaili ka arritur moshën e pjekurisë, gjë që i lejohet atij me i ndihmua babës së tij me i ringritur themelet e Qabes.

Kur'ani na tregon se Ibrahimi a.s. e ka dërgua dhe e ka vendos për me jetua Ismailin dhe nënën e tij te shtëpia e Shenjtë (Qabja). Kjo dëshmon se shtëpia ka ekzistua edhe para se me shkua Ibrahimi aty.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe Ne ia përgatitëm Ibrahimit për me shkua te vendi i shtëpisë së shenjtë (Qabes)”.

Pra Qabja ka ekzistua në atë kohë dhe para asaj kohe, por në atë kohë nuk ka qenë e banuar, por prapë është banuar (është bërë vendbanim) dhe është përkufizuar.

UMREJA A ËSHTË SUNET APO FARZ?

Pyetje: Umreja a është sunet apo farz?

Shejh Shaëraviju përgjigjet: “Thënia e Zotit të Lartmadhëruar”, do të thotë se Umreja është farz e jo sunet. Përderisa Zoti i Lartmadhëruar haxhin e ka cilësua se është “më i madhi”, që do të thotë se ka edhe “haxh të madh”.

Ndërsa “haxhi në Qabe për atë i cili ka mundësi dhe e ka rrugën e lirë” ka për qëllim haxhin dhe Umren së bashku.

Po ashtu mund të kuptojmë se Zoti i Lartmadhëruar e ka cilësua haxhin në Arafat se është haxhi më i madhi, ndërsa haxhi në të cilën nuk është qëndrimi në Arafat nuk është “haxhi më i madhi” por “haxhi i madh”, po mos të ishte kështu do të zbehej domethënia.

Në hadithin “Është ndërtua Islami në pesë shtylla”, ka për qëllim haxhin dhe Umren së bashku.

HAXHI PËR TJETRIN

A mund ta kryej femra për nënën e saj?

Një grua e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: Vërtetë nëna ime ka vdekur dhe nuk e ka krye haxhin. Ata kryej haxhin për të? Është përgjigj: Po kryeje haxhin për ta. (HADITHI SAHIHË)

Një njeri derisa ishte afër të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. dhe thoshte: “Leb-bejke an Shebremete”. Kur e ka dëgjua i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: A e ke krye haxhin për vete? Ai i thotë jo!. Muhamedi a.s. pastaj i ka thënë: Kryeje haxhin për vete, e pastaj për Shebremetën. (E ka regjistrua Shafiju dhe Ahmedi)

KONTAKTIMI SEKSUAL NGA PRAPA

Një grua e Ensarëve e ka pyetur Muhamedin a.s. për "TEXHBIJËN" për kontaktimin seksual prej nga prapa por jo në anus por në vagjinë.

Përgjigje: Ia ka lexuar asaj ajetin Kur'anor: **"Gratë e juaja janë arat (bahçet) e juaja dhe kontaktoni në arat e juaja nga të doni (por në vagjinë).** ***(AHMEDI)***

Omeri r.a. i ka thënë Muhamedit s.a.v.s.: O i dërguari i Allahut: Jam shkatërruar. Muhamedi a.s. i ka thënë: Po si je shkatërruar? I ka thënë: Bashkëshortja ime është rrotullua dhe skam pasur çka të bëj: pastaj ka zbritur ajeti Kur'anor: **"Gratë e juaja janë arat e juaja dhe kontaktoni në arat e juaja nga të doni"**. ***Kontakto nga para e nga prapa, vetëm mos kontakto kur ajo është në kohën e menstruacionit dhe në anus. (AHMEDI DHE TIRMIDHIU)***

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka lejua kontaktimin seksual nga prapa por jo në anus. Muhamedi a.s. ka thënë: ***"Të mallkuar janë atë që kontaktojnë me gratë e tyre në anus".***

Po ashtu ka thënë: ***Kush kontakton me gruan me menstruacion ose në anus ose i beson falltarit, ai ka mohu atë çka i ka zbritur Muhamedit. (AHMEDI)***

FILLIMI I SHPALLJES

Si i ka zbritur Vahji të Dërguarit të Allahut Muhamedit s.a.v.s.?

Shejh Shaëraviju përgjigjet: Që në fillim të shpalljes Pejgamberi s.a.v.s. ka pas angazhim dhe përpjekje tepër të madhe, dhe pas shpalljes së ajeteve të para ka thënë: Më mbuloni. Më mbuloni. Pra ky ka qenë kontakti i parë në pranimin e shpalljes dhe është mbulua pasi që veç ka pasur vështirësi. Është vërtetua në biografi të Muhamedit a.s. se fytyra e tij u mbushte me djersë. E gjithë kjo ka qenë dukuria në trup. Kjo dukuri në trup tregon se ka pasur vështirësi fizike, mirëpo përderisa ka pasur vështirësi fizike, patjetër ka pasur siç kemi përmendur më parë edhe ndryshime kimike në vet trupin njerëzor të Muhamedit a.s. Sepse forca më e madhe (Meleku) takohet me

njeriun. Dhe është e pamundur pa qenë të paraqitura dy çështje:

Çështja e parë: Ose Meleku prej qenies së tij melek me kalua në qenien njerëzore, pra me u barazua me qenien njeri si Muhamedi a.s. dhe të flet me të. Mirëpo në atë rast nuk ka për njeriun ndonjë vështirësi me pranua shpalljen, sepse procesi fillon prej Melekut, e ai paraqitet si njeri dhe i flet ndërsa Muhamedi a.s. mbetet në natyrshmërinë e tij-njeri. Ose te Muhamedi a.s. me u paraqit diçka e jashtëzakonshme që Muhamedi a.s. të tronditet dhe natyrshmëria e tij të përqendrohet në pranimin prej një force më të madhe, pra prej Melekut. Kjo mënyrë është mënyra më e vështira, mirëpo ai është përqendrua fortë dhe e ka pranu me përpikëri dhe e ka përcjell me përpikëri atë çka i ka zbritur prej Allahut, sepse Meleku kur të shndërrohet njeri është e mundur që të mendohet se prapë ai është në një shkallë më të lartë se shkalla njerëzore më drejtohet, më flet dhe e tregon këtë, ndërsa te Muhamedi s.a.v.s. nuk ka më kontakt të jashtëm. Ose me ndodh diçka e jashtëzakonshme ku Muhamedi a.s. dridhet, djersitet dhe i ndodh ajo çka i ka ndodh. Kjo është çka mënyra e sjell atë gjendje. Dhe kur të vjen dituria nëpërmjet kësaj rruge, e di se ajo dituri ka ardhur nëpërmjet rrugës së jashtëzakonshme, e kupton qartë se çka i ka zbritur Muhamedit s.a.v.s. dhe për këtë ai ka argument, se ajo ka qenë çështje e jashtëzakonshme as njeri, as të folur pas perdeje.

BOTA TJETËR DHE KJO BOTË

Çfarë kuptimi ka ajeti **“Dhe bota tjetër, është më e mirë për ty se kjo botë.”** Sadakallahul Adhijm.

Përgjigje: Për këtë ajet të suretul “Duha” disa mendojnë se “Bota tjetër” është për qëllim jeta e botës tjetër. Mirëpo Shejh Shaëraviju sqaron se kjo fjalë “Bota tjetër” ka për qëllim zbritja e shpirtit besnik, xhibrilit me shpallje “herën e fundit”.

Imami i mirënjohur thotë: Për këtë arsye i Dërguari i Allahut s.a.v.s. asnjëherë nuk është ankuar për shpalljen. Shtrohet pyetje: Pse? Sepse është frymëzua është edukua me edukatën e fuqisë për pranimin e çështjeve të vështira, dhe vështirësia është lehtësua, dhe qenia e tij njerëzore as që e ndien. Kur të vjen njeriu dhe ia paraqet njeriut një çështje të vështirë, e kur ta sheh

se fryti i asaj çështjeje të vështirë është i ëmbël, pasi që ti pushon, i largohet lodhja ndërsa i mbetet ëmbëlsira e asaj çka i ka zbritur. Ëmbëlsira e shpalljes për të cilën përmallohet nëse nuk i zbret prapë. E kur të përmallohet, atëherë i tubohet forcë e madhe për pranim sa që nuk e ndien kurrfarë lodhje herëve tjera.

FEMRA E MARTUAR DY HERË ME CILIN BURRË DO TË JETË NË XHENET

Një femër e cila është martuar dy apo tri herë me cilin do të jetë në ditën e kijametit?

Me këtë është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe është përgjigj:

Ajo do të zgjedh, dhe do ta ketë atë, i cili ka qenë më i sjellshëm me të.

SUNDIMI DHE SUNDIMET

Pyetje: Cili është dallimi në mes të sundimit dhe sundimeve?

Shejh Shaëraviju përgjigjet: Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Qoftë i lartësuar (Allahu), i Cili në dorë të Tij ka sundimet e çdo gjëje”.

Këtu është përdorur fjala “sundimeve” në shumicë dhe nuk është përdorur fjala “sundim” në njëjës.

Po ashtu Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“I Allahut është sundimi i qiejve dhe i tokës”.

Këtu është përdorur fjala “sundim” në njëjës dhe nuk është përdorur “sundimet” në shumës. Kjo nga arsyeja se “sundim” është atë që e dëshmon dhe e sheh, ndërsa “sundimet” janë çështjet e fshehta dhe sekrete. Në rend të parë tregohen çështjet e dukshme, ndërsa nuk mund të dish çka ka pas çështjeve të dukshme.

Nuk ka dyshim se hapësirat dhe çështjet pas çështjeve të dukshme është bota e sundimeve.

"Qoftë i Lartësuar Allahu, i Cili në dorën e Tij, janë sundimet e çdo gjëje dhe te Ai do të kthehen (që të gjitha)".

NËSE RROBA NDOTET ME GJAKUN E MENSTRUACIONIT

Një grua e ka pyetur Muhamedin s.a.v.s.: Nëse ndonjërën prej nesh e përlyen rrobën me gjakun e menstruacionit, si duhet vepruar?

Përgjigje: Muhamedi s.a.v.s. është përgjigjur: ***E shkund, pastaj e fërkon duke e spërkatur me ujë, pastaj e pastron dhe në fund falesh me të.***

AFATI I LEHONISË (NIFASËS)

Sa është kohëzgjatja e lehonisë?

Transmeton Darukutni se Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: ***Pas lindjes, femrës i vazhdon lehonia 40 ditë vetëm nëse e vëren dhe e vërteton pastërtinë para kësaj kohe.***

POLEMIKA DHE ARGUMENTIMI NË EKZISTIMIN E ZOTIT

Allahu i Lartmadhëruar ka ekzistua para ekzistencës, atëherë kur nuk ka pasur asgjë pos Tij, ashtu siç është regjistruar në hadith në Musnedin e Imam Ahmedit. Ekzistimi i Zotit të Lartmadhëruar është i vazhdueshëm dhe nuk ka mbarim dhe njeriu as që mund të ketë mundësi ta përkufizojë mënyrën e ekzistimit të Zotit pa fillim dhe pa mbarim.

Atëherë për çka bëhet polemika? Polemika bëhet rreth argumentimit për ekzistimin e Zotit apo rreth tentimit për vërtetimin e ekzistimit të Zotit?

Në lidhje me temën për ata që polemizojnë ekzistimin e Zotit apo mundohen të vendosin argumente për ekzistimin e Zotit, i nderuari Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju në rend të parë pyet: Çka është ajo që të ka shtyrë në këtë, të ka lodhur ty, e ka lodhur mendjen dhe logjikën tënde për të sjellë argument për ekzistimin e Zotit.

Shejhu na zbulon një sekret shumë të rëndësishëm në lidhje me këtë kur thotë: Allahu ekziston në vetveten tonë instinktivisht dhe natyrshmërisht. Ai ekziston në tërë jetën e qenies tonë. Ai i cili tenton të sjellë argument mbi ekzistimin e Allahut, në të vërtetë ai veç e ka vërtetuar ekzistimin Allahut, pa pasur nevojë për argument.

Argument për ekzistimin e Allahut, sepse kërkesa e argumentit dhe angazhimi i mendjes në të, do të thotë se Allahu ekziston në ne natyrshmërisht, e ndiejmë dhe e përjetojmë dhe e dimë se ekziston. Sepse ekzistimi i Allahut qenka para tentimit për të gjetur argument. Ky tentim është prezent dhe do të jetë prezent deri sa të ekzistojë jeta. Vërtet ky është një apelim se Zoti ekziston, ndërsa ne tentojmë dhe përdorim atë çka mendjes i përshtatet për të gjetur argumente.

SHENJA E PARË E KIJAMETIT

Cila është shenja e parë e kiametit?

Shenja e parë e kiametit është shpërndarja e zjarrit prej lindjes e deri në perëndim. Kjo është një çështje prej tri çështjeve të cilat i ka tregua Abdullah Ibn Selam. (Kjo është e treguar në sahihun e Buhariut)

MREKULLIA E ISRASË DHE MIËRAXHIT

Mrekullia e Israsë dhe miëraxhit është prej mrekullive shumë interesante të islamit e cila ka sjell argumente dhe fakte të fuqishme për me i befasua kokat e pabesimtarëve dhe hipokritëve. Çfarë komenti jep Shaëraviju në lidhje me këtë mrekulli.

Imami i nderuar thotë:

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka bërë Isranë pastaj është ngritur në qiellin e shtatë në Sidretul Munteha me fuqinë e Allahut ndërsa ne në ditën e Kijametit ku do të jemi me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar.

Po mos të ishte ajeti Kur'anor "Ju nuk mund të ngriheni" vetëm se me fuqinë e (Allahut) disa njerëz nuk kishin me pranua Isranë dhe Miëraxhin, po pasi që ky ajet ka zbritur kjo do të thotë se Zoti i Lartmadhëruar me fuqinë e tij e bën kë të dojë të ngrihet në qiell dhe ashtu qysh e përcakton ai.

Nëse e dëgjojmë ndonjërin duke thënë: njeriu është ngritë në hapësira të qiellzave dhe të tokës, pasi që ai ka hypë në hënë. Ne i themi atij se njeriu është ngrit në lartësi prej milionave vit drite vetëm për disa sekonda ndërsa hëna është vetëm një largësi e vogël e qiellit të parë të botës, dhe duket që prej miliona vite drite të hiqen dy sekonda për të arritur në largësinë e thellë e cila është prej qiellit të kësaj bote. Dhe ende nuk ka arrit as në qiellin e parë.

Vazhdon Shejh Shaëraviju e thotë:

Kjo është një çështje shumë e rëndësishme për me iu kundërpërgjigj atyre që tentojnë të thonë se Kur'ani është libër njeriu, e e harrojnë fuqinë e Allahut, dhe mundohen me të arritura të vogla që edhe ata vet e kuptojnë se askund ende nuk janë ngritur, sepse unë kur bëj analizë se për disa sekonda kalohen miliona vit drite, nuk mund të them, apo njeriu i logjikshëm nuk mund të thotë se është ngrit në lartësi të qiellit të tokës prej miliona vite drite.

Për këtë arsye, muëxhizja e Israsë dhe Miëraxhit është e përgjithmonshme, dhe do të mbetet deri në ditën e kiametit, dhe njeriu nuk mund të arrij pa marr parasysh në çfarë niveli të diturisë dhe fuqisë të arrijë për me u ngritë në hapësirat e qiellërave dhe tokës. Ai

nuk mund të ngritet as në qiellin e botës e mos të flasim në shtatë qiejt. Mrekullia e Miëraxhit do të mbetet mrekulli e cila i fton njerëzit në besimin në Allahun, në fuqinë e tij, mrekulli e cila meriton adhurimin në një Zot.

MARTESA DHE SHKURORËZIMI

Pas martesës së vështirë, me problemet në të, me vështirësitë dhe pamundësia bashkëshortore, ne shohim se shkurorëzimi është ilaçi më i lehti për të zgjedh problemin e padurimit të ndërsjelltë në familje dhe shoqëri.

Çka mendon cili është shkaku i cili shpie deri aty?

Kjo ndodh për shkak të konfliktit të bashkëshortëve duke mos e përfillë dhe duke mos e shikuar atë që e kërkon dhe parasheh Islami në të gjitha çështjet. Po nëse kërkuesi i martesës do të martohej ashtu siç e parasheh dhe e kërkon Allahu, nuk do të ndodhte ajo që shpie në shkurorëzim.

NË MES TË SHTIMIT DHE TË PAKËSIMIT

Të gjitha sendet rriten, shtohen, por edhe zvogëlohen e humben. Ndryshim i shpejtë dhe i përnjëhershëm nuk mund të ndodhë. Kjo është mëshira e Allahut ndaj njerëzimit dhe ndaj krijesave në përgjithësi, sepse ndryshimet e menjëhershme lënë pasoja të pashërueshme në shpirtrat gjë që shkakton pengesa në jetën, e cila vazhdimisht është e ndryshueshme.

Pasi që ditët ndryshojnë dhe jeta nuk është stabile, kanoset rreziku që befasisht gjërat të kalojnë prej një gjendje në një gjendje tjetër, por ndryshimi i asaj gjendje patjetër duhet të bëhet në mënyrë graduale dhe ngadalë-ngadalë.

Kur ia parashtrova këtë çështje Imamit, Shejh Shaëravijut, ai tha: Sasia e shtimit dhe sasia e pakësimit është çështje e cila ndodhë në çdo pjesë të kohës. Në syrin e nënës foshnja nuk rritet përnjëherë. Mirëpo p.sh., pas kalimit të dy muajve dhe pas një krahasimi e sheh se është rritur në njëfarë mase. Kjo është peshoja e krahasimit me jetën, diçka çka është e ndryshueshme me diçka që është përmbajtjesore, e domosdoshme – statike.

Siç thonë dijetarët për çështjen e evolucionit se njeriu e ka prejardhjen prej majmunit, ne u kundërpërgjigjemi: Pse atëherë çdo majmun nuk është shndërruar në njeri, mirëpo majmunët prapë kanë mbetur në gjendjen e tyre të mëparshme.

Çdo herë kur femrës i zbehet bukuria e saj, i kompensohet bukuria në

bukuri tjetër. Shtimi dhe pakësimi në shumicën e çështjeve ndodhin në atë masë siç e kërkon jeta. Vazhdimësia e jetës dhe barazia apo paralelizmi i saj vetë e kërkon pakësimin në një çështje prej shumë çështjeve.

NDJENJAT E BRENDSHME

Pyetje: Sa i përket mosmarrëveshjes dhe problemeve që shpërthejnë mes burrit dhe gruas, pa marrë parasysh shkakun, cila procedurë është më e mira dhe më e shëndosha, për t'i tejkaluar vështirësitë bashkëshortore.

Përgjigje: Shejh Shaëraviju në lidhje me zgjidhjen e këtij problemi këshillon dhe parasheh shërimin shpirtëror medicinal, i cili është i dobishëm në të cilin janë ilaçet shëruese me ndihmën e Allahut.

I nderuari Shejh Shaëraviju thotë: Çdo konflikt, i cili ndodh në mes burrit dhe gruas, nëse ai konflikt vjen nga faktorët e jashtëm, vështirë është që të shërohet, ndërsa nëse nuk janë faktorët e jashtëm shkak i atyre mosmarrëveshjeve, atëherë me kalimin e kohës, dhe atë të një kohe të shkurtër, i zgjedhin ndjenjat e brendshme.

Shejhu i mirënjohur vërteton se harmonizimi familjar në mes të burrit dhe gruas janë garancioni më i sigurt për zgjidhjen e problemeve shoqërore dhe sigurinë shoqërore.

MAGJIA E POPULLIT TË FIRAUNIT DHE SHKOPI I MUSASË A.S.

Populli i Musasë a.s. është i njohur për magji. Musa a.s. ka qenë dashtë patjetër t'i mposhtë ata, për t'u vërtetuar e vërteta e misionit dhe pejgamberllëkut të tij, e vërteta e ftesës së tij dhe e dërgimit të tij se është i dërguar prej Allahut të Lartmadhëruar, për të transmetuar shpalljen prej tij.

Prej vështirësive më të mëdha është që të dërgohet i Dërguar te magjistarët dhe shizofrenët, të cilët e kanë profesion magjinë dhe janë marrë një kohë të gjatë me atë veprimtari negative. Dhe ka qenë dashtë të jetë i përgatitur shumë, më shumë se ata, që ata të jenë të detyruar të dorëzohen të

nënçmuar dhe kokulur.

Magjistari nuk dorëzohet, përpos ndaj atij i cili është më i madh se ai, sikurse mjeku kur të dëshirojë ta mjekon veten e tij, ai ndryshon prej mjekut i cili është më i specializuar se ai dhe më me përvojë. Kjo është ajo çka ka ndodhur me Musanë a.s. kur Allahu e ka aftësuar, e ka përsosur, pastaj atë eksperiencë e ka vendosur në praktikë dhe i ka mbyllur gjuhët e të pavërtetëve me gjuhën e sinqertë dhe të vërtetë, dhe përvojën dhe eksperiencën e drejtë.

Pyetja është: Cili është dallimi në mes të magjisë së popullit të Musasë dhe shkopit të Musasë a.s.?

Shejh Shaëraviju përgjigjet: Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Çka ke ti në dorën tënde të djathtë o Musa? Musa a.s. ia kthen: Ky është shkopi mbi të cilin mbështetem, me të e ngas bagëtinë time dhe ky është shkopi im që e përdori për punë tjera”.

Këtu Zoti i Lartmadhëruar ka dëshiruar që ta bëjë provën gjenerale të Musa a.s. kur i thotë: **“Hidhe atë o Musa”.**

Musa a.s. e hodhi shkopin. Kur ai shkop menjëherë është shndërruar në gjarpër aktiv. Musa a.s. është frikësuar. Mirëpo Allahu i thotë: Mos u friko, se ne prapë do ta rikthejnë në gjendjen e tij të më parme.

Po të mos ishte frikësuar Musa, ne do të kishim thënë se ka qenë lloj magjie. Për këtë arsye duhet ta tërheqim vërejtjen se ka dallim të madh në mes të magjisë së popullit të Firaunit dhe asaj çka iu është dhënë Musasë a.s..

Kur’ani përshkruan gjendjen e Musasë a.s.:

“Dhe filloi që të rrëqethet dhe të frikohet në vetvete”.

Ky është argument se shkopi i Musa a.s. është shndërruar në gjarpër të vërtetë dhe ka qenë gjarpër në kuptimin e fjalës, që do të thotë se shkopi në të vërtet e ka ndryshuar lëndën e tij, e ky është ai dallimi në mes të magjisë së popullit të Firaunit dhe shkopit të Musasë. Vërtet magjia e Firaunit vetëm i ka hipnotizuar sytë e njerëzve të cilët pastaj nuk kanë mundur ta vërejnë realitetin e sendeve, mirëpo ata kanë parë iluzion, pra janë magjepsur sytë e tyre.

Ndërsa Muëxhizja e Musasë – shkopi, e ka ndryshuar esencën dhe është shndërruar në gjarpër të vërtetë. Kështu ne shohim Muëxhizen e Allahut, të cilën ia ka dhënë Musasë, e cila është realizuar pas testimit, e pas

testimi e ka obliguar për kryerjen e rolit të shkopit.

Kështu na mëson Allahu, se nuk ka detyrë vetëm pas testimit dhe nuk ka sukses të mirëfilltë pa ushtrim të vazhdueshëm dhe përsosmëri.

ÇIFTËZIMI DHE GJITHËSIA

Në suretu Ja Sinë Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Qoftë i Lartësuar Ai i cili ka krijua gjithçka çift, prej asaj që mbinë prej toke, edhe në vetveten e tyre edhe në ato (gjëra) të cilat nuk i dinë".

Cili është argumenti shkencor i pjesës së ajetit "dhe në ato (gjëra) që nuk i dinë"?

Përgjigje: I nderuari Shejh Shaëraviju në lidhje me komentin e këtij ajeti fisnik thotë: Çiftëzimi është te të gjitha krijesat, të gjithë e dimë se e jemi çift dhe martohemi, e dimë në gjallesa, e dimë edhe në bimë. Mirëpo thënia e Zotit të Lartmadhëruar "dhe në atë çka nuk dinë".

Kjo është argument se ky proces është gjithëpërfshirës në tërë ekzistencën, se po të ishte ndryshe, atëherë si të interpretohet pjesa e ajetit "dhe në atë çka nuk dinë". Çka na jep të kuptojmë ky ajet?

Ky ajet bën që të kuptojmë se Zoti i Lartmadhëruar e ka ngritur dhe e ka fisnikëruar mendjen dhe logjikën bashkëkohore në atë se po të kishte thënë shkenca për çiftëzimin e disa çështjeve mendja do të ishte hamendur dhe nuk do ta kishte pranuar. Mirëpo thënia e Zotit të Lartmadhëruar "dhe në ato (gjëra) të cilat nuk i dini", që kur pastaj do të zhvillohet mendja jote dhe shkenca, do ta mësosh dhe do ta kuptosh se çështja e çiftëzimit është prezent në tërë ekzistencën. Tash e kanë vërtetuar në shumë çështje, e kanë vërtetuar në atom, e kanë vërtetuar në fushën magnetike – pozitivin dhe negativin. Nuk na ka mbetur sot asgjë tjetër, pos t'i drejtohemi Zotit të Lartmadhëruar me lutjen "SUBHANE", se askush nuk ka mundësi për asgjë përpos Tij. Qoftë i Lartësuar Ai në dorën e të Cilit janë sundimet e çdo gjëje.

PSE NAMAZI HAPTAZI DHE FSHEHTAZI

Dëshirojmë ta dimë sekretin pse në namazin e drekës dhe të ikindisë Kur'ani lexohet fshehtazi ndërsa në namazin e sabahut, të akshamit dhe të jacisë Kur'ani lexohet me zë.

Imami i mirënjohur Shejh Shaëraviju thotë:

Sekreti qëndron në atë se muslimanët në fillim të Islamit kanë qenë të dobët dhe Kur'anin e lexonin me zë në namaz në kohën kur armiqtë e tyre flinin në shtëpitë e tyre në sabah dhe këndonin me zë në aksham dhe në jaci, sepse pabesimtarë ishin në gjumin e natës, ndërsa këndonin Kur'anin pa zë në namaz të drekës dhe të ikindisë sepse armiqtë ishin zgjuar dhe ishin të shpërndarë ditën në çdo vend. Ndërsa kur u forcua dhe me muslimanët nuk ishin të dobët, prapë mbeten namazet fshehtazi dhe namazet haptazi, pa e ndryshua gjendjen e mëparshme.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **Dhe mos këndo vetëm me zë në namaz, e as mos këndo vetëm fshehtazi në të, por kërko dhe përcjelle rrugën mes të dyjave-mesatare.**

E kjo do të thotë se falësi në namazin e tij duhet të këndoj edhe fshehtazi por edhe haptazi, pra duhet ta gjej rrugën mesatare.

KU ËSHTË SHKURORËZIMI I TRETË

Pyetje: Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: Shkurorëzimi dy herë, e pastaj ose le ta mbajë me mirësi, ose le ta lirojë (shkurorëzojë) me mirësi.

Këtu qartë e kuptojmë se ka të bëjë me shkurorëzimin sepse Zoti i Lartmadhëruar pastaj thotë: Dhe burrat e tyre kanë prioritet për t'i kthyer ato. Ky është shkurorëzim me të drejtë kthimi, pse fjala "shkurorëzim" ka të bëjë me veprimin e burrit dhe është atribut për njëjës dhe për shumës.

Pasi që ajeti tregon "shkurorëzimi dy herë", atëherë shtrohet pyetja: Ku është shkurorëzimi i tretë?

Përgjigje: Shkurorëzimi i tretë është në pjesën e ajetit ose le ta shkurorëzoj (liroj) me mirësi, pra kjo tregon se kuptimi i fjalës "dy herë"

është dy shkurorëzime, parafjala "f" tregon për pasimin e çështjes tjetër menjëherë. Pra ligjësimi i çështjes pason menjëherë çështja e njëjtë.

Ebu Davudi dhe Xhemaatun nga Ebi Rezijm el Esedi transmetojnë se një njeri ka thënë: O i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: Unë po e dëgjoj se Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: "Shkurorëzimi është dy herë". Po ku është shkurorëzimi i tretë? Është përgjigjur "ose shkurorëzimi (lirimi) me mirësi". Kjo pjesë e ajetit pra tregon shkurorëzimin e tretë.

SHKURORËZIMI I TRIHERSHËM NË TË NJËJTËN KOHË

A lejohet shkurorëzimi i trefishtë në të njëjtën vend dhe në të njëjtën kohë: Transmeton Bejhekiu nga Ibn Abasi r.a. se ka thënë Ruhanete e ka shkurorëzua bashkëshorten e tij tri herë në të njëjtën kohë dhe në të njëjtin vend, e pastaj është pikëlluar shumë. Kur i ka treguar të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. ka pyetur: Si e ka shkurorëzuar?

"E ka shkurorëzuar tri herë".

Muhamedi s.a.v.s. i tha: Në të njëjtën vend dhe në të njëjtën kohë: Tha Po!. Muhamedi a.s. i tha: Po kjo konsiderohet vetëm një shkurorëzim, si të duash, ke të drejtë të martohesh me të, pastaj. Pastaj u martua me të shkurorëzuarën.

SUKSESI DHE LUMTURIA NË JETË

Pyetje: Çka do të thotë fjala sukses dhe lumturi në jetë?

Përgjigje: Imami i nderuar Shejh Shaëraviju thotë:

Kuptimi i fjalës "sukses në jetë" është që e tërë jeta të ketë sukses, e jo vetëm ti. Me rëndësi është që i tërë aktiviteti yt i jetës me qenë i suksesshëm. Një shoqëri, në të cilën dominon apo e udhëheq dyfytyrësia dhe mashtrimi nuk mund ta quajmë sukses në jetën shoqërore. Sukses quhet kur tërë shoqëria është e suksesshme e jo vetëm individi.

Për me tregu më qartë: A të pëlqen ty me jetua në një rreth ku të gjithë ankohen, ky ankohet, ai ankohet. Pra ne ankohemi prej vetes sonë. Nëse secili

në shoqëri ankohet, ta dish se ankohet edhe ankuesi edhe i ankuari.

Ndonjëherë njeriu e donë të keqen kur heshtë, pra e keqja patjetër duhet me u largu. Njerëzit mendojnë se suksesi në jetë është kur vetëm ti ke arritur diçka, mirëpo esenciale është kur njeriu jeton, dhe të tjerët jetojnë pa u plasaritur mes vete, me qëllim që jeta e tij të jetë e sigurt. Nëse ai vet nuk është i fuqishëm mund të jetoj edhe pse është i dobët. Shoqëria e cila posedon hipokrizin, urrejtjen, egoizmin, dhe nëse ka plasaritje në mes të anëtarëve të saj, nëse ndonjëri është i fuqishëm ai u merr të drejtën e tjerëve me padrejtësi, po nëse është i dobët të tjerët ia marrin të drejtën me padrejtësi.

Njeriu i cili jeton, jetën pa u plasaritur me jetën e të tjerëve, ai është i lumtur në Çfarëdo forme. Mjafton që ata të cilët dëshirojnë që ta realizojnë suksesin e tyre në jetë me atë që e ka ndaluar feja, e ndalon Krijuesi, si me hipokrizi, rrenë, keqpërdoron dhe mashtron. Mjafton vetëm ajo se edhe pse para tjerëve duken të mëdhenj në veten e tyre, me vetveten e tyre ata janë të vegjël, sepse njeriu, në rend të parë me veten e tij duhet me qenë njeri, që do të thotë mos me u largu prej natyrshmërisë dhe mos ta tradhtojë veten e tij. Unë mundem me e mashtrua tërë botën, por si ta mashtroj veten time se?

Pastaj Imami i nderuar shton:

Kur unë kërkoj prej ndonjë njeriu të dëshmojë para gjykatës rrejshëm, për dobinë time, me dëshminë e tij unë kam përfituar diçka, mirëpo vetë unë pastaj e urrej dhe në çdo moment dëshiroj ta largojë ose e mbajë të nënshtruar dhe të nënçmuar.

Pastaj në fund, çfarë suksesi është i atyre të cilët korrin sukses në këso formash?! Ata kanë korrur sukses vetëm në fazën e parë të jetës (të kësaj bote). Mirëpo, jeta është e përgjithmonshme, e ata të cilët janë të drejtë dhe arrijnë sukses në përgjithësi, sepse Allahu u jep atyre të mira të përgjithmonshme, të cilat nuk ndërpriten asnjëherë.

TË SHKURORËZUARAT LE TË PRESIN TRI KOHËRA TË MENSTRUACIONEVE

Pyetje: Çka ka për qëllim fjala "pritje" dhe "kohëra" në pjesën e ajetit dhe cila është dispozita e ajetit për të?

Përgjigje: Në thënien e Zotit të Lartmadhëruar "Le të presin" është kallëzues, dhe ka për qëllim formën urdhërore në mënyrë alegorike.

Qëllimi për këtë që femrat ta kenë vëmendjen dhe le t'i presin sepse pjesëza ب - **B** është pjesëz transitive, që do të thotë se i urdhëruari duhet që të ngarkohet për të pritur, kjo është gjendje shpirtërore e mrekullueshme, sepse ato munden që të jenë ende tërheqëse për burrat e tyre, të cilët i kanë lëshuar. Ndërsa thënia e Zotit të Lartmadhëruar "tri kohëra" është kallëzues i ndajfoljes, sepse është shprehje për afatin-kohëzgjatjen "Mefuli bihi" është i anuluar, sepse fjala "pritje" është transitive. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"Dhe Ne ju presim ju, deri sa t'ju dënoj juve Allahu". Le të presin për martesë, ndërsa anulimi sinjalizon se ato duhet që të mos martohen brenda këtij afati, por edhe të mos diskutojnë për martesë.

"Kuruë-kohëra" është shumës i "Kur -it- kohës" e ka kuptimin e menstruacionit.

Transmetojnë Nesaiju, Ebu Davudi, Darukutnij se Fatimeve bint Ebi Xhehsh ka thënë:

"O i Dërguar i Allahut, nëse femra është e papastër me ISTIHAD, a e len namazin që të mos e falë? Muhamedi s.a.v.s. i thotë: Jo. Le të mos e falë namazin vetëm gjatë menstruacionit".

Po ashtu "Kur'ë" ka kuptimin e pastrimit, pra kohën e pastërtisë së gruas në mes të dy menstruacioneve.

ISLAMI ËSHTË SIMBOL, EMËR DHE CILËSI

Drita e Islamit ka depërtuar te të gjitha vendet e botës dhe do të jetë deri në Ditën e Kijametit.

Misioni i Islamit ka ardhur me planprogram të qëndrueshëm dhe stabil, i cili i siguron paqe dhe i sjellë të mira njerëzimit në këtë botë dhe në botën tjetër. Fetë të cilat kanë qenë para Islamit bazën po ashtu dhe burimin e kanë pasur prej Islamit, mirëpo Islami në të cilin është dërguar i Dërguari i ynë s.a.v.s. i ka përfshirë të gjitha dhuntitë e Allahut.

Askush nuk mund ta mohojë se Islami ka ardhur mrekulli e çdo suksesi të mendjes së njeriut, dhe sikur të zbriste para kohe, mendja dhe logjika vështirë e kishte pasur ta kuptojë, por ka ardhur në kohë të përshtatshme për ta zhvilluar logjikën dhe të kuptuarit. Nga këtu ka filluar të pranuarit dhe të kuptuarit e obligimeve.

Në Kur'anin fisnik qartë tregohet se fetë e mëparshme burimin e kanë pasur prej Islamit, dhe në tolerancën e tij, ndërsa ka pasur vetëm disa degëzime të cilat kanë qenë të natyrës së lehtë.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"A ishit ju (ithtarë të librit) dëshmitarë kur Jakubit iu afrua vdekja, e ai bijve të vet u tha: "Çka do të adhuroni pas meje"? Ata thanë: Do ta adhurojmë Zotin tënd dhe Zotin e prindërve tuaj: Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, një të vetmin Zot dhe ne vetëm Atij i jemi dorëzuar!"(El-Bekare, 133)

"Ju (besimtarë) thuani: Ne i besuam All-llahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin të ndarë në dymbëdhjetë kabile), atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm atij i jemi bindur".(El-Bekare, 136)

Parashtrohet pyetja: Si të dallojmë Islamin i cili ka qenë në fetë e përparme, dhe Islamin të cilin e ka zbritur Allahu vulë e feve të mëparshme, nëpërmjet më fisnikut dhe më të ndershmit, zotërisë tonë Muhamedit s.a.v.s.?

Përgjigje: Imami i nderuar Shejhu Muhamed Muteveli Shaëraviju përgjigjet: Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Luftoni me një luftë të denjë për hir të All-llahut, se Ai ju zgjodhi

ju (ju përcaktoi për të luftuar për rrugën e Tij) dhe nuk ju obligoi në fe me ndonjë vështirësi, në fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai edhe më parë, e edhe ky (Kur'an) ju quajti muslimanë, e për të qenë i dërguari dëshmitar juaji dhe për të qenë ju dëshmitarë ndaj njerëzve, pra falni rregullisht namazin, jepni zeqatin, përmbahuni me All-llahun se Ai është ndihmëtari juaj. Sa mbrojtës i mirë dhe sa ndihmëtarë i madh që është".(El-Haxh, 78)

Këtu teksti Kur'anor është i qartë dhe i definuar se Imani është i ndërlidhur me ibadet, ndërsa ibadeti është i ndërlidhur me veprim. Puna e mirë kërkon përpjekje në rrugën e Allahut të cilën Allahu e ka zgjedhur si besim për besimtarët, dhe nuk ka asgjë në fe që është vështirë për njeriun për ta kryer.

Islami është feja përfundimtare, ashtu siç ka qenë prej fillimit feja e parë. Ibrahimi a.s. është baba i besimtarëve.

Allahu veç e veç i quajtur besimtarët muslimanë, e ju jeni dhe keni qenë muslimanë në librat, të cilat kanë zbritur para Kur'anit, për t'i kënaqur dhe për t'i bërë të lumtur besimtarët në atë çka e ka ligjësuar (përcaktuar) Allahu më parë ka qenë ashtu siç Allahu ju ka quajtur muslimanë. Le të jetë përfundimi i islamit tuaj përsosmëri dhe kompletim i këtij islami, derisa i dërguari të dëshmojë për ju në Ditën e Kijametit, se ai ua ka transmetuar fenë, e ju keni vepruar atë që u ka mësuar dhe të jeni të lumtur edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër.

Kështu ne shohim se Allahu na ka quajtur neve muslimanë e nuk na ka cilësuar muslimanë, sepse për besimtarin islami është emër, cilësi dhe simbol.

Për këtë arsye është shumë e qartë se feja te Allahu është Islami, dhe emri Islam është cilësi e jona dhe simbol për ne, ndërsa sa i përket Islamit, për ata që kanë qenë para nesh ka qenë vetëm cilësi. Për këtë arsye, të gjitha fetë janë të cilësuar fe muslimane, ndërsa ne - pasuesit e Muhamedit a.s. jemi muslimanë me emër, me cilësi dhe me simbol; islami i ynë është superiori.

PARAQITJA E BURRIT TË PARË

Zhduket burri në luftë, dhe nuk ka kurrfarë shenja të gjallërisë, pas një kohe gruaja martohet me një burrë tjetër dhe pasi që martohet, pas një kohe, befasisht paraqitet burri i saj i parë. Si duhet vepruar?

Kur iu është bë kjo pyetje Shaëravijut është përgjigj: "Patjetër duhet të ngrihet aktpadia në gjyq".

NUK DO TË ARRINI VETËM SE ME FUQI

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Thuaji (o Muhamed): po sikur të tuboheshin njerëzit dhe xhinët për të sjellë diçka të ngjashme sikur Kur'ani, nuk mund të sjellin të ngjashëm edhe sikur t'i ndihmonin njëri-tjetrit." (ISRA)

Po ashtu thotë:

"O ju grup e xhinëve dhe e njerëzve nëse dëshironi t'i kaloni hapësirat e qiejve dhe tokës, atëherë kaloni, por jo, nuk mundeni përpos se me fuqi".(ERR-RRAHMAN)

Këtu na del e qartë se fjala "insan" kur të vjen në një fjali me xhinët, Zoti i Lartmadhëruar e përdorë "insan". Ku fjalën njeri (insan) e vë para fjalës xhin në ajetin e parë, mrekullia e kësaj është se fjala njeri, me fjalë njeriu është më i theksuari dhe më i njohur për ne se sa xhinët.

Pyetja e cila na parashtrohet neve është: Cili është kuptimi i fjalës së Zotit të Lartmadhëruar "Dhe ju nuk mund të ngriheni vetëm se me fuqi". A është në pyetje fuqia absolute e Allahut apo mos është në pyetje "fuqia e diturisë" apo çka?

Imami i nderuar Shejh Shaëraviju thotë: Disa mendojnë se fjala sulltan ka për qëllim fuqinë e diturisë ndërsa ne mendojmë se fjala "sulltanë" ka për qëllime fuqinë absolute të Allahut të Lartmadhëruar. Patjetër duhet të dëshmohet para gjithë botëve paaftësinë e tyre në atë që patjetër duhet besuar në fuqinë e absolute të Allahut.

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. kur e bëri Isranë dhe është ngritur në

qiellin e shtatë, e pastaj në Sidretul Munteha, e ka bërë me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar.

Në ditën e kiametit ne do të jemi në çdo vend me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar. Melekët të cilët zbresin në tokë dhe ngrihen lart në qiell, e bëjnë me fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar .

Po sikur ajeti "nuk mund të ngriheni vetëm se me fuqinë" nuk do ta kishte domethënien fuqinë e Allahut, atëherë disa njerëz do ta vinin në dyshim mrekullinë e Israsë dhe Miëraxhit. Mirëpo pasi që Israja dhe Miëraxhi ka ndodh kjo do të thotë se Allahu i Lartmadhëruar është Ai i cili bën çka do, dhe e ngrit në qiell çdonjërin që ai e parasheh dhe e përcakton.

Po nëse ndonjëri na thotë: Ja njeriu është ngritë në hapësira të tokës dhe qiellit pasi që ka arritur në hënë ne i përgjigjemi: Njeriu ka arritur të ngrihet lart dy sekonda të vitit të dritës e i kanë mbet edhe miliona vit drite e cila është pjesë e qiellit të kësaj bote. Ai pra nevojitet në lartësi të miliona vit drite, për të arritur në lartësi të qiellit të dynjasë të cilën ne e shohim ndërsa në lartësi përpos qiellit të dynjasë as që ka arritur. Pastaj, Shejh Shaëraviju këtë çështje shumë të rëndësishme e përfundon duke iu kundërvu atyre të cilët tentojnë që Kur'anin ta quajnë libër njeriu, ndërsa e harrojnë fuqinë e Allahut dhe i shikojnë vetëm çështjet sipërfaqësore për me i zhvillu problemet e tyre të cilat nuk janë të tyre sepse unë kur të ngrihem për disa minuta drite prej miliona vite drite rrugë nuk mund të them, por asnjë njeri i logjikshëm nuk mund të thotë se është ngritur në një lartësi të madhe prej milion vit drite e cila është në thellësi të qiellit të kësaj bote. Për këtë arsye, është e sigurt se mrekullia e Israsë dhe Miëraxhit është mrekulli e përgjithmonshme ajo do të jetë mrekulli e përgjithmonshme deri në ditën e kiametit. Dhe njeriu sado që do të ngrihet lartë, sado që do të zhvillohet dhe sado që do të arrij dituri ai kurrë nuk mund të arrij në horizontet, apo lartësitë e qiellzave dhe të tokës, por nuk do të mundet as në lartësitë e qiellit të tokës e mos të flasim në shtatë qiejt. Pra për këtë arsye mrekullia e Israsë dhe Miëraxhit do të mbetet mrekulli i përgjithmonshëm dhe argument (shkencë) e cila thërret njerëzit në besim në Zotin dhe në fuqinë absolute të tij.

NAMAZI I BASHKËSHORTES ME BASHKËSHORTIN E SAJ

A pranohet namazi i gruas me bashkëshortin e saj?

Po, dhe ajo duhet të jetë në safë në vete.

Mirëpo nëse gruaja bëhet Imam ajo duhet të jetë në një safë me gratë (por pak përpara). Femra nuk lejohet të bëhet Imam i burrave.

NUK I NGJASON ASGJË

Zoti i Lartmadhëruar është cilësuar me cilësi precize ashtu që mendjen e njeriut e cila luhatet prej një ane në anën tjetër ta vendos në vijën e prerë, që mos ta imagjinoj këtë të ekzistuarit e Zotit për t'i dhënë formë Krijuesit të Lartmadhëruar, ose me e cilësua Zotin e Lartmadhëruar me cilësi të shqisave të thjeshta të njeriut, të cilat janë të kufizuara dhe janë cilësi të krijesave.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: Nuk ka të ngjashëm si Ai asgjë. Kjo sikurse po i thuhet njeriut: Lëre veten qetë nga çështjet e kota, për me i hulumtua çështjet të cilat nuk janë të Kandarit tuaj.

Çka mendon Shejh Shaëraviju në lidhje me pjesën e ajetit Kur'anor "Nuk ka të ngjashëm si Ai asgjë".

Imami i nderuar thotë: Kur të dëgjosh psh. se Allahu i Lartmadhëruar ka këmbë, dëgjon e sheh, ti nuk di për këmbë e duar pos atë që e sheh në veten tënde, nuk e di të dëgjuarin pos ashtu siç e di në vetvete. Ne nuk themi: Dëgjimi i Allahut është i ngjashëm me dëgjimin e krijesave, sepse esenciale është "Nuk ka të ngjashëm si Ai asgjë". Të gjitha cilësitë dhe emrat të cilat janë të Allahut janë po ato cilësi te Krijesat, mirëpo ti përqendrohesh dhe po i përkufizon ato cilësi të cilat Allahu e ka cilësi veten.

Mënyra e atyre çështjeve nuk është domosdoshmëri e Imanit. Mënyra se si është diçka në një çështje nuk është domosdoshmëri e Imanit. Zoti ynë na ka tregu: Unë shikoj, unë dëgjoj, pra Ai ka të shikuarit, ai ka të dëgjuar, mirëpo ti mos e merr mënyrën të cilën e di të dëgjuarit dhe të shikuarit në krijesat dhe të thuash: Zoti ynë sheh dhe dëgjon si ne. Jo! Kurrsesi jo. Po shtrohet pyetja pse? Sepse ti dëshmon se Zoti ynë ekziston, krijesat

ekzistojnë, mirëpo a janë krijesat si Krijuesi, pse të dëgjuarit e krijesave po e ngjason me të dëgjuarit e Tij, ose të dëgjuarit e Tij e ngjason me krijesat. Ti ndryshon, dhe e di se ndryshon prej Krijuesit. Allahu jeton, njeriu jeton por a është jeta ime si jeta e Tij. Ai jeton, ti jeton por a është jeta jote si jeta e Tij. Jo! Kurrsesi jo!.

Çdo emër apo cilësi e Zotit i cili na ka ardhur në Kur'an dhe hadithë është edhe te njeriu. Ti tani gjendesh para dy çështjeve: As të mos bësh ngjasim, por as të mos i mohosh. T'i mohosh do të thotë: që ti të thuash: Jo, ai nuk ka dëgjuar, sepse të dëgjuarit është cilësi e njeriut. Ne themi: Ti po bën krahasim të dëgjuarit tënd i cili ka mjetin (veshin), dhe ti po e pastron Allahun nga kjo çështjeje. E vërtet është ashtu ti dëshiron me i përshkrua atij diçka, mirëpo pse nuk po e pranon tekstin Kur'anor. Ai ka thënë: Unë kam të dëgjuar, ti pranoje atë se ai ka të dëgjuar, mirëpo pastaj mënyra se si dëgjon nuk është çështja jote, se asnjëherë "mënyra" nuk është çështje e Imanit.

Imami i mirënjohur sqaron një çështje shumë të rëndësishme:

Ne kemi treguar një herë, kur e ka pyetur Zotin e Tij, çka e ka pyetur: Më trego (mënyrën) si i ngjallë të vdekurit? Zoti i ka thënë: A nuk po beson? Ai iu është përgjigj: Po, gjithsesi besoj, pra ai ka besuar mirëpo ai ka dashur ta kuptoj mënyrën "mirëpo që të më qetësohet zemra ime". Ai i cili dëshiron me polemizua çështjen e thuktë, ai thotë se këtu ka kundërthënie, ju po thoni se Zoti ka thënë: mirëpo po jemi indiferent në atë se këtu ka kundërthënie.

Cili është kuptimi i Imanit? Iman do të thotë qetësimi dhe pushimi i zemrës në një çështje aq shumë sa që nuk të shkon ndërmend me bisedua më për atë çështje. Nëse fillon që edhe njëherë me diskutua për atë çështje, atëherë nuk ke arritur në shkallën e Imanit, që do të thotë ti veç e ke Imanin por ende po hulumton për të. Mendo Imani është qetësimi dhe pushimi i zemrës në një çështje dhe puna mori fund, dhe s'ka mbet hapësirë më që ta diskutosh çështjen e Imanit.

Përsërisim: "Gjithsesi po" do të thotë: kam besuar, por bëhet pyetja: Çka donë të thotë kam besuar? Do të thotë qetësimi dhe pushimi i zemrës në këtë çështje sa që as që më shkon ndërmend që të diskutoj edhe ndonjëherë. Mirëpo "Që të më qetësohet zemra ime". Kërkimi i diçkaje që ka humbur prej saj, dhe përderisa unë kërkoj që të më qetësohet zemra, sikurse bëhet e ditur se ende nuk është arritur qetësimi i zemrës, përderisa ai qetësim po kërkohet, pra është e palogjikshme të kërkohet Imani me fjalën "po gjithsesi".

Ne i themi atij: Ti po del prej teme, se ne po shikojmë pikësynimin e

fjalëve. Pse, a mos ka thënë Ibrahimi: O Zoti im, a ti i ngjall të vdekurit? Jo, nuk ka thënë ashtu, por ka thënë: Si i ngjallë të vdekurit? Pra kur bëhet pyetja "Si?" pra për mënyrën e ngjalljes, kjo do të thotë se beson në ngjalljen por e dëshiron me pa formën e ngjalljes. Pra Ibrahimi a.s. ka besua në ngjalljen e të vdekurve, dhe kjo është çështja të cilës po e diskutojmë, dhe kjo është Imani, mirëpo pyetja *si* nuk është çështje të cilën e kërkon Imani.

PRANGOSJA E SHEJTANËVE NË RAMAZAN

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: ***Kur të vjen muaji Ramazan, hapen dyert e xhenetit, mbyllen dyert e zjarrit dhe prangosen shejtanët. I DËRGUARI I ALLAHUT E KA FOLUR TË VËRTETËN***

Prangosja e shejtanëve do të thotë të lidhurit e tyre izolimi dhe paralizimi i tyre për çdo aktivitet i cili nuk e lejon shpërndarjen e të mirës ose gjërave që sjellin mirësi. Mirëpo, ne shohim se shumica prej neve prangosen prej punëve të mira, ato i prek me fjalë tjera i përvetëson shejtani dhe i përvetësojnë xhinët, shohim gënjeshtarë, rrenacak, tradhtar, mashtrues, por edhe që hanë haptazi në ramazan, të gjitha këto janë shenja të qarta se ata janë të manipuluar prej shejtanit.

Pyetja është:

Si janë të prangosur shejtanët, dhe të mbyllur në ramazan pas të gjitha këtyre dukurive negative të përditshme. Disa fukaha (dijetarë të jurisprudencës islame) këto dukuri i arsyetojnë me atë se janë të prangosur dhe të mbyllur vetëm një lloj i shejtanëve, ndërsa lloji tjetër jo!.

Disa tjerë thonë se: Të gjithë shejtanët në përgjithësi janë të prangosur, dhe e vërtet është ashtu siç tregon hadithi po të gjitha punët e ndyta dhe amorale janë rezultat i njerëzve shejtan dhe të ngjashëm me ta, të cilët më nuk kanë nevojë që shejtani t'i përvetësoj, t'i hutoj që të mos largohen prej punëve të këqijave dhe harameve.

Mirëpo i nderuari ynë në lidhje me këtë çështje thotë: Kemi dy lloje të fjalive: Fjali lajmëtare, pra që tregojnë realitetin e kaluar, dhe fjali fillestare apo veprim formuese e cila ka për qëllim veprimin e tanishëm dhe të ardhshëm. Fjala vjen: Zoti i Lartmadhëruar në ajetin Kur'anor për Qaben thotë dhe kush hynë në të (Qabe) është i sigurt. Nëse kjo fjali ka për qëllim

lajmërimin e së kaluarës, atëherë është e pamundur që të ndodh diçka çka është në kundërshtim me fjalën e Allahut, por nëse ka për qëllim fjalinë fillestare apo veprim formuese, atëherë ky ajet është urdhër prej Allahut për njerëzit që ata të cilët hynë në Qabe le të jenë të sigurt sepse ne në realitet mund të shohim që të ndodh e kundërta që mos të jenë njerëzit të sigurt në të, mirëpo kjo është sepse njerëzit nuk e kanë dëgjua urdhrin e Allahut.

Po ashtu nëse e shohim ajetin Kur'anor: **"Të mirat për të mirët, të mirët për të mirat dhe të këqijat për të këqijtë e të këqijtë për të këqijat"**. Në realitet shohim se ka të mirë për jo të mirat, dhe e kundërta, por esenca është se nëse e dëgjojmë fjalën e Allahut, dhe veprojmë me të atëherë të mirët i martojmë me të mirat, por nëse nuk e dëgjojmë fjalën e Allahut ndodh e kundërta të mirët për jo të mirat. E njëjta është edhe me hadithin e prangosjes së shejtanëve, në hadith kemi fjalinë e cila ka për qëllim veprim formimin pra hadithi ka për qëllim "prangosni shejtanët" e ne nëse e dëgjojmë hadithin i prangosim shejtanët, mirëpo nëse nuk e dëgjojmë atëherë shejtanët nuk prangosën, pra ne jemi të urdhëruar që kjo me ndodhë që ata (shejtanët) me u prangosë.

PËRBETIM PËR MOSKONTAKTIM SEKSUAL ME GRUAN

Pyetje: ILAË - siç thotë Err-Rragibi është përbetimi i cili ka të bëjë për pakësimin, apo mosveprimin e çështjeve për të cilën përbetuesi është përbetuar. Siç thotë Zoti i Lartmadhëruar: "Nuk përbetohet rrejshëm". Po ashtu ajeti kur'anor:"Dhe të mos përbetohen të nderuarit prej mesit tuaj". Mirëpo në terminologjinë e sheriatit "IJLAË" është të përbetuarit e burrit për moskontaktim seksual me gruan e tij.

Përgjigje: Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Për ata që përbetohen për moskontaktim me gratë e tyre, afati i pritjes është katër muaj. Por nëse pendohen atëherë Allahu është Falës i Mëshirshëm."

Pra, thënia "afati i pritjes së tyre është katër muaj" ka për qëllim për me ndërprerë dhe me ndaluar. Pra iu është shtuar ndajfolja e kohës *katër muaj*. E kjo do të thotë se ndajfolja është kryefjalë, ndërsa para saj është

kallëzuesi. I këtij mendimi është gramaticienti Ahfesh, pra e parashoh veprimin e tillë.

LUTJA PËR ZOTIN TIM DHE PËR MUA

Një beduin ka kërkua prej Muhamedit a.s. për t'ia mësuar një dua, Muhamedi a.s. ia mëson:

"LA ILAHE ILALLAHU VAHDEHU LA SHERIKE LEH ALLAHU EKBERU KEBIRA VELAMDULILAHI KETHIJRA VE SUBHANELLAHI RABIL ALEMINE VE LA HAVLE VE LA KUVETE IL-LA BIL-LAHIL AZIJZIL HAKIJME. E ai i ka thënë kjo është lutja për Zotin tim, por lutja për mua?

O Zoti Im, më mëshiro, më udhëzo, më furnizo, më fal, kjo dua përfshin këtë botë dhe botën tjetër".TRANSMETON MUSLIMI

PREJ DUAVE TË NAMAZIT

Ebu Bekri Sidiki ka kërkua prej Muhamedit a.s. me ia tregu duan të cilën e thotë në namaz.

Muhamedi a.s. ka thënë:

O Zoti Im, unë i kam bë vetës padrejtësi të shumta, ndërsa gabimet nuk mund ti fal askush pos Teje. Më fal më faljen Tënde, dhe më mëshiro. Vërtet Ti je Falës i Mëshirshëm. (MUTEFIKUN ALEJHI)

SHPIRTI

Dihet mirëfilli se njeriu përbëhet prej dy komponentëve: prej materies dhe shpirtit, po ashtu dihet se shpirti është prej Allahut dhe mëshirës së Tij, dhe se shpirti besnik, pra Xhibrili është përcjellës i programit të Allahut, pra Kur'anit i cili po ashtu është shpirt, pyetja është: A është shpirti me të cilën Zoti i Lartmadhëruar e ka frymëzuar materien për ta lëvizur, për të ndier, në të vërtetë po ai shpirt të cilin Allahu ia ka dhënë planprogramit të tij Kur'anit.

Përgjigje: Kurrsesi jo, shpirti i parë është ai i cili është edhe në jetën e besimtarit edhe në jetën e pabesimtarit ndërsa shpirti i dytë është ai shpirt i cili i jep jetë lumturi të përgjithmonshme dhe jetë më me vlerë e kjo është ajo jeta e vërtetë.

ISLAMI DHE EDUKIMI I EPSHIT-NDJENJAVE

Shumë herë Shejh Shaëraviju ka sqarua se Islami nuk ka ardhur me i paralizua ndjenjat por përkundrazi ka ardh me i edukua, me i kënaq, e këtë e bëni për me sigurua njeriun prej shkatërrimit.

Në realitet shumica, në shumicën e rasteve i pasojnë epshet e tyre, nuk i përmbahen planprogramit të Allahut të Lartmadhëruar. Islami dhe mësimi i tij i pastër është për me mbrojt njeriun nga rrëshqitjet, nga gabimet dhe e siguron atë pasi që vazhdimisht ia tërheq vërejtjen njeriut për mos me ra në grackë të shejtanit.

Pyetja është: Cili është sekreti psikologjik i njeriut kur ai bënë prostitucion p.sh. ndërsa ai e di (qind për qind) plotësisht se është mëkat prej mëkateve të mëdha, mirëpo ai prapë e vazhdon për të dytën për të tretën?

Imami i nderuar përgjigjet në këtë pyetje: Njeriu i cili tejkalon kufijtë e tij dhe krekoset, është si rezultat i mos ndëshkimit dhe mos dënimit të tij për kryerjen e atij krimi.

Nëse njeriu bën krim dhe dënohet për atë krim, ai dënim është për të mirën e tij. Imami i mirënjohur sqaron një çështje shumë të rëndësishme kur thotë: Nëse shikojmë p.sh. dënimin për epshin seksual do të shohim se Zoti i Lartmadhëruar nëpërmjet atij dënimi dëshiron ta ruaj, ta mbroj dhe ta siguroj

njeriun prej asaj çka e shkatërron atë dhe për ta siguruar po ashtu tërë shoqërinë.

Transmetohet se një njeri ka ardhur te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe i ka thënë: ***Unë të premtoj se i përmbahem ligjeve Islame dhe jam musliman mirëpo jam njeri i cili i dua gratë, femrat dhe nuk mund të largohem nga kjo (prostitucioni). A nuk po ma lejon këtë mua!? Muhamedi a.s. nuk e ka përdorë menjëherë forcën e ashpërsinë, por është sjell si edukator, ka dashur që atij njeriu t'ia mësoj urtësinë dhe qëllimin e ndalesës në atë mënyrë që ai njeri ta kuptoj dhe ta ndiej thellë në zemër. Muhamedi a.s. e ka pyetur: A dëshiron që kjo t'i ndodh nënës tënde (që dikush tjetër pos babës tënd të kontaktoj seksualisht me të). Ai menjëherë me dëshpërim i thotë: Jo. Po a dëshiron që kjo t'i ndodh motrës tënde? Ai prapë me dëshpërim i thotë jo! A dëshiron t'i ndodhë gruas tënde? Ai i thotë jo, jo. Po secili prej neve është ashtu (me nënë,grua, e motër) o vëllai ynë.***

Kështu i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka dashur të sqaroj se qëllimi i ligjeve të Allahut është që të mbrohet nëna, motra, e gruaja gjë të cilën asnjë nuk dëshiron që tu ndodh e keqja.

Nëse çdo prostitutit gjatë prostitucionit të tij i kujtohet ky dialog dhe e kujton nënën e tij, motrën e tij dhe gruan e tij do të largohej menjëherë nga prostitucioni.

Pra dispozitat e sheriatit janë për t'i edukua dhe për ta forcua shpirtin, dhe çdo dispozitë është për me sigurua individin dhe shoqërinë. Islami nëse ta përkufizon një liri, ai me të e pengon tjetrin me keqpërdorë të drejtën tënde, nderin tënd.

JA RAB (O ZOT !) DHE DËSHIRA ABSOLUTE

Ku po jetë dëshira absolute e cila është në librin e Allahut, dhe cila është ndërlidhmëria e saj dhe pranimi i duasë së besimtarit, kur t'i ngritë duart lartë dhe thotë "O ZOT!".

Imami i mirënjohur Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë: Fjala: O Zot? Kur të buron nga zemra e atij të cilit iu është bë padrejtësi. Nuk ka forcë as fuqi të ndryshoj diçka por është rezultati i fuqisë së Allahut i cili e ka

caktua ligj (siç i ka caktua ligjet) hyjnorë, pra ligj të Tij, pra ligj të shkaqeve, që do të thotë ai i cili klith O Zot? Atëherë është ligj që shkaqet të mos funksionojnë dhe realizohet "Nuk ka fare as fuqi të ndryshoj atë që Ai cakton". Nga kjo themi se atij si ka mbet asgjë tjetër përpos që me i ngrit duart në qiell dhe me kërkua fuqinë absolute, sepse vetëm ajo lutje është mjeti i fundit i cili me ia kthye të dobëtit, të drejtën e tij, që me iu kthye e drejta prej të padrejtit tek ai të cilit iu është padrejtësi. Zoti i Lartmadhëruar fuqinë e Tij dhe caktimin e Tij absolut nuk e ka fsheh nga ne, por përkundrazi në shumë në shumë ajete të Kur'anit hasim nëse e lexojmë atë: "me mëshirën e Tij e veçon kë të donë Ai", "e dënon atë që do Ai", "e falë atë që do ai", "e ngrit lartë kë të do Ai, dhe e zbret poshtë cilin do Ai", "i jep pushtet dhe pushtim atij që do Ai, dhe e zbret nga pushteti atë të cilin do Ai". Vërtetë "Allahu ka mundësi për çdo send".

Pra, po shohim se Zoti i Lartmadhëruar në këto ajete, dhe në ajetet tjera na ka tregua qartë fuqinë e Tij absolute, ndoshta fuqia absolute dhe rezultati kulminant i kësaj është i shprehur në ajetin Kur'anor "Vërtetë, çështja e Tij (Allahut)" është se kur dëshiron diçka, mjafton që vetëm me i thënë asaj çështjeje bëhu dhe ajo bëhet menjëherë.

Kjo për arsye se ky ajet na tërheq vërejtjen se për Allahun nuk funksionon shkaqet, edhe pse ai i ka krijua ato shkaqe për me organizua sistemin e jetës në tokë. Po të kishin qenë shkaqet diçka përfundimtarë për Allahun. Zoti i Lartmadhëruar në ajet Kur'anor do të kishte thënë "Vërtetë Ai kur të dëshiron diçka i përgatit shkaqet dhe rrethanat që të bëhet", por fjala "bëhu" do të thotë se shkaqet janë të paralizuara dhe se vetëm fjala "bëhu" bën që të bëhet pa shkaqe dhe rrethane.

Kështu, krijimi i qiejve është bë me "bëhu" krijimi i njeriut është bë me fjalën "bëhu" dhe dëshira e tij mjafton dhe i mjafton vetëm fjala "bëhu".

Këtë çështje Shejh Shaëraviju na sqaron më shumë me rastin e tregimit të Ibrahimit kur është hedhur në zjarr, pse cilësi e zjarrit është që ai me djegë, por Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: "O zjarr bëhu i ftohtë dhe sjellë qetësi Ibrahimit". Në atë moment cilësia e zjarrit e cila është djegia u bë cilësi e cila nuk djeg dhe nuk lëndon.

INSPIRIMI (NGULITJA NE ZEMËR-MENDJE)

Të gjithëve po na intereson një çështje, cili është dallimi në mes të asaj: vendosje në zemër, ngulitje në zemër dhe ideve të njeriut, sepse çdo njeriut mund t'i vjen një ide në mendje.

Imami i mirënjohur Shaëraviju thotë:

Ai i cili vendos, ngulit në zemër bëhet nëpërmjet përcjelljes në zemër dhe se ajo është prej Allahut dhe ai "mendim" është i drejtë dhe i vërtetë, nuk ka dyshim në të sepse: ne kur kemi tregua me rastin e nënës se Musa a.s.: **Ne e kemi inspirua (e kemi vendos në zemrën e saj) jepi gji dhe nëse e ndien frikë (se ta marrin) hidhe në det e mos u pikëllo, as mos u brengos, sepse Ne prapë do ta kthejmë tek ti, dhe do ta bëjmë prej pejgamberëve. (KASAS)**

Kemi thënë: A dëgjoi dhe veproi nëna e Musaut apo jo? Natyrisht se po, ajo dëgjoi dhe veproi. Dëshiroj ta di cila nënë nuk pikëllohet dhe nuk brengoset për fëmijën e saj, nëse unë i them hidhe në det fëmijën tënd e mos u brengos. Cila logjikë e pranon këtë, kush e beson po mos të kishte ardhur kjo ide dhe ky mendim në zemër jo prej njeriut, as prej shejtanit por vetëm Allahut. Nuk do ta kishte bë nëna e Musa a.s. një gjë të tillë e cila është në kundërshtim me natyrshmërinë dhe logjikën e njeriut. Si me i dhënë përparësi vdekjes së sigurt (hedhjes së fëmijës në det) prej vdekjes së dyshimtë (me mbajt fshehtas). Pra inspirimi (ngulitja në zemër) është ide nga lartë poshtë (prej Zotit te njeriu).

ËSHTË PREJ KADERIT TË ALLAHUT

Një arab (beduin) e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: ***O i Dërguari i Allahut: A të mjekohemi? Është përgjigjur: Po, sepse Ai i cili e ka zbritur sëmundjen e ka zbritur edhe mjekimin (ilaçin). E mëson ai i cili studion, dhe nuk e mëson ai i cili e inspiron. Mjekohuni, vetëm se mos u mjekoni me haram. E KA REGJISTRUAR AHMEDI***

Në Sunen disa arab (beduin) e kanë pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: ***A të mjekohemi? Është përgjigjur: Po! Rob të Allahut mjekohuni, sepse Allahu nuk ka vendos sëmundje e të mos ketë vendosë shërimin***

(mjekimin) e saj përpos një sëmundje. E cila është ajo o i Dërguari i Allahut? Ajo është pleqëria.

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: ***Çka mendon nëse përdorim Rukje për shërim, apo ilaçe për shërim, a nuk e kthen (e largon) kaderin e Allahut? Është përgjigjur: Po mu ajo është kaderi i Allahut. E KA REGJISTRUAR TIRMIDHIU***

Mjekimi në spital po ashtu është prej kaderit të Allahut.

Përgjigje: Në lidhje me këtë Shejh Shaëraviju jep mendim shumë të rëndësishëm: Mjekësia mjekon, ndërsa Allahu shëron. Mjekimi mund t'ia qëlloj por edhe mund të gaboj, sepse shumica e pacientëve vdesin mu në duart e mjekëve të tyre-SUBHANALLAH.

Imami i nderuar thotë: Mjeku i cili ia ka qëllua me diagnozën e tij dhe shëron ai nuk e ka largu kaderin e Allahut.

TOKA ËSHTË XHAMI DHE E PASTËR

Pyetje: I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: ***Jam i privilegjuan ndaj pejgamberëve tjerë me 6 gjëra: Më janë dhënë të gjitha njohuritë, jam i ndihmuar me atë se tjerët ma kanë frikën, më është lejua teprica e pasurisë prej frontit, toka më është bë xhami dhe e pastër, jam vula e pejgamberëve dhe do të bëj shefat në ditën e kiametit.***

Në thënien e të Dërguarit s.a.v.s. më është bë toka xhami dhe e pastër: Na vendos neve në tavolinë një çështje përfundimtare e ajo është se falja e namazit për çdo person është e lejuar absolutisht në çdo vend.

Ku është dallimi në mes të faljes së namazit në çdo vend dhe faljes së namazit në xhami?

Imami i mirënjohur Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë: Toka është e pastër dhe xhami, ka vende ku lejohet të falet namazi e po ashtu lejohet të zhvillohet aktiviteti jetësor. P.sh. Në fabrikën tënde, ti edhe punon edhe falesh, në arën tënde edhe mbjell, por edhe falesh, në objekte arsimore edhe mund të studiosh por edhe të falesh në të. Pra në vendet publike lejohet edhe namazi por edhe veprimtaritë tjera jetësore.

Mirëpo nëse dëshirojmë që ndonjë vend ta veçojmë vetëm për namaz,

themi: Ky është vend ku nuk zhvillohen aktivitetet e jetës por është e veçuar vetëm për namaz, atëherë këtë vend e quajmë Xhami, mesxhid apo shtëpi e Zotit. Për këtë arsye Muhamedi a.s. ka thënë: Mos lidh kontratë tregtie derisa të jesh në xhami, e po ashtu as me kërkua send të humbur aty, pse aty ishte koha ku do të takohesh me Zotin tënd e nuk lejohet me qenë indiferent ndaj tij. Mjafton që ti i ke 24 orë në disponim, e prej atyre 24 orëve një orë me e nda për me u taku me Zotin, e në atë orë largohesh prej aktivitetit të jetës. Pra përcaktimi i vendit për xhami është vetëm për namaz, e papërcaktimi i vendit është edhe për namaz edhe për aktivitetet tjera të jetës. E atë vend të cilin e përcaktojnë njerëzit me dëshirën e tyre e quajnë shtëpi e Allahut.

Pra shtëpia e Allahut (Qabja) në Meke është përcaktua me dëshirën e Allahut ndërsa shtëpitë e Allahut (xhamit) tjera janë përcaktua me dëshirën e vetë njerëzve. Atëherë shtëpitë e Allahut të përcaktuara me dëshirën e njerëzve janë zinxhirë, apo vazhdimësi e shtëpisë së Allahut me dëshirën e Allahut.

EPSHI I KAFSHËS

Te intelektualët dhe te jointelektualët, dhe te njerëzit në përgjithësi paraqitej nevoja e të njohurit të kontaktit seksual te kafshët, dhe sundimi i epshit të tyre. Duke krahasua njeriun me epshin e kafshës. Ndoshta kjo është se kur epshi e sundon trupin dhe i dirigjon pjesët e tij atëherë logjika (mendja) humbet dhe depërton shejtani, kështu që njeriu zbret në shkallën e kafshëve që do të thotë se ai funksionon vetëm nëpërmjet të indikacionit të epshit, apo vetëm reflektim i epshit ashtu siç thonë edhe mjekët.

Mirëpo Imami i nderuar Shejh Shaëraviju këtë çështje e shpjegon nga një kënd tjetër ku thotë: Instikti i epshit të kafshës është për ta ruajtur llojin. Pra është ndjenjë vetëm për ta ruajtur llojin, ajo është e patjetërsueshme që do të thotë epshi vetëm e kryen detyrën e tij.

Kur mashkullori bashkohet me vezorin në embrion fryhet dhe femra jetë shtatzënë (barsë), pra sikurse të fryrit do të thotë unë jam ajo që barroj.

FOTOGRAFIA E XHAMISË NË QIBRIT

Ishim në shtëpinë e Imamit kur erdh Shejh Shaëraviju edhe Dr. Muhamed Tajib Nexhar Degon i Universitetit të Ez-herit. Njëri prej prezentëve e pyeti Dr. Nexharin për fotografinë e xhamisë në Qibrit, a është e lejuar apo e ndaluar, kur dihet se Qibriti pas harxhimit të kokrrave gjuhet në tokë.

Dr. Nexhari u përgjigj se lejohet.

Kjo për arsye se veprat shpërblehen sipas qëllimit, dhe çdo njeri do të shpërblehet ashtu siç e ka qëllimin ashtu siç na ka mësuar i Dërguari i Allahut s.a.v.s.

A PYETET I DËRGUARI I ALLAHUT S.A.V.S. NË DITËN E KIAMETIT?

Pak para se të botohet kjo libër një motër muslimane na ka dërgua një pyetje dhe e parapashë që t'ia bashkëngjis këtij numri, dhe u përgjigja prej asaj çka kam mësuar prej diskutimit të Imamit të nderuar Muhamed Muteveli Shaëravijut me prof. dr. Muhamed Ibrahim Shafiju dhe prof. dr. Abdul Kerim Dihjete.

Pyetje: A pyeten të Dërguarit e Allahut në ditën e kiametit apo jo?

Përgjigje: Po, pyeten të Dërguarit e Allahut në ditën e kiametit. Këtë na e tregon Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an: **"Dhe do t'i pyesim ata të cilëve u kemi dërguar pejgamber, por do t'i pyesim edhe pejgamberët." (EL EARAF)**

"Atë ditë kur Allahu do t'i tuboj pejgamberët dhe do t'u thotë: Çfarë përgjigje keni marrë prej tyre? Ata do të përgjigjen: Nuk dimë asgjë". (EL-MAIDE, 109)

"Dhe si do t'u vijmë secilit popull me dëshmitarë, ndërsa këtyre do t'u sjellim juve dëshmitarë." (EN-NISA)

Unë frikohem se nëse bëjë mëkat ndaj Zotit tim do të dënohem në Ditën e Madhe (Ditën e Kiametit).

“Dhe i Dërguari thotë: O Zoti Im ! Populli im këtë Kur’an e kanë konsiderua si çështje e harruar (e lënur pas dore).”

Të gjitha këto ajete dëshmojnë se pejgamberët do të pyeten në ditën e kiametit.

FETAVATË E SHAËRAVIJUT

PJESA E PESTË

V

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

Kaçanik, 2015

HYRJE

Falënderimet i takojnë Allahut - Krijuesit të gjithësisë.

Përshëndetjet dhe selamet çofshin për të Dërguarin tonë besnik, familjen e tij dhe ata që pasojnë rrugën e tij deri në ditën e Kijametit.

Na ka arritur një letër e mrekullueshme nga një vajzë e re muslimane, në vitet më të reja të rinisë dhe të fesë (ka qenë letra e pesta me radhë). Nuk kishim mundësi t'i përgjigjemi, pasi që nuk kanë qenë kushtet e përshtatshme për ta përshkruar dhe komentuar përbërjen e letrës së saj.

Me zemër të sinqertë dhe me fjalët më të përzemërta e përshëndes, për fetvatë e saj dhe prej asaj çka ka përfituar shumë dhe ka pasur dobi të madhe prej fetvave, sipas shkresës së saj.

E falënderoj atë dhe i jam shumë mirënjohës, në vend të të nderuarit të imamit të mirënjohur, pasi që shkresën e saj ia kam lexuar Imamit. Përshëndetje për të renë muslimane S.M.M. Studente e Fakulteti Sociologjik.

Na ka arritur një shkresë nga lexuesi musliman SHAM nga Misr Xhedidetu, në të cilën thotë: Pasi që harresa e njeriut e nënçmon atë, ndikon për të bërë mëkat, e cila është vepër e shejtanit dhe për të cilën jepet përgjegjësi. E pasi që drejtësia qiellore është e pakrahasueshme që të dënojë krijesën e Tij me një krijesë tjetër. Dhe pasi që njeriu është i krijuar, e xhinët janë krijesa tjera, duhet që njeriu të jep llogari vetëm për mëkatet që vetë i bën, e jo për mëkatet për të cilat shkaktar është shejtani. Cila është zgjidhja dhe çka është më së miri të veprohet në këtë rast?

Prej asaj çka kam kuptuar nga Shejh Shaëraviju dhe prej mësimeve dhe bisedave që i kam zhvilluar vazhdimisht me të, dhe prej diturisë, ideve që i kam përfituar prej tij, pasi po e filloj me Bismilahirrahmanirrahim, dhe pasi që po përshëndes Pejgamberin fisnik, po përgjigjem:

Njeriu është i urdhëruar për adhurim të sinqertë ndaj Allahut të Lartmadhëruar, ai po ashtu është i urdhëruar që t'iu largohet shejtanit të mos e dëgjojë atë. E nëse ai nënshtrohet urdhrave të shejtanit, ai veç ka kundërshtuar tekstin dhe urdhrin Kur'anor për të mos e dëgjuar shejtanin.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"(Ju porosita) Të më adhuroni Mua, se kjo është rruga e sigurt! Vërtet, ai ka humbur shumë njerëz prej jush, a nuk mblodhët mend?" (Jasinë, 61- 62)

Njeriun, të cilin e hamend, e mashtron dhe e përvetëson shejtani, dhe i

cili i nënshtrohet urdhrave të tij, ai është bërë prej ushtrisë së tij, dhe në çfarë mase njeriu i largohet kurtheve dhe mashtrimeve të shejtanit, po në atë masë imani i tij është i fortë.

O ju muslimanë, Allahu ju ka dhënë juve atë çka e doni prej të mirave të islamit. Dëgjojeni atë çka ju pastron, ju dëlirë dhe ju shndritë në adhurimin e Tij, për t'iu siguruar lumturi edhe në këtë botë edhe në botën tjetër, dhe derisa para jush të hapen dyert e faljes, zgjerimit, lehtësimit, ëmbëlsirës, mëshirës dhe kënaqësisë. Vërtet Allahu është Dëgjues dhe Pranues i lutjeve.

Shpirtrat fisniko-qortues gjithmonë pyesin dhe kërkojnë sqarime: A është kjo haram, a është kjo hallall? E kjo na gëzon se në thellësi të zemrave ka ndjenja të flakta për të hulumtuar çdo gjë çka e kënaqë Allahun, dhe për t'u larguar prej çdo gjëje që e urren Allahu.

Në çdo shekull, në çdo popull, në çdo kohë, dhe prej kohërave më të lashta ka ekzistuar hallalli dhe harami, mirëpo ka pasur dallime në mes të shkaktarëve dhe llojeve dhe në përcaktimin.

Çështja e hallallit dhe haramit ka ekzistuar edhe në tregime, fabula e përralla, të cilat e kanë humbur peshën dhe vlerën në vet substancën e tyre.

Hallalli ka ekzistuar te çdo fe dhe në çdo sekt, e deri në kohën e sodit, ku ka arritur niveli i lartë i zhvillimit, ku e ka edhe vendin e vet. Për këtë arsye edhe thirrja në njëshmërinë e Krijuesit dhe adhurimi ndaj Allahut me të cilat është obliguar i Dërguari a.s., janë prej ligjeve të cilat kanë qenë në kohë të caktuar dhe kanë përfunduar në kohën e caktuar.

Dhe kur ka ardhur Islami, i cili ka rolin për t'i sjellë njerëzimit paqe e lumturi, deri në fund të ekzistimit të kësaj bote, ka qenë dashtë që të përfshijë çështjen e hallallit dhe haramit në tërësi, pra çdo gjë çka i nevojitet njeriut për lumturi në këtë botë dhe në botën tjetër. Kjo formë e hallallit dhe e haramit do të vazhdojë edhe në të ardhmen pa ndërprerje, sa të ekzistojë jeta në të gjitha mënyrat e saj.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Dhe (kam ardhë) që t'ju vërtetoj Tevratin që e keni para duarsh, t'ju lejoj disa që u ishin ndaluar juve, kam ardhë me argument nga Zoti juaj, pra kini frikë All-llahun dhe më dëgjoni mua". (Ali Imran, 50)

Po ashtu thotë:

"Dhe cakto për ne (jetë) të mirë në Dunja dhe të mirë në botën tjetër, pse vërtet jemi kthyer kah Ti. Ai (Zoti) tha: Dënimi im është ai me të cilin e godas cilin dua, e mëshira Ime ka përfshirë secilin send. Atë (Mëshirën) do

ta caktoj për ata të cilët u ruhen (mëkateve), e japin zeqatin dhe për ata që i besojnë argumentet tona”.

“Që pranojnë të dërguarin (Muhammedin), Pejgamberin arab, (që nuk shkruan as nuk lexon), të cilin e gjejnë të cilësuar (të përshkruar me virtytet e tij), te ata në Tevrat dhe në Inxhil, e që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet, dhe heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta. Pra, ata të cilët e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmojnë, veprojnë me dritën që iu zbrit me të, të tillët janë të shpëtuarit”.(El-Ea’rafë, 156-157)

Po ashtu thotë:

“Thuaj: Kush i ndaloi bukuritë dhe ushqimet e mira që All-llahu i krijoi për robërit e vet? Thuaj: Ato janë në këtë botë për ata që besuan, e në ditën e kijametit janë të posaçme për ta. Kështu ia sqarojmë argumentet një populli që kupton”.(El-Ea’rafë, 32)

Një lexues tjetër pyet: Unë kam mendime të këqija, nuk mund të tërhiqet prej tyre, dhe me mendimet e këqija edhe iu bëj keq njerëzve. Dhe pyet: Si të veproj me këto mendime dhe veprime të këqija?

I themi atij: Ai nuk na ka shkruar në letër se a falet apo jo, natyrisht ne presim prej tij përgjigje negative, sepse namazi të largon nga punët e këqija dhe imoraliteti. Por edhe nëse falet, është e mundur se namazi i tij është i papranuar, prandaj le të hulumtojë dhe le të shikojë rreth vetes së tij dhe atëherë kemi shpresë se Allahu do ta udhëzojë në rrugë të drejtë dhe të na largojë edhe neve edhe atë nga botëkuptimet e shejtanëve.

E ndiejmë për obligim me përmend se mendimet e këqija dhe armiqësore, në psikologji kanë emërtim të veçantë të sëmundjes së tillë. Dhe nuk ka kurrfarë të keqe për ta drejtuar te psikologu, për shërim të kësaj sëmundjeje psikike. Pasi kam lexuar shumë

libra psikologjik nuk kam gjetur mjekim më të mirë dhe më të suksesshëm se leximi i Kur’anit të sëmurëve psikik. Këtë e thotë Zoti i Lartmadhëruar:

“Dhe Ne kemi zbritur nga Kur’ani çka është shërim dhe mëshirë për besimtarët”.*Sadakallahul Adhim*

Zoti i Lartmadhëruar ka kërkuar lehtësim dhe falje për mëkatarin, keqbërësin ku thotë: ***“Dhe dënimi i të keqes me të keqe të të njëjtës masë, por kush falë, dhe përmirëson, shpërblimin e ka te Allahu”.***

Hakmarrja është drejtësi, teprimi në dënim është kalim i normave. Ai i cili tejkalon normën, ai ka bë padrejtësi. Tepruesi ka tejkaluar kufirin e urtësisë dhe të mirës, e cila e ka barazuar dhe ka harmonizuar çdo çështje të jetës. Dhe mos harroni vlerat dhe dallimet mes jush.

Dhe kur Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: ***"Dhe mos anoni me anim të tërësishëm".*** *Na ka dhënë bazën e logjikës dhe planprogramin madhështor. Zoti i Lartmadhëruar di se çka fshehin zemrat me diturinë e Tij të përhershme pa fillim, bazat e paralelizmit dhe barazimit dhe sjelljet e njeriut për këtë arsye nuk ka thënë vetëm "Mos anoni", por ka thënë mos anoni me anim të tërësishëm, sepse animi i pjesshëm mundet të arsyetohet në disa çështje. Kjo është po në jetën normale, mirëpo e keqja e të keqes është animi në ekstremitet. Sepse çdo ekstremitet dhe çdo kryeneçësi e humb tërë vlerën dhe qëllimin e jetës.*

O Zot na forco hapat në rrugën tonë që të kemi mundësi për t'iu përgjigjur letrave të lexuesve në përputhshmëri me lejen e Allahut. Jepi atyre dhe neve durim, sepse shumica e tyre presin me padurim. Mirëpo ne dëshirojmë që ata të na kuptojnë se jemi shumë, shumë afër tyre dhe së shpejti secili prej tyre do të marrë përgjigjen e pritur, me lejen e Allahut.

Kush dëshiron shpejtimin e një çështje dënohet me vonimin e saj. Por ne me tërë fuqinë tonë do të mundohemi që ata të mos presin shumë. E nesërmja është e afërt për pritësit. Zoti qoftë i kënaqur.

Kajro, 14 Safer, viti 1402 h. 10 Shtator, viti 1982 Isa a.s.

PËRZIERJA E DJEMVE ME VAJZA

Jeta e fakultetit, po a e di çka është jeta e fakultetit, e studentit. Në të janë të tubuar të gjitha të gjitha të mirat dhe të këqijat. Dituria i përfshinë të gjitha të mirat dhe të gjitha vlerat, ndërsa e gjithë e keqja, arroganca dhe kryeneçësia janë tubuar mbi (kundër) të mirës dhe vlerave. Posa të arrij djali apo vajza në shkallët e Universitetit ai apo ajo ekspozohen me rrobat e pubertetit dhe posa të takohen pozitivi dhe negativi e tërheqin njëra-tjetrën, dhe paraqiten në teatrin e adoleshencës nën hijen e "civilizimit" i ashtuquajtur bashkëkohësi dhe modernizim, ndërsa në esencë është në kundërshtim me planprogramin e Allahut.

Nuk do të kishim asnjë breng e kurrfarë frike. Vërtet në të gjitha vendet ngatërrohet kjo me atë e pastaj shohim përfundime të këqija dhe rezultate të padëshirueshme.

Shejh Shaëraviju në lidhje me përzierjen e djemve dhe vajzave thotë:

Përzierja e djemve dhe vajzave është një çështje jo natyrore dhe e palogjikshme. Unë këtë çështje e kam elaboruar, kur kam folur rreth tregimit të Musa a.s. me Shuajbin. Kam thënë se femra në ndonjë punë jashtë rrethit familjarë, del vetëm atëherë kur është ndonjë domosdoshmëri absolute.

Kam thënë, dëgjoni fjalët e Allahut të Lartmadhëruar: **"E kur arriti ujin e Medjenit, aty gjeti një grumbull njerëzish që po i jepnin bagëtisë ujë, e pak më larg prej tyr vërejti d gra që o i ndalnin (kafshët e tyre) e u tha: "E çka është puna e juve dyjave?" Ato që të dyja i thanë: "Nuk mund t'i jap bagëtisë me pi ujë përderisa të shkojnë barinjtë tjerë, kurse babai jonë është i moshuar!"(KASSAS, 23)**

Fjala "Baba jonë i moshuar" dëshmon domosdoshmërinë, e cila i ka detyrua me dalë nga puna e nga shtëpia, duhet të jetë e përkufizuar "Nuk mund t'i jap bagëtisë me pi ujë përderisa të shkojnë barinjtë tjerë."

Nuk ka qenë domosdoshmëria e cila i ka detyruar me dalë në punë dhe me qenë në largësi prej shoqërimit me meshkuj, dhe "Baba jonë tepër i moshuar", por pastaj tregon rolin e shoqërisë (së meshkujve) dhe iu ndihmoj atyre për me pi ujë bagëtia tyre.

Kjo do të thotë se kur një mashkull e sheh një grua se ka dalë për të siguruar ekzistencën dhe se domosdoshmëria e ka detyrua, nevojitet asaj me i ndihmua, që ajo të shkoj drejt rrugës së saj dhe vajza apo gruaja e cila për

shkak të domosdoshmërisë del dhe punon, asaj i ndihmohet për ta kryer atë nevojë.

Bija e Shuajbit i ka thënë babës së saj:

“O babai im shpërbleje atë, se vërtet atë cilin do ta shpërblesh është i fuqishëm dhe besnik.” (El Kasas, 26)

Ajo ka dëshiruar me zgjedh problemin e jetës së saj me atë ndodhi. Ne nuk e pengojmë femrën me punua, mirëpo ajo del me punua në hapësirën e saj familjare, ndërsa nëse del jashtë hapësirës së familjes së saj, ajo duhet të jetë e kujdesshme, e ndërgjegjshme dhe e matur. Pse domosdoshmëria nuk duhet ta shtyjë atë që të përzihet me meshkuj dhe të veproj çka të dëshiroj me ata.

Të marrim si shembull nëse femra ndien ndonjë nevojë të domosdoshme dhe del me punua në një mes, ku nuk ka burrëri edhe pse të gjithë ata janë burra, dhe ajo punon për ekzistencë, çka ka lidhje domosdoshmëria që ajo të del e zbukuruar e parfumuar dhe me rroba tërheqëse.

Çka ka lidhje domosdoshmëria me zbulimin e trupit të saj?

Femra e cila del për studim, ndërsa ne themi se domosdoshmëria e ka shtyrë që ajo të përzihet me meshkuj.

Cila është ajo domosdoshmëri që ajo të vishet me rroba tërheqëse dhe me rroba të cilat nuk e mbulojnë në tërësi trupin e saj, që ajo të ndjek modën më të re.

Unë edhe më herët kam thënë: A thua dituria patjetër përftohet vetëm nëpërmjet gjoksit të të zbuluar!?

Vajza e cila del e zbuluar jashtë oborrit të shtëpisë së saj dhe ekspozon veten e saj para mashkullit, sepse zbulimi sa më i madh i femrës jashtë shtëpisë së saj do të thoshte pa fjalë: “Shiko, unë jam këtu. Eja.”

Mashkulli nuk ka mundësi me i ngrit ndjenjat e epshit, tani ai ka nevojë me i ftohë ndjenjat e epshit.

O popull! Bëni dallim në mes të angazhimit për jetë dhe mashtrimit të kësaj jete.

E DREJTA E TË ÇMENDURIT

Shejh Shaëraviju thotë: Njeriun të cilin e ka krijua Allahu të çmendur, ndërsa ne e dimë se njeriu është i dalluar dhe i nderuar me mendje, a do të thotë kjo mos dhurimi i mendjes (çmendurie) zhveshja e atij njeriu prej gradës së nderit dhe fisnikërisë.

Pyes ? Çka dëshirojnë të mençurit dhe të fuqishmit me trupin e tyre ?

Çka dëshirojnë ata në këtë botë ?

Dëshirojnë vetëm me fol, e fjala e tyre me u dëgjuar e mos me iu refuzuar, dëshirojnë të veprojnë çka të dëshirojnë e askush mos me iu fol atyre.

Iu kam thënë atyre: I çmenduri është i tillë që kur të bie ty, ti qesh me të, ti nuk e kritikon me fjalë tjera nuk e pyet atë pse më mëshove, po ashtu edhe Allahu nuk e pyet atë ditën e kijametit: Dhe bjere një njeri i cili nuk është i çmendur,ai tërë jetën angazhohet për me arrit qëllimin të cilin veç e ka arritur i çmenduri. Kështu na habitë fakti se deri sa për veprimtarinë e tij në këtë botë e quajnë të çmendur, atë në një moment prej momenteve të jetës së tij Allahu i jep fuqi sa fuqia e mendjes tënde dhe sa është jeta jote.

Po si realizohet kjo ?

Njeriu çështjet i kupton nëpërmjet mendjes së tij, të cilat pastaj i fshehë në vete e nuk i flet, ndërsa i çmenduri e flet të vërtetën dhe nuk mërzitet, e thotë atë që ti nuk mundesh me thënë o i mençur ta thuash, e as nuk mundesh ti ikësh asaj.

Kjo është që na shpie te kuptimi “mendje-akl, ndërlidhje”. Pse quhet mendje? Sepse aq shumë është i ndërlidhur me ty saqë as që mund t’i ikësh.

Ndërsa i çmenduri as që mërzitet. Pra i çmenduri në një moment prej momenteve të çmendurisë së tij. Shpaguhet me atë që ti nuk mund ta arrish tërë jetën me mendjen tënde, “Qoftë i lartësuar Zoti i Lartmadhëruar”.

SHFUQIZIMI I LIGJIT PARA OBLIGUESHMËRISË

Të gjithë e dimë se namazi është ligjësua drejtpërdrejt në mes të Zotit të Lartmadhëruar dhe krijesës së tij dhe më të nderuarit të të Dërguarve të tij dhe vulës së pejgamberëve , zotërisë tonë Muhamedit a.s. Ashtu siç na është transmetuar Pejgamberi s.a.v.s. prej Zotit është obligua me i falë 50 kohë të namazit në ditë. E dimë edhe atë se Musa a.s. e ka këshillua dhe Muhamedi a.s. është kthye te Zoti i Lartmadhëruar sa që namazi ka zbrit prej 50 kohëve në ditë në 5 kohë, mirëpo shpërblimi është si me i falë 50 kohë.

Disa kanë thënë se këto janë israilijatë, pse tregojnë porosinë e popullit të Musa a.s. Umetit të Muhamedit s.a.v.s.

Shejh Shaëraviju në lidhje me këtë transmetim thotë: Musa është i Dërguari i Allahut. Ai është prej pejgamberëve të dalluar (Ulul Azm). Dhe mënyra se si ka kërkua prej Muhamedit a.s. që ai me kërkua që me iu zbrit. Ne nuk shohim se është porosi? Çka është porosia ?

Porosi është kur kërkohet prej njeriut të cilit iu është obligua diçka, me u obligua më shumë. Ndërsa porosia e cila kërkon lehtësinë a quhet porosi?

Musa a.s. ka dëshirua me u lehtësua një çështje sepse ai e ka ditë se nuk mundet me u krye.

Transmetimi "Vërtet populli yt nuk mundet", sikurse ka dëshirua me ua lehtësua çështjen Umetit Islam.

E tashti ne e analizojmë dhe e diskutojmë atë çështje, posaçërisht pasi që kemi transmetim tjetër ku thuhet: "Vërtet Umeti yt është i dobët, dhe nuk mundet", ka edhe transmetime të ngjashme.

Kjo është ajo çka thuhet: Mirëpo kur Musa a.s. kur thotë: "Unë i kam sprovuar popujt para teje", dihet se Allahu nuk ia ka bë obligim popullit të Musa a.s. më shumë se dy namaze: Namazin e mesnatës dhe namazin e mesditës, mirëpo edhe këto dy namaze nuk i kanë kryer. E, Musa a.s. kur e ka pa se populli i tij nuk ka mundur me i falë dy namaze, i ka thënë Muhamedit a.s. atë që i ka thënë: Ky është argument se ai e ka dashur të Dërguarin e Allahut, dhe Umetin e të Dërguarit të Allahut, e për këtë arsye nuk ka dashur që ata të obligohen ashtu siç është obliguar Umeti i tij, e pastaj ata nuk do të kishin mundur me i krye.

Pra kjo nuk është dëshmi se ne jemi të dobët, por është supozim se ne nuk forcohemi me këtë. Pse? Sepse eksperienca e popujve të tjerë nuk e ka

dëshmuar këtë dhe ka qenë i bindur se edhe Umeti i tij nuk mund të dëshmojë këtë. Pra kjo është çështje e cila dëshmon kundër tyre e jo kundër neve (kundër popullit të Musa a.s.)

Parashtrohet pyetja:

Pasi që Allahu ka dëshirua 50 namaze në fillim, pastaj i ka bë obligim pesë kohë, pse kështu?

I nderuari Imam Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë:

Obligimet edhe pse vijnë prej Allahut, Allahu i Lartmadhëruar nuk ka nevojë për kryerjen e obligimeve tona, por obligimet janë për të mirën tonë. Parësore është se me kryerjen e obligimeve nuk ka dobi Allahu, por kemi dobi vetë ne.

Dhe përderisa Allahu i ka bë 5 kohë obligim me 50 shpërblime, atëherë dhurata është prej Allahut, e lehtësimi ka ardhur nëpërmjet shkakut dhe arsyes, e Allahu nuk e ka pranu pakësimin e pagesës dhe shpërblimit.

Pyetja është:

Si me shfuqizua Allahu një ligj para se të vendoset?

Imami i mirënjohur thotë:

Njerëzit e kuptojnë se qëllimi i obligimit prej Allahut është kryerja e obligimit që do të thotë çdo obligim prej Allahut përbëhet prej dy pjesëve.

Pjesa e parë: Besimi në çështjen e obliguar dhe pranimi i atij obligimi.

Pjesa e dytë: Kryerja e atij obligimi.

Nëse të parën e ke pranua, kjo do të thotë pjesën e parë e ke krye e pastaj vjen pjesa e dytë, veprimi pra kryerja e atij veprimi. Këtë pikë për ta sqaruar themi: p.sh. Iblisi ka mëkatua ndaj Zotit të tij, po ashtu edhe Ademi ka mëkatua ndaj Zotit të tij, atëherë pse me u dëbua nga mëshira e Allahut, e pse Iblisi është pendua ndërsa Allahu ia ka pranua. Kjo sepse Iblisi ia ka kthye urdhrin, pra nuk e ka pranuar urdhrin, ndërsa kjo nuk ka ndodh me Ademin a.s., pra Ademi e ka pranua urdhrin.

QETËSIMI I SHPIRTIT NË MARTESË DHE PREJ TIJ KA BË BASHKËSHORTEN E TIJ

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: Dhe prej atij shpirti ka bë bashkëshorten e saj,e pse nuk ka thënë: dhe prej atij shpirti ka krijua bashkëshorten e saj.

Përgjigje: Bashkautorët e librit "Mrekullia mjekësore në Kur'an" në të cilën Shejh Shaëraviju ka sqarua dallimin në mes të "bërjes dhe krijimit".

Në lidhje me këtë Shejh Shaëraviju thotë: Fjala "e ka bë" gjuhësisht kur të përdoret për një çështje, ka të bëjë me atë se nuk ka ekzistua dhe është krijua. Zoti i Lartmadhëruar thotë: **Dhe ka bërë prej tij bashkëshorten e tij.** Këtu fjala "ka bërë" ka kuptimin ka krijua.

Ndërsa kur të përdoret fjala *"ka bërë"* për çështjen që veç ka ekzistua, kjo do të thotë është shndërrua në diçka tjetër, atëherë unë i kuptoj dy çështje: e bërë dhe e bërë prej tij. E kam bë baltën Ibrik, e kam bë dërrasën tavolinë. Pra këtu ka dallim në mes të fjalës e cila është transitive në një folje, e kjo do të thotë krijimi prej asgjëje, ndërsa "ka bë" fjala e cila kalon në dy folje,sendi veç ka ekzistua por pastaj është shndërrua në diçka tjetër.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Vërtetë unë të bëj ty udhëheqës (imam) për njerëzimin. Ti (o Ibrahim) veç je mirëpo me të bë imam është çështje tjetër."

EL-MEDHIJ

"Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për *medhinë*?

Është përgjigj: ***Për atë shkak merret abdes.***

Njëri thotë: Po nëse më bie stërpika në rroba prej saj?

Mjafton me marrë ujë me grusht e me hedh në vendin e stërpikur dhe e shikon a e ka përfshi ë tërën apo jo.

FAZA E OBLIGUESHMËRISË

Cila është faza e obligueshmërisë, pra prej kur kërkohet nga njeriu me pasuar rrugën e Allahut dhe me i kryer obligimet?

Shejh Shaëraviju thotë:

Faza e obligueshmërisë është pjekuria, po çka është pjekuria: arritja e fazës së burrërisë te njeriu, pra përsosmëria e qenies së njeriut, përsosmëri e cila manifestohet me ndjenjën e epshit, pra spermatozoidit e cila është mjet për të mbijetuar dhe për t'u shtuar qenia njerëzore. Sepse po të kërkonte Allahu para se t'i paraqitej epshi i brendshëm njerëzorë, atëherë kërkimi për me besua prej tij do të ishte kërkim jo i plotë (i mangët).

E po të kërkohej e ai nuk di për çështjen e ndjenjës së brendshme (epshit), atëherë kur do t'i paraqitej në trup diçka e re, atëherë pranimi i obligueshmërisë duhet të filloj rishtazi prej fillimit. Atëherë njeriu do të kishte thënë: E kam pranuar para se me ekzistua kjo çështje e brendshme, mirëpo Allahu ka dëshiruar që të pranohet obligimi pasi të vjen kjo ndjenjë e brendshme, që njeriu ta pranoj obligimin dhe përgjegjësinë pasi të plotësohet në tërësi si njeri, e mos me iu paraqit diçka e re pas asaj kohe.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Dhe kur të arrijnë fëmijët moshën e pjekurisë, le të kërkojnë leje".(EN-NURË, 59)

Pra këtu është fillimi i fazës së obligueshmërisë, pasi që çdo obligim e ka kohën, edhe koha e obligueshmërisë e ka fillimin e fazës e kjo fazë është pjekuria, e pjekuria është plotësimi i burrërisë së njeriut, e burrëria e njeriut është fillimi i kryerjes së obligimeve ndaj Allahut,e kjo nuk mund të arrihet vetëm atëherë kur ai është në gjendje me formua njeri, e kjo arrihet në epshin seksual, e cila është mjet për të lindur njeri tjetër, pra jetë tjetër.

PRAKTIKIMI I SHERIATIT

Pse deri sot nuk është praktiku Sheriati Islam?

Imami i nderuar Shejh Shaëraviju thotë:

Kjo pyetje duhet t'i parashtrohet drejtpërdrejt popullit sepse ai është i cili zgjedh ligjin në këtë vend. Kur i keni zgjedhur deputetët a mos keni bë ndonjë krahasim kush premton se do të gjykoj me librin e Allahut: Bazë kryesore për t'i zgjedhur deputetët është që ata me premtua se do ta praktikojnë ligjin e sheriatit. Unë edhe më herët kam thënë: ne nuk dëshirojmë që haptazi me thënë mendimin tonë për planprogramin e Allahut.

Mirëpo, unë dëshiroj prej juve që ju të kërkoni që kuvendi haptazi të deklarohet që nuk vendosin asnjë ligj njerëzor para ligjit të Allahut. Dëshiroj prej juve që kjo të jetë bazë kryesore me të cilin ju i krahasoni deputetët e juaj që me ju thënë atyre çka keni vendos ju për fenë tuaj në parlament. Kur të ndodh kjo, atëherë deputetët e kuptojnë se ata janë zgjedhur në bazë të kësaj çështjeje, pra për me vendos Ligjin e Allahut. Kjo është ajo që duhet të ndodh në këtë qytet, dhe se ligji i sheriatit duhet të filloj të praktikohet sa më shpejtë që është e mundur.

Lus Allahun që të gjithëve të na përkrahë dhe që të gjithë të jemi shëmbëlltyrë për të mirë të na dojë të mirë, të na bëjë që ta dëshirojmë të mirën dhe të na drejtojë në të mirën.

TË NDALUARIT E VRASJES SË BESIMTARIT

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s për njeriun i cili e ka zënë në pozitë të vështirë një idhujtarë për me mbytë.

Por ai i thotë: Unë jam musliman, por prapë e ka mbytë. Mirëpo ai këtë fjalë e ka thënë vetëm për me shpëtuar jetën e tij.

Muhamedi a.s. ka thënë: ***Vërtetë Allahu ma ka ndaluar mua me mbytë besimtarin.***

CILI ËSHTË MË I HERSHËM PABESIMI APO BESIMI

Çka do të thotë pabesim dhe cili paraprin pabesimi apo besimi?

Shejh Shaëraviju thotë: Ai i cili shikon në pabesim, përfiton prej tij edhe pse nuk ka me qenë vetë pabesimtarë, pasi që pabesimi ekziston tek njerëzit, pabesim do të thotë *fshehje*.

Pra, fjala e pabesimit është se besimi ekziston në brendësi, sepse pabesim do të thotë *fshehje*, pra mosbesimi në Allahun do të thotë fshehja e ekzistimit të Allahut. Për arsye se fshehja është dytësore ndërsa parësore është besimi në Zotin. Pra, vet fjala *pabesim* vetvetiu është kundër pabesimtarëve, sepse nuk thuhet pabesim përderisa nuk ekziston diçka e pastaj e fshehim që tregon se imani (besimi) është natyrshmëri, pastaj është paraqitur fshehtësia e besimit për m'i indinjua njerëzit. Pasi që besimi nuk i le hapësirë udhëheqësit, sunduesit, pozitëlartët dhe shfrytëzuesit e pozitës.

Për këtë arsye kanë filluar me fsheh besim në Allahun. Pra, fjala në esencë tregon se pabesimit i ka parapri besimi.

Kjo është çështje e logjikshme, sepse njeriu i parë është Ademi. Ai i cili e ka krijua atë është Allahu, Ai e ka frymëzua me shpirt, i ka urdhërua melekët me i bë sexhde dhe ia ka tregu rrugën e vërtetë.

Të gjitha këto tregojnë një çështje se pabesimi në fillim as që ka qenë, por nëpërmjet pabesimit Iblisi ka dëshirua me mashtrua Ademin. Ka qenë e patjetërsueshme se Ademi iu ka sqarua djemve të tij çka ka ditur, mirëpo me kalimin e kohës ka fillua harresa, dhe kështu shumica e njerëzve kanë fillua me mendua se besimi ua përkufizon jetën e tyre, e kanë fillua mos me besua, mirëpo i logjikshmi kur të dëgjon fjalën pabesim, duhet të jetë i kujdesshëm që mos i bashkëngjitet mendimit me fsheh të ekzistuarën për këtë arsye Allahu tërheq vërejtjen dhe pyet: po si po mohoni atë.

Ata nuk kanë përgjigje tjetër pos:

"Ne kemi fshehur besimin në ty o Zot". Ky është besimi ku Zoti i Lartmadhëruar

thotë:

"Po si po e mohoni Zotin kur nuk ka ekzistuar (keni qenë të vdekur) e ai ju krijoi (ju ngjalli juve)."(El Bekare, 28)

Ky ajet tregon argumentin në besim. Allahu iu është përgjigjur natyrshmërisë së sendeve, ashtu që vepron në këtë e ajo reflektohet te Ai. E

kjo është se Zotit të Lartmadhëruar i janë të nënshtruar të gjitha sendet çka ka në tokë, dhe me kalimin e kohës mendohet se ka lidhje mbi ngarkesat. Për këtë arsye në mendjen e njeriut jeton fuqia e shkaqeve. Zoti i Lartmadhëruar është Krijues dhe krijuesi i shkaqeve.

Nuk ka dyshim se imani i paraprinë pabesimit. E shfrytëzova rastin dhe kam pyetur imamin e nderuar edhe me pyetjen të cilën e bëjnë njerëzit me tallje. Cila është më e para veza a po pula.

Ai e cilëson këtë si mendjelehtësi prej mendjelehtësive të njerëzve të cilëve nuk logjikojnë dhe nuk mendojnë.

PSE NË KUR'AN KA AJETE TË PAQARTA

Pyetje: Pse në Kur'an ka ajete të paqarta?

Përgjigje: Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Ai është i Cili të ka zbritur ty Librin (Kur'anin). Në të ka ajete plotësisht të qarta, të cilat janë themelet e librit dhe të tjerat jo krejtësisht të qarta. Kështu, sa për ata në zemrat e të cilëve ka largim nga e vërteta, ndjekin atë që nuk është krejtësisht e qartë, në këtë mënyrë ata dëshirojnë ngatërresa (mosmarrëveshje e konflikte) dhe dëshirojnë kuptimet e fshehta, por askush nuk i di kuptimet e fshehta, pos Allahut dhe ata që janë të thelluar në dituri thonë: Ne besojmë në të, i tëri (Kur'ani) është nga Zoti ynë. Këtë nuk e logjikojnë, pos atyre që kanë mendje të shëndoshë". (Ali Imran, 7)

Pyetje: Pse ka në Kur'an ajete të paqarta?

Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Të thelluarit në dituri thonë: ne kemi besuar Allahun, edhe pse nuk kuptojnë asgjë, sepse të gjitha janë prej Allahut. Pra, të paqartat prej Allahut dhe të paqartat prej Allahut. Dhe sikurse që syri e ka kufirin e të shikuarit, veshi kufirin e të dëgjuarit, ashtu edhe mendja e ka kufirin e të kuptuarit mendor.

Për këtë arsye Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Çka të kuptoni se është e qartë veproni me të, çka të kuptoni se është e paqartë, vetëm besojeni". I Dërguari i ka folur të vërtetën.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Ata të cilët besojnë e dinë se është e vërtetë prej Zotit të tyre, ndërsa ata të cilët mohojnë thonë: Po çka ka dashur Allahu të thotë me këtë (shembull)".

Allahu i Lartmadhëruar ka dashur ta testojë dhe ta sprovojë besimtarin. Sprovimi duhet të jetë i qartë se është testim.

Allahu dëshiron të dallojë të mirën prej të keqes, e Ai e di se çka është e mirë dhe çka është e keqe. Mirëpo dëshiron që edhe ti vetë ta vendosësh në praktikë, për të qenë argument për ty.

Ai e di, mirëpo Ai dëshiron dituri praktike dhe me dëshminë tënde. Sepse po të thoshte, me diturinë të cilën ti e posedon; ti ndoshta do të kishe thënë: Po të kisha pritur do të kishte qenë kjo, kjo, kjo ...

Kur'ani është një, mirëpo pranimi i tij është i ndryshëm. Kështu edhe pranimi i të gjitha fshehtësive dhe pranimi i të gjitha gjërave në të cilat barazohet mendja besimtari i pranon ato, sepse ato janë të vërteta dhe të drejta dhe janë prej të Drejtit dhe Vërtetuesit (Allahut), e kuptoi apo nuk e kuptoi ai.

Ky është shkaku pse në Kur'an ka ajete të paqarta. Kur'ani ka zbritur për të na sqaruar ligjet dhe dispozitat, ndërsa ajetet e paqarta të cilat janë zbritur në Kur'an janë zbritur për të vendosur imanin në peshojë. Pra në të janë ajetet e qarta dhe tjerat të paqarta.

KULMINACIONI I ADHURIMIT NDAJ ALLAHUT

Pyetje: Cili është kulminacioni i adhurimit të cilin duhet ta arrijë besimtari, me qëllim që të jetë i qetësuar dhe ta ndiejë dhe ta përjetojë kënaqësinë e Allahut vazhdimisht dhe pandërprerë.

Imami i nderuar thotë:

Po të kishte që çdo çështje që kërkohet për t'u vepruar dhe ajo çështje e ka arsyen dhe urtësinë e obligueshmërisë dhe të jetë i sigurt në atë, atëherë nuk do të kishte kuptim adhurimi i vërtetë. Mirëpo adhurimi është çështje që

kur të pranon urdhërin prej Allahut pasi që t'i besosh Atij dhe t'i besosh plotësisht dhe me bindje të thellë se Ai është më i Urti dhe më i Mençuri, i Cili të drejton dhe të orienton në një veprim.

E pastaj nëse veç ti e ke pranuar atë urdhër me këtë qëllim, ti veç e ke arritur kulminacionin e adhurimit ndaj Allahut. E pas kësaj Allahu t'i zbulon ty fshehtësitë dhe sekretet e kryerjes së dispozitave dhe urdhrave dhe pasojat për moskryerjen e tyre. Ata të cilët kanë sqaruar urtësinë dhe arsyen e namazit, urtësinë dhe arsyen e agjërimit, urtësinë dhe arsyen e zekatit. Mu ata janë të cilën në rend të parë e pastaj e kanë kuptuar në veten e tyre se çfarë dobie u ka sjellë në veten e tyre dhe në shpirtin e tyre. Ata kanë treguar se kanë pasur këtë e këtë dobi.

Farzet e abdesit janë këto:

Pastrimi i duarve deri në bërryla, pastrimi i fytyrës, lëmimi (mes- hi) i kokës dhe pastrimi i këmbëve. Nëse njërin e pyet vetëm për këto çështje, e kupton se pastrimi i këtyre pjesëve ka arsyen dhe urtësinë, po ashtu, nuk ka dyshim se i Dërguari i di specifikat e ujit qarkullues dhe i cili nuk ka as erë, e as ngjyrë. Dhe kur njeriu e merr ujin në dorë dhe sheh se nuk ka ngjyrë kur të fut ujin në gojë dhe bën shpëlarjen e gojës, e kupton se nuk ka shije, kur ta vendosë në hundë ujin e kupton se nuk ka erë. Atëherë çka? Kuptohet se është ujë i përdorshëm dhe i vlefshëm për abdest. Pra kjo është ndoshta se shkaqet dhe urtësitë nuk vijnë para se të veprohet urdhri, por në rend të parë kryhet urdhri.

FEMRA DHE XHIHADI NË RRUGËN E ALLAHUT

A e ka për obligim femra me dalë me luftua në rrugë të Allahut.

Përgjigje:

Përderisa njerëzit luftojnë në rrugë të Allahut është e patjetërsueshme, pa pasur të vrarë, të plagosur e të lënduar në betejë.

Në luftë ka vend për të qenë edhe femra sepse kushtet nuk lejojnë që ajo me qenë indiferent kur të sheh se si tjerët vriten në rrugë të Allahut, si derdhet gjaku i muslimanëve si masakrohen apo torturohen, e pastaj ajo mendon për çështjet të cilat janë për mashkullin dhe çështjet të cilat janë për femrën .

Për këtë arsye i Dërguari i Allahut s.a.v.s në çdo luftë ku ka marr pjesë aty ka pasur edhe gra.

Zonja Umijete Bint Kajs pas kësaj ajo e ka vesh uniformën e luftës dhe e ka mbajtur gjatë tërë jetës, kur ka vdekur ka lënë vasiet me u varros me të, gjë që e cila ka ndodhë.

Pra, kjo është një çështje e cila paraqitet në dy raste specifike: në Haxh dhe në luftë në rrugë të Allahut.

Në Haxh njerëzit i luten Zotit të tyre, dhe mëkatet e mëparshme në tërësi u falen. Për këtë nuk dyshoj se ndokush të ketë mendim tjetër pos ajo që duhet të jetë.

Në luftë në rrugë të Allahut, në fushëbetejë ku gjaku derdhet, njerëzit vriten, gjymtyrët humben, zemrat digjen.

E kush është ai i cili mendon që ajo të mos merr pjesë.

LOGJIKA DHE ROLI I SAJ

Çka është logjika dhe cili është roli i saj, dhe kur njeriu hamendet në mes të dy çështjeve, a është prej çështjeve të logjikës, apo jo?

Shejh Shaëraviju thotë:

Logjika është shqisë me të cilën dallohet njeriu. Logjika nuk ka punë aty ku nuk ka çka të logjikohet. Roli i logjikës është vetëm me zgjedh mes çështjeve, pra në fushën e zgjedhjes.

Çështjet të cilat nuk kanë zgjedhje por ato kanë vetëm një mundësi, vetëm një rrugë, aty nuk ka punë logjika, mirëpo në çështjet ku ka dy e më shumë mundësi, atëherë ndërhyn logjika për të zgjedh çështjen të cilën e mendon se është më e përshtatshmja.

Argument për këtë kemi, se kur mendja bllokohet, pra kur të çmendet njeriu, për atë njeri nuk ka obligim, pra hiqet obligimi prej tij, sepse në ato raste nuk ekziston mundësia e zgjedhjes, pra ai lirohet se nuk ka çka të zgjedh sepse është i çmendur.

FILLIMI I SUREVE ME SHKRONJA TË ALFABETIT

Dijetarët e mëhershëm dhe të sotshëm kanë diskutuar shumë rreth vendosjes së shkronjave të alfabetit arab në fillim të sureve.

Disa kanë thënë se janë shkronja tërheq-vërejtjes, thirrorë për t'u përgatitur i thirruri për të pranuar ajetet fisnike të cilat vijnë në vazhdim.

Të tjerët kanë thënë se shkronja "Kaf" është emërtim kodre, ndërsa disa shkronja tjera për qëllim emërtimin e disa sendeve lëndore.

Disa komentues mendojnë se: sepse këto shkronja janë përsëritur në Kur'an më shumë se shkronjat tjera.

Të tjerët mendojnë se janë shkronja logaritmike, pra thonë llogari të gjithësisë. Pra llogari në horizont, siç janë planetet, yjet dhe trupat tjerë qiellorë.

Dhe përderisa ka polemika rreth një çështjeje, kjo tregon për rëndësinë dhe problemin, apo rëndësinë e zgjedhjes së një problemi të madh. Posaçërisht kur dihet se Muhamedi a.s. nuk ka fol për të dhe nuk e ka pyetur askush për këtë edhe kanë ardhur variante dhe mendime të ndryshme.

Kur e kam promovuar librin tim "Mrekullia mjekësore në Kur'an" për këtë çështje e kam pyetur Imamin e nderuar Shejh Shaëravijun, Imami i nderuar është përgjigjur: Dijetarët e parë e kanë ditur për fillimin e këtyre sureve me këto shkronja, për këtë arsye edhe nuk kanë pyetur për to, pse sikur mos ta kishin ditur kuptimin e tyre do ta kishin pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. për to.

ME GURALECË ËSHTË MUNDUR USHTRIA E EBREHESË

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"A nuk e ke parë se ç'bëri Zoti yt me poseduesit e elefantit? A nuk ua bëri përpjekjen e tyre të dështuar? Dhe Ai kundër tyre lëshoi shpendë që vinin tufë- tufë! Dhe i gjuanin ata me gurë nga balta e gurëzuar! Dhe ata i bëri si gjeth i grimcuar (i përtypur)!".

Fjala "*guralecë*". Guralecët a kanë qenë prej zjarri apo këtu ka të bëjë me mikrobet, të cilët e kanë shkatërruar ushtrinë e elefantëve të Ebrehesë?

Në librin tonë "Mrekullia mjekësore në Kur'an" për këtë çështje kemi

diskutuar shumë dhe me përkushtim të madh.

Imami i nderuar nuk e pranon se bëhet fjalë për mikrobet, sepse po të ishte ashtu, atëherë mikrobet do të ishin shpërndarë në tërë Mekën.

Pastaj Imami pyet: Cili shpend i mençur fluturon vetëm në një drejtim të përcaktuar, duke dashur t'ia lehtësojë çështjet Allahut.

Pra, Shejh Shaëraviju mendon se kanë qenë guralecë të vërtetë, e është larg asaj që thuhet se kanë qenë mikrobe e jo guralecë.

HIPOKRITËT DHE DËNIMI I TYRE

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Vërtetë hipokritët janë në pjesën më të poshtme të zjarrit."

Muhamedi s.a.v.s. ka thënë:

"Hipokriti njihet në tri cilësi: Kur të flet rrenë, kur të premton tradhton, dhe kur t'i besohet diçka tradhton."

Cila është e vërteta e hipokritëve?

Shejh Shaëraviju thotë:

Allahu tallet me hipokritët përderisa ata veç kanë thënë: Vërtet ne jemi duke u tallur.

Zoti i Lartmadhëruar i thotë hipokritit:

"Pasi që ke bërë hipokrizi dhe ke thënë me gjuhë atë që nuk e ke në zemrën tënde, atëherë do të merremi me ty, kështu do t'i marrim prej teje sendet që i thua haptazi dhe do t'i vendosim me ligjet tona. Do të të lejojmë që ti të bashkëjetosh e me u martua me muslimanet, e me i trashëgua muslimanët, por me këtë e kemi për qëllim që ti të jesh i përgjithmonshëm në zjarr, në fund të fundit të xhehenemit. Ashtu siç ke vepruar ti o hipokrit, që haptazi ke qenë ndryshe, e fshehtazi ndryshe, ashtu edhe ne haptazi veprojmë ashtu siç sillesh haptazi se nuk ka Zot tjetër pos Allahut, pasi që thua: La i lahe il-lallah Muhamedun resulullah, pastaj Ne të llogarisim prej pabesimtarëve. A mos je ti o hipokrit vetëm ti lajkatar? Jo kurrsesi jo. Allahu është lajkatari më i mirë."

Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: *Allahu tallet*, sepse fjala "ISTIHLA" ka domethënien: nënçmim, tallje e poshtërim.

PUNA E CILA TË SHPIE NË XHENET DHE PUNA E CILA TË SHPIE NË XHEHENEM

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: Cila punë të shpie në xhenet?

Është përgjigj: ***Sinqeriteti, pse sinqeriteti i robit të Allahut është mirësi, mirësia e shti të besojë, e kur të besojë shkon në xhenet.***

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: Cila punë të shpie në xhehenem?

Është përgjigj: ***Rrena, pse kur të rrenë robi mëkaton e mëkatimi e shtyn në pabesim, e pabesimi e shpie në zjarr të xhehenemit.*** E ka fol të vërtetën i Dërguari i Allahut s.a.v.s

SUFEHATË-MENDJELEHTËT

Zoti i Lartmadhëruar thotë: ***Dhe nëse u thuhet atyre besoni ashtu siç kanë besuar njerëzit (tjerë)? Thonë: A të besojmë ashtu siç kanë besuar mendjelehtët ? Përkundra, pra ata janë me të vërtet ato mendjelehtët por nuk e dinë.***

Cili është kuptimi i fjalës *Sefijh – Mendjelehtë*?

Shejh Shaëraviju thotë:

Sefhe do të thotë mendjelehtësi pra do të thotë paaftësi për t'i kuptuar çështjet.

Mirëpo, kush është Sefijh-mendjelehtë: Ai i cili beson në Zotin e tij apo ai i cili nuk beson?

Pra... Nëse ju besoni (mendoni) se ato janë mendjelehtët, pse atëherë kërkoni prej vetvetes suaj që të besoni e të bëheni mendjelehtë? Edhe kjo është mendjelehtësi . . . edhe kjo është kundër argument për ta.

RRUGA E VULLNETIT DHE E VETËDËSHIRËS DHE RRUGA E PAVULLNETIT DHE IMPONIMIT

Në çdo çështje ku zhvillohet polemika dhe fillojnë kundërthëniet, shohim se islami për atë çështje e ka dhënë fjalën përfundimtare dhe definitive.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"... dhe mos harro pjesën e kësaj bote" (El-Kasas, 77)

Po ashtu thotë:

"Ta dini se jeta e kësaj bote është lojë, aheng e zbavitje dhe zbukurim". (El-Hadidë, 20)

Nëse kemi për qëllim të themi jeta në ekzistencë është jetë e jovetëdëshirës dhe e jovullnetit ose jetë e vetëdëshirës dhe e vullnetit, atëherë jeta gjithmonë është epiqendër e këtyre dy çështjeve. Lëvizjet dhe aktiviteti, i cili ndodhë pa vetëdëshirë, lëvizjet që ndodhin me vetëdëshirë dhe në mes të lëvizjeve që ndodhin me vetëdëshirë ose i jepet përparësi zgjedhjes së veprimit.

Jeta e lumtur e botës tjetër, apo kënaqësia në të është në atë masë sa ke qenë i sinqertë dhe sa ke qenë i vetëpërmbajtur në jetën tënde të kësaj bote. Bota tjetër nuk është temë e fesë, por është shpërblim për shkak të fesë.

Ata të cilët thonë se kjo botë është qëllim final dhe nuk ka asgjë pas saj, ne i kundërpërgjigjemi: Cili është faji i atyre të cilët përjetojnë dhembje, vuajtje e vështirësi për t'i bërë të lumtur të tjerët? Ku mbetet shpërblimi i tyre?

Nëse i shikojmë çështjet kështu, atëherë ata të cilët vuajnë për t'i kënaqur të tjerët janë më marroqët dhe më budallenjtë, sepse ata e kanë humbur ajo çka është kryesore në jetën e tyre, e ajo është çështja e kësaj bote, dhe nuk presin kompensim asgjë në atë që quhet bota tjetër.

IMPONIMI DHE LIRIA E VEPRIMIT - DËSHIRA DHE ZGJEDHJA E VEPRIMIT

Në të gjitha çështjet ku diskutohet dhe për ato çështje bëhet polemikë e madhe, shohim se islami e jep mendimin definitiv dhe të qartë.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Mos harro pjesën tënde prej kësaj bote.” (El Kasas, 77)

Po ashtu thotë:

“Ta dini se jeta e kësaj bote është lojë, zbavitje e zbukurim.” (El Hadidë, 20)

Nëse kemi për qëllim të deklarojmë për jetën me ekzistencë në përgjithësi pra lëvizjeve të padëshirueshme dhe nënshtruese dhe po ashtu lëvizjen e dëshirueshme dhe jonënshtruese pse jeta gjithmonë është fushë e dy lloje të lëvizjeve.

Lloji i parë: Lëvizjet të cilat ndodhin pa dëshirë.

Lloji i dytë: Lëvizjet që ndodhin me dëshirë, por dëshira prapë është në es gjërave në diskonim apo në ambient.

Ndërsa sa i përket botës tjetër, aty ka lumturi varësisht prej sinqeritetit dhe punës tënde në këtë botë. Bota tjetë nuk është çështje e fesë, por çështje e shpërblimit, respektivisht dënimit për shkak të fesë.

Ata të cilët thonë: Kjo botë është pika kryesore dhe nuk ka pas kësaj bote asgjë. Ne i kundërpërgjigjemi: Po çka është puna me ata të cilët mundohen në jetën e tyre vetëm e vetëm për t’u sjellë lumturi tjerëve. Ku do të shpërblehen ata?!

Nëse shkojmë sipas këtij parimi, atëherë ata të cilët e kanë vështirësuar jetën e tyre vetëm e vetëm për t’u sjellë lumturi të tjerëve do të ishin njerëzit më të çoroditur dhe më të çmendurit! Sepse ata një pikë të cilën e kanë pasur, pra këtë dunja, edhe atë e kanë humbur dhe nuk kanë kurrfarë kompensimi në botën tjetër.

BARAZIA E MASHKULLIT ME FEMRËN

Ata të cilët e ngritin zërin që femra të barazohet me mashkullin, pse nuk e ngritin zërin që mashkulli të barazohet me femrën?

Pra për me kërkua prej saj me punua punën e mashkullit. Ka qenë dashtë me kërkua që edhe burri me punua punën e femrës, se përndryshe bëjnë padrejtësi në peshojën e barazisë të cilën po e kërkojnë.

Nëse femra punon punën e mashkullit dhe mbetet prapë me i krye punët e saja të posaçme, pra të cilat i takojnë natyrës së saj. Kjo do të thoshte se ne e kemi ngarkuar dyfish.

Kështu, ata nuk kërkojnë barazimin e saj, por përkundrazi ata kërkojnë me ngarkua më shumë, dhe me i bë padrejtësi. Nëse femra dëshiron drejtësi për vete, ajo do të shikonte ata të cilët kërkojnë barazi të saj me mashkullin, ajo çka është posaçërisht për të. Nëse ata dëshirojnë drejtësi që ajo të jetë e barazuar me mashkullin, ka qenë dashur të kërkojnë që ajo mos të punoj punët e mashkullit, e me qenë fushëveprimi i saj në punët e lehta, jo të rënda dhe jo të vështira.

TRASHËGIMIA E MASHKULLIT DHE TRASHËGIMIA E FEMRËS

Pyetje: Pse pjesa e femrës është sa gjysma e pjesës së mashkullit në trashëgimi?

Përgjigje: Shejh Shaëraviju thotë: Ai i cili thotë ashtu i themi: Pse islami e ka zvogëluar pjesën e femrës nga pjesa e burrit në trashëgimi, duhet të shikojmë: Me këtë islami a ka anuar në anën e mashkullit apo në anën e femrës?

Në islam, para martesës për femrën, përgjegjësinë për furnizim e ka kujdestari i saj, ndërsa pas martesës përgjegjësinë për furnizim e ka burri i saj edhe nëse supozojmë se ajo është e pasur ndërsa burri i saj i varfër. A e detyron sheriati që ajo ta furnizoj atë kur ai është i varfër? Natyrisht jo... Por ai merr borxh dhe nuk ka të drejt të ia merr asaj, pra femra nuk është furnizuese por e furnizuar si para martesës ashtu edhe pas martesës.

Nëse pjesën e trashëguar dy të tretat ia japim vëllait të saj ndërsa një të

tretën asaj. Burri e ka për detyrë ta ketë shtëpinë, të martohet, pra ta sjell bashkëshorten në shtëpi dhe të shpenzojë për furnizimin e saj pra për këtë ai ka të drejtë në dy të tretat me investuar për vetën dhe për bashkëshorten e tij, ndërsa motra e tij kur të martohet, nuk e ka për detyrë që ta furnizoj bashkëshortin e saj, e nga ky shkak një e treta është e destinuar për ta e një e treta tjetër jo. Ata të cilët pak logjikojnë ka qenë dashtë të supozojnë: femra nuk është furnizuese as para martesës, as pas martesës, ajo asnjëherë nuk është furnizuese e shtëpisë, e kjo është lehtësi për femrën...

USHQIMI I VËRTETË

Pyetje: Në vendet e zhvilluara përkundër jetës komode, përkundër kushteve të volitshme për jetë, përkundër civilizimit dhe zhvillimit bashkëkohor, prapëseprapë shohim se të rinjtë bëjnë vetëvrasje. Cilat janë shkaqet?

Imami i mirënjohur përgjigjet:

Suedia është prej vendeve më të zhvilluara dhe më të ngritura, ndërsa sipas statistikave numri më i madh i të rinjve, të cilët bëjnë vetëvrasje është në Suedi, në të cilin edhe dominojnë sëmundjet e çmendurisë dhe psikopatisë. Pse atëherë ata të bëjnë vetëvrasje kurse i kanë të gjitha kushtet më të volitshme të jetesës, mirëpo natyrisht ata kanë uri në çështje tjera.

Ai ushqen një pjesë të trupit të tij, mirëpo nuk e ushqen pjesën tjetër, e kështu ndodhë tronditja, sepse pjesët tjera të nevojshme të trupit nuk i ka të zhvilluara, të edukuara, dhe kështu nuk ndodhë harmonizimi mes tyre. Mirëpo besimtari i rrit dhe i zhvillon paralel të gjitha pjesët e trupit të tij. Nëse e merr një njeri dhe ia heq pjesën më të lartë të trurit të tij, ai bëhet plotësisht si kafshë dhe jeton e lëvizë dhe i ka sjelljet si të kafshës.

Pra, humaniteti i tërësishëm qëndron në pjesën më të lartë të trurit. Kafshët jetojnë të uritura, mirëpo ata edhe kur janë në atë gjendje nuk jetojnë në stresin e varfërisë, apo frikën e krizës ekonomike ata as që mendojnë për këtë.

Kafsha ngordh apo pritet, ndërsa biri i saj para saj nuk ndien kurrfarë dhembje, as pikëllimin e ndarjes. Kafsha e di rolin të cilin ia ka dhënë Allahu

prej ndjenjave të cilat i bëjnë dobi e nuk e dëmton dhe nuk e brengos çështja kur sheh tjetrin duke vdekur. Në ato momente as që mendon për vdekjen e tij apo rrugën e cila e shpie në vdekje.

FJALA ALLAH NË GJUHËT E NJERIUT

Fjala e të Lartmadhëruar përfundon me shkronjën "ه - H", e cila është shkronjë e kraharorit – gjoksit, kur të artikulohet vendnxjerrja e tij është prej brendësisë së thellësisë së njeriut.

Shumica pyesin se kur ka filluar përdorimi i fjalës Allah në gjuhën e njeriut?

Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Po të kishte qenë fjala (Allah) çështje e cila nuk do të kishte ekzistuar, atëherë çështjet e paekzistuara nuk kanë emërtime të cilat tregojnë për atë çështje. Më e habitshme se kjo është se ti te të gjitha gjuhët mund të gjesh përdorimin e fjalës Zot, i cili është i ngjashëm me fjalën Allah. Është e patjetërsueshme se baza themelore e kësaj është te njeriu i parë të cilit ia ka mësuar Allahu. Allahu ia ka mësuar babës tonë Ademit a.s. pastaj është përcjellë gjeneratë pas gjenerate, e tek pastaj ka filluar kundërshtimi i njerëzve. Por parashtrohet pyetja pse?

Sepse njerëzit i kanë përcjellë fjalët të cilat tregojnë lëndët dhe nuk i kanë përcjellë fjalët të cilat tregojnë të padukshmet. Allahu është i padukshëm. Për këtë arsye në gjuhët tjera shohim se te filozofët fjala "mohim i Zotit" është argumentim në ekzistimin e Zotit. Pra, sikurse bazë është imani (besimi) e pastaj sekondare mohimi në Zotin.

Esenciale është se kjo fjalë iu është mësuar Ademit a.s. i cili pastaj ua ka mësuar bijve të tij. Esenciale është se kjo është natyrshmëri njerëzore. Andaj fjala Allah – Zot dhe fjala pabesim, që të dyja dëshmojnë në besimin në Zot, besimin në Allahun.

A KA PAS POLIGAMI PARA ISLAMIT ?

A ka pas poligami para islamit apo vetëm me ardhjen e islamit është ligjësuar poligamia?

Shejh Shaëraviju thotë: Islami nuk ka ardhur me parimin poligamisë, sepse poligamia veç ka ekzistuar edhe para islamit. Por islami ka ardhur për përkufizimin e poligamisë në 4 përpos te Pejgamberi s.a.v.s. sepse Muhamedi a.s. veç i ka pasur më shumë se 4. Muhamedi a.s. ka thënë: Mbaj 4 gratë dhe lëshoj të tjerat, gjë që tregon se poligamia ka qenë më shumë se 4 në realitet. Ata të cilët nuk kuptojnë e akuzojnë islamin se e ka lejuar poligaminë, mirëpo e vërteta është se poligaminë e ka kufizuar. Mirëpo kundërshtarët e islamit kalojnë në çështje tjetër, e ajo është se Muhamedi a.s. nuk iu është përmbajt fjalës. Mbaj 4 dhe lëshoj tjerat. Për t'i mbajtur 4 në rregull, ndërsa për t'i mbajtur më shumë se 4 është ndaluar, mirëpo kjo nuk e ndalon asnjë femër që ajo të lidh kurorë me tjetër kënd dhe të martohet me tjetër në kufirin brenda 4 grave. Në ato çaste Pejgamberi s.a.v.s. ka qenë i martuar me nëntë ndërsa ato momente kanë qenë momente ku gratë e Pejgamberit kanë qenë nëna të besimtarëve, dhe ka qenë e ndaluar që ndonjë prej besimtarëve të martohej me ndonjërën prej grave po ta kishte lëshuar Pejgamberi s.a.v.s. Dhe pasi që asnjë nuk do të martohej atëherë patjetër të i mbante në martesë.

MJEKIMI

Një beduin e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. o i Dërguar i Allahut: A të shërohemi?

Përgjigje: ***Po, sepse Allahu nuk ka zbrit sëmundje, e të mos e ketë zbritën shërimin, e mëson (e gjen) ai që mëson, dhe nuk e (gjen) e mëson ai i cili nuk mëson.***

(Ahmedi)

Në Sunen: Beduinët kanë pyetur: O Dërguar i Allahut: A të shërohemi?

Është përgjigjur: ***Po, o ju robër të Allahut shërohuni, se vërtet Allahu***

nuk ka lënë sëmundje pa e pasur shërimin (ilaçin) përpos vdekjes (e cila nuk ka shërim).

Është pyetur s.a.v.s.:

Si është puna me ilaçet që shërohemi në rukjet që shërohemi, dhe me preventivat që nuk lejojm të sëmureni, a mos është kundërshtim me kaderin e Allahut?

Është përgjigjur: ***Po mu ajo është kaderi i Allahut.***

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. a ndikon pozitivisht mjekimi në sëmundje?

Është përgjigjur: ***Pse a mos Allahu i Lartmadhëruar ka zbritur sëmundje në tokë e të mos ketë zbritur mjekim (ilaçin) e shërimit të asaj sëmundje.(Ahmedi)***

NDALIMI I IDHUJTARISË

Çka është "idhujtaria"?

Përgjigje: Idhujtaria është të ekzistuarit e Allahut me ortakët e tij. Idhujtaria është dy llojesh: E para : Supozimi se janë dy luftëra dhe (kanë marrëveshje) janë në pajtim mes vete. E Dyta : Supozimi se janë në kundërshtim mes vete.

E para është bashkëveprimi i të dyve në një çështje

E dyta nëse janë në kundërshtim mes vete, paraqitet problemi i supozimit se a mund të realizohet apo jo? Ekzistenca Aksidenti ose mund të ekzistoj ose jo pse njeri dëshiron me krijuar diçka e tjetri jo, e nëse veç krijohet diçka atëherë ndodh humbja e atij i cili nuk ka dëshiruar me u krijuar diçka (ekzistenca) e nëse nuk krijohet diçka atëherë dështon ai i cili ka dashur me krijuar. Për këtë arsye në të gjitha rastet është i pamundur idhujtaria. **"Dhe me të (Allahun) nuk ka Zot tjetër, se atëherë do të shkonte secili Zot me atë që ka krijuar dhe do të ngritej njëri mbi tjetrin." (El- Muëminunë, 91),** e nëse ndodh kjo, atëherë do të dyluftonin mes vete, dhe njëri do të ishte i ngritur mbi tjetrin. Pastaj do të ndodhte revanshizmi në dy luftim e kjo do të ishte në kundërshtim me përsosmërinë absolute të Zotit. Idhujtarët e gjorë, kur të shohin diçka refleksive në gjithësi, si p.sh. Dielli mbi ta duhet ta dinë

se ai i është nënshtruar Zotit, sepse ibadeti (adhurimi) ka kuptimin që robi me i krye urdhrat e Krijuesit, dhe epiqendër e ibadetit është planprogrami i Krijuesit me të gjitha ligjet dhe obligimet.

PROKLAMIMI

Çka është proklamimi dhe cili është rreziku i tij në shoqëri?

I nderuari imami Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë: Proklamimi është: zhvleftësimi i punës për shkak se nuk paguhet për atë që e ka punuar. Proklamuesi hulumton shpërblimin jomeritor, ai mund të kënaqet vetëm me një fjalë të njeriut tjetër, ndikimi në të është i cekët, e kjo është si rezultat sepse atij nuk i shoqërohet shpërblimi i madh i punës të cilën e ka premtuar Allahu. Ai gjithnjë hulumton pjekjen e të keqes me shpejtësi, dhe shpërblimin e punës me shpejtësi p.sh. Largimin e vetës së tij për të mos përngjajë se është fetar ose me pas respekt dhe pozitë të dalluar tek njerëzit. Kjo është një shpërblim simbolik dhe i dobët në krahasim me shpërblimin e përgjithmonshëm të cilën e ka parapa Allahu për robërit e tij të sinqertë.

Esenca e proklamimit është: mendjelehtësia në përcaktimin e shpërblimit. Sipas sheriatit proklamuesi është besimtarë sepse Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë: **"Proklamohen para njerëzve, dhe Allahun e përmendim vetëm pak".(EN-NISA, 142)**

PSE SUREJA IHLAS PAS SURES KJAFIRINË NASR DHE MESED

Pse është vendosur në Kur'an sureja "Ihlas" pas suretu Kjafirun, Nasr dhe Mesed?

Shejh Shaëraviju thotë:

Renditja e suretul-Ihlas pas suretu El-Kjafirun, En-Nasr dhe El-Mesed është renditje e domosdoshme, sepse e para i ndërpret marrëdhëniet plotësisht me pabesimtarë sepse ata janë të vendosur në pabesimin e tyre. E kjo ndërprerje e marrëdhënieve është bë nga ana e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. në ajetin. "Nuk besoj atë që besoni ju" dhe ajeti tjetër dhe "unë nuk do të besoj atë që ju keni besuar". Kjo është domethënia e TEVHIDIT. Njëshmërisë dhe rrënjosja në zemër... Këtu ajeti vërteton ndërprerjen e marrëdhënieve me pabesimtarët në çfarëdo kushtesh dhe rrethanash. E me këtë kuptohet ndërprerje e marrëdhënieve, pra pranimin e kundërshtarit me fenë e tij si do që të jetoj. Mirëpo a vazhdon gjendja kështu? Vjen sureja "Nasr". "Dhe kur vjen ndihma e Allahut dhe fitorja". Sinjalizon dështimin e pabesimtarëve dhe ziliqarëve. E kjo do të thotë se të gjithë pabesimtarët do të besojnë në fenë e Allahut. Për këtë arsye vjen në Kur'an përjashtimi, disave duke tregu disa prej tyre siç është rasti i Ebi Lehebit e të ngjashëm të cilët e luftojnë thirrjen islame, për këtë arsye është sureja Mesed "Ju thafshin duart (u mallkoftë) Ebi Lehebit ashtu siq ju kan tharë (paralizu)". Sureja e tretë pas dy sureve të para për me bë përjashtim të disa pabesimtarëve të cilët me kufrin e tyre luftojnë besimin, e pas kësaj vjen sureja "Ihlas" për me vendos të vërtetën se bazë e atyre e ka u tha më parë prej ajeteve është "Ai(Allahu) një i vetëm", dhe çdo gjë e ka u cek më lartë është fjalë e të vetmit Allah, e vërtetë dhe e pamohueshme, dhe e pandryshueshme. Kështu të gjitha suret janë të thurrura dhe harmonike mes vete ...

BUJQËSIA DHE OBLIGUESHMËRIA

Çdo obligim prej obligimeve të kësaj bote është i përcaktuar dhe i përkufizuar në të gjitha fetë qiellore për t'iu sjellë planprogrami i tyre lumturi qenies njerëzore, dhe mos të shkaktohet turbullira dhe trazira. Si qëndron çështja me suksesin në kryerjen e obligimeve?

Shejh Shaëraviju përgjigjet:

FELEHA do të thotë: ndalje, ndërprerje, hekuri me hekurin prihet. Kjo domethënie shpie në kuptimin e aktivitetit i cili rezulton pjesën tjetër automatikisht.

Bujku kur ta punon tokën këtë e ka pasuar nga baba i tij Ademi a.s. Mirëpo Ademi a.s. kur e ka punuar tokën, nga kush ka mësuar?

Ai ka mësuar prej Allahut, ashtu siç ia ka mësuar të gjitha emrat e ekzistencës. Rrënjët e shkencave janë prej Allahut, sepse Allahu nuk e ka krijuar Ademin që ta kryejë rolin e tij në tokë pa ia mësuar rregullat në të ose së paku ka mësuar fillimin e këtij roli dhe misioni.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"A e shihnit farën që ju e mbillni në tokë? A ju e bëni që të rritet apo Ne jemi Rritës dhe zhvillues së saj? Po të donim Ne mund ta shkatërronim e ta bënim pluhur, e ju do të ishit habitur e brengosur (pa shpresë)."

Obligueshmëria e ngushton njeriun, mirëpo Allahu ia mëson njeriut se obligueshmëria e zgjeron njeriun, sepse ngushtësimi është në këtë botë kalimtare, ndërsa Zoti i Lartmadhëruar do të jep në botën tjetër të përgjithmonshme tokën, në të cilën ti mbjell një kokërr, prej saj ti pastaj i fiton shtatëqind kokrra. Pasi që toka është diçka e krijuar të jep fitim të shumëfishtë prej asaj çka i jep asaj. Po si është çështja me Krijuesin? A nuk të jep shumëfish nga ajo që jep ti?

NË NAMAZET E TYRE JANË PËRTACË

Pyetje: Pse disa njerëz përtojnë në faljen e namazit, kur dihet se Muhamedi a.s. ka thënë: ***"Namazi është shtyllë e fesë."?***

Po ashtu ka thënë: ***"Nuk i takon islamit lënësi i namazit".***

Përgjigje: Shejh Shaëraviju thotë:

Disa prej njerëzve a nuk e falin namazin për atë se merr kohë e cila ju nevojitet atyre për punën e tyre e cila u nevojitet për jetë.

Nëse puna është kështu, u themi atyre: Në çka bazohet vlera e kohës?

Vërtetë Zoti i Lartmadhëruar nëse e sheh se ti ke sakrifikua kohë e cila të është nevojit për fitim të pasurisë, ti atë kohë që ke punua dhe ke ardhur me pasuri tek Allahu për me tregu adhurimin tënd se pasurinë të cilën e ke fitua me duart tua, duhet me nda një pjesë të pasurisë për vëllezërit tu të dobët, e për atë është ligjësua zekati.

VLERA E XHEMATIT

Në jetën islame xhemati ka vlerë të madhe. Adhurimi me xhematë është më i vlefshëm te Allahu se ai i vetëm. Dhe derisa sa Musa a.s. i ka thënë Hidrit:

"Nëse dëshiron Allahu do të jem ***durimtar****."* Ai nuk ka mundur të durojë, sepse ka thënë në njëjës "**durimtar**". Ndërsa, ne shohim se Ismaili, kur ka qenë në pyetje për t'u bërë kurban, i ka thënë babës së tij: ***"****Nëse do Allahu do të jem prej* ***durimtarëve".*** Për këtë arsye ai veç ka duruar. Sepse ka thënë në shumës "**prej durimtarëve**" . Kjo na tregon qartë vlerën e shumësit xhematit.

Për këtë çështje Shejh Shaëraviju na tregon se në namaz; kur ta këndojmë suretul "fatihan", themi: ***"****Vetëm ty të* ***adhurojmë*** *dhe vetëm prej teje ndihmë* ***kërkojmë".*** Pra muslimani thotë për vete dhe për tjetrin, edhe tjetri thotë për veten dhe për tjetrin, e kështu me radhë ...

Ti ndoshta nuk je i kënaqur dhe nuk të pushon zemra për punën tënde që e ke kryer te Allahu, mirëpo nëse është me xhematë, atëherë është e mundur që prej gjithë asaj mase, ndonjërit nga robërit t'iu pranohet te Allahu. E ti nëse iu ke bashkangjitur atyre me adhurim e lutje, atëherë kur Allahu t'ia pranojë xhematit në tërësi, ti veç je në mesin e atij xhemati ...

ZEKATI DHE ZHVILLIMI – SHTIMI I PASURISË

Si mundet me qenë zekati shtim i pasurisë, kurse zekati është dhënie, e dhëna e pakëson pasurinë e dhënësit. E si mundet me qenë pastrim i pasurisë?

Përgjigje: Shejh Shaëraviju thotë:

Zekati është shtim dhe pastrim. Është pastrim sepse zekat- pranuesi është i dobët, e sheh atë i cili është më i fuqishëm se vet. Atëherë atij i nxiten ndjenjat e tij dhe fillon urrejtja, xhelozia dhe zemërimi mbi ta, mirëpo kur ta sheh se njeriu të cilit Zoti i ka dhënë begati, pastaj prej asaj begatie ai e zgjat dorën dhe jep, ai në vete thotë: begatia e këtij njeriu më ndihmoj mua, kështu që ai e pastron zemrën nga zemërimi dhe urrejtja.

Zekati është shtim, sepse kur i pasuri i jep pasuri, ai veç e ka zhvillu aktivitetin e jetës me atë pasuri, po ashtu ai tregohet se është i barabartë me shoqërinë në besim, sepse ai nuk e sheh perspektivën me vëllezërit besimtarë përreth.

Pra atë nuk e preokupojnë ngjarjet e jetës, e përderisa me të jetojnë vëllezërit e tij besimtarë. E mira të tjerët është kënaqësi për të. Shtimi i pasurisë realizohet me burrërinë e tij, me fuqinë e tij dhe personalitetin e tij.

Mirëpo, nëse njerëzit tërhiqen nga ai, ai ballafaqohet me jetën e tij me vetën e tij, sepse ai atëherë jeton i vetmuar... dhe i vetmuar nuk mund ta arrijë shtimin e pasurisë të cilën e kërkon, dhe nuk ka shpresë dhe lumturi në jetën e tij.

PENDIMI

Pyetje: Cila është urtësia e ligjërimit të TEVBES, dhe pranimi i pendimit prej Pendim-pranuesit. Falësit të gabimeve?

Përgjigje: Imami i njohur thotë:

Ligjësimi i pendimit, pranimi i faljes prej Zotit të Lartmadhëruar ka ardhur me siguri dhe me mbrojt rrugën e udhëzimit në tokë, sepse po mos të ishte ligjësuar pendimi atëherë aksidentalisht po të binte njeriu në mëkate atëherë ato mëkate do të kishin qenë pengesë pastaj që ai me u kthye në rrugë të drejt, dhe do të kishte vazhduar me mëkate, ashtu që do të pësonin trazirat dhe shkatërrinat në tokë. Sepse vetëm prej një lëshimi apo vetëm të një mëkati do të dëboheshin njerëzit prej mëshirës së Allahut dhe nuk do të shpresonin me u kthye në gjendjen e mëparshme pra të pastër prej gabimeve. Pra pse me u kthye në planprogramin e lirive dhe epsheve të kufizuara pasi që një mëkat do ta dëbonte atë nga mëshira e Allahut.

Paramendoni, sikur ndonjëri të bënte mëkat dhe të humbte shpresën me ia pranua Zoti tevben.

Si do të kishte me veprua ai?

Ai do të vazhdonte dhe të mëkatonte më shumë, do të bënte padrejtësi më shumë, do të bënte krime më shumë, e pastaj do t'i mashtronte edhe tjerët në rrugën e tij të keqe, e atëherë e tërë bota do të bëhej me të këqij, do të paralizohej jeta, sepse askush nuk do të mund t'u kundërvihej atyre, pra ligjësimi i tevbes prej Zotit është hapje e rrugës për tu kthyer nga rruga e lakuar në rrugë të drejtë.

Për këtë arsye, Allahu arsyeton njeriun me gabua për shkak të harresës apo pakujdesisë. Arsyetimi është sepse njeriu ndonjëherë dobësohet kur të bën mëkat, por kjo nuk llogaritet prej çështjeve të mëkatimit dhe Allahut i cili gëzohet me tevben e robit mëkatar sikurse ai i cili e ka humb devenë e tij dhe e deveja e ka lënë të humbur në shkretëtirë e pastaj e gjen edhe devenë edhe mallrat në të.

E gjithë kjo për të mbrojt dhe sigurua ekzistencën.

NË PAAFTËSI KA URTËSI

Disa persona kanë aftësi të kufizuara, për këtë arsye janë një pjesë e shoqërisë me të meta fizike. Nëse i numërojmë të paaftit apo njerëzit me aftësi të kufizuara na del se proporcioni është një me mbi dhjetëmijë (Aftësi të kufizuara quhen të çmendurit, të verbëritë, kaluesit).

Pra numri i tyre është i vogël pra në krahasim me të aftit është shumë shumë i vogël. Këtë e ka përcaktua Allahu në gjithësi për me ua tërhequr vërejtjen harrestarëve për të mirat dhe begatitë që ua ka dhënë Allahu atyre.

Ti nuk mund ta dish të mirën e syve ku deri sa ta pashë një të verbët, tek atëherë i kthehesh vetes tënde. Ti nuk mund ta dish begatinë e këmbëve tua deri sa të pash ndonjë njeri pa këmbë, pse tek atëherë e sheh aftësinë e këmbëve që të ndihmojnë me lëvizë pa kurrfarë mundimi. Reflektimi në trupin tënd, në mendjen tënde vjen atëherë kur ta pash një njeri i cili nuk mund të lëviz sipas dëshirës së tij.

Pra ai nëse dëshiron me lëvizë por nuk mundet ashtu siç dëshiron pra nervat e pjesëve të trupit nuk janë në gjendje t'i aktivizojnë ashtu siç aktivizon rryma mjetin. Pra njerëzit me aftësi të kufizuara i ka parapa Allahu që të jenë në numër simbolik për me nxit me i përkujtua begatitë e trupit tënd, mos me i harru të mirat e Allahut por me qenë ata shembuj praktik.

FAJI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE ÇËSHTJA E SPROVIMIT TË TYRE

Pyetje: Pasi që jeta në këtë botë, me të gjitha bukuritë dhe kënaqësitë e saj, ndërsa në anën tjetër personat me aftësi të kufizuara nuk ka dyshim se ndiejnë veten të mangët në realizimin e kënaqësive, lumturisë dhe përjetimin e kënaqësive të cilat të tjerët i përjetojnë dhe i realizojnë. Cili është faji i personave me aftësi të kufizuara, të cilët për shkak të të metave fizike nuk mund ta realizojnë një pjesë të madhe të kënaqësisë së kësaj bote?

Përgjigje: Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Zoti i Lartmadhëruar ka zgjedhur disa njerëz për të qenë mostër te të tjerët.

Cili është faji i aftësive të kufizuara në këta njerëz ose p.sh., cili është

faji i të verbëtit? Pastaj ta tërheqë vërejtjen dhe përgjigjja është:

Ti po e sheh se çka i mungon (çka nuk iu është dhënë), mirëpo ti po harron se çka posedon ti, çka të ka dhënë Allahu ty përballë tij apo në krahasim me të. Nëse e shoh njeriun me të meta fizike p.sh., dhe i analizon të gjitha begatitë tjera të pjesëve fizike të tij do të shohësh se Allahu i ka dhënë atij diçka tjetër, me fjalë tjera ia ka kompensuar në pjesë tjera, atë çka i mungon në një pjesë të trupit. Është verbëruar njeriu ndërsa mprehtësia e mendjes është në të mbyllurit e syve.

Dhe u mahnita kur pashë se ai është kompletuar për dituri. Humbja e bebëzave të syrit iu kishte bërë udhëheqës i mendjes.

Diturinë të cilën tjerët nuk e kishin ai ua mësonte.

Ne e dimë se shumica e zbuluesve kanë qenë të pa aftë në disa apo në një pjesë të trupit të tyre.

Ne po ashtu shohim gjenialitet, të cilën dhunti ua jep Allahu në vetë pjesën, hapësirën, apo vetë organin e tij fizik, i cili është i kufizuar në aftësi të tij.

Kur Allahu njeriut i mungon (nuk i jep) diçka në një pjesë të trupit të atij personi Allahu ia jep aftësinë e dyfishtë ose të shumëfishtë në pjesën tjetër të trupit të tij. Kështu tërësia e çdo njeriu është e barabartë me njerëzit tjerë. Mirëpo përfundimisht njerëzit dallohen njëri me tjetrin vetëm me devotshmëri.

E VËRTETA E TEVEKULIT (MBËSHTETJEN NË ALLAHUN)

ET-TEVEKUL dhe TEVAKUL janë dy fjalë që i përdorin njerëzit, ndërsa kuptimin e tyre nuk e dinë shumica prej tyre.

TEVEKULI gjithmonë është fjalë që ka të bëj me angazhimin e një pune të mundimshme, mirëpo i bindur dhe i sigurt se shpërblimi dhe pagimi i takon punëkryersve, dhe sa shpërblimi i mirë i punëkryersve.

Ndërsa "TEVAKUL" është prej tjetrit në tjetrin, pa u angazhuar dhe pa punuar për jetë.

Pyetja është: Cila është e vërteta e TEVEKULIT?

Imami i mirënjohur Shejh Shaëraviju thotë:

Vërtetë besimi është me zemër dhe me trup dhe derisa trupi punon

zemra duhet me u mbështet në Allahun (TEVEKUL KALBIHI).

Trupi punon e zemra mbështet, ky është parim i besimtarit.

Ndërsa ai i cili mendon apo parafytyron se TEVEKUL do të thotë anashkalim prej pune, dhe thotë se Allahu na furnizon ashtu qysh furnizon shpendët. Ne u themi atyre: Shpendët nuk janë të obliguar me mbjellë, puna e tyre është me u ushqye dhe me vazhdua fluturimin e tyre (e jo me u ndal me mbjell). Për këtë arsye atyre të cilët dëshirojnë që *tevekulin* ta bëjnë profesion u themi: Do ta vendosim tryezën, në të do të vendosim ushqim të shijshëm dhe të shohim *tevekulin* tënd. Pra ti mos e zgjat dorën në tryezë fare, e ne të shohim se a mos po kërcen ushqimi drejt në gojën tënde ! ?

Ata të cilët thonë ashtu, vërtetohet se janë rrenacak sepse e vërteta e *tevekulit* është me angazhua (lodh) trupin tënd e me qetësua zemrën tënde.

MESXHIDI AKSAJA E DIKURSHME

Mesxhidi Aksaja a ka qenë Mesxhid, kur dihet se më herët Muhamedi a.s. nuk është falur në të, dhe nuk ka qenë Mesxhid në kuptim të fjalës.

Imami i mirënjohur ka thënë:

Çka do të thotë Mesxhid?

Mesxhid është kuptim i vendit ku bëhet sexhdja. Sexhdja ka qenë veprim apo ligjësim i të gjitha shpalljeve. Mirëpo ka dallim në mes të rrënjës së fjalës, dhe veprimit me ato fjalë, me fjalë tjera kuptimit terminologjik të saj. Pra fjala Mesxhid a është objekt dhe vend i posaçëm. Mesxhid quhet çdo vend ku i bëhet sexhde Allahut, mirëpo pastaj atë vend e quajmë Mesxhid, vendsexhde ndaj Allahut.

Argument për këtë kemi fjalën e Allahut të Lartmadhëruar:

“O Mejreme, vërtet Allahu të ka zgjedhur dhe të ka pastruar, të ka zgjedhur e të ka dalluar mbi të gjitha gratë e botës. Oj Mejreme nënshtroju Zotit tënd bën sexhde dhe falu (bjer në ruku) me falësit.”

Pra sikurse dëshirohet të tregohet se sexhdja ka ekzistua edhe në shpalljet e mëhershme.

Po ashtu Zoti i Lartmadhëruar na tregon ngjarjen e strehuesve të shpellës ku thotë: “**Do ta marrim atë vend si Mesxhid”.** Pra sikurse

dëshirohet të tregohet se fjala Mesxhid nuk ka ardhur me islamin, por përdorimi i kësaj fjale është përdorur dhe është përhapur në këto vende paralel me Islamin. Me fjalë tjera çdo vend ku i bëhet sexhde Allahut është *Mesxhid*.

Kemi thënë se: Mesxhidi Harami është shtëpia e parë e cila është vendosur për njerëzimin. Duhet ta kemi parasysh atë se disa njerëz kanë thënë se Ibrahimi a.s. e ka ndërtuar atë.

E ne u themi atyre: Jo. Qabja veç ka qenë e vendosur për njerëzimin. Pasi që veç ka qenë e vendosur për njerëzimin, kjo do të thotë se vendosja e saj (Qabes) ka qenë jashtë ndikimit të qenies njerëzore dhe para se të jetë krijuar Ademi a.s. dhe njerëzit. Patjetër mbetet alternativa se ajo është shtëpi e Allahut, dhe patjetër që ajo ka qenë e vendosur para Ademit. Siç është ajeti Kur'anor. **"Vërtetë shtëpia e parë e cila është vendosur për njerëzimin. Ademi është njeri, fëmijët e tij janë njerëz, dhe ata të cilët hyjnë në të dhe sillen rreth saj me qenë prej njerëzve se për ta është vendosur, mirëpo Ibrahimi vetëm i ka ringritur themelet, pra i ka lartësua themelet e shtëpisë".**

Duhet ta dimë edhe atë se Ismaili a.s. i ka ndihmuar babës së tij, Ibrahimit, në ngritjen (lartësimin) e themeleve të shtëpisë.

"Dhe përkujto kur i ka ngritë Ibrahimi themelet e shtëpisë dhe Ismaili."

Ismaili i ka ndihmuar babës së tij me e rindërtua, mirëpo Zoti i Lartmadhëruar na tregon në një ajet tjetër:

"O Zoti im vërtetë unë vendosa pasardhësit e mi në bregoren e cila nuk ka bimë e as pemë, por që aty është shtëpia jote e Shenjtë. O Zoti im për të falë ata namaz."

Pra, Haxherja dhe biri i saj në gji kur janë dërgua aty, mirëpo aty nuk e kanë pa Kjabën e ngritur, por ka qenë e njohur se shtëpia e Allahut ka qenë aty para se me i ringritur Ibrahimi themelet e shtëpisë së shenjtë. Pra shtëpinë nuk e ka vendosur Ibrahimi dhe nuk është projekt dhe ndërtues nismëtar Ibrahimi. Mirëpo shtëpia ka qenë para Ibrahimit dhe Ibrahimi vetëm i ka ringrit themelet.

PREJ MESXHIDI HARAMIT NË MESXHIDI AKSA

Në suretul Isra Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **Qoftë i Lartësuar Ai i cili e ka bartur robin e tij për një pjesë të shkurt nate prej Mesxhidi Haramit e deri në Mesxhidi Aksa, të cilin e kemi bekua atë dhe periferinë e tij.** Pse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:"Prej Mesxhidi Haramit e deri në Mesxhidi Aksa."?

Shejh Shaëraviju thotë:

Sepse Qabja ka qenë e përcaktuar si shtëpi prej shtëpive të Allahut. Mirëpo ia kanë ndërrua këtë destinim dhe e kanë quajtur shtëpi arabe, dhe është mbushur me idhuj, ndërsa shtëpia e Kudsit, e ka pas shenjtorin e tij prej Musaut, Isaut dhe pejgamberëve tjerë te beni israilët.

I dërguari i Allahut s.a.v.s. nuk është dërguar vetëm për popullin e tij, pra nuk është dërguar posaçërisht për arabët, siç pretendojnë ata. Jo, është pejgamber ndërkombëtar. Udhëtimi për një pjesë të shkurtë të natës prej Mekës në bejtul Mukades, do të thotë përfshirjen e bejtul Mukadesit prej vendeve të shenjta në fenë e re. Ky akt sqaron se feja e tij është dëshmues dhe vërtetues i të gjitha vendeve dhe i të gjitha vendeve të shenjta, për këtë arsye në namaz në fillim të obligimit kthimi ka qenë në drejtim të tij. Që mos me thënë askush se ju e keni fenë tuaj e ne e kemi fenë tonë. Jo, s'është e vërtetë. Është e vërtetë se feja jonë ka zbrit në Meke mirëpo është vërtetues i pejgamberëve të mëparshëm dhe i Dërguari ynë është vërtetues i të gjitha vendeve të shenjta, e nga këtu bejtul Mukades është prej vendeve tona të shenjta sepse ka qenë vendi i fundit i Israsë dhe vendi i parë i Miëraxhit të Muhamedit s.a.v.s.

ÇKA ËSHTË SIDRETUL MUNTEHA?

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Atë (Xhibrilin) e ka parë edhe herën tjetër. (E ka parë) tek Sidretul Munteha”. (En-Nexhm, 13, 14)

Është e vërtetë se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka shkuar në Sidretul Munteha. Mirëpo pyetja është: Pse nuk na ka ardhur tekstualisht?

Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Kanë thënë: Kjo është mëshirë e Allahut ndaj krijesave të tij. Çështjen të cilën i dërguari i Allahu ka mund ta paraqes me argument lëndor për njerëzit ka ardhur tekstualisht dhe qartësisht, që të mos ketë vështirësi i Dërguari i Allahut për ta transmetuar. Ndërsa sa i përket çështjeve të cilat mendja ndalet në to dhe nuk i percepton e ka lënë që të jetë në besimin dhe Imanin tënd, apo dorëzimi yt paraprak, i cili është rezultat i Imanit, sepse përderisa ti je besimtar, do të thuash: Pasi që ka ndodhur dhe është krijuar kjo dhe kështu të cilën e di, atëherë mund të krijohet kjo dhe ajo të cilën nuk e di, sepse çka më ka ndodhur diçka e zakonshme, mund të më ndodhë edhe e jashtëzakonshme, çfarë pengese ka këtu ligji. Pse ligjet qiellore për Zotin, a mos janë të vështira, të paarritshme, ndërsa ligjet e tokës të lehta dhe të arritshme në raport me ligjet qiellore!!

Pse, mos vallë me mrekullitë me të cilat Zoti i Lartmadhëruar i ka përforcuar pejgamberët s.a.v.s. a mos janë diçka tjetër, pos diçka të jashtëzakonshme dhe jashtë ligjeve, të cilat Ai vetë i ka paraparë. Pra, është shumë e zakonshme që Ai i ndryshon ligjet e Tij të zakonshme.

Atëherë, është gjë normale t’i ndodhë edhe të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. . Ta marrim shembull, kur ndonjë filozof thotë: Është e vërtetë, unë besoj se është një Zot, i Cili ka krijuar gjithësinë. Mirëpo unë i them Allahu është Ai i Cili ka krijuar gjithësinë. Krijimi i ligjeve dhe mos krijimi i ligjeve është që secili kryen detyrën e vet, pra ligjet janë ata të cilët veprojnë. E kjo do të thotë se Allahu fuqinë e Tij e ka vendosur mbi pushtetin e Tij përnjëherë, ka krijuar ligjet, pastaj ka paraparë që ata ligje të praktikohen dhe të ekzekutohen, por dëshira e Allahut është që ato ligje t’i ndryshojë në disa raste apo më shumë se në disa raste, e kjo vetëm që ta kuptojmë se përmbi ligjeve natyrore dhe të zakonshme është Krijuesi i ligjit, i cili ka mundësi që atë ligj ose ta pezullojë, ose ta paralizojë.

Për këtë arsye ndodhin mrekullitë mbinatyrore. Të gjitha mrekullitë mbinatyrore, të cilat i janë dhënë të Dërguarve të Allahut të gjitha janë ndryshim të ligjeve natyrore. Se përndryshe ligji ujit është të qarkullojë, e qarkullimi i tij nuk mundet të jetë mrekulli mbinatyrore, por ligj natyror.

Nuk ka që një ujë të ketë ligj të qëndrojë kështu (teposhtë), ndërsa tjetri ujë të ketë këtë ligj të qëndrojë ashtu thik përpjetë. Kështu që Musa a.s. kur i ka rënë ujit të detit dhe deti është ndarë dhe është bërë si të ishte në dy pjesë (ndërtesa- penda) të larta. Kjo është pra ndryshim i ligjit (mrekulli mbinatyrore).

Ligji i zjarrit është për të djegë, Ibrahimi është hedhur në zjarr. Qëllimi nuk ka qenë që të shpëtohet Ibrahimi, sepse Ibrahimi a.s. ka mund të shpëtojë.

Edhe ndryshe, për t'iu ikur atyre ose Allahu ka mund të dërgojë shi rrebesh për ta fikur zjarrin. Mirëpo qëllimi ka qenë që Ibrahimi të hidhet në zjarr që të digjet, mirëpo ligji i zjarrit ndezës është pezulluar, është paralizuar dhe nuk ka djegur.

Kështu është rasti i Miëraxhit. Kush është Ai, i Cili e ka ngritur në qiell për të pa shenjat e tij? Ata do ta pyesin Muhamedin a.s.: Na përshkruaj Sidretul Muntehanë? Ata as që kanë dëgjuar dhe as që dinë diç për të, dhe as që dinë çka të pyesin për të? Zoti i Lartmadhëruar në rend të parë e ka bartur robin e tij prej Mesxhidi Haramit në Mesxhidi Aksa për një pjesë shumë të shkurtër nate (Israja) për të qenë argument lëndor, sepse ai udhëtim është udhëtim tokësor, dhe kjo mrekulli është i treguar tekstualisht në ajet të qartë, pastaj ia ka dhënë mrekullinë qiellore, i cili është Miëraxhi për obligueshmëri...

Për këtë arsye dijetarët kanë dhënë mendimin se: Ai i cili mohon Isranë është pabesimtar, sepse ai bie ndesh me tekstin kur'anor. Ndërsa ai i cili mohon Miëraxhin nuk është pabesimtar, por është mëkatar, sepse Israja është me ajet të drejtpërdrejtë dhe i treguar tekstualisht, ndërsa Miëraxhi në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, pra me tregues indikacioni për t'iu përmbajtur.

ËNDRRA DHE JOËNDRRA

Ajetet të cilat përshkruajnë ngjarjen e Israsë dhe Miëraxhit i shohim se si ndonjëherë thuhet "për me t'i tregu argumentet tona", pastaj në një ajet tjetër Zoti i Lartmadhëruar thotë: "Ai veç ka pa prej argumenteve Tona të mëdha". Pra njëherë me ia tregu, ndërsa herën tjetër "veç i ka pa". Pra e para herë procesi i shikimit të direkt, herën tjetër procesi i shikimit indirekt.

Për këtë çështje Imami i nderuar thotë:

Kjo çështje e cila nevojitet shikimin e ndodhisë, po ashtu edhe vet shikuesin. Ne e dimë p.sh. ndodhinë kur Muhamedi a.s. ka zgjedh në mes të alkoolit dhe qumështit, pastaj ndodhinë e shpërblimit të muxhahidinëve, ndodhinë se si përfundojnë ata të cilët e hanë pasurinë e jetimit, ndodhinë e përfundimit të vepruesit me kamate. Pastaj çështjet tjera të cilat i ka pa: siç janë sëmundjet shoqërore, dhe dukurit negative të moralit në shoqëri. Për të gjitha këto çështje duhet diskutua veç e veç. Po ashtu e dimë se Muhamedi a.s. është bë Imam i pejgamberëve, duke mos harruar faktin se shumica e pejgamberëve me të cilët është taku Muhamedi a.s. kanë qenë pejgamber te Beni Israilët, pastaj çështje që Muhamedi a.s. disa herë ka shkuar te Musa a.s. pastaj prapë te Zoti i tij, përkundër asaj se hadithet janë të sakta, disa kanë thënë se nuk janë të sakta.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

Kur ia ka zbrit Zoti i Lartmadhëruar këtë ajet fisnik për ndodhitë e Israsë, ka qenë "për me të tregu" pra për me ia mundësua me pa, e çka do të thotë "me pa".

Shikim do të thotë: "me ia mundësua me pa". E kjo do të thotë: ose shndërrimin e shikuesit në ligjet e të shikuarit ose sendet e para me i shndërrua ne ligjin e shikuesit.

PSE POPULLI ANALFABET ËSHTË PËRGATIT PËR TA PRANUAR MISIONIN E ISLAMIT?

Kjo është një pyetje e cila i ka preokupuar shumë komentues, dhe shumica janë habitur, pse Umetin analfabet Zoti e ka parapa me pranua shpalljen e Allahut dhe planprogramin e tij, e pastaj me u shpërnda te të gjithë popujt e botës.?

Shejh Shaëraviju thotë:

Allahu e ka përgatitur gadishullin arabik për ta pranuar shpalljen, ky gadishull ka qenë analfabet, sepse Allahu nuk ka dashur që me fillua përhapja e fesë prej popullit të zhvilluar. Sepse do të thuhej pastaj se: Feja është përhapë për shkak të zhvillimit të atij populli se përndryshe nuk do të përhapej.

Allahu nuk ka dashur që Islami të përhapej ashtu sepse do të ishte thënë imponim me dhunë të vendeve të zhvilluara, por ka dashur që islami të burojë prej pejgamberit analfabet dhe umetit analfabet që me ditë të gjithë njerëzit, se për çdo gjë që është në mesin e tyre nuk është prej tyre por vetëm prej Allahut.

Për këtë arsye duhet ta dimë se ata të cilët kur flasin për analfabetizmin e Muhamedit a.s. thonë: Këtë fjalë duhet ta fshijmë dhe nuk duhet te thuhet: "Pejgamberi analfabet i popullit analfabet" , ndërsa ne u themi atyre: Keni mendjen dhe zgjohuni prej kllapisë se Allahu ka dashur me i tregu botës se Muhamedi a.s. dhe umeti i tij nuk kanë marrë asgjë nga civilizimi i kësaj bote, por i tërë planprogrami i tyre ka ardhur prej qielli, dhe askush nuk ka thënë asgjë prej vetes së tij, as Pejgamberi të cilit i ka ardhur shpallja, e as populli të cilëve u ka ardhur shpallja.

HURITË E XHENETIT

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe Ne i martuam ata me hyritë e Xhenetit”.

Pasi që kontaktimi seksual po ndodhë në xhenet, ndërsa ajeti tjetër:

“Dhe për ta ka bashkëshorte të pastra”.

Patjetër duhet të jetë e tërë mënyra e kontaktimit seksual ndryshe nga ai i kësaj bote, sikurse ajo e alkoolit në xhenet, hiqet cilësia e dehjes, të cilën cilësi e ka në këtë botë.

Çka mendon Shejh Shaëraviju në lidhje me këtë, pasi që disa thonë se ky proces dhe kjo dukuri është e neveritshme dhe e fëlliqur, e si të jetë në xhenet.

Imami përgjigjet:

Kjo është kënaqësia më e madhe e jetës prej kënaqësive shpirtërore. Mirëpo ti mos e shiko vetë procesin ose gjërat përgatitore të procesit, por shikoje përfundimin e procesit. Para se të kryhet procesi paraqitet gjëja më e lezetshme dhe kënaqësia më e madhe dhe mbetet kënaqësia dhe pas kësaj nëse ke fëlliqur diçka, pasi që veç je zbrazur, pra fëlliqësira bëhet në momentin e zbrazjes, atëherë gjërat para procesit të dashura në këtë nuk ka dyshim, vetë procesi i dashur. Por çka është ajo që e ka bërë të neveritshme dhe të fëlliqur? Është ajo çka vjen pas atij procesi. Kjo është në cilësinë e cila vjen pas kënaqësisë në këtë botë.

Pra nuk duhet shikuar dhe nuk duhet krahasuar çështje me realitetin (ngjarjen) e tyre në këtë botë.

Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Dhe vajza të reja të të njëjtës moshë”.

Mos thuaj ti se kjo çështje kaloi në seksualitet. Dhe është për t’u habitur pse të thuhet “kjo fjalë është e ndyrë, e si kjo të ndodhë në xhenet”, kur kjo është çështja e cila është prej më të parëve të njerëzimit, dhe çështja më e rëndësishmja në këtë botë, dhe çështja për të cilën më së shumti bëhet interesimi dhe angazhimi.

Pse po e njollosni?

Ajo është kënaqësi e vërtetë në fazën e parë të procesit, kënaqësi e vërtetë gjatë vetë procesit. Nëse diçka është fëlliqur është fëlliqur pas saj. Pse atëherë nuk po thua se Allahu do ta heqë cilësinë e fëlliqjes së saj, ashtu siç e

heq dehjen prej alkoolit.

“... prej të cilit (alkool) nuk do t’u dhemb koka dhe nuk do t’u humb mendja (nuk do të dehen)”.

Pra cilësia e dhembjes së kohës dhe e humbjes së mendjes dhe vetëdijes do të hiqet.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Vërtet për të devotshmit janë përgatitur vende kënaqësie, kopshte e vreshta, dhe vajza të reja të të njëjtës moshë”.

“Keab – vajzat e reja”, pra vajzat të cilat nuk e kanë humbur virgjërinë e tyre. “Etraba” pra të gjitha të një moshe, që të mos thuash kështu e ashtu, kjo apo ajo. Çështja është se të gjitha janë të njëjta.

SI DO TE VEPROJ ZOTI ME NEVE KUR TA SHOHIM ATË

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. si do të veproj Zoti ynë me neve kur do ta takojmë në ditën e kiametit?

Përgjigje: Ka thënë: ***Do të paraqitemi të gjithë para tij në një fushë ku secili nga ju do të jetë para Tij, atëherë Zoti yt (i Lartmadhëruar) do të merr ujë dhe do të hedhë para jush. Për Zotin tënd: fytyra e secilit prej juve patjetër do të nënshtrohet prezencës së tij. Sa i përket muslimanit fytyra e tij do të jetë e shndritur vezulluese dhe e bardhë, ndërsa pabesimtari do të jetë e kërrusur dhe e nxjerr zi sikur qymyri. (E ka regjistrua Ahmedi)***

HAXHI I FËMIJËS PËR PRINDIN E TIJ

Ebu Dherri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: Babi im është tepër i plakur dhe nuk mundet me udhëtua as për në Haxh as për në Umre. Muhamedi a.s. iu është përgjegj: Kryeje haxhin ose urren për babën tënd. (Darëkutniju thotë se të gjithë transmetuesit e hadithit janë të besueshëm)

Një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: Babi im ka vdekur dhe nuk e ka krye haxhin, a ta kryej haxhin për të?

Muhamedi a.s. i ka thënë:

"Çka mendon po të kishte pasur babi yt borxh dhe ti ia kryen, a nuk të pranohet kryerja e borxhit, pra krye haxhin për të."(E ka regjistrua Darëkutniju)

Vet mënyra e pyetjes dhe përgjegjës tregon për pranimin dhe vlefshmërinë e haxhit e jo për atë se është obligim (vaxhib). Allahu i Lartmadhëruar e di më së miri.

MES-HI I MESTEVE

Është pyet i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për Mes-hin mbi meste?

Është përgjigjur: ***Udhëtarit (mysafirit) i vlen Mes-hi mbi meste tri ditë ndërsa jo udhëtarit vendasit një ditë dhe një natë.***

Ebu Umare e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: ***O i Dërguari i Allahut a të jap mes-hi mbi meste?***

Iu është përgjigj: - Po.

- A vlen për një ditë?

- Po.

- A vlen për dy ditë?

- Po.

- A vlen për tri ditë?

- Po, vlen edhe për tri ditë, nëse ti dëshiron edhe më shumë . (E ka regjistrua Ebu Davudi)

Një pjesë e dijetarëve e kanë kuptua hadithin nga aspekti i jashtëm sa që e kanë lejuar mes-hin për kohë të pacaktuar.

Një pjesë tjetër e dijetarëve mendojnë se ky Hadith është i papërcaktuar (mutlak) dhe hadithet tjera e kanë përcaktuar (mukajid) ndërsa rregull është se veprohet me hadithin e përcaktuar (mukajid).

CILI ËSHTË NAMAZI MË I VLEFSHMI?

E kanë pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: Cili namaz është namazi më vlefshmi?

Është përgjigj:

Namazi ku e ka lutjen më të gjatë dhe më të thellë të Kunutit. (E ka regjistrua Ahmedi)

Po cili namaz i natës është më i vlefshmi ?

Është përgjigj: ***Namazi i mesit të natës edhe pse falet shkurt.***

Po ashtu është pyetur: Cila orë është ora më e afërta tek Allahu nga orët tjera?

Është përgjigj: ***Po, është ora e thellësisë së natës, a po mesnatës.(E ka regjistrua Nesaiju)***

CILI AJET I KUR'ANIT ËSHTË MË MADHËSHTORI?

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: Cili ajet i Kur'anit është më madhështori?

Është përgjigj: Ajetul Kursija.

Pra: Allahu La Ilahe Il-la Huvel Hajjul Kajjum.

ÇKA I LEJOHET BURRIT ME VEPRUA ME GRUAN E TIJ DERI SA AJO TË JETË NË FAZËN E MENSTRUACIONIT

Ka ardhur një njeri te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe i ka thënë: Çka më lejohet mua në gruan time deri sa ajo të jetë me menstruacion?

Iu është përgjigj: ***E vendos jetekun deri në pjesën e epërme e pastaj çka të duash vepro prej pjesës së mesme të trupit e më lartë.(E ka regjistrua Maliku)***

VEPRAT E MIRA TË PËRGJITHMONSHME

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për veprat e mira të përgjithmonshme. Është përgjigj: ***Tekbiri, Tehlili, Tesbihi, Tahmidi dhe Ve La Havle Ve La Kuvete Il-la Bil-lah.***

FETAVATË E SHAËRAVIJUT

PJESA E GJASHTË

VI

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

Kaçanik, 2015

HYRJE

Falënderimet i takojnë Allahut, Krijuesit të të gjithë botëve. Përshëndetjet dhe selamet qofshin mbi më të mirin e të gjithë pejgamberëve, vulës së të dërguarve, zotërisë sonë, të Dërguarit tonë, të dashurit tonë, ndërmjetësuesit për ne në ditën e Gjykimit dhe të tubimit - Muhamedit s.a.v.s dhe shokëve te tij në përgjithësi deri në ditën e Gjykimit.

Çdo falënderim dhe çdo përshëndetje shpirtërore për të nderuarin tonë, shejhun tonë, i cili na mahnit me fetva për te cilin nuk do t'i kisha mundur të bëj asnjë hap përpara sinqeritetit të tij dhe pastërtia e tij më ka mundësuar ta përjetoj këtë libër.

Me nijet të pastër dhe me sinqeritet bashkohen zemrat e besimtarëve dhe se idetë e tyre sjellin punë që shpiejnë me mirësi; të gjithë kanë nevojë për punë të mira dhe nuk ka çështje më madhështore se të zgjuarit e të përgjumurve me këshilla dhe udhëzime të mira.

Duke u nisur nga kjo pikë, nga shumë lexues na kanë arritur pyetje shumë të thjeshta, por ne shejhut tonë nuk ia kemi paraqitur, sepse pejgamberi ynë s.a.v.s. është përgjigjur qartë me hadithet e vërteta dhe të sigurta, të fuqishme dhe të cilat përgjigje kanë sjell dobi.

Nga kjo situatë, unë i kam hulumtuar dhe i kam përzgjedhur vetëm këto pyetje pas një analize te thellë. Prej Zotit kërkoj ndihme dhe mbështetje.

Sejid Xhemil, Rebiul evel, 1402, 13.01.1982, KAJRO

USHQIMI I KËSAJ BOTE DHE USHQIMI I XHENETIT

A është ushqimi i xhenetit i njëjtë me ushqimin e kësaj bote?

Imami i mirënjohur thotë:

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"E, përgëzoi ata që besuan dhe bënë vepra të mira, se ata do të jenë në xhenete, në të cilët rrjedhin lumenj. Sa herë që u jepet ndonjë ushqim nga frutat e tij, ata thonë: "Ky është ai me të cilin u ushqyem edhe më parë", ngase u sillet ushqim i ngjashëm (vetëm në formë, e jo edhe në shije). Aty do të kenë ata bashkëshorte të pastra dhe aty do të jenë përgjithmonë".(El-Bekare, 25)

Derisa njeriu nuk e di një çështje, nuk mund ta emërtojë, dhe përderisa nuk e emërton, në gjuhën tonë nuk mund të ketë ndonjë emër tjetër, i cili e tregon kuptimin faktik.

Mirëpo. Allahu dëshiron të na japë pasqyrë reale, gjendje faktike. Për këtë arsye ka sjellë shembull, por, edhe përkundër kësaj, ne prapë themi: Ky është vetëm një pasqyrim, e asgjë reale, absolute. Na tregon çështjet, të cilat i dëshiron, dhe i kundërshton çështjet tjera. P.sh. Kur na tregon për pirjen e alkoolit në botën tjetër, thotë: "Nuk ka në të dehje", pra e heq prej alkoolit pjesën e dëmshme, e ajo është se alkoolit të kësaj bote, që turbullon dhe e deh mendjen, i jepet pjesë tjetër, pra kur thotë Zoti i Lartmadhëruar: "Alkool të ëmbël dhe të shijshëm, për ata që e pinë".

Zoti i Lartmadhëruar, kur t'i tregojë llojet e pemëve në xhenet, thotë: "... rrush, shegë dhe hurme ...", pra prej llojeve të cilat gjenden tek ne në këtë botë. Pse? Sepse, nëse na tregon gjëra, të cilat nuk gjenden tek ne, vështirë se do t'i pranonte mendja, sepse ato janë gjëra, të cilat njeriu nuk i ka njohur më parë. Mirëpo, kur ta paraqetë ty mollën e madhe, formën e bukur, shijen e mrekullueshme, ti veç e ke të njohur mollën dhe erën e saj në këtë botë. Pra, a e pranon apo jo? Për këtë arsye t'i bjerë shembujt dhe llojet e ushqimeve që ti veç i ke shijuar, i ke përjetuar në këtë botë. Për këtë arsye Kur'ani thotë:

"Çdo herë kur në të furnizohen me ndonjë pemë, perim, lloj ushqimi e furnizimi, thonë: Kjo është ajo me çka kemi qenë të furnizuar më parë (në dunja) dhe furnizohen edhe me gjëra të ngjashme".

Pse të ngjashme? Sepse është më e kapshme, më e lehtë për ta kuptuar, sepse çdo gjë të panjohur e merr, ndoshta, me frikë, me rezervë dhe brengë.

KU ËSHTË DALLIMI NË MES TË "VE MA EDRAKE" DHE "VE MA JUDRIKE"?

Cili është dallimi në mes të "ve ma edrake" dhe "ve ma judrike"?

"Ve ma judrike" është mosnjohje për të kaluarën dhe nuk mund të mësosh dhe ta dish as sot, as në të ardhmen. Për këtë arsye kanë thënë: Për çdo gjë çka vjen në Kur'an "Ve ma judrike" nuk mund të dihet, ndërsa për çdo gjë çka vjen në Kur'an "... ve ma edrake" mësohet dhe dihet.

Nëse në Kur'an shohim "Ma edrake" do të thotë se nuk e ke ditur në të kaluarën, por nuk ka pengesë për ta ditur sot, ndërsa kur shohim "Ve ma judrike", atëherë nuk e di as sot, as në të ardhmen, ashtu siç nuk e ke ditur në të kaluarën, pa marrë parasysh se a është hija e errët shumë, apo jo e errët.

Për këtë arsye kjo mënyrë nuk ka ardhur për asnjë ndodhi tjetër, por vetëm për çastin e Ditës së Kiametit dhe për Tezkijen e çështjeve të fshehta. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"Ve ma judrike (as sot dhe asnjëherë nuk do ta dish) ndoshta dita e Kiametit është afër", natyrisht nuk ka thënë për ngjarjen, sepse ngjarja dihet me siguri se do të ndodhë, por ka thënë për çastin e asaj ngjarjeje: **"Ve ma judrike (dhe ti as sot dhe as në të ardhmen) nuk do ta dish se ndoshta Kiameti është afër".**

Për të dy rastet është çështja e Kiametit se nuk e di dhe nuk do ta dijë, sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: "Ve ma judrike" dhe nuk ka thënë "Ve ma judrake", sepse mënyra "Ve ma edrake" është për kohën e kaluar dhe nuk ka pengesë për ta mësuar dhe për ta ditur sot, ose në të ardhmen.

Ajeti tjetër "Ve ma judrike" ndoshta pastron. Pastrimi (falja) është vetëm i Allahut dhe askush tjetër nuk mund ta posedojë këtë të drejtë, këtë cilësi. Për këtë arsye i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: ***"Unë nuk e pastroj (fali) askënd për te Allahu"***.

Pra, këto tri raste janë përmendur në Kur'an.

Pra, tri herë është përmendur "Ve ma judrike".

Ndërsa 13 herë në Kur'an është përdorur "Ve ma edrake".

Suretul Haka.

Suretul Murselat.

Suretul Infitar.

Kështu mënyra "Ve ma edrake" dhe "Ve ma judrike" vazhdon të

përdoret në suret në vijim. Pra, në suretul Mutaffifinë është përdorur "Ve ma edrake – (çka është sixhini)", po ashtu në këtë sure "Ve ma edrake – (çka është Ilijjun)". Në suretul-Beled është përdorur "Ve ma edrake mel akabe"; Suretut-Tarik: "Ve ma edrake met-Tarik"; në suretul-Kadr "Ve ma edrake ma lejletul kadër"; në suretul-Kariatu: "Ve ma edrake mel Kariatu".'

SHËRIMI (NDËRMJETËSIMI) ME KUR'AN

Shumica e të rinjve pyesin për ndërmjetësimin me Kur'an për qëllime të dunjasë.

Shejh Shaëraviju përgjigjet: Ndërmjetësimi me të gjitha format është i ndaluar, sepse fjala "Tesevul – ndërmjetësim" është shprehje-krijim prej kërkesës. E, kërkesa nuk mund të jetë realizim i qëllimit, por nevojë e paraqitur, pra, kur në moment kërkohet, meriton të ndihmohet; mirëpo, merita e ndihmesës vërehet nga pamja e jashtme dhe nuk është në rregull të hulumtohet pastaj se a është ajo kërkesë (lypje) vetëm profesion i lypësit, por ndihmohet automatikisht.

Për këtë është rregulla e "rezervës". Ndihma (dhënia e lëmoshës) është më e vlefshme se sa mosdhënia e ndihmës: se ndoshta me të vërtetë e ka merituar, e ti nuk e di se e ka merituar, dhe e ke penguar. Sa i përket ndërmjetësimit (Tesevul) me Kur'an, kjo është dukuri prej të cilës duhet larguar dhe në të njëjtën kohë duhet këshilluar njerëzit, të cilët veprojnë një gjë të tillë, që të largohen dhe kështu mos të lejojmë që fjala e Allahut të nënçmohet dhe të nënvlerësohet duke marrë vetëm si mjet kërkese e lutjeje.

Mendoj se dukuria e ndërmjetësimit me Kur'an (Tesevul) është si pasojë e zbutjes së zemrave të atyre, të cilët kanë qenë të larguar nga libri i Allahut, me qëllim që t'i afrohen librit të Allahut, e të cilët nuk kanë pasur mundësi apo mënyrë tjetër që atyre t'u zbuten zemrat. Ndërsa, praktika islame na obligon që mënyra e shërimit të kësaj çështjeje (zbutjen e zemrave) të jetë në atë mënyrë, duke u krijuar atyre ngrohtësi për t'i tejkaluar problemet e tyre dhe për t'i zgjidhë çështjet e tyre, e jo për t'ua dhënë atyre librin e Allahut, që ata ta keqpërdorin dhe ta ultësojnë.

DALLIMI I DISA SUREVE DHE I AJETEVE PREJ DISA SUREVE DHE AJETEVE TË TJERA NË KUR'AN

Pyetje: A ka në Kur'an ajet, i cili është më i vlefshëm se ajetet tjera, dhe sure, e cila është më e vlefshme se suret tjera?

Përgjigjja: Nuk thuhet ajete më të vlefshme se ajetet tjera, sepse çdo ajet është fjalë e Zotit, mirëpo secili ajet në vendin e vet është dobi. P.sh. nuk thuhet për barin (ilaçin) e përbërë prej bimëve të shumënumërta dhe elementeve të ndryshme kimike të shumta, se ky element është më i mirë se ai element, sepse secili element në vetvete kryen detyrën e tij, që është i dobishëm dhe që i ndihmon shërimit e shëndetit.

Mirëpo, ajetet e Kur'anit në raste të veçanta kryejnë detyra të veçanta në Kur'anin, i cili përbëhet prej ajeteve. Secili ajet e ka vlerën e vet, sepse ai aty shëron plagën. Pra, ai ajet me fashën (lidhjen e tij) është dobi dhe ne nuk themi se ky ajet është më i mirë se ajeti tjetër, për arsye se ajeti tjetër ka hapësirë tjetër ku sjell dobi.

A I FSHIN PENDIMI MËKATET?

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"Allahu nuk i dënon ata derisa ti je në mesin e tyre, Allahu nuk i dënon derisa ata kërkojnë falje".

A do të thotë kjo se Istigfari i fshin gabimet?

Përgjigjja: Shjejh Shaëraviju përgjigjet: Ky ajet fisnik na sqaron kuptimin e Istigfarit. Po si të mos ndodhë kjo, kur në zemrën e njeriut ka besim? Kuptimi i ajetit është se Allahu nuk i dënon ata derisa të jesh në mesin e tyre, sepse Unë ty të kam dërguar mëshirë për botët dhe mëshira Ime i paraprin dënimit. Për këtë arsye Unë nuk i dënoj ata duke qenë ti në mesin e tyre i mëshirshëm dhe udhëzues. Pastaj, ajeti fisnik vazhdon të sqarojë se çka do të ndodhë pasi që i

Dërguari të kalojë në botën tjetër dhe këtu përfundon teksti: "Allahu nuk i dënon ata derisa ata pendohen". Pra, kur ti, o Muhamed, kalon në praninë Time, atëherë Unë nuk do t'i përfshij me dënim pendimtarët. Pse?

Sepse pendimi është nënshtrim ndaj Allahut dhe nuk ka nënshtrim vetëm se në zemrën e besimtarit; dhe derisa Imani zë vend në zemrën e besimtarit, atëherë mëshira e Allahut është mbi të.

Kështu, Zoti i Lartmadhëruar na tregon vlerën e pendimit tek Ai, se si nuk ndëshkon dhe i fshin gabimet dhe se çfarë vlere ka pendimi te Ai. Allahu thotë:

"Dhe nëse ata i bëjnë padrejtësi vetes së tyre, e vijnë te ti, pendohen te Allahu dhe kërkojnë falje, e nëse ata i fal i dërguari, do të shohin se me të vërtetë Allahu është Pendimpranues dhe i Mëshirshëm".

Pra, faza e parë e faljes së mëkatit dhe më e rëndësishmja është pendimi. Nënshtrimi ndaj Allahut dhe përkushtimi ndaj Tij janë prej shenjave më të fuqishme të pranimit të pendimit. Zemra e jobesimtarit nuk ka mëshirë, nuk ka falje. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. vazhdimisht e ftonte umetin e tij për të kërkuar falje. Në një rast ka thënë:

"Pendohuni te Allahu se, vërtet, unë kërkoj falje prej Tij njëqind herë në ditë".

Përderisa të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. i janë falur gabimet e mëhershme, ato të mëvonshmet dhe ai është penduar njëqind herë në ditë, po atëherë si është puna me ne?!

Pra, pendimi është shkallë prej shkallëve të Imanit e të nënshtrimit ndaj Allahut të Lartmadhëruar dhe nuk hyn pos në zemrën e besimtarit, nuk flet sinqerisht pos njeriu, i cili i frikësohet vetëm Allahut, nuk nxiton në pendim, pos ai i cili i frikësohet Zotit të Tij dhe Ditës së Gjykimit. E, ndoshta Allahut pranon lutjen, fal gabimin dhe zbret mëshirën e Tij.

Përderisa Allahu i Lartmadhëruar urdhëron të Dërguarin e Tij fisnik për kërkimfalje, nëpërmjet tij, Ai na ka urdhëruar të gjithë neve, dhe përderisa Allahu i Lartmadhëruar ka urdhëruar të Dërguarin për Istigfar, të cilit ia ka falur gabimet e mëhershme dhe të mëvonshmet. Kjo është një çështje, e cila kërkon nga ne të kërkojmë falje vazhdimisht.

Pendimi dhe falja e gabimeve prej Allahut, i fshin gabimet tona. E, kush mund t'i falë gabimet pos Allahut? Të gjithë, së bashku, duhet të kërkojmë falje dhe vazhdimisht, të hiqet e padrejta, të pendohemi tek Allahu dhe të zbuten zemrat tona. Pra, Istigfari gjithmonë na përkujton fuqinë e Allahut dhe mundësinë e Tij, ndërsa dobësinë e robit dhe paaftësinë e Tij. Dhe gjithmonë kur të harrojmë, kjo na bën që ta kujtojmë Allahun. Gjithmonë kur kjo botë na tërheq në vete dhe na largon prej urdhrave të Allahu, llogarisë

para Tij, na bën që t'i nënshtrohemi fuqisë së tij të madhe dhe mundësisë së Tij të pakufishme, të Cilin e adhurojmë, e Ai është Allahu i Lartmadhëruar.

Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë të Dërguarit të Tij: **"Dhe kërko falje për gabimin tënd."**

Pyetje: Cilin gabim e ka bërë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për të cilin ka qenë dashur të kërkoj falje?

Përgjigjja: Duhet t'i kemi parasysh dy çështje:

E para: I Dërguari i Allahut s.a.v.s. është dërguar mëshirë për të gjithë botët, e nga këtu manifestohet mëshira dhe se Allahu i Lartmadhëruar është i fuqishëm, i cili jep rast, ndërsa ju t'i jepni rast atij. Nëse Ai dënon, Ai dënon se është i fuqishëm dhe ka mundësi ta bëjë këtë.

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ngarkonte veten me jobesimtarët dhe hipokritët më shumë se sa kishte mundësi; e rëndonte dhe e mundonte veten e tij për ta, për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an i thotë:

"Ne nuk ta kemi zbritur Kur'anin për të të rënduar".

E Muhamedi a.s. ka pranuar arsyetimin e munafikëve, pse janë zmbrapsur nga fronti, e Zoti i Lartmadhëruar i thotë:

"Zoti ta fali ty pse u ke dhënë leje (që të mos shkojnë në front)".

Këtu Zoti i Lartmadhëruar e kritikon të Dërguarin e Tij, sepse i ka tejkaluar normat e mëshirës, sepse ato janë jobesimtarët, të cilët e kanë maltretuar të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe e kanë luftuar fenë e Allahut. E, kur kanë vdekur, Muhamedi s.a.v.s. ua fal atyre dhe lutet për mëshirë për ta.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Dhe mos e fal asnjëherë namazin e ndonjërit prej tyre".

Pyetje: Po namazi i të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. është mëkat?

Përgjigjja: Është tejkalim i normave të mëshirës dhe angazhimi i të Dërguarit të Allahut, duke kërkuar mëshirë për ta, e Zoti i Lartmadhëruar i drejtohet atij:

"Nëse kërkon falje për ta edhe shtatëdhjetë herë, Allahu kurrë nuk ua fal atyre".

SËMUNDJET E ZEMRËS DHE SHËRIMI I TYRE

Kur'ani fisnik në shumë vende tregon për sëmundjet e zemrës, si p.sh. ajeti:

"Në zemrat e tyre ka sëmundje dhe për këtë Allahu ua shton edhe më shumë sëmundjen".

Çka ka për qëllim ajeti: "sëmundjet e zemrës" dhe a janë sëmundje konkrete (fizike) apo sëmundje psiqike e shpirtërore (kuptimore)?

Shejh Shaëraviju përgjigjet:

Sëmundja është kalimi i trupit prej baraspeshës, prej binarëve. Ti nuk mund ta ndiesh dhembjen në sy kur të lëndohet syri, derisa nuk kalon prej kufirit të baraspeshës. Nuk mund ta ndiesh sëmundjen e barkut, derisa ai të dhemb, e nuk mund ta ndiesh sëmundjen e veshkës derisa të dhemb. Nuk të dhemb asnjë pjesë e trupit, përderisa nuk del prej vendit të tij.

Kalimi i trupit prej vendit normal të tij tregon sëmundjen, e shenja e kalimit të trupit prej vendit normal të tij është dhembja. Kjo dhembje është tregues i lëkundjes së shëndetit, sepse është tregues i sëmundjes, sëmundjet të cilat vijnë dhe gjenden në trup; sëmundjet pa dhimbje janë më të vështira për shërim dhe më të rrezikshme.

Pastaj, vazhdon Imami i mirënjohur:

Sa i përket zemrës ajo është pjesë fizike (konkrete) e stërmbushur me gjak, ajo jep lëvizje dhe jetë. Kjo është ana materiale, ndërsa në çështjet abstrakte, çështjet logjike përqendrohen dhe depërtojnë në zemër dhe e komplikojnë, e shtrëngojnë dhe nuk mund të lirohet më nga ato shtrëngime. Lëvizja e trupit, pra e jetës bëhet nëpërmjet këtyre çështjeve. Hapësirën të cilën e përfshin zemra, quhet mendje (zemër + mendje). Zemra dhe mendja.

Pra, zemra (kalb) dhe mendja (fund) janë në kraharor, gjoks. Allahu, kur tregon për zemrën tregon me metodologji dhe forma të ndryshme, dhe thotë:

"Dhe zemra (Fuad-gjoksi, kraharori) i nënës së Musait u bë e zbrazët".

Pra, nuk e ka përdorur fjalën "kalb-zemër", por e ka përdorur fjalën "Fuad – gjoks, mendje". Sepse Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Dhe sikur mos ta kishim ndërlidhur dhe përforcuar zemrën e saj (kalbeha)".

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“A nuk ta kemi zgjeruar ty kraharorin tënd”.** Pra, zgjerimi i zemrës në tërësi, e jo vetëm zgjerimi i mendjes, ose vetëm zgjerimi i zemrës.

Pra, ajeti fisnik, i cili përmend sëmundjen e zemrës, ka për qëllim sëmundjen kuptimore-abstrakte, e kjo do të thotë të kaluarit jashtë normales.

Cili është kufiri normal hapësinor i zemrës? Kufiri i normales është që të jetë në atë masë, pra besimi i cili të afrohet të jetë i përmbushur, në njërën anë, dhe, në anën tjetër, të gjitha çështjet tjera, pra balancimi dhe ekuilibrimi në mes tyre, e pastaj cila prej dy çështjeve të qetëson, e vendos në zemër.

Nëse njëra çështje të mbetet në zemër, e diskutohet çështja tjetër, kjo nuk është drejtësi e pranimit të ofertës, ose kjo mund të quhet anim i shërimit të zemrës. Por, balancim i plotë është të dalët e të dy çështjeve nga zemra jote, pastaj t’i analizosh, e më në fund cila të jetë më prioritare, ta vendosësh në zemër. Ky është balancimi dhe ekuilibrimi më i drejtë dhe më i saktë, sepse Allahu asnjë njeri nuk e ka bërë me dy zemra në gjoksin e tij, që me dy zemra t’i analizojë dy çështje, por t’i analizojë vetëm me një zemër, në një hapësirë. Ndërkaq, në një hapësirë nuk mund të vendosen asnjëherë dy hapësira të ndryshme.

Nëse ti e ke një çështje në zemër, e pastaj ti e analizon çështjen tjetër, tjetra asnjëherë nuk hyn në zemër.

Imami na sjell një shembull:

Shiko në gjërat e kapshme, shiko në gotën e zbrazët, e pastaj mbushe me ujë. Do të shohësh se uji nuk mund të depërtojë pa e larguar ajrin nga ajo gotë. Pra, ajri del duke u mbushur gota me ujë. Nëse ti këtë e vendos në zemrën tënde, duke e analizuar çështjen, ti je larguar nga natyrshmëria. Nëse ti e largon nga zemra natyrshmërinë, atëherë sëmundja jote vetëm sa vjen e shtohet.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Në zemra të tyre ka sëmundje, e ua shtoi sëmundjen atyre Allahu edhe më shumë”.

CILIN LLOJ TË XHINËVE MUND TA NËNSHTROJË NJERIU?

Ne e dimë se xhinët janë shumë llojesh, një lloj janë të mirë, e tjetri lloj janë pabesimtarë të këqij, të cilët shkaktojnë dëme. Pra, cilin lloj të xhinëve mund ta nënshtrojë njeriu: llojin e të mirëve apo llojin e të këqijve?

Imami i nderuar përgjigjet: Xhinët, të cilët mund t'i nënshtrojë njeriu mund të jenë dy llojesh: lloji i xhinëve të mirë dhe lloji i xhinëve të këqij. Xhini i mirë është sikurse njeriu i mirë, askush nuk mund ta nënshtrojë, me fjalë të tjera, nuk i nënshtrohet askujt. Atëherë nënshtrohet lloji i xhinëve të këqij dhe kjo vetëm çka sjell vështirësi me xhinët e tij.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Dhe me vërtet kanë qenë burra prej njerëzve, të cilët harronin mbrojtje dhe mbështetje prej xhinëve, e për këtë arsye ne u shtuam atyre edhe më shumë vuajtje(Rebeka)".

U shtuam vuajtje (rebeka) pra ua kanë shtuar vuajtjet, vështirësitë dhe problemet, sepse ata janë treguar mendjemëdhenj, kryelartë dhe kanë kundërshtuar të veprojnë me drejtësi, pra me ligjin e njeriut.

Iu thotë atyre: Neve na është dhënë ligji, i cili është më i mirë se i yti.

Në këtë rast nuk thuhet: veprat shpërblehen sipas qëllimit, sepse qëllimi yt dëshiron të realizohet tek njeriu me ligjin, i cili nuk është ligj i njeriut.

Imami i mirënjohur e sqaron një çështje shumë të rëndësishme, kur thotë:

Çdo gjë çka shohim prej dukurive të çuditshme (fantazma), prej veprimeve të shpirtrave të këqij, të gjitha ato dukuri, veprime, fshehtësi mundet që njeriu të nënshtrojë tjetrin dhe të veprojë atë çka njeriu tjetër nuk mund të veprojë, por edhe xhini i rëndomtë (i mirë) nuk mund ta bëjë atë veprim.

Pyetje: Por, a mundet që njeriu të nënshtrojë shpirtra të këqij, të cilët mund t'i shpejtojnë diçka njeriut në jetë, t'i vonojnë ose të mos i ndodhë.

Përgjigje: Jo, kurrsesi. Për shkak se ata, të cilët merren me këso veprimtari, pra që të gjithë, janë të goditur me shumë gjëra dhe janë të lodhur me shumë gjëra. Pra, aty ka krijesa të fshehta nga shikimi ynë, kanë ligje të

tjera dhe e vërteta është se xhinin e kategorisë më të vogël mund ta nënshtrojë xhini i kategorisë më të madhe.

DITËT E ALLAHUT

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **Në ditën kur gjatësia e asaj dite është njëmijë vjet, të viteve të cilat i llogaritni dhe i numëroni ju.**

A është dita e llogarisë së Allahut sikurse e ditës tek njerëzit. Pra, dita te njerëzit është 24 orë, ndërsa tek Allahu a është e njëjta llogari apo jo?

Po ashtu, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

Ai i cili ka krijuar qiejt dhe tokën për 6 ditë, pastaj ka përfshirë dhe ka nënshtruar arshin. Cila është gjatësia e këtyre 6 ditëve në llogarinë e krijesave dhe llogarinë e Krijuesit të Lartmadhëruar.

Imami i mirënjohur thotë:

Ka dallim në mes të kësaj kur them se unë e kam prodhuar këtë pako për 6 orë dhe në mes të asaj se ti ke ardhur me elementet e qumështit, thartirës dhe i ke vendosur; për një çast vetëm ke thënë bëhu dhe ajo bëhet. Pra, nuk na ka krijuar për nëntë muaj, por na ka krijuar me fjalën “bëhu" dhe është bërë. Dhe, sikurse Allahu ka thënë: E ka krijuar për gjashtë ditë, nuk ka të bëjë me gjashtë ditë. Koha është në tërësi pjesë e ndodhisë dhe se kuptimi të jetë kohë e ndodhisë, është se çdo pjesë e ndodhisë përputhet me pjesën e kohës. Kjo është receta. Mirëpo, Allahu punon pa recepturë. Allahu e punon me “bëhu”, mbase elementet e qiellit apo të tokës; Allahu është ai i cili ka vendosur fshehtësitë, të cilat reflektohen atëherë kur Ai dëshiron, e pastaj e lë të reflektohen. Zoti i Lartmadhëruar thotë: Çdo ditë, brenda 12 orëve. Tjetrën ditë? Ai është aktiv gjithmonë, pra, në çdo çast. Për këtë arsye kur i kanë pyetur dijetarët: Ai (Allahu) për çdo ditë është në aktivitet? Çfarë aktiviteti kryen Zoti ynë, pasi që është e vërtetë se ngjyra e lapsave është terur? Çdo gjë ka marrë fund. Janë përgjigjur: Çështjet të cilat janë krijuar e që vendosen në aksion. Ka dallim të madh në mes të krijimit dhe fillimit të sendit të krijuar. Fillimi i sendit është krijimi i atij sendi, ndërsa fillimi i sendit të krijuar është paraqitja e atij sendi në skenë. Pasi astronomia është zhvilluar deri në atë shkallë, ne e kemi kuptuar Gjithësinë, sistemin diellor, e kemi kuptuar

sistemin diellor dhe sistemet tjera afër tij, etj. E kemi kuptuar se fjala ditë nënkupton çdo çast. Pastaj parashtrohet pyetja: Pse? Sepse, nëse në bazë të definimit tuaj ditë quhet hapësira kohore prej lindjes së diellit e deri në perëndimin e tij, dielli gjithmonë, në çdo çast lind e perëndon. Kjo do të thotë se "kur thotë për çdo çast": Për çdo ditë është në aktivitet. Ka për qëllim çdo çast. Kuptohet se në çdo çast është në aktivitet. Pse? Sepse nëse supozojmë se kjo ditë fillon në orën pesë të mëngjesit deri në orën pesë të mbrëmjes, në orën pesë e një minutë fillon dita tjetër dhe përfundon në pesë e një minutë. Po ashtu, edhe minutat i kanë pjesët përbërëse, sekondat e kështu me radhë. Pra fjala ditë është në çdo çast. Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: Në çdo ditë (çast) është në aktivitet, kjo do të thotë se ai vazhdimisht e pandërprerë është në aktivitet, kur përmendet Ezani, Allahu, dhe sekondat e jetës nuk përfundojnë. Çdo fjalë që dëgjohet, nuk përfundon, dhe çdo kryerje e adhurimit nuk përfundon. Kur Muedhini (thirrësi për namaz) thotë: "Allahu Ekber" për namazin e sabahut, në vendin tjetër është Muedhini tjetër, i cili thotë "Allahu Ekber", ndërsa tjertri "Eshhedu en la ilahe illallah"; e Muedhini tjetër thotë: "Eshhedu ene Muhamedun Resulullah". Pra, fjala e ezanit dhe e ibadetit janë të ndërlidhura gjithmonë dhe nuk përfundojnë. Allahu vazhdimisht thirret me "Allahu Ekber, Allahu Ekber". Në çdo çast prej çasteve të ditës, në çdo çast prej çasteve të natës dhe në çdo ibadet prej ibadeteve, i bëhet lutje Allahut. Përderisa këtu falet sabahu, në një vend tjetër falet dreka, në një tjetër ikindija, diku tjetër falet akshami e në një vend tjetër jacia. Nga kjo edhe mund të komentohet thënia kurioze e atyre, të cilët thonë: Oj kohë, dhe në ty janë të gjitha kohët. Pra, thënia e Zotit të Lartmadhëruar: "Sundimtarit të ditës së gjykimit". A nuk është ai sundimtar, udhëheqës i çdo çështje, po ashtu edhe i ditës së gjykimit? Mirëpo, pasi që për sundimtarin dhe për sundimin ka çështje të cilat manifestohen në gjithësi, e kjo do të thotë se: Kur ne shohim një personalitet, e quajmë sundimtar, ndërsa kur shohim tjetrin, e quajmë sundimtar simbolikisht, pra, pasi që çështjet janë të dukshme dhe të padukshme. Disa njerëz janë sundimtarë në aspekt formal (jo real), ndërsa në botën tjetër nuk do të jetë as sundimtar formal, por që të gjitha çështjet në tërësi do të jenë të Allahut. Kjo është arsyeja pse te njeriu paraqiten shkaqet; pra këtu jetojmë me shkaqet e Allahut. Këtu fjala "dita e kiametit" (dinë-kijamet) ka kuptim të shumëfishtë. Këto kuptime, kur i kanë sqaruar dijetarët, i kanë sqaruar kështu: Dinë-ka kuptim shpërblimin. Shpërblimin për çka? Për nënshtrim. Nënshtrim për çka? Ndaj urdhrit të

Allahut. Çka është ajo që tregon nënshtrim ndaj urdhrit të Allahut? Planprogrami dhe sheriati.

Pra, shpërblimin për nënshtrim; nënshtrimin në çka, nënshtrim ndaj planprogramit të Allahut. Pra, këtu i kemi tri elemente: shpërblimin, nënshtrimin dhe planprogramin.

Pyetja: Pse ka thënë: Sundimtar i ditës së shpërblimit, e nuk ka thënë "i ditës së kiametit"?

Përgjigje: Sepse dita e kiametit është skenë prej skenave të ditës së kiametit. Kiamet, pra, do të thotë se do të ngriten njerëzit nga varret e tyre. Mirëpo, përderisa ka tubim llogaridhënie, kalim në urë të siratit dhe shpërblim, ndërsa shpërblimi është akti i fundit, e ka treguar aktin e fundit, sepse parashtrohet pyetja: Pse ringjallemi? Ringjallemi që të shpërblehemi, pra shpërblim është finalizimi. Ai i cili thotë: Dita e shpërblimit apo dita e shpagimit, ai ka për qëllim ditën e kiametit, sepse shpërblim është finalizimi i adhurimit në përgjithësi. Varësisht prej asaj si ka qenë adhurimi ynë, ashtu do të jetë edhe shpërblimi ynë. Për këtë arsye shohim se Kur'ani kur e shtjellon këtë çështje thotë: "Dhe ai i cili shpreson në takimin me Zotin e tij, le të punojë punë të mira dhe adhurimit të Zotit të tij mos t'ia shoqërojë askënd tjetër".

Për këtë arsye kur ta paraqesim para njerëzve fjalën fe, kemi për qëllim paraqitjen e sheriatit. Themi: ndjenjë, pasion dhe vërtetësi. Pse feja ndikon në personalitet? Kjo do të thotë: nëse ti ke një shumë të pasurisë dhe sheh se ndonjë njeri ka nevojë, menjëherë ndikon në qenien tënde dhe të mundon. E vërteta është se ti e dëshiron fitimin. Por, kush e kupton dhe kush e di ç'është fitimi? Këtë e kuptojnë vetëm njerëzit që kanë pasione. Pra, Ai i cili dëshiron takimin me Zotin e tij, le të veprojë punë të mira dhe mos t'i bëjë idhujtari në adhurimin e tij askujt tjetër pos Tij.

E adhuron vetëm Atë, e falënderon vetëm Atë. Pra, falënderimi vetëm për Zotin e gjithë botëve, falënderimi vetëm për të Gjithëmëshirshmin, falënderimi vetëm për sunduesin e ditës së gjykimit.

PO TË MOS KISHIM PËRFORCUAR TY

Kanë diskutuar shumë prej analistëve për madhështinë ndaj Muhamedit a.s., kur ata e kanë lexuar ajetin kur'anor: **"Po të mos kishim përforcuar Ne ty"**.

Ata thanë se kjo është nënçmim për të Dërguarin prej Zotit të Lartmadhëruar, sepse sipas tyre ka anuar në krahun e pabesimtarëve, e për këtë arsye ka zbritur ky ajet. Çka mendon Shejh Shaëraviju në lidhje me këtë?

Imami i nderuar mendon se:

Çështja se i Dërguari i Allahut s.a.v.s ka anuar në krahun e pabesimtarëve dhe se ajeti "Po të mos kishim forcuar ty" është nënçmim për të Dërguarin, lirisht mund të themi se: I Dërguari i Allahut s.a.v.s nuk ka anuar asnjëherë në krah të pabesimtarëve, sepse nuk kishte filluar zbritja e ajetit "po mos?", sepse Allahu i Lartmadhëruar nuk ka lejuar që të ndodhë një gjë e tillë. Pastaj, Zoti i Lartmadhëruar na tregon se *po në atë mos duhet ose bëhet* afrimin tek Allahu dhe zbulimin e ajeteve, shenjave dhe argumenteve prej tij nga robërit e tij; nëse robërit mohojnë pas kësaj, atëherë dënimi i tyre do të jetë i dyfishtë, në krahasim me njerëzit tjerë, apo siç i ka thënë Allahu Isa a.s. për Havarijunët: **"Dhe kush mohon prej jush pas kësaj, atëherë unë do ta dënoj me dënim të madh, e që me aso dënimi nuk do ta dënoj askënd prej botëve".**

TEORIA E DARVINIT DHE SHAËRAVIJUT

Si është çështja e teorisë së Darvinit dhe e shkencëtarëve të tjerë, të cilët e kanë pranuar një teori të tillë një kohë dhe a është e vërtetë shkencore apo vetëm teori?

Imami i mirënjohur Shaëraviju përgjigjet: Ajo është vetëm teori, mirëpo, ata të cilët nuk kanë kuptuar, e kanë marrë si të vërtetë shkencore, e nga këtu ka buruar gabimi.

Ata, të parët, të cilët e kanë pasuar Darvinin për të parën herë, ata e kanë demantuar herën e dytë. Atëherë pse e lodhim veten tonë në këtë çështje, aq sa nuk duhet për t'u lodhur. Ne atë çka e ka thënë Darvini e vendosim në

një dorë dhe atë çka ka thënë Allahu në dorën tjetër!?

Mjafton vetëm ky krahasim për të qenë të humbur. Po atij, i cili është sprovuar më këtë teori mund t'i përgjigjemi thjeshtë: Cilët faktorë kanë qenë që majmuni i parë të shndërrohet në

njeri? Pse majmunët tjerë nuk janë shndërruar në njeri, por kanë mbetur majmunë? Pse nuk kemi vërejtur *apo* nuk kemi parë se majmunët e tjerë nuk iu kanë nënshtruar këtij procesi, që të zhvillohen e të bëhen njerëz. Nëse ne e kemi prejardhjen prej majmunit, atëherë majmuni nga çka e ka? E ai çka prej çka-hit.

Pra, patjetër duhet të jetë diçka prej diçkaje dhe do të arrijmë te çështja e parë, prapë prej çka-hit. Llojet tjera të gjallesave, a kanë edhe ato prejardhje, që të kenë një origjinë. Bimët, që gjithashtu kanë shenja të zhvillimit më të ulët, a kanë edhe ato prejardhje, ashtu që duke shkuar nëpërmjet prejardhjes zinxhirore të tyre të arrijmë në një origjinë, e cila është zhvilluar. Nëse puna është kështu, atëherë pse nuk po shohim ndonjë zinxhir prej zinxhirëve të kafshëve ose zixhir prej zinxhirëve të bimëve duke u zhvilluar, para syve tanë, në diçka tjetër.

Në të kaluarën është thënë, e kjo pa u kuptuar, se bima e fundit është kafsha e parë. Kjo është vetëm ndjenjë dhe paramendim se bima mbetet bimë, siç ka mbetur dhe kafsha- kafshë.

Kështu edhe kafshët ndoshta mund të zhvillohen në një organ apo disa organe dhe të marrin ndonjë veçori të njeriut; por kjo është aftësia e të imituarit dhe ajo prapëseprapë mbetet kafshë, e nuk mund të zhvillohet në njeri.

Për këtë kemi një shembull: Nëse i mësojmë majmunit çfarëdo veprimi, ai mund ta bëjë një gjë të tillë, mirëpo atë veprim ai nuk mund t'ia mësojë llojit të tij; pra mbetet prapëseprapë majmun, ashtu siç është.

Të mbeturit e krijesave në formën e tyre, siç janë të krijuar, është argument se ato nuk evoluohen, por janë të paevoluara.

DOMOSDOSHMËRIA E BARAZISË NË MES FËMIJËVE

Prindi i tri vajzave nuk ka djalë për t'i takuar pjesa e trashëgimisë. Ai ka një pagë nga e cila pagë deponon në Bankën Islame, p.sh. në Bankën Fejsul, për t'ua shpërndarë vajzave në mënyrë proporcionale. A është e lejuar kjo me sheriatin Islam?

Përgjigje: Prindi ka të drejtë dhe liri që të dhurojë gjatë jetës së tij sa të dojë. Për këtë çështje janë pajtuar të gjithë derisa ndarja bëhet në mënyrë proporcionale dhe nuk është haram. Haram është vetëm atëherë kur dallohet njëri fëmijë prej tjetrit ose njëri fëmijë prej të tjerëve. Niemam bin Beshirë ka shkuar te i Dërguari i Allahut s.a.v.s dhe i ka thënë: O i Dërguari i Allahut, u kam dhënë djemve të Nëumaniut kaq e kaq. Muhamedi a.s. i ka thënë: A ju ke dhënë fëmijëve njësoj sa i ke dhënë Nëumanit? Ai i thotë: "Jo". Muhamedi a.s. i thotë: Le të dëshmojë për këtë ndokush tjetër, sepse unë nuk dëshmoj për padrejtësi.

Sa i përket shumës së caktuar për dhuratë vajzave, le të jetë ajo aq sa u nevojitet atyre për përgatitjen e martesës, e jo tërë pasurinë, të cilën e posedon ose e deponon, sepse kjo do të thotë zvogëlim i trashëgimisë pas vdekjes së prindit.

MËNYRA E HAXHIT

Cilat janë mënyrat e kryerjes së haxhit dhe të Umres?

Përgjigje: Haxhi ka tri mënyra.

E para: Haxhi tek *(IFRAD)*: Pra, kur bëhet nijeti vetëm për kryerjen e haxhit dhe, pasi që të kryhet haxhi në tërësi, lirohet në tërësi prej të gjitha ndalesave. Bën nijet dhe vesh ihramin për umre dhe nuk e ka për detyrë (vaxhib) të presë kurban (*Hedj).*

E dyta: Haxhi i bashkangjitur me umren (KIRAN): Është haxhi kur nijeti bëhet për kryerjen e haxhit dhe të umres me një ihram të përbashkët dhe më një rruarje apo shkurtim të flokëve të përbashkët dhe se e ka për detyrë (vaxhib) të presë kurban kur të lirohet prej ihramit.

E treta: Haxhi (*Temetuë)*: Është haxhi kur vishet ihrami për të parën

herë vetëm për umre dhe, pasi ta përfundojë dhe të lirohet prej ihramit, e bën nijetin, vesh ihramin për haxh në ditën e 8 të muajit Hixhe dhe e ka për detyrë (vaxhib) të presë kurban, pasi të lirohet prej ihramit të haxhit.

SADAKAJA E GRUAS PA LEJEN E BURRIT TË SAJ

Pyetje: Sadakaja prej pasurisë së gruas, pa leje të burrit, a është haram apo hallall?

Përgjigje: Një grua e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s për stolinë e saj, të cilën e ka dhënë sadaka. Ndërsa, Muhamedi a.s. i ka thënë: ***"Nuk lejohet që gruaja të japë diçka prej pasurisë së saj pa lejen e burrit të saj."***

Në një transmetim tjetër: "***Nuk i lejohet gruas asgjë prej pasurisë së saj, pasi që burri i saj e ka në bashkëshortësi dhe e ka në përgjegjësi atë e pasurinë e saj".(E kanë transmetuar Ehlu-Suneni)***

Ibn Maxhe transmeton se gruaja e Keab ibn Malikut ka shkuar te Muhamedi a.s dhe i ka thënë: E kam dhënë sadaka këtë stoli. Ndërsa, Muhamedi a.s i ka thënë: "Nuk i lejohet gruas asgjë prej pasurisë së saj, nëse nuk merr leje prej burrit të saj; dhe a ke marrë leje prej Keabit për këtë"Ajo iu është përgjigjur: "Po". Pastaj, Muhamedi a.s e ka dërguar një sehabe te Keabi dhe e ka pyetur: "A i ke dhënë leje Hirjetës (gruas tënde) për të dhënë sadaka stolinë e saj?". Ai është përgjigjur: "Po". Atëherë Muhamedi a.s e ka pranuar sadakanë e saj.

MËKATET E VOGLA DHE MËKATET E MËDHA

Kur Allahu i fal mëkatet e të gjithëve në përgjithësi, a do të thotë se falen edhe mëkatet e mëdha apo vetëm mëkatet e vogla?

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: "**Thuaj: O robërit e mi, ju që e keni tepruar në mëkate në dëm të vetvetes suaj, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut. Vërtet, Allahu i fal gabimet për të gjithë së bashku në përgjithësi".** A ka të bëjë kjo me mëkatet e mëdha, si p.sh. idhujtarinë ose prostitucionin?

Shejh Shaëraviju thotë:

Në ajetin Kur'anor: ***"Vërtet, Allahu i fal gabimet për të gjithë së bashku në përgjithësi"*** nuk përfshihet idhujtaria, sepse idhujtaria nuk është mëkat; kjo për arsye se mëkat quhet kur ti të veprosh diçka që është rregull në besimin tënd; nëse e vepron, dënohesh. Ndërsa, sa i përket idhujtarisë, ajo është tradhti e madhe. Argument për këtë është ajeti tjetër: **"Vërtet, Allahu nuk fal kur t'i bëhet idhujtari dhe i bëhet ortak atij; përpos kësaj, i fal kujt të dojë."**

Idhujtarinë nuk e quajmë mëkat, sepse është më e madhe se sa mëkati; sepse mëkati është që ta pranosh planprogramin, pra besimin, mirëpo e ke kundërshtuar këtë program kur të është thënë: "Vepro këtë dhe këtë", pra mosveprimi i kësaj apo i asaj është mëkat. Por, kjo vjen në pyetje kur njeriu nuk e beson planprogramin në tërësi. Pra, mosbesimi i planprogramit në tërësi nuk bën pjesë në brendi të mëkateve. Për këtë arsye të gjithë komentuesit kur ta interpretojnë pjesën e ajetit "Vërtet Allahu i fal të gjitha gabimet në tërësi për të gjithë juve, përpos idhujtarinë", duke e përfshirë idhujtarinë në listën e mëkateve "pse"; vërtetë, Allahu nuk fal, nëse i bëhet idhujtari Atij dhe i fal përpos kësaj atij që dëshiron Ai. Faljen e mëkatit Zoti i Lartmadhëruar a e ka renditur vetëm me dëshirën e Tij, apo vetëm është renditje në ajet? Është thënë se "Vërtet, Allahu i fal gabimet në përgjithësi". Mirëpo, çka ka thënë Zoti i Lartmadhëruar në ajetin tjetër: "Dhe kthehuni te Zoti juaj dhe dorëzojuni Atij", pra, për të mos menduar se ju falen gabimet në tërësi nëse nuk bëhet dorëzimi dhe kthimi te Ai: Zoti i Lartmadhëruar veç ka thënë në ajetet: **Dhe, kthehuni te Zoti juaj dhe përuljuni Atij para se t'u vijë dënimi, se pastaj nuk do të ketë kush t'ju ndihmojë. Dhe përmbajuni asaj më të mirës që u është shpallur nga Zoti juaj, para se t'ju vijë**

dënimi befas e ju të mos dini. Dhe të mos thotë ndokush: "O i mjeri unë që kam lënë mangu respektimin ndaj All-llahut dhe ë kam qenë prej atyre që talleshin!" (EZ-ZUMER 54-56).

Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: "Vërtet Allahu i fal mëkatet, gabimet e të gjithëve", mirëpo, pas kësaj thotë: "Kthehuni te Zoti juaj nëse kthimi do të thotë pendim", atëherë pendimi nevojitet para kthimit. Nëse nuk pendohet dhe nuk kthehet, atëherë Allahu nuk i fal atij, sepse ka thënë: "Dhe kthehuni te Zoti juaj". Njeriu, pra, nuk duhet ta marrë vetëm pjesën e jashtme të ajetit, sepse ajeti fillon. "O ju, robër të Allahut, të cilët e keni tepruar, i keni tejkaluar kufijtë", pra nuk tregon ajeti nëse mëkat është çështja, së cilës nuk mund t'i iket në tërësi, mirëpo pendimi ta shlyen mëkatin, e të mirat e shndërrojnë të keqen në të mirë. Ndërsa, deri sa njeriu i tejkalon kufijtë e mëkateve dhe pas kësaj nuk pendohet, nuk bën të mira, për t'i shndërruar të këqijat në të mira dhe angazhohet e nuk kthehet në besimin e Allahut. Kjo nuk lejohet në Islam.

KU TË TË KËRKOJ NË DITËN E KIAMETIT?

Pyetje: Është e vërtetë se Muhamedi s.a.v.s. do të ndërmjetësojë umetin e tij në ditën e kiametit. Kjo është specifikë prej specifikave të Muhamedit a.s., me të cilën e ka dalluar prej të gjithë pejgamberëve. Cilat janë vendet ku saktësisht mund të takohet Muhamedi në ditën e kiametit?

Përgjigje: ***Enesi r.a. ka kërkuar prej Muhamedit a.s që të ndërmjetësojë për të (në ditën e kiametit). Muhamedi a.s. i ka thënë: Po, unë do të ndërmjetësojë. Pastaj Enesi i ka thënë: Po ku të të kërkoj ty në ditën e kiametit?***

Është përgjigjur: Më kërko në rend të parë në sirat (urën e xhehnemit). Po nëse nuk mund të takoj në sirat?

Është përgjigjur: Atëherë do të jem në Mizan (peshojë). Po nëse nuk të gjej te Mizani?

Është përgjigjur:Unë jam te bahçja ime. Në ditën e kiametit nuk do të jem në ndonjë vend tjetër përpos këtyre tre vendeve.(AHMEDI)

PSE I DËRGUARI NUK E KA KOMENTUAR KUR'ANIN NË TËRËSI

Pse nuk është komentuar Kur'ani në tërësi në kohën e Muhamedit s.a.v.s?

Përgjigje: Kur'ani ka zbritur udhëzim për tërë njerëzimin dhe dritë për mbarë rruzullin tokësor, ndërsa Muhamedit s.a.v.s i ka zbritur për 23 vjet.

Atëherë pse i Dërguari i Allahut nuk e komentuar Kur'anin fisnik në tërësi gjatë gjithë jetës së tij?

E vërteta është se këtu kemi dy grupe: Grupi i parë mendon se komentimi i kohës së Muhamedit s.a.v.s dhe sahabëve është komentim përfundimtar dhe nuk pranon komentim shtesë. Bile shtimi në të është një lloj ngarkese (njollosje) e Kur'anit fisnik më shumë se atë çka e ka parashtruar dhe e kërkon Libri i Allahut në teoritë praktike tokësore; mund të vërtetohet josaktësia e atij komentimi pas disa dekadave.

Ndërsa, grupi tjetër mendon se Kur'ani ka dy pjesë: Në pjesën e parë janë farzet dhe dispozitat, të cilat janë të qarta dhe nuk ka dyshim në ato, dhe komentimi i cili është bërë në kohën e Pejgamberit s.a.v.s., i cili është obligativ deri në ditën e kiametit. Ndërsa, mrekullitë tjera të Kur'anit ia shtojnë njeriut të kuptuarit. Çdo herë kur shkenca ecën përpara, Allahu zbulon fakte në tokë. Nga këtu, pjesa e Kur'anit e këtij drejtimi është pjesë vazhduese dhe nuk përfundon asnjëherë. U ka dhënë gjeneratave para nesh dhe do t'u japë gjeneratave që do të vijnë pas nesh. Pra, Kur'ani është burim i pashtershëm i fakteve deri në ditën e kiametit. Anët e mrekullisë së Kur'anit janë të pranishme në çdo kohë dhe në çdo vend dhe në ditët e ardhshme do të bëhet zbulimi i disa ajeteve, të cilat ne nuk kemi mundur t'i kuptojmë plotësisht.

Muhamedi s.a.v.s nuk e ka komentuar Kur'anin në tërësi, gjatë jetës së tij, sepse atëherë do të kishin qenë pasive mrekullitë shkencore të llojllojshme. Mirëpo, ajetet e dispozitave dhe të sheriatit janë shpjeguar për arsye se obligueshmëria duhet të jetë e qartë dhe e saktë.

Pra, fusha e gjithëpërfshirjes së Kur'anit është burim i pashtershëm i të rejave të llojllojshme dhe të mrekullueshme. Ai i cili e mohon një tekst të qartë dhe të prerë të Kur'anit, është pabesimtar; edhe në çështjet e ajeteve, të cilat tregojnë qartë mrekullitë hyjnore të gjithësisë, të mendimit, mendjet duhet patjetër të kuptojnë, edhe pse secili e kupton në rrugën dhe mënyrën e

vet në veçanti. Përfundimi del se nuk guxohet të preket në çështjet e akides, besimit dhe imanit të plotë, në Allahun e Lartmadhëruar. Kjo është ana, e cila ripërtërihet kohë pas kohe, shekull pas shekulli, gjeneratë pas gjenerate, pra ana e të kuptuarit mendor të Kur'anit.

NAMAZI NË ANIJE

Pyetje: Si falet namazi në anije, kur njeriun e kaplon frika, ose i kanoset rreziku i fundosjes, për shkak të stuhisë së fortë të detit. Ose: falet, apo nuk falet?

Përgjigje: Xhafer bin Ebi Talibi r.a. e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s për namazin në anije, ndërsa Muhamedi a.s i ka thënë: ***"Falu në të duke qëndruar në këmbë, vetëm nëse i frikësohesh fundosjes." (HAKIMI NË MUSTEDREKUNET E TIJ)***

AGJËRIMI PAS MUAJIT RAMAZAN

Përpos muajit Ramazan, cili prej muajve të vitit është më i vlefshëm për ta agjëruar njeriu?

Një njeri e ka pyetur Muhamedin a.s:

Pos muajit ramazan, cilin muaj më kishe urdhëruar për ta agjëruar. Muhamedi a.s iu është përgjigjur: ***Nëse ke vendosur për të agjëruar muaj, pos ramazanit, agjëro muajin Muharrem, sepse ky është muaji, në të cilin Allahu fal një popull dhe, po ashtu, fal një popull (njeri) tjetër. (E ka regjistruar Ahmedi)***

NE E KEMI KRIJUAR NJERIUN NË VËSHTIRËSI

Pyetje: Në jetë dhe në aktivitete të ndryshme ballafaqohemi me vështirësi të natyrave të ndryshme. Ndonjëherë ato vështirësi tejkalohen, ndonjëherë jo. A është kjo natyrshmëri e jetës së njeriut në këtë botë dhe a është krijuar për kryeneçësi?

Përgjigje: Imami i mirënjohur thotë: Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Ne veç e kemi krijuar njeriun në vështirësi..."**. E, kjo do të thotë se njeriu nga natyrshmëria e përbërjes së tij është i ndërlikuar apo që të jetë në vështirësi. Ai i cili dëshiron të jetë i qetë, është njeriu, i cili nuk e ka kuptuar fshehtësinë e krijimit të Allahut, sepse Allahu i Lartmadhëruar e ka krijuar njeriun të jetojë në vështirësi. Ia ka krijuar aftësinë dhe e ka dalluar me mendje. Fuqinë njësoj si të kafshës, pra në vete ka pjesë (përbërje) shtazarake, e cila zhvillohet me ligjet e kësaj bote ,e cila manifestohet në trupat e gjallë, me të cilën pikë bashkohen pjesa më e madhe e krijesave. Mirëpo, prej të gjithave atyre krijesave, e ka dalluar me mendje, pra Zoti i Lartmadhëruar e ka dalluar mbi të gjitha krijesat me mendje. Po pse? A ke parë ndonjë lloj apo gjeneratë të ndonjë kafshe duke thënë: Duhet që jetën tonë ta zhvillojmë. Ta rrisim komoditetin në shkallën më të lartë, ta ndryshojmë ushqimin në përbërje më të mirë, të zbulojmë ilaçe për sëmundjet tona dhe të mundohemi t'i zgjidhim problemet tona vet. A ke parë ndonjë gjeneratë të kafshëve se ka vepruar kështu? A ke parë ndonjë kafshë që kur i vendoset ushqimi pranë saj, e ajo të ketë thënë: e dua këtë ushqim, e nuk e dua këtë, ose duke thënë: Këtë ushqim do ta ruaj për nesër ose një pjesë të ushqimit do ta ruaj për ditët e ardhshme. A e ke parë kafshën, edhe pse ajo ngopet duke ngrënë, ajo vazhdon të hajë. Po, edhe nëse i mëshon, dhe sado që i mëshon, ajo vazhdon të hajë, pra ha e nuk ndalet, sepse ajo vetëm e plotëson nevojën e tij, e pastaj, që t'i ketë mjetet në disponim, ta çojë ushqimin në vendin e tij.

Pas kësaj shohim njeriun kur ha dhe ngopet, e pastaj kur i thua: Ky ushqim është i mirë dhe duhet ta shijosh, ose ia sjell një pjatë tjetër me pamje tërheqëse, të përgatitur mirë, ai edhe pse është i ngopur, ha. Ndërsa, kafsha ha sa kërkon nevoja, pra vetëm mbush nevojën. Këtu shohim se njeriu është në hapësirë ku Zoti i Lartmadhëruar i ka dhënë të drejtë zgjedhje, që ai vet të vendosë. Ndonjëherë ai merr vendim, i cili është i dëmshëm për të, ndonjëherë i dobishëm. Mirëpo, mundësia e vendimmarrjes për të ngrënë ose

për të mos ngrënë pas ngopjes, ose të veprojë diçka, ose të mos veprojë diçka, nuk është çështje të cilën e kërkon nevoja apo ndjenja, por me të drejtën e tij zgjedhëse. Pas kësaj shkojmë dhe shikojmë: A e kemi parë kafshën që i merr fëmijët e tij deri sa të bëhen të pavarur, dhe në momentin kur fëmija e kafshës rritet, ajo ndahet prej prindërve, përfundon çdo gjë dhe nuk dinë prindërit ku shkon, sepse roli dhe misioni i tyre ka përfunduar. Pra, ndjeshmëria dhe e drejta e të zgjedhurit janë shkak i kryeneçësisë së njeriut dhe e vështirësive të tij.

QIELLI DHE TOKA QAJNË

Pyetje: Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Për ta nuk qajtën as qielli e as toka dhe atyre nuk iu dha afat."(Ed-Duhan, 29)**

A është fjala "të qajturit" alegori apo qielli dhe toka qajnë realisht?

Shejh Shaëraviu përgjigjet: Qielli dhe toka qajnë. Po, qajnë dhe ky veprim është veprim i ndjenjave. Qajtja është operacion, veprim, reflektim dhe dalja jashtë për shkak të ndjenjave për diçka. Ti qan për arsye se ke ndonjë ndjenjë për diçka.

Dëshiron ta sqarojë dhe të vërtetojë pse në të ka ndjenja. Pasi që qielli dhe toka kanë ndjenja, mbesin çështje prej të cilave mund të përfitohet, e ato janë sende të ngurta, bimët, gjallesat; për këtë arsye nuk ka ndonjë pengesë për të mos besuar se ata kanë ndjenja. Atëherë vetvetiu kuptohet se ata gëzohen për gjërat për të cilat shpërblehen. Pse meritojnë të shpërblehen?

Sepse ata e dinë qartë se nuk meritojnë shpërblim, derisa mbi ta nuk praktikohet programi i Allahut, ashtu siç e kërkon Ai.

Pra, qielli është gëzuar atëherë kur praktikohet programi i Allahut, ashtu siç dëshiron Allahu, por pa dëshirën e tij të drejtpërdrejtë. Pra, ai (qielli) është vëlla në fe për të (tokën) dhe kur të jetë e begatuar, e ndien veten të kënaqur e të gëzuar, sepse është begati edhe për të. Për këtë arsye kënaqësia në jetë varet prej kënaqësisë konkrete dhe abstrakte; pra, këtu është konkrete.

"Dhe atij të cilit i peshojnë veprat e mira në peshojë, ai do të jetojë jetë të kënaqshme."

SI PAGUHEN KOPPRRACËT NË KËTË BOTË

Koprracët nuk e pastrojnë pasurinë e tyre me sadaka. Zakonisht, ata janë të padobishëm, e po ashtu janë larg vetes së tyre, larg Zotit të tyre, larg njerëzve. Si është pagesa e tyre në këtë botë?

Përgjigje: Fisniku (bujari) është i afërt te Allahu, i afërt me veten e tij, i afërt me njerëzit. Filozofia e jetës së koprracëve është interesante. Ata, në raste të veçanta, e japin tërë atë që e fitojnë. Llogaria e tyre është pengimi i asaj që dëshirojnë në jetën e tyre. Ata në jetën e tyre gjithmonë kanë pengesa, vazhdimisht edhe ndalesa.

Fshati i mallkuar koprrac te i cili ka shkuar robi i mirë - Hidri me Musa a.s., të cilët kanë qenë të uritur, kanë kërkuar ushqim, por banorët e fshatit i kanë refuzuar.

Kur Musa.a.s. me Hidrin e kanë rindërtuar murin, i cili ishte në rrëzim e sipër dhe rrezik për banorët, nuk kanë kërkuar shpërblim prej tyre. Musa a.s. është habitur nga robi i mirë (Hidri), pra të rindërtojë murin dhe mos të kërkojë shpërblim prej banorëve koprracë të fshatit të mallkuar, të cilët edhe kishin refuzuar t'i japin ushqim. **"I kanë refuzuar t'u japin ushqim."**

Vet puna e tregon se ai fshat i mallkuar ka qenë lajkatar. Pse? Sikur të rrëzohej muri, apo po të rrëzohej muri, ata do të merrnin pasurinë e jetimëve dhe do të kishin thënë: E po të kishin qenë fisnikë banorët, do të kishin marrë përsipër ta sigurojnë dhe ta ruajnë atë thesar.

Ajo për çka Musa a.s. ka punuar në rindërtimin e murit, është e kundërta e asaj për çka ka punuar robi i ndershëm (Hidri). Pra, e njëjtë, me qëllime të ndryshme.

"Sa i përket murit, ai ka qenë i dy fëmijëve jetimë të fshatit dhe thesari i tyre ka qenë i fshehur nën të. Babai (i jetimëve) ka qenë njeri i mirë. E, për këtë arsye Zoti i yt ka dëshiruar që ata të rriten e të forcohen dhe pastaj ta marrin thesarin e tyre nga aty. "Kjo është mëshirë prej Zotit tënd". (*EL–KEHF)*

Pra, pagesa e koprracëve është pengimi dhe ndalimi i të mirës për ta.

ISLAMI DHE FEMRA

Pyetje: A e ka përcaktuar sheriati llojin e punës në shoqëri dhe cilat detyra ia lejon islami femrës për të punuar?

Përgjigje: Duhet të dimë se nëse bëhet unifikimi i detyrave dhe roli i të dy gjinive, atëherë nuk do të kishte pasur nevojë për gjini fare: pra për gjininë mashkullore dhe gjininë femërore. Të sjellim një shembull të shenjave të gjinisë të gjithësisë së kohës. Koha është hapësira e ndodhive. Ndodhitë ndahen në ndodhi të natës dhe të ditës. Koha është si gjinia, hapësira e ndodhive si e llojit. Pra, dita ka rolin e saj, poashtu edhe nata. Nëse dëshiron të thuash: A janë të njëjtë roli i ditës me atë të natës, ose roli i natës me të ditës, atëherë veç ke shkatërruar sistemin natyror të gjithësisë, sepse nata është krijuar për të kryer detyrën e saj, kurse dita të sajën. Nëse shohim se një lloj është ndarë në dy gjini kjo do të thotë specifikat e përbashkëta të llojit, e pastaj ndaji specifikat e secilës gjini. Allahu, kur ka dëshiruar të na e sqarojë këtë çështje, ka thënë: Shikoni llojet e gjithësisë, të cilat janë të pandryshuara, e prej tyre është: p.sh. nëse i pyesim biologët, ata thonë: Drita e diellit e kryen rolin e saj për bimët, e po ashtu edhe nata e kryen rolin e saj për bimët. Bimët lëshojnë dyoksidin e karbonit, i cili është i nevojshëm për natyrën; pra nata ka rolin e të ekzistuarit për gjallesat, e po ashtu, edhe dita ka rolin e të ekzistuarit të gjallesave. Nëse ti thua: Po këto janë dy të kundërta, ne u kundërpërgjigjemi: Jo, nuk janë të kundërta, por kompletues dhe plotësues të njëra-tjetrës. Zoti na ka sjellë shembull kur ka thënë: **“Thuaj (O Muhamed), pa shikoni (e analizoni): po të kishte bërë Allahu natë për ju deri në ditën e kiametit (pra, jeta jonë në terr në tërësi), kush pos Allahut do të sillte dritën. A nuk po dëgjoni?”**. Pastaj, në ajetin tjetër thotë: **“Thuaj: A nuk po shikoni (analizoni): po ta kishte bërë Allahu ditë për ju deri në ditën e kiametit, kush pos Allahut do t’ju sillte natën për të pushuar në të. A nuk po shihni?”** Pra, secila prej tyre ka rolin e vet. Nuk duhet që një lloj ta ngarkojë me detyrën e tjetrit, sepse atëherë do të humbte baraspesha, ekuilibri dhe do të ndodhte disproporcion. Allahu i Lartmadhëruar na ka sqaruar se çështje primare në ekzistencën është jetesa në të, pra jeta e njerëzve, e pastaj ka treguar çështjen e mashkullit dhe të femrës. Parashtrohet pyetja: Si? Ata (mashkulli dhe femra) janë si nata me ditën, ata janë të një lloji, pra të llojit njeri, mirëpo të ndarë në dysh: mashkull dhe femër. Atëherë, ata dy si qenie

njerëzore kanë specifika të përbashkëta, në të cilat nuk ndeshen, mirëpo ata dy, si dy gjini, secili prej tyre ka rolin e vet. Lexo fjalën e Zotit të Lartmadhëruar: Pasha natën, kur ajo errësohet (dhe lëshon pëlhurën e saj), pasha ditën, kur qartësohet (dhe shpalos veten e saj) dhe pasha atë që ka krijuar meshkuj dhe femra, nuk ka dyshim se angazhimi juaj është i shumëllojtë, pra secili prej tyre ka rolin e vet në ekzistencë. Nëse mundohesh që rolin e mashkullit t'ia ngarkosh femrës, ose rolin e femrës mashkullit, atëherë ti ke shkaktuar tronditje në ekzistencë, sepse, sipas kësaj, nuk ka qenë nevoja të jenë dy gjinitë dhe specifikat e përbashkëta të tyre. Zoti ynë ka thënë: Mashkulli dhe femra janë të një lloji, prej një brumi, dhe prej atij brumi ka bërë bashkëshorten e tij, e nuk është ashtu, si kanë thënë ideologjitë dhe fetë tjera, se shejtani ka krijuar femrën, ose Zoti i të keqes e ka krijuar femrën, e Zoti i së mirës e ka krijuar mashkullin. JO! Islami thotë: Që të dy janë të një përgjegjësie si njeri. Femra është përgjegjëse për punën e saj, e mashkulli është përgjegjës për punën e tij. Këtë e sqaron Muhamedi s.a.v.s, kur thotë: ***Burri është ai i cili kujdeset dhe është përgjegjës për kujdestarinë e tij; femra është kujdestare dhe ajo është përgjegjëse për kujdestarinë e saj.*** Përgjegjësia para Allahut: "Kush vepron punë të mira, qoftë mashkull, qoftë femër dhe ai është besimtar". Ne gjithashtu kemi thënë: Femra ka liri në besim, beson çka dëshiron, mirëpo që nga momenti kur të besojë, ajo patjetër duhet t'i përmbahet atij besimi dhe ligjeve që rezultojnë prej tij. Ajo ka të drejtë të hyjë në besim ose mos të hyjë në besim, varësisht prej burrit ose prindit të saj. Zoti na ka sjellë shembullin e gruas së Nuhit dhe gruas së Lutit. Nuhi dhe Luti, që të dy, kanë qenë të dërguar, mirëpo përkundër kësaj bashkëshortet e tyre nuk e kanë pranuar fenë e tyre. Allahu sjell shembull gratë e Nuhit dhe të Lutit për pabesimtarët: që të dyja qenë nën kurorë të dy robërve tanë të mirë, mirëpo ato i tradhtuan ata dy dhe kjo te Allahu nuk pati kurrfarë dobie për ato (dy gra), por u tha: Hyni në zjarr me hyrësit tjerë. Pastaj sjell shembullin për besim: Allahu për besimtarët sjell shembull gruan e firaunit, i cili i ka thënë vetes Zot, mirëpo, përkundër kësaj, asnjëherë nuk ka arritur ta bindë që të hyjë në fenë e tij. Zoti i Lartmadhëruar thotë**: "Kur tha: O Zoti im, më ndërto mua një shtëpi te Ti në xhehnet dhe më shpëto nga firauni dhe puna e tij, më shpëto nga populli kriminel."** Pra, femra ka liri besimi, Islami i ka dhënë femrës të drejtat qytetare të plota, të cilat nuk ia ka dhënë asnjë fe tjetër. Femra jehude, para martesës, ka qenë pronë e babait të saj dhe nuk ka mundur të veproj asgjë në vete, e pas martesës është bërë

pronare e burrit të saj. Më vonë, ligjet laike, si ligji XVIII francez, neni 207, thotë: Edhe pse femra është kushtëzuar që të ketë të drejtë pasurie, pavarësisht prej burrit të saj, ky kusht shfuqizohet dhe se ajo nuk ka të drejtë posedimi të pasurisë në mënyrë të pavarur.

Nëse bëjmë një analizë, do të shohim se perëndimi është duke ia humbur femrës cilësitë e saj. Cilat janë cilësitë primare të njeriut? Forma, reputacioni dhe emri. Në Evropë kur të martohet femra, quhet Madam i Filanit, që do të thotë se nuk ka të drejtë ta mbajë mbiemrin e saj ose të babait të saj, ose të nënës së saj. Kur tradicionalistët kanë ardhur në Egjipt në fillim të zhvillimit bashkëkohor dhe e kanë parë këtë, ata thanë se duhet të harrohet (fshihet) emri i tyre. Ato kanë pranuar të ndërrojnë emrin e baballarëve dhe të nënave, mirëpo kanë vazhduar ta mbajnë emrin e tyre. HEJD Shaëraviju e ka marrë emrin e saj HEJD dhe e ka marrë mbiemrin e familjes së burrit të saj. Ali Basha Shaëravijut nuk i është dhënë e drejtë ta ndërrojë mbiemrin e saj. Mirëpo, në Evropë dhe Amerikë e ndërron emrin dhe mbiemrin e familjes (emrin) dhe emërtohet me emrin e burrit të saj. Po çfarë e drejte është kjo, çfarë barazie e femrës, pasi që i merret emri i saj. Në Islam gratë e Pejgamberit, të cilat kanë qenë femrat më të nderuara, nuk janë quajtur Madam Muhamed bin Abdullah. Nuk janë quajtur Zonja Muhamed, por janë quajtur Ajshe bin Ebu Bekr, Hafsa bin Umer, Zejneb bin Xhash, pra e kanë ruajtur edhe emrin e tyre, edhe emrin e baballarëve të tyre, ose të familjeve të tyre. Pas gjithë kësaj dëgjohen zëra: "Dëshirojmë të jemi si perëndimi". Perëndimi nuk i ka dhënë liri femrës as në emërtim, as në pasuri, por lirinë të cilën e ka fituar femra, ka qenë si shkak i luftërave. Kur meshkujt kanë shkuar ushtarë në luftë, është ndier nevoja për t'u zëvendësuar krahu i tyre në punën qytetare. Atëherë ua kanë dhënë disa të drejta për të shtuar prodhimin shoqëror, nëpërmjet duarve të tyre. P.sh. Sokrati thotë: Femra nuk është e përgatitur për të kuptuar diçka në dituri, por nga natyrshmëria e saj, ajo është e përgatitur për kuzhinë dhe edukim të fëmijëve. Pas tij vjen Platoni, i cili i jep pak të drejtë për dituri, mirëpo që të gjithë ngriten kundër tij dhe e kundërshtojnë. Kundër tij ngritet edhe filozofi Aristofan, i cili shkruan librin "Gratë *MUTEHADHLIKAN* (gratë e nënçmuara) dhe i akuzon gratë, të cilat kanë arritur shkallë të lartë të diturisë. Pas tij vjen Molier Fransi dhe shkruan "Paramendimi i grave". Islami nuk e ka marrë atë qëndrim, por ka thënë: "Kërkimi i diturisë është farz për çdo musliman e muslimane", pra ne e kemi bërë farz arsimimin e femrës. Kur i Dërguari i Allahut s.a.v.s është martuar

me Hafsa bin Umer r.a., ndërsa, para martesës, te shtëpia e Umerit shkonte një grua nga Beni Adij, ku e ka mësuar shkrim e leximin. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka kërkuar nga Omeri r.a. që ajo të vazhdojë mësimin te shtëpia e të Dërguarit. Omeri r.a. i thotë: po ajo e ka përfunduar mësimin, ndërsa i Dërguari i Allahut s.a.v.s. i thotë: le ta përsërisë dhe ta përforcojë. Femra le të mësojë, por të mësoj atë që i përshtatet llojit të saj. Ne i ndajmë meshkujt nga shkolla fillore në paralele dhe në drejtime p.sh. industri, bujqësi, tregti etj, për femra mësimin përkatës dhe drejtimin, i cili i përshtatet asaj, që ajo me lehtësi t'i arrijë pikësynimet e saj. Femra duhet të jetë falënderuese për të mirat që ia ka dhënë Allahu, sepse njerëzit punojnë punë të llojeve dhe drejtimeve të ndryshme. Bujku e blegtori angazhohen në kultivimin e kafshëve, industrialisti punon në industri, ndërsa femra merret me edukimin dhe arsimimin e krijesës më fisnike, pra me edukimin e njeriut. Femra nuk dëshiron që në këtë mision të dështojë. Femrës, e cila dëshiron ta kryejë detyrën e saj si edukuese e familjes, si grua, si nënë etj., nuk i mbetet kohë të merret me punë të tjera. Le të mësojë dhe të jetë mësuese speciale, ose le të mësojë rrobaqepësi për fëmijët e saj dhe të të tjerëve. Nëse shikon aktivitetin e saj në jetë, ajo sjell përfitime në shtëpi më shumë se sa paga mujore. Na plotëson neve nevojat dhe bukurinë e saj në jetën tonë. Pastaj shikojmë realitetin. Femra që ngritet sa më më lart në punë, a dëshiron që edhe më shumë të punojë apo sa më shumë që ngritet me punë, dhe sa më shumë që shtyhet në moshë, dëshiron që të jetë edukuese e familjes, deri sa edhe gratë e perëndimit, si Merlin Monro, e cila ka thënë: "Ruajuni nga dritat të cilat ju verbërojnë. Po të rikthehej jeta ime prej fillimit, do të dëshiroja që të isha edukuese e familjes", kur është bërë statistika në mes të vajzave dhe grave rreth asaj se sa prej tyre kanë dëshirë të qëndrojnë në shtëpitë e tyre dhe ta kenë detyrën si edukatore e familjes? Pra, çështja është se në perëndim ka, çka tek ne nuk ka. Neve nuk duhet të shikojmë atje, e në bazë të atje-hit ta rregullojmë jetën tonë, sepse në perëndim që nga momenti kur të rritet fëmija, largohet nga familja dhe fillon jetën e pavarur. Po edhe vajzës, që nga momenti kur të rritet, i thuhet "tani shko ku të duash". Tek ne nuk ka nevojë që femra të ballafaqohet me probleme në shoqëri për të siguruar jetën e saj. Kur perëndimi e ka shpikur ditëlindjen e gruas, ne e kemi pasuar verbërisht dhe nuk i kemi analizuar shkaqet, të cilat kanë ndikuar që perëndimi të shpikë një ditë të tillë, pra ditën e nënës. Intelektualët perëndimorë kur kanë vërejtur se fëmijët kanë harruar nënat e tyre, nuk përkujdesen dhe nuk i kushtojnë

rëndësi atyre, kanë vendosur që të caktojnë një ditë në vit që fëmijët së paku atë ditë t'i kujtojnë nënat e tyre. Mirëpo, tek ne festë e nënës është çdo çast prej çasteve të saj në shtëpinë e saj. Tek ne, që nga momenti kur njeriu del nga shtëpia, ia puth dorën nënës së tij, kërkon lutje prej saj dhe gjithmonë i kthehet me dhurata. Pra, tek ne nuk është e domosdoshme një festë e tillë. Mirëpo, ne e kemi marrë se është një traditë prej traditave perëndimore, ndërsa ajo është nënçmim për të. Tek ne nuk është kështu. Islami i ka paraparë të drejtat në bazë të aftësive të prindërve. Islami i ka renditur të drejtat: (nënën tënde, pastaj nënën tënde, pastaj nënën tënde, pastaj babain tënd), sepse babai yt është burrë sa që, edhe nëse bëhet lypës, e ka lehtë, ndërsa nëna jo.

Kur'ani në mënyrë të veçantë e thekson këtë çështje, kur thotë: **"Dhe ne e kemi porositur njeriun që të sillet me prindërit me mirësi."** Mirë pra, po porosit për mirësi ndaj prindërve, mirëpo nëse i analizon ajetet kur'anore, shohim se ajetet vazhdimisht, pas porosisë për mirësjellje të përbashkët, e cekin në mënyrë të veçantë nënën; pra, vazhdon ajeti: **"e ka bartur nëna e tij me plot vështirësi dhe e ka lindur me vështirësi, e ka bartur dhe i ka dhënë gji (që të dy operacionet së bashku) tridhjetë muaj"**. Kjo do të thotë se nuk e ka përmendur zanafillën prej babait!!!

RISKU A DO TË THOTË VETËM PASURI APO KA KUPTIM GJITHËPËRFSHIRËS?

Përgjigje: Disa mendojnë se risku ka të bëjë me pasurinë dhe mjetet tjera të dobishme në tokë, por ne themi: Jo!

Pse? Risku është çdo gjë nga e cila njeriu përfiton dobi. Ushqimi është risk, por edhe çdo lëvizje e aktivitet në jetë është risk. Pra, mos thuaj se nuk ke risk (furnizim) për të shpërndarë. Ti ke shëndet për të cilin jep sadaka, duke ndihmuar të paaftit.

Ti ke dituri me të cilën e këshillon tjetrin për të mirë.

Ti ke dituri me të cilën e mëson (jep sadaka) të padituri.

Kur thotë Zoti i Lartmadhëruar: **"Dhe me atë çka i kemi furnizuar (rezaknahum), shpërndajnë"**. Ky ajet përfshin të gjitha çështjet e jetës. Të gjitha çështjet plotësuese në ekzistencë janë risk (furnizim), sa që nëse ndonjë

njeriut i mungon diçka, e ti ia plotëson, do të thotë se i ndihmon, sepse ti disponon, e ai jo. Kjo është çështje risku (furnizim).

Pra, plotësimi i mungesës së diçkaje është risk.

SI ËSHTË BËRË TAKIMI I MUHAMEDIT S.A.V.S. ME PEJGAMBERËT TJERË KUR AI KA QENË I GJALLË, NDËRSA ATA TË VDEKUR

Pyetje: Si është bërë takimi i Muhamedit s.a.v.s me pejgamberët kur ai ka qenë i gjallë, ndërsa ata të vdekur?

Imami i mirënjohur përgjigjet:

Kur'ani ka shumë ajete. Nëse njeriu ndalet e përqendrohet në të gjitha ato, do të përfitojë thelbin në të cilin duhet bazuar, pasi që ai noton me imanin e tij nëpër ta dhe nëpërmjet ngjarjeve, si p.sh. mënyra se si është takuar me pejgamberët, si ua ka falur namazin atyre, përderisa ai ka qenë gjallë, sipas ligjit të të gjallëve, ndërsa atyre të vdekur, sipas ligjit të të vdekurve. E, si bëhet takimi i të gjallit me ligjet e të gjallëve, ndërsa i vdekuri me ligjet e të vdekurve dhe të kenë kryer së bashku një veprim?

Është e vërtetë se njeriu kur ndërlidhet me shpirtin e tij, ndërlidhet në forma të ndryshme. Është i ndërlidhur kur është i gjallë, mirëpo në këtë rast ka dy forma të ndërlidhjes: ndërlidhet kur ai është në gjumë, i cili është ligj në vete, dhe kur ai është zgjuar, i cili, po ashtu, është ligj në vete. Mirëpo, edhe të zgjuarit, edhe gjumi janë dy çështje të të gjallëve. Të lëmë anash çështjet sekrete të jetës në varr (Berzahit) dhe pas ringjalljes, sepse ne po flasim për çështjet, të cilat janë në sferën tonë. Unë po kam dy statuse: statusi i parë- gjallë dhe statusi i dytë- gjallë në gjumë. Shpirti ka lidhje me trupin, kur jemi zgjuar, e ky është ligj i veçantë, dhe, po ashtu, shpirti ka lidhje me trupin, kur jemi fjetur, e ky ligj është, po ashtu, i veçantë. Nëse e analizojmë ligjin e shpirtit me trupin fjetur, a është po i njëjti ligj i lidhjes së shpirtit me trupin zgjuar? Natyrisht se jo, nuk është një lidhshmëri. Jo. Parashtrohet pyetja: Pse? Thuhet se unë e shoh në gjumë (ëndërr) filanin, i cili kishte veshjen ngjyrë të kuqe, e tjetri veshje ngjyrë të gjelbër, pra unë po shoh ngjyra, ndërsa sytë i kam të mbyllur. Ç'është ajo që më ka bërë që t'i shoh ngjyrat pa mjet (mjetin

e syve), pasi që unë jam në gjumë dhe sytë i kam të mbyllur!? Pra, po ekzistuakan mjete prej mjeteve të të perceptuarit, të cilat nuk i kam (drejtpërdrejtë) dhe mjete prej mjeteve shqisore, me të cilat flas, e ndiej dhe përjetoj gjërat jo me mjete shqisore të veçanta. Që në momentin kur trupi im bie në gjumë, shpirti fillon të reflektojë dhe të paraqitet me trupin, i jep kuptim të mrekullueshëm, e pas kësaj kohe nuk e ka fuqinë e dominimit, por ka ligj tjetër të veçantë. P.sh. deri sa je në ëndërr, sheh vëllezërit tu që mahiten me ty, qeshin, hanë, pinë, po ashtu, e tjetri, deri sa është fjetur së bashku me ty në një krevat, është me një grup njerëzish, të cilët e rrahin. Ti nuk ndien çfarë i ndodh atij, por edhe ai nuk ndien çfarë të ndodhë ty; ti je në një botë tjetër, e ai në një botë (hapësirë) tjetër. Nëse dëshiron që ti ta harmonizosh këtë ligj jo në ëndërr, asnjëherë nuk mund ta realizosh.

Pra, të zgjuarit ka ligj, gjumi ka ligj. Ligji i shpirtit në gjumë është më i lehtë dhe më i fuqishëm se sa ligji i shpirtit zgjuar. Përderisa është kështu sa jemi në këtë jetë, atëherë si do të jetë me këtë materie kur përfundon dhe humbet? Cili ligj vjen në pyetje pas tij?

A është më i rëndë apo më i lehtë se ligji i gjumit? Patjetër duhet të jetë më i lehtë se ligji i gjumit; mund të shqisojë, të shohë, të takohet, mirëpo kush është ai, i cili mund të zhvishet prej materies së tij dhe ta ndajë shpirtin nga trupi për t'u takuar me ta. Është Ai, Allahu i cili ka vepruar me të dërguarin e Allahut s.a.v.s. për të qenë ashtu; procesi është më i privilegjuar se procesi i gjumit. Ai e ka zhveshur në tërësi prej qenies njerëzore. I ka bërë të shohin gjëra, të cilat nuk ka mund t'i shohë as zgjuar, i ka parë në tërësi prej një procesi të veçantë. Për këtë i Dërguari i Allahut s.a.v.s ka kaluar nëpër dy faza. Çdo ëndërr që e shihte, e përjetonte plotësisht zgjuar, pra që nga momenti kur Muhamedi s.a.v.s. ka dalë prej materies, i ka parë ëndrrat, të cilat nuk kanë qenë iluzion, por realitet. E, si ka qenë puna kur Zoti i Lartmadhëruar ka parë që Muhamedi s.a.v.s të kalojë krejtësisht në një formë tjetër. Sheh apo nuk sheh? A është ai ligj më i ngritur se ligji i gjumit, apo jo? Pasi që ai ka qenë ligj i Berzahit (jetës pas vdekjes), atëherë çfarë lidhjesh ka shpirti me trupin në botën tjetër. Do të jetë sistem i veçantë.

Pra, duhet ta dimë se shpirti ka lidhje me trupin kur është zgjuar, e pas kësaj shpirti prapë ka lidhje me trupin, kur është në gjumë. E ligji i lidhmërisë në gjumë është më i fuqishëm se ligji i lidhmërisë zgjuar. Po ashtu, shpirti ka lidhje me trupin pas vdekjes në berzah, sikurse do të ketë lidhsmëri me trupin pas ringjalljes. Kjo lidhmëri është superiorja dhe përfundimtarja. Për këtë

arsye do të jemi përfundimisht krejt diçka tjetër. Hamë e nuk kryejmë nevojë dhe nuk plakemi. Pra, botën tjetër duhet ta kuptojmë si lidhmëri të trupit dhe shpirtit me ligjin e tij të posaçëm. Ligji zgjuar është diçka në vete, ligji në gjumë është, po ashtu, diçka në vete. Ligji në vdekje është diçka në vete, sikur edhe ligji pas ringjalljes që është diçka në vete.

NJË E TRETA, POR EDHE NJË E TRETA ËSHTË SHUMË

Cila është shuma maksimale, të cilën njeriu ka të drejtë të japë sadaka, e në të njëjtën kohë të mos i dëmtojë trashëgimtarët?

Sead ibn Vekasi r.a. e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: "O i Dërguar i Allahut, siç po e sheh, jam sëmurë, ndërsa kam pasuri. Mirëpo, trashëgimtare kam vetëm një vajzë. A ta jap sadaka dy të tretën e pasurisë? Muhamedi a.s i ka thënë: "Jo".

A ta jap sadak gjysmën e pasurisë? -Jo.

-Po një të tretën?

-Një të tretën po, edhe pse prapë është shumë, sepse të lësh trashëgimtarë të pasur është më mirë se sa t'i lësh ata duke kërkuar prej njerëzve. Çdo shpenzim të cilin e bën për të fituar kënaqësinë e Allahut, do të shpërblehesh, qoftë edhe puthjen që e bën në buzë të bashkëshortes tënde.

A ËSHTË XHENETI I ADEMIT XHENETI I BOTËS TJETËR

Dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme sa i përket xhenetit, prej të cilit ka zbritur Ademi a.s. në tokë. A është ai xhenet shpërblim në botën tjetër apo xhenet i kësaj bote, ose bashqe e lulëzuar, ashtu si çdo bahçe, siç emërtohet xheneti gjuhësisht?

Përgjigje: Xheneti në të cilin ka banuar Ademi a.s nuk është xheneti i shpërblimit në botën tjetër, sepse në ato xhenete njeriu nuk mund të hyjë pa marrë shpërblimin, të cilin e ka fituar; dhe xhenetin e shpërblimit për të cilin nuk ka ngarkesë me obligime. Aty shejtani nuk mund të hyjë dhe të jetojë.

Xheneti në të cilin ka banuar Ademi, ka qenë vend i pasur, me të gjitha të mirat e jetës. Allahu ka dëshiruar ta ushtrojë Ademin dhe bashkëshorten e tij për detyrën e tij apo ngarkimin me obligime, të cilën Allahu e ka caktuar të jetë me vullnetin e tij (Ademit a.s.). Vullneti kërkon orientim, e orientimi është urdhër për të mos vepruar. Të gjitha planprogramet e pejgamberëve, të cilët i ka dërguar Allahu janë planprograme me ngarkesa të obligimeve: vepro, mos vepro. Kështu, Allahu e ka ushtruar Ademin a.s. me detyrën "vepro" dhe me detyrën "mos vepro". Allahu i ka thënë atij dhe bashkëshortes së tij: "Hani dhe pini prej tij (xhenetit) dhe mos iu afroni (mos hani prej) kësaj peme". Pra, simbolika e veprimit "Hani" dhe simbolika e mosveprimit "Mos hani" (Mos iu afroni). Kështu është parashtruar vullneti, që të hash atë që e ka lejuar Allahu dhe mos të hash prej pemës. Mirëpo, kush ha pemën, pra ai i afrohet. Shiko përpikërinë praktike, kur Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: "Dhe mos iu afroni", e nuk ka thënë "Mos hani", sepse bëhet fjalë për ndalesat për të cilat Allahu ka kërkuar të ndalohen. Nuk ka kërkuar Allahu vetëm mosveprim. Por Allahu dëshiron të na mbrojë dhe të na sigurojë nga rënia e epshit tonë në ato mëkate. Për këtë arsye: largohu dhe mos iu afro mëkatit.

LARGIMI NGA FRONTI NË BETEJËN E TEBUKUT

Pse i Dërguari i Allahut ua ka falur gabimin atyre që nuk kanë shkuar në betejën e Tebukut?

Imami i njohur Shaëraviju përgjigjet:

"Të ka falë Allahu ty për atë pse i ke lejuar ata."

Kur ka përdorur Zoti i Lartmadhëruar fjalën "Aff" -falja gabimin, do të thotë ka marrë fund. Çdo gjë, pra, të ka falur Allahu ty. Për këtë çështje nuk ka çka të diskutohet, por unë po e tregoj dhe po e them këtë që ta dinë të tjerët, atyre të cilëve nuk u zbret vaji (inspirimi). Pra, për këtë çështje nuk ka drejtë askush tjetër të marrë vendim.

Derisa të kuptohet dhe sqarohen ata të cilët me të vërtetë janë të drejt dhe dihet se cilët janë rrenacakë. Pra, i dërguari e di të vërtetën dhe vepron me drejtësi, ndërsa të tjerët jo. Kështu problemi ekziston. Ti nuk ke marr

vendim, nuk ke lejuar për këtë çështje deri sa ti të kuptosh se cilët kanë folur dhe kanë pasur arsye të vërtetë (për mosshkuarje në betejë). Kur ekziston Ai, i cili na përmirëson neve dhe atë, nuk ka tjetër i cili ua fal dhe i përmirëson ata (rrenacakët).

UDHËZON CILINDO, E HUMB CILINDO

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Ai, Allahu udhëzon cilindo, e humb cilindo"**. E, po ashtu thotë: **Allahu udhëzon cilindo në rrugën e drejtë**. Pse udhëzimi në rrugë të drejtë nuk është për të gjithë njerëzit?

Imami përgjigjet: Këtu paraqitet pyetja: Kush e përkrah këtë, e kush atë, e pastaj: A nuk është Allahu Ai, i cili udhëzon cilindo, e humb cilindo. Kur t'i sheshojmë ajetet Kur'anore, patjetër duhet t'i sjellim të gjitha elementet, që do të thotë: Unë i paraqes ajetet, të cilat vërtetojnë, dhe ajetet, të cilat nuk vërtetojnë atë. P.sh.: Allahu i thotë të Dërguarit të Tij s.a.v.s: **"Mirëpo ne e kemi bërë dritë, me të cilën udhëzojmë cilindo prej robërve tanë dhe me të vërtetë Ti udhëzon në rrugë të drejtë. (ESH-SSHURA, 52)**. Vërtet, Ti ndihmon të udhëzohet. Çka vërteton? Vërtetohet udhëzimi i tij. Ndërsa ajeti tjetër: **"Vërtet, ti nuk mund të udhëzosh atë të cilin ti dëshiron, por Allahu është Ai, i cili udhëzon cilindo, sepse Ai është më i dituri për të udhëzuarit". (EL KASAS, 56)**. Pra, një herë vërteton udhëzimin, herën tjetër e mohon. Dhe është ë pamundur që vërtetimi dhe mohimi të jenë në të njëjtën kohë për udhëzim. Por, udhëzimi ka dy kuptime: Udhëzim, që ka kuptimin e drejtimit, dhe udhëzim, që ka përkrahjen, sa i përket ajetit, i cili i drejtohet të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. Udhëzimi ka për qëllim orientimin, pra vërtetimin: "Pra, vërtet, ti orienton në rrugën e vërtetë". Pra, ti i orienton dhe i drejton ata në rrugën e hajrit, ndërsa a shkojnë apo nuk shkojnë, është krejt çështje tjetër; për të besuar apo për të mos besuar, është çështje krejt tjetër.

Ai i cili beson atë që ti e orienton, e pranon planprogramin e Allahut dhe dëshmon vërtetësinë e Allahut, Allahu ia lehtëson atë rrugë dhe e forcon në të. Në ajetin tjetër Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Ata të cilët janë të udhëzuar, u zgjerohet udhëzimi, forcohen në të dhe u shtojnë**

devotshmërinë". (Muhamed, 17)

Pra "udhëzimi" ka dy kuptime: E para, ka kuptimin e orientimit, apo udhëzimin në punë të mira, ose të udhëzimit. Që të dy kuptimet kanë një ndërlidhje. Kuptimi "udhëzim" në punë të mira është udhëzimi i atij, i cili beson në Allahun dhe e vërteton udhëzimin. Zoti i Lartmadhëruar për të thotë: "Përderisa më ke besuar dhe më je bindur, si dhe e ke pranuar për veten tënde planprogramin tim, Unë do të të përkrah në këtë program dhe do të mundësoj të shijosh ëmbëlsirën e tij". Pra, kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: "Sa i përket popullit Themud, ne i udhëzuam, mirëpo ata parapëlqyen verbërimin në vend të udhëzimit". Pra, ne i drejtuam, i orientuam, por ata dëshiruan humnerën, e nuk ranë dakord të tregojnë rrugën e drejtë. Pra, ata kanë thënë: "Jo, ne nuk besojmë se ka Zot dhe nuk ka për neve rrugë të drejtë. Edhe pse ata nuk besojnë se ka Zot, rruga dhe udhëzimi ekzistojnë; pra, ata nuk dëshirojnë të jenë në atë rrugë të drejtë. Është e pamundur që ata të jenë të përqëndruar në rrugë të drejtë, por mund të jetë i përqendruar ai, i cili beson, pranon dhe dëgjon. Kjo ngjason sikur të themi: më ke besuar dhe ke pranuar rrugën Time, më ke pranuar për veten tënde, e për këtë arsye unë të ndihmoj në këtë çështje. Kur ta lexosh ajetin jodefinitiv, siç është rasti me fjalën e Zotit të Lartmadhëruar: "E humb cilindo dhe udhëzon cilindo", patjetër këtë ajet duhet ta shohim si ajetin definitiv. Ne kemi thënë: na sjell të gjitha ajetet Kur'anore të udhëzimit këtu. "E humb cilindo dhe udhëzon cilin do" të gjitha janë të papërcaktuara (të padefinuara). Ndërsa, në ajetet tjera Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Allahu nuk udhëzon popullin pabesimtar". (EL BEKARE, 264)**

Si t'i përkrahim në devotshmëri ata, të cilët janë pabesimtarë? Kjo s'mund të ndodh. Ajeti tjetër: **"Allahu nuk udhëzon popullin e mbrapshtë." (EL MAIDE, 100);**

"Allahu nuk udhëzon popullin e padrejtë-kriminel." (EL BEKARE, 259)

"Vërtet, Allahu nuk udhëzon atë që është rrenacak e pabesimtar." (EZ-ZUMER, 3)

Pra, fjala "udhëzim" i Allahut ka këtë kuptim: lirimin e rrugës apo shtimin e rrugës të hajrit, por për cilin? Për atë i cili e beson Atë, e pranon atë dhe rrugën e Tij. Pra, atëherë ndihma dhe përkrahja vjen prej Allahut. Për këtë arsye: Ai i cili nuk e beson, nuk dëgjon, nuk e pranon rrugën e tij, atëherë si të përkrahet dhe si të ndihmohet ai? Nuk duhet t'i ndihmohet atij.

Nëse e sheh në Kur'an një ajet jodefinitiv dhe të tjerët definitiv, atëherë jodefinitivja bartet gjithmonë në definitiv. Pra, thuaj: "Udhëzon cilindo, kjo është e vërtetë, por cilët jan ata të cilët do Allahu t'i udhëzojë. Janë ata të cilët kanë besuar, e kanë pranuar dhe e trasojnë rrugën e tij, ndërsa ai i cili nuk beson, nuk e përkrah dhe nuk e ndihmon në rrugën e drejtë. Ndihma dhe përkrahja, pra janë për ata, të cilët i besojnë dhe pranojnë të vazhdojnë, të qëndrojnë në atë rrugë; dhe kur t'i besohet Atij, është i kënaqur në rrugën e Tij, atëherë ndihma dhe përkrahja e Allahut është mbi të.

Arsyeja për këtë është që të plotësohet liria e vullnetit, sepse për të detyruarin e Allahut nuk ka dënim. Çështja nuk është se kjo është në kundërshtim me logjikën. Ata thanë: Pasi Allahu e ka shkruar që njeriu të bëjë gabime, atëherë pse ta dënojë atë. Ne u kundërpërgjigjemi, sepse vazhdon pjesa e dytë: Nëse Allahu e ka shkruar devotshmërinë, atëherë pse të shpërblehemi? Pyetjen e dytë asnjëherë nuk e kemi dëgjuar. Gjithmonë pyetja bëhet: Pasi që Allahu e ka shkruar të bëjë gabime, pse ta dënojë atë... dhe asnjëherë nuk bëhet pyetja nëse Allahu e ka shkruar të jetë i devotshëm, pse ta shpërblejë atë: Pse? Sepse çështja është se ne vet kemi bërë padrejtësi, ndërsa e dyta jo. E, dëshirojmë që të gjejmë shpëtim dhe rrugëdalje.

KOMENTIMI SHKENCOR NË KUR'AN

Pyetja: Çka mendon Shejh Shaëraviju në lidhje me komentimin shkencor të Kur'anit?

Përgjigje: Zoti i Lartmadhëruar ka ligjësuar obligime, të cilat ndryshojnë në mendime dhe ide, për të na mbrojtur nga konfliktet e emocioneve dhe epsheve. Ndërsa, sa i përket çështjeve, të cilat i nënshtrohen fakteve dhe argumenteve, ato janë unikate. Materia është statike, ajo kurrë nuk e mashtron zbuluesin. Përfundimi se ku arrin zbuluesi është ndërhyrja në materie, pa epshe, pa emocione të brendshme dhe jashtë dëshirës së tij. Zbuluesi arrin aty e me dëshirën e tij ka depërtuar në materie, jo sipas dëshirës së tij, por sipas asaj që e kërkon vërtetësia dhe realiteti, sepse materia nuk lejon që zbuluesi të kalojë mbi atë që është faktike dhe argumentuese. Për këta arsye shohim se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka vendosur vija të prera për

muslimanët dhe atë vija të sakta. E ato vija të sakta i ka bërë kandar të këtyre argumenteve shkencore. Pra, cilat janë këto argumente shkencore?

Argumentet shkencore fillojnë prej fakteve të dukshme në gjithësi. Pastaj këto fakte nuk vazhdojnë e të jenë vetëm çështje të kaluara, por ndalen në pikën e hulumtimit dhe studimit në të; dhe nuk studiohen e hulumtohen vetëm për t'u kënaqur dhe për t'u dëfryer, por për të përfituar dhe për të sjellë dobi, pra, për të marrë atë çështje, atë argument dhe për të ngritur lart jetën. Kur'ani, kur të paraqet këtë çështje të gjithësisë, thotë:

"Sa e sa argumente ka në qiej e në tokë, të cilët i shohin, por ata nuk i vështrojnë fare".(Jusuf, 105)

Pra, sa argumente në qiell dhe në tokë kërkon Allahu nga ne që t'i shikojmë në prizmin e studimit, jo vetëm për t'i kaluar, pra kalimthi, që t'i analizojmë, t'i elaborojmë, që nëpërmjet atyre argumenteve të udhëzohemi. Ky është vështrim praktik. Në çështjet lëndore dhe praktike kurrë nuk ka kundërthënie. E, kjo do të thotë se rezultati gjithmonë është i njëjtë. Ne edhe më herët kemi thënë se nuk ka elektricitet sovjeti, e as amerikani. Nuk ka as kimi britanike e as gjermane. Çdo gjë që ka rezultuar prej zbulimeve shkencore, ka qenë çështje për të cilën të gjithë janë pajtuar. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka thënë të vërtetën, **"Dhe çka ju jep i Dërguari, merreni, e çka ju ndalon, ju largohuni". (El-Hashr, 7)**

Kur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ligjëson diçka, ai atë ligj e ka sjellë prej Allahut, ose tekstualisht ose kuptimisht, ose shpjegon ligjin e Allahut. Ndonjëherë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ligjëson nga vetvetja e tij. Kjo kuptohet nga ajeti Kur'anor: **"Dhe çka ju jep i Dërguari, merreni, e çka ju ndalon, ju largohuni". (El-Hashr, 7)**

Në lidhje me këtë çështje, Shejh Shaëraviju sjell shembull: I Dërguari i Allahut, kur shkon te beduinët, sheh se ata bënin fekondimin e hurmeve, pra ata vendosnin mashkullorët e hurmeve me femërorët e tyre. I Dërguari i pyet: Po çka jeni duke vepruar? Ata i përgjigjen: Kështu, kështu... . I Dërguari i Allahut s.a.v.s. u thotë: Mos veproni kështu, sepse edhe pa vepruar kështu do të ketë shumë fryte. Ata e dëgjojnë të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe nuk bëjnë fekondimin e hurmeve. Kur vjen sezona e fryteve, e shohin se hurmet nuk kanë fryte sikurse vitet e mëhershme. Këtë ia tregojnë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. Ndërsa i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka dashur që t'u tregojë në praktikë, duke u thënë atyre: "Ju jeni më të ditur për çështjet e jetës suaj". Çështjet praktike, faktike dhe argumentuese ju i dini, në ato çështje më nuk ka

çka të diskutohet.

Kjo është hapje e mendjes para fshehtësive të kësaj gjithësie, që të përfitojmë nga ky shembull, që me aktivitet të sjellim rezultate, por në bazë të rregullit sa më pak angazhim e më shumë rezultat. Islami me këtë dallohet. Islami nuk e dëbon dijetarin nga veprimtaria e tij, as ekspertin nga aktiviteti i tij, e as zbuluesin nga zbulimi i tij.

Kur'ani nuk cenon asgjë nga kjo apo ajo.

Nëse i bëjmë një vështrim zbulimeve, të cilat i kanë sjellë dobi kësaj bote, do të shohim se ato zbulime janë rezultat i paraqitjes së simptomave apo shenjave në gjithësi (natyrë). Parashtrohet pyetja: Si kemi arritur deri te fuqia e makinës me avull? Kemi arritur ashtu se në rend të parë është parë kjo dukuri. Është parë se është ngritur fuqia mbi masën e paraparë. Kur është hulumtuar dhe është studiuar shkaku i ngritjes apo rritjes se asaj fuqie, është vërtetuar se shkaku i shtypjes së avullit e rrit fuqinë dhe e ngrit kapakun; pra është vërtetuar se avulli ka fuqi dhe se atëherë paska mundësi që të përfitojmë nga ajo fuqi. Pra, çdo zbulim, i cili është arritur, është rezultat i paraqitjes së asaj dukurie (zbulimi) në gjithësi (natyrë). Ndërsa, Islami dhe shkenca kërkojnë që të sqarohet, të vërtetohet dhe të shfrytëzohet, që të kemi dobi. E, kjo nuk është në kundërshtim me fenë. Përkundrazi, e vërteton dhe e përforcon fenë, sepse, pasi Islami ka ardhur që program i tij të aplikohet në tërë gjithësinë, atëherë nuk është në dobi të Islamit t'i lërë pabesimtarët që t'i marrin të gjitha fshehtësitë dhe sekretet në ekzistencë, ndërsa ne besimtarët të qëndrojmë larg atyre sekreteve, të cilat sekrete i ka krijuar fuqia dhe madhështia e Allahut.

DRITA E PEJGAMERIT S.A.V.S

Zoti i Lartmadhëruar thotë: Ju ka ardhur juve prej Allahut drita dhe libri i qartë. Në këtë ajet fjala "dritë" a e ka për qëllim Pejgamberin s.a.v.s apo Kur'anin?

Pasi që pjesëza "vav" është lidhëse dhe kjo lidhëse nuk është nënrenditëse, por bashkërenditëse, që do të thotë se mund të ketë kuptim tjetër prej të parës. Nga kjo mund të kuptohet se fjala "dritë" nuk ka për

qëllim Kur'anin, i cili përmban programin dhe i cili na nxjerr nga errësira në dritë. Por, Muhamedi a.s. është dritë, ai i cili na ka treguar këtë libër (Kur'anin), e kjo na shpie deri te ajo se Muhamedi a.s. është dritë. Muhamedi a.s. para neve ka qenë materie (trup), e njerëzit nuk e kanë parë si materie ndriçuese, por si njeri të natyrshëm e të zakonshëm në përbërje fiziologjike.

Në shekullin tonë, mendja nuk e pranon këtë mendim tonin. Është e mundur që materia të japë shkëndija të ndriçuara dhe çdo shkëndi kur takohet dhe bashkohet me shkëndija të tjera, formojnë materien.

Nga ky rregull, nga ky rotacion dhe nga kjo renditje kuptohet çështja e këtij lëmi dhe e kësaj shkence, sepse Allahu i ka krijuar çështjet prej drite, e kjo do të thotë se prej shkëndijave dhe rrezatimeve të dritës së Tij ka krijuar materie.

DUAJA GJATË VIZITËS SË VARREVE

Cila është duaja, e cila buron prej thënies së Muhamedit a.s., kur të vizitohen ose kur të kalohet pranë varreve?

Ka dua të shumta, por po i përmendim dy:

"Eselamu alejkum shtëpi e besimtarëve, nuk ka dyshim se me dëshirën e Allahut edhe ne do të jemi tek ju."

"Eselamun alejkum, o banorë të varreve të besimtarëve dhe muslimanëve. Zoti na faltë neve dhe juve; ju keni ardhur këtu para nesh, e ne do të vijmë këtu pas jush".

SHTYLLAT E SHKURORËZIMIT

Cilat janë shtyllat kryesore të shkurorëzimit?

Shkurorëzimi i ka tri shtylla e ato janë:

E para: Burri, pra ai është përgjegjës dhe ka obligim ndaj asaj martese. Nuk lejohet që dikush tjetër, pos burrit të shkurorëzojë, se Muhamedi a.s. ka thënë: ***"Vërtet, shkurorëzimin e ka në dorë ai, i cili kurorëzimin e ka marrë në dorë."(TRANSMETON IBN MAXHE DHE DARUKUTNI)***

E dyta: Gruaja me akt të kurorëzimit të plotë, pra që është i plotfuqishëm, e jo akti i kurorëzimit, i cili është zhvleftësuar, ose ka qenë i plotfuqishëm, por është bërë shkurorëzimi dhe gruaja në idet as në shkurorëzim me të drejtë kthimi. Nuk pranohet shkurorëzimi i gruas, e cila s'ka çka të shkurorëzojë (pra veç është e shkurorëzuar), as e gruas, e cila veç është shkurorëzuar tri herë, ose veç është zhvlerësuese, ose veç e ka shkurorëzuar pa kontakt me të.

E treta: Formula, fjala që tregon shkurorëzim të qartë ose alegori, që është e qartë për shkurorëzim. Nijeti për shkurorëzim pa formulë, fjalë e cila tregon, nuk mjafton dhe ashtu nuk bëhet shkurorëzim.

PSE NJË VARG PEJGAMBERËSH?

Vazhdimisht janë dërguar pejgamber dhe ata gjithmonë janë ballafaquar që të vendosin të vërtetën dhe të largojnë të pavërtetën. A nuk ka mjaftuar që Allahu i Lartmadhëruar të dërgojë vetëm një pejgamber dhe vetëm një shpallje për t'i detyruar njerëzit ta dëgjojnë atë dhe t'i besojnë atij?

Imami i mirënjohur thotë: Zoti i Lartmadhëruar ka thënë : **"Nëse dëshirojmë, Ne ua zbresim atyre prej qiellit një ajet dhe të gjithë do të nënshtroheshin përnjëherë."**

Por, Allahu ka dërguar disa pejgamberë dhe ata i ka përgatitur me aso fuqie sa që askush në fytyrën e tokës nuk do të mund t'i mposhtë, si p.sh. Sulejmanin a.s.: Ai ka pasur erën, ka pasur ushtrinë e fortë edhe njerëzore, edhe xhinore. Ai ka pasur fuqi të madhe prej Allahut. Allahu ka pasur

mundësi të dërgojë pejgamberë me aso force, që njerëzit t'i nënshtrojë, ta dëgjojnë atë dhe t'i besojnë atij.

Mirëpo, Allahu nuk ka dashur ashtu.

Allahu dëshiron që atë ta dëgjojmë, atij t'i besojmë, atij t'i nënshtrohemi me dëshirë. Kjo është ajo çka e dallon njeriun prej gjallesave të tjera dhe krijesave të tjera. Dëshiron që njeriu të thotë: O Zoti im! E kam zgjedhur me dëshirë që të jem i nënshtruar tek Ti. E kam zgjedhur me dëshirë të të besojë Ty. Jam larguar nga ato që Ti i ke ndaluar, vetëm pse Ti më ke lënë të drejtë zgjedhjeje dhe liri veprimi, që pastaj shpërblimi im të jetë i madh tek Ti. Unë të besoj edhe të dëgjoj, me zgjedhjen e lirë timen.

DUAJA E PAPRANUAR

Të gjithë e dimë se Zoti i Lartmadhëruar ia ka pranuar duanë kur është lutur: "Më jep rast dhe leje deri në ditën e ringjalljes". E Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë: "Vërtet ty do të jap rast dhe leje."

Shumica e njerëzve pyesin "Ne bëjmë dua te Allahu gjithmonë, ditë e natë dhe nuk na pranohet duaja. Cila është arsyeja e mospranimit të duasë?

Përgjigje: Allahu i Lartmadhëruar automatikisht i përgjigjet duasë për të mirën e robit të besimtarëve, ndërsa si na është pranuar, ne nuk e dimë dhe atë askush nuk e di, pos Zotit të Lartmadhëruar. Për këtë arsye nuk është mirë për ne që të gjykojmë për të ardhmen.

Ti ndoshta kërkon diçka, që për ty do të ishte dëm i madh, edhe pse në shikim të parë duket e dobishme. Ndoshta ne kërkojmë pasuri, por kjo pasuri do të na shkatërronte dhe do të na largonte prej Allahut, do të na bënte të jemi kryelartë dhe kriminelë, e kjo atëherë do të ishte humbje e vërtetë. Ndërkaq, Allahu dëshiron të na ruajë neve dhe të na shpërblejë në botën tjetër, për të na begatuar me të mira të pakufishme, e këto janë pranimi dhe mëshira e Zotit të Lartmadhëruar. Të vërtetën e ka folur Zoti i Lartmadhëruar, kur ka thënë: **"Dhe ju ndoshta urreni diçka, por ajo është e dobishme"**.

Zoti e di, e ju nuk e dini. Njerëzit shohin pjesët e jashtme të kësaj bote dhe nuk i shikojnë gjërat e brendshme të saj. Zoti i Lartmadhëruar me diturinë e përhershme, nëse është e dobishme, të përgjigjet menjëherë, e nëse e sheh të dëmshme, e vonon.

ZËVENDËSIMI I BURRIT NË GJUAJTJEN E GURALECAVE

Pyetje: Bashkëshortja ime ka qenë në haxh me mua. Për shkak të turmës së madhe a më lejohet që unë t'i gjuaj guralecët për të?

Përgjigje: Lejohet që t'i gjuash guralecët për bashkëshorten tënde, edhe nëse nuk ka turmë të madhe.

FETAVATË E SHAËRAVIJUT

PJESA E SHTATË

VII

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

Kaçanik, 2015

HYRJE

Falënderojmë Allahun, Krijuesin e gjithësisë. Nuk ka Zot tjetër pos Allahut, nuk mund të ndryshojë askush asgjë, përpos fuqisë së Allahut, dhe ne vetëm Allahut i mbështetemi.

Dhe ...

Përderisa gozhda fundoset në ujë, e kundërta: anija lundron mbi sipërfaqen e ujit, e cila në vete i mban mijëra e mijëra gozhda. Po, si është e mundur të fundoset gozhda e vogël në ujë, e anija e madhe jo, pra ajo plot e përplot gozhda nuk fundoset?!

Me këtë shembull i jepet përgjigjja lexueses muslimane, e cila ka pyetur: Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: ***"Çdo grua, e cila parfumohet, e pastaj del para një populli që ta ndiejnë erën e saj, ajo është prostitutë dhe çdo shikim është (vepër) prostitucion në vete". (Hakimi)***

Vajza muslimane pyet: Përderisa vajza apo gruaja muslimane e nxit epshin e mashkullit, unë pyes: Po mashkulli i parfumuar a nuk e nxit epshin e femrës?

Ne i themi: Femra e ka të ndaluar ta zbulojë trupin e saj për meshkuj, përpos para burrit të saj në shtëpinë e saj, sepse prostitucion do të thotë akt imoral jashtëmartesor, për t'i tërhequr zemrat e meshkujve dhe për t'i nxitur epshet e tyre.

Hulumtimet psikologjike kanë vërtetuar se femra është më e ndjeshme dhe shumë vështirë e ka t'i sundojë emocionet e saj, përkundër mashkullit, i cili më me lehtësi i udhëheq epshet e tij. Kështu që, ai i ka ndjenjat e tij më shumë nën kontroll. Femra ka mundësi të prodhojë dashuri artificiale, ajo mund të aktrojë para personit me pasion të sinqertë. Ndërsa, mashkulli vështirë e ka dhe nuk mund të aktrojë para pasioneve të sinqerta. Aktrimi i tij paraqet shenjat në fytyrën e tij, në të folurit e tij. Femra, ndërkaq, mund të paraqitet me dashuri të flakët, por në brendësi mund të jetë e kundërta.

Nga kjo konkludohet se mashkulli apo djali i parfumuar nuk ndikon te femra, ashtu siç ndikon femra e parfumuar te mashkulli.

Vështirë është të depërtohet në thellësinë e zemrës së femrës, mirëpo zemrat e meshkujve janë më të sinqerta. Nga kjo shohim se Kur'ani në ajetin e prostitucionit, në rend të parë, e përshkruan femrën, e pastaj mashkullin, përderisa në ajetet tjera mashkulli përshkruhet para femrave. Në suretun-Nurë Zoti i Lartmadhëruar thotë: ***"Laviren dhe Lavirin t'i rrihni secilin prej***

tyre me nga njëqind të rëna dhe në zbatimin e dispozitave të Allahut mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre dyve, nëse jeni që i besoni Allahut dhe botës tjetër. E, gjatë zbatimit të ndëshkimit ndaj tyre, le të jenë të pranishëm një numër besimtarësh". (En-Nurë, 2)

Po ashtu, në suretun-Nurë, Zoti i Lartmadhëruar thotë: ***"Të këqijat (gratë) janë për të këqijtë (meshkuj) dhe të këqijtë janë për të këqijat. Të mirat (të ndershmet) për të mirët (të ndershmit), të mirët (të ndershmit) për të mirat (të ndershmet)". (En-Nurë, 26)***

Nga të parët tanë është vërtetuar se femra asnjëherë nuk mund të bëjë prostitucion pa dëshirën e saj dhe pa pëlqimin e saj, ndërsa burri vështirë e ka që të kontaktojë seksualisht pa dëshirën e tij, edhe kur është i detyruar.

XHINËT DHE MAGJIA

Pyetje: A mund të pengojë xhini njeriun për të kryer marrëdhënie seksuale me gruan e tij? Dhe në ato raste a duhet shkuar te falltarët për ta çliruar nyjen e pengesës?

Përgjigjja: Po, e gjithë kjo është e mundur. Magjia është e vërtetë dhe e vërteta e xhinëve në ndikimin e një gjëje të tillë është realitet. Allahu i Lartmadhëruar i jep disa veçori dhe specifika, sa që xhinët e llojit më të ulët të jenë të nënshtruar dhe të kontrolluar prej llojit të xhinëve të kategorisë më të lartë. Prej këtyre veçorive është që njeriu ta ketë në përkujdesje atë lloj xhini, ashtu që xhini ka mundësi që kur femra të jetë e bukur, ai të figurohet në trupin e saj si e keqe, e shëmtuar dhe e trishtuar; pra ai bëhet mbulesë e bukurisë së saj dhe shndërrohet në formën më të keqe, sa që bukuria e saj në sy të burrit bëhet si të jetë majmun para tij.

Mund të ndodhë edhe e kundërta, sa që në një grua e zakonshme të shndërrohet e të duket si grua shumë e bukur, e dashur dhe ai ta dojë aq shumë, sa që t'i duket mbretëreshë e bukurisë.

Dhe kështu, kur të martohet një burrë me një grua, ai mund të ndikojë në ftohjen e marrëdhënies seksuale.

Të gjitha këto janë vetëm rrugët se si ndikon dhe si formëson xhini. Unë gjithmonë këshilloj për të mos shkuar te falltarët për t'i çliruar nyjet e magjisë, por, burri le të këndojë te gruaja e tij "Kul huvall- llahun", "Kul eudhu birabbil felek", "Kul eudhu birabbin nas". Kështu, ai sigurohet nga lajka e shejtanit, e largon atë me lejen e Allahut dhe atëherë xhini nuk mund të ndikojë në asgjë të keqe.

PASI QË RIZKU-FURNIZIMI ËSHTË I CAKTUAR, PSE TË PUNOHET?

Pyetje: Disa thonë: "Pasi që rizku-furnizimi është i caktuar, përse ta lodhi veten sa i përket çështjes së rizkut-furnizimit? Çka mendon Imami i nderuar për këtë?

Përgjigjja: I nderuari Shejh Shaëraviju thotë: "Ajo çka i ndodhë njeriut në jetë, është dy llojesh:

Lloji i parë është ajo çka i vjen nga jashtë; aty është Kaderi-caktimi i Allahut. Nuk mund të pengohet apo të kontrollohet, si p.sh. kur njeriu është në fabrikë ose në ndonjë vend të caktuar dhe pastaj e humb punën, pasi që fabrika bankroton, ose e bën reduktimin e punëtorëve; ose p.sh. kur njeriut i ndodhin me dhjetëra ngjarje në ditë, të cilat janë larg dëshirës së tij dhe nuk mund t'u ikën atyre ngjarjeve.

Përpos kësaj, është pjesa e zgjedhjes aty ku njeriu vepron me dëshirën e tij, aty ku Zoti i Lartmadhëruar i ka vendosur rregullat dhe ligjet. Ai, i cili punon, arrin frytin e punës së tij. Për çdo punë, veprim dhe angazhim shpërblehesh ose paguhesh. Pra, rizku-furnizimi gjendet në tokë. Mirëpo, çështja është se a vjen te ti në tërësi. Si p.sh. ti blen harxhin mujor për shtëpinë tënde, e vendos në vendin e posaçëm dhe në frigorifer, pra furnizimi gjendet në shtëpinë tënde. Të gjitha llojet e ushqimit dhe të gjitha elementet janë të sistemuar dhe janë nën kompetencën tënde. Ata, të cilët thonë "i mbështetemi Zotit (tevekkelna)" dhe rizkut ia japin po këtë kuptim, mu ata janë të cilët dëshirojnë të ikin nga çdo punë e vështirë dhe e mundimshme; ndërkaq, nëse është puna e lehtë, pa lodhje dhe pa ndonjë vështirësi, atëherë nuk besojnë në "Tevekkul – mbështetje në Zotin", ata e ngritin veten e tyre aq lart, sa mundohen që t'i ikin çdo lodhjeje, çdo mundimi; ai mbështetet te Zoti "jetevekkel", derisa të arrijë furnizimi (rizku) te ai. Por, derisa të vendoset ushqimi para tyre, ata e harrojnë menjëherë se çka kanë thënë më herët dhe menjëherë fillojnë pa hezitim ta marrin ushqimin. Pra, ata me të shpejtë dhe me angazhim e marrin ushqimin, derisa të ngopen. E pse pra nuk mbështeten te Zoti "jetevekkelune" derisa të hyjë ushqimi vetë në fytin dhe barkun e tyre pa angazhimin e tyre? Pse nuk pret që ushqimi t'u afrohet dhe të hyjë në gojën e tyre, të futet në bark, derisa të mbushen barqet e tyre? Pra, ata janë mbështetur në ato çështje, për të cilat nevojitet mund dhe angazhim, ndërsa në

çështjet, të cilat janë të lezetshme, të shijshme dhe të gatshme ti nuk ke bërë "tevekkul – mbështetje te Zoti". Po të kishe qenë i sinqertë në atë që thua, pse nuk ke bërë "tevekkul-mbështetje", kur të është vendosur ushqimi para teje, të kishe vazhduar të qëndrosh ulur pa lëvizur dhe ta kishe pritur për të ardhur ushqimi në gojë.

Nga këtu shohim se Allahu i Lartmadhëruar na i ka mundësuar të gjitha kushtet dhe rrethanat e furnizimit në tokë, saktësisht ashtu siç i thotë pronari i shtëpisë punëtores apo përgjegjëses: Për një muaj çdo gjë që të nevojitet e keni në depo, ndërsa tjetër është çështja se ajo nuk dëshiron ta lodhë veten dhe ta përgatitë ushqimin.

Kështu thotë edhe fjala e urtë: "Pjesët organike të trupit punojnë, ndërsa zemrat mbështeten". Mbështetja është cilësi e zemrave dhe nuk është cilësi e pjesëve organike, sepse prej pjesëve të trupit kërkohet të veprohet.

Shejh Shaëravijun në shumë raste e kam dëgjuar duke thënë me urtësi: "Rizku (furnizimi) që të takon ty si në pasuri, ashtu edhe në reputacion, e di më mirë se ti vendin se ku do të jesh në të ardhmen". Kjo fjalë e urtë, të cilën e ka thënë Imami, ka domethënie të rëndësishme, është fjalë që shkëlqen dhe udhëzon, është fjalë, e cila bën që njeriu të kuptojë dhe të angazhohet për rizkun (furnizimin) e tij, por jo të hezitojë, të ngutet, të shikojë për të përshpejtuar diçka, sepse rizku (furnizimi) është i përcaktuar dhe i emëruar në adresë të caktuar dhe nuk mund të kalojë në adresë të tjetërkujt.

Imami i mirënjohur komenton ajetin e Zotit të Lartmadhëruar: "Dhe në qiell është furnizimi i juaj dhe ajo çka u është premtuar". Zoti i Lartmadhëruar çështjen e rizkut e ka lënë në qiell, ashtu që njerëzit të mos jenë në gjendje të arrijnë atje. Pra, kuptimi i ajetit është: Oj krijesë, furnizimi yt është në qiell, atje ku duart tua nuk mund të arrijnë, mirëpo duhet të punosh, të mundohesh, të angazhohesh e të lodhesh që të vijë furnizimi yt, të cilin e ka caktuar Zoti për ty. Pjesa e ajetit "furnizimi juaj" na vërteton qartë se fjala "ku furnizimi" është i ndarë dhe i përkufizuar posaçërisht për ju dhe se furnizimi i njeriut është i premtuar për angazhuesin dhe punuesin dhe për atë, i cili aktivizohet, vepron dhe nuk duhet të qëndrojë i ngurtë para rrethanave dhe peripecive të ndryshme.

DREJTËSIA E VËRTËTË

Gjatë historisë njerëzore, pra edhe sot, e vërteta dhe e drejta në mes njerëzve nuk realizohet, gjë që është vështirë që njeriu të ketë qetësi. Pra, a na tregon ç'është drejtësia njerëzore?

Përgjigje: Drejtësia e vërtetë është ajo, të cilën na e ka obliguar Allahu neve. Drejtësia nuk është tipar, të cilin i drejti e bën me vetëdëshirë. Me drejtësi nënkuptohet kur i drejti i përmbahet kandarit të Tjetrit, i cili e ka vendosur atë në peshojë, e Ai është Allahu i Lartmadhëruar. I Drejti nuk është ai, i cili me vullnet dhe sipas dëshirës së tij praktikon atë që e parasheh, por praktikimin e asaj çka e ka përcaktuar dhe e ka vendosur Krijuesi. Për këtë arsye kam thënë dhe them se specifika e besimit nuk është ajo që ti ose unë vazhdimisht të gjykojmë për veten tonë, por unë dhe ti të jemi të gjykuar prej Allahut për veten tonë.

PROBLEMI MJEKËSOR I MASTURBIMIT (VETËKËNAQËSIA)

Masturbimi a është hallall apo haram? Dhe vajza apo djali i cili bën një veprim të tillë, a e kaplon sëmundja apo paaftësia, siç thonë disa prej njerëzve, dhe nëse teprohet a është e dëmshme për organizmin, pra për pjesët e tjera të trupit?

Përgjigjja:

Masturbimi është edukatë e keqe, kur të rinjtë dhe të rejat, pra në kohën e pubertetit, e bëjnë një gjë të tillë, për shkak të ndikimit të hormoneve seksuale, të cilat janë tepër aktiv në trupin e njeriut.

Ndoshta dëshira e madhe për seks shtohet për shkak të shtimit të këtyre hormoneve, në njërën anë, dhe ndalesa fetare për lirimin e tyre të paligjshëm e shtyjnë që ato patjetër të lirohen prej vendit të tyre ku tubohen dhe shtohen. Kjo është një gjë që zakonisht përhapet, mirëpo i riu dhe e reja janë tepër nervoz, të ciët e teprojnë në të gjitha lëvizjet e jetës së tyre.

E kemi për detyrë të themi se masturbimi nuk shkakton ndonjë sëmundje në organizëm, por është një traditë e keqe, ves i keq dhe zakonisht paraqitet tek ata të cilët kanë kohë të lirë dhe nuk kanë kurrfarë përgjegjësie

në jetë.

Nuk është e vërtetë se masturbimi verbëron njeriun, apo se e bën njeriun të paaftë. Ky është një hiporbolizim.

Largimi prej një veprimi të tillë bëhet duke e angazhuar me diçka, duke agjëruar, duke lexuar Kur'an, deri sa të plotësohen kushtet e martesës dhe ky është ilaçi natyror i këtij problemi.

PASTRIMI I NDËRSJELLTË BASHKËSHORTOR

A lejohet që gruaja ta pastrojë burrin e saj?

Përgjigjja: Ajsha r.a Transmeton se: ***Është kthyer i dërguari i Allahut s.a.v.s nga një përcjellje kufome, ndërsa kishte kokëdhimbje, e i ka thënë: më dhemb koka. I Dërguari i Allahut më tha: Po edhe mua po më dhemb koka, por çka mendon sikur ti të vdesësh para meje, e unë të të pastroj, të të mbështjell me kefin, e pastaj të ta fali namazin e xhenazes dhe të të varrosi?!(TRANSMETON AHMEDI)***

Hadithi tregon se gruaja e pastron burrin e saj, kur ai vdes, ndërsa analog me këtë edhe e kundërta (burri e pastron gruan). Transmetohet se Esma e ka pastruar Ebu Bekrin, e po ashtu, edhe Fatimja e ka pastruar Aliun. Zoti i pastë nderuar! Kjo është dëshmia se ky është argument unanim (IXHMAI), sepse asnjëri prej sahabëve nuk e ka kundërshtuar veprimin e tyre.

PËRGOJIMI

Pyetje: Çka është përgojimi dhe a është e vërtetë se të përgojosh mëkatarin e madh (FASIKUN) nuk është mëkat?

Përgjigje: Muhamedi a.s. ka thënë: ***"A e dini se ç'është përgojimi? Por, askush nuk e di më së miri se Allahu dhe i Dërguari i Tij. Pastaj, Muhamedi a.s. ka thënë "Përgojimi është t'ia përmendësh emrin vëllait tënd për atë që ai nuk dëshiron"***

I kanë thënë: Po nëse është e vërtetë atë çka ka vepruar vëllai im? Është përgjigjur: Nëse është e vërtetë atë që e thua, mu ajo është përgojim, po nëse nuk është e vërtetë, atëherë ti ke shpifur për të". E KA TRANSMETU AHMEDI

Po ashtu, është transmetuar se një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s: ***"Çka është përgojimi?". Me atë rast është përgjigjur: T'ia përmendësh emrin vëllait tënd për atë që ai nuk dëshiron ta dëgjojë" Po, o i Dërguari i Allahut edhe nëse është e vërtetë atë që e them?" Ka thënë: Nëse e thua jo të vërtetën, ti veç ke shpifur për të. (TRANSMETON AHMEDI DHE MALIKU)***

HAXHI I GRUAS PA LEJEN E BURRIT TË SAJ

A lejohet që gruaja ta kryejë haxhin pa pëlqimin dhe pa lejen e burrit të saj?

Nuk është e pëlqyeshme që gruaja të kërkojë leje prej burrit të saj për kryerjen e haxhit farz. Por, edhe nëse e pyet dhe e lejon, e kryen haxhin, sepse burri nuk ka të drejtë ta ndalojë apo ta pengojë gruan e tij për ta kryer haxhin farz, sepse haxhi është ibadet, i cili është bërë obligim për të, dhe nuk lejohet të dëgjohet krijesa për të mëkatuar ndaj Krijuesit.

Ajo duhet që sa më shpejt të kryejë obligimin, që të lirohet nga obligimi i saj, sikur ajo që e fal namazin në fillim të kohës, e ai nuk ka të drejtë ta ndalojë. Kështu vepron edhe me rastin e haxhit të përbetimit. Ndërsa, sa i përket haxhit vullnetar, ai ka të drejtë ta pengojë.

E KANË PARË KUR'ANIN DHE NUK I KANË BESUAR

Si i ka luftuar Kur'ani zemrat e pabesimtarëve, edhe përkundër asaj që ata nuk e kanë besuar prej mllefit dhe kryelartësisë së tyre?

Imami i nderuar Shaëraviju thotë:

Arabët e parë që në fillim e kanë pranuar këtë çështje, por jo pse e kanë dashur, as për atë se është natyrshmëri që ata, deshën apo nuk deshën, ta pranojnë, por nga shkaku se ata e kanë pranuar Kur'anin, duke u arsyetuar vetëm në atë se përse Kur'ani i ka zbritur Muhamedit s.a.v.s., e që, sipas mendimit të tyre, ai është njeriu i gabuar për t'i zbritur Kur'ani. Këtë e tregon Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an, kur thotë: **"Dhe sikur t'i kishte zbritur ky Kur'an një njeriu prej vendeve me famë".(EZ-ZUHRUF, 21)**

Pra, ata nuk e kanë kundërshtuar Kur'anin si libër, sepse atyre në mendje dhe gjokset e tyre u ka arritur, mirëpo kundërshtimi qëndron në atë se përse i ka zbritur këtij pejgamberi (Muhamedit a.s.). Pra, ata e kanë ndryshuar esencën e temës, sepse tema ka qenë se Kur'ani ka kërkuar kundërargument. Mirëpo, kundërshtimi i tyre nuk ka qenë në vetë Kur'anin, por në atë, të cilit i është zbritur Kur'ani. Për këtë arsye ne shohim se ata hamenden dhe ndonjëherë thonë: Është magji. Thonë: Gjithsesi magji është. Ne u themi atyre : I magjepsuri a ka të drejtë zgjedhjeje prej magjistarit? Kur një magjistar dëshiron të magjepsë njeriun, a mund ta refuzojë i magjepsuri atë magji? Por, nëse e ka magjeps një popull (një pjesë të njerëzve), pse nuk ju ka magjepsur juve, o ju, kundërshtarë? Me këtë argumentojmë se Kur'ani nuk është magji, sepse po të kishte qenë magji, do t'ju kishte magjepsur juve.

Ndonjëherë thonë: Është poezi. Ne u themi atyre: bëni një krahasim në mes të metodikës së Kur'anit dhe metodikës poetike. Ju, pra, keni njohuri për këtë çështje, a është Kur'ani prej llojit të poezisë?

Ndonjëherë thonë se është iluzion. Ne u themi: bëni krahasimin e iluzionit dhe Kur'anit. Vetëm se Kur'ani kur t'i paraqetë këto çështje, i paraqet me argumente bindëse, të cilat argumente bindin shpirtin e pastër dhe natyror, ku thotë:

"Nuk është fjalë (thurje) poeti, pak po besojnë, as thënie iluzionisti (magjistari), pak po logjikojnë."(EL-HAKATU, 41,42)

DITA E MARTË DHE DITA E ENJTE

Cila është vlera e agjërimit të ditës së martë dhe e ditës së enjte dhe pse i ka specifikuar i Dërguari i Allahut s.a.v.s.?

Përgjigje: Kur është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s për agjërimin e ditës së martë, ai është përgjigjur: **"Është dita, në të cilën kam lindur dhe në të cilën më ka zbritur Kur'ani".(E KA REGJISTRU AHMEDI)**

I ka thënë Usame r.a të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: ***"O i Dërguari i Allahut, ti po agjëron aq shumë sa po mendojmë se nuk do ta ndërpresësh asnjëherë agjërimin; dhe, po ashtu, nuk po agjëron sa po mendojmë se asnjëherë nuk do të agjërosh, pos dy ditëve që ti gjithnjë po i agjëron. Po cilat janë ato dy ditë? Tha: Dita e martë dhe dita e enjte.Tha: Këto dy ditë janë ditët, në të cilat i paraqiten Allahut, Krijuesit të botëve, veprat tona, ndërsa unë dëshiroj që veprat e mia t'i paraqiten Allahut duke qenë agjerueshëm. (E KA REGJISTRU AHMEDI).***

SHKURTIMI I FLOKËVE TË FEMRAVE

A lejohet femra t'i shkurtojë flokët e saj?

Është e ndaluar që femra të rruajë kokën e saj në bazë të thënies së Aliut r.a.: E ka ndaluar i Dërguari i Allahut s.a.v.s. që femra ta rruajë kokën e saj." TRANSMETON NESAIJU DHE TERMIDHIU.

Kjo nga shkaku se të rruarit e kokës i ngjason mashkullit dhe kalon prej suazës femërore në atë mashkullore dhe në shëmtim të natyrshmërisë së saj; e kjo është haram, ashtu siç e transmeton Ibn Abasi se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë***: I ka mallkuar Allahu përgjasuesit e meshkujve në femra dhe përgjasueset e femrave në meshkuj". (TRANSMETOJNË TË PESTËT POS MUSLIMIT)***

Mirëpo, nëse paraqitet infektimi prej insekteve e të ngjashme dhe i dobësohet lëkura nga mosshkurtimi apo mosrruarja e saj, kjo është domosdoshmëri, e cila e lejon shkurtimin e flokëve të saj, ashtu siç transmetohet në koleksionin e Ahmedit se kur është pyetur për femrën, e cila nuk ka mund të shërojë kokën e saj pa i shkurtuar flokët. Kur e ka pyetur:

pse? Ka marrë përgjigje se nuk mund të depërtojë yndyra në lëkurën e saj. Ka thënë: "Nëse është domosdoshmëri, shpresoj se nuk ka ndonjë pengesë, dhe nuk është keq".

ÇKA KA PARË I DËRGUARI I ALLAHUT NATËN E ISRASË DHE MIRAXHIT

Çka ka parë i Dërguari i Allahut s.a.v.s natën e miraxhit dhe cilat janë argumentet, si p.sh. pirjen e qumështit dhe mospirjen e alkoolit, dhe se a ka ndonjë lidhje kjo dukuri me çështjen obligative?

I nderuari, Muhamed Muteveli Sheëraviju, thotë:

Kanë thënë se: mendja është ekzekutiv i obligimeve të pranuara prej Allahut, ndërsa alkooli është dehje e mendjes, sepse Allahu detyrat ia obligon mendjes, e cila i pranon obligimet; sepse për të çmendurin nuk ka çështje obligative, ngaqë mjeti, i cili ka të drejtë zgjedhjeje, është paralizuar; sepse mendja është ajo, e cila zgjedh në mes sendeve. E, nëse është çështje për diçka që nuk ka të drejtë zgjedhjeje, atëherë mendja aty nuk ka çka të kërkojë; dhe derisa ekziston çështja e zgjedhjes në mes të dy sendeve, atëherë ajo patjetër duhet të jetë mendja e shëndoshë dhe vaga e drejtë, dhe sikur që njeriu të përdorte alkoolin do ta prishte këtë begati të madhe, pranimin e besimit në Allahun dhe që në fazën e parë ka dashtë Allahu me thënë: natyrshmëria është e pastër dhe e shëndoshë dhe atë e prishë veprimtaria e juaj. Qumështin të cilin e ka pirë Pejgameri s.a.v.s. dhe nuk ka pirë alkool, është se qumështi është burim (lëndë) i natyrshmërisë, ndërsa ju alkoolin e keni prishur, sepse ju e prodhoni, pra me duart tuaja keni ndërhyrë dhe keni përpunuar atë. Pasi ka qenë begati e pastër, ju e keni bërë të ndotur dhe e shpini te ekzekutivi i obligimit te Allahut, pra tek mendja. Për këtë arsye begatia e madhe është kthyer kundër jush.

Kjo ka qenë çështja e parë, të cilën e ka parë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. natën e miraxhit. Pas kësaj vjen faza e dytë, ku i Dërguari i Allahut s.a.v.s. sheh një popull, i cili aty mbillte, aty menjëherë e mblidhte dhe kjo përsëritej vazhdimisht. E ka pyetur Xhibrilin se kush ishin ata? I është përgjigjur: Këta janë luftëtarë në rrugën e Allahut. Lufta në rrugën e Allahut

është përkushtimi dhe angazhimi në thirrjen e Pejgamerit, i cili ka zbritur prej Allahut te njerëzit për t'i udhëzuar në atë rrugë. Andaj, këta luftëtarë në rrugë të Allahut patjetër duhet të kenë fryte të llojllojshme. Po pse fryte të llojllojshme? Sepse ata angazhohen me pasuri të tyre, me shpirtra të tyre. E premtimi i Allahut është harmonik me shpërblimin në bazë të punës dhe të angazhimit, e kjo do të thotë shpërblim i vazhdueshëm. Dhe, çdo herë kur të luftosh në rrugën e Allahut, e prej aty përhapet feja e Allahut, ti do të kesh shpërblim të vazhdueshëm.

Pra, këtë e ka parë i Dërguari i Allahut s.a.v.s për të sqaruar të vërtetën e muxhahidinëve dhe shpërblimin e tyre: ***"Dhe çka do të shpenzoni, qoftë ai i vogël, shpërblimi pason."***

Pas kësaj faze Allahu i Lartmadhëruar i paraqet një pasqyrë tjetër të botës me një grua plakë të mbushur me stoli. E, kur e ka pyetur Xhibrilin: Çka është kjo? Ai i është përgjigjur: Nuk ka mbetur prej botës më shumë se sa i ka mbetur kësaj plake. Me këtë Muhamedi a.s. sikur ka dashur të thotë: Unë e kjo botë do të jemi sikur jeta e kësaj plake, pra sa ka mbetur nga jeta e kësaj plake, aq ka mbetur edhe koha deri në ditën e kiametit. Pasi që kësaj plake i ka mbetur shumë pak kohë, mos u angazhoni shumë në të. Jepi rëndësi aq sa ke për të jetuar në të. Duhet punuar për këtë botë aq sa ke për të jetuar në të. Të mirat në këtë botë janë të kufizuara brenda kufijve të mundësive të mia, mirëpo në botën tjetër nuk janë të përkufizuara, sepse aty është mundësia dhe fuqia e Allahut.

Çështje tjetër çka ka parë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. është se ka parë njerëz të cilëve me gërshërë ua prenin buzët dhe gjuhët e tyre. Pse? Sepse buzët dhe gjuha janë mjete komunikimi. E, kur e ka pyetur "Kush janë këta, o Xhibril?", ai është përgjigjur: "Këta janë ligjëruesit e përfituesve material. Janë ata, të cilët thonë atë që nuk veprojnë. Fjalët e tyre janë më të ëmbla se mjalta, ndërsa veprat më të hidhura se e hidhura e rrënjëve, sepse shkaktojnë fitne; sepse për ato mendohet se janë thirrës, ndërsa ata janë ligjërues apo, më mirë të themi, shkaktues të fitneve." Ata me të vërtetë flasin dhe njerëzit i dëgjojnë, por veprimtaria e tyre është në kundërshtim me fjalët e tyre. Atëherë, njerëzit i krahasojnë fjalët me veprën e tyre dhe kuptojnë se fjala flitet, e vepra veprohet dhe, kur të jetë në kundërshtim me sjelljet, atëherë çdo gjë çrregullohet.

Pastaj, Imami i nderuar thotë: Këto janë disa çështje, të cilat i ka parë i Dërguari i Allahut .s.a.v.s., ku Muhamedi a.s është takuar me pejgamerët, ku

shumica e tyre kanë qenë prej beni Israilit. Në atë natë është bërë obligim namazi. Shejh Shaëraviju tregon urtësinë dhe arsyen e shikimit të këtyre çështjeve. Është një mjet prej mjeteve sqaruese për disa çështje të rëndësishme, të cilat kanë të bëjnë me thirrjen islame, e pas kësaj vijojnë çështjet tjera, të cilat kanë të bëjnë me pasurinë, nderin dhe fjalët.

Ajo çka ka të bëjë me pasurinë, Allahu i Lartmadhëruar ia ka paraqitur të Dërguarit të Allahut s.a.v.s një popull, i cili nxitonte mbi lum me gjak, e pastaj gjuheshin me gurë. Për këtë popull e ka pyetur Xhibrilin: "Po kush janë këta"? I është përgjigjur: "Ushqyesit me mjete të kamatës".

Pastaj, pasqyrimi i nderit. Është interesant se përgojimi, i cili i është paraqitur të Dërguarit të Allahut s.a.v.s, është paraqitur në tri forma: Njëherë e ka parë një popull me thonj të hekurt, të cilët i shqyenin fytyrat e tyre. Kur ka pyetur për ta, ka marrë përgjigje se ata janë njerëz që përgojojnë të tjerët. Ka parë edhe formën tjetër, ku ata merrnin mishin e njerëzve dhe e hanin. Herën tjetër ka parë duke marrë mishin e njerëzve të vdekur dhe duke e ngrënë. I është paraqitur në tri forma, për shkak të krimit të madh të përgojimit.

Pastaj, Zoti i Lartmadhëruar ka paraqitur një pasqyrë tjetër, e ajo është prostitucioni në formën më të egër. Ka parë një popull, i cili para vetes kishte mish të pastër dhe nuk e hante atë mish të mirë, por shkonte e hante mishin e ndotur, të përlyer dhe jo të pastër. Kur ka pyetur për këtë, ka marrë përgjigje: "Njeriu, i cili e ka gruan e tij hallall për kontributin seksual, e lë atë dhe shkon te gruaja e huaj, e pastaj kontakton me të, të cilën e ka haram; ose gruaja, e cila ka burrin, që në kontakt me të e ka hallall, ndërsa shkon me burrë të huaj, të cilin e ka haram."

Sa i përket fjalëve, edhe për të ka parë Muhamedi a.s. .

Pra, ka parë një lopë të madhe, e cila del prej një vrime dhe dëshiron të hyjë prapë në atë vrimë, por nuk mundet. Kur i Dërguari i Allahut s.a.v.s ka pyetur për këtë, ka marrë përgjigje: "Kjo është sikur një njeri që e thotë një fjalë, pastaj dëshiron ta kthejë mbrapa, por nuk mundet".

Pas kësaj Muhamedi a.s. ka parë diçka tjetër: Ka parë një njeri, i cili ka një barrë të rëndë në shpinën e tij që nuk mund ta bartë, mirëpo kësaj radhe e zgjat dorën për të marrë edhe një barrë tjetër për ta vendosur në kraharorin e tij. Kur ka pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. për këtë, ka marrë përgjigje: "Janë ata, të cilët marrin detyra me përgjegjësi (emanete), e janë të paaftë t'i kryejnë ato. Edhe përkundër kësaj, ata dëshirojnë përgjegjësi tjera e emanete

tjera”.

Të gjitha këto ndodhi, të cilat i ka parë i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe sqarimet e atyre ndodhive, janë që besimtari t’i kuptojë ose t’i dënojë ata, të cilët veprojnë ashtu, në formën më të egër, dhe t’i largojë sa më parë ato dukuri negative. Prej ndodhive që ka parë i Dërguari i Allahut s.a.v.s është se ka parë një popull, kokat ë të cilëve copëtoheshin me gurë dhe sa herë që copëtoheshin, ktheheshin në gjendjen e mëparshme; pastaj u bihej me gurë dhe prapë copëtoheshin kokat. Kur ka pyetur: “Kush janë këta, o Xhibril”? Merr përgjigje: Këta janë mosfalësit e namazit. E vërteta, përse copëtoheshin kokat e tyre, është se namazi është proces i mendjes; kur ta përqendrojë njeriu mendjen për t’u falë, ai falet pa marrë parasysh kushtet, rrethanat dhe angazhimin e tij.

Pas obligimit të namazit për Umetin e Muhamedit s.a.v.s. Muhamedi a.s shkon e takohet me Musa a.s. për t'u lehtësuar namazi, deri sa mbetet në pesë kohë. E tëra tregon për vlerën dhe rëndësinë që ka namazi.

ZËRI I FEMRËS

A është zëri i femrës turpëri?

Zëri i femrës nuk është turpëri e pjesës së turpshme të saj, vetëm nëse ka për qëllim që me zërin e saj të hollë të tërheqë, të përfitojë dhe të joshë njerëzit, sepse me hollimin e zërit të saj i traumatizon burrat, pra kur aktron për së tepërmi, e për këtë kemi argument fjalën e Zotit të Lartmadhëruar:

“Dhe të mos e keqpërdorin zërin e tyre me fjalë, ashtu që ai, i cili e ka zemrën e sëmurë, të lakmojë në të.” (EL-AHZAB, 32)

Në fikhun e katër medhhebeve thuhet:

Zëri i femrës nuk është turpëri, sepse gratë e pejgamberit kanë folur dhe kanë biseduar me sahabët, e sahabët i kanë dëgjuar ato dhe prej tyre kanë mësuar fenë.

Mirëpo, është haram të dëgjosh zërin e saj, nëse njeriu frikësohet se mos po traumatizohet, edhe me lexim të Kur'anit prej saj. Gruaja ka qenë ajo që ka polemizuar me Emirin e besimtarëve, Omer Ibn Hatabin r.a., kur ka dashur ta përkufizojë “MEHRIN” dhe ia ka treguar ajetin Kur'anor: **“Dhe, në**

qoftë se doni të merrni ndonjë grua tjetër, në vend të asaj që keni (por keni vendosur ta lëshoni), dhe i keni dhënë pasuri të papërcaktuar (KINTAR) si mehr, mos i merrni asaj aspak."(EN-NISA, 20)

SOT E HEQIM PERDEN E SYVE

A ka ndërlidhmëri në mes të ligjeve të raportit shpirt-trup, derisa njeriu është në gjumë, ose është zgjuar, apo kur vdes dhe në rastin për të cilin Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"Dhe Ne kemi hequr sot perden e syve tu dhe sot sheh me shikim tjetër, të veçantë".

Përgjigjja: Po, kur njeriu kalon prej momentit të jetës në momentin e vdekjes dhe shpirti i arrin në fyt, e ju në atë moment shihni, Zoti i Lartmadhëruar thotë: **Ti veç ke qenë i panjohur dhe nuk ke pasur kurrfarë diturie për këtë ditë. Mirëpo, pasi që e kemi hequr perden e syve tu, sot sheh tjera gjëra që si ke parë më herët .**

Posa të kalojë njeriu prej momentit të vdekjes në momentin e kalimit në botën tjetër, sheh gjëra, të cilat kurrë më parë nuk i ka parë më herët, edhe pse ende është gjallë dhe shpirti është në të.

AI ËSHTË PENG I BORXHIT TË TIJ

Si qëndron çështja me personin, i cili vdes dhe ka pasur dëshirë të lajë borxhin e tij?

Përgjigjja: Një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: ***"Nëse unë luftoj me veten time, me pasurinë time, me vendosmëri, drejtpërdrejt në front, pa u trembur fare dhe pa ia kthyer shpinën armikut, a do të hyj në xhenet"?Po... Këtë e ka përsëritur dy apo tri herë, pastaj ka vazhduar: "(Nuk do të hysh) Vetëm nëse vdes dhe nuk e ke larë ndonjë borxh tëndin."*** Këtë e ka treguar bindshëm, duke e sqaruar "Borxhin". ***Për Zotin, në dorë të të cilit është shpirti im, nëse njeriu lufton në rrugë të Allahut, nuk do të***

hyjë në xhenet, derisa të lajë borxhin e tij."(AHMEDI)

Një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. për një vëlla të tij, i cili ka vdekur dhe ka pasur borxh pa kryer. Muhamedi a.s. ka thënë: "Ai është peng i borxhit të tij. Laje borxhin për të". Ai prapë ka thënë: "Po, unë i kam larë borxhet e tij, pos një borxhi praj dy dinarësh, të cilin e kërkon një grua, edhe pse ajo nuk ka argumente se i ka pasur borxh ai. Muhamedi a.s. ka thënë: "Jepja dy dinarë, sepse ajo ka të drejtë."(AHMEDI)

Ky është argument se kujdestari, nëse merr vesh për ndonjë borxh të të vdekurit, e ka vaxhib t'ia lajë borxhin, edhe nëse nuk ka argument se i ka borxh.

INVESTIMI NË MJETE TË CILAT SHPENZOHEN NË KAMATË

Kam aksione në njërën prej shoqatave për ndihmë banesore. Kryesia e zgjedhur prej kuvendit të kësaj shoqate ka vendosur të marrë kredi prej investitorëve për t'i mbuluar disa investime, e në anën tjetër, ka (profituar) debituar prej pasurisë së shoqatës, duke deponuar në banka me kredi. Po ashtu, shoqata, në anën tjetër, merr kredi kooperimi me kamatë, në emër të shoqërive aksionare, për të ndërtuar objekte të veçanta për shoqatën.

Kjo lloj veprimtarie e ndaluar, a bie në barrë të Kuvendit menaxhues të shoqatës, apo bie në barrë të të gjithë anëtarëve? Me fjalë të tjera, përqindja e vogël e kamatës me shoqëri aksionare a konsiderohet investim i shpenzimit, apo kamatë?

Përgjigjja: Të gjitha këto veprimtari konsiderohen kamatë dhe që të gjithë kanë përgjegjësi të veprimtarisë me kamatë, e nëse ti nuk ke ditur për veprimtarinë me kamatë, nuk ke përgjegjësi. Kjo është e njëjtë sikur një njeri të ketë blerë banesë prej mjeteve me kamatë ose me para të vjedhura, atëherë shitësi nuk ka përgjegjësi, sepse nuk ka ditur për burimin e atyre mjeteve. Përqindja e kamatës, qoftë e madhe, qoftë e vogël, pa kurrfarë dyshimi, është kamatë.

LLOJET E IDETEVE

Sa lloje të Ideti ekzistojnë?

Llojet e Idetit janë katër:

- Ideti i gruas që ka menstruacione, e ajo është prej tri menstruacioneve, që do të thotë pastrimi prej atyre tri menstruacioneve;
- Ideti i gruas që nuk ka menstruacione, e ideti i saj është tre muaj;
- Ideti i gruas, së cilës i ka vdekur burri; ideti i saj është katër muaj e dhjetë ditë, nëse nuk është shtatzënë.
- Ideti i shtatzënës është deri sa të lindë.

MIRËSIA NDAJ PRINDËRVE PAS VDEKJES SË TYRE

Si është mënyra e nderimit të prindërve pas vdekjes së tyre?

Një njeri prej ensarëve e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: ***"A mund t'i nderoj me diçka prindërit pas vdekjes së tyre?***

Muhamedi a.s. është përgjigjur: Në katër mënyra të luturit për ata: të kërkuarit falje për ta, të kryerit e premtimeve të tyre, nderimi i shokëve të tyre, lidhja farefisnore, e cila lidhje vjen drejtpërdrejtë prej tyre. Kjo është detyra, e cila ka mbetur për t'i nderuar ata pas vdekjes së tyre". (Transmeton Imam Ahmedi)

Një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: Cila është detyra e fëmijëve ndaj prindërve?

Është përgjigjur: Ata janë Xheneti dhe Xhehenemi yt. (Transmeton Ibn Maxhe)

Një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. për mirësinë ndaj prindërve, e ai është përgjigjur:

"Mjerë për ty, po a e ke gjallë". "Po"! "Mjerë për ty, po rri pranë këmbëve të saj se aty e ke Xhenetin".(Transmeton Ibn Maxhe)

Muhamedi a.s. ka thënë :

Më së shumti më habit fakti i personave, të cilët i kanë prindërit e moshuar dhe në pleqëri, e nuk e fitojnë Xhenetin e tyre. (Hadith Sahih)

KALIMI I MENDJES DIKU TJETËR GJATË NAMAZIT

Si është çështja e kalimit pa qëllim të vetëdijes diku tjetër gjatë namazit?

Çështja e kalimit të mendjes diku tjetër gjatë namazit është dukuri e njohur, mirëpo kjo çështje në vetvete nuk përkufizohet si dukuri normale, por veprimi i dëshirës së vet njeriut.

Gjatë namazit vjen shejtani dhe ta fshehë mendjen tënde; pra e meta është se ti nuk ke kujdes në atë që je përqendruar. Shejtani ta jep perin, pastaj ti me mendjen tënde shkon nëpër atë pe dhe jeton aty. Pra, çështja është se ai nuk ta ka marrë mendjen, por mendja shkon aty. Kur ka qenë diskutimi mes Allahut dhe Iblisit dhe kur Iblisi ka refuzuar t'i bëjë sexhde Ademit, a mos i ka thënë Iblisi Allahut se do të qëndrojë te rruga e shtrembër e robërve të Tij? Jo. Por, çka i ka thënë? Do të qëndroj te rruga e drejtë e robërve Tu, sepse ai i cili është në rrugë të gabuar, shejtani s'ka nevojë të shkojë te ai. Shejtani nuk qëndron në vendet ku pihet alkooli e ku dehen njerëzit, sepse ata mendjen veç e kanë të dehur, të humbur. Po, atëherë çfarë bën? Shkon e qëndron në derë të xhamisë, e shejtani nuk rri aty me këshilla, por ka thënë se do të qëndrojë pranë tyre, aty ku ata janë në rrugë të drejtë...

Çasti i namazit është çasti kur njeriu është më së afërti me Allahun, ndërsa shejtani këtë afërsi mes robit dhe Allahut dëshiron ta shkatërrojë, e për këtë arsye vjen në mendjen tënde. Lidhjen të cilën nuk ka mundur ta zgjidhë para namazit, tenton që ta prishë gjatë namazit. Mossuksesi, humbja e njeriut në ato momente, është se shejtani hulumton në forma dhe mënyra ta zgjidhë gjatë namazit. Dhe, sikur njeriu në ato momente, kur i ndërhyn dhe e prek shejtani në ato momente fjala i tregohet qartë, se shejtani nuk është gjithmonë me ty dhe ata të cilët i frikësohen Zotit dhe janë të devotshëm, kur t'u ndërhyjë shejtani e i prek, menjëherë bëhen të kujdesshëm, e vërejnë dhe ata janë vizitorët më të mirë, thotë: "I mbështetem Allahut nga shejtani i mallkuar" dhe derisa Zoti i Lartmadhëruar më ka thënë mua "dhe në ato momente kur shejtani ndërhyn dhe të ndërlidhë diçka, ti kërko mbrojtje prej Allahut" dhe që nga ai çast kur e thua këtë, shejtani pengohet, sepse shejtani asgjë nuk mund të bëjë para Krijuesit të tij.

Por, nëse unë nuk ballafaqohem me të, cili do të ishte rezultati ?

Ata të cilët e pasojnë Iblisin, u vjen në ditën e kiameti dhe u thotë: "Ju

keni qenë të pakujdesshëm, o mëkatarë!" Pse? Mos kam pasur ndonjë pushtet mbi ju? "Unë vetëm ju kam ftuar dhe ju m'u keni përgjigjur. Ju veç keni pasur shenja dhe vërejtje që të mos më pasoni, ndërsa unë nuk kam pasur argumente bindëse dhe pushtet mbi ju. Nëse ke ardhur të ankohesh tek unë për mëkatin tënd, çfarë të të them unë ty? Kjo është forca e argumentit. Unë nuk kam pasur diçka të veçantë të të josh, që të shpresosh diçka, por as nuk kam pasur mundësi të të detyroj; pra, ti nuk e ke as argumentin se ke qenë i detyruar, as argumentin se të kam premtuar diçka." Pra, "Unë nuk kam pasur pushtet mbi ju; vetëm ju kam ftuar, e ju m'u keni përgjigjur; mos më akuzoni dhe mos me mallkoni mua, por akuzoni e mallkoni veten tuaj". Ta sjellim një shembull të Ebu Hanifes r.a., i cili ka ditur të japë përgjigje për çdo rast dhe për çdo person.

Ka shkuar një njeri dhe i ka thënë "O Imam ! Kam pasur pasuri dhe e kam fshehur në tokë, mirëpo e kam harruar vendin. Si ta gjej? Ebu Hanifja i thotë: Për këtë nuk mund ta dijë, por po të jap një propozim: zgjohu menjëherë pas namazit të jacisë, në mesnatë, dhe fal namaz mesnate.

Menjëherë në namazin e sabahut vjen ai njeriu te Ebu Hanife dhe i thotë: O Imam, e kam gjetur pasurinë. Ebu Hanifja i thotë: "Po si e gjete"? Ai tregon: "Kam vepruar ashtu siç më ke këshilluar dhe gjatë faljes së namazit të mesnatës, më është kujtuar". Ebu Hanife pastaj i thotë: "Për Zotin, e kam ditur se shejtani nuk do të lërë të jesh i përkushtuar me lutje te Zoti yt. Ai do të vijë në mendjen tënde për të të treguar se ku e ke pasurinë që ti të anosh ka shejtani dhe të biesh në kurthin e tij, që për shkak të gjetjes së pasurisë të mos e përfundosh namazin. Por, a e përfundove, apo jo?"

KY ËSHTË KOMPENZIM (KEFARET) YT

Thuhet se sëmundjet, të cilat na kaplojnë, kanë për qëllim pastrimin prej mëkateve, që në ditën e kiametit të jemi sa më të pastër. A është kjo e vërtetë?

Është pyetur i Dërguari i Allahit s.a.v.s . Çka është puna me sëmundjet që po na kaplojnë dhe çka kemi prej tyre?

Përgjigjja: ***"Është kompensim i mëkateve". Ebu Said el Hudriju i thotë: Edhe nëse është ndonjë sëmundje e lehtë, apo janë sëmundje të lehta. Është përgjigjur: Edhe nëse është një sëmundje aq e lehtë sa për të klithur, e deri tek ato më të rëndat. (E ka regjistruar AHMEDI)***

KOMPENZIMI (KEFARETI) I ATIJ QË KONTAKTON ME BASHKËSHORTEN GJATË MENSTRUACIONIT

Cili është kompenzimi i atij, i cili kontakton seksualisht me bashkëshorten, derisa ajo është me menstruacione?

Përgjigjja: Kontakti seksual e dëmton mitrën, e mund të shkaktoj edhe sterilitetin. Prej sëmundjeve më të rënda të femrës është kur ajo ndien dhembje në mitër dhe rreth saj, të cilat nuk mund t'i përballojë, për shkak të temperaturës së lartë, ndezjeve në organet gjenitale, të cilat ndodhin për shkak të kontaktimit seksual gjatë menstruacioneve.

Kjo sa i përket femrës, ndërsa sa i përket pasojave të vet mashkullit, ato janë:

Ndezjet e mëdha, të cilat ndodhin në organin gjenital, të cilat pastaj shoqërohen me mikrobe brenda kanalit urinor, bile mund të shkojë deri te mashkulloret; ndezjet pastaj vazhdojnë në të gjitha pjesët rreth e përqark. Ndërsa, sa i përket kompensimit: Transmeton Ibn Abasi nga Pejgamberi s.a.v.s. se ka thënë: ***Ai i cili kontakton seksualisht me bashkëshorten, derisa ajo është me menstruacion, le të japë sadaka një dinarë ose gjysmë dinari. (MUTEFIKUN ALJHI)***

Hadithi tregon se është vaxhib kefareti (kompensimi) ai që kontakton seksualisht me bashkëshorten e tij, derisa ajo është me menstruacione.

KANË REFUZUAR TË MARRIN PËGJEGJËSINË... A DO TË THOTË KJO MËKAT DHE KUNDËRSHTIM?

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"Ne ua ofruam amanetin (obligimet) qiejve, tokës dhe maleve, e ato nuk deshën ta marrin përsipër atë dhe u frikësuan prej tij, ndërsa njeriu atë e mori mbi vete; dhe ai i bëri padrejtësi vetes dhe ishte i padijshëm". (El-Ahzabë, 72)

A do të thotë: *"Kanë refuzuar të marrin përgjegjësinë";* a do të thotë mëkat, apo jo?

Përgjigjja: Përderisa është e drejta e zgjedhjes, që do të thotë se ti ke mundësi ta pranosh ose mos ta pranosh këtë, pra ke mundësi të thuash: Unë veç i kam pranuar të hollat, ose nuk i kam marrë, pra ky është emaneti; e drejta e zgjedhjes është alternative. Ti dhe emaneti yt mund të thoni të vërtetën, ose mund të mos e pranoni. Kur Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: Ne ia kemi paraqitur emanetin qiejve dhe tokës, edhe kodrave, dhe kanë refuzuar të marrin përgjegjësinë e saj. Kjo do të thotë se të gjitha këto i kanë refuzuar që të kenë të drejtë zgjedhjeje për atë çështje, por kanë preferuar që të jenë të nënshtruara, ashtu siç dëshiron Allahu i Lartmadhëruar. Bëhet pyetja. Pse? Pse të gjithë u janë frikësuar pasojave të asaj të drejte në zgjedhje, e cila mund t'i shpjerë në mëkat ose do të veprojnë në kundërshtim me urdhrin e Allahut. Mirëpo, njeriu me mendjen e tij e ka pranuar këtë emanet. Ka pranuar që ai të ketë të drejtë zgjedhjeje. Imami i mirënjohur e thjeshtëson këtë çështje, duke thënë: Të konsiderojmë se erdhi te ti një njeri, i cili ka një sasi të pasurisë, dhe thotë: Unë dëshiroj që këtë pasuri ta lë tek ti emanet. Ti ke të drejtë njërën prej dy çështjeve: Ose të veprosh, siç kanë vepruar ato krijesa (qielli toka dhe kodrat), pra të refuzosh e të mos e pranosh atë emanet dhe t'i thuash vetes tënde: Kjo është vështirë për mua. Atëherë ai njeri do të ma lënë atë pasuri mua; ai ndoshta largohet e unë i shpenzoj në çështje të mashtrimit pas kësaj bote dhe kur të vijë koha për t'ia kthyer, unë nuk do të mund t'ia kthej pasurinë. E, për të mos rënë në grackë, unë atë që është e pasigurt nuk e pranoj dhe shkoj në atë që është më e sigurt; nuk e pranoj atë emanet, sepse ti po më propozon diçka që unë nuk mund ta bart dhe më mashtron shejtani. Nga këtu unë nuk dëshiroj që ta sprovoj veten time dhe nuk e marr pasurinë si emanet.

Pra, kur e ka marrë emanetin njeriu, thelbësore ka qenë se ai ka pranuar lirinë për të vepruar, ose për të mos me vepruar.

Për këtë arsye shpalljet qiellore i kanë zbritur njeriut, sepse ai e ka pranuar emanetin, që do të thotë se e ka marrë të drejtën e zgjedhjes në duart e tij, për të vepruar atë për të cilën është i kënaqur Allahu dhe për t'u larguar nga ajo, të cilën e urren Allahu, mashtrimin e shejtanit dhe dunjasë; dobësinë e tij njeriu nuk e ka llogaritur, e për këtë arsye ai është zullumqar dhe injorant, pra zullumqar i vetes së tij, sepse ai ka menduar dhe ka llogaritur më shumë se sa e ka aftësinë të bartë. Ky është ai mashtrimi, i cili e shpie njeriun të dalë nga Imani, mashtrim, i cili e ka mashtruar Karunin, kur i ka thënë "Vërtet, kam përfituar dituri vetëm prej vetes sime." Pra, njeriu mashtrohet me veten e tij, me mendjen e tij dhe me aftësinë e tij, duke harruar se ato aftësi janë prej Allahut dhe se është Ai, i Cili ia ka dhënë atij, e në të njëjtën kohë, Ai ka mundësi t'ia marrë. Njeriu është injorant, sepse atë e injoron ajo çka ka rreth vetes së tij, sepse Allahu i Lartmadhëruar ka mundësi, Ai ka Forcë e Fuqi, Ai është Dhurues, Pengues, Ngritës, Ultësues, Lartësues, Nënçmues.

Dhe, kështu njeriu e ka pranuar ta bartë amanetin, sepse Allahu i Lartmadhëruar ia ka lënë në kompetencë: vepro, ose mos vepro. Dhe, përderisa Zoti i Lartmadhëruar i ka thënë njeriut vepro kështu, kjo do të thotë se ai ka mundësi për të vepruar atë.

LEXUESI I FILXHANIT

Leximi i filxhanit është haram apo hallall?

Ka mendime të ndryshme rreth leximit të filxhanit. Ka lexues të tillë, të cilët ndërlidhen me ndërmjetësues, të cilët paraqiten më këtë apo atë formë, japin gjëra apo parashikime të dyshimta dhe rrëfejnë tregime, të cilat nuk janë të sigurta, e pastaj, në bazë të atyre tregimeve, mendojnë se do të ndodhë kështu apo ashtu.

Është e mundur, po ashtu, që lexuesi ta ketë nën kontroll xhinin, i cili paraqitet në filxhan, në cilën formë dëshiron ai, e sheh atë dhe flet me të. Ajo sheh në filxhan një njeri ose rrugë të hapur, ose udhëtim me aeroplan, ose me

anije; të gjitha këto janë mundësi të shejtanit, sepse ai mund të paraqitet në cilën formë dëshiron ai.

Në shumicën e rasteve shohim lexues të filxhanit, të cilët përfitojnë duke kërkuar,

të cilëve Allahu u ka hapur rrugën atyre dhe ata dëgjojnë fjalët për të cilat kanë nevojë ata, por, natyrisht, ata nuk marrin shpërblim dhe nuk përfitojnë prej asaj veprimtarie, sepse atë mundësi ua ka dhënë Allahu; dhe ata nuk bazohen në mundësit dhe aftësitë e tyre, sepse këto mundësi dhe këto aftësi ua ka dhënë Allahu i Lartmadhëruar për t'i nderuar dhe për t'i fisnikëruar ata njerëz, që ata të bëjnë mirë. Kështu, ky është një lloj "KERAMETI", por Allahu e di më së miri.

BOTA E PADUKSHME

Çka është bota e padukshme dhe cili është kuptimi i ajetit Kur'anor "Njohës" (Mësues) të padukshëm dhe nuk ia tregon sekretin e tij askujt. A ka lloje të çështjeve të padukshme dhe a mund t'i zbulojë ndokush ato sekrete me logjikën njerëzore, apo ajo është sekret prej sekreteve të madhështisë së Allahut. Dëshirojmë mendim të plotë nga ju, i nderuar, pasi që kjo është prej çështjeve të rëndësishme, me të cilën janë marrë dhe po merren shumica e muslimanëve, që nga njerëzit e rëndomtë e deri te dijetarët më eminentë.

I nderuari u përgjigj:

Të padukshmet janë dy llojesh: E padukshmja absolute dhe e padukshmja relative.

E padukshmja absolute është e padukshmja (fshehtësia), të cilën nuk e di askush tjetër pos Allahut të Lartmadhëruar.

E padukshmja relative (mukajed) është e padukshmja (fshehtësia), të cilën disa e mësojnë apo, me fjalë të tjera, u shpaloset, e disave jo.

Të sjellim një shembull: Kur të përfundojnë provimet e studentëve në fund të vitit, para se të shpalosen rezultatet, atëherë këtu kemi të bëjmë për fshehtësinë (të panjohurën) për mua dhe për ty, mirëpo është e njohur për profesorët dhe komisionin e provimeve. Edhe një shembull tjetër, kur të vidhet diçka prej teje, hajni është i panjohur sa i përket çështjes sate, sepse ti

nuk ke njohuri për të, ndërsa sa i përket atij dhe atyre të cilët kanë qenë me të, nuk është fshehtësi.

E, kur ta mësojmë atë fshehtësi, atëherë ka ekzistuar dikush tjetër (detektivi, policia), i cili më ka informuar dhe ka pasur mundësi të ma bëjë të njohur; pra kjo nuk është fshehtësi. Disa njerëz kërkojnë informata prej xhinëve, e ai (xhin) merr përsipër të mbledhë informata dhe të m'i sjellë mua. Këto janë informata që disa kanë mundësi t'i mësojnë. Kështu, pra, është Mësuesi i fshehtësive, Allahu i Lartmadhëruar. Ai e ka paraparë se do t'i tregojë në të ardhmen për ndonjë fshehtësi, të cilën nuk e di askush. Pra, ky është Mësuesi i fshehtësive. Ndërsa, bota e të padukshmes (të fshehtës), kjo kuptohet në vetvete, se Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: Nuk ia shpalos fshehtësinë e Tij askujt, pos atyre me të cilët është i kënaqur prej të Dërguarve. Njerëzve të tillë ua shpalos Allahu fshehtësinë e disa sendeve, mirëpo ti ato nuk mund t'i dish apo të marrësh përgjigje për çdo çështje që dëshiron ti, sepse Allahu ua ka shpalosur vetëm atyre që ka dashur Ai t'i përgëzojë. Dhe ky njeri mund t'ia shpalosë atë lajm të mirë ndokujt. Fshehtësia, pa marrë parasysh se a ka ndodhur në të kaluarën, a do të ndodhë në të ardhmen, kur të shpaloset, ajo bëhet fshehtësi e së kaluarës, pra e ka hequr perden e së ardhmes. Ndërsa, sa i përket të sotmes, kjo do të thotë se është hequr perdja e vendit, e gjatësisë gjeografike, që do të thotë informon apo paralajmëron personi për diçka çka ka ndodhur në Aleksandri, e ai është ulur me mua këtu në Kairo në të njëjtën kohë.

Te Allahu i Lartmadhëruar ndodhitë janë një. Kur të na lajmërojë diçka për të ardhmen, kjo është sikurse të ketë ndodhur sot, sepse nuk ka forcë a fuqi që të veprojë përpos ashtu siç ka thënë. Patjetër duhet të ndodhë siç ka paralajmëruar Allahu se do të ndodhë në të ardhmen. Pra, e ardhmja është realiteti i së kaluarës. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **Ka ardhur urdhri i Allahut (ka ndodhur kiameti), e ju mos shpejtoni**. Pra, fjala "ka ardhur " është folje e kohës së kaluar, ndërsa pjesa tjetër "mos shpejtoni" tregon se kjo është për të ardhmen, pra, kuptimi i kësaj se kjo çështje do të ndodhë pa kurrfarë dyshimi në të ardhmen, sepse nuk ka forcë tjetër, e cila mund ta ndryshojë atë që e ka thënë Zoti i Lartmadhëruar: çka ka thënë për të ardhmen, ajo do të realizohet dhe sikurse veç të kishte ndodhur.

Koha e kaluar është çështje, e cila ka ndodhur për te njerëzit, ndërsa e ardhmja është çështje, e cila veç ka ndodhur për te Allahu i Lartmadhëruar. Për këtë arsye, kur të thuash: "Filani ma ka shpalosur një fshehtësi", ne themi:

Ajo çështje a ka qenë fshehtësi për ty dhe për të tjerët, apo vetëm për ty? Nëse ka qenë fshehtësi (e panjohur) për ty, e jo fshehtësi për të tjerët, këtë çështje në këtë mënyrë apo në ndonjë mënyrë tjetër ke pasur mundësi ta mësosh.

Nëse një ndodhi e botës më të lartë, të cilën nuk e di askush, dhe Zoti i Lartmadhëruar ua jep mundësinë që ta dinë vetëm disa prej krijesave të Tij, si dhuratë, siç është rasti i lajmërimit të Zekirija a.s se do të ketë një djalë dhe emri i atij djali do të jetë Jahja.

Përfundojmë se fshehtësinë absolute (mutlak) nuk e di askush tjetër, përveç Allahut. Nuk themi se është bota e të padukshmes fshehtësi, por themi se Mësuesi i të fshehtës .

Ne prej njerëzve marrim informata, me fjalë të tjera, na shpaloset për të njohur të fshehtën. Kjo është gabim, sepse prej begative të Allahut është se i ka fshehur disa gjëra; ose tregoja një njeriu se do t'i ndodhin njëqind raste të lumtura në jetën e tij dhe tregoja vetëm një ndodhi të pikëlluar, pastaj shikoje atë; do të shohësh se lajmi pikëllues i tejkalon, i peshon lajmet e mira dhe kjo ndodhi e rrëzon për tokë para se të ndodhë, sepse jeton jetë të izoluar. Allahu është i butë për ne dhe i mëshirshëm, edhe në raste të fatkeqësisë (ditës se Kiametit), e ju pse po shpejtoni, pse po brengoseni?

ËNDRRAT E VËRTETA

I nderuar Shejh: Çka janë ëndrrat e vërteta dhe a janë specifikë e pejgamberëve, në lidhje me këtë, ajeti Kur'anor: **"Do ta tërheqim zvarrë për hundë."**? Ky ajet Kur'anor i cili tregon për Velidin, a jep të tregoj për ndodhi e cila do të ndodhë në të ardhmen?

Përgjigjja: Është e mundur që ne mund të parafytyrojmë se si një dijetar e sjell një shembull tipik për diçka, e ajo ngjarje ndodh saktësisht, siç e ka treguar dijetari më herët. P.sh. Inxhinieri e bën projektin e një ndërtese, e cila do të ndërtohet, pastaj ndërmarrja (mjeshtri) e ndërton ashtu siç e ka përshkruar dhe siç e parasheh projekti; ashtu e ndërtojnë dhe ngjason në projektin, edhe me ngjyrat brenda dhomave, madje edhe se ku do të vendosen orenditë e kështu me radhë. E gjithë kjo ndodh me aftësinë dhe profesionalizmin e mjeshtërve dhe inxhinierit, i cili e ka paraparë të jetë

salloni me një ngjyrë të caktuar. Mirëpo, aftësia dhe mundësia e tij stopohet, atëherë kur të bëhet punimi i asaj ndërtese, kur ngjyra e kërkuar dhe e paraparë nuk gjendet në treg. Atëherë, p.sh. ngjyroset, edhe pse me kombinimin e ngjyrave, nuk mund të prodhohet ngjyra e kërkuar; atëherë ngjyroset me ngjyrë të përafërt, por, megjithatë nuk është ngjyra, e cila është paraparë. Kjo është ose si shkak i planifikimit të paraparë, ose pamundësia e sigurimit të elementeve. Mirëpo, si qëndron puna me Atë, te i cili nuk mund të ndryshojnë rrethanat dhe ka aftësi absolute. Kur të përcaktojë diçka, patjetër duhet të ndodhë. Atëherë paraqitet dhuntia e Zotit, pra të sjellë një shembull, një pasqyrim të një ngjarje, e cila do të ndodhë në të ardhmen. P.sh. të thotë: Në këtë vend do të ndërtohet shtëpia ime, e cila do të ketë këto cilësi, këtë formë, kaq dhoma e kështu me radhë. Kjo konsiderohet "paralajmërim" prej paralajmërimeve të të Dërguarit të Allahut dhe janë ëndrrat e vërteta. Ka prej njerëzve, të cilët shohin ëndërr në gjumë, mirëpo ka të tjerë, të cilët e shohin ëndrrën zgjuar (parafytyrim). Ne shohim se Zoti i Lartmadhëruar i ka treguar Muhamedit a.s. për ndodhi në të kaluarën, e dihet mirëfilli se Muhamedi a.s. nuk ka mësuar për atë ndodhi, nuk ka qenë prezent në ato ndodhi dhe ata e kanë ditur se Muhamedi a.s. nuk i ka ditur ato. Po ashtu, edhe Kur'ani e tregon këtë realitet dhe e vërteton kur thotë: **"Ti nuk ke qenë në Kodrën Turë. Nuk ke qenë në mesin e tyre, kur ata kanë gjuajtur lapsat e tyre (për short) se cili prej tyre do ta ketë nderin të marrë në përkujdesje Mejremën, e as nuk ke qenë në mesin e tyre kur kanë rënë në mosmarrëveshje (konflikt) në mes vete; dhe nuk ke qenë te populli Medjen, duke ua lexuar atyre ajetet tona".** Të gjitha këto janë njohuri të mrekullisë mbinatyrore, kur Muhamedi a.s. i ka marrë pozitat në të njëjtën kohë, kanë ndodhur paralajmërimet dhe në të njëjtën kohë është zhveshur perdja kohore.

Kur Muhamedi a.s. ka bërë përgatitjet e betejës, e ka shkelë me këmbë vendin dhe ka thënë: Këtu është vendvrasja e filanit, këtu është vendvrasja e fistekut, e pas kësaj, në të ardhmen, ndodh e njëjta gjë dhe vërtetohet ajo çka ka thënë. Çka është ajo çka e përcakton fushëbetejën, lëvizjen e luftëtarëve të tjerë e që Muhamedi a.s. e di saktësisht se ku do të ndodhë filani. Si është e mundur kjo? E, për Velidin ka thënë "Do ta tërheqim zvarrë për hunde.", pra e ka përcaktuar fushbetejën dhe vendin e plagës vdekjeprurëse. Kush është ai, i cili e përcakton fushëbetejën dhe vendluftimin e personave ku do të bien saktësisht dhe në cilin vend do të vriten? Kjo është mrekulli mbinatyrore për

të ardhmen, lajm, i cili e di të ardhmen dhe nuk ka asgjë që mund t'i ikën dëshirës së tij. Pra kjo është specifikë, në të cilën është dalluar Muhamedi a.s. për t'u ngritur personaliteti i tij.

XHENETI NËN KËMBËT E NËNAVE TUAJA

Imam i nderuar, cili është kuptimi: "xheneti është nën këmbët e nënave?"

Përgjigjja: Thuhet: Filani pranë duarve të filanit, që d.m.th. para tij.

Thuhet: "Nën këmbët e filanit". Kjo është alegori, si p.sh.: Kur thua: Filani ma dha dorën, pra filani ta ka dhënë dorën, edhe pse as që e ke prekur dorën e tij. Kjo përngjan sikur t'a kishe marrë dorën e tij dhe ta sjellësh në cilin drejtim dëshiron dhe vepron me dëshirën e tij, edhe pse nuk e ke prekur dorën e tij. Kjo do të thotë: Ai është urdhërdhënës, i cili nuk del jashtë kornizave të dëshirës së tij, ashtu siç nuk del dora e tij, të cilën e ke në dorën tënde. Dhe kur themi: Vërtetë xheneti është nën këmbët e nënave tuaja, ky nuk është lajmërim për vendin e xhenetit, por kuptimi i kësaj është: Kush dëshiron xhenetin, le të qëndrojë më afër këmbëve të nënës tij, që do të thotë të qëndrojë në vendin, ku njerëzit mendojnë se është poshtërsi.

Për këtë arsye kuptimi "Xheneti nën këmbët e nënave" është: O ti, i cili e dëshiron xhenetin, përulju dhe nënshtroju, ashtu siq ka thënë Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an: "Dhe shtriji këmbët e përulshmërisë së mëshirës".

Kur ka këshilluar Muhamedi a.s., ka këshilluar për t'u përkujdesur më shumë për nënën se për babain. Kjo për arsye se babai ka mundësi më të shumta për të siguruar ekzistencën dhe ai më pak ka nevojë, ose edhe nuk mund të ketë fare, por, edhe nëse paraqitet nevoja dhe bëhet lypës, ai e ka më lehtë. Ndërsa, nëna të arrijë në atë gjendje, pra të ketë nevojë të lypë, është poshtërim për ta. Duhet që kurrë të mos vijë në atë gjendje dhe të largohet nga ajo gjendje.

Kur është pyetur Muhamedi a.s. kush ka më së shumti përparësi për shoqërim, ai ka thënë: Nëna jote, nëna jote, nëna jote, e pastaj babai yt. Pra, ka porositur tri herë për nënën, para se të porositë për babain, sepse nëna përfaqëson anën e të dobëtëve, ajo përfaqëson ledhatime, ndjeshmëri. E,

Allahu ka dashur ta sigurojë atë.

Kur Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: "Zoti im, mëshiroji ata dy, siç janë sjellë me mëshirë ndaj meje, kur unë isha i vogël." ai ka kërkuar nga fëmija që të lutë të Lartin dhe të Gjithëfuqishmin për të dy prindërit, që ndaj tyre Allahu të jetë i mëshirshëm. Pastaj ka treguar se edukimi dhe përkujdesja ka qenë prej të dyve, edhe prej nënës, edhe prej babait.

Nëna është ajo, e cila e përkëdhel dhe përkujdeset, ndërsa babai është ai, i cili sjell furnizime, ushqime, veshmbathje, mirëpo, në esencë, që të dy janë bashkëpjesëmarrës në edukim dhe përkujdesje. Zoti i Lartmadhëruar, gjithashtu, ka porositur për mirësi: "Dhe ne e kemi porositur njeriun për mirësi ndaj prindërve." Pra, ka porositur mirësi për të dy prindërit. Ndërsa, në ajetin tjetër: "Dhe thuaj, O Zoti im, mëshiroji ata dy, siç kanë qenë të mëshirshëm dhe janë sjellë mirë me mua në vegjëli." Pra, Zoti i Lartmadhëruar ka porositur për të dy prindërit. Në një ajet tjetër, ndërkaq, shohim: "Ne e kemi porositur njeriun për mirësi ndaj prindërve, e ka bartur nëna e tij me vështirësi e mund të madh dhe e ka lindur me vështirësi e mund të madh." Ne ajetin tjetër: "E ka bartur nëna e tij me vështirësi përmbi vështirësi." Në të dy ajetet fisnike ka treguar shkaqet pse ka porositur për nënën, sepse çështjet, të cilat i vepron babai për të birin, janë çështje të qarta dhe të njohura. Atëherë kur fëmija fillon të kuptojë, e sheh se çdo gjë e ka burimin prej babait të tij, se ai sjell pasuri, me të cilat blihen gjërat e nevojshme; për këtë arsye ai fillon të kuptojë se të gjitha shpenzimet janë prej babait. Fëmijës nuk ka nevojë t'ia tërheqësh vërejtjen për këto çështje, sepse ai i sheh vet, sepse me pjekurinë e tij e kupton se çfarë bën babai për të. Ndërsa, sa i përket mendimeve për nënën, ato mendime për fëmijën kanë ndodhur atëherë kur ai nuk ka qenë i moshës së rritur, kur ka filluar të kuptojë se ajo fazë veç ka kaluar. Ai nuk mund t'i kuptojë mendimet, të cilat i ka përjetuar nëna gjatë kohës së shtatzënisë, gjidhënies dhe lodhjen e tepërt, duke u përkujdesur për të kur ai ka qenë foshnje. Për këtë arsye mundimet e nënës, të cilat nuk i ka parë, i drejtohet Zoti i Lartmadhëruar me këshilla. Mirëpo, këshillimi vjen atëherë kur ai të rritet, kur të jetë i aftë për të kuptuar se çka veprojnë prindërit e tij momentalisht. Ajo çka ka vepruar nëna e tij në të kaluarën, ai nuk mund ta kuptojë vetvetiu, por mund ta kuptojë atëherë kur t'ia shpjegojë tjetri. E, për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar ia përkujton atë kohë dhe e këshillon.

DHURIMI I GJAKUT

Cili është shpërblimi i dhurimit të gjakut dhe a ka të drejtë dhuruesi të marrë fitim prej dhurimit, e nëse merr kompensim, a zhvishet prej shpërblimit të dhurimit të gjakut? A mund të na e sqaroni këtë, Imam i nderuar?

Imami ynë i nderuar, Shejh Shearëviju, u përgjigj:

Vetëm dhurimi i gjakut, pa marrë parasysh a merr kompensim a jo, ka shpërblim, sepse një gjë e tillë shpëton jetën e një njeriu, posaçërisht pasi që mjekësia bashkëkohore ka mundësi ta bëjë rezervimin e gjakut. Ndërsa, sasia e dhurimit të gjakut nuk dëmton dhe nuk e dobëson shëndetin e dhuruesit. Argument për këtë është se njeriut aksidentalisht mund t'i rrjedhë shumë gjak, e ajo sasi është më e madhe se sa kur dhuron. Mirëpo, kur i ndalet gjakderdhja dhe i mbyllet plaga, humbja e gjakut nuk rrezikon jetën e tij (sasia e vogël) dhe nuk dëmton shëndetin e tij, nëse veç ka qenë i shëndoshë. Përpos kësaj, gjaku i ripërtërihet, gjaku i humbur i kompensohet. Për këtë arsye, përderisa ai gjak i humbur nuk ndikon ne shëndetin e tij negativisht, dhe ajo nën kontroll të mjekut, dhurimi i gjakut, edhe me të holla, për të ka shpërblim. Por, nëse dhuruesi i gjakut nuk dëshiron të holla (kompensim), ai ka dy shpërblime: shpërblimin e dhurimit të gjakut dhe shpërblimin (prej të cilit ka hequr dorë) me të holla. Allahu e di më së miri.

LINDJA E VËSHTIRË FSHIN MËKATET

A është e vërtetë se çdo gruas, që lind fëmijë, i falen mëkatet në tërësi?

Gruaja që lind fëmijë me vështirësi të madhe, dhembje të madhe, pra më shumë se në lindje të zakonshme, dhe ajo duron, beson e shpreson në shpërblimin e Zotit për atë gjendje të vështirë, i fshihen mëkatet.

HAXHI PREJ LLOGARIVE BANKARE

A lejohet të kryhet haxhi prej kamatës bankare apo një gjë e tillë është në kundërshtim me ligjin e Allahut?

Na urdhëro dhe na sqaro, për këtë. Zoti ju shpërbleftë!

Haxhi prej kamatës është haram, haram, haram. Haxhi patjetër duhet të jetë prej pasurisë hallall. Mëkatari nuk mund t'i afrohet Allahut me mëkat.

Poeti ka thënë:

Nëse shkon ne haxh me pasurinë e përlyer,
Nuk e ke kryer haxhin, por deveja ka shkuar haxh.

TË JETUARIT ME VRASËSIN

Burri im ka vrarë një njeri gabimisht. A është bashkëjetesa me të haram apo hallall? Kjo çështje më ka munduar ditë e natë dhe mendja asnjëherë nuk ka pushuar, e zemra asnjëherë nuk më është qetësuar. A mundet i nderuari ynë, Shaëraviju, që të ma lehtësojë gjoksin tim dhe të më çlirojë mendjen time, e cila më preokupon? Zoti e shpërbleftë!

Përgjigjja: Të jesh e lirë se deri sa burri yt nuk e ka vrarë me qëllim, por gabimisht, ai duhet të kompensojë vrasjen gabimisht, ashtu siç e ka paraparë Allahu, ndërsa bashkëshortja nuk ka kurrfarë pengese të jetojë me të, pra nuk ka kurrfarë lidhje bashkëjetesa burrë-grua për atë që e ka vepruar burri.

ABDESI - FAZA E PARË E ADHURIMIT

Abdesi është hyrje në fazën e parë të adhurimit të parë, e ai është namazi. Kur Zoti i Lartmadhëruar ka dashur që të na përgatitë neve shpirtërisht, na ka urdhëruar të marrim abdes. Ai ka thënë: "Dhe kur të vendosni të falni namaz, pastroni fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla." Kjo do të thotë se urdhri përfshin pastrimin e duarve deri në bërryla. Pra, urdhër është që të bëhet pastrimi i fytyrave dhe duarve deri në bërryla. Në rend të parë, është pastrimi i fytyrës, pastaj pastrimi i duarve. Sa i përket fytyrës, nuk është përcaktuar asgjë, pra "fytyrat tuaja", ndërsa te duart është përkufizuar "deri në bërryla". Sikur Allahu dëshiron pastrimin e kufizuar, ndërsa fytyra nuk sjell ndonjë mosmarrëveshje, sepse fjala fytyrë është e njohur gjuhësisht se cilën hapësirë e përfshin. Ndërsa, sa i përket fjalës "dorë", ka mendime të ndryshme të përkufizimit të hapësirës së saj. Allahu dëshiron të mos shkaktojë mosmarrëveshje, e për këtë arsye e ka definuar "deri në bërryla". Po mos të ishte e definuar "duart tuaja deri në bërryla", disa do të kishin thënë të pastrohen vetëm shuplakat, të tjerët deri në bërryla, e disa të tjerë tërë dorën, pra me gjithë krahët, dhe secili do të kishte thënë se është e mundur edhe ashtu. Mirëpo, Allahu ka dëshiruar ta përkufizojë deri në bërryla dhe më nuk ka alternativë tjetër. Pas kësaj, Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: "Lëmoni kokat tuaja ", ashtu siç ka thënë "pastroni fytyrat tuaja", edhe pse nuk e ka definuar hapësirën e lëmimit të kokës. Pra, vet kjo formë e tekstit tregon mundësinë e alternativave, të cilat Zoti i Lartmadhëruar i pranon. Parafjala "B" në këtë fjalë është parafjalë mbështetëse.

JU I DINI MË SË MIRI ÇËSHTJET E JETËS SUAJ

I nderuari Imam! Nëpër tribuna, nëpër vende të ndryshme ka dalë në sipërfaqe një pyetje serioze dhe e rëndësishme, e ajo është çështja e ixhtihadit në Islam. Secili e tregon në bazë të mendimit të tij, i dituri e injoranti, i specializuari dhe i paspecializuari, profesori e studenti, e ajo është çështja e rëndësishme, me të cilën janë marrë shumica e mendimtarëve dhe dijetarëve të kohës së kaluar, por edhe të tashmes. Cili është mendimi juaj në lidhje me këtë çështje shumë të rëndësishme?

Imami filloi sqarimin kështu:

Tek ne ka njerëz që aq shumë janë liruar në fe sa që çdo çështje të fesë ia lënë ixhtihadit, ndërsa të tjerët çdo çështje të fesë dhe të dunjasë ia lënë ixhtihadit.

Ne u themi atyre: Që të dy palët e keni gabim, sepse ixhtihad do të thotë të angazhohesh, të shpenzohesh në maksimum për të dhënë mendimin, e kjo nuk do të thotë se duhet të hulumtohet. Por, gjërat ekzakte dhe qëllimi i njeriut asnjëherë nuk prishin diçka, nëse jep një mendim për çështjet, të cilat janë të lejuara sipas ixhtihadit, ndërsa sa i përket të parës, shkencave ekzakte, po. I pari i cili dëmton është ai i cili thotë jo, sepse unë e marr përsipër përgjegjësinë. Çështja tjetër është se ka njerëz që të gjitha çështjet e fesë ia nënshtrojnë parimit : "Ju më së miri i dini çështjet e jetës suaj", që do të thotë se çdo çështje dëshirojnë ta përfshijnë në këtë hadith. Ne duhet ta kuptojmë burimin dhe esencën e hadithit. Hadithi është thënë për një çështje shkencore praktike, ndërsa çështjet praktike nuk duhet shikuar në mënyrë parazite, vetëm prej qiellit, por duhet shikuar shkaqet e krijimit të materies, sepse Allahu ka garantuar dhe e ka vendosur ligj, që në ato çështje nuk ka vend emocioni. Në çështjet e materies lëndore nuk mund të ndryshojë emocioni i dijetarit, por ndryshon aty ku është fakti, realiteti dhe praktika.

Ç'janë fakti, realiteti dhe praktika? Janë ato në të cilat përputhen elementet. Çështjet praktike dhe reflekset nuk mund të ndërhyjnë asnjëherë në emocione. E, kjo nga shkaku se Allahu ka garantuar që në çështjet praktike dhe ekzakte nuk ka vend iluzioni dhe emocioni. Ndërkaq, në çështjet ideore mund të ndërhyjë emocioni, por edhe kjo është dy llojesh. Lloji i parë, në të cilin nuk kemi ndërhyrje në brendi dhe nuk lejohet ixhtihadi në të, dhe lloji i dytë, me qëllim që të keni liri të hulumtimit dhe që të mos jeni të ngurtë në

pranimin e obligimeve, pra që të keni liri të veprimit dhe liri të zgjedhjes. Sa i përket çështjeve në të cilat veprimi zgjidhet, do të thotë se ka alternativë, ndërsa te çështjet lëndore praktike, nuk ka kurrfarë alternative, sepse në to nuk ka vend për emocione dhe dëshira.

Them: Ne çdo herë vërejmë se janë dy pakte. Pakti lindor i Varshavës, të cilin e kryeson Rusia, dhe pakti perëndimor i Natos. Këta dy pakte janë në kundërshtim të njëri-tjetrit vetëm nga aspekti teorik, ndërsa nga aspekti i lëndëve jo, pasi nuk ka rrymë elektrike ruse dhe rrymë elektrike amerikane. Jo, kështu kurrë nuk do të ketë. Por, pakti i Rusisë dëshiron që të përvjedhë nga shkencat praktike, po ashtu edhe tjetri. Mirëpo në çështjet teorike shohim fortifikatë të hekurt, e cila e pengon atë. Këto i pengojnë të tjerët dhe të tjerët i pengojnë këta, ndërsa këto vjedhin prej të tjerëve dhe anasjelltas. Kjo vërteton se në çështjet praktike lëndore nuk ka dëshira, por ashtu i pranojnë, pra ashtu si i ka krijuar Allahu për njeriun. Allahu i ka krijuar lëndët në mundësi të njeriut dhe për njeriun, ndërsa njeriu prodhon në bazë të zhvillimit dhe të çështjeve praktike. E, sa i përket asaj se ky është ateist, ky komunist, ky pabesimtar, në këto çështje nuk mund të ndërhyjë njeriu.

Vjen një njeri dhe të tregon: Pejgamberi juaj, Muhamedi, ka thënë: "Ju jeni më vizionarë në çështjet e jetës suaj". Ato janë çështjet praktike, në të cilat ke liri të plotë e me këtë islami ka vendosur parimin shkencor praktik. Mirëpo, në çështjet teorike, në të cilat ndryshojnë dëshirat dhe emocionet, kemi dy forma. *Forma e parë:* Forma e ligjeve absolute të pandryshueshme, që do të thotë se nëse në ato çështje konfrontohemi, do të depresionohemi dhe do të lodhemi. Dhe *forma e dytë*: Nëse japim mendime të ndryshme, nuk do të lodhemi, por, edhe pse lodhemi, lodhemi për shkak të fanatizmit, e dihet se fanatizmi është cilësi vetëm e të dobëtve. Pra, kjo do të thotë se i pranuam apo nuk i pranuam çështjet e islamit, prapëseprapë i kemi pranuar, sepse u jemi dorëzuar pa e hetuar.

Unë nuk i dorëzohem atij, i cili është i nivelit tim, por i dorëzohem atij, i cili është më i mirë se unë dhe më i ditur se unë. E, kjo nënkupton islamin. Islami im është se unë e pranoj atë, se ajo është e Zotit të Vërtetë dhe të Madhëruar. Çdo veprim imi është i vërtetë, pasi është burim prej Allahut dhe prej të Dërguarit të Allahu dhe këtu përfundon çështja.

Analizo dhe shiko precizitetin e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.; analizo fuqinë dhe guximin e bindjes së thellë të Pejgamberit s.a.v.s. kur ka thënë: "Edhe nëse nuk i mbarsni, prapë do të ketë hurma". Pasi që ato nuk kanë bërë

mbarsin e hurmave, hurmat nuk kanë sjell fruta. Shiko pra se çfarë stërvitje praktike ka bërë Muhamedi s.a.v.s., sa që ka thënë se në çështjet shkencore praktike mos e dëgjoni as fjalën e Muhamedit, birit të Abdullahut. A mund të thuhet diçka më shumë se kjo?! Mirëpo, në çështjet e dëshirave dhe emocioneve shohim se në praktikë na ka thënë Allahu që praktika ta përkrahë dhe ta vulosë. Po, si kjo? Shiko në çështjet teorike, në të cilat ka pasur mospajtime; pastaj shiko edhe çështjet lëndore. Krahaso, e pastaj do të shohësh se zbuluesi i çështjeve lëndore është shkencëtari, i cili i ka vërtetuar në praktikë, e njerëzit pastaj kurrë nuk e kanë kundërshtuar dhe se ai ka mbetur i vetmi zbulues i asaj çështjeje. Mirëpo, askush nuk e di se sa ka sakrifikuar në punë, në kohë, ushqim e pije derisa e ka arritur atë zbulim. Njerëzit e tjerë nuk kanë ndier asgjë derisa ka arritur te zbulimi, derisa e ka vërtetuar atë zbulim apo çështje të re, e pastaj ne fillojmë ta shijojmë dobinë e atij zbulimi shkencor praktik. Mirëpo, kush është ai, i cili e ka nxjerrë në shesh atë zbulim? Vetëm ai dhe puna e tij. Për sa i përket teorive, teoriku kënaqet, ndërsa të tjerët lodhen derisa më në fund zbulohet se teoria e tij kishte qenë e dëmshme, ose ndodh që vjen një teorik tjetër dhe e mposht teorinë e tij. Pra, Allahu na ka shkarkuar barrën, e cila na ka munduar. Është e vërtetë se edhe zbulimet shkencore lëndore e praktike janë të fshehta dhe të mbuluara, deri sa Allahu na mundëson, kur të dëshirojë, që të arrijmë deri te ai zbulim. Mirëpo, Allahu ka dashur ashtu, pasi Allahu është Krijues, projektues dhe ekzekutues dhe asnjë prodhues nuk dëshiron që t'i dështojë prodhimtaria e tij. Çdo prodhues e do prodhimin e tij; Allahu e do prodhimin (krijimtarinë) e Tij. Për këtë arsye nuk na ka lejuar gjykimin në bazë të emocioneve dhe dëshirave, por e ka lejuar ixhtihadin, ndërsa ixhtihad domethënë se *kjo është e lejuar,... edhe kjo është e lejuar, por Allahu e di më së miri*.

PËR TË TRIUMFUAR (PËR T'U PARAQITUR) MBI TË GJITHA FETË

Pyetje: Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Është Ai(Allahu), i cili ka dërguar të Dërguarin e Tij për të udhëzuar dhe fenë e vërtetë, për të triumfuar mbi të gjitha fetë".** Ne sot ende po shohim se ka ateizëm dhe fe të trilluara dhe nuk ka fe triumfale ndaj feve të tjera.

Përgjigjja: Nëse e kuptojmë Kur'anin me logjikën Kur'anore dhe gjuhën arabe, nuk do ta kishim parashtruar një pyetje të tillë, sepse në ajet thuhet "për të triumfuar mbi të gjitha fetë, edhe pse këtë e urrejnë pabesimtarët"; në ajetin tjetër "edhe pse këtë e urrejnë idhujtarët", pra fjala është edhe do të triumfojë, por edhe do të ketë urrejtës. Mirëpo, po të mos kishte urrejtës prej pabesimtarëve, urrejtës prej idhujtarëve dhe të gjithë të ishin vetëm besimtarë, atëherë çfarë kuptimi do të kishte "cilit t'i paraqitet"?

Ia ka paraqitur kuptimin, ka triumfuar do të thotë se kanë qenë dy palë dhe njëri është fitues, tjetri humbës, e ata janë në mes të arenës. E po të ishte vetëm Imani në njërën anë, atëherë nuk ka arenë dhe nuk ekziston dueli dypalësh, pra dueli mes palëve.

Ja tani do të udhëzoheni duke shikuar gjendjen momentale, në bazë të përvojës në shoqëritë tuaja, në disa çështje, dhe dëshironi t'i zgjidhni sipas metodologjisë njerëzore, ndërsa zgjedhja njerëzore është në Islam dhe zgjidhjet e problemeve përputhen me Islamin, sepse ju vet keni dashur të dilni në arenë. Pastaj, ju vetë keni qenë të detyruar, edhe pse keni vazhduar qëndrimin në vendbanimet e juaja dhe keni vazhduar idhujtarinë e juaj, për të pranuar të vërtetën. Por, a e keni pranuar pse është Islame apo pse e keni parë të vetmen zgjidhje, ashtu siç e ka paraparë Islami. Atëherë, pjesa e ajetit "për të triumfuar mbi të gjitha fetë (sistemet, ideologjitë)", do të thotë se do të dëshmojnë nëpërmjet ngjarjeve dhe eksperiencës se çështjet Islame janë superiore dhe se njerëzit do të jenë të detyruar për t'i pranuar, përkundër dëshirës së tyre; edhe pse i urrejnë, ata do të veprojnë me ato ligje, jo nga aspekti se janë Islame, p.sh., sikurse është rasti me ata, të cilët kanë kundërshtuar lejimin e shkurorëzimit, e pastaj prapë janë detyruar ta marrin një hap të tillë, pra duke e lejuar atë. Njësoj janë edhe çështjet tjera, si lejimi i kamatës, lejimi i alkoolit etj. Analizojeni se sa mjete ka shpenzuar Amerika në luftimin e këtyre çështjeve? Ata nuk e bëjnë këtë pse është Islame, pra pse

e ka ndaluar Islami, por e bëjnë një gjë të tillë ngaqë i lehtëson apo i zgjidh problemet e tyre shoqërore. Pra, pjesa e ajetit "për të triumfuar mbi të gjitha fetë" ka kuptimin se ligjet e tij do të triumfojnë mbi ligjet e pabesimtarëve dhe do të angazhohet, do të mundohet të veprojë me të më shumë se të kishte qenë besimtar, sepse ata nuk e bëjnë për shkak të fesë dhe për shkak se janë këshilla fetare, por e bëjnë sepse ai veprim i qetëson dhe i shpëton. Atëherë Islamin duhet ta pranojmë se është themel i dispozitave; ose çdo çështje që e veprojmë, që i përmbahemi, i përmbahemi, sepse ne iu kemi dorëzuar Allahut dhe se çështjet i takojnë vetëm Allahut.

FEJA DHE SHKENCA

A bën dallim Islami në mes të fesë dhe shkencës? Ç'mendoni ju rreth kësaj çështjeje, për të cilën po flitet shumë kohët e fundit?

Nuk ka dallim në mes të fesë dhe shkencës, por dituria përfshihet në planprogramin e fesë, sepse askush prej njerëzve të fesë nuk thotë: Ai i cili mëson kiminë, është pabesimtar. Ne themi "Feja dhe jeta".

Fjala fe i ka frikësuar ata që mendojnë për këtë botë, e jo për fenë, dhe fjala "botë" ka frikësuar fetarët prej kësaj bote. Ne u themi atyre: nuk ka "fe dhe jeta". Kjo botë është përballë botës tjetër, ndërsa feja përfshin që të dyja. Atyre, të cilët kujdesen për këtë botë, u thonë disa: ata janë pabesimtarë, ndërsa atyre, të cilët kujdesen për botën tjetër, disa u thonë: të prapambetur. Ne u themi se kjo nuk është e drejtë, sepse përballë botës tjetër është kjo botë dhe feja i përfshin që të dyja, sepse bota tjetër nuk është tematikë apo çështje e fesë së botës tjetër, por është shpërblim dhe dënim.

SHPIFJA NDAJ ISLAMIT

Në librin EARLY MANKIND IN THE WORLD të historianit të njohur dhe arkeologut J.Henry Breasted, i cili është dijetar me famë dhe është studiues i njohur, kur ka qenë në pyetje Islami dhe përhapja e tij, e kam parë se ka shkruar: Islami është përhapur me teh të shpatës. Kur e kam lexuar këtë tekst, jam brengosur shumë. Këtë thënie, të cilën dëshirojnë t'ia mveshin Islamit orientalistët dhe të ngjashmit, nga shkaku se e urrejnë dhe kanë xhelozi ndaj Islamit, sepse për një kohë shumë të shkurtër, nëse e krahasojmë të njëjtën kohë me popujt tjerë, islami është përhapur prej Indie deri në Andaluzi, që do të thotë i ka tejkaluar kufijtë kontinental të tokës. Dhe kjo të bën të dyshosh se si mund të përhapej ashtu aq shpejt me egërsi dhe me shpatë Islami!? Për këtë çështje Shejh Sheëraviu thotë: Islami është përhapur me mësimin e të dobëtëve dhe nuk është përhapur prej të fortëve. Për këtë arsye, kur ndokush prej tyre thotë: Islami është përhapur me shpatë, ne i themi atij: Kjo është e papranueshme. Pasi që po thoni Islami është përhapur me shpatë, kush e ka pasur në dorë shpatën apo kush e ka shtyrë ta kapë shpatën. Kjo do të kishte qenë në rregull sikur Muhamedi .a.s. të kishte ardhur pejgamber me shpatë dhe do t'i kishte detyruar njerëzit të besojnë; mirëpo, mu ata, të cilët i kanë besuar, kanë qenë të dobët. Ne nuk po flasim për shpatën, e cila është marrë, por për atë, i cili ka qenë bartës i shpatës, në rend të parë.

Edhe nëse pranohet (pretendohet) se Islami është përhapur me shpatë, kush e ka mbajtur shpatën? Çështja është: Çka i ka shtyrë ata, të dobëtit, të bëhen të fortë dhe të mbajnë atë shpatë apo armë në dorë? Duhet të shikohet çështja e parimit, sepse Islami ka ardhur të paraqesë rregulla dhe parime, e jo për ta mbajtur shpatën mbi kokë.

DALLIMI NË MES TË DITURISË DHE EDUKATËS

Cili është dallimi në mes të diturisë dhe edukatës?

Imami i nderuar, Shaëraviju, thotë:

Dituri do të thotë të depërtuarit e diturisë prej dijetarit në mendjen e nxënësit, ndërsa edukatë do të thotë që njeriu të marrë në përgjegjësi sjelljet e tij për atë që ka mësuar. Kjo për arsye se dituria fetare kërkon sjellje për atë që e ka mësuar njeriu, ndërsa kimia nuk kërkon të ndryshojë "sjelljen" me formulat e saj. Feja është sistem i aktivitetit tënd dhe nuk është vetëm çështje e lëvizjes së trupave. Aty ka çështje, të cilat nuk dëshiron që t'i ti veprosh, mirëpo kërkon prej teje t'i veprosh, si dhe çështje, të cilat ti i dëshiron, mirëpo kërkohet prej teje të mos i veprosh.

Pyetje: Po, atëherë pse feja përkufizohet vetëm me medrese mesxhide e universitete dhe përmbajtja e fesë është bërë shumë e vështirë?

Përgjigjja: Kjo nga shkaku, siç thamë më parë, se fillon prej të mësuarit. I mësuari duhet të ketë mostër të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe shëmbëlltyrë me karakter Islam në aspekt të përgjithshëm, ose le të zgjedhin tjetër profesion. Duhet që sjelljet e tyre t'i harmonizojnë me atë, me të cilën është ballafaquar i Dërguari i Allahut s.a.v.s., që pastaj ata t'ua pasojnë nxënësve të tyre. Muhamedi a.s. ka përjetuar çka ka përjetuar, mirëpo asnjë prej dijetarëve Islam nuk ka përjetuar vështirësi, të cilat i ka përjetuar Muhamedi a.s. Pra, mostra dhe kopjimi i saj janë bazament i suksesit ne procesin e mësimit fetar.

IDHUJTARIA E HAPUR

Në revistën Islame "DHAIATU SAJT", njëri prej komentatorëve të kësaj reviste ka shkruar një artikull dhe në fund të atij artikulli ka shkruar këtë dua: *O Zot im, bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit.* Më vjen shumë keq për këtë, lus Allahun të na udhëzojë, të na harmonizojë veprat tona dhe përfundimi ynë të jetë i mirë.

Shejh Shaëraviju thotë: Të gjitha cilësitë dhe emrat e Allahut janë edhe te krijesa. Ne shikojmë vetëm atë masë, të cilën Allahu i ka përshkruar cilësitë e tij, ndërsa realitetin e vërtetë të atyre cilësive nuk është e domosdoshme ta dimë. Allahu ka thënë: "Unë dëgjoj", "Unë shikoj". Pra, ai ka të dëgjuarit, të shikuarit. Mirëpo, mos e merr ti formën e dëgjimit dhe të shikimit, që ti i njeh në krijesa. Vërtet, dëgjimi dhe shikimi i Allahut është si te ne. Parashtrohet pyetja: Pse? Sepse ti gjykon me logjikën tënde se Zoti ekziston, e po ashtu, edhe krijesat ekzistojnë, ...mirëpo a është krijesa si krijuesi? JO! Pasi që Krijuesi nuk është si krijesat, pse atëherë shikimin dhe dëgjimin e Krijuesit t'i bëjë si shikimin dhe dëgjimin e krijesës? Në esencë, ti ndryshon se je krijesë, e Ai Krijues. Allahu është i Gjallë, njeriu është i gjallë, pasi që Flet. Mirëpo, a është Jeta e Allahut si jeta ime? JO! Kur thuhet një emër apo një cilësi e Zotit e njëjta cilësi si te njeriu, atëherë ti je para dy çështjeve: Atë mos ta përshkruash si të njeriut, por as mos ta mohosh. Pra, nëse dikush thotë: "Nuk ka të dëgjuar, sepse dëgjimi është cilësi e njeriut", ne i themi se : "Ti po bën krahasim të gabuar, sepse ne shohim aparatin e të dëgjuarit, e ti veç ke për ta pastruar nga kjo. E ti, vërtet, dëshiron ta pastrosh Allahun, mirëpo pse ti po e hedh poshtë tekstin Kur'anor.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: "Unë dëgjoj", ndërsa ti po thua se ai posedon të dëgjuar. Mirëpo, forma e të dëgjuarit nuk është çështje e imja, sepse Mënyra se si gjithmonë është çështje e besimit IMANIT.

VENDET KU NUK PËRMENDET EMRI I ALLAHUT

A ka vende ku nuk lejohet të përmendet emri i Allahut dhe, nëse ka, cilat janë ato?

Përgjigjja: Po! prej këtyre vendeve janë WC-ja dhe banjot, në momentet kur kryhet nevoja. Kjo për arsye të pastrimit të emrit të Allahut të Lartmadhëruar nga këto vende të fëlliqura. Ka edhe vende të tjera ku besimtari nuk është mirë të përmendë emrin e Allahut. Në vendet apo, më mirë të themi, në momentet kur dikush vjen e kërkon diçka prej teje, e ti nuk ke për t'i dhënë, ne e kemi bërë traditë të themi "Zoti të dhashtë"; dhe që në çastin kur i thua "Zoti ", ai e kupton se ti nuk je duke i dhënë. E, ai e urren këtë fjalë, këtë arsyetim kur ti e përmend Allahun, sepse lypsi e urren atë se ti nuk je duke i dhënë gjë. Nëse ndonjë nënë e ka humbur (i ka vdekur) birin e saj të vetëm, ndërsa ne shkojmë ta ngushëllojmë, nuk është e drejtë t'i themi asaj, ashtu siç i thonë shumica e të paditurve: "Allahu është, Ai i cili e ka bërë këtë, ne nuk mund të bëjmë asgjë. Por, e drejtë është të themi "Caktim", pra, vetëm caktim. Shtrohet pyetje: pse? Sepse: Që në çastin kur i thua Allahu, ajo mund të jetë e hidhëruar në Allahun.

Pra, besimtari duhet të jetë vizionar, ai mund të dijë dhe atëherë të përcaktojë kohën kur ta përmendë Allahun. Emri i Allahut të përmendet me sinqeritet dhe ta pastrojë emrin e Tij, e kur ta pastrojë në heshtje, pra pa e përmendur, ai veç e ka përmendur emrin e Allahut, për shkak të seriozitetit dhe pastërtisë së emrit të Tij.

INSTIKTIVITETI I GJUMIT

Gjumi është shenjë e madhe. Zoti e ka krijuar për ta zëvendësuar shenjën e ditës, e kështu ka bërë kombinim të balancimit. Cila është e vërteta e asaj që thuhet se është begati dhe shenjë?

Përgjigjja: Gjumi është begati e madhe prej begative të Allahut. Ti ndoshta e ngarkon dhe e angazhon veten për së tepërmi, mirëpo nuk të lërë që të vazhdosh ashtu, por thotë: Jo, mori fund, pusho, ndale punën tënde përkohësisht. Ky është instiktiviteti i gjumit dhe mjet i njeriut, e mjeti punon,

sepse ndoshta lodhesh, por prapë ti mundohesh, e angazhon veten shumë; mirëpo, vjen koha kur thotë: Ndalu. Nuk është më kohë e përshtatshme për punë; prit deri sa të të rikthehet fuqia dhe forca.

Gjumi është pushim, e për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar thotë: A nuk e kemi bërë gjumin tuaj pushim për ju?

Pra, ko është prej begative të mëdha të njeriut. Dhe, përderisa gjumi ia ndërpret njeriut lidhjen me këtë jetë, është pushim. Subat do të thotë: ndërprerje. Të ka ndërprerë prej punës dhe aktivitetit. Mëshirë dhe përgatitje për njeriun, për aktivitetin e mëtutjeshëm. Gjumi të humbë vetëdijen, ndërsa humbja e vetëdijes për një kohë të caktuar është begati e madhe. Nëse ti ke dhembje në një pjesë apo organ të trupit, që në momentin kur të flesh, ndalet dhembja, e pas gjumit, pra kur të zgjohesh, prapë rifillon dhembja. Ky është argument se gjumi është mëshirë, qetësim i sëmundjeve dhe i dhembjeve.

HALLALLET E ARIT TË FEMRAVE

A është hallall apo haram stolisja e hallhalleve të femrave me ajete Kur'anore?

Përgjigjja: Lejohet që në hallhalle të arit të jenë të shkruara ajete të Kur'anit apo fjala e Allahut, mirëpo atëherë femra duhet pasur kujdes t'i ketë ato kur të jetë e pastër, e gjithashtu nuk lejohet që të hyjë me to në WC .

BOTA TJETËR

Si do të jetë bota tjetër?

Gjatë jetës sonë përjetojmë dy gjendje: jeta në gjumë dhe jeta e zgjuar; dhe a mund të thuhet se është e njëjtë gjendja (ligji) e gjumit me gjendjen (ligjin) zgjuar. Ne shohim se kanë dallim të madh, edhe pse në të dy rastet ekziston jeta. Pra, kur themi: Vdekja është jetë e botës tjetër dhe në atë botë ka sistem tjetër të jetës, patjetër duhet të besojmë, sepse ti po sheh në gjumë, deri sa sytë tu janë mbyllur, pra ka mjete të tjera të shikimit, pos syrit, me të cilët mund të shihen njerëzit, "ngjyrat dhe vendet. Kur kjo të ndodhë, atëherë në trupin e njeriut paraqitet vetëm një gurëzim i vogël. Po, nëse na thuhet neve: Në varr ka jetë tjetër, kur kjo jetë përfundon, atëherë ajo jetë patjetër duhet të jetë më e fuqishme dhe më e fortë. Në ëndërr ushqehemi, pimë, ndiejmë të hidhurën, ëmbëlsirën, dhe, kur të shohim ëndrrën, e tregojmë gjatë, edhe pse shkencërisht është e vërtetuar se ëndrra më e gjatë nuk zgjatë më shumë se shtatë sekonda. Pra, kjo do të thotë se koha është mënjanuar, thjesht nuk ka ekzistuar. Kështu, ne, në njërën anë, shohim se një njeri sheh ëndërr që është në mesin e shokëve të tij, qesh, ha, gëzohet, ndërsa tjetri, në anën tjetër, sheh ëndërr se armiqtë e tij e rrahin. As ky nuk ndien çfarë i ka ndodhur tjetrit, as tjetri nuk di se çfarë i ka ndodhur këtij.

Për këtë arsye Muhamedi a.s. na ka tërhequr vërejtjen, kur ka thënë: Ju do të vdisni, sikurse do të flini, e do të ringjalleni, sikurse do të zgjoheni.

E, përderisa ligji i gjumit ndryshon prej ligjit të jo gjumit, ashtu ndryshon edhe ligji i vdekjes prej atij të jetës.

Me ndihmën e Allahut përfundoi pjesa e shtatë e librit "Fetvatë e të nderuarit tonë, Shejhut Muhamed Muteveli Shaëravijut", dhe pason pjesa e tetë, nëse dëshiron Allahu.

FETAVATË E SHAËRAVIJUT

PJESA E TETË

VIII

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

Kaçanik, 2015

HYRJE

Falënderimet i takojnë Allahut, Zotit të të gjithë botëve. Zotit të Madh dhe të gjithë madhështive. Përshëndetjet qofshin për zotërinë tonë Muhamedin s.a.v.s., i cili është vulë e të dërguarve dhe pejgamberëve dhe, po ashtu, ndërmjetësues në ditën e Tubimit dhe të Gjykimit.

Falënderojmë Allahun, i Cili e ka mbajtur premtimin duke na e bërë tokën që të jetojmë në të me të gjitha të mirat. Nuk ka Zot tjetër pos Zotit Një, të vetëm. Nuk ka fare fuqi që mund të ndryshojë diçka, pos Allahut të Madh të Lartë. Prej atij kërkojmë ndihmë, mbrojtje dhe sigurim.

O Zoti ynë, nga Ti kërkojmë mbrojtje prej pasanikut të keq dhe të varfrit të poshtër. O Zoti ynë, nga Ti kërkojmë mbështetje që të mos harrojmë e të biem në grackat e shkatërrimit, mos lejo që të flasim e të mos veprojmë. Punët tona vulosi me të mira. Mos lejo që veprat e këqija të na afrohen gjatë jetës dhe para përfundimit të jetës.

O Zoti ynë, shpresojmë në lutjet tona, lutjen e të dobëtit, të cilin nuk e kthen duarthatë, dhe lutjen e të dëmtuarit, të cilit i është bërë padrejtësi.

O Zoti ynë, nëse shkojnë të mirët, na dërgo pas tyre.

O Zoti ynë, na jep për këtë botë pasuri, e për botën tjetër devotshmëri; na pajis me punë të mira dhe na mundëso që të arrijmë grada të larta.

O Zoti ynë, mëshiroji nënat tona, bëji banore të xhenetit dhe të përjetojnë të gjitha të mirat në të. O Zoti ynë, mëshiroji të vdekurit dhe të gjallët tanë, sepse ata kanë nevojë për faljen dhe mëshirën tënde, sepse askush nuk mund të hyjë në xhenet për shkak të veprave të tij, por me ndihmën tënde, ndërsa mëshira jote përfshin çdo gjë.

O Zoti ynë, mos na largo prej mëshirës Tënde, sepse Ti je i Mëshirshmi i të gjithë mëshiruesve. E pastë përshëndetur Allahu zotërinë tonë - Muhamedin a.s., familjen e tij dhe të gjithë shokët e tij.

Sejid Xhemilë, Rexhep, 1402, Maj, 1982, KAJRO.

NJERËZIT JANË THESAR

A janë njerëzit thesare, siç po pretendohet?

Po, njerëzit janë thesare. Të vërtetën e ka thënë poeti i njohur Ahmed Shevki: Njerëzit janë dy llojesh:

Citoj vargjet e tij, Zoti e mëshiroftë:

Njerëzit janë dy llojesh: të vdekurit mbi dhe, të cilët po jetojnë, dhe të tjerët nën dhe, të gjallë.

Nëse e bëjmë një analizë të njerëzve në fytyrë të tokës, shohim se ata janë dy llojesh:

Njerëzit e mençur, të cilët mund të binden me fakte e argumente dhe;

Njerëzit injorantë që janë zhytur në injorancë, të cilët nuk binden dhe nuk i pranojnë argumentetet, por i kundërshtojnë, tregohen kryelart dhe paraqiten të padrejtë.

I nderuari ynë, Muhamed Muteveli Shaëraviju, na e vërteton neve se nëse Allahu dëshiron që një parim prej parimeve ta udhëheqë, atëherë e drejta patjetër duhet ta ketë fuqinë e argumenteve, për t'i bindur të tjerët dhe për t'i gjunjëzuar të tjerët me mprehtësinë e gjuhës.

SHOQËRIA IDEALE

Pyetje: Cila është shoqëria ideale për të cilën me të madhe po flitet?

Përgjigjja: Shoqëri ideale është ajo shoqëri, e cila i plotëson të gjitha kushtet e jetesës, të të gjitha nevojave dhe të të gjitha fushave. Arrihet atëherë kur njeriu kërkon shërim, i sigurohet shëndetësia, kërkon punimin e tokës, i plotësohen mjetet për ta punuar, kërkon investime për zhvillim, i jepen investime, e po ashtu, kërkon mjete për hulumtim, i plotësohen kushtet dhe ndahen mjete për atë qëllim. Mirëpo, ta zëmë se e gjitha kjo është arritur, e pas kësaj paraqiten trazira në ndonjë vend tjetër, se asaj shoqërie i mungon idealizmi, atëherë duhet shikuar formë tjetër për të siguruar atë ekuilibër, për t'u arritur siguria në brendi të asaj shoqërie dhe për t'u arritur siguria nga frika se nga jashtë nuk mund t'ua prishë ndokush rendin dhe qetësinë.

KONTRATA PROFITABILE

Blerës është Allahu, shitës janë shpirtrat e besimtarëve, shpërblimi (mjet i pagesës) xheneti. Qëllimi kryesor i njeriut është që të jetojë i lumtur dhe i qetë. Sado që të jetë i shtrenjtë xheneti, duhet arritur sa më shpejtë, ashtu siç e ka shpejtuar sahabiu i njohur, i cili i ka thënë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: "A është e vërtetë se mes meje dhe xhenetit është vetëm një çështje, e ajo është shkuarja ime në front që të luftoj pabesimtarët, e të me vrasin". I është përgjigjur: Po, gjithsesi!

Ai i kishte në gojë hurmat, e nuk ka dashur të jetë gjallë e t'i hajë ato hurma, por i ka nxjerrë prej goje, shkon në front dhe vritet.

Po ashtu, përsosmërinë e kontratës dhe fuqizimin e saj e bën arsyetimi në Islam, për të shkuar në Xhihad vullnetar.

Amër Ibn Xhunuhe ka pasur arsyetim që të mos shkojë në luftë, sepse ka qenë i çalë, e u thotë djemve të vet: "Patjetër duhet të bie shehid në këtë betejë". I thonë: "O babai ynë, mjafton që ne jemi duke shkuar në këtë betejë", e ai u thotë: "Jo, nuk mjafton. Unë dua patjetër të bie shehid në këtë betejë". Djemtë kanë tentuar për ta penguar, ndërsa ai shkon te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. dhe i thotë: "O i Dërguari i Allahut, djemtë po më pengojnë të shkoj në luftë". E, Muhamedi s.a.v.s. i thotë: "Allahu të arsyeton, nëse nuk shkon", sepse i verbëri, i çali dhe sakati nuk kanë mëkat, nëse nuk shkojnë në luftë (sepse kanë arsyetim)". Amr Ibn Xhunuhe i thotë: "Për ZOTIN, O i Dërguari i Allahut, unë kam dëshirë që të shkeli në xhenet me këtë këmbë të çalë". I Dërguari i Allahut s.a.v.s. buzëqesh dhe kërkon prej djemve të tij ta lejojnë që të shkojë në luftë, edhe pse ka pasur arsyetim prej Allahut dhe me sheriatin Islam. Mirëpo, edhe përkundër kësaj, ai e ka pëlqyer kontratën profitabile dhe ka dashur të fitojë.

Ah! Po çfarë kontrate! Ai ashtu-kështu do të vdesë; vdekjes nuk mund t'i ikën askush. E, pse të mos e japësh jetën me çmim të shtrenjtë, pse të mos e japësh jetën me kontratë profitabile, i cili para njerëzve duket i vdekur, ndërsa ai është i gjallë dhe furnizohet deri në ditën e kjametit!

Po sa janë të mençur ata? Ata vendosin në peshojë kontratat. I kanë të gjitha të mirat dhe bukuritë e kësaj bote, përderisa besimtari jeton në frymën fetare; dhe atëherë kur ta vërtetojë se lidhja e kontratës është me ZOTIN e tij, të cilit i beson dhe i Cili e realizon premtimin, ai i cili e lidh atë kontratë, meqë nuk ka çka të tubojë më të mira, është i sigurt se do të vdesë, mori pjesë

në luftë, apo jo.

GJENIALITETI I MUHAMEDIT

Profesori Abas Akadi ka shkruar një seri librash për gjenialitetin, për të bërë analizë rreth personaliteteve Islame me famë, si në aspektin filozofik, shpirtëror, edukativ e shkencor. Në ato libra ka paraqitur gjenialitetin e Muhamedit s.a.v.s., të Ebu Bekri Sidikhit, të Omerit, gjenialitetin e Halid bin Velidit etj.

Çka mendon Shejh Shaëravuju në lidhje me këtë?

I nderuari Imam thotë: Deri sa rahmetliu, Profesor Abas Mahmud Akadi, ka shkruar librat serik të "gjenive", Allahu e di dhe Ai është dëshmitar se kam shkruar dhe kam thënë: Nëse lejohet që për ndonjë sahabe të themi gjeni (gjenialiteti i Ebu Bekri Sidikit, ose gjenialiteti i Omerit), kjo nuk lejohet të thuhet për të Dërguarin e Allahut s.a.v.s (gjenialiteti i Muhamedit), sepse Muhamedi s.a.v.s. nuk ka pasur asgjë të përbashkët me gjenialitetin në lidhje me procesin (misionin) e tij. Për këtë arsye edhe Zoti i Lartmadhëruar ka dëshmuar analfabetizmin e tij. Dhe vetë dëshmia e analfabetizmit të tij e absorbon mendimin se ai nuk ka qenë analfabet dhe se nuk ka pasur ndonjë epitet prej epiteteve njerëzore. Allahu ka dashur të jetë ashtu, pra nuk i ka lejuar epitet prej epiteteve njerëzore. Çdo gjë që ka poseduar ai, nuk ka qenë prej epiteteve njerëzore, por epitet qiellor.

Kjo do të thotë se Allahu është Ai, i Cili e ngriti çështjen dhe epitetin e tij shkencor. Është e vërtetë se njerëzit kur të dëgjojnë fjalën analfabet, e marrin si mangësi, por e vërteta nuk është ashtu. Analfabetizmi në mua nënkupton mangësinë time, ndërsa analfabetizmi në Muhamedin s.a.v.s nënkupton përsosmëri, sepse çdo gjë i ka ardhur prej Zotit të vet. Ndërsa nëse e them këtë (gjenialitet), e kam zhvlerësuar vlerën e burimit.

E, pas kësaj ka thënë: Ka popull analfabet, sepse populli është ai, i cili e bart mesazhin, e bart sistemin legjislativ, pastaj e kështillon botën, e bota (popujt tjerë) mahniten. Me fjalë të tjera, kjo nuk është shkallë e civilizimit, sepse populli analfabet nuk ka të bëjë me këtë. E, kur të behet pyetja: Prej nga ka ardhur e gjithë kjo? Ne përgjigjemi: prej qiellit. Ndërkaq, po të kishte qenë në pyetje një epokë e civilizimit, kjo do t'i kishte ndodhur në epokën e civilizimit Persian apo Ramah. Ne do të kishim thënë: Epokë e civilizimit,

sikurse epokat tjera civilizuese. Mirëpo, kjo ka ndodhur në vendet arabe, me popullin analfabet. Për këtë arsye edhe Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **Thuaj: Po të kishte dashur Allahu, nuk do t'jua kisha lexuar juve dhe nuk do t'jua kisha pranuar (mësuar) e përcjellë juve, sepse veç kam jetuar tërë këtë jetë në mesin e juve më parë. A nuk po logjikoni? (JUNUS, 16)**

Pos kësaj, kush do të arrinte gjenialitetin tek pas viteve të katërdhjeta, ndërsa ne e dimë se gjenialiteti te njeriu paraqitet në vitet e njëzeta a të tridhjeta. A është e mundur që dikush ta ketë në vete gjenialitetin e ta paraqesë vetëm pas viteve të katërdhjeta. Thonë: Jo, e ka pasur të lindur gjenialitetin, por ka pritur t'i paraqitet pasi të arrijë pjekurinë, pas viteve katërdhjeta. Ne u kundërpërgjigjemi: Po kush mund të dijë se unë do të jetoj deri sa të më paraqitet, kurse njerëzit për ditë vdesin. Ky vdes në kaq vjet, e ai në aq vjet.

Kush i garanton atij se do t'i arrijë të katërdhjetat, e pastaj t'i paraqitet gjenialiteti. Pra, gjenialiteti njerëzor është e mundur për njeriun. Por, bëhet pyetja: pse? Sepse te ai do të kenë ndikim rrethanat dhe njerëzit përreth tij, e pastaj ai ndikon te të tjerët. Kështu, thënia e Akadit për sahabet është në rregull, ndërsa për të Dërguarin e Allahut s.a.v.s nuk është në rregull, sepse arsimimi shkencor i tij nuk është nga njeriu, por nga lart, pra nga Zoti.

NË MES TË SHPIRTIT DHE TRUPIT

Qenia njerëzore përbëhet prej dy komponenteve: atij shpirtëror dhe trupor. Elementet kimike në trupin e njeriut reflektohen vetëm atëherë kur shpirti është në të; që në çastin kur ndahet prej tij aktiviteti i tij, paralizohet në tërësi.

Të fjeturit nuk i shkruhen mëkatet deri sa të zgjohet, sepse shpirti në atë çast është i ndarë prej trupit dhe konsiderohet sikur të mos kishte qenë fare. Ose të themi: Shpirti dhe trupi së bashku kanë përgjegjësi të plotë për mëkat, si përgjegjësi e tyre ndaj padëgjueshmërisë së Krijuesit të Lartmadhëruar. Çka mendoni në lidhje me këtë?

Përgjigjja: Imami i nderuar, Shejh Shaëraviju, thotë: Materia e tërë ekzistencës është materie e vullnetit, tesbihut dhe adhurimit. Për këtë arsye,

që në momentin kur të mungon dëshira e dëshiruesit nga materia, atëherë materia kthehet në natyrshmërinë e saj.

“Atë ditë kur kundër tyre do të dëshmojnë gjuhët e tyre, duart e tyre dhe këmbët e tyre për atë që kanë vepruar”. (EN-NURË, 24)

Sepse atëherë nuk do të ketë askush pushtet mbi ta, por pushtet mbi ta ka Allahu. Ti ke pasur më herët pushtet mbi pjesët tua dhe se pjesët e trupit nuk mund të të kundërshtonin, sepse ke pasur pushtet të drejtpërdrejtë mbi ta. Ndërkaq, në Ditën e Kijametit nuk do të kesh pushtet mbi pjesët e trupit, e për këtë arsye edhe do të dëshmojnë kundër teje.

Materia e trupit të pabesimtarit është e gjykuar të madhërojë Allahun, sepse dëshira e pabesimtarit nuk ka ndikim në të; por, edhe pse ai nuk e madhëron, e madhëron materia e tij. Reflektimi i dëshirës së pabesimtarit është pabesimi i tij, mirëpo materia e tij i nënshtrohet dhe madhëron Zotin e Lartmadhëruar.

Mos thuaj: shpirtëror dhe material. Kjo thënie është e cekët, sipërfaqësore, e nuk është term shkencor. Gjërat për nga natyrshmëria e ekzistimit të tyre janë adhuruese dhe madhëruese te Allahu. Për këtë arsye, as mos e cilëso vetëm materien, mos e cilëso as vetëm shpirtin, sepse bëhet fjalë për “NEFSIN”, e kuptimi i “NEFSIT” është se shpirti është i ngritur për materien; pastaj vjen vullneti dhe çështjet tjera, e tek pastaj ndodhin çrregullimet.

MOS TA KTHEFTË ALLAHU TË HUMBURËN

Pyetje: Kur një njeri ka shkuar ne xhami dhe e ka kërkuar një send të humbur, i Dërguari i Allahut s.a.v.s. i ka thënë: “Mos ta ktheftë Allahu”. Pse i ka thënë kështu?

Shejh Shaëravij përgjigjet: Sepse xhamia është një vend ku njeriu (vizitori) duhet të dijë se nuk duhet t’i shkojë mendja askund tjetër, pos që të jetë drejtpërsëdrejti me Allahun e Lartmadhëruar.

Pasi xhamia është destinuar për këtë adhurim, atëherë kjo nënkupton se në të nuk ka pse të zhvillohet ndonjë aktivitet tjetër i jetës, sepse namazi është adhurim. Vërtet, xhamia është vendi, të cilin robi e ka emëruar për

Allahun dhe çdo akt tjetër, të cilin e kryejnë njerëzit në shtëpinë e Allahut, patjetër duhet të jetë gjykuar që ajo kontratë të dështojë.

Për këtë arsye besimtari, që në momentin kur hyn në xhami, le ta bëjë nijet se është duke bërë iëtikaf se do të qëndroj në xhami, sepse njeriu, nëse flet për çështje, e cila nuk ka të bëjë me Allahun, le ta dijë se për atë çështje nuk do të ketë sukses. Disa njerëz e kanë bërë traditë që në xhami t'i bëjnë takimet e kontratave në shitblerje apo takime për interesa të dynjasë, ndërsa ata harrojnë se xhamia e ka rolin vetëm për ibadet dhe përfitim të diturisë. Ndërkaq, ata duhet ta dinë se çdo kontratë apo çdo aktivitet prej aktiviteteve të kësaj bote që zhvillohet apo kontraktohet aty, është e pabereqetshme.

Pyetje: Cila është arsyeja e mekruhit të tregtisë në xhami?

Imami i nderuar përgjigjet: Kur çështjet (interesat) e dynjasë hyjnë te njeriu, fillojnë grindjet, kacafytjet, mospajtimet, ngriten zërat etj., e kjo ndikon te çdo njeri që ta ndiejë veten të nënçmuar e të turpëruar, që ashtu ta takojë Allahun dhe të qëndrojë para tij.

Imami i mirënjohur pastaj thotë: Në xhami takimi i vëllezërve besimtarë duhet të jetë takim i afrimit dhe i dashurisë mes vete, e jo takim i konfliktit.

Takimi me Allahun në xhami duhet të prodhojë qetësi të zemrës, e jo të jetë qëllim për përfitim të dynjasë, sepse aty jemi në praninë e Bamirësit të Përgjithshëm.

Çka mendon për përcaktim të gjithhershëm të një vendi në xhami? Pse Allahu e ka ndaluar atë?

Përgjigjja: Disa njerëz shkojnë në xhami dhe ulen gjithmonë në një vend, ndërsa harrojnë se Pejgamberi s.a.v.s e ka ndaluar uljen gjithmonë në një vend, e kjo do të thotë se është haram, sepse duhet shkelur nëpër krahë të xhematit për të arritur të vendi i caktuar i tij.

A është e vërtetë se rreshti i parë ka vlerë më të madhe se rreshti i dytë dhe i rreshtave të tjerë?

Përgjigjja: Vendqëndrim (radhitje) në xhami konsiderohet ajo, e cila

është më herët se thirrja e Allahut. Disa mendojnë se rreshti i parë ka shpërblim më të madh se rreshti i fundit. Jo, kjo nuk është e vërtetë, sepse është e palogjikshme që njeriu të vijë pas thirrjes së ezanit, të shkelë xhematin, t'i ngushtojë ata për të arritur te rreshti i parë. Rreshtat dhe renditjen e bën Allahu, e jo ne.

Njeriu duhet ta pyes veten e tij: Si të hyjë në shtëpinë e Zotit tim duke shkelur kështu mbi supet e tjerëve? Besimtari duhet të ulet në çdo vend të xhamisë, pa ngushtuar askënd, sepse qëllimi i hyrjes në xhami është që ta heqë egoizmin prej vetes së tij, përfitimit të kësaj bote dhe ta përfitojë plotësisht dashurinë e Allahut; se hyrja dhe qëndrimi në xhami është përforcim i imanit, pastrim dhe shkëlqim i shpirtit me rreze të reja drite. Po, edhe nëse është i vërtetë teksti, pra alegoria e vërtetë, ne prapë themi: Bateritë e zemrës mbushen me dritën, shkëlqimin dhe prezencën para të Gjithëmëshirshmit dhe në momentin, kur t'i mbush bateritë e tij me dritën e të Gjithëmëshirshmi, njeriu duhet të dalë prej xhamie për të vazhduar jetën dhe aktivitetin e tij, pasi që në xhami ka përforcuar imanin, devotshmërinë, mirësinë dhe kënaqësinë e të Gjithëmëshirshmit.

DHJETË DITËT E FUNDIT TË RAMAZANIT

Cila është urtësia (arsyeja) e qëndrimit të dhjetë ditëve të ramazanit në xhami (i cili është sunet)?

Përgjigjja: Qëllimi është ngritja dhe lartësimi i ngarkimit me obligime, me qëllim që muslimani të pastrohet plotësisht, sepse, në rend të parë, vetë agjërimi është ushtrim dhe trajnim i njeriut për t'ia ndaluar vetes sendet e lejuara dhe iëtikafi me dhjetë ditët e fundit të Ramazanit është sunet; po ashtu, muslimani ka të drejtë të qëndrojë në xhami ose në shtëpi. E, kur njeriu zgjedh që të largohet prej vendit dhe familjes së tij, kjo nga arsyeja që njeriu t'i ndajë disa ditë vetëm për Allahun, të shkojë e të qëndrojë në xhami dhjetë ditë dhe të pastrohet e të ndriçohet me dritën, e cila depërton thellë. Pasi njeriu veç e ka lënë familjen e tij, pasurinë e tij, e në atë trajnim, apo ushtrim, është udhëtimi tjetër, pra plotësimi i ruknit të pestë të Islamit, haxhi; sepse në atë ditë udhëtimi njeriu lë familjen e tij, vendin e tij, pasurinë e tij dhe synon

shtëpinë e Allahut.

Kështu, ietikafi bëhet ushtrim i devotshmërisë dhe përgatitje për të shkuar në Qabe, në të cilën çdo musliman shkon me zemër dhe e forcon ashtu fort bindjen në zemrën e tij, sikur është duke e parë drejtpërsëdrejti.

GJËRAT E NËNSHTRUARA PËR NJERIUN

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Dhe Ne e kemi krijuar njeriun dhe ia kemi bërë shtrojë (në shërbim të tij) ç'ka në tokë e në det."** Po ashtu, ka thënë: **"Ka krijuar gjithçka në tokë për të gjithë ju**". Njeriu në këtë gjithësi është epiqendra. Zoti i Lartmadhëruar ia ka nënshtruar çka ka në tokë, e çka ka në det, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Është Ai, i Çili ka bërë tokën shtrojë të dobishme dhe të përshtatshme, andaj ecni nëpër të dhe ushqehuni prej furnizimeve të saj"**. Në thënien e Zotit të Lartmadhëruar "për ju" dhe thënies "të përshtatshme" tregohet qartë se sa janë të nënshtruara krijesat prej Allahut për krijesën njeri. Parashtrohet pyetja: Pse Allahu i Lartmadhëruar të gjitha këto çështje i ka nënshtruar për njeriun?

Shejh Shaëraviju përgjigjet: Vërejmë se Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: "ka krijuar për ju", pra për të gjithë njerëzit, e jo vetëm për besimtarët. Në hadith kudsij Zoti i Lartmadhëruar thotë: "O biri i Ademit, sendet i kam krijuar për ty, ndërsa ty të kam krijuar për Mua; mos e lodh veten në ato çka janë për ty, por angazhohu për atë për çka je ti". Ky hadith Kudsij na shtyn të pyesim: A mund t'i shtyjë fuqia dhe aftësia ime këto krijesa që të më shërbejnë mua. Unë nuk kam mundësi të mbizotëroj diellin, hënën, ajrin, ujin, mirëpo ato më shërbejnë mua, pa e përdorur fuqinë time mbi ta. Duhet ta analizoj atëherë këtë për çka është krijuar njeriu?

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Njerëzit dhe xhinët i kam krijuar vetëm e vetëm të më adhurojnë".**

Zoti i Lartmadhëruar e ka krijuar njeriun për të treguar dhe sqaruar se ai e nënshtron të fuqishmin për më të dobëtin. Nuk ia ka nënshtruar njeriut vetëm çështjet, të cilat ka mundësi t'i mbizotërojë, por edhe çështjet, të cilat nuk ka mundësi t'i mbizotërojë. Kështu, shohim se të gjitha fenomenet natyrore nuk kanë të drejtë lirie për të më shërbyer, por ato janë të

nënshtruara për të na shërbyer dhe nuk mund të më refuzojnë për të më shërbyer as dielli, as ajri e as uji, sepse ekzistenca e tyre është paraparë për të qenë ashtu.

Zoti i Lartmadhëruar i ka bërë këto sende në shërbim tonin, për t'u parë fuqia e nënshtrimit të atyre sendeve ndaj neve dhe për t'u parë sundimi absolut i Zotit të Lartmadhëruar ndaj krijesave të Tij, për ta nënshtruar të fuqishmin ndaj të dobëtit; dhe askush nuk mund të ndryshojë diçka në këtë. Pastaj, njeriut i thotë: Ty t'i kam nënshtruar të gjitha në këto çështje dhe të gjitha janë në shërbim tëndin, ndërsa ti duhet të më dëgjosh, për shkak të dashurisë tënde ndaj Meje, ngaqë krijesat tjera janë të nënshtruara pa vullnetin dhe pa dëshirën e tyre. Mirëpo, në disa çështje unë ty të kam dhënë të drejtë zgjedhjeje. Nëse do, më beson dhe më përgjigjesh, e nëse do, mund të mos më përgjigjesh. Atëherë, Allahu kërkon nga ne që ta duam Atë me dëshirë, përderisa ne kemi mundësi ta duam, ose jo, sepse ka dallim të madh në mes të nënshtrimit, imponimit detyrimit dhe dashurisë.

Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar në hadith Kudsij thotë: ***"O bir i Ademit, unë të dua, e detyrë jotja është që të më duash".*** Kjo është shkalla më e lartë e edukatës dhe moralit të njeriut.

BOTA E VËSHTIRËSIVE

Pyetje: Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Vërtet, Ne e krijuam njeriun (të jetojë) në vështirësi të njëpasnjëshme". (El-Beled,4)

"O njeri, vërtet, ti përpiqesh me një përpjekje të madhe, që çon te Zoti yt, e atë (përpjekie) do ta gjesh". (El-Inshikak, 6)

Përgjigjja: Shejh Shaëraviju thotë: Kjo është kështu vetëm për ata që nuk besojnë, ndërsa ata të cilët e pranojnë këtë me iman (besim) në Krijuesin e kësaj bote dhe të tij, jo. Të ekzistuarit e lodhjeve, mundimeve dhe vështirësive është për atë, i cili nuk beson në Zotin, njëherësh është argument për besimin në Zotin dhe vërtetësinë e programit të Allahut. Ne i përgjigjemi pyetësit: Allahu këtë botë nuk e ka bërë botë të vështirësive, lodhjeve dhe dhembjeve, por kjo është e tillë për ata, të cilët largohen nga programi i

Allahut. Për këtë arsye ne shohim se besimtarët janë më të lumturit dhe më të kënaqurit në çdo gjë çka iu është caktuar prej Allahut. Kjo, nëse ti ke për qëllim lodhjen e zemrës, ndërsa, nëse e ke për qëllim angazhimin për jetë dhe lodhjen për ekzistencë, kjo është një çështje tjetër, sepse kërkohet që njeriu të jetë refleksiv me ekzistencën, nëse ai dëshiron të zhvillohet. Allahu ka krijuar ujin, mirëpo unë, në vend se të shkoj për çdo ditë te burimi të pi ujë, të mbushi bidonat dhe t'i plotësoj nevojat e mia, e mbushi një rezervuar të madh dhe e përcjelli deri aty me gypa, e prej aty e afroj brenda në shtëpi. Kështu, ujë kam vazhdimisht, e ky është komoditeti, të cilin e dëshiron njeriu. Mirëpo, për të arritur deri aty, nevojitet lodhje dhe angazhim. Përpos kësaj, ka lodhje dhe angazhim të llojit tjetër, i cili të mundon, e ai është mundimi i zemrës dhe brengosja. Për këtë Kur'ani fisnik thotë: **"Dhe kush prej juve vjen te unë i udhëzuar dhe kush pason udhëzimin, për ta nuk ka brengosje e frikë dhe ata nuk pikëllohen**". Në ajetin tjetër thotë: **"Dhe kush pason udhëzimin tim, nuk do të humbë, nuk do të jetë i lodhur e kryeneç. Dhe, kush ia kthen shpinën librit (këshillave) Tim, ai do të jetojë jetë të vështirë."**

Pyetësi thotë: Vërtet, kjo jetë është krijuar për lodhje e vështirësi, e ne i themi: Kjo botë është e tillë për ata, të cilët ia kthejnë shpinën librit të Allahut. Kjo është e tillë, sepse i paraqitet lodhja dhe mundimi, ndërsa sa i përket besimtarit, kur t'i paraqitet lodhja, ai e di dhe beson se ajo çështje është jashtë çështjeve dhe dëshirave të tij dhe ai shpërblehet për durimin që bën.

DALLIMI NË MES TË "PROGRAMIT" DHE "PROGRAMIT"

A ka dallim në mes të maksimës "Kur'ani program" dhe maksimës tjetër "Kitabi program"?

Imami i nderuar, Shaëraviju, përgjigjet: Kush thotë se Kur'ani ka zbritur si libër PROGRAM, kjo do të thotë se ai program është i vetmi dhe nuk ka tjetër program pos tij. Ndërsa, "Libri program" e lejon që, pos tij, të ketë edhe program tjetër.

Përderisa Kur'ani, në të cilin besojmë, i ka dhënë të drejtë Pejgamberit

s.a.v.s. për ankesë, pra për të ligjësuar diçka, kjo do të thotë se është ligjësuar në Kur'an.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Çka ju jep (dispozitë) i dërguari, pranojeni si vendim, e çka ju ndalon ai juve, ju largohuni dhe pranojeni si ndalesë". (EL HASHIR, 7)**

Kjo dëshmon se ka dispozita të veçanta. Po ashtu, edhe ajeti Kur'anor, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Por jo, për Zotin tënd! Ata nuk besojnë, përderisa të të bëjnë ty (Muhamed) gjykues për të gjitha mosmarrëveshjet mes tyre, përderisa nuk mbetet në veten e tyre (mesin e tyre) asnjë pikë kundërshtimi ndaj vendimeve tua dhe përderisa t'i pranojnë plotësisht (ato vendime) të nënshtruar." (EN-NISA, 65)

Kjo, sepse çka ka vendim të Allahut në Kur'an, i dërguari i Allahut e zbaton dhe e vepron, e çka ka në Kur'an, ai atëherë merr vendim si i autorizuar prej Allahut (Kur'anit). Pra, çka vendos i Dërguari i Allahut s.a.v.s., edhe pse nuk është me tekst të qartë, ai vendos si i autorizuar prej tekstit të qartë të Kur'anit.

ABIDËT DHE UBADËT (ROBËRIT DHE TË ROBËRUARIT)

Pyetje: A ka dallim në mes të fjalisë "të gjithë ne jemi Abidullah" dhe fjalisë "të gjithë ne jemi Ibadullah"?

Përgjigjja: Imami i njohur thotë: Kur njeriu nuk mëkaton, edhe pse ka mundësi, atëherë kjo do të thotë sakrifikim për Allah. Ne që të gjithë jemi Abidullah dhe nuk jemi Ibadullah. Ibad janë ata, të cilët nuk kanë, por në tërësi i janë të nënshtruar Zotit të tyre të Lartmadhëruar. Besimtari thotë: Zoti im, më ke dhënë vullnet dhe liri të plotë, por kërkesat tua do të jenë më të larta se vullneti im. Ndërsa, në ditën e kiametit hiqet e drejta e vullnetit, e lirisë dhe të gjithë bëhemi ABIDUHU. **"Dhe çdo gjë që ka në qiej e në tokë, patjetër do të jenë pranë të Gjithëmëshirshmit ABDA. Ne i kemi numëruar, i kemi llogaritur veç e veç, një nga një".** Përderisa më herët ata kanë pasur vullnet dhe liri në vetvete, për këtë arsye ne në tokë kemi sundim mbi veten tonë. Mirëpo, në ahiret Zoti i Lartmadhëruar thotë: "I Kujt është

sundimi sot?", saqë edhe trupat tanë nuk na dëgjojnë ne.

Këtu, në këtë botë trupat tanë na nënshtrohen neve dhe dëshirës sonë, këmbët shkojnë ku dëshiroj, duart prekin ç'të dëshiroj unë dhe e prekin kë dëshiroj unë. Ofendoj, shaj, flas ç'të dëshiroj dhe gjuha nuk më kundërshton. Ndërsa, në botën tjetër ato më kundërshtojnë dhe dëshmojnë kundër meje, kundër kohës, në të cilën kam pasur liri dhe sundim mbi ta. Mirëpo, atje ka marrë fund: ata janë çliruar në tërësi nga zotërimi im mbi ta.

VETËM PËR MESHKUJT

Pyetje: Pse Allahu i Lartmadhëruar u ka premtuar vetëm meshkujve hyritë e xhenetit, e nuk u ka premtuar grave?

Përgjigjja: Imami i mirënjohur thotë: Zoti i Lartmadhëruar i ka paraparë të mirat e xhenetit në harmoni me atë çka do zemra e shëndoshë dhe ajo që është e drejtë. Femra për nga natyrshmëria e saj e shëndoshë nuk dëshiron të ketë më shumë se një burrë, sa që edhe grave, të cilave u vdesin burrat, refuzojnë të martohen pas vdekjes së burrave të tyre, edhe pse është e drejtë e tyre dhe e kanë të lejuar martesën. Ajo e konsideron si ndershmëri të saj që të mos ketë më shumë se një burrë. Ndërsa, burrëri dhe personalitet i burrit është të ketë më shumë se një grua. E, i ka dhënë burrit atë çka e vërteton burrërinë e tij, ndërsa i ka dhënë gruas ndershmërinë, pastërtinë dhe krenarinë. Ndoshta femra mund të mendoj se burrit i ka dhënë më shumë se asaj, por ne themi: Edhe në këtë botë burrit i është dhënë e drejta të martohet me më shumë se një grua, ndërsa femrës jo. Në xhenet gruaja nuk do të ndahet nga burri i saj, sepse në xhenet nuk shkojmë me natyrshmërinë tonë, pra ndryshon paralelizmi, pra natyrshmëria. Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Dhe Ne do të heqim nga gjokset e tyre çdo pikë hidhërimi dhe inati."** Sadakallahu adhijmë.

PËRSËRITJA E UMRES DHE E HAXHIT

Shkuarja në haxh më shumë se një herë, e cila shkakton turmë të madhe, dhe përsëritja e umres më shumë se një herë, janë mekruh. Dhe a është e vërtetë se dhënia sadaka e shpenzimit të haxhit ka më shumë shpërblim te Allahu?

Përgjigjja: Argumenti më i madh në lidhje me gabimin në këtë mendim është se shumica e haxhilerëve janë për së dyti e për së treti, thuaja se haxhi vullnetar nafile nuk mund t'i imponohet, që në vend të atij veprimi vullnetar, të bëjnë ndonjë punë vullnetare tjetër...Kështu ai vepron ç'të dojë, çka ia do shpirti dhe nuk ka diçka më të vlefshme se ai veprim. Ndërsa, sa i përket të përsëriturit të umres kjo është në rregull, sepse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **"Dhe kush e bën (umren) vullnetarisht (shumë herë), është e dobishme për të".**

Disa thonë: Nuk lejohet që të bëhen më shumë se nje UMRE në një vit, sepse umreja nuk është si haxhi, sepse nuk lejohet të përsëritet ajo çka është në nivel më të ulët se ajo çka është në nivel më të lartë, pasi që nuk e përsëriti kryesoren (haxhin) në të njëjtin vit. Ne u përgjigjemi atyre se haxhi është i caktuar dhe i përkufizuar në kohë, e pasi që është puna kështu, nuk mund të përsëritet në ndonjë kohë tjetër, p.sh. Nuk mund të them se do ta kryej haxhin në muajin sheval apo muajin safer, sepse haxhi e ka kohën dhe nuk lejohet në ndonjë kohë tjetër, ndërsa umreja nuk është e përkufizuar në kohë dhe mund ta kryej në çdo kohë; dhe në çdo kohë që më jepet rasti e përsëris haxhin dhe atëherë çdo gjë është në rregull.

DHUNTI SPECIFIKE DHE ANGAZHIMI PËR DHUNTI

Shumica e njerëzve të rëndomtë flasin për dëshirën e tyre që të jenë evlija, të cilëve Allahu ua shpalos fshehtësinë e Tij, e t'u lajmërojnë njerëzve se ç'do të ndodhë në të ardhmen, çka fshehet në të ardhmen; ata cilësohen evlija të Allahut. Çka mendon Shejh Shaëraviju për këtë?

Cilët janë evlijatë e Allahut?

Përgjigjja: Imami thotë: Allahu kur ta caktojë një njeri të jetë evlija

ose i jep urtësi (fuqi) të drejtpërdrejtë, ose mundësi që ai ta arrijë me angazhim. Allahun nuk mund ta detyrojë çfarëdo shkaku dhe te Ai nuk mund të arrijë askush, pos ai i cili është i dëgjueshëm ndaj Tij. Ka njerëz, të cilët e arrijnë kerametin e Allahut, duke qenë të dëgjueshëm ndaj Tij. Ka njerëz, të cilët me kerametin e Allahut arrijnë shkallën e dëgjueshmërisë ndaj Tij. Pra, i pari në rend të parë e dëgjon Allahun, e për atë arsye Allahu e ngrit në nivelin e kerametit. E te i dyti në rend të parë Allahu e cakton në nivelin e kerametit, e pastaj ai bëhet i dëgjueshëm ndaj Zotit. Po të ishte që të gjitha çështjet të ishin të varura prej shkaqeve të tyre dhe të gjitha çështjet të shkonin vetëm në bazë të shkaqeve të tyre, atëherë njeriu do ta humbte shpresën në mëshirën e Allahut dhe Allahu fuqinë e Tij do ta aktivizonte menjëherë. Mirëpo, Allahu e ka përdorur fuqinë e Tij absolute, sepse Ai vepron çka të dojë. Zoti i Lartmadhëruar thotë: "Padyshim se ata, për të cilët ka paraprirë mirësia nga Ne, do të jenë të larguar larg prej andej (xhehenemit)". Po ashtu, Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: "Ata të cilët angazhohen për Ne, do t'i orientojmë në rrugën Tonë". Asgjë nuk mund ta detyrojë fuqinë e Allahut të Lartmadhëruar. Më të afërmit te Allahu janë ata, të cilët me mundimet, angazhimet dhe aktivitetet e tyre më të mëdha arrijnë në afërsi të Allahut, sepse ato debatojnë, ligjërojnë me diturinë e tyre, argumentojnë dhe shihen se janë lartë, e pastaj, për shkak të diturisë dhe angazhimit të tyre, ballafaqohen me sfida të mëdha. Ne e dimë se kur Omeri r.a. u ndal, ka bërë lutje për shi dhe nuk ka ra shi. Duke u kthyer e gjen një rob plak, i cili lutet vetëm për ujë. Omeri pastaj ka shkuar te farkëtari (zotëria i tij) dhe i ka kërkuar robër për të blerë. Mirëpo, farkëtari mendon se Omeri dëshiron të blejë rob të fuqishëm e të kategorisë së parë, dhe i thotë: O emir i besimtarëve, unë nuk kam robër. Gjithçka që kam, është vetëm një dhe ia sjell. Kur e sheh se ishte ai, Omeri i thotë: Ky është ai, të cilin dua ta blej. Ai rob e sheh dhe lutet: "O Zoti im, ashtu siç e ke bërë të shihem para njerëzve, më merr pa u sprovuar fare"; dhe në atë çast vdes.

Pastaj Imami i mirënjohur thotë: Të fshehurit e sekretit është dhunti e madhe, të cilën na e ka dhuruar Allahu neve, ndërsa shpalosja apo zbulimi i atij sekreti është humbja e asaj dhuntie. T'i lëmë çështjet si janë. Le të jetojmë të izoluar për shkak të butësisë me të cilën Allahu dëshiron që të na dhurojë mirësi. Përpos kësaj, këtu është një çështje e rëndësishme. Po qe se e di të fshehtën, a mund ta pengojë që mos të ndodhë? Natyrisht se jo. Atëherë, pse tërë kjo zhurmë, ky mundim, i cili më mundon mua? Për këtë arsye njeriu çështjet duhet t'ia lërë Allahut, përderisa aty nuk mund të ketë qasje. Allahu i

ka krijuar këto çështje që të shtojë qetësi dhe të na mbjellë bindje, e jo për të na përçarë në mendime dhe për t'i lodhur mendjet tona.

SHAËRAVIJU DHE EDUKIMI

Pyetje: Çka do të thotë fjala edukim?

Përgjigjja: Edukim do të thotë të përforcosh besimin në Allahun. Po ashtu, e ka edhe kuptimin që i edukuari të arrijë në shkallën e përsosmërisë, e cila ju ka ofruar atij.

Cili është burimi i edukimit në Islam?

Edukata Islame burimin e ka në planprogramin e Allahut. Kur edukata Islame të vendosë programin, në të vërtetë ai ka vendosur program për Allahun, i cili e ka krijuar njeriun, Krijuesi i cili e ka krijuar njeriun dhe gjithësinë, i Cili i di më së miri rregullat dhe ligjet që i nevojiten Atij.

Pyetje: Cila është teoria Islame në edukimin fizik?

Islami e parasheh rolin edukativ në atë, duke zgjedhur llojin mashkullor dhe femëror, që ato të takohen në një pikë, e cila u sjell atyre pasardhës? Teoria Islame në edukim bazohet në barazinë thelbësore të të dy gjinive. E, barazia, në esencë, ka për qëllim barazimin psikik, shëndetësor, fizik dhe moral. Imami i mirënjohur thotë: Islami këtë çështje e parashtron para se të lindë fëmija, apo para se të fillojë edukimi i fëmijës, sepse Islami dëshiron që t'i sigurojë fëmijës ambient të përshtatshëm në vendin ku fillojnë qelizat e para të tij. Përpos kësaj, në këtë kohë i është dhënë e drejta e trashëgimisë, varësisht prej gjinisë, e po ashtu edhe prej llojit familjar (prindor), sepse aty fillojnë cilësitë, të cilat do të jenë bazë për edukimin e mëtutjeshëm.

Pyetje: Cila martesë është harmonike, me të afërmit apo me të largëtit?

Imam Shaëraviju tregon se Islami insiston në martesën e çifteve që të jenë sa më të largët, që të mos lindë dhe zhvillohet fëmija i dobët e me të meta. Pastaj, në lidhje me këtë, Imami thotë: Kur Kur'ani dhe suneti na orienton në këtë parim, ai e ka vërejtur pikën e parë të edukimit, që fëmija të rritet me dhuntitë e Allahut, fëmijë i fuqishëm me të gjitha cilësitë pozitive, sepse nuk mund të tubohen cilësitë pozitive prej një fare apo një lloji (farefisnor). Imami thekson të drejtën e fëmijës, që atij t'i jepet qumësht prej nënës dy vjet të plota dhe, pasi familja ta kalojë fazën e gjirit, fillon fazën e përkujdesjes. I jepet përkujdesje fëmijës nga ai që është i përshtatshëm për organizmin e tij.

E, kjo e drejtë është e nënës. Imami këtë e arsyeton me thënien e tij: Sepse fëmija në vegjëli nuk ka nevojë për njeri tepër të mençur, por ka nevojë për butësi, ledhatim e ngrohtësi, veçori këto të cilat i ka natyrshmëria e nënës.

Pyetje: Cilat janë shkaqet e çrregullimit psikik te fëmijët, të cilat kanë çrregullime të shumta?

Përgjigjja: Imami i nderuar përgjigjet: Prej shkaqeve kryesore të presionit psikik te edukimi i fëmijëve është dallimi në mes tyre. Kur njërit i jepet më shumë, e tjetrit më pak, njërit i kushtohet përkujdesje më e madhe, e tjetrit jo, e në ato momente fëmija ndien se nuk është njeri i barabartë me të tjerët. Po ashtu, shkak tjetër është se njeriu gjithmonë kërkon shumë e më shumë. Zoti i Lartmadhëruar thotë për vëllezërit e Jusufit, kur kanë thanë: **Jusufi dhe vëllai i tij janë më të dashur se ne për babain tonë, ndërsa ne jemi shumë. Nuk ka dyshim se babai ynë është në humbje të qartë." (JUSUF, 8)**

Pyetje: Cili është fryti i diturisë?

Imami i mirënjohur thotë: Fryt i diturisë është të praktikuarit e tij. Dituria teorike duhet të kalojë patjetër në praktikë.

DHE I SHËRON ZEMRAT E BESIMTARËVE

Pyetje: Zoti i Lartmadhëruar thotë: "Dhe i shëron zemrat e popullit besimtar". Po ashtu, thotë: "Dhe shërim për atë çka ka në zemra". A është qëllimi për shërim abstrakt apo shërim konkret, pra të pjesëve të trupit?

Përgjigjja: Në lidhje me këtë, Imami thotë: Mos e ngushto të zgjeruarën. Organizmi i njeriut ende është i panjohur, nuk dihet, përpos organeve të jashtme, të cilat shihen. P.sh. sistemi i tajitjes ose sistemi i trurit, ai urinor apo gjinekologjik. Pastaj shohim se për çdo ditë zbulohet diçka e re. Ndoshta një pilulë e vogël (e dehjes), vetëm pse depërton në tru, e bllokon tërë trurin dhe ende për të nuk dihet asgjë. Secili sistem organik e luan rolin e tij, përderisa sistemi është i balancuar, pra në mes të lirimit dhe shtrëngimit, pra shtrëngohet më shumë se sa është përcaktuar, apo lirohet më shumë se sa e ka rolin e tij. Zoti i Lartmadhëruar na sjell një shembull: **"Që të mos dëshpëroheni për atë që nuk keni arritur, as të mos krenoheni për atë që u ka dhënë"**. Pra, përmbajuni mesatares. Njeriu, i cili, në rastet e gëzimit apo të pikëllimit, vetëpërmbahet, organi i tij është i shëndoshë dhe stabil, i drejtë dhe i qëndrueshëm dhe se veprimet, të cilat paraqiten, i përjeton me lehtësi.

Shërimi çka ka në zemra përfshin të gjitha llojet e sëmundjeve, pa marrë parasysh a janë psikike, shpirtërore apo fizike, pra siç e quajmë ne sëmundje psikike apo shpirtërore. Kjo do të thotë se çdo lloj sëmundje, e cila paraqitet në një organ prej organeve fizike, e që ne ende nuk e kemi zbuluar, e quajmë sëmundje shpirtërore, e kur t'ia zbulojmë bazën, atëherë ajo sëmundje e merr titullin në bazë të bazës, pra sëmundje organike.

Pyetje: Çka nënkuptohet me fjalën "shërim" dhe a ka shërim me fjalë?

Në një rast Raziu e ka gjuajtur me fjalë pyetësin dhe ai është hidhëruar për së tepërmi, është dridhur dhe në fund i ka rënë të fikët. Pastaj, Raziu i thotë se të kemi hidhëruar me fjalë!! Ai i cili sëmuret me fjalë, ai edhe shëron me fjalë. Shërim nënkupton rikthyerja e organit të njeriut në gjendje normale dhe stabile, pra në balancim. Çdo trazirë në sistemin e tij gjendet në moral dhe karakter. Njeriu normal të gjitha sistemet e trupit i ka standard dhe të balancuara.

Pyetje: A mund të jetojë njeriu pa frikë, pa pikëllim dhe pa sëmundje?

Përgjigjja: Nëse njeriu ka iman (besim) nuk mund ta dëmtojë asgjë, përpos nga jashtë, prej veprimit të jashtëm, si thyerja e dorës prej dikujt tjetër e të ngjashme. Mirëpo, edhe kjo vjen si rezultat i mosqëndrimit të organeve në gjendje normale dhe i sistemit të tij sipas planprogramit të Allahut.

O JU, TË CILËT BESUAT

Pyetje: Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **"O ju, të cilët keni besuar, kini kujdes"**.

Po ashtu, ka thënë: **"O ju, të cilët keni besuar, mbrojeni veten tuaj dhe familjen tuaj prej zjarrit, ku lëndë djegëse në të janë njerëzit dhe gurët".**

Po ashtu, ka thënë: **"O ju, të cilët keni besuar, mos t'ju shkatërrojë pasuria juaj dhe fëmijët tuaj duke mos kujtuar Allahun".**

Po ashtu, ka thënë: **"O ju, të cilët keni besuar, ka prej bashkëshortëve tuaj dhe fëmijëve tuaj, të cilët janë armiqtë tuaj. Andaj, keni kujdes dhe ruajuni prej tyre".**

Po ashtu, ka thënë: **O ju, të cilët keni besuar, pendohuni te Allahu me pendim të pastër dhe të sinqertë.** Në këtë ajet dhe ajete të tjera Zoti i Lartmadhëruar u drejtohet besimtarëve. Mirëpo, në ajetet tjera thotë:

"O ju njerëz, frikësojuni Zotit tuaj, nuk ka dyshim se tronditja e çastit të kiametit është çështje shumë e madhe." Këtu u është drejtuar njerëzve në përgjithësi, si individë por edhe si besimtarë. Pse ndonjëherë u drejtohet vetëm besimtarëve, e ndonjëherë njerëzve?

Përgjigjja: Bazë e praktikimit të programit të Allahut është Imani (besimi). Për këtë arsye, kur Allahu u drejtohet robërve të tij në praktikimin e programit të Tij, gjithmonë thotë: "o ju, të cilët keni besuar", e kjo formë përsëritet në shumë ajete. Parashtrohet pyetja: Pse? Sepse bazë e praktikimit të programit të Allahut është besimi në Allahun, pejgamberët e Tij, melaqet e Tij dhe çështjet e padukshme. Ky është çelësi, ndërsa çdo gjë jashtë kësaj është e pavlerë; nëse vepron diçka që ka urdhëruar Allahu, por ti nuk beson, vepra jote është e pavlefshme. Allahu i Lartmadhëruar ka urdhëruar t'u japësh

lëmoshë të varfërve për të fituar kënaqësinë e Allahut, besimin në Allahun dhe programin e Tij; nëse beson në këtë, ke shpërblim. Mirëpo, ta konsiderojmë një njeri, i cili jep lëmoshë, që të thuhet se ai është fisnik, ai i tubon të varfrit, u ndihmon, i përkrah, u jep lëmoshë, e me atë lavdërohet; ai u jep para njerëzve që ta shohin dhe të flasin për të, e të tjerët flasin vazhdimisht për të. Mirëpo, kur ndonjë i varfër shkon te ai dhe kërkon ndonjë lëmoshë, ai nuk i jep. Ai do reputacion, ai nuk e do kënaqësinë e Allahut. Ky njeri nuk shpërblehet, edhe pse ka bërë vepër, të cilën e ka kërkuar Allahu i Lartmadhëruar. Ai ka vepruar, por nuk ka besuar në Allahun dhe nuk e ka bërë për Allahun. Ai me zemër nuk beson në Allahun dhe tek ai nuk zbatohet thënia e Zotit të Lartmadhëruar: "O ju që keni besuar". Kështu, p.sh. një njeri falet para njerëzve, mirëpo kur të jetë i vetmuar, nuk falet. A shpërblehet ai për atë namaz? Asnjëherë. Kurrë nuk shpërblehet, ani pse ai vepron atë që ka urdhëruar Allahu; pra është pa iman. Allahu i Lartmadhëruar nuk ka nevojë për ortak. Për këtë arsye, çdo vepër që bëhet për ta fituar kënaqësinë e Tij, e pranon, por nëse bëhet për të fituar kënaqësinë e njerëzve, Ai nuk ka nevojë për atë vepër dhe nuk e pranon prej tij, edhe pse është një pjesë, e cila i kënaq njerëzit. Allahu i Lartmadhëruar është i pavarur nga gjithë bota.

PSE SHTËPIA E SHENJTË DHE MUAJI I SHENJTË

A kanë lidhje në mes vete fjalët "Iftaram-E shenjtë" me fjalën e Zotit të Lartmadhëruar "Shtëpia e Shenjtë" dhe "Muaji i Shenjtë", apo secila ka kuptim në vete?

Përgjigjja: Imami i nderuar, Shejh Muhamed Metveli Shaëraviju, thotë: Kuptimi i fjalës "Shtëpia e Shenjtë" është se Allahu ka dashur që atë shtëpi ta bëjë të Shenjtë dhe ka caktuar muajt e shenjtë për të ngopur epshin e njeriut. Njeriu ka epsh (zbrazëti), të cilën shejtani e ushqen vazhdimisht, e ai ushqim pastaj ndikon që të refuzosh kthimin te Allahu, bën që t'i marrësh të shenjta çështjet tjera. Për këtë arsye, edhe shtëpia e shenjtë është paqe për njerëzimin, se ndoshta shpirti i njeriut qetësohet kur të hyjë në shtëpinë e shenjtë; po ashtu, i ka caktuar muajt e shenjtë për të mos luftuar, e kjo ndoshta do të ndikojë që njeriu të logjikojë dhe t'u ikën trazirave, konflikteve

që shpiejnë deri të lufta, e anojnë kah paqja, kur t'i shikojmë të mirat e paqes. E, Zoti i Lartmadhëruar, me mëshirën e Tij, ka dashur që të arrihet ky sukses, duke mos lejuar ngopjen e epshit njerëzor.

Për këtë arsye njeriu, i cili dëshiron ta ndalë luftën apo armiqësinë, duhet të thotë: këtë ndërprerje e kam bërë për Zotin e Lartmadhëruar; dhe kështu përfshihet me mëshirën e Allahut, kur ta hapë derën e pendimit, që njeriu ta ruajë ujin e fytyrës së tij, të epshit të tij dhe ta bëjë një çështje të lehtë, e jo të rëndë. Për këtë arsye kjo dëshirë është e lehtë për t'u penduar dhe stimulim për pendim. Nga këtu, muajt e shenjtë janë armëpushim dhe ndërprerje e operacioneve ushtarake dhe të luftës, të cilat pastaj shpiejnë përfundimisht në paqe të përgjithshme. Mirëpo, Allahu i Lartmadhëruar nuk ka dëshiruar që ti t'i nënshtohesh armikut, kur ai të shpallë luftë dhe të sulmon ty. Allahu nuk ka urdhëruar që p.sh. gjatë muajve të shenjtë t'i lëmë armët dhe armiqtë tanë të vijnë të na presin e të na vrasin e ne tu themi, na vrani sa të doni, se ne nuk ju vrasim, sepse ne jemi në muajin e shenjtë.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **"Dhe mos luftoni (vrani) në Mesxhidil haram, derisa nuk ju luftojnë (vrasin) juve në të. Nëse ju luftojnë, luftoni ata."** Po ashtu, ka thënë: **"Të pyesin për muajt e shenjtë, saktësisht për luftën në ta, thuaj: Lufta në ata muaj është mëkat i madh, por largimi nga rruga e Allahut, mohimi i Tij dhe Mesxhdil Haramit, e po ashtu dëbimi i banorëve të vendit të tij është mëkat edhe më i madh te Allahu. Fitneja është mëkat më i madh se vrasja."** (**EL BEKARE, 217)**

Nga kjo kuptohet se nëse bëhet luftë në muajt e shenjtë, mos thuaj se më ke sulmuar në muajt e shenjtë, sepse ti ke filluar armiqësinë dhe më ke sulmuar. Për këtë, i nderuari Shejh Shaëraviju thotë: Muajt e shenjtë janë kohë e mbyllur për t'u zgjuar ata të cilët luftën e konsiderojnë mjet të vetëm për zgjidhjen e problemeve të tyre. Nuk lufton gjatë kësaj kohe, kohë kjo e cila u jep rast që, në rend të parë, ta shijojnë, ta përjetojnë dhe ta kuptojnë vlerën e paqes, t'i lënë armët e t'i largohen luftës si nënshtrim ndaj urdhrit të Allahut. E, nga këtu, mbrohen tradhtitë dhe epshet, të cilat gjithmonë shkatërrojnë qenien njerëzore, shpiejnë në mundime të mëdha dhe largojnë nga Allahu. Kjo, sepse tradhtia e lëkund imanin në shpirtin e njeriut dhe e trondit. Zoti i Lartmadhëruar prej momentit kur ka krijuar Ademin dhe ka caktuar vendin e Mekes dhe shtëpinë në vend të shenjtë, ashtu siç e ka caktuar Arafatin, para se të ndërtohet Qabeja e nderuar, ndërsa Ibrahimi dhe Ismaili janë ata, të cilët i kanë ngritur themelet e qabes; në atë vend ka qenë një

ndërtesë e vogël, e kanë bërë tavaf rreth asaj shtëpie, kanë qëndruar në Arafat. Haxhi ka ekzistuar prej momentit kur është krijuar Ademi a.s. dhe prej momentit kur njeriu i parë ka zbritur në tokë.

KUPTIMI I BESIMIT RRETH GURIT TË ZI HAXHERUL ESVED

Cila është domethënia e ekzistimit të Haxherul Esvedit dhe pse janë gjurmët e këmbëve, pastaj a janë gjurmët e vërteta të Ibrahimit a.s. në gur, apo jo, dhe cila është vlera e rëndësia e gurit mbi të cilin janë gjurmët e këmbëve?

Imami i mirënjohur thotë: Qëllimi i mbetjes së këtij guri në atë vend të shenjtë ka domethënie të rëndësishme për përforcimin e Imanit. Allahu e ka urdhëruar Ibrahimin a.s. për atë gur dhe ai e ka bërë atë. Por, pse? Për ta ngritur objektin pak më lart. Ky gur është bartur prej një vendi në vend tjetër për të përfunduar ndërtimi i objektit. E, nga kjo buron kuptimi i Imanit, sepse besimtarit nuk i mjafton vetëm të ngarkohet me obligime, por të ketë edhe shtesa tjera. Për këtë arsye edhe Ibrahimi ka dashur që të shtojë diçka, përpos asaj për çka ka qenë i obliguar. Për këtë arsye shohim se në Islam rukni kryesor, i cili mjafton të kryhet vetëm një herë në jetë, është haxhi për atë i cili ka mundësi dhe që rrugën e ka të lirë. Mirëpo, kjo nuk është kurrfarë pengese që ai i cili dëshiron ta përsëritë haxhin më shumë se një herë, mund ta kryejë nëse ka mundësi dhe nëse rruga është e lirë.

CILA DUA PRANOHET MË SË SHUMTI DHE KUR?

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Lutmuni Mua, do t'ua pranoj”**. Ne e dimë se lutja është truri i ibadetit, por pyes: Cila dhe kur pranohet më së shumti?

Përgjigjja: Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. Cila dua është më e pranuar? Është përgjigjur: ***Duaja në thellësi të natës dha pas namazeve farze. (E ka regjistruar Ahmedi)***

Në një rast tjetër ka thënë: ***"Duaja në mes të ezanit dhe ikametit nuk kthehet prapë." I kanë thënë: Po për çka të lutemi, o i Dërguari i Allahut?***

"Lutjuni Allahut për shëndet në këtë botë dhe botën tjetër. (E ka regjistruar Tirmidhiu)

Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s.: "Me çka ta përmbyllim lutjen? Është përgjigjur: "Me Amin".

KËMBIMI I TË MIRËS ME TË KEQEN

Gjatë një viti dy herë kam dështuar në tregti dhe gati sa nuk e kam humbur tërë pasurinë time. Më ka mbetur mall i dobët dhe ajo është e tëra që e kam, prandaj këmbimi i mallit të dobët me mallin e mirë a është haram, apo në kushte të domosdoshme lejohet?

Përgjigjja: Bilalli e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. për këmbimin e *dy saave të hurmave* të kualitetit të dobët me *një saa të hurmave* të kualitetit të mirë, e ai është përgjigjur:

"Kjo është kamatë e plotë, mos vepro ashtu. Mirëpo, nëse dëshiron të blesh hurma të mira, atëherë shiti hurmat dhe merri të hollat, e me ato të holla bli hurma të mira". (Muttefekun alejhi)

Fadeletu bin Abidi e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. për një "KALAD", të cilën e ka pasur ari dhe hirz (thesar i ruajtur) dhe, pasi që i ndan, e sheh se janë më shumë se dymbëdhjetë dinarë. Muhamedi s.a.v.s. i thotë: ***"Nuk shitet deri sa të ndahen veç e veç".(E ka regjistruar Muslimi)***

Ky është argument se çështja e MUDIT AXHVETUN, përafërsisht, është masë e dy litrave, andaj nuk lejohet që njëra prej masave të ketë më shumë se tjetra, sepse haptazi kjo është kamatë e pastër. E vërteta është se ndalesa ka ardhur në këtë formë, por ka hadithe, të cilat e tregojnë ndalesën edhe në forma të tjera.

Pyetje: Kam një djalë të vëllait. Pas vdekjes së babait të tij unë përkujdesem për trashëgiminë e tij. Jam në gjendje të vështirë ekonomike dhe kam bankrotuar. A kam të drejtë të vë përkohësisht në lëvizje apo në qarkullim pasurinë e jetimit, apo kjo është haram - kuptohet që kur ai të rritet, pasuria e tij të jetë në të njëjtën vlerë, ashtu siç ka qenë?

Përgjigjja: Një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: "Nuk kam pasuri dhe jam duke u përkujdesur për një jetim". Muhamedi a.s. i ka thënë:

"Shfrytëzoje pasurinë e jetimit, por pa e tepruar, pa e shkapërderdhur , pa e përzier me pasurinë tënde dhe duke mos lejuar që në vend të pasurisë tënde të shpenzosh pasurinë e tij".

Kur ka zbritur ajeti: **"Dhe mos iu afroni pasurisë së jetimit, pos me mirësi"**, aq shumë janë larguar nga pasuria e jetimëve, sa që pasuria e tyre (jetimëve) është prishur dhe nuk e kanë prekur, mishi i tyre është kalbur dhe nuk e kanë ngrënë. Pastaj, për këtë e kanë pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s., kështu që ka zbritur ajeti kur'anor:

"Dhe nëse i përzieni ata dhe pasurinë e tyre me pasurinë tuaj, atëherë ata janë vëllezër tuaj, se Allahu e di më së miri të keqin prej të mirit".

SHIKIMI I TË FEJUARËS

Pyetje: Një djalë i ri musliman dëshiron të fejohet me vajzën time. Ai e ka parë atë një herë, por tani kërkon që të ulet me të, të bisedojë me të dhe ta shohë. Pyetja është: Të shikuarit e vajzës, me të cilën ka qëllim martese, a është haram, apo jo?

Përgjigjja: I Dërguari i Allahut s.a.v.s., pasi që e ka pyetur për fejesën e Mugirete bin Shuebetes, i ka thënë atij:

"Shko dhe shikoje (të fejuarën), sepse të shikuarit ndikon më shumë që të afroheni dhe ta doni njëri-tjetrin".

Ai shkon dhe i tregon prindërve të saj atë që i ka thënë i Dërguari i Allahut s.a.v.s., mirëpo ata sikur nuk e dëshiruan një gjë të tillë. Vajza, e cila ishte prezente, kur e dëgjoi kërkesën e tij, thotë: "Pasi që i Dërguari i Allahut

s.a.v.s. ka thënë kështu, atëherë edhe le të bëhet, se përndryshe unë nuk pranoj". Pra, ai i ka dhënë rëndësi të shikuarit mes tyre. Pastaj, tregon Mugirete – "e pashë atë dhe u martova, pasi që u bë pajtimi mes nesh". *(E ka regjistruar Ahmedi dhe Ehlu suneti)*

PROSTITUTI DHE PROSTITUTA

Çfarë dënimi parashihet për gruan që bën tradhti kurore me djalin e pamartuar?

Përgjigjja: Një njeri i ka thënë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: "Djali im ka qenë shërbëtor i këtij dhe ka bërë prostitucion me gruan e tij. I kam dhënë njëqind dele dhe shërbëtorin. Për këtë i kam pyetur dijetarët, e ata më thanë se djali im duhet të dënohet me njëqind të rëna dhe të internohet (largim nga vendlindja për një kohë të caktuar), ndërsa gruaja e tij duhet të ekzekutohet me gurëzim". Muhamedi s.a.v.s. i thotë:

"Për Atë që shpirti im është në dorën e Tij, gjykoni mes vete siç e parasheh Libri i Allahut. Njëqind dele dhe shërbëtorin ktheje prapë, djali yt le të dënohet me njëqind të rëna dhe le të internohet një vit. O Enis, shko te gruaja e këtij, nëse ajo pranon se ka bërë prostitucion, gurëzoje". Kur shkon, ajo pranon dhe e ka ekzekutuar me gurëzim deri në vdekje".*(Muttefekun alejhi)*

"I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka gjykuar për prostitutën e pamartuar internim një vit dhe dënimin prej njëqind të rënave". *(E ka regjistruar Buhariju)*

TË GËNJYERIT NDAJ BASHKËSHORTES

A mund ta gënjej bashkëshorten time me qëllim që mos ta komplikoj jetën bashkëshortore, sepse ajo është tepër e ndjeshme, e nëse ia them të vërtetën asaj, atëherë keqësohen çështjet e jetës sonë; ndërsa, nëse e gënjej (duke mos e ditur), ajo qetësohet. A është kjo haram?

Përgjigjja: Kjo pyetje i është bërë të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: "A ta gënjej gruan time?" I është përgjigjur: ***"Nuk ka dobi prej rrenës!"*** Pastaj e ka pyetur: "Por, o i Dërguar i Allahut, i premtoj dhe i them se e kam kryer premtimin?!" I Dërguari i Allahut s.a.v.s. është përgjigjur: ***"Nuk ke mëkat për atë".****(E ka regjistruar Ahmedi)*

SADAKAJA PËR TË VDEKURIN

Pyetje: A lejohet sadakaja për të vdekurin?

Përgjigjja: Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. nga një pyetës: "Nëna ime ka vdekur. A të jap sadaka për të, apo jo?" – Është përgjigjur: "***Po***". *(E ka regjistruar Muslimi)*

Tjetri e ka pyetur: "Nëna ime ka vdekur befasisht, e mendoj se, po të kishte pasur rast për të folur para vdekjes, do të më kishte thënë që të jepja sadaka për të. A mund të jap sadaka për të?". Është përgjigjur: "***Po***". *(E ka regjistruar Muslimi)*

Një tjetër e ka pyetur kështu: "Nëna ime ka vdekur dhe nuk ka lënë porosi. A i bën dobi, nëse jap sadaka për të? Është përgjigjur: "***Po***". *(E ka regjistruar Ahmedi)*

Hakim bin Hazami e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: "O i Dërguar i Allahut, në kohën e injorancës jam përbetuar se do të forcojë lidhjet farefisnore, do të liroj rob. A kam për ato shpërblime?" I është përgjigjur: ***"Për atë të kaluar të begatshme e ke pranuar Islamin dhe kjo është ajo e mira"****. (Mutefekun alejhi)*

Aishja r.a. e ka pyetur Muhamedin s.a.v.s. për Ibn Xhedanin, i cili në kohën e injorancës i ka forcuar lidhjet farefisnore, i ka ushqyer të varfrit dhe

se për ato veprime a do të ketë dobi? I Dërguari i Allahut s.a.v.s. është përgjigjur***: "Nuk ka dobi, sepse asnjë ditë nuk ka thënë "O Zoti im, m'i fal gabimet e mia në Ditën e Gjykimit"****. (E ka regjistruar Muslimi)*

ISLAMI DHE LAICIZMI

Pyetje: Çka do të thotë "Laicizëm", i cili po përdoret nëpër fjalorë të rregullimit shoqëror?

Përgjigjja: Fillimisht dua të sqaroj fjalën "Laicizëm", ashtu që të kuptohet se ata gabojnë dhe kanë lajthitur në këtë emërtim.

Çdo të thotë "Laicizëm"? Do të thotë se kjo sillet në të gjitha çështjet, ashtu si argumentohet shkencërisht. Por, parashtrohet pyetja: Çka do të thotë "shkencë"? Shkenca është çështje bindëse. Unë jam i bindur në këtë ndodhi dhe në këtë realitet. Unë në këtë çështje sjell argumente. Mirëpo, a janë çështje bindëse teoremat, ku nuk mund të sjell argument, kur janë në pyetje çështjet lëndore?

Në çështje lëndore, praktike, nuk ka çka të diskutohet më tej. Mirëpo, si të jetë bindëse çështja e teoremës?! Nuk mundet, natyrisht jo.

Ne u themi atyre: Ju po thoni: Laicizmi nuk ka të bëjë me fenë. Mirëpo, kush ka thënë se feja nuk është Laicizëm? Feja është Laike në shkencën, e cila sjell argumente bindëse. Në këtë nuk ka diskutim, sepse për këtë ka argumente bindëse lëndore. Feja, posaçërisht Islami, ka ardhur për ta ngritur shkencën, bile edhe ka domethënie më gjithëpërfshirëse. Mirëpo, ti dëshiron që ta përkufizosh fjalën Laicizëm në kufij ku nuk bën pjesë çështja shkencore, e ajo është çështja teorike. Dëshiron që teoremën ta konsiderosh shkencë. E, ne u përgjigjemi: Kjo nuk është shkencë, sepse nuk është bindëse. Gabim është ajo; ju keni dashur që fjalën *"shtet laik"* ta përdorni përballë fjalës *"shtet fetar"*. Ky krahasim është gabim, sepse feja, posaçërisht Islami, kanë zbritur për shkencën. Vetëm se shkencën e aktivizon në çështje bindëse dhe praktike, e cila nuk ndeshet me fenë. Pejgamberi s.a.v.s. ka folur për çështje, të cilat mund të kenë dimensione të ndryshme të veprimit dhe e ka thënë fjalën përfundimtare të fesë, në të cilën nuk ka çka të hulumtohet më tej. Ndërsa, sa i përket çështjeve praktike, për ta nuk ka folur.

Kjo do të thotë se për çështjet shkencore, të cilat vërtetohen dhe argumentohen, nuk ka çka të flasë askush. Pejgamberi s.a.v.s. na urdhëron që çështjet praktike mos t'i marrim nga thënia e askujt, por drejtpërsëdrejti prej argumentimit të çështjes, ndërsa sa i përket çështjeve që nuk vërtetohen dhe nuk argumentohen, merrni nga unë.

"Dhe kjo, vërtet, është rruga ime e qëndrueshme, e drejtë dhe stabile, e mos pasoni rrugë të tjera, të cilat u ndajnë juve nga rruga e vërtetë".

"Po të pasonte e vërteta epshet e tyre, do të shkatërroheshin qiejt dhe toka".

Laicizmi me fushat e vërteta të saj është me Islamin. Mirëpo, Islami është kundër laicizmit, i cili nuk është brenda fushëveprimit të vet, sepse ju çështjen e fesë e keni bërë çështje të epsheve, ndërsa epshet nuk sjellin shkencë.

Kurse, sa i përket kundërshtimit në mes të fesë dhe Laicizmit, në esencë nuk ka kurrfarë kundërshtimi mes *shkencës, Laicizmit*, në kuptimin e tyre të vërtetë, dhe *Islamit*.

DEVOTSHMËRIA DHE ADHURIMI

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Ky libër, për të cilin nuk ka dyshim, është udhëzues për të devotshmit".

Po ashtu, Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"O ju njerëz bëhuni të devotshëm ndaj Zotit Tuaj, sepse nuk ka dyshim se tronditja e Ditës së Kiametit është çështje e madhe (dhe e trishtueshme)".

Po ashtu, ka thënë:

"Adhurojeni Zotin tuaj, i Cili ju ka krijuar juve dhe të tjerët para jush, me qëllim që të jeni të devotshëm".

Këto tregojnë se devotshmëria është qëllim i adhurimit, prandaj bëhet pyetja: Çka është ajo *"që të jemi të devotshëm në adhurim"*?

Imami i nderuar, Shejh Shaëraviju, thotë:

Nëse e konsiderojmë devotshmërinë me kulminacionin e devotshmërisë, do të shohim se ajo i ka cilësitë e të Madhërishmit ose gjurmët e cilësive të të Madhërishmit, ose që të dyjave së bashku. Ti me devotshmëri pastron cilësitë e të Madhërishmit, pastron gjurmët e cilësive të të Madhërishmit. Pastron njollat që njollosin jetën dhe veten tënde, të pasurisë tënde, që të orientohesh në epiqendrën e adhurimit në tokë; e gjithë kjo është devotshmëri. Mirëpo, kulminacion të devotshmërisë janë cilësitë e të Madhërishmit. Bëhu i devotshëm në të gjitha pjesët e jetës tënde, e nëse e ke realizuar këtë, atëherë ti veç e ke adhuruar Allahun.

Po t'i afrohej toka diellit më shumë se sa është tani, do të çrregullohej jeta, po ashtu, edhe po të largohej më shumë se sa është tani. Kështu, nëse afrohet, ngulfatemi, nëse largohet, ngrihemi nga të ftohtit. Allahu ka paraparë këtë largësi me urtësinë e Tij. Allahu ka kërkuar prej nesh që ta adhurojmë Atë, sepse Ai është Zot. Përderisa Ai është Zot, meriton të dëgjohet në atë që urdhëron të veprohet dhe të largohemi nga ajo që urdhëron të largohemi; jo për shkak se është mirë, por për shkak se është detyrim të adhurohet Ai. Pastaj e ka sqaruar qëllimin, e ai qëllim është që të jemi të devotshëm. Të larguarit nga një çështje e dëmshme nënkupton adhurimin ndaj Allahut, e cila na mbron nga çdo çështje e cila na bën dëm, e pastaj të jemi të mbrojtur nga zjarri i xhehenemit në botën tjetër.

NATYRSHMËRIA NUK PRANON IDHUJTARINË

Pyetje: Natyrshmëria, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit, nuk pranon idhujtarinë, mirëpo ajo çka ndodh prej idhujtarisë së fshehtë dhe jo të fshehtë është depërtim i shejtanit në thellësi të shpirtit të njeriut, në njërën anë, ndërsa, në anën tjetër, dominimi i kushteve dhe i rrethanave ideore, fetare dhe sociologjike etj.

Nëse gjykojmë sipas natyrshmërisë, atëherë shohim se natyrshmëria nuk pranon idhujtarinë, por e pranon dhe qetësohet me Njëshmërinë e Krijuesit, e assesi nuk pajtohet me diçka tjetër, apo të zëvendësohet me diçka tjetër. Çka mendon Shejh Shaëraviju në lidhje me këtë?

Imami i nderuar thotë: Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Dhe mos i bëni Allahut rival e partner deri sa ju e dini (se nuk ka)”.

Pra, mos i bën Allahut partner, shok e rival deri sa e dini se ata nuk krijojnë asgjë, nuk e kanë bërë tokën shtrojë, nuk e kanë ngritur qiellin lart dhe nuk zbresin shi nga qielli. Ju e dini se ata asgjë nuk kanë bërë në këtë drejtim, e pra pse i keni bërë shok dhe partner Allahut?! Thuaja se Allahu dëshiron të na thotë: Sillni Allahut rivalin që ta kundërshtojë, duke i thënë: Jo, Unë jam ai i Cili e kam ngritur lart qiellin, Unë jam ai i Cili e kam zbritur ujin (shiun) nga qielli. Po nëse nuk i kanë bërë këto dhe nuk kanë përgjigje, atëherë nuk lejohet që ata të jenë shokë, partnerë apo rivalë, e nëse i kanë krijuar, atëherë pse nuk po thonë: jo ti i ke krijuar?

Atëherë, pse idhujtarët t’i bëjnë shok e rival Allahut? Kjo nga arsyeja se idhujt nuk kushtëzojnë asgjë në jetën e idhujtarëve, ashtu siç kushtëzon Allahu në jetën tuaj. Ju i keni bërë Allahut idhull, atëherë kur Allahu ka kushtëzuar jetën tuaj, mirëpo Allahu ka kushtëzuar për shkak se ka dashuri në ty, sepse Ai kur e ka kushtëzuar jetën tënde, në të njëjtën kohë Ai ka kushtëzuar miliona njerëz për dobinë e tyre. Ndërsa, sa i përket idhujve, ata asgjë nuk kërkojnë nga ju. Ky është shkaku që pabesimtari i do idhujt, siç ju e doni Allahun; mirëpo, besimtarët e duan edhe më shumë Allahun. Kjo nga shkaku se Ai ka kushtëzuar jetën tonë për të mirën e sigurisë dhe qetësisë sonë.

Vështroni fjalën e Zotit të Lartmadhëruar:

“Dhe kur t’i ndodhë njeriut ndonjë fatkeqësi apo vështirësi, thërret dhe i lutet Zotit të vet”.

E, pse nuk thërret dhe nuk i lutet idhullit në atë çast? Nga shkaku se ai e di se ai idhull nuk ka krijuar dhe nuk posedon mundësinë e largimit të fatkeqësisë dhe vështirësisë; e nuk mund të ndihmojë asgjë. Për këtë arsye i drejtohet Zotit të Vërtetë, i Cili pronëson çdo gjë dhe i Cili çdo gjë e ka në kompetencën e Tij. I kthehet Atij (Allahut). Fjala “u kthye” tregon se ka qenë i larguar nga Ai dhe pastaj është kthyer.

Vështroni fjalën e të Madhërishmit:

“Pastaj kur t’ia ndryshojë atij vështirësinë, i ndihmon, ai harron atë se çka është lutur dhe kujt i është lutur më parë.”, dhe është kthyer te idhujt, pasi që Allahu ia ka tejkaluar vështirësinë dhe fatkeqësinë. Allahu i Madhërishëm thotë:**“Dhe i ka bërë Allahut shok, rival e partner për të**

humbur nga rruga e Tij. Thuaj: Kënaqu pak me pabesimin tënd, sepse kjo nuk do të zgjasë gjithmonë. Por, nuk ka dyshim se ti je prej banuesve të zjarrit".

ÇKA PËR SUNETIN E PEJGAMBERIT S.A.V.S.

Pyetje: Prej risive dhe shpikjeve të këqija e të rrezikshme, të cilat po ndodhin në mes të zemrës islame, është ajo e mohimit të sunetit pejgamberik dhe të bazuarit vetëm në Kur'an në çdo çështje të sheriatit dhe obligimeve.

Mospranimi i sunetit fisnik, i cili është sqarim dhe komentim i Kur'anit fisnik, është çështje e rrezikshme. Pra, kjo do të thotë se Islami ia ndalon Pejgamberit s.a.v.s. t'i sqarojë çështjet dhe komentimin e tyre, të cilat kanë zbritur në Kur'an.

Nga kjo shihet se është e patjetërsueshme të definohet kjo çështje, të cilën të dyshimtit e sjellin në dyshim andej e këndej. Çka mendon Shejh Muhamed Muteveli Esh-Shaëraviju në lidhje me këtë?

I nderuari Shejh Shaëraviju thotë:

Përsëritja dhe praktikimi i vazhdueshëm i sunetit deri në ditën e sotme është mrekulli prej brendësive të mrekullive të Kur'anit dhe ata, të cilët dyshojnë dhe sjellin dyshime për sunetin, sfidohen me dyshimin në veten e tyre. Me fjalë të tjera, me sjellje të dyshimit në sunet, ata në të vërtetë sjellin dyshim në vetë mrekullinë Kur'anore, për arsye se Zoti i Lartmadhëruar në librin e Tij thotë:

"Dhe Ne ta kemi zbritur ty Kur'anin që t'u sqarosh njerëzve çka u ka zbritur atyre, ndoshta ato do të mendojnë".

Detyrë e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. është që të sqarojë atë çka i ka zbritur atij. Pastaj Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"Vërtet detyrë Jona është tubimi i tij dhe leximi i tij. Dhe, kur ta kemi lexuar (ta lexojmë), përcjellja jote duhet të jetë në leximin e tij, e pastaj, vërtet, Ne kemi për ta sqaruar".

Zoti i Lartmadhëruar ka treguar se e ka obliguar të Dërguarin e Tij të sqarojë atë, kur ka thënë: **"Që t'u sqarosh njerëzve, e pastaj Ne kemi për ta sqaruar atë"**. Po të mos kishte qenë i vërtetë dhe obligim për muslimanët

sqarimi i Pejgamberit, Zoti i Lartmadhëruar nuk e kishte treguar se ai e sqaron. Besimi në mbështetje dhe të ekzistuarit të sunetit të Pejgamberit s.a.v.s. është mrekulli e brendshme e Kur'anit.

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"Dhe çka u ka dhënë juve i Dërguari, pranojeni, dhe çka u ka ndaluar juve për diçka, ndalohuni. Frikësojuni Allahut. Vërtet, Allahu është i ashpër në dënim".

Kjo tregon se Pejgamberi s.a.v.s. është në bashkëveprim me Kur'anin dhe përderisa është në bashkëveprim me Kur'anin, ai patjetër duhet të flasë për Kur'anin, të veprojë sipas Kur'anit, ose ta pranojë atë çka e thotë Kur'ani. Por, kjo është për gjeneratën e tij, ndërsa për ata pas tij kërkohet që të pranojnë atë çka e thotë i Dërguari i Allahut s.a.v.s.. Për këtë arsye është e patjetërsueshme të mbetet fjala e tij, veprimtaria e tij, pranimi i tij ose mosveprimi i tij për diçka.

Pasi që i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka kumtuar prej Zotit të tij njëzet e tri vjet, fjala e tij, veprimtaria e tij, pranimi i tij për ndonjë veprim në prezencë të tij është sqarim. Për Zotin, ata që sjellin dyshim në sunet le të na tregojnë. Sa fjalë Pejgamberi s.a.v.s. nuk i ka thënë duke sqaruar atë që i ka zbritur atij prej Zotit të tij apo çka e ka urdhëruar Zoti i tij.

Atëherë, nëse paraqesim se çka ka mbetur prej haditheve të vërteta, do të shohim se ajo që ka mbetur është shumë e pakët nga ajo çka është dashur të mbetet. Kanë mbetur shumë hadithe që t'i vërtetojmë me anë të formave të ndryshme, analizave të ndryshme dhe analogjisë, që ta pranojmë atë që e ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.. Më mirë është që të lihet diçka çka ka thënë se sa të depërtojë në hadith diçka që nuk e ka thënë.

Ata të cilët dëshirojnë që vetëm Kur'ani të jetë bazë dhe mbështetje, ata duhet të na gjejnë zgjidhje në Kur'an për detajet e shtyllave të Islamit. Nuk po them për mësimin dhe studimin e Islamit. Vërtet, janë ata që e kanë tepruar ndaj vetes së tyre dhe i janë qasur kësaj loje, përderisa vetë janë dëshmitarë për hadithin e Pejgamberit s.a.v.s. se është i vërtetë; sepse për ta ka treguar me hadithe vet Pejgamberi s.a.v.s. dhe ka treguar se të tillë do të ketë edhe në të ardhmen. Po mos ta kishin mohuar sunetin dhe po të mos kishin thënë çka kanë thënë, për t'u bazuar vetëm në Kur'an, nuk do ta kishin hasur hadithin, i cili vërteton për ta. Kur Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

"Është e mundur që një njeri, i mbështetur në kolltukun e tij, të thotë: Në mes nesh dhe jush është libri i Allahut; çka të jetë e lejuar në të, e

lejojmë, e çka të jetë e ndaluar, e ndalojmë. Por, ta dini se çka e ndalon i Dërguari i Allahut, është identike me atë çka e ka ndaluar Allahu”.

Po të kishte qenë ndryshe, ose po mos të kishin shpifur këta dhe mos t’i kishin hyrë kësaj valle, ne do të kishim dyshuar në këtë hadith të Pejgamberit s.a.v.s.. Mirëpo, vetë thënia e tyre ashtu është argument se ajo çka thonë dhe pretendojnë ata është rrenë.

DËGJOJENI ALLAHUN DHE TË DËRGUARIN

Pyetje: Zoti i Lartmadhëruar në librin fisnik ka thënë:
“Dëgjojeni Allahun dhe të Dërguarin”.
Ka thënë:
“Dëgjojeni Allahun dhe dëgjojeni të Dërguarin”.
Ka thënë:
“Dëgjojeni të dërguarin”.
A ka ndonjë dallim në mes këtyre tri urdhëresave, të cilat përsëriten në forma të ndryshme në këto ajete?

Përgjigjja:
Imami i nderuar, Shejh Shaëraviju përgjigjet:
Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Dëgjojeni Allahun dhe të Dërguarin”**, do të thotë se Allahu vendos një ligj, ndërsa edhe i Dërguari flet për atë ligj. Pra, unë nuk e përsëris dëgjueshmërinë, unë i dëgjoj që të dy, sepse të dy urdhërojnë të njëjtën çështje.

Allahu na ka urdhëruar të falemi, Pejgamberi s.a.v.s. na ka urdhëruar të falemi; Allahu na ka urdhëruar të japim zekat, Pejgamberi s.a.v.s., gjithashtu, na ka urdhëruar të japim zekat. Pra, dëgjuesi në të njëjtën kohë kryen urdhrin e të dyve.

Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Dëgjojeni Allahun dhe dëgjojeni të Dërguarin”**, Allahu urdhëron në mënyrë të përgjithshme, ndërsa i Dërguari e detajon atë urdhër. Unë e kam dëgjuar Allahun, kur ka urdhëruar në mënyrë të përgjithshme, dhe e kam dëgjuar Pejgamberin, kur e ka detajuar atë çështje.

Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Dhe dëgjojeni të Dërguarin”**, Allahu nuk ka urdhëruar për atë çështje, por Pejgamberi urdhëron. Nga kjo,

Allahu kur e thotë këtë ajet, në të njëjtën kohë thotë: **"dhe kush e dëgjon Pejgamberin, e ka dëgjuar Allahun",** që mos të mendohet se të dëgjuarit e të Dërguarit nuk është dëgjueshmëri ndaj Allahut. Po pse? Sepse Pejgamberi është i autorizuar prej Allahut. Unë kur e dëgjoj të autorizuarin, e kam dëgjuar autorizuesin.

SHOQËRIA PARAZITE

Në kohë të fundit është mbajtur një kongres ekonomik i shteteve të mëdha, i cili zgjati disa ditë, ku morën pjesë ekspertë dhe profesionist të profileve të shumta. Pasi u paraqitën me dhjetëra punime hulumtuese, dhjetëra e dhjetëra mendime e propozime, që të gjitha ishin të përqendruar në mënyrë te veçantë te problemi i ushqimit të banorëve, të prodhimit, si dhe në atë se si të investohet dhe shpenzohet shumë pak me këtë çështje. Këtë çështje ia parashtruam imamit të nderuar, Shejh Shaëraviut, i cili tha: Sistemi, me të cilin kemi jetuar një kohë të gjatë, është sistem shumë larg nga islami dhe nga politika njerëzore. Ti nuk po vepron sipas sistemit dhe politikës njerëzore, e pastaj po thua: Më shkatërron feja. Kjo nuk është e drejtë, sepse themelet i ka të brishta. Do të kisha pasur të drejtë ta akuzoj, nëse e kam praktikuar atë sistem. Mirëpo, aktivitetit im që nga starti është jo i shëndoshë, e unë nuk kam të drejtë që për këtë ta akuzoj islamin.

Jo, por unë duhet të them: Nuk veproj më me këtë sistem, por veproj me islam, bazohem në planprogramin islam, e pastaj, nëse ballafaqohesh me vështirësi ekonomike, ti nuk je ballafaquar më me islam, por me politikën ekonomike njerëzore. A janë të sinqertë statistikët në diagnostifikimin e sëmundjes, apo thjesht vetëm flasin andej e këndej dhe nuk sjellin argumente? Asnjëri nuk na sjell argumentin e të na thotë: shkak i kësaj krize është se ne jemi shoqëri parazite. A nuk kemi ne tokë që ta shndërrojmë në tokë pjellore? Pse gjatë një periudhe të gjatë të mëparshme nuk kemi shndërruar në tokë pjellore, para se të shtohet numri i banorëve!!?

Atëherë, atë që sot po themi se është mangësi, të cilën kemi mundur ta eliminojmë më herët, pra, a paskemi pasur mundësi ta eliminojmë këtë më herët, apo jo?

Normalisht se kemi mundur. Po të kishe punuar një periudhë të gjatë

kohore dhe po t'i kishe tejkaluar shkaktarët e krizës, ka pasur mundësi që sot të mos ketë krizë.

Sikur çdo gjeneratë ta kishte pasur parasysh të prodhojë dyfishin (nga nevoja e vet), ose së paku të prodhojë aq sa merr (nga gjenerata e kaluar), ose sikur çdonjëri të jepte aq sa ka marrë, çfarë rezultati do të kishim? Krizë jo, normalisht, mirëpo ne marrim, e nuk japim, ashtu siç po ndodh tani: ushqimi ynë nga eksporti!!

Çka duhet të ndodhë: Ose të mos ushqehemi nga tjetri, por të shtrëngoj rripin duke vendosur gurë në bark, ose të udhëtoj jashtë vendit tim e të ushqehem. Unë nuk mund të jetoj më shumë sipas mundësive të mia.

Ne kemi thënë: Janë tri çështje. Prodhimi dhe shpenzimi. Nëse është i barabartë prodhimi me shpenzimin, vjen deri te ngecja. Nëse shpenzimi është më i madh se prodhimi, vjen deri te shkatërrimi i parakohshëm. Nëse prodhimi është më i madh se shpenzimi, vjen deri te zhvillimi. Ndërsa ne, përderisa shpenzojmë më shumë se sa prodhojmë, atëherë patjetër rezultati ynë është se jemi vonuar.

Sikur çdo gjeneratë prej gjeneratave, apo çdo vend prej vendeve t'i jepte popullit aq sa ka marrë, çështja do të kishte qenë ndryshe. Nëse punoj gjatë tërë jetës dhe e shndërroj në tokë pjellore një hektar, edhe tjetri, po ashtu, një hektar, atëherë të gjithë do të ishin të pasur. Mirëpo, ne rrimë neglizhent një shekull, e pas kësaj e veprojmë për një ditë.

Çështjet duhet t'i zgjedhim me zell dhe guxim. Çështjet zgjidhen me përgjegjësi dhe në mënyrë sistematike. Nëse i bëjmë një vështrim zgjidhjes së krizës ekonomike, shohim se ata, të cilët diagnostifikojnë krizën dhe shkaqet e krizës, flasin për sistemin ekonomik të tanishëm. Ata nuk kanë guxim të thonë: Sistemi ekonomik, të cilin e kemi, është sistem i brishtë, sistem jo natyror, i papërshtatshëm dhe, përderisa vazhdojmë me këtë sistem, jemi shumë larg nga zgjidhja e problemit të krizës.

A ka mundësi që ndonjëri të thotë: Punëtorët shtetërorë (qeveritarët) nuk prodhojnë aq sa marrin prej shtetit? Kush ka guxim ta thotë këtë, posaçërisht për qeveritarët: A prodhojnë aq sa marrin?! Unë them jo…!

DHE JENI NË LUFTË ME ALLAHUN

Çështja e kamatës, problemet dhe krizat që rezultojnë prej saj, posaçërisht kur sistemet ekonomike në botë janë shkatërruar në një trup dhe ato së bashku kanë vendosur ligje e rregulla, të cilat nuk mund t'i shpëtojë asnjë shtet, posaçërisht të botës së tretë apo të vendeve të pazhvilluara të ballafaqohen me ata, cilët janë ngarkuar me borxhe, me plotësim të kritereve dhe kushteve të ditëpërditshme.

Me një fjalë, këto vende të vogla janë të udhëhequra prej vendeve të mëdha për shkak të borxheve dhe rritjeve të kamatave. I nderuari ynë, çfarë zgjidhje parashihni?

Përgjigjja: Zgjidhja e problemit qëndron në atë se a dëshiron shteti i sëmurë sistem, të cilin nuk e kanë shtetet e mëdha dhe të cilat e pranojnë se është i mirë, e pastaj të vijnë dhe ta mësojnë islamin.

Për këtë kemi argument. A ka ndonjë shtet, i cili ka filluar me sistemin ekonomik islam apo jo. A e kanë praktikuar, apo jo? A e ka penguar ndokush kur e ka filluar atë sistem, apo a e ka kundërshtuar. Unë dëshiroj të bëj krahasim në mes të sistemeve. E, pas krahasimit, nëse shoh se është i mirë, e pranoj, e nëse nuk është i mirë, u themi: Për Zotin ju e keni gabim për këtë. Mirëpo, kjo nuk ka ndodhur?

Pastaj, bazë kryesore e sistemit te ne është sistemi kamatar. A mund ta stabilizojmë gjendjen me sistem kamatar. Zoti i Lartmadhëruar askujt tjetër nuk i ka shpallur luftë, pos atij, i cili vepron me kamatë.

Përderisa vendet në Amerikë kanë ardhur dhe e kanë marrë sistemin e bankave islame, po ashtu edhe vendet evropiane, sepse e kanë parë se është më i volitshëm, sepse dëshmon teori të re ekonomike. Se borxhi nuk mund të lahet deri sa të kthehet kamata në 0%.

Ata dëshirojnë që këtë ta marrin nga islami dhe ta praktikojnë ndërsa, në anën tjetër, ende ka dijetarë islamë, të cilët dëshirojnë ta arsyetojnë sistemin e tyre ekonomik. Ata dëshirojnë ta largojnë sistemin e tyre ekonomik dhe të vendosin sistem të ri, ndërsa ne ende e mbrojmë, e kjo është e palogjikshme. A nuk pajtohesh në këtë çështje me mua.

NATALITETI I MADH

Pyetje: A mos është nataliteti i madh një prej pengesave kryesore të zhvillimit ekonomik?

Përgjigjja: Është e vërtetë se kemi natalitet të madh. Kjo është e pamohueshme. Ne kemi krahasuar dhe kemi bërë analiza, të cilat sjellin shkatërrime. Ashtu siç thonë ata, në vitin 2000, është po ashtu e vërtetë. Por, parashtrohet pyetja: Pse? Ne kemi bërë llogaritjen e numrit të banorëve në vitin 2000, ndërsa nuk e kemi bërë llogaritjen se sa sipërfaqe të tokës nevojitet për atë numër të banorëve.

Çka kemi arritur? Ti ke thënë se do ta zvogëloj numrin e banorëve. Kjo do të thotë se ti ke shikuar vetëm anën negative, e nuk e ke llogaritur anën pozitive. Në vend se të thuash: Në vitin 2000 për këtë numër të banorëve nevojitet kaq e kaq sipërfaqe të tokës, kaq fabrika, e pastaj punon për shtimin e sipërfaqe së tokës dhe të fabrikave. Ti ke shikuar anën e dobët dhe ke thënë: Jo, numrin e banorëve do ta zvogëlojmë.

Pra ti ke llogaritur shtimin e popullsisë për çdo vit, e pastaj ke arritur te numri i popullsisë në vitin 2000. Vërtet, është numër i madh, natalitetet i madh, e pastaj ti thua: patjetër duhet të zvogëlojmë këtë numër. Pse ti në vend se të thuash të shtojmë prodhimin, thua ta zvogëlojmë numrin e banorëve. Pra, ti ke shikuar vetëm anën negative, e cila të bën të plogësht dhe përtac, e nuk e shikon anën pozitive, të prodhosh kaq, të punosh këtë ditë, të bëhesh i përgjegjshëm, të planifikosh e të realizosh projekte. Ne kemi shikuar anën, e cila nuk kërkon lidhje e mundim, dhe kemi kërkuar prej të tjerëve zvogëlimin e numrit të popullatës, "Ju falënderojmë. Mirë, do ta zvogëlojmë, nëse do Allahu!!"

Nëse shikojmë çështjen në jetën e rëndomtë individuale, do të shohim se çështja ndryshon. P.sh Një individ thotë: Unë kam tre fëmijë, të ardhurat personale i kam katërdhjetë lira egjiptase dhe shtesë marr kaq etj. A mjafton kjo? Natyrisht se nuk mjafton Atëherë patjetër duhet gjetur punë pas dite?

Merrem me tregti në dyqanin tim, nëse jam tregtar, ose punoj taksist, ose në ndonjë trafik. Kështu ua plotësoj nevojat anëtarëve të familjes. Ti angazhohesh dhe e lodh veten tënde për ekzistencën dhe nuk shikon në vetë ekzistencën e të thuash: E pakësoj këtë anëtar dhe atë anëtar. Ti nuk vepron kështu. Kur shtohet numri i anëtarëve, ka ngushtim të ekzistencës, ndërsa

nëse vëren para se të ndodhë kriza, nuk do të kesh ngushtim dhe vështirësi.

Ne si shoqëri, parapraktikisht nuk kemi bërë asgjë për atë që do të ndodhë, për shtimin e popullsisë. Për këtë arsye, kur thuhet se pejgamberi s.a.v.s ka kërkuar mbrojtje tek Allahu prej varfërisë dhe numrit të shumtë të anëtarëve në familje (I përgjigjemi): po, që të dyja, nëse janë në të njëjtën kohë!! Ti pse ke planifikuar shumë fëmijë dhe nuk e ke planifikuar për të qenë i pasur, por ke mbetur i varfër? Pse nuk je angazhuar në jetë për ta zhdukur varfërinë? (ka njerëz që e kanë shikuar të dytën, e nuk janë brengosur për të parën. Pra ia kanë arritur qëllimit, ta zhdukin varfërinë, e nuk ka ndikuar te ata numri i madh i anëtarëve në familje.

Kur është pyetur Shejhu për projektet ekonomike islame dhe si të arrihet deri te rruga e dritës, e cila zgjidh shumë probleme të kohës bashkëkohore, dhe cili është shkaku i mosbashkëpunimit në mes të dijetarëve të fesë dhe ekonomistëve, i nderuari është përgjigjur: sepse ai i cili flet për fe, nuk ka eksperiencë për sistemin njerëzor. Ai i cili flet për sistemin e njerëzve, nuk ka eksperiencë në fe. A ka ndokush që i bashkon këto dy eksperienca, të bëhet unifikimi i botëkuptimeve, të unifikohet qëllimi? Shpresoj të ndodhë kjo.

ARMA E KARAKTERIT (MORALIT)

Pyetje: A është në kundërshtim mendimi i perëndimit bashkëkohor, i cili dëshiron që edukatën fetare ta zëvendësojë me karakterin njerëzor? Pra, atë që feja kërkon prej njeriut, të jetë i devotshëm si fuqi apo forcë, që njeriun e largon prej të keqes, humanitetin mendojnë që ta zëvendësojnë me karakterin njerëzore pra në moral njerëzor.

Përgjigjja: Çfarë kuptim ka fjala “karakter’’? Çka është karakteri, karakteri i kujt? Karakteri im, karakteri i këtij, apo i atij. Çdonjëri është në gjendje të zbukurojë një çështje që e dëshiron, e pas kësaj zgjohet karakteri e tij, pasi që tërë botën e ka stërmbushur me të keqe. Karakteri nuk zgjohet përderisa njeri nuk punon keq!! Mirëpo, atë që dëshiroj unë, është që të vendosi një mur (pengesë) në mes të njeriut dhe të keqes. E këtu, mos e thuaj fjalën karakter.

Pra, do të kishte qenë më mirë sikur të parashtrohet pyetja se çfarë kuptimi ka fjala karakter në islam. Karakteri është veprim në mes teje dhe vetes tënde, i cili të ndalon dhe të paralajmëron, e jo të të pengojë nga jashtë, pra, ndjenjë fetare, të cilën ne e quajmë karakter, që më mbron nga çështjet, në të cilat shoqëria nuk mund të më mbrojë. Sikurse civilizimi perëndimor kapitalist ne do të kishim pasur këtë bashkëpunim me fenë e tyre nuk do të kishim mundur për këtë ide. Pra, përderisa fëmija ende nuk ka karakter (deri sa të rritet). Fëmijën, të cilit dëshirojmë t'ia forcojmë. Veprimet për të cilët shoqëria është pajtuar se janë të këqija. Ku ka qenë karakteri p.sh i vajzave, të cilat e shesin nderin e tyre? Ku ka qenë dhe ku është karakteri i tyre? Ku është karakteri i çështjeve, të cilat rrezikojnë sigurinë shtetërore?

Themi se po të kishte pasur më të vërtetë karakter dhe ai karakter të qëndronte në mes të njeriut dhe të keqes, atëherë nuk do të kishte pasur nevojë që të ketë gjykata. Ka qenë dashur të mos ekzistojnë gjykatat, bile edhe ligjet. Mirëpo, e vërteta është se ju keni qenë të detyruar të themeloni gjykata, të vendosni ligje, sepse ju nuk keni siguri në karakterin tuaj, bile edhe në këtë çështje!!

Të parashtrojmë një pyetje: sikur te ju të kishte diçka nga feja? Nuk ka dyshim se feja jo në islam apo në shtetet islame është vetëm fe politike. Nuk është fe, e cila udhëheq apo ngarkon njeriun me obligime, që të jetë me karakter, që t'ia zgjojë karakterin, i cili zë vendin në mes tij dhe të keqes, të cilën e vepron. Në islam karakteri është çështje të cilën e ndërton Allahu, e nuk e ndërton teknologjia.

LEJOHET SHFRYTËZIMI I MJETEVE TEKNOLOGJIKE

Pyetje: Shfrytëzimi i mjeteve bashkëkohore teknologjike, si telefoni, televizori, pastaj aeroplani e raketat, zhvillimi teknologjik e mjetet tjera komode për njeriun, a janë haram apo hallall? Këto mjete a duhet t'i konsiderojë muslimani begati, me të cilat Allahu ka dëshiruar t'i begatojë, apo begati me të cilat Allahu dëshiron t'i dënojë në këtë botë, e pastaj t'i marrë në përgjegjësi nesër, në ditën e kiametit, posaçërisht, pasi që ato janë prodhim i perëndimit, të cilat laicizmi materialist i ka program? Kjo është çështje, e cila na ka vënë në sprovë i nderuari ynë.

Përgjigje: Zhvillimi nuk ka të bëjë me teknologjinë. Nuk duhet ngatërruar mjetet teknologjike me zhvillimin. Ç'është zhvillimi? Këtu p.sh. ka mjete, të cilat i shfrytëzojmë, telefonin, të cilin e shfrytëzojmë, televizorin, aeroplanët, raketat të cilat i shfrytëzojmë, Pra, mjetet në vetvete, nuk quhen zhvillim. Por, shfrytëzimi i mjetit është ai i cili ka rezultuar prej zhvillimit. Për këtë arsye nuk duhet t'i përziejmë çështjet materiale me zhvillimin. Islami nuk refuzon çfarëdo zhvillimi material e teknologjik përderisa janë në shërbim të zhvillimit. Ti e dëshiron telefonin, por shfrytëzimi i telefonit a mos e cenon zhvillimin? Normalisht se nuk e cenon zhvillimin. Ne këtu po flasim për çështjen materiale. Mirëpo, për çka po përdoret telefoni? Në të kaluarën kam luftuar me shpatë, ndërsa sot luftoj me raketa. Mjeti është mjet. Mirëpo për çka po e shfrytëzoj? Zhvillimi nuk ka të bëjë me mjetin, por ka të bëjë me shfrytëzimin e mjetit. Nuk thuhet ky mjet është hallall, e ky haram. Mirëpo, pyetja bëhet: Për çka e ke shfrytëzuar këtë mjet.

Pra, zhvillimi nuk ka të bëjë me teknologjinë. Teknologji quhen çështjet, të cilat i ofrojnë mundësi jetës që të jetë sa më komode, sa më e lehtë dhe sa më shpejtë të arrihet te përfitimi; mirëpo, cilat janë mënyrat e jetesës? Këtë duhet ta hulumtojmë: ky zhvillim sjell zhvillim apo jo? Nëse e kanë prodhuar mizorët dhe kriminelët, kjo është mirë dhe e dobishme. Shfrytëzoje TV-në në edukimin e fëmijëve tu dhe zhvilloj në bazë të aftësive të tyre, sepse kjo është e mirë dhe e dobishme. Por, nëse e shfrytëzoj TV-në që nëpërmes saj në shtëpinë time të depërtojë devijimi, gjërat e degjenerimit dhe lakuriqësia, kjo është sherr-keq.

Pra, televizioni nuk është "zhvillimi'' në vetvete, por është zhvillimi në bazë të asaj se si e shfrytëzon ti. Thika; a mos thuhet se thika është zhvillim apo jozhvillim. Jo. Por, thika cilësohet në bazë të asaj për çka e përdorim. Nëse përdoret për atë që është hallall e lejuar, është mirë dhe e dobishme, por nëse përdoret për atë që është haram e ndaluar, është e dëmshme.

Pra, nuk lejohet që të themi: Teknologjia është zhvillimi perëndimor, por duhet të themi: teknologjia e këtyre mjeteve, mjete të cilat i sigurojnë njeriut zhvillim të shpejtë, nuk e lodhin, i sjellin njeriut të mira shumë shpejt dhe me lehtësi. Mos thuaj: Këto janë zhvillim. Por, zhvillim është në shpenzimin e këtyre mjeteve. Ky është zhvillimi (modernizmi)!!

ABESE VE TEVELA – "U VRENJT DHE KTHEHU SHPINËN"

Pyetje: Disa armiq të islamit thonë se tërheqja e vërejtjes prej Allahut të Lartmadhëruar, pejgamberit të Tij s.a.v.s. në suretu "Abese" tregon dobësinë e pejgamberit fisnik dhe ky është një ajet prej ajeteve që është qortuar. Dëshirojmë, nga ju, i nderuar, të na sqaroni këtë çështje dhe të na e largoni këtë dyshim, që të mos bien pre disa prej besimtarëve.

Përgjigjja: Le të shikojmë çështjen thelbësisht dhe me logjikë dhe ta analizojmë së bashku: a është qortuar, ashtu siç thonë ata, "dobësi dhe paaftësi e pejgamberit s.a.v.s."

Në fillim: Ky i verbër, i cili ka shkuar te i dërguari i Allahut s.a.v.s. është besimtar apo pabesimtar?. I verbëri, i cili ka shkuar te pejgamberi s.a.v.s. ka qenë besimtar, i cili ka vajtur për të pyetur çështje prej çështjeve të fesë. Mospërgjigjja për t'i sqaruar besimtarit a është çështje e lehtë apo e vështirë!? Nuk ka dyshim se mospërgjigjja ndaj besimtarit është çështje e lehtë. Ai njeri e pyeste të dërguarin, përderisa ai ishte i preokupuar dhe i angazhuar me pabesimtarët, për t'iu kundërvënë atyre.

Nuk ka dyshim se kjo është shumë e vështirë, në krahasim me të parën. Pra, Allahu i Lartmadhëruar i ka thënë të Dërguarit të Tij : "Pse po lodhesh dhe po e mundon veten me ata pabesimtarë dhe po humb kohë me ta? Kjo është çështje e mundimshme për ty". Pra, Zoti i Lartmadhëruar nuk e qorton pse është i hidhëruar me të, por pse ai mundohet. Kjo do të thotë se po ia tërheq vërejtjen në dobi të Pejgamberit s.a.v.s.

Të shikojmë qortimin në një rast tjetër, ku Zoti i Lartmadhëruar i thotë: "Pse po e ndalon veten në atë çka Allahu ta ka lejuar ty?". Këtu Zoti i Lartmadhëruar e pyet të dërguarin e Tij: "Pse po e ngushton veten tënde". A mos është kjo çështje, e cila e dëmton dhe e vështirëson të Dërguarin s.a.v.s., apo është çështje që e lehtëson dhe e zgjeron.

Kjo është kështu. Për të ta bërë më të qartë: nëse ti ke një fëmijë apo një vëlla, i cili angazhohet për së tepërmi për të mësuar, ai gjatë ditës është në shkollë, ndërsa tërë natën mëson, përsërit mësimin dhe studion. E, ti e qorton pse ai po lodhet për së tepërmi. Kjo është se ti e do dhe ke kujdes të madh ndaj tij, e ky qortim, në këtë rast, nuk është për shkak se ka lënë mangët diçka nga detyrat e tij. Qortimi dhe vërejtja ka ndodhur, por ka ndodh për t'ia lehtësuar, e jo për t'ia vështirësuar gjendjen. Çështja në mes të qortimeve ka

dallim shumë të madh.

VETËVRASJA

Shumica pyesin se vetëvrasja a është haram apo hallall. Ndonjëri arsyetohet: Po, unë, në atë rast, nuk e dëmtoj askënd dhe nuk e mundoj askënd, sepse është e drejta ime dhe jeta ime?

Përgjigjja: vëlla i dashur, Zoti të udhëzoftë! O vëllai im, Allahu ta ka dhuruar jetën, e jetën tënde duhet ta lësh te Ai, i cili ta ka dhuruar. Për këtë arsye, vrasja e tjetërkujt është mëkat i njëjtë me vetëvrasjen, sepse kjo konsiderohet shkelje e të drejtës tënde. Nuk do të thotë se një veprimi i tillë është e drejta jote. Na hadith kudsij Zoti i Lartmadhëruar thotë: "Robi im e ka mbytur veten dhe për këtë arsye ia ka ndaluar vetes xhenetin, sepse ky njeri e ka pranuar jetën, të cilën ia ka dhuruar atij Allahu. Pastaj, atë jetë e ka shuar vet, e kjo nuk është e drejtë e tij."

Shkak tjetër. Vetëvrasësi nuk e bën një gjë të tillë, përpos nëse iu është vështirësuar diçka, e kjo do të thotë dobësi e imanit. Prej vlerave të imanit është që t'i tejkalosh fatkeqësitë dhe me imanin tënd të jesh i fuqishëm. Ndërkaq, me vetëvrasje ke paragjykuar paaftësinë e Allahut, e kjo nënkupton humbjen e shpresës në mëshirën e Allahut.

Duhet ta dimë se në këtë botë njeriut i ndodhin ndryshime të shumta. E tërë bota është ndryshuese. Njeriu duhet të jetë i ndërlidhur patjetër me Zotin e tij. Nëse njeriut i ndodhin fatkeqësi ose përjeton fazë kritike, i kthehet Zotit të Tij. E besimi dhe lidhja me Zotin e tij i jep freski dhe forcë për t'i tejkaluar krizat dhe vështirësitë nëpër të cilat kalon. Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Pra, me përkujtim ndaj Zotit qetësohen Zemrat".** Zoti e ka folur të vërtetën. Ne shohim se zemrat, të cilat nuk e kujtojnë Allahun, janë të brengosura dhe të tronditura. Mirëpo, atëherë kur njeriu e kujton Zotin, i qetësohet zemra, sepse e di se nuk i përballon vet ngjarjet me jofuqinë e tij, por ballafaqohet me ngjarjet me fuqinë e Zotit të Tij dhe kjo e bën që zemra e tij të jetë e qetë.

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: **"Është interesant me besimtarin se çdo çështje që i ndodh, është e dobishme për të, e këtë nuk e posedon askush tjetër, pos besimtarit. Nëse i ndodh ndonjë e mirë, falënderon, e kjo i sjell dobi pastaj. Nëse i ndodh ndonjë e keqe, duron**

dhe për durimin e tij ka dobi."

I FSHEHIN TË MIRAT E BURRIT

Pyetje: Kam dëgjuar se shumica e banorëve të xhehenemit janë gra.

Përgjigje: I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: ***"Ato i fshehin të mirat e burrit, nëse i bën të mira gjithmonë, por, nëse vetëm një herë ia bën një të keqe, thotë: Kurrë nuk kam parë ndonjë të mirë prej teje"***

Pasi që kjo është e metë e tyre, secila që nuk dëshiron të jetë prej banorëve të xhenetit, le ta largojë këtë ves; dhe, kur burri t'ia bëjë një të keqe, le të thotë se ia ka bërë vetëm një të keqe dhe gjithmonë është sjellë mirë. Me këtë kënaqet dhe pajtohet burri i saj dhe kalon jetë të lumtur me të, pra që mos t'ia fshehë të mirat, sepse e fiton xhenetin, nëse do Zoti. Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: Çdo grua, me të cilën është ndarë i kënaqur burri i saj, do të hyjë në xhenet.

Lusim Allahun që ju të jeni bashkëshorte e tillë.

KUJTIMI I VDEKJES

Vazhdimisht e kujtoj vdekjen: në çdo vend, në çdo moment, kur bie të flej e kur zgjohem. Ky kujtim nuk më ndahet ditë e natë dhe më ka hyrë në gjak. E dëgjoj zërin e tij (të vdekjes) duke më pëshpëritur në vesh, zë i cili më frikëson dhe nuk mund ta largoj. Më mundon për së tepërmi, thuajse dëshiron të më mbysë. Më ka pushtuar mërzia, pikëllimi e dhembja dhe jetën e shoh zi. Kam mbetur e pashpresë dhe nuk kam vullnet për jetë.

Përgjigja: Oj bija ime! Qetësohu. Vdekja nuk është ashtu si mendon ti, nuk është përfundimi i jetës, por kalim prej një faze të jetës në një fazë tjetër. Oj bija ime, besimi (imani) është pasaportë e kufirit të jetës së amshuar, të cilën e ka përgatitur Allahu për robërit e tij të mirë. Mëshira e Allahut është më e madhe se që mendon ti. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: "Dhe mëshira Ime ka përfshirë gjithçka"

Ndërsa, sa i përket gjendjes tënde, besoj se është për shkak të ndonjë

rasti të veçantë, i cili të ka ndodhur, ose për shkak se të ka vdekur ndonjë i afërt e i dashur befasisht dhe ai rast është shkak që ti e kujton vdekjen pandërprerë.

Prej njeriut kërkohet që ta kujtojë vdekjen, mirëpo jo të jetosh me agoni të vdekjes. Prej mëshirës së Allahut është që ne ta harrojmë ndonjëherë, sepse po ta kujtonim pandërprerë, njerëzit do të bëheshin parazitë, nuk do të punonin dhe do të ndërpritej aktiviteti jetësor.

Njeriu besimtar le ta kujtojë vdekjen aq sa i mundëson të mbetet në këtë jetë dhe aq sa i mundëson të kalojë në botën tjetër.

AGJËRIMI ËSHTË I PLOTË EDHE PSE AGJËRUESI ËSHTË XHUNUB (I PAPASTËR)

Kur të thërret ezani i sabahut në Ramazan, unë veç kam qenë xhunub prej natës së asaj dite të ramazanit. A ndikon kjo në prishjen e agjërimit tim, pasi që unë veç kam vendosur të agjëroj atë ditë?

Përgjigjja: Agjërimi yt është i plotë, por ti duhet të pastrohesh (gusël) në kohën sa më të afërt, me qëllim që të falësh namazin e sabahut.

MJEKU I GRAVE

Jam shtatzënë. Kontrollat i bëj te një gjinekolog i njohur, te i cili kam besim dhe më pushon zemra, mirëpo ai nuk është i devotshëm. A konsiderohet kjo haram për mua, edhe pse jam kontrolluar te një gjinekologe, tek e cila nuk kam besim se është shumë e aftë?

Përgjigje: Përderisa je e devotshme, edhe pse nuk ke besim në aftësinë e gjinekologes dhe nuk të pushon zemra te ajo, nuk ka pengesë të hulumtohet gjinekolog i specializuar, i cili i frikësohet Allahut. Po, nëse nuk has të tillë, nuk ka kurrfarë pengese të vazhdohet te ai gjinekolog, nëse nuk ka në atë vend gjinekolog të specializuar, pos tij.

FETAVATË E SHAËRAVIJUT

PJESA E NËNTË

IX

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

Kaçanik, 2015

HYRJE

Prof. Ali Abdul Adhim.
Këshilltar dhe ekspert i artit në institutin e hulumtimeve islame.

Të shkruarit është art i ndërlikuar dhe më i përpiktë prej arteve ideore. Çdo ide nuk është e dobishme dhe për atë nuk është mirë të shkruhet.

Idetë janë ushqim i mendjeve, ashtu siç janë ushqimet-ushqimi i trupit. Çdo ushqim nuk është i mirë për trupin, por patjetër duhet parapërgatitur kushtet specifike që e bëjnë të dobishme për kryerjen e detyrës. Prej kushteve më të rëndësishme janë: e para: që ta ngopë (mbulojë) nevojën e mendjes, ashtu siç e ngopë ushqimi nevojën e trupit. Llojllojshmëria e ushqimit, e cila posedon proteinat, vitaminat dhe kaloritë, bëjnë që ushqimi të jetë më i mirë dhe të kryejë detyrën. Po ashtu, idetë duhet të përmbajnë argumente logjike dhe të kapshme për të ngopur mendjet; gjithashtu duhet të ketë element nxitës që të joshë lexuesin, e pastaj ai të përfitojë prej atyre ideve.

Kur Halil bin Ahmedi, themelues i poezisë, rimimit dhe i rregullave diametrike të vargjeve në poezi, është pyetur për poezinë, ai është përgjigjur: E mira mua më refuzon, ndërsa zemra ime të keqen po e refuzon.

Kur është pyetur profesor Akadi përse nuk martohet, pasi që ai ka nevojë për shoqërinë, përkujdesje dhe jetë më të mirë, është përgjigjur në të njëjtën mënyrë, siç është përgjigjur Halili bin Ahmedi: për shkak se e mira më refuzon, ndërsa të keqen zemra ime po e refuzon.

E dyta: Për t'i nxitur ndjenjat e lexuesit, për t'i aktivizuar elementet e tretjes.

Ai që dëshiron të ketë apetit në ushqim, me ushqime të llojllojshme, për ta ngopur veten nga më e mira dhe me ushqim sa më të mirë, ai harmonizon ushqimin e llojllojshëm me nevojën e trupit, i cili ka nevojë për ushqime të llojllojshme. Për këtë arsye, ai ushqimit i shton lloj-lloj mëlmesash që të jetë ushqim sa më i këndshëm, i cili duhet të jetë i lehtë për organet e tretjes.

E treta: Për këtë arsye, autori i librit, apo studiuesi, duhet të tregojë literaturën e konsultuar, të paraqesë rëndësinë e librit, sepse tërheqja e vëmendjes është nga qëllimet kryesore të autorëve ose të studiuesve.

Nga kjo, urtësia e Allahut është se ua ka mundësuar disa studiuesve dhe hulumtuesve që ato ide të tyre logjike t'i paraqesin në formën sa më të

mirë, sa më tërheqëse, për të pasur dobi prej atyre ideve.

Nëse i bëjmë një vështrim kulturës së grekëve të vjetër, shohim se nuk do të kishim pasur dobi prej ideve të filozofit Sokrat, po të mos e kishte vazhduar rrugën e tij Platoni. Platoni i ka ruajtur dhe i ka paraqitur idetë e Sokratit, e pastaj prej tij kanë ardhur deri tek ne me metodën tërheqëse dhe bindëse.

Nuk do të kishim pasur dobi prej ideve të Platonit, po mos të kishe vazhduar dhe mos t'i kishte përcjellë Aristoteli idetë e tij deri tek ne. Ai i ka ruajtur që të mos lihen në harresë dhe prej tij kanë ardhur deri tek ne me metodën tërheqëse dhe bindëse.

Shembull të tillë mund të marrim edhe rastin e Ibni Tejmije, si dijetar islam me renome, dhe nxënësin e tij, Ibn Kajin el Xhevzijut, i cili na ka sjellë neve mendimet e profesorit të tij dhe ka vazhduar rrugën e tij në rizgjimin islam; dhe frytet e tij po i shijojmë tani. Po ashtu, shembull kemi edhe Xhemaludin Afganin, nxënësin e tij, Muhamed Abduhun, po ashtu edhe nxënësin tjetër, Reshid Rida. Po mos të kishte qenë ai, gjurmët e profesorit të tij do të kishin humbur dhe nuk do të kishim projektimin e rrugës për rizgjimin e plotë islam, i cili ka sjellë rezultate të mira, e frytet e atyre rezultateve po i shijojmë edhe sot.

Kjo çështje m'u kujtua atëherë kur kam lexuar pjesë të librit "Fetvatë'' të imamit shejh Muhamed Muteveli Esh-Shaëravijut, të cilat i ka përgatitur nxënësi i tij, Mr. Sejid Xhemil, sepse Shejh Shaeraviju është i njohur për mendjemprehtësinë dhe dhuntinë e tij.

Ai nuk ka pasur kohë që t'i rishikojë, kontrollojë dhe redaktojë, por këtë ia ka mundësuar Allahu Sejid Xhemilit dhe profesorit Ahmed Feraxh, për t'i shpalosur gjurmët e Shejh Shaeravijut dhe paraqitjen e tyre në formën më të mirë e më të lehtë.

Këtë e kam vërejtur atëherë kur kam lexuar artikujt e dr. Sejid Xhemil dhe kam parë përvojën e tij gazetareske, e cila është tërheqëse me metodologjinë e tij dhe depërtimin e tij thellë dhe fuqishëm në kulturën dhe studimin islam, në mjekësinë praktike islame, në letërsinë islame, e i cili me mund dhe durim të madh hulumton, tubon, i përzgjedh dhe i harmonizon idetë dhe mendimet.

Zoti e shpërbleftë me të mira shejhun tonë, imam Shaeravijun për diturinë e tij të dobishme, i cili islamit dhe muslimanëve u ofron dituri të dobishme! Zoti e bekoftë jetën e tij! KAJRO: 7 sheval, 1402/28 korrik, 1982.

ARTET E BUKURA

Pyetje: Artet e bukura, si pikturimi, skulpturimi e të ngjashme, a janë të lejuara apo të ndaluara?

Përgjigjja: Arti i bukur, ti po e thua këtë. Ti po thua se është arti i bukur, por nga e more këtë qëndrim që ti ta cilësosh të bukur? A është cilësi me të cilën e ka emëruar feja? JO. Prej njeriut? Ne parashtrojmë pyetjen: Çka do të thotë "i bukur"? Kusht është që e mira mos të të shpjerë ty në të keqen. Thonë: Vallëzimi është art i bukurisë. Mirëpo, vallëzimi a të shpjerë në të keqe, apo jo? Çdo bukuri, e cila rezulton (prodhon) të keqen, nuk është e bukur. Për këtë arsye mos thuaj: "Arti i bukur". Por, e cilëson të bukur atëherë kur pranohet e bukur. Po si të jetë e bukur, kur nuk sjell asgjë tjetër pos të keqen!!

Skulptori krijon një skulpturë. Kjo skulpturë është e bukur, është e përkryer, ndërsa të tjerët devijojnë dhe, pas kësaj, e adhurojnë atë skulpturë; pra kjo është e keqja. E mira duhet të mbetet e mirë, të mbetet e mirë në sy dhe në mendje, e jo e mirë në vetvete (vet skulpturën). Allahu kërkon prej nesh që botën ta bëjmë të bukur. Çka do të thotë "e bukur"? Do të thotë që të vazhdojë të jetë gjithmonë e bukur (p.sh femra, e cila zbukurohet, që të jetë e bukur). Unë i them asaj: Bukurinë tënde bëje që të mos na shpjerë neve në të keqe, që të mos t'i shkaktojë probleme familjes së saj, mos t'i shkaktojë probleme burrit të saj; mos u zbukuro vetëm të jesh e bukur, por që bukuria jote të jetë gjithëpërfshirëse, se përndryshe...Kur'ani para se të na sjellë të mira të shumta materiale, na sjell të mira të shumta të bukurisë. Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an thotë: **"Dhe për ju (caktoj) në ta (bagëti) ka bukuri, kur i ktheni nga kullota, dhe kur i merrni në kullotë. Ato mbajnë barrët tuaja deri në vende të largëta, tek të cilat ju do të arrini me mundim të madh." (EN-NAHL; 6,7).** Parashtrohet pyetja: Pse?

Sepse teorema e bukurisë është që edhe ai i cili nuk pronëson, gëzohet, pra ai, i cili nuk i pronëson, gëzohet kur t'i shohë. Unë nuk kam kështjellë, por kur ta shohë një kështjellë të bukur, pastaj shoh parkun, oborrin rreth e përqark, gëzohem dhe bëhem i lumtur. Nga ky aspekt, bukuria është çështje transitore, që do të thotë kalon në të gjithë ata, të cilët e shohin, ndërsa sa i përket qumështit, bartjes së barrës, është posaçërisht për ata që e pronësojnë.

Para se t'i shohë frytet e pemëve, Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Shikoni në frytet e pemës para se të piqen plotësisht dhe të marrin formën e tyre.” (EL-ENAM, 99). Kënaqni sytë e juaj duke shikuar, e jo vetëm barqet tuaja.

Mirëpo, më siguro se puna mbetet kështu. Mos thuaj se “arti i bukur në tërësi”, sepse arti i bukur patjetër duhet ta ruajë bukurinë përgjithmonë, e jo të jetë e bukur në një çast, e të shkatërrojë në çastin tjetër. Kjo nuk është “e bukura”.

P.sh. Skulptura, nëse më sjell mua në idhujtari dhe në pabesim, nuk është e lejuar. Para se të sprovohen njerëzit, ajo veç ka qenë prezente, mirëpo pasi që ka kaluar në adhurim të tyre, puna e tyre veç ka mbaruar. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë për Sulejmanin: Sulejmani i ka nënshtruar xhinët, që ata të ndërtojnë çka dëshiron prej mihrabave, skulpturave. Kanë ndërtuar skulptura dhe nuk ka ndodhur shkatërrim prej tyre. Mirëpo, nga çasti kur kanë ndodhur fitnet dhe shkatërrimet, ka thënë: JO, nuk ndërtohen më skulptura.

PSE ALLAHU E KA CAKTUAR SULEJMANIN QË TË JETË MBRET?

Zoti i Lartmadhëruar ka dërguar pejgamberë, të cilët nuk kanë qenë mbretër. Kështu ka caktuar me urtësinë e tij, sepse, po të kishte dashur Allahu të ishin që të gjithë mbretër, askush nuk do të kishte mund t’i pengojë. Cila është urtësia e zgjedhjes së Sulejmanit edhe mbret, edhe pejgamber?

Përgjigjja: Nga kjo kuptohet qartë se po të donte Allahu, të gjitha çështjet do të shkonin në rregull dhe askush nuk do të mund ta ngriste kokën. Dhe ja, e ka zgjedhur pejgamberin, kërkesën e të cilit nuk ka mundur ta refuzojë askush, sepse ai ka poseduar pushtet dhe sundim. Mirëpo, Allahu nuk ka dëshiruar kështu. Allahu dëshiron që të shkojmë vullnetarë në drejtimin e tij, Allahu dëshiron që të shkojmë në rrugën e Tij, edhe pse ata të cilët shkojnë në rrugën e tij, janë të dobët. Kjo nga arsyeja se dashuria për Të na ka shtyrë të besojmë.

Sa e sa mundime kanë përjetuar pejgamberët? Sa e sa urrejtje, sa e sa xhelozi e fatkeqësi i kanë përjetuar në thirrjen e tyre në programin e Allahut!!!?

DHE NUK KA BËRË KUFËR (NUK KA KALUAR NË PABESIM) SULEJMANI

Allahu ia ka nënshtruar Sulejmanit xhinët. Melekët ia kanë dërguar Sulejmanit xhinët me pranga të zjarrit. Sulejmani i ka dënuar ashpër, nëse nuk e kanë kryer urdhrin e tij. Sulejmani nuk e ka përdorur magjinë për nënshtrimin e xhinëve. Ai i ka përdorur ata për çështje të dobishme, e jo për ato të dëmshmet.

Kur ka vdekur Sulejmani, ata janë ngritur kundër tij, duke thënë: "Sulejmani ju ka nënshtruar juve me magji" dhe i kanë dërguar te vendi ku ka qenë i varrosur... hajmalia i kanë vendosur edhe nën frontin e tij, ashtu siç thuhet në disa shkrime të "israilëve". Kur'ani e shfajëson Sulejmanin për këtë, ku Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **"Dhe pasojnë atë që kanë thënë shejtanët për sundimin e Sulejmanit. Sulejmani nuk ka qenë pabesimtar, por shejtanët kanë qenë pabesimtarë, ata ua mësonin njerëzve magjinë".**

Pyetja është: Çka mendon Shaëraviju në lidhje me këtë çështje ?

Imami i nderuar thotë: Allahu i Lartmadhëruar ia ka nënshtruar xhinët Sulejmanit për t'i sjellë dobi njerëzimit dhe për ta zhvilluar tokën, e nuk i ka nënshtruar për t'i dëmtuar. Kur Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: "Dhe Sulejmani nuk ka qenë pabesimtar", që do të thotë se Zoti i Lartmadhëruar, kur ka dëshiruar që Sulejmanit t'ia nënshtrojë xhinët, ka qenë e ditur se Sulejmani nuk është pabesimtar dhe këtë fuqi nuk e ka shfrytëzuar për të keq, por e ka shfrytëzuar fuqinë e tyre për të mirë, posaçërisht kur Allahu i jep dikujt diçka çka nuk u ka dhënë të tjerëve, sepse mizoria dhe pabesimi e mbisundojnë botën, posaçërisht kur e shfrytëzojnë këtë shans për t'u përhapur e keqja dhe mëkati. Pastaj, Zoti i Lartmadhëruar tregon për melekët Harut dhe Marut, të cilët ua kanë mësuar njerëzve magjinë: "E nuk e ka mësuar asnjë njeri pa i thënë: Vërtet, ne jemi sprovë për ju, e mos moho". Fjala "mos moho" do të thotë se nëse e ke në disponim një forcë të gjithësisë, ruaju, ki kujdes e mos e shfrytëzo për asgjë tjetër, pos për gjëra të dobishme. Kjo praktikë duhet të jetë për çdo fuqi, pushtet apo forcë, të cilën ia jep Allahu kujtdoqoftë. Kur t'i lutesh për diçka, thua: Zoti im, më jep këtë, që të adhuroj me sinqeritet dhe të bëj të mira në këtë botë. E, kur Allahu ta jep atë (pushtet, pozitë apo forcë), ajo ty të nënshtron dhe, përkundrazi, ti fillon të bësh shkatërrime. P.sh. nëse ti do pushtet, e lut Allahun që të të japë pushtet, Zoti

ta pranon këtë lutje. E, pasi që ti të arrish në pushtet, fillon ta sulmosh të drejtën, e përhap shkatërrimin dhe padrejtësinë, duke menduar se ti mund ta pengosh Zotin e Lartmadhëruar. Ti, kur je lutur për mirësi ose pasi që të është dhënë, je drejtuar në të keqe. Kështu, Allahu na mëson sjelljet e shejtanit në zemrën e njeriut. Pasi të arrish në pozitë, të vjen shejtani ty dhe të shkakton cytje në epshin tënd, ashtu siç e ka hamendur zemrën e Ademit, duke i thënë: pushteti yt nuk do të ketë përfundim, ti do të jesh i përgjithmonshëm, Allahu nuk do të të kërkojë llogari. E, ti e harron ditën e llogarisë dhe atëherë fillon të shkaktosh trazira e shkatërrime në fytyrën e tokës. Kështu, ti e humb pushtetin, e humb autoritetin, e takon i vetmuar e i pafytyrë Allahun. Kështu, Allahu ta ka humbur shansin, të cilin e ke pasur në dorë. Në vend se ti të jesh më i graduari, ti bëhesh më i nënçmuari.

Për këtë arsye, kur të fillosh të lexosh Kur'an, Allahu ka kërkuar prej teje që të kërkosh prej Tij mbrojtje nga shejtani i mallkuar. Po pse? Nëse ti i mbështetesh Krijuesit, kundrejt krijesës së Tij, ajo krijesë nuk mund të të shkatërrojë. Kur ti e lexon Kur'anin, shejtani nuk dëshiron që ti të përfitosh të mirat e Allahut prej leximit të Kur'anit. E, kur ti kërkon mbështetje prej Allahut, kundrejt shejtanit, ai shtrydhet, sepse që në çastin kur ti e kujton Allahun, shejtani shtrydhet. Pra, thënia e Allahut: Dhe kur ta lexosh Kur'anin, kërko mbështetje kundrejt shejtanit të mallkuar, thuhet se ti je bërë mjet për të pranuar rrezet e dritës së të mirave të Kur'anit pa kurrëfarë pengese.

DHE SECILI PREJ JUSH DO TË SILLET NË TË

Dhe Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **“Dhe secili prej jush do të sillet në të. Kjo çështje është vulosur”**. **(MEJREM, 71)**

A do të thotë se të gjithë njerëzit do të sillen në zjarr?

Imami i nderuar, Shaëraviju, thotë: Siç e interpretojnë disa komentues, ky ajet tregon se askush nuk mund t’i shpëtojë ndëshkimit. Dhe ne, që të gjithë, disa prej nesh janë të mirë, e disa mëkatarë, gënjeshtarë e të dëgjueshëm, do t’i dënojmë me zjarr. Kuptimi i vërtetë i këtij ajeti është ky. Duhet ta kuptojmë fjalën “do të sillet”. Sjellja e ujit ka kuptimin ardhjen e ujit prej vendit të tij, e ai vend është burimi. Unë e kam sjellur bagëtinë time te uji, ata kanë pirë, mirëpo unë nuk kam pirë dhe jam kthyer me ta. Pra, kush

është me mua, pi, por unë nuk kam pirë. Pra, "sjellja te uji" do të thotë t'i sjellësh te burimi i ujit, ndërsa pirja apo mospirja është çështje tjetër.

"Dhe secili prej jush do të sillet në të". Allahu dëshiron të tregoj vlerën e tij te ta. Do të thotë: Ju, që të gjithë, do ta shihni zjarrin, do të kaloni nëpër të. Mirëpo, ne e dimë se ajetet e Kur'anit e shpjegojnë njëra-tjetrën. Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Dhe ai i cili tejkalon zjarrin dhe nuk bie në të, por hyn në xhenet, ai ka shpëtuar".**

Pra, secili prej nesh do ta shohë zjarrin, ndërsa robërit e mirë orientohen në drejtim të qiellit dhe do të thonë: O Zoti im, Falënderojmë Allahun, i cili na shpëtoi prej përvëlimit të madh, të cilin e pamë vetë, na bëri ta tejkalojmë zjarrin dhe na shpëtoi prej tij. Begati e madhe për njeriun është që të mos hyjë në xhenet, e të mbetet në (EARAF) mes xhenetit e xhehenemit, por begati shumë e madhe është të tejkalohet zjarri dhe të hysh në xhenet. Ky është fitim i pakrahasueshëm. I është shmangur dënimit të zjarrit dhe është siguruar prej tij. Në të njëjtën kohë kënaqet me të mirat e xhenetit. Kjo është rruga e imanit dhe rruga që shpie në xhenet, në të cilin ka të mira, që syri as i ka parë ndonjëherë, veshi as i ka dëgjuar ndonjëherë dhe as që ka menduar ndokush ndonjëherë për të mira të tilla.

O Zoti ynë, na ofro rrugën e xhenetit Tënd dhe na bëj që të hyjmë në të, na lehtëso të gjitha çështjet, qofshin me fjalë, qofshin me punë, që të hyjmë në të.

SHPIRTI DHE MATERIA

E dimë se Islami bën paralelizëm në mes të materies dhe shpirtit, mirëpo ka mendime se "Ka dallim të madh në mes shpirtit dhe materies" dhe secili i takon botës së tij të veçantë. Si t'i harmonizojmë këto dy mendime, kur po shihet se këto mendime janë kundërthënëse?

Imami ynë i nderuar na sqaroi atë që për ne është e paqartë. Zoti e bekoftë!

Përgjigjja: Shpirti dhe materia, këto janë vetëm fjalë. Në esencë, shpirti është i mirë. E keqja prej shpirtit vjen atëherë kur të depërtojë në materie dhe e përbën njeriun, sepse atëherë njeriu (NEFSI-EPSHI) vepron ç'të dëshirojë.

Esenca e tërë ekzistencës është materie e së mirës, pastërtisë dhe ibadetit. Për këtë arsye, në atë moment kur dëshiron (epshi), e vendos materia, kthehet në natyrshmërinë e saj: **“Atë ditë kur do të dëshmojnë gjuhët e tyre, duart e tyre dhe këmbët e tyre atë çka kanë punuar” (EN NURË, 24)**. Tani kompetencat kanë kaluar në Allahun. Më herët kompetenca mbi ta ka qenë komptetenca e dëshirës (epshit) mbi pjesët e trupit. Oj dorë, bjeri filanit, ose: oj dorë vepro këtë dhe atë. Dora nuk ka mundësi të kundërshtojë, sepse dëshira jote e ka udhëheqjen mbi të, ndërsa në ditën e kiametit ti nuk e ke atë mundësi. Për këtë arsye edhe dëshmojnë kundër dëshirës tënde dhe kundër teje. Materia e pabesimtarit i bën tesbih Allahut, ndërsa ajo reflekton dëshirën e pabesimtarit (shiko sa mahnitëse, materia, substanca lartëson Allahun, ndërsa reflektimi i saj prej dëshirës së pabesimtarit është pabesimi). Mos thuaj: o biri im shpirtëror material, sepse kjo është fjalë sipërfaqësore, nuk është shkencore; sendet nga natyrshmëria e tyre bëjnë tesbih dhe adhurojnë, e për këtë arsye nuk cilësohet vetëm materia, po ashtu, nuk cilësohet vetëm shpirti, por bëhet fjalë për NEFSIN-TRUPIN ME SHPIRT. Kuptimi i NEFSIT është shpirti me trupin, pastaj vjen dëshira, etj. Për këtë arsye vjen deri te mjegullinat. A u sqarua çështja?

VLERA E LEXIMIT TË KUR'ANIT

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Dhe lexoni çka është më së lehti prej Kur'anit”.**

Po ashtu, thotë: **“Dhe Ne e kemi lehtësuar Kur'anin për përkujtim, por a ka ndonjë që logjikon?”.**

Po ashtu, thotë: **“Dhe e kemi marrë përsipër, e detyrë e jona është që ta tubojmë dhe ta lexojmë atë. Dhe atëherë kur ta lexojmë atë, përcille leximin e tij.”**

Leximi i Kur'anit është ibadet. Koha më e vlefshme e të lexuarit të Kur'anit është sabahu, ku Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Dhe leximi i Kur'anit në sabah është dëshmuar**”. Pra, e dëshmojnë edhe melaqet e natës dhe të ditës.

Pyetja është: Cili lexim ka me shumë shpërblim: leximi në heshtje apo leximi me zë?

Përgjigjja: Më së miri është të lexuarit me zë dhe përmendësh.

Po ashtu, lexo edhe duke shikuar në Mus-haf, ashtu që të ketë shpërblim shikimi yt dhe dëgjimi yt (i veshit tënd). Po ashtu, të ketë shpërblim gjuha jote. Kur'ani nuk është thjeshtë vetëm fjalë, e cila theksohen, por secila shkronjë është melaqe. Kur'ani ka dashuri, sikurse është dashuria njerëzore: nëse e lë anash, e harron.

Pyetje: Ka njerëz të rëndomtë dhe të huaj, të cilët e lexojnë Kur'anin dhe nuk i kuptojnë domethëniet e tij, as mrekullitë e tij.A shpërblehen ata për leximin e Kur'anit?

Përgjigjja: Leximi i Kur'anit është dy llojesh. Lloji i parë është lexim adhurimi dhe ky lexim nuk ka të bëjë me kuptimin, sepse sado që ta kuptojmë Kur'anin, ajo është çka na ka mundësuar Allahu dhe sa kemi mundësi ne. Leximi i shprehjeve të Kur'anit, të cilat Allahu dëshiron që të na mundësojë të kuptojmë prej tij, ndërsa nuk është ajo çka dimë dhe çka kuptojmë prej tij.

Ndërsa, kur ta lexojmë Kur'anin për të nxjerrë ligje prej tij, kjo është krejt një çështje tjetër. Studiuesi e lexon Kur'anin dhe thotë: "prej këtij kuptimi nxirret kjo, prej kësaj fjale kjo". Dhe sikur të ktheheshim te i dërguari dhe te ata, të cilët vet e kanë emëruar, do të dinim atë që e kanë nxjerrë ata prej tij (prej vet mesit të tyre).

Pra, unë e lexoj Kur'anin për të kuptuar qëllimin që dëshiron Allahu ta kuptojë prej tij. Duhet ta dimë se shfrytëzimi (dobia) në çështje nuk do të thotë të kuptuarit e mënyrës së shfrytëzimit (dobisë). Njeriu i rëndomtë përfiton prej ekranit televiziv, ose prej zërit të radios, mirëpo inxhinieri e di çdo çështje të saj në brendi. Mirëpo, pse unë nuk i di pjesët e brendshme të atij mjeti, nuk do të thotë se nuk mund të përfitoj prej tij. Nëse nuk e di përbërjen e barërave, a do të thotë se unë nuk do të përfitoj asgjë prej atyre barërave?

Jo, kurrsesi jo, se atëherë çdo pacient (i sëmurë) do të kërkonte prej farmacistit përbërjen e çdo hapi (bari), të cilin e merr prej tij.

Pra, leximi i Kur'anit, e kuptova apo nuk e kuptova, më bën dobi.

Ne duhet ta kuptojmë Kur'anin aq sa kemi mundësi, e Allahu nuk na ngarkon më shumë se sa kemi mundësi.

ATA TË CILËT DO TË SHPËRBLEHEN ME TË MIRA EDHE MË SHUMË SE KJO

Pyetja: Kanë thënë: "Edhe më shumë se kjo" është të shikuarit në Allahun e Lartmadhëruar në xhenet. Allahu ka caktuar që ne, besimtarët e devotshëm, ta shohim në xhenet madhërinë e Tij. Allahu nuk e thyen premtimin.

Si do ta shohim Allahun në botën tjetër, me shqisat tona lëndore të kësaj bote, apo ndoshta do të shndërrohen në shqisa të tjera (superiore) për të parë dritën e të Gjithëfuqishmit?

Përgjigje: Imami i nderuar, Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju, thotë: Po, në botën tjetër do ta shohim Allahun e Lartmadhëruar. Mirëpo, vështirë e kemi ta parashikojmë këtë, nëse mendojmë se do ta shohim me shqisat tona tokësore. Allahu i Lartmadhëruar do t'i shndërrojë shqisat rrënjësisht në shqisa të tjera, të cilat do të jenë harmonike me botën tjetër. Mirëpo, Allahu na përafron. Allahu ka krijuar sende në tokë, të cilat nuk mund të shihen për të na treguar përafërsisht për sendet e fshehta. Ka sende të cilat nuk mund të shihen me sy, mirëpo me zbulimin e mjeteve dhe aparateve i shohim. P.sh. mikrobin më parë nuk e kemi parë, por pse nuk e kemi parë, nuk do të thotë se ai është i paparë. Syri yt nuk mund ta shohë, e argument për këtë është se unë po e shoh me mikroskop. Sendi mund të mos shihet ose për shkak të largësisë (distancës), ose për shkak të imtësisë.

Mikroskopi e zmadhon të voglën, teleskopi e afron të largtën. Shkak i asaj pse nuk i shohim apo nuk i kemi parë është mungesa e aparateve.

Kur të ringjallemi, ne do të kemi aparate të tjera për të parë atë që nuk kemi mund ta shohim më herët. Për këtë arsye në berzah, në çastin e vdekjes hiqet perdja (pengesa) dhe ne mund të shohim atë që nuk kemi mundur ta shohim më herët (në jetë). Pra, secila (pjesë e jetës) i ka ligjet e saj. Ta marrim shembull jetën tonë. Ajo kalon nëpër dy faza: në gjumë dhe zgjuar. Ligji i gjumit ndryshon prej ligjit zgjuar. Në gjumë (në ëndërr) shohim njeriun e veshur me rroba të bardha në automjet të gjelbër. Po si i kam dalluar ngjyrat, përderisa sytë i kam pasur të mbyllur.

Pra, gjatë gjumit ne kemi mjet, i cili i percepton (i sheh) gjërat pa i pasur sytë hapur. Shoqërimi në gjumë nuk ndikon në ne. Dy persona flejnë në të njëjtin shtrat, njëri sheh veten e tij të lumtur, e tjetri sheh veten e tij të

pikëlluar ku njerëzit rreth e rrotull e rrahin dhe asnjëri nuk ndien përjetimin e (ëndrrës) së tjetrit.

DHE NE I KEMI NËNSHTRUAR ATA

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Dhe ua bëmë ato që t'u binden atyre, e disave prej tyre u hipin, ndërsa prej disave ushqehen”.(Jasinë, 72)

Në ajetin e lartpërmendur çfarë qëllimi ka pjesa “dhe ne i kemi nënshtruar për ta”?

Shpresojmë se Imami i nderuar do të na e sqaroj.

Përgjigjja: Njeriu është mëkëmbës i Allahut në fytyrën e tokës dhe ekzistenca të jetë në shërbim të tij, toka e nënshtruar për të, kafshët e nënshtruara për të, sendet e ngurta në shërbim të tij. Mirëpo, njeriu është indiferent. Ai mendon se të gjitha ai i ka nënshtruar. Për këtë arsye ai i thotë njeriut: jo, nuk i ke nënshtruar ti, por Ne i kemi paraparë për të t'u nënshtruar ty. Po mos t’i kishte nënshtruar për ty, ti nuk do të kishe pasur mundësi t'i nënshtrosh.

Për këtë në gjithësi sheh gjëra mahnitëse, sheh se si fëmija e sjell devenë e madhe nga të dojë, ndërsa trimi i trimave nuk guxon t’i afrohet gjarprit. Devenë e ka nënshtruar Allahu për ty, ndërsa *këtë nënshtrim për ty, që të thotë: nëse mund ta nënshtrosh me fuqinë tënde, nënshtroje!!*

Ti nuk mund ta nënshtrosh bubuzhelin (akrepin), i cili të tremb e të frikëson kur të biesh për të fjetur, mirëpo ti mund ta nënshtrosh elefantin. Interesant!! Pra, çështja është se ti me fuqinë tënde dhe mundësinë tënde nuk mund të nënshtrosh. Mirëpo, ai i cili të ka krijuar, i ka nënshtruar ato për ty. Po, nëse diçka nuk është e nënshtruar për ty, ti kurrë nuk mund ta nënshtrosh.

NE E KEMI ORIENTUAR RRUGËN

Çfarë kuptimi ka ajeti: **“Vërtet Ne e kemi orientuar rrugën, e dikush prej jush të falënderon, e dikush të mohon?”**

Përgjigje: Kur Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: “Ne e kemi orientuar rrugën”, është shpjeguar rruga ose falënderuese, ose mohuese. Vija është rruga, të cilën e ke marrë ti ose për të falënderuar, ose për t’i mohuar begatitë e Allahut; ajo është për të dy veprimet. Ndoshta dikush mund të thotë: “Dhe ne ia kemi udhëzuar dy rrugë”, që do të thotë edhe për këtë rrugë, edhe për tjetrën, por çka është prioritare mes këtyre dy rrugëve, pasi që bën për këtë, por edhe për atë që e bën prioritare Allahu, për ta bërë obligative për veten time atë rrugë. Por, po të kisha qenë i krijuar vetëm për një rrugë, do të kisha thënë: Jo, unë nuk kam mundësi të shkoj në rrugë tjetër, sepse e kam vetëm këtë rrugë. Mirëp, Ai, Allahu është orientues në një rrugë, ndërsa garuesi i ka dy çështje para vetes: Ose të jetë falënderues, ose mohues.

Pyetje: Po cili mjet zgjedh mes këtyre dy gjërave?

Përgjigjja: Pa dyshim se është ai mjet, sepse kjo është detyra e tij dhe ne e kemi udhëzuar atë në dy rrugë. Pastaj, Zoti i Lartmadhëruar thotë: “**Betohem për diellin dhe shkëlqimin e tij. Për hënën kur e përcjell atë! Për ditën kur ndriçohet plotësisht. Për natën kur e fsheh atë(diellin)! Për tokën dhe për Atë, i Cili e bëri shtrojë atë. Për shpirtin dhe për Atë, i Cili e përsosi atë. Pastaj, e orientoi atë dhe ia tregoi atij çfarë është e gabuar dhe çfarë është e drejtë për të! Vërtet, ka shpëtuar ai, i cili e ka pastruar atë (shpirtin e tij). Dhe ka dështuar ai, i cili e ka prishur veten e tij.” (ESH SHEMS 1-10)**

MES’HI MBI KOKË

Mes’hi i një pjese të kokës a është mes’h i cilitdo vend të kokës, sa që pranohet edhe nëse i jepet pjesës së prapme, e jo pjesës së përparme?

Në disa mendime lejohet mes’hi në pjesë të kokës dhe nuk është kushtëzuar t’i japësh mes’h pjesës së përparme, e as asaj të prapme. Allahu e di më së miri.

MREKULLIA E KRIJIMIT

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Allahu është sunduesi i qiejve dhe i tokës, Krijon çka të dojë, kujt të dojë i jep (fëmijë) vajza dhe kujt të dojë i jep (fëmijë) djem, ose u jep (fëmijë) djem e vajza. E , po ashtu, cilin do e bën shterpë."**

Cila është urtësia e cila rezulton nga ky ajet dhe cili është garantuesi absolut, pra kam për qëllim garantues i çështjeve, të cilat i tregon ky ajet?

Përgjigjja: Nëse e parashtrojmë në tavolinë çështjen e krijimit të njeriut në Kur'an, shohim se ne jemi të krijuar prej Ademit. Allahu prej tij ka krijuar bashkëshorten e tij. Ja, shiko: bashkëshortja e tij a është krijuar prej tij apo prej llojit (prej elementeve), siç e ka krijuar atë, pastaj shohim se njerëzit, për nga krijimi, janë të krijuar në katër mënyra: njëri as prej nënës e as prej babait, tjetri vetëm prej babait, një tjetër vetëm prej nënës (e nderuara Merjeme) dhe prej nënës e babait të gjithë njerëzit tjerë. Mirëpo, ka baba dhe nënë (çift bashkëshortor), të cilët nuk kanë fëmijë. Pra, nuk mund të thuhet absolutisht se çdo njeri duhet patjetër të jetë i krijuar vetëm prej nënës dhe prej babait. Zoti ka krijuar atë, i cili nuk ka as nënë e as baba, ka krijuar vetëm prej babait dhe ka krijuar vetëm prej nënës. Por, mund të jetë edhe nëna edhe babai, por Allahu nuk ka dëshiruar që të kenë fëmijë ata dy, edhe pse ata i kanë të plotësuara të gjitha kushtet që të kenë fëmijë. Pra, këtu është pika kulminante e fuqisë absolute të Allahut, kur të gjitha ligjet paralelizohen pranë tij.

LEXIMI I KUR'ANIT PA E KUPTUAR

Pyetje: Nëse njeriu e lexon Kur'anin, mirëpo nuk kupton asgjë prej atij leximi, a shpërblehet apo jo?

Përgjigjja: Po shpërblehet, sepse ai është lexim adhurimi.

FOTOGRAFITË ME KAFSHË NË SHTËPI

Ç'është puna me ata, të cilët e zbukurojnë murin duke pikturuar gjallesa? A është njësoj sikurse të gdhendurit e statujave dhe a është haram?

I nderuari Shejh Sheaëraviju përgjigjet:

Nuk ka asgjë në këtë, por ajo çka është haram është ajo që disa i madhërojnë dhe i

shenjtërojnë kafshët, ndërsa pikturimi vetëm për zbukurim nuk është kurrfarë pengese.

FJALA PËRFUNDIMTARE

Mjaft kemi folur. Në hyrjen e këtij libri kemi folur mjaft për ndjenjat e të vdekurve ndaj të gjallëve, për atë se ata e ndiejnë atë që na ndodh neve, çka sillet rreth nesh në këtë botë kalimtare. Ata gëzohen kur ne jemi të lumtur dhe hidhërohen kur jemi të pikëlluar, e kjo çka është gjurmuar prej haditheve. Kemi paraqitur mendimet kundërthënëse, argumentet dhe sendet. Na ka mundësuar Allahu që çdo kundërargumenti t'i përgjigjemi me kundërargument. Këtu dëshirojmë ta dimë se çfarë mendimi ka i nderuari Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju në lidhje me këtë çështje?

Pra, pyetja është: Të vdekurit a ndiejnë diçka për ne, apo jo, dhe lutja jonë që t'u falen mëkatet dhe të mëshirohen, a arrin tek ata, apo jo?

Përgjigjja: Shejh Shaëraviju thotë: Po, i vdekuri ndien për të gjallët. Po mos të kishin ndier asgjë, atëherë Ligjvënësi (i dërguari i Allahut s.a.v.s.) nuk do të na kishte urdhëruar që kur të shkojmë tek ata, t'i përshëndesim me ***"ESELAMU ALEJKUM DARU KAUMIN MUËMINIJE ENTUN SABIKUNE VE INNA SHAALLAHU LAHIKUN",*** që do të thotë: ***Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi ju shtëpi e besimtarëve, ju na keni paraprirë, por nëse do Allahu, ne do të vijmë pas jush".*** Ligjvënësi na ka urdhëruar t'i përshëndesim ata, e kjo do të thotë se ata patjetër përgjigjen.

Sa i përket lutjes, po çka është ajo e cila pengon që shpërblimi i lutjes dhe mëshira të arrijë te ata?! Pse, a nuk mund të takosh një njeri që po e dënon një tjetër, por në atë kohë shkon ndërmjetësues dhe ia ndërpret

dënimin? Cili është qëllimi i kësaj? Qëllimi është që ta ndiejë dhe ta kem parasysh se unë kam nevojë për mendimin e tjetrit për veten time dhe se mendimi i tjetrit mund të më shpëtojë dhe të më bëjë dobi. Ashtu, mendimet e mira më bëjnë dobi dhe për këtë arsye angazhohem që të sillem mirë me njerëzit, që të më duan edhe kur të vdes, sepse unë atëherë kam lënë bagazh të mirë te të gjithë njerëzit dhe se ndoshta ndonjëri prej tyre do të lutet për mua. Pra, kjo është ajo që ti duhet të punosh, që te njerëzit të lësh vetëm atë që është e mirë.

Nuk duhet që gjërat t'i marrim të ndara. Allahu ka krijuar gjithësinë në asi sistemi që ta ndihmojmë njëri-tjetrin, e të mos ekzistojnë armiqësitë. Unë kur ta shoh një cilësi të mirë te ndonjë person, dëshiroj ta kem atë, por nëse nuk mund të bëjë punë të mira, së paku mos ta nënçmojë dhe mos të tallem me punën e mirë, sepse ajo punë e mirë e tjetrit do të më sjell dobi dhe të mira edhe mua. Qëllimi kryesor është që të lë punë të mira dhe përshtypje të mirë te të gjithë njerëzit.

AGJËRIMI I TËRË VITIT

Pyetje: prej vegjëlisë më mjafton vetëm pak ushqim dhe nuk ma ka ëndja ushqimin. Kjo është ajo që mund të agjëroj me lehtësi. A lejohet të agjërosh gjatë gjithë jetës dhe a është e vërtetuar prej të parëve tanë të mirë se kanë agjëruar gjatë tërë jetës?

Përgjigjja: Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. :O i dërguar i Allahut, si është puna me atë, i cili e agjëron tërë vitin?

Ka thënë: Nuk ka agjërim dhe mosagjërim, apo ka thënë "as nuk ka agjëruar, as nuk ka ngrënë"; ka thënë: Po të agjërosh dy ditë e të hash një ditë.? Është përgjigjur: Po. A mundet dikush ashtu? Ka thënë: Si është puna me atë, i cili agjëron një ditë, e nuk agjëron dy të tjera? Është përgjigjur: Do të kisha dashur, po të kisha mundur ashtu.

Pastaj, i dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: ***Tri ditë, çdo muaj, dhe prej ramazanit në ramazan, kjo është sikur ta agjërosh tërë vitin. Nëse agjërohet dita e arafatit, bëhet falja e gabimeve të vitit të kaluar dhe e vitit paraprak, agjërimi i ditës "ASHURA" i fshin mëkatet e vitit paraprak. AHMEDI***

RUBIKONI I KURBANIT

Cili është sekreti i imanit në therjen e kurbanit?

Zejd ibn Erkami e ka pyetur të dërguarin e Allahut s.a.v.s : Ç'është kurbani? ***Është përgjigjur: Sunet, vepër e babait tuaj, Ibrahimit salallahu alejhi ve selem. E ka pyetur pastaj:*** Po çfarë shpërblimi kam prej tij?

Është përgjigjur: ***Për çdo qime është një e mirë.***

E kanë pyetur: O i dërguari i Allahut, a qime të leshit ? Është përgjigjur: ***Për çdo qime të leshit është një e mirë. (AHMEDI)***

EDHE NËSE ËSHTË E PAKTË

Kur Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: ***Kush ia merr të drejtën besimtarit me përbetim të rrejshëm, Allahu ia ndalon atij xhenetin dhe e shpie në zjarr.***

E kanë pyetur: Qoftë edhe diçka e imët dhe e lehtë? Ka thënë : ***Qoftë edhe një krënde misvaku.***

NJË SHKURORËZIM

Një njeri e ka shkurorëzuar gruan e tij tri herë me një fjalë në një vend, në prezencën e dëshmitarëve. A konsiderohet një shkurorëzim apo tre shkurorëzime?

Përgjigjja: Ne edhe më herët jemi përgjigjur se kjo konsiderohet një shkurorëzim, sepse kur është pyetur i dërguari i Allahut s.a.v.s. për burrin, i cili e ka shkurorëzuar gruan e tij tri herë, përnjëherë është ngritur, i hidhëruar, dhe pastaj ka thënë: Edhe duke qenë në mesin tuaj, ai po luan me Allahun? Deri sa një njeri është ngritur dhe ka thënë :O i dërguari i Allahut: A ta dënojmë me vdekje?

CILA ËSHTË E DREJTA E SECILIT PREJ KËTYRE

Pyetje: Nëse vdes babai, duke lënë pas vetes vajzën e djalit ,*vajzën* dhe motrën, si ndahet trashëgimia në mes tyre?

Përgjigjja: Është pyetur Ebu Musa el Eshariju për vajzën, vajzën e djalit dhe motrën. Është përgjigjur: Vajzës i takon një e dyta, ashtu edhe motrës një e dyta tjetër. Ja, po vjen Ibn Mes'udi dhe ai do të pajtohet me mendimin tim. Është pyetur Ibn Mes'udi dhe i kanë treguar se si është përgjigjur Ebu Musa, e ai ka thënë: Ka lajthitur, e po të pajtohesha, edhe unë do të isha në humbje. Gjyko ashtu siç ka gjykuar pejgamberi s.a.v.s: vajzës një e dyta, vajzës së djalit një e gjashta, për t'u plotësuar dy të tretat, dhe çka mbetet motrës.(BUHARIU)

A PËRGJIGJET SHPIRTI NË VARR?

Kur të pyetet njeriu në varr, i kthehet shpirti, me fjalë të tjera, si do të bëhet gjykimi në varr?

Përgjigjja: E ka regjistruar Ahmedi se pejgamberit s.a.v.s. këtë pyetje ia ka parashtruar Omeri r.a.: "Në momentin e gjykimit në varr a na kthehet mendja"?

Është përgjigjur: **Po, ashtu si e kemi (shpirtin dhe mendjen) sot.**

ENA E TIGANISUR NË TË CILËN ËSHTË TTIGANISUR MISHI I DERRIT

Një profesor i universitetit thotë: gjatë shkuarjes me një delegacion në Evropë, ka banuar në një shtëpi, në të cilën kanë përdorur mishin e derrit dhe kanë pirë alkool, mirëpo enët dhe gotat pastaj i pastronin. Pyetja është: A e kam të lejuar apo të ndaluar t'i përdori enët dhe të njëjtat gota?

Përgjigjja: Ebu Thealebete el Hushmiju r.a. e ka pyetur pejgamberin s.a.v.s: O i dërguari i Allahut, ne jetojmë në vend të pasuesve të librit, e ato hanë mish derri dhe pinë alkool. Si të veprojmë me enët e tyre, t'i përdorim, apo jo?

Muhamedi s.a.v.s i thotë: ***Nëse nuk gjeni enë të tjera, pos tyre, atëherë enët e tyre i pastroni, tiganisni në to, po ashtu edhe gotat pastroni dhe pini në to.***

Pastaj tregon: I kam thënë: O i dërguar i Allahut, po çka na lejohet dhe çka na ndalohet? Është përgjigjur: ***Mos hani mishin e gomarit dhe ju është e ndaluar çdo kafshë shqyese (me kthetra) mishngrënëse.***

Në hadithin Sahihë të Muslimit nga Ebu Hurejrete r.a. është vërtetuar se Muhamedi s.a.v.s ka thënë: ***Mishi i çdo kafshe mishngrënëse shqyese me kthetra është e ndaluar.***

UTHULLA PREJ ALKOOLIT

Disa njerëz alkoolin e shndërrojnë dhe e përdorin në uthull. Si është puna me ta? A është e ndaluar apo jo, duke pasur parasysh se qëllimi është i mirë?

Përgjigjja: Është pyetur i dërguari i Allahut për shndërrimin e alkoolit në uthull. E, ai është përgjigjur: Jo nuk lejohet. (MUSLIMI)

Disa njerëz e kanë pyetur të dërguarin e Allahut s.a.v.s: Ne e shtrydhim lëngun,e lëngun e shtrydhur të fermentizuar e përdorim për drekë e darkë për pije (në një transmetim tjetër për ushqim). E, Muhamedi s.a.v.s. u ka thënë: ***"Pini, por largohuni nga çdo lëng dehës"***. Pastaj, ia kanë përsëritur pyetjen, e Muhamedi s.a.v.s. prapë u ka thënë: ***"Allahu ua ka ndaluar edhe të paktën, nëse e shumta e saj deh". (DARUKUTNIJU)***

FALLTARËT

Ç'thua për njerëzit e thjeshtë dhe injorantë, të cilët shkojnë për shërim apo për të ditur të fshehtën (fatin e tyre) te falltarët dhe dexhallët?

Për shkuarjen te falltarët, Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: ***Kurrë mos shkoni te ata***. Është pyetur i dërguari i Allahut s.a.v.s për falltarët, e ai është përgjigjur: ***Nuk ka asgjë prej tyre***. Njëri që ishte prezent, i thotë: Po ata ndonjëherë po ia qëllojnë dhe po e dinë, e Muhamedi s.a.v.s i thotë: ***Ajo është e vërtetë, të cilën Xhini Karijn ia tregon falltarit, e pastaj ia përzien njëqind rrena të tjera. (MUTEFIKUN ALEJHI)***

SHARJA E PRINDËRVE

Dëgjojmë për sharjen e prindërve nga djemtë e tyre. Çka nënkuptohet me këtë dhe se mosrespektimi i prindërve a është mëkat i madh?

Përgjigjja: I nderuari ynë, i dërguari i Allahut s.a.v.s., ka thënë: ***"Prej mëkateve të mëdha është kur njeriu i shan prindërit e vet.***

Është pyetur: Po si i shan njeriu prindërit e vet?

Është përgjigjur: I shan babain dhe nënën e tjetrit, e ai ia kthen duke ia sharë babain dhe nënën e këtij."(MUTEFIKUN ALEJHI)

Transmetohet nga Imam Ahmedi se Muhamdei s.a.v.s ka thënë: ***Prej mëkateve më të mëdha është mosrespektimi i prindërve.***

Është pyetur: Po çka është (si bëhet, si shkaktohet) mosrespektimi i prindërve? ***Është përgjigjur: Njeriu shan nënën e babain e tjetrit, e ai ia shan babain e nënën këtij.***

NDËRPRERJA E LIDHJEVE FAREFISNORE

Kam farefis, i cili nuk i përmbahet besatimeve e premtimeve. Ata nuk i lidhin marrëdhëniet farefisnore, janë kriminelë dhe i ndërprejnë me mua të gjitha lidhjet; u bëj mirë, e ata ma kthejnë me të keq. A duhet t'i përforcoj lidhjet?

Përgjigjja: Një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s., u bëj mirë ma kthejnë me të keq, sillem me butësi, e ata më injorojnë. E Muhamedi s.a.v.s. i ka thënë: Nëse është e vërtetë ajo që thua, ti je duke u hedhur zjarr të nxehtë dhe derisa të vazhdosh ashtu, Allahu do të të ndihmojë. I dërguari i Allahut s.a.v.s ka thënë: Jo, nëse të gjithë janë ashtu, por shiko më të vlefshmit dhe me ta përforcoji marrëdhëniet, sepse derisa të jesh në atë pozitë, Allahu do të jetë me ty dhe do të të ndihmojë.

ISRAJA DHE MIËRAXHI

Pyetje: Pse Israja është treguar me tekst të qartë, ndërsa Miraxhi me argument jo të drejtpërdrejtë?

Përgjigjja: Shejh Shaëraviju përgjigjet: Kur Kur'ani e ka treguar ngjarjen e Miraxhit, e ka treguar qartë, mirëpo Miraxhin nuk e ka treguar ashtu, sepse nuk ka thënë: Lavdërimi i qoftë Allahut, i cili e ka ngritur atë prej mesxhidi Aksas e deri në Siretul Munteha, mirëpo, na ka treguar gjëra për ngritjen, e nuk ka treguar në suretul Isra me argument të qartë për Sidretul Munteha.

Pastaj, Shejh Shaëraviju vazhdon e thotë: Kjo është mëshirë e Allahut për krijesat e tij. Për çështjet praktike, të cilat ka mundur t'u tregojë i dërguari i Allahut s.a.v.s. banorëve të tokës, i ka treguar me argument të qartë, që të mos ketë vështirësi gjatë transmetimit. Mirëpo, në çështjet që mendja kërkon analizë më të thellë, e ka lënë në bazë të Imanit tënd të fortë, apo varësisht prej parapërgatitjes tënde, prej rezultateve tjera.

Të gjitha mrekullitë, me të cilat i ka stolisur Allahu pejgamberët tjerë, të gjitha kanë qenë jashtë ligjeve të zakonshme; e pse mos të ketë mrekulli të

tillë edhe i dërguari i Allahut s.a.v.s. Pasi që Allahu është Ai, i Cili vendos dhe i ndryshon ato ligje, atëherë ai që beson ngjarjen e të dërguarit të Allahut s.a.v.s se për një kohë të shkurtër të natës është bartur prej Mekes në Mesxhidi Aksa, e që është mrekulli praktike, duhet të besojë për Miraxhin, i cili nuk është mrekulli praktike, sepse ai, i cili të beson ty pasi që të njeh se je besnik, të beson edhe për gjërat tjera që ai nuk i di.

Pyetje: Cili është dallimi në mes të atij, i cili nuk e beson ngjarjen e Isras, dhe atij, i cili beson ngjarjen e Miraxhit?

Përgjigjja: Ai i cili e mohon Isranë është pabesimtar, sepse ai bie ndesh me argument të qartë. Ndërsa, ai i cili e mohon Miraxhin, nuk është pabesimtar, por mëkatar i madh, sepse Israja është treguar me argument të qartë, kurse Miraxhi më argument që kërkon të besohet.

Pyetje: Cila është ndërlidhja në mes të Isras, që është udhëtim tokësor-horizontal dhe Miraxhit, që është udhëtim qiellor-vertikal?

Përgjigjja: Pasi që Allahu i Lartmadhëruar për Muhamedin s.a.v.s e ka thyer ligjin kohor në Isra, e cila është ngjarje tokësore, i ka dhënë të dërguarit tonë pejgamberit s.a.v.s argumente praktike (lëndore), pra që besimi ynë të jetë në suazat e gjërave tona, të cilat i dimë, e atë mrekulli pastaj e bën mjet për të besuar dhe vërtetues se Ai, i cili e ka thyer ligjin kohor, me gjatësi tokësore, në çështjet, të cilat i dimë, ka mundësi të thyejë ligjin vertikal (ngritjen në qiell) në çështjet, të cilat nuk dimë. Pra, mund të themi se Israja është parapërgatitje e logjikës njerëzore për ta besuar dhe për ta vërtetuar lajmin e Miraxhit të pejgamberit s.a.v.s.

Pyetje: Cili është argumenti se Israja ka qenë edhe me trup edhe me shpirt?

Përgjigjja: Argument është fjala e Zotit të Lartmadhëruar. I lavdëruar është Ai, i cili e ka bartur robin e tij për një kohë shumë të shkurtë të natës. Pse fjalët “robin e tij” nënkuptojnë njeriun edhe me trup edhe me shpirt, pra që të dyja në të njëjtën kohë. Dhe tjetra është se, po të kishte qenë Israja dhe Miraxhi vetëm me shpirt apo të kishte qenë vetëm ëndërr, nuk do kishte pasur

nevojë ta kontestojë askush se a është e vërtetë apo dispozitë. Dhe pabesimtarët Kurejsh nuk kanë pasur nevojë të marrin qëndrim negativ e të pyesin: "Ti po thua se ke kaluar distancë për një kohë shumë të shkurtër të natës, ndërsa ne atë distancë e kalojmë për një muaj". Mirëpo, vetë pyetja e tyre konfirmon që ata e kanë kuptuar se nuk ka qenë në pyetje as ëndërr e as udhëtim i vetëm me shpirt, por ka qenë zgjuar edhe me trup, edhe me shpirt. Po të kishte qenë e kundërta, nuk do të kishte pasur nevojë për kundërshtim, sepse ligji i ëndrrës është superior ndaj ligjit zgjuar.

Pyetje: Cili është dallimi në mes të "ëndrrës" dhe të "pamit"?

Përgjigjja: Fjalët "ëndërr kam parë" vijnë në *infitiv* vetëm kur të jetë ëndërr iluzioni "kam parë ëndërr", sepse, sa i përket shikimit me sy, thuhet "duke shikuar, kam parë". Ndërsa nëse e shikon në gjumë, thua "kam parë ëndërr".

Në poemën e rij Rai Nemiri thotë:

"Ëndërr shikon gjërat e mëdha që të habitet mendja.

Përgëzoje veten, e cila më parë ka qenë e përgënjeshtruar."

Fjalët "shikim duke parë" e ka përdorur shikimin me sy dhe shikimin në gjumë.

Mirëpo, zakonisht "shikimi në ëndërr" e përdorin për shikimin e gjërave mahnitëse, të cilat nuk mund të shihen në ëndërr.

ISRAJA DHE MIËRAXHI

Si të jetë ëndrra fitne për njerëzit? A është ky argument se israja ka qenë ëndërr?

Përgjigjja: Kjo patjetër duhet të interpretohet si shikim praktik. Pra, nuk është kurrfarë pengese, që i dërguari i Allahut s.a.v.s. ta ketë parë ISRANË (udhëtim natën) në ëndërr, e pastaj ta kishte bërë atë udhëtim zgjuar në praktikë (realitet), ashtu siç e tregon Zoti i Lartmadhëruar në disa sure të tjera.

Zoti i Lartmadhëruar ia ka bërë ëndrrën realitet të dërguarit të tij dhe ju me siguri do të hyni ne Meshidul Haram. Pra, e ka parë në ëndërr, e pastaj

ëndrra i është bërë realitet. Çfarë pengese ka këtu, nëse Zoti i Lartmadhëruar ia ka vulosur në shpirt atij që, në rend të parë, t'i shohë në ëndërr ato ngjarje, e ato ngjarje pastaj janë bërë realitet, siç është hyrja në Mesxhid Haram, shkurtimi i flokëve, qethja e shokëve në haxh dhe të gjitha i ka parë zgjuar? Pra, kurrfarë pengese nuk ka që i dërguari i Allahut s.a.v.s. në rend të parë, Isranë e ka parë në ëndërr, e pastaj ajo ëndërr, të cilën e ka parë me shpirt, është bërë realitet.

Pyetje: A ka ardhur në "ETHER" se i dërguari i Allahut s.a.v.s. ka parë ëndrra, e pastaj janë bërë realitet?

Përgjigjja: Po, Ajsha r.a. thotë: "Çdo ëndërr që e ka parë i dërguari i Allahut s.a.v.s., të nesërmen në mëngjes i është bërë realitet, sikurse qartësia e sabahut pas natës." Pra, nëse ka parë ëndërr, ajo është realitet.

Pyetje: Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **"Pa të meta është Lartëmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (prej Qabes) gjer në Mesxhidi Aksa (Bejti Mukaddes), rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëmë këtë udhëtim) për t'ia treguar atij disa nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është dëgjuesi (i fjalëve të Muhamedit), pamësi (i punëve të Muhammedit). (Isra, 1).**
Pse në fund të ajetit nuk është "Allahu ka mundësi për çdo send"

Përgjigjja: Këtu shkaku është i qartë pse është bërë "ISRAJA" e të dërguarit të Allahut s.a.v.s për shkak se pabesimtarët e kanë ofenduar të dërguarin e Allahut s.a.v.s. E ato ofendime i ka dëgjuar. Po ashtu, ka parë çka i ka ndodhur Muhamedit s.a.v.s.: lodhja, mundimet, se si e kanë nënçmuar. Të gjitha këto Allahu edhe i ka parë, edhe i ka dëgjuar. E, kur Allahu i ka parë e i ka dëgjuar, atëherë ka dashur që Muhamedi s.a.v.s. t'ia mundësojë që të shohë ajetet e mëdha dhe ia ka mundësuar ISRANË.

SHAËRAVIJU DHE LËMIA MEKANIKE

Për ngjarjen e ISRASË Shejh Shaëraviju thotë: Sa më shumë që të shtohet shpejtësia (forca), zvogëlohet distanca. Pra, distanca dhe shpejtësia janë refleksive, varësisht prej njëra-tjetrës.

Forca (shpejtësia) ka qenë forca (shpejtësia) e Allahut, e cila nuk ka kohë. Këtu Shejh Shaëraviju na paraqet ligjin (parimin) e rëndësishëm të mekanikës, i cili thotë: Distanca është e barabartë me shpejtësinë e kohës.

Pasi që distanca është e palëvizshme, atëherë sa më shumë që të rritet shpejtësia aq më shumë zvogëlohet koha për atë distancë. Kështu që koha për Allahun është e barabartë me zero. Subhanellah

LOGJIKA (METODOLOGJIA) E THIRRJES NË BESIM

Pyetje: Cila është logjika e thirrjes në Islam? Çfarë dialogu parasheh Islami? Cila është zemërgjerësia fetare dhe mostoleranca fetare? Dhe, ç'është ajo e cila bën që të gjithë të jetojnë nën një hije, pra edhe fetë tjera?

Përgjigjja: Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë: Islami ka metodologji të mirë edukative dhe madhështore. Logjika e besimit është mëshira, fortësia e tij, është Imani, i cili manifestohet në atë se drejtësia është parim dhe nuk ka mbizotërim të njeriut ndaj njeriut. Mirëpo, thirrja në besim duhet të bëhet me edukatën e të dërguarit të Allahut s.a.v.s., varësisht nga aftësia e të kuptuarit dhe e rrethanave, në të cilat gjendet ai, i cili thërret në besim.

Thirrësi Islam nuk duhet që, në vend se t'i thërrasë njerëzit, t'i largojë, ashtu siç e kanë bërë zakon me metodologji të urrejtjes ndaj të tjerëve, sepse njeriu thirret në udhëzim.

Dihet se thirrja me gjuhën e urrejtjes u shkakton njerëzve dy vështirësi. Vështërsia e parë: Largimi i njerëzve edhe më shumë dhe dëbimi sa më larg në atë çka e kanë bërë traditë. Vështirësia e dytë: Mbylljen e rrugës, e cila i shpie ata në diçka të re, në edukatë të keqe dhe moskëshillimi me urtësi, të cilët ndoshta në ndonjë moment ishin drejtuar në rrugë të vërtetë. Për këtë arsye një beduin, në të kaluarën, ka thënë: Këshilla është aq e rëndë, sa që nuk mund ta bartë as mali (kodra). Mos ia dërgo kodrën ta bartë, sepse e

vështirëson polemikën edhe më shumë, por merre këshillën me sqarim të lehtë.

Nëse e parashtrojmë pyetjen: Pse këshilla është aq e rëndë ?

Përgjigjja: Sepse këshilla e nxjerr të këshilluarin prej asaj që ai e ka dashur shumë më herët. Pra, kjo është se këshilla është e rëndë.

I këshilluari dëshiron që t'ia zbukurosh çështjet, që ia ka ënda dhe që ia do epshi, e i këshilluari nuk dëshiron të mendojë për përmirësimin e gjendjes së tij. Për këtë arsye e shohim ilustrimin madhështor, të cilin e përdor Kur'ani, kur i dërguari, i edukuar me edukatën e Zotit të tij, u thotë kundërshtarëve të tij: **"Thuaj: Ju nuk do të pyeteni për krimet e tona, e ne nuk do të pyetemi për punët tuaja".**

Muhamedi s.a.v.s. u thotë kundërshtarëve të tij se çdo njeri përgjigjet për veprën e tij. E, ju besimtarë, pra e ka quajtur krimin për veten e tij dhe për besimtarët, sepse kundërshtarët në fillim imanin e kanë quajtur krim.

Mirëpo, i dërguari i Allahut s.a.v.s sjelljen e kundërshtarëve nuk e ka quajtur ashtu, por me fjalë të Allahut u ka thënë: Ne nuk përgjigjemi për veprat tuaja.

Nëse bëjmë një analizë, i dërguari i Allahut s.a.v.s. ka qenë dashur të thotë: Dhe ne nuk pyetemi për krimet tuaja, mirëpo e ka thënë të kundërtën "çka punoni". Pra, Allahu ia ka mësuar të dërguarit të tij metodën e dialogut dhe të diskutimit.

Kjo është edukata e dialogut, kjo është pasqyra e diskutimit, por duhet të dimë se epshin njerëzor duhet ta ngrisim lart dhe të diskutojmë më logjikën e së vërtetës qiellore në qiell.

Kështu duhet të jetë i përgatitur thirrësi islam?

Kështu duhet t'i presim të gjithë kundërshtarët e islamit; duhet patjetër që kundërshtarët e kësaj feje të shijojnë dhe të jetojnë në mëshirën e kësaj feje.

Pyetje: Nëse kundërshtarët e shfrytëzojnë, e keqpërdorin tolerancën dhe ngriten kundër tij për ta sunduar, si duhet vepruar?

Përgjigjja: Nëse ata mendojnë dhe veprojnë ashtu, atëherë Islami kërkon prej besimtarëve të mbrohen me çdo kusht kundër tyre, që nga fillimi e deri sa fjala e Allahut të jetë më e larta, ngaqë është e qartë se nëse në një

vend sulmohen të drejtët prej të këqijve dhe kriminelëve, Allahu i ka mësuar njerëzimit si duhet vepruar.

Pyetje: Si do të kishte qenë jeta nëse e keqja dhe e padrejta mbizotërojnë dhe udhëheqin?

Përgjigjja: Nuk ka dyshim se jeta do të ishte e keqe, nëse atë e udhëheq e keqja. Sundimi i ligjit dhe i drejtësisë është sundim i programit të Allahut.

Ne e mësojmë dhe e kuptojmë të drejtën nga e padrejta, atëherë kur bëhet krahasimi në mes tyre, e Allahu na ka mësuar që këtë ta bëjmë me gjuhën e dialogut.

Allahu na ka mësuar se e vërteta arrihet me fuqinë e së drejtës dhe të argumenteve. Askush nuk i bën padrejtësi askujt me logjikën e drejtësisë dhe të vërtetës.

Pyetje: Si e ka udhëhequr Islami dhe si e ka larguar të keqen?

Përgjigjja: Nëse e shikojmë historinë Islame, do të shohim se Islami është zhvilluar në dy çështje:

E para: Të nxiturit e besimtarëve në përhapjen e kësaj feje, e cila i udhëzon njerëzit, e në këtë kanë pasur vullnet dhe kjo ka qenë forca e tyre.

E dyta: Kërkesa e qytetarëve apo e banorëve të sunduar prej kriminelëve, të cilët kanë kërkuar sundimtarë të drejtë t'u ndihmojnë. Kështu, ne shohim se të gjitha çlirimet e vendeve islame janë bërë në bazë të thirrjes së atyre vendeve të çliruara, ashtu që banorët e atyre vendeve kanë kërkuar që muslimanët të shkojnë te ata që t'i nxjerrin nga e keqja dhe torturimi që u bëhej atyre.

Për këtë arsye ne shohim shumicën e popujve, të cilët e kanë pranuar islamin, nuk e kanë pranuar për shkak të dhunës, me forcë ose me lufte, dhe si rezultat i kësaj del se në shumicën e vendeve, të cilat i kanë çliruar muslimanët, ka pasur edhe pjesëtarë të feve tjera.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **Dhe thuaj: E vërteta është nga Zoti i juaj, e kush do, le të besojë, e kush do, le të mohojë. Ne kemi përgatitur zjarr për mohuesit keqbërës, që do t'i përfshijë nga të gjithë anët. Nëse do të kërkojnë ndihmë, do t'u jepet një ujë si xehja e shkrirë që do t'ua**

përcëlloj fytyrat. Sa pije e tmerrshme është ajo, sa strehim i keq është ai (zjarri)!

ISLAMI EMËR, CILËSI DHE SIMBOL

Pyetje: Cili është dallimi i fjalës Islam si emër, cilësi dhe simbol dhe a është e vërtetë se secila ka kuptim në vete?

Përgjigjja: Nëse shohim fjalën Islam, vërejmë se është përdorur në kuptim të emrit, cilësisë dhe simbolit. Sendi kur të jetë cilësi, e ka kuptimin e cilësimit. Mirëpo sendi, kur të jetë i emëruar, atëherë merr kuptim edhe më të gjerë. P.sh. nëse ndonjëri prej nesh thotë: "A e ke parë hënën?", dëgjuesit menjëherë i shkon mendja te planeti hënë, i cili shndrit dhe ndriçon tokën gjatë natës, pasi ta marrë dritën prej diellit.

Mirëpo, nëse ndonjëri nga ne e quan vajzën e vet "hëna" a do të thotë se cilësitë e hënës gjenden të kjo vajzë?! Jo, sepse ajo mund të mos jetë e bukur, por prapëseprapë babai i saj e quan "hënë"; saktësisht, sikurse një njeri që është fatkeq dhe i keq, përkundër asaj se prindi i tij e ka emëruar me emrin e mirë fatlum.

Mirëpo, fjala "ISLAM" është emër, cilësi dhe simbol në të njëjtën peshë. Po pse? Sepse njeriu nuk mund të jetë i sigurt apo i qetë prej atij, i cili është më i fuqishëm se ai, as prej atij, i cili është i barabartë. Ku është dallimi në mes të cilësisë dhe gjendjes (ndajfoljes së gjendjes). Cilësia është e pandryshueshme, ndërsa gjendja e ndryshueshme. Fjalia pas trajtës së shquar është ndajfolje e gjendjes, ndërsa pas trajtës së pashquar është cilësi.

P.sh. ka dallim të madh në mes të thënies "është bërë i tij, i djegur plotësisht". Fjalia e parë "i djegur plotësisht" është fjali emërore, në rasën emërore dhe gjendja e automjetit është ndryshuar. Ndërsa, fjalia e dytë: "është i djegur" është fjali emërore në rasën emërore, cilësi, e cilësia është e pandryshuar, ndërsa ndajfolja e gjendjes, e ndryshuar.

FUQIA E TË DOBËTVE NË DASHURI

Pyetje: Ku është fuqia e dashurisë së të dobëtve? Cili është rezultati i kësaj dashurie në fitoren e Islamit dhe ngritjen e flamurit të Tij?

Përgjigjja: Ne e dimë se çfarë vështirësish ka përjetuar i dërguari i Allahut s.a.v.s. në fillim të jetës së tij, i cili nuk ka pasur mundësi të mbrojë shokët e tij. Ndoshta ky ka qenë simboli se Allahu ka dëshiruar që atij t'i bashkëngjiten vetëm ata që kanë fuqinë e dashurisë. Këtë fuqi të dashurisë, të cilën e kanë poseduar të dobëtit, ka qenë fuqi e pathyeshme para Kurejshitëve, të cilët nuk kanë pasur mundësi ta ngrejnë kryet lart. Kjo është fuqia e dashurisë së të dobëtve, e cila fuqi nuk mposhtet kurrë, edhe pse Kurejshitët e kanë pasur në dorë tregtinë dhe ekonominë, udhëtimin e tyre dimër e verë.

Allahu i Lartmadhëruar ka dëshiruar që të dërguarin e tij ta ushtrojë dhe ta sprovojë. Për këtë arsye, në fillim të shpalljes, nuk ka fituar kundër kurejshitëve, sepse po të kishte fituar që në fillim, njerëzit do të thoshin: Kurejshitët janë fisi i tij, ata gjithmonë kanë qenë në pushtet dhe e kanë bërë një lidership të tyrin, që ta udhëheqë botën. Po të kishte ndodhur kjo, atëherë islami, i cili ka arritur tek ne, do të kishte qenë një fe e njoftësive dhe do të ishte përhapur me njoftësi të fisit të Muhamedit s.a.v.s. Mirëpo, Allahu ka dashur që kurejshitët të jenë kundër Muhamedit s.a.v.s dhe, që nga lindja, Muhamedi s.a.v.s të jetë i dobët, i dobët në mesin e qendrës së zhvillimit ekonomik, por i fuqishëm në Iman dhe bindje për të arritur qëllimin.

Kështu, ëmbëlsira e Imanit, e cila ka ardhur prej Muhamedit s.a.v.s, është bërë njoftësia dhe familja e Muhamedit s.a.v.s.

Po të kishte dashur Allahu që Muhamedi s.a.v.s ta kishte forcën e mbizotërimit dhe të sundimit, nuk do të kishte pasur forcë që ta pengonte, mirëpo Allahu ka dashur që robi i Tij t'i nënshtrohet me vullnet dhe dëshirë, edhe atëherë kur ka pasur mundësi të refuzojë.

Allahu dëshiron imanin e paimponuar e të vullnetshëm dhe që robi i Tij ta pranojë me zemër, t'i përulet dhe t'i nënshtrohet Allahut, t'i përmbahet planprogramit të Tij, edhe atëherë kur ka mundësi të mos besojë.

CILËSITË E HYRIVE TË XHENETIT

Pyetje: Cilat janë tiparet e hyrive të xhenetit?

Përgjigjja: Hyri: e bardhë, sytë e mëdhenj, flokëshndritëse, sikurse krahët e petritit.

Pyetje: Çfarë kuptimi ka ajeti: "Të ngjashëm me margaritarët e ruajtur"?

Përgjigjja: Shkëlqimi si shkëlqim i mëndafshit, të cilin nuk e ka prekur dorë e njeriut.

Pyetje: Çfarë kuptimi ka ajeti: "Në ta ka të mira të shumta"?

Përgjigjja: Pamje të bukur dhe edukatë të mirë.

Pyetje: Çfarë kuptimi ka ajeti: "Sikurse të ishin vezë të ruajtura"?

Përgjigjja: Butësia e tyre është si butësia e nënlëvozhgës së vezës.

Pyetje: Çfarë kuptimi ka ajeti: "Të dashura (për bashkëshorte të tyre)"?

Përgjigjja: Janë ata, të cilat në këtë botë kanë vdekur në moshë të vjetër, mirëpo Allahu, pas pleqërisë së tyre, i ka shndërruar në virgjëresha, *uruben*, do të thotë: simpatike dhe të dashura, ndërsa etraba-do të thotë: të gjitha janë të një moshe.

KUR'ANI BAR DHE SHËRIM I SHOQËRIVE

Pyetje: Zoti i Lartmadhëruar thotë: Dhe shëron zemrat e popullit besimtar. Po ashtu, Zoti i Lartmadhëruar thotë: Dhe Ne zbresim nga Kur'ani atë çka është bërë shërim dhe mëshirë për besimtarët.

E pyesim Imamin e nderuar: Si i ka mënjanuar dhe si i ka shëruar Kur'ani sëmundjet njerëzore, si dhe shkatërrimin e shoqërive nëpërmjet të programit të tij të drejtë, të fortë dhe stabil?

Përgjigjja: Imami i nderuar thotë: ti në shumicën e rasteve e kundërshton programin e Allahut, sepse ai të përkufizon lirinë e aktivitetit në jetë, për të cilin ti mendon me mendjen tënde, se po të kishe vepruar sipas epshit tënd, do të zbaviteshe dhe tërë bota do të shkatërrohej. Programi Islam është i shpallur prej Zotit të Lartmadhëruar. Ai është Allahu, i cili e ruan Kur'anin, mrekullinë e njerëzimit. E, programi i tij është mrekulli e njerëzimit, sepse njeriu nuk ka dorë e kompetencë mbi të. Ai është fjalë e Allahut, e mbrojtur dhe e siguruar prej Allahut deri në ditën e Kiametit. Mrekullia në të qëndron se i jep njohuri çdo gjenerate edhe çdo gjeneratë ndryshon prej gjeneratës së mëparshme. Mrekullia në të qëndron se është i përshtatshëm dhe harmonik për çdo kohë, për çdo vend. Mrekullia në të qëndron edhe në atë se shëron sëmundjet e shoqërive kudo qofshin, sepse është fjala e Allahut, e cila në vete përmban barin (ilaçin) për çdo sëmundje. E, kjo do të thotë se vetëm të folurit e kësaj fjale (të Allahut) na sqaron se është mrekulli madhështore e Kur'anit fisnik.

Shpalljet kanë zbritur për të shëruar sëmundjet e shoqërisë dhe çdo shpallje, e cila ka zbritur te një popull, ka zbritur për t'i shëruar sëmundjet apo për t'i mënjanuar degjenerimet, të cilat ndodhin në atë shoqëri.

HARRESA, SËMUNDJE E NJERIUT

Pyetje: Në faza të ndryshme të jetës një prej fatkeqësive të njeriut është harresa. Pse është harresa fatkeqësi e krijesave dhe sëmundje, e cila përcillet gjeneratë pas gjenerate, dhe a përgjigjet njeriu për shkak të harresës së tij?

Përgjigjja: Harresa është sëmundje e pashërueshme (e pashmangshme) e njeriut dhe ndryshimi i programit ekziston prej kohërave të lashta, sepse njeriu largohet prej shumë çështjeve të programit të Allahut për shkak të harresës. Nëse fëmija yt është i sëmurë, ti mundohesh sa më shpejt ta dërgosh të mjeku për shërim. Nëse e sheh se mjeku i parë nuk mund ta shërojë, hulumton tjetrin. Kështu, ti vrapon prej mjekut në mjek që ta shërosh fëmijën tënd sa më shpejt. Mirëpo, nëse fëmija yt e lë namazin, ti nuk përkujdesesh fare (ta shërosh), sepse ti interesohesh për së tepërmi që fëmijës t'i sigurosh ardhmëri vetëm të kësaj bote, e nuk interesohesh t'i sigurosh ardhmëri në botën tjetër. Nga kjo themi se ti plotësisht ke harruar programin e Allahut.

MËKATI I NJERIUT DHE MËKATI I SHEJTANIT

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **Pasha Madhërinë Tënde (O Zot), do t'i përvetësoj dhe do t'i mashtroj që të gjithë, përpos atyre që prej mesit të tyre janë robër të sinqertë (ndaj teje) Po ashtu, ka thënë: Dhe ka kundërshtuar Ademi Zotin e Tij, ka rrëshqitur në mëkat dhe devijoi (nga rruga e drejtë). Pastaj, Zoti i Tij e zgjodhi atë, ia pranoi pendimin dhe e udhëzoi.**

Po ashtu, ka thënë: **Dhe Ademi mësoi fjalët se si të kërkonte falje prej Zotit të tij (dhe u pendua), ashtu që Ai ia pranoi pendimin.** Parashtrohet pyetja: Pse Zoti i Lartmadhëruar ia ka pranuar pendimin Ademit, ndërsa Iblisin e ka mallkuar dhe e ka dëbuar nga mëshira e Vet deri në ditën e kiametit?

Përgjigjja: Mëkati i shejtanit ndryshon nga mëkati i njeriut. Shejtani ka bërë mëkat ndaj Allahut, kur ka refuzuar t'i bjerë në sexhde Ademit; pra, ky ka qenë veprim i tij, ka qenë mëkat.

Ndërsa, Ademi ka bërë mëkat ndaj Allahut, kur ka ngrënë frytet e pemës. Ky veprim ka qenë mëkat. Mirëpo, që të dyja mëkatet kanë dallim të madh nga njëri-tjetri. Kur shejtani ka kundërshtuar, është treguar kryelart dhe arrogant ndaj Zotit të Lartmadhëruar dhe ka insistuar në mëkatin e tij, duke thënë: "Do t'i devijoj ata në tërësi". Ai ka sfiduar dhe ka vazhduar të sfidojë pandërprerë; ai ka refuzuar të pranojë se ka bërë mëkat, pra ka thyer prapë urdhrin e Zotit të Lartmadhëruar. Ndërsa, sa i përket Ademit a.s., kur ka gabuar, e ka pranuar gabimin e tij, është penduar dhe nuk ka insistuar në atë që ka bërë, por ka thënë: "O Zoti im, unë jam njeri i dobët, më ka mashtruar dhe më ka devijuar shejtani, ai më ka poshtëruar. O Zoti im, unë jam i vetëdijshëm se me të vërtetë Ti je në të drejtë, fjala jote është e drejtë, programi dhe rruga jote janë të drejta, por qenia ime është e dobët, nuk mundi t'i qëndrojë dhe gaboi. E ,Unë kthehem te Ti, O Zot i im, i penduar, i përkulur duke kërkuar falje". Pra, kjo ka qenë rruga e Ademit se ka pranuar Madhështinë e Allahut, e ka pranuar peshën e mëkatit të vet, është penduar dhe ka premtuar se nuk do të kthejë më në atë mëkat. Krejtësisht ndryshe nga kjo ka vepruar Iblisi. Ai nuk ka pranuar pendimin, por ka insistuar në mëkat dhe ka këmbëngulur se ai është në të drejtë, se ai nuk ka gabuar; ia ka kthyer urdhrin Allahut, vepron si do ai dhe se ai (Iblisi) ka të drejtë. Për këtë arsye e ka dëbuar Allahu nga mëshira e Tij. Por, Iblisi me çka është pajtuar me këtë dëbim? Është pajtuar me sfidimin e tij, kur ka thënë:

"Pasha Madhërinë Tënde (O Zot), do t'i devijoj dhe do t'i përvetësoj ata, që të gjithë". Mirëpo, edhe gjatë kundërshtimit, ai prapë e ka ditur se urdhri i Allahut do të ketë sukses. Për këtë arsye ka thënë: "Pasha Madhërinë (Fuqinë) Tënde. "E ka përdorur termin "Fuqinë", sepse Allahu është i pavarur për gjithçka nga gjithë bota. Iblisi, i mallkuari i Zotit, pra është përbetuar në pavarësinë e Allahut ndaj çdo gjëje, në panevojëshmërinë e Allahut ndaj krijesave dhe nuk ka hasur në diçka tjetër që t'u afrojë njerëzve, përpos fuqisë së Allahut, Krijuesit të tyre, i cili nuk ka nevojë për ta. Po të kishte dashur Allahu i Lartmadhëruar që krijesat t'i nënshtrohen vetëm Atij, të udhëzuar vetëm në rrugën e Tij, shejtani nuk do të kishte pasur mundësi kurrë t'iu afrohet krijesave të Allahut. Për këtë ka përdorur formën përjashtuese, kur ka thënë: "Përpos atyre (që në mesin e tyre) janë të sinqertë". Pra, atë që Allahu e do, e zgjedh që të jetë rob i sinqertë i tij. Iblisi te ai kurrë nuk mund të depërtojë.

SEXHDEJA DIKUJT TJETËR POS ALLAHUT

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **Dhe kur Ne u kemi thënë (i kemi urdhëruar) melaqeve të bien në sexhde Ademit, ata i ranë në sexhde, përpos Iblisit (i cili) refuzoi; refuzoi dhe ishte prej mohuesve.**

Pse t'i bëhet sexhde dikujt tjetër pos Allahut? Pse Iblisi të jetë pabesimtar? Pse nuk i ka rënë në sexhde Ademit, kur dihet se Ademi është krijesë e Allahut?

Përgjigjja: Shejhi Shaëraviju përgjigjet:

Për arsye se urdhri për sexhde Ademit ka ardhur prej Allahut të Lartmadhëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë te melaqet, e urdhri i Allahut është çështje obligative. Ai patjetër duhet të ekzekutohet, pa pyetur e pa diskutuar fare dhe pa analizuar. Urdhri ka qenë për melaqet, edhe për Iblisin për t'i rënë në sexhde Ademit, sepse ky urdhër ka qenë prej Allahut, i cili në të njëjtën kohë është Krijues edhe i melaqeve, por edhe i Ademit.

Urdhri prej Krijuesit është urdhër, i cili duhet të zbatohet dhe të realizohet. Iblisi ka mohuar, sepse ka kundërshtuar urdhrin e Krijuesit të tij, ka insistuar e ka këmbëngulur në mëkatin dhe kryeneçësinë e tij.

MUSLIMANI EMIGRANT (REFUGJAT)

Cilat janë obligimet e muslimanit emigrant në vend joislam, i cili ballafaqohet me kushte dhe rrethana të reja, dhe si duhet t'i tejkalojë vështirësitë, të cilat e rrethojnë për të u mos infektuar me sëmundjet e terenit të ri?

Përgjigjja: Ndonjëherë kushtet e jetës e detyrojnë njeriun që të kalojë në një vend tjetër, e pas një kohe të vijë aty në aso pozite ku njeriu nuk mund të shpëtojë veten kurrsesi nga dukuritë negative të atij vendi të ri, edhe nëse e harxhon tërë potencialin dhe tërë energjinë e tij.

P.sh. Prej tyre fëmijët e tij e mësojnë gjuhën e huaj dhe e harrojnë gjuhën e tyre arabe, pastaj harresa e fesë së tyre dhe mosnjohja e vlerave të islamit, e po ashtu edhe problemi kur të rriten vajzat. Ne mendojmë se nuk

ekziston asnjë domosdoshmëri në jetë, e cila e shtyn njeriun të shkojë në një vend të pasigurt për fenë e tij dhe fenë e fëmijëve të tij, posaçërisht, shkuarja në një ambient, i cili ua sjell në pikëpyetje fenë e tyre dhe ku ai është i vetmi shpëtimtar i tyre në ato vende, në ato kushte dhe në ato rrethana.

VEPRIMI PARALEL (I NDËRSJELLË)

Pse Islami ka lejuar që muslimani të martohet me pasuese të librit (krishtere, jehude), ndërsa nuk e lejon që muslimanja të martohet me pasues të librit. A nuk është veprim jo paralel apo joreciprocitet?

Përgjigjja: Mashkulli (burri), sipas natyrës së tij, në çdo shoqëri është mbizotërues dhe udhëheqës i familjes. E, nëse është musliman, ai vepron sipas ligjeve të fesë së tij; ai e do bashkëshorten e tij, e nderon dhe e respekton, e nëse nuk e do, së paku nuk i bën padrejtësi, sepse atë çka e ka emanet dhe emanetin, të cilin e ka marrë, e bën që jeta bashkëshortore në mes tyre të jetë e qetë dhe me respekt të ndërsjelltë. Përpos kësaj, burri i cili e ka marrë pasuesen e librit, e beson pejgamberin e saj, ndërsa ajo nuk beson në pejgamberin e tij dhe nga kjo rezulton që femra, e cila gjendet nën kurorën e burrit, i cili beson në pejgamberin e saj, është prioritare dhe më e mirë se femra, e cila gjendet nën kurorën e burrit, i cili nuk beson në pejgamberin e saj.

ARDHMËRIA E SUKSESSHME

Duke përdorur mjetet e mjekësisë bashkëkohore, si p.sh. preparatet e veçanta, preparatet e zërimit, mund të shihet (kuptohet) shtatzënia e hershme, pa i përdorur preparatet e rëndomta, të cilat konstatojnë embrionin e zhvilluar jonormalisht, p.sh. femra e pakrah, pa kokë apo pa një pjesë tjetër të trupit.

Pyetja është: A lejohet që mjeku të bëjë abortimin për të mëshiruar, për të siguruar shoqëri të ardhshme të shëndoshë, e jo me të meta?

Përgjigjja: Në lidhje me këtë çështje, i nderuari Shejh Shaëraviju thotë: Ai i cili tenton të rregullojë një mjet vet mjeti është i rregulluar edhe vet është ai i cili çka ka në dorë e shkatërron në vend se të rregullohet vetë. Mjeti nuk është në dorën e tij, ai ka për qëllim paaftësinë në të, që do të thotë: Ai i cili dëshiron të krijojë njeri të verbër, ai ka pasur dëshirë dhe qëllim që ashtu të krijohet, njësoj edhe i pakrahu, edhe i pakëmbi, ashtu ka dashur vet krijuesi i tyre. Kjo nga shkaku se në këto çështje Krijuesi dëshiron t'ua tërheqë vërejtjen të tjerëve!!!

Kam thënë edhe më parë se: Ti nuk e di vlerën e shikimit dhe të begative të tjera që Allahu t'i ka dhënë dhe përderisa nuk e sheh të verbrin, ti nuk e falënderon Allahun; apo, me fjalë të tjera, nuk kujton të mirën e Allahut për këmbët e tua, derisa nuk sheh njeri të çalë.

Ndoshta për këto çështje i ka krijuar Krijuesi. Ti thua se janë të zymta (jo të përkryera); është e vërtetë se janë të zymta, por është zymtësi e përkohshme, ndërsa tërësia është përsosmëri, ashtu që të gjithë njerëzit të përqendrohen dhe t'i kuptojnë të mirat e Allahut. Ndërkaq, çështja që ti thua se do të jetë me të meta, kjo mund të thuhet vetëm për çështjet të cilat i thua ti, p.sh. Nëse ti prodhon dritare, por dritarja nuk ishte e përforcuar, ti mund ta përforcosh, por sa i përket Allahut, Allahu është më i lartë se ti. Ai ashtu e ka krijuar, e ti mos thuaj: Kjo është me të meta. Mos shiko sipërfaqësisht dhe me mendjelehtësi. Ti nuk mund të dish urtësinë e krijimit të kësaj bote. Për ta sqaruar më mirë, themi: Njerëzit me aftësi të kufizuara janë shumicë apo pakicë? Natyrisht se ata janë pakicë!! Ata janë mjet i sqarimit të gjithësisë!! Parashtrohet pyetja: Pse? Për atë se Allahu dëshiron t'ia tërheqë vërejtjen njeriut për ato begati, e pastaj, prej mendjes së njeriut rezulton se ato janë çështje automatikisht të kategorizuara. Kjo do të thotë se mashkulli dhe femra i bashkojnë vezoret e mashkullorët e tyre dhe kështu merr fund. Ne themi: Jo.

Aty ka fuqi edhe më të lartë se kjo! Argument për këtë kemi se të gjitha elementet janë të gatshme, të njëjta, mirëpo më vonë shohim se një njeri është në këtë formë, e një tjetër në formë tjetër? Shkolla Gjermane e lashtë, e quajtur shkolla Xhibil dhe shkolla *Bahter* kanë thënë: Paaftësitë (njerëzit me aftësi të kufizuara) në gjithësi janë argument se nuk ka Zot, i cili paraqitet me urtësitë e tij, me përsosmëri të tij. Ndërsa shkolla bashkëkohore, e cila është trashëgimtare e shkollës së mëhershme thotë: Paaftësia në gjithësi është argument se ligjet janë ata, të cilët mbizotërojnë gjithësinë, se përndryshe edhe nga njëra anë, por edhe nga ana tjetër, ligjet në natyrë do të kishin qenë të çrregulluara dhe do t'kishte qenë gjithësia kaos.

E para: Çrregullimi (disharmonia) është argument i mohimit të Zotit. E dyta: Rregullsia (harmonia) është argument i mohimit të Zotit.

Që të dy shkollave u themi: Ju jeni të palogjikshëm. Nëse ka të meta, parregullsi, atëherë ky është argument se ka fuqi edhe më të madhe se ato ligje. Për këtë arsye, edhe ligjet mund të ndryshojnë. Ky argument veç është evident, ekziston, por është evident vetëm në disa njësi, pra është i pjesshëm. Nëse ka harmoni e rregullsi, po ashtu edhe harmonia, edhe rregullsia ekzistojnë, mirëpo ekzistojnë në çështjet kryesore. Nuk ka parregullsi dhe të meta ne thelb të çështjes, sepse parregullsia dhe disharmonia në thelb e shkatërron gjithësinë në tërësi. Për këtë arsye, ne nuk mund të shohim disharmoni në qiell, në tokë, në planete etj. Mirëpo, e meta ekziston në individ. Nëse një njësi apo individ ka të meta, njësia apo individi tjetër nuk ka të meta!! Për këtë arsye, themi: O ju, të cilët dëshironi të meta, paaftësi, ky është argument se ekziston një fuqi më e madhe se ato ligje. Kjo veç është evidente, mirëpo vetëm në njësi, pjesërisht. E, ju që dëshironi harmoni stabile, edhe kjo është evidente, mirëpo vetëm në çështjet e përgjithshme, i cili, po ashtu, është argument i urtësisë së Krijuesit. Përderisa një mendim shkon në drejtim të çrregullsisë dhe disharmonisë, ndërsa mendimi tjetër shkon në drejtim të rregullsisë dhe harmonisë, ne u themi se që të dyja janë evidente. Mirëpo, në vend se të ekzistojë disharmonia në ligjin e përgjithshëm, e që gjithësia të çrregullohet në tërësi, çrregullsia ekziston vetëm në disa pjesë dhe pjesërisht. Atyre, të cilët dëshirojnë dhe pyesin për abortin apo heqjen e një shpirti, u themi: Në vend se të bëhet abortimi, apo heqja e shpirtit, arritje shkencore e mjekësisë do të ishte që ta shëndoshë dhe ta rregullojë para se të lindë i paaftë, ndërsa mbytja është proces negativ, e ti nuk ke bërë asgjë!! Ai i cili dëshiron që ta mbytë të paaftin, ai nuk e ka

kuptuar urtësinë e ekzistencës. Natyrshmëri jonë është që nëse dëshirojmë t'ia ushtrojmë apo trajnojmë një pjesë shoqërisë për diçka, atëherë p.sh. trëndafilin e këpusim, e pastaj ua shpjegojmë dhe ua sqarojmë.

Përfundim i kësaj është që ai i cili dëshiron të arrijë rezultate shkencore për krijesën njeri, jo ta mbytë këtë, por të hulumtojë si ta pengojë shtrembërimin, të metën dhe dobësinë e embrionit.

MËSHIRA E PALOGJIKSHME (E ÇORODITUR)

Pyetje: A lejohet dhurimi i pjesëve të trupit?

Përgjigjja: T'i jap një pjesë të trupit njeriu, ndërsa vetes t'ia heq? Që nga momenti kur e ke hequr një pjesë nga një njeri për ta vendosur te tjetri, ajo pjesë mund t'i përshtatet njeriut, e mund edhe të mos i përshtatet. Në këtë mënyrë, ti ke hequr një pjesë prej trupit tënd, të cilën nuk dihet a e pranon trupi tjetër, apo jo. Për këtë arsye, unë shoh se kjo është mëshirë e palogjikshme (e çoroditur). Këtë e ka krijuar Krijuesi, e meta në krijesa, paralizim në pjesë të trupit, dhembje në një trup tjetër. Të gjitha këto tregojnë se ekziston një fuqi Madhështore. Për këtë arsye njeriu është më afër Zotit, atëherë kur i mungon diçka prej pjesëve të trupit të tij.

OBDUKSIONI

Pyetje: Cili është qëndrimi i islamit ndaj obduksionit?

Përgjigjja: Nëse obduksioni na ndihmon për diçka, nuk ka kurrfarë pengese të bëhet.

TË DJEGURIT E KUFOMAVE

Pyetje: Çfarë qëndrimi ka islami për djegien e kufomës?

Përgjigjja: Djegia e kufomës është haram, me zjarr dënon vetëm Allahu. Diçka çka e kanë pranuar në natyrë, ashtu duhet ta lërë në natyrë. Ndërsa, sa i përket mendimit se djegia e kufomave pengon përhapjen e sëmundjeve të ndryshme, nuk janë mendime të islamit dhe nuk ka të bëjë islami me mendime të tilla.

SHOKËT E XHENETIT

Pyetje: Cilat vepra të ngritin në shkallë të lartë të xhenetit dhe që të bëjnë të jesh në shoqëri të Muhamedit s.a.v.s në xhenet?

Përgjigjja: Për të qenë shok i të dërguarit të Allahut s.a.v.s. në xhenet duhet ta pasosh atë në çdo veprim dhe të kesh shëmbëlltyrë të jetës tënde; dërgo salavate për të, duaje atë, sepse kush e do një njeri (popull), Allahu e ringjall më atë njeri (popull). Mund të falesh edhe nafile sa ke mundësi, në mënyrë të vazhdueshme dhe pa ndërprerje, por mos e ngarko veten se Allahu nuk ngarkon askënd, por aq sa ke mundësi. Ta dish, nëse ke falur nafile, ke rezervuar (ke përgatitur) ashtu që, nëse pastaj sëmuresh apo të pengon diçka në namaz, Allahu t'i vazhdon shpërblimet e veprave nafile, të cilat i ke kryer gjatë gjendjes fizike të shëndoshë, dhe kur ke pasur mundësi. Allahu t'a mundësoftë dhe t'i realizoftë dëshirat tua!

EZANI DHE CËSHTJET RRETH TIJ

Është bërë traditë në shumicën e xhamive, kur muezini e thirr ezanin, menjëherë pas përfundimit, thuhet me zë: "ESELAMU ALEJKE JA SEJIDIJ JA RESULULLAH". Pra, salavatet për të dërguarin e Allahut s.a.v.s me zë, pas ezanit, a janë pjesë përbërëse e ezanit, apo kjo është shtuar më vonë. Ju lutemi të na e sqaroni?

Përgjigjja: Kjo është respekt dhe dashuri ndaj të dërguarit të Allahut s.a.v.s, mirëpo t'i e do me entuziazëm. Muhamedi a.s. ka thënë: Kur të dëgjoni muezinin dhe ai përfundon ezanin, thoni ashtu siç thotë muezini, pastaj më dërgoni salavate mua. Pra edhe muezini edhe dëgjuesit e ezanit dërgojnë salavate për të dërguarin e Allahut s.a.v.s në heshtje. Mirëpo, muezini këtë nuk duhet ta bëjë me zë të lartë, sikurse të ezanit, sepse ndokush prej njerëzve mund të mendojë se është pjesë përbërëse e ezanit dhe tekst i ezanit.

PSE QUHET RAMAZAN

Pyetje: Pse Zoti i Lartmadhëruar muajin e agjërimit e ka quajtur Ramazan? Çka do të thotë Ramazan dhe cila është urtësia e agjërimit? Shpresojmë se do t'na i sqaroni këtë çështje. Ne lusim Allahun t'ju shpërblejë për këtë!

Përgjigjja: Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"(Ato ditë të numëruara janë) Muaji i Ramadanit që në të (filloi të) shpallet Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtra). E, kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju. (Të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) që të plotësoni numrin, ta madhëroni All-llahun për atë se u udhëzoi dhe që të falënderoni".(EL-BEKARE, 185)

Çka do të thotë (shehr) muaj? Fjala muaj ka prejardhjen prej fjalës "lajmërim, proklamim dhe paraqitje". Edhe sot përdoret kjo fjalë me këtë

kuptim në raste të aktmarrëveshjeve, kur themi: Esh-shehr (muaji) i aktit. Pra, lajmërim se u bë marrëveshje, që të mos ndodhë kontratë mbi kontratë. Gjatësia apo hapësira kohore quhet muaj (shehr), sepse është koha e sinjalit, në të cilin ti e lajmëron apo e paraqet. Dielli nuk ka mundësi të tregojë kohën, por është shenjë me të cilën identifikohet dhe përcaktohet dita. Dita është prej lindjes së diellit e deri në lindjen e tij herën tjetër. Kjo ditë përfshin edhe ditën, edhe natën. Dielli nuk ka ndonjë shenjë dalluese paraqitëse, në bazë të së cilës e kupton njeriu, mirëpo sa i përket hënës së re në fillim të muajit, pas kalimit të saj në faza dhe forma të ndryshme, dallohet dhe paraqitet saktësisht në formë krejtësisht të re. Pra, te hëna e re ka shenjë dalluese të muajit; atëherë, hëna e re është për të dalluar muajin, ndërsa dielli është për të dalluar ditën prej ditës. Për këtë arsye, Zoti i Lartmadhëruar ka ndërlidhur veprimtarinë e adhurimit me shenja të qarta. Në këtë rast, shenjë e qartë është hëna e re, e pas kësaj vjen shenja tjetër e ditës, e ajo shenjë është vetëm dielli, sepse hëna e re nuk është shenjë e ditës, nuk sjell ditën. Pra, ne kemi nevojë për të dy shenjat. E, kjo do të thotë se hëna e re, pas rrotullimit, është fillimi i muajit. Për këtë arsye, koha e Ramazanit fillon natën. Edhe adhurimi i Ramazanit fillon natën, pasi që nata vjen e para, kur të filloj errësira e natës, e nëse e shohim hënën, themi: Muaji i Ramazanit ka filluar. Kjo çështje nuk sjell diskutim se dita është para natës, përpos në një lloj të adhurimit, e ai është qëndrimi në arafat; e pas tij vjen nata.

Muaji i Ramazanit tregon nxehtësinë dhe ndezjen (Kur thuhet Remeda insan-do të thotë u ndez njeriu nga etja). Ramada-rëra e nxehtë; bagëtia Remedat do të thotë: E ka kapluar nxehtësia dhe është dobësuar aq shumë, sa që nuk mund të ngritet në këmbë. Pra, thelbi i fjalës është nxehtësi dhe uri e madhe. E kjo do të thotë se njerëzit kur i kanë emëruar muajt, muajin e nxehtësisë e kanë quajtur muaji i Ramazanit (nxehtësisë). Pra, ato e kanë vërejtur se cilësimi i muajve dhe emërimi i tyre në momentin e emërimit të tyre është bërë në bazë të kësaj çështjeje dhe është zëvendësuar kalendari i posaçëm arab hënor me atë të përgjithshëm diellor. Pastaj, ka ardhur muaji i Ramazanit në kohën e ftohtë të pranverës. Mirëpo, në momentin e emërimit ka qenë nxehtësi. Pra, Ramazan është quajtur në kohën e pikënisjes, apo të fillimit, në të cilin ka qenë nxehtësi e madhe. Ashtu, Zoti i Lartmadhëruar e ka zgjedhur këtë muaj më këtë emër për të treguar vështirësinë, me të cilën ballafaqohet agjëruesi.

DITË TË CAKTUARA

Pyetje: Cila është urtësia e agjërimit të ditëve të caktuara dhe cili është kuptimi i ditëve të caktuara?

Përgjigjja: Agjërimi i ditëve të caktuara është dita Ashura dhe tri ditë të çdo muaji etj. Këto ditë të caktuara dhe të definuara janë ato, të cilat Allahu i ka caktuar për t'i agjëruar, përpos kur njeriu është i sëmurë, apo në udhëtim. Mirëpo, këto ditë të caktuara, nëse mund t'i agjërojë, ndërsa agjërimi e rraskapit, ka të drejtë ose të agjërojë, ose t'i kompensojë me sadaka. Zoti i Lartëmadhëruar ka thënë: **"(jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompenzim, ushqim (ditor), i një të varfëri ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aqë më mirë për të. Mirëpo, po që se dini, agjërimi është më i mirë për ju." (El Bekare, 184)**

Mirëpo, kur Zoti i Lartmadhëruar ka sjellë vendimin për agjërimin e muajit Ramazan, nuk ka dhënë leje, apo nuk ka lejuar që të bëhet zgjedhja mes agjërimit apo kompensimit. Argument për këtë kemi se Zoti i Lartmadhëruar nuk e ka treguar në ajetin: **"(ato ditë të numëruara janë) Muaji i Ramadanit që në të (filloi të) shpallet Kur'ani, që është udhërëfyes për njerëz dhe sqaruesi i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtra). E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështërsim për ju. (Të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) Që të plotësoni numrin, të madhëroni All-llahun për atë se u udhëzoi dhe që të falenderoni." (El Bekare, 185)**

Për këtë arsye, ne themi se agjërimi ka kaluar në dy faza: faza e parë, kur Zoti i Lartmadhëruar e ka obliguar agjërimin në ditë të caktuara; kush nuk ka qenë i sëmurë dhe nuk ka qenë në udhëtim, ai ka pasur obligim të agjërojë, e pas kësaj, nëse agjërimi e ka lodhur apo e ka munduar, ai ka pasur të drejtë të agjërojë ose ta kompensojë, edhe nëse agjërimi ka qenë i dobishëm për të. Mirëpo, kur ka sjellë vendimin që të agjërohet saktësisht muaji i Ramazanit, nuk e kanë pasur *këtë të drejtë dhe këtë lehtësim*. Argument për këtë kemi se pjesa e tekstit "i mundon" është vendosur në ajetin "ditë të caktuara" dhe nuk

ekziston në “Muaji i Ramazanit është muaji, në të cilin ka zbritur Kur'ani...”Dhe kush është prezent në këtë muaj, le të agjërojë, e pastaj nga agjërimi është përjashtuar i sëmuri dhe udhëtari. VALLAHU EALEM.

ALLAHU DËSHIRON T'JU LEHTËSOJË JUVE E NUK DËSHIRON T'JU VËSHTËRSOJË

Pyetje: Çka nënkuptohet prej ajetit fisnik: **Allahu dëshiron për ju lehtësim, e nuk dëshiron për ju vështirësim?**

Përgjigjja: Disa njerëz ndiejnë vështirësi gjatë adhurimit. Ne atyre u themi: Vështirësia te ai i cili adhuron dikë është para vështirësisë së adhurimit. Shiko çka ka dashur të na thotë Zoti i Lartmadhëruar: **“Allahu dëshiron për ju lehtësim, e nuk dëshiron për ju vështirësim”.**

Vazhdimësi dhe sqarim se Allahu i Lartmadhëruar e ka liruar të sëmurin dhe udhëtarin prej agjërimit. Vërtet, Allahu dëshiron për ju lehtësim. Me këtë ka dashur të na tregojë se nëse e kundërshton, ti ke dashur që Allahu të të vështirësojë, e jo të të lehtësojë. Ti patjetër duhet t’i përmbahesh ajetit: “Agjëro po aq ditë në ardhmëri (në kohë tjetër)”. E, ti duhet t'i përmbahesh lehtësimit (mosagjërimit). Parashtrohet pyetja: pse? Sepse nëse ti i përmbahesh dispozitës së agjërimit në atë gjendje (udhëtim e sëmundje), ti ke vendosur për vet dispozitën e vështirësimit ndaj vetes.

NDERIMI I TË VDEKURIT

Pyetje: Varrimi i të vdekurit në tokë, a mos është nënçmim për të?

Përgjigjja: Varrimi i të vdekurit në tokë është nderim për të, sepse dheu është burimi i përbërjes së tij. Për këtë arsye unë sfidoj: Ai i cili e do njeriun e vdekur, le ta kthejë në bazën e tokës një ditë, dy, një javë....! Për këtë arsye, më i dashuri i të vdekurit le të angazhohet për ta varrosur të vdekurin në dhe, sepse ne kështu e kthejmë te nëna tokë, e cila ia merr të gjitha elementet e të vdekurit, e përkëdhel dhe e pranon në gjirin e saj me të

gjitha elementet!!

Është interesant se, nëse ne e vendosim të vdekurin drejtpërsëdrejti në tokë, toka i pengon erërat e rënda të dalin prej tij, por nëse e vendosim në çdo vend tjetër, kundërmon erë e rëndë. Kështu, pas një kohe të gjatë zhduken elementet e tjera, për t'i lënë hapësirë që të kenë dobi elementet tjera. Të vendosurit e të vdekurit në tokë është nderim për të. Po të kishte qenë ndryshe, kurrë nuk do ta kishim vendosur të dashurin tonë në dhe; provoje, vendose në dhe, *a do të kishim duruar?* Nuk do të kishim duruar, ai do të kthehet në tokë prapë. Ai është prej dheut dhe në *dhe* do të kthehet**. Prej saj ju kemi krijuar, në të do t'u kthejmë dhe prej saj do t'ju nxjerrim edhe herën tjetër.** SADAKALLAHUL ADHIJM

Ajo që e mbron jetën tonë është lëvizja dhe aktiviteti ynë, mirëpo njeriu kur të vdesë, nuk mund të lëvizë, por nëse e lëviz tjetri, po, sepse ai është shndërruar në kufomë. Allahu dëshiron që këto të meta (paaftësi) të njeriut t'i mbulojë nga njerëzit tjerë, që forma e njeriut të vazhdojë (mbetet) e gjallë, pra të ketë gjallëri në vazhdim dhe që ne mos të dimë çka ndodh pas vdekjes së tij. Këtë na e ka ilustruar me shembullin e Habilit dhe Kabilit, kur sorra e ka varrosur sorrën, që edhe ai ta varrosë vëllanë e tij, sepse çdo gjë çka rezulton prej të vdekurit, është turpëri, sepse njeriu pastaj neveritet prej kufomës dhe se pjesët e trupit të gjallë lëngojnë. Me një fjalë, varrimi i të vdekurit nën dhe është nderim për të, që njerëzit dhe të dashurit e të vdekurit të mos lëndohen.

BOTA E NUMRAVE DHE BOTA E EKZISTENCËS

Pyetje: A i tubon Allahu i Lartmadhëruar biliona njerëz në ditën e Kiametit në një vend, në një kohë? I nderuar Shejh, mos ma zin për të madhe. Në cilin vend, në cilën kohë? Lus Allahun t'na falë. Mendja ime nuk mund ta paramendojë një gjë të tillë. Është mahnitëse, por unë jam i dyshimtë në të.

Imami i nderuar më shikoi, fytyra e tij shkëlqeu dhe tha: Zoti të bekoftë!

E nderuara pyetëse, bija ime e nderuar. Ti nuk mund ta paramendosh madhësinë e gjithësisë. Toka është planet prej njëmbëdhjetë planetëve të sistemit diellor, ndërsa sistemi diellor është një prej një milion sistemeve sikur të sistemit diellor. E gjithë kjo është vetëm qielli i kësaj bote. Po, çka

janë qiejt, toka dhe gjithçka ka mes tyre për fuqinë e Allahut, përpos sikurse një farë të cilën e hedh bujku në arë.

Astronomia na mundëson që të kuptojmë më lehtë, sepse ka gjetur masën e gjatësisë së dritës, për t'na zvogëluar numrat marramendës në mendjen tonë. Kurrë nuk mundemi të paramendojmë madhësinë e krijesave të Allahut të Lartmadhëruar. Në momentin kur ti e përkufizon gjithësinë në planetin e tokës, kjo i ngjason sikur ti të konsiderosh gjithësinë sikurse një ndërtesë, në të cilën banon ti, apo sikurse një rrugë, në të cilën ecën ti, apo sikurse një qytet, në të cilin jeton.

ATË DITË KUR NJERIU IKËN PREJ VËLLAIT TË TIJ

Pyetje: Pasi që njeriu në ditën e kiametit ikën prej vëllait të tij, prej nënës e babait të tij, ku i mbeti ajo dashuri, të cilën e ka pasur ndaj babait, nënës e vëllait?

Përgjigjja: Allahu ka dëshiruar që t'na sjellë shembull se njeriu e ka veten e vet. Kjo vetvete bën që dashuria të jetë në atë çka më së shumti i sjell të mira dhe i bën dobi. Për këtë arsye dashuria e djalit ndaj nënës nuk rezulton vetëm në atë se ai e ka nënë. Argument për këtë kemi se fëmija largohet nga nëna dhe gji i jep një grua tjetër, e edukon gruaja tjetër, përkujdeset dhe e rrit një grua tjetër. Ai fëmijë nënën e vet nuk e njeh dhe nuk e do, por e do atë, e cila e ka dashur dhe e ka ledhatuar. Allahu i Lartmadhëruar dashurinë reciproke nënë-baba-fëmijë e ka bërë varësisht prej nevojës dhe rrethanave. Për këtë arsye kur është pyetur një grua beduine për dashurinë ndaj fëmijëve të saj, është përgjigjur: E dua më së shumti fëmijën më të vogël deri sa të rritet, të sëmurin deri sa të shërohet dhe të zhdukurin deri sa të gjendet. Pra, dashuria, varësisht prej rastit dhe nevojës. Në ditën e kiametit për besimtarët, të cilët kanë bërë vepra të mira, nuk do të jetë kështu. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: **"Ata të cilët kanë besuar, e edhe pasardhësit vazhdojnë në përforcimin e besimit, ne ua bashkëngjisim atyre pasardhësit e tyre."** Ndërsa, ata, të cilët do të ikin nga familja e tyre, kanë bërë mëkate dhe e kanë hidhëruar Allahun e Lartmadhëruar, do të dënohen. Atëherë, secili do të jetë i preokupuar me fatkeqësinë e vet. Ata ikin për shkak të pabesimit, për shkak të mëkateve, prej atyre të cilët kanë qenë shkak i mosbesimit dhe mëkateve.

SHPËRBLIMI DHE DËNIMI

Cila është urtësia e shpërblimit dhe e dënimit në bazë të ligjit të Allahut dhe a shpërblehet njeriu në këtë botë, para botës tjetër, e po ashtu, a dënohet para botës tjetër? Nuk ka dyshim se në këtë ka arsye dhe urtësi. Lusim Imamin e nderuar të na i sqaroj këtë.

Përgjigjja: Dua të pyes pyetësen: A e shikon jetën e saj në aspekt të veçantë dhe jetën e saj në përgjithësi, e t'u thotë njerëzve çka mendojnë për të. Nëse nuk janë të fesë sime, e vendosin ligjet e tyre të shpërblimit dhe të ndëshkimit për fëmijët e saj, edhe pse ajo i do më shumë se çdokush tjetër. Po ashtu, edhe babai. Shteti parasheh ligjin e shpërblimit dhe të ndëshkimit për qytetarët e vet. Pra, çdo përkdujdesës i diçkaje parasheh ndëshkimin dhe shpërblimin për atë. Përderisa kjo vajzë ka besuar se Allahu është Krijues, atëherë është e logjikshme të jenë shpërblimet dhe ndëshkimet. Po mos të kishte ekzistuar çështja e shpërblimit dhe e ndëshkimit, ne menjëherë do të kishim parashtruar pyetjen për ta, sepse vet natyra dhe vet mendimet në këtë botë kanë vendosur çështjen (ligjin) e shpërblimit dhe të ndëshkimit. Të ekzistuarit e shpërblimit dhe e ndëshkimit është domosdoshmëri, përderisa të ekzistojë çështja e vullnetit, e dëshirës dhe e zgjedhjes. Përderisa ti ke të drejtë të zgjedhësh, të veprosh apo të mos veprosh, patjetër duhet të ekzistojë edhe çështja: të shpërblehesh ose të ndëshkohesh, sepse atëherë nuk do kishte pasur vlerë liria e të vepruarit. Përderisa ti je i lirë dhe i vullnetshëm, patjetër duhet t'i bartësh rezultatet (pasojat) e zgjedhjes tënde. Nxënësi shkon në shkollë, ai është i lirë të dëgjojë apo të mos dëgjojë, të kuptojë apo të mos kuptojë, ai është i lirë të mësojë apo të mos mësojë. Ai gjatë tërë vitit është i lirë të zgjedhë. Po mos të ishte provimi në fund të vitit, kalimi a përsëritja, asnjë nuk do të ishte lodhur për të kuptuar e për të mësuar gjatë tërë vitit. Pra, të ekzistuarit e shpërblimit dhe ndëshkimit është garanci për mosdhunimin e të drejtës së vullnetit dhe zgjedhjes. Për këtë arsye nuk vendoset ligji i shpërblimit dhe i ndëshkimit për çështjet, në të cilat nuk ka të drejtë (pra çështjet e imponimit). Atëherë, nuk ka çka të bëhet pyetja: Pse është ligji i shpërblimit dhe ndëshkimit? Por, përkundrazi, po mos të kishte ekzistuar shpërblimi dhe ndëshkimi, patjetër do të ishte parashtruar pyetja: Pse mos të ekzistojë shpërblimi dhe dënimi? Qëllimi dhe arsyeja e të ekzistuarit të shpërblimit dhe dënimit nuk është që të kryhen veprat e ndaluara, por që të

mos ndodhë të kryhen ato. Kur unë them: Vjedhësi ndëshkohet me prerje të dorës, kjo nuk do të thotë se unë jam duke thënë: Vjedh që të ta pres dorën ty. Por, kuptimi i saj është se unë jam duke thënë: Kujdes, mos vjedh, se përndryshe do të të pritet dora. Pastaj, shikojmë një njeri që në jetën e tij është në rrugë të drejtë, i dobishëm për shoqërinë, nuk ia cenon të drejtën askujt, ndërsa, në anën tjetër, një njeri tjetër krejt ndryshe prej tij. A do të ishte drejtësi që këta dy të jenë të barabartë, pra njeriu, i cili është degjeneruar, vjedh e bën krime te të tjerët, me njeriun e ndershëm dhe besnik?

Pra, pagimi bën që jeta e njeriut në këtë botë dhe në botën tjetër të jetë peshojë dhe pikëbashkimi i ndarjes së njërës prej tjetrës. Nuk mund të jesh i lumtur në botën tjetër pa punuar vepra të mira në këtë botë. Nuk shkëputet puna e njeriut në këtë dynja prej pagimit në botën tjetër, që do të thotë se jeta e tij është edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër. Kështu, kur njeriu bën një punë të keqe, ai do të jetë shëmbëlltyrë e mirë për të tjerët, nëse nuk ndëshkohet, nuk pengohet dhe nuk ndërpritet hovi i tij. VALLAHU EALEM ALLAHU E DI MË SË MIRI

E ZGJERON KRAHARORIN TIM

Pyetje: Ndonjëherë kur falem, më çlirohet edhe më zgjerohet gjoksi, e ndonjëherë nuk ndiej kënaqësi fare në namaz. Kjo ndodh pa dëshirën time. A ekziston diçka, ndonjë këshillë apo formë, e cila më bën që çdo herë të ndihem më i devotshëm dhe më i qetësuar në namaz?

Përgjigjja: Allahu i Lartmadhëruar dëshiron nga ne t'i kryejmë veprat obligative, si p.sh. namazin. Nëse i kryejmë këto vepra me qetësi, kjo do të thotë shpërblim i parakohshëm. Mirëpo, pse nuk ndien qetësi dhe ngushtohet kraharori, kjo nuk do të thotë që të mos falet namazi, përderisa ti vazhdimisht i kryen obligimet, ti vazhdimisht do të shpërblehesh për veprat e kryera. Është parim, të cilin patjetër duhet ta dish se nuk do të japim përgjigjen për çështjet të cilat nuk janë në dëshirën dhe kompetencën tonë. Njeriu i kryen gjithmonë namazet, pa marrë parasysh a i zgjerohet gjoksi në namaz apo jo, sepse namazi është obligim, e lënia e namazit, pabesim.

FETAVATË E SHAËRAVIJUT

PJESA E DHJETË

X

Përktheu: Dr. Musli Vërbani

Kaçanik, 2015

HYRJE

Shkruan Dr. Ibrahim Betavi, ish profesor në universitetin e El-Ezherit, i dalluar me sjelljen e tij dhe personalitetin e tij.

Vëllai im, Shejh Shaeraviju u konsiderohet dashuri prej dukurive shpirtërore me kohën ku është prezent dhe mbizotëron materializimi. Rruga e tij dhe pasqyrimi i tij i tematikave bashkëkohore, në formë dhe mënyrë tashmë të njohur dhe ky është shkaku se atë e dëgjojnë miliona dëgjues nga të gjitha kategoritë shoqërore dhe nivelet e tyre intelektuale. Dobia e tij zgjerohet aq sa pranojnë edhe zemrat e zbrazura, aq sa shkëlqen në kohën kur dominojnë errësirat materialiste dhe nivelet e larta në të gjitha poret e jetës, sa që ku depërton, edhe ata të cilët dinë për fe, e që një pjesë të tyre ka prekur edhe shejtani se duhet përfituar prej kamatës, për të cilët zoti i Lartmadhëruar ka thënë: ***Ata të cilët përfitojnë dhe ushqehen prej kamatës, nuk ngriten ndryshe në ditën e kiametit, përpos ashtu siç ngritet ai që e kaplon shejtani. Kjo nga arsyeja se ata kanë thënë: Nuk ka dyshim se edhe shitblerja është e ngjashme me kamatën****. Ky është shkaku se të rinjtë janë më të shpejtë se të vjetrit në perkrahjen e ideve të Shaëravijut, sepse te ai gjendet sinqeriteti, i cili mungon te shumica e të tjerëve, ashtu siç ngjitet ushqimi shpirtëror tek i urituri, të cilit i ka munguar ushqimi për një kohë të gjatë. Këtu është edhe arsyeja e rrahjeve të tematikave të shumënumërta, që të mbulojë zbrazëtinë shpirtërore tek të rinjtë, duke filluar prej tematikës së "Kadasë" dhe "Kaderit" e deri te fejesa, të përzierit femra e meshkuj në kufij të cilat i lejon ligji i sheratit, si kundërpërgjigje ndaj mendimeve të thirrësve të humbur islam, të cilët thonë se duhet shikuar vetëm Kur'anin, e nuk dinë se suneti është plotësues dhe sqarues i tij; sqarues i përpiktë, e jo sipas dëshirës apo epsheve, e duke sqaruar çështjen e shejtanëve ifrit, gjurmët dhe pasojat e magjive, të cilat ndikojnë në ndarjen mes bashkëshortëve, e deri te teoria e krijimit të njeriut dhe e zhvillimit të tij, duke deklaruar: Cilët janë dhe ku janë faktorët që ndikuan që majmuni të bëhet njeri!? Pse llojet tjera të majmunëve kanë mbetur në majmunërinë e tyre? Pse ata nuk janë shndërruar në njeri !?*

Kështu, ky njeri i ndërlidh çështjet bashkëkohore me bazat themelore islame dhe ndriçon rrugën e kalimtarëve, qofshin djem e vajza ata, të rinj ose pleq, duke kaluar prej lules në lule, prej kopshtit e në kopsht, për të zgjidhur enigmat bashkëkohore.

Ky është shkaku që ne kemi thënë se shejh Shaëraviju është edukim shpirtëror i këtij shekulli, shekull i cili mundohet që njeriun ta bëjë rob të materies, larg nga ligjet e Allahut.

PERPILIMI I FETFAVE

Kur ky njeri flet, flet zëshëm, me oratori, me ide të shkëlqyeshme dhe domethënëse, të cilat depërtojnë në mendje e zemër në të njëjtën kohë. Mirëpo, nëse ti i përqendron këto dy elemente para librit, të ndihmon t'i kesh gjithmonë pranë, nëse nuk i ke regjistruar. Kjo është rëndësia e nxerrjes së teksteve dhe renditja e tyre, të cilat janë të shumënumërta nga një ligjërues, duke e përcjellë atë vazhdimisht në vende të ndryshme për të prezantuar idetë e ligjëruesit me precizitet, ashtu që edhe ligjëruesi t'i japë besim të plotë për përpilimin e atyre ideve. Mirëpo, vështirë e ka përpiluesi të futë diçka të re, ose të zbulojë diçka të re, për shkak se ai tenton të tregojë atë që e ka thënë ligjëruesi, duke mos i dhënë përparësi asaj çka e shkruan vet, se ndryshe nuk do të dëgjohej (lexohej).

Nga kjo rezulton vepra e letrarit Dr. Sejid Xhemilë, doktor dhe po ashtu mjek i respektuar, duke përpiluar idetë e të nderuarit dhe të respektuarit, shejh Sheravijut, të cilat i ka përpiluar prej ligjëratave dhe fetvave në fushën e njohurive të fikhut, njohurive shoqërore për t'ia lehtësuar studentëve dhe lexuesve që të arrijnë deri te qëllimi i tyre. Kjo është shkëndija prej shkëndijave të dritës, të cilën mund ta çmojmë dhe ta vlerësojmë mirë. Kështu, edhe përpiluesi besnik ka shpërblim për angazhimin dhe mundin e madh, për rininë e kësaj kohe, për qetësimin e zemrave të tyre, për forcimin e besimit të tyre dhe për forcimin e rrugës së tyre të drejtë.

Më kanë mbetur edhe dy fjalë:

E para : Përpiluesi i këtij libri e demanton mendimin e Akadit, i cili mendim përputhet me orientalistët se: Pejgamberi s.a.v.s. ka qenë gjenial, sikur gjenitë tjerë, përderisa mrekullia mbinatyrore bie ndesh me gjenialitetin e të tjerëve. Kjo është e vërtetë dhe e drejtë, të cilën Shejh Shaeraviju e ka treguar fuqishëm që të mos ngelin lexuesit e prof. Akadit në rrjetën e tij. Zoti i Lartmadhëruar qoftë i hidhëruar mbi ata, të cilët ia kanë zili vulës së pejgamberëve dhe më të madhit të gjithë njerëzimit!

E dyta: Të ngatërruarit e fjalës terminologjike, e cila përdoret me

përkthim dhe e cila i jep kuptim krejt tjetër, siç është fjala "ILMANIJE – sekularizëm", e cila përkthehet si shkencë dhe e cila përdoret përballë joshkencës. Shejh Shaëraviu e kundërshton fuqishëm, gjë që për këtë ka plotësisht të drejtë, sepse për dallim nga fetë tjera, në islam ky term nuk përdoret përballë islamit.

Arsyetimi në këtë rast është i shëndoshë, nëse çështja e shkencës (sekularizmit) është e kundërta e islamit, sepse islami nxit për shkencë tërë njerëzimin.

Mirëpo, sekularizmi te shkencëtarët përafërsisht është terminologji, e cila përdoret kundër paditurisë (injorancës), apo, me fjalë të tjera, injorim feje, pra është në tërësi kundër diturisë (shkencës) apo njohurisë fetare. Kjo terminologji është përkthyer tekstualisht nga gjuha latine te francezët ose te anglezët, ndërsa, përkthimi i fjalës "Alem", që ka të bëjë për botën, pra për këtë botë (ose kohëtarët). Ndërkaq, kjo terminologji është e hershme, të cilën e ka potencuar edhe vet Kur"ani, ku thotë: ***Dhe thanë: Nuk është asgjë tjetër kjo botë, përpos që lindim, vdesim dhe nuk na shkatërron asgjë tjetër, pos koha. Për këtë nuk kanë kurrfarë njohurie. Ata vetëm se imagjinojnë.***

Ky është prej emërtimeve tradhtare, të cilin e kanë përdorur jahuditë për të vallëzuar ata me fenë e tyre, nëpërmjet sionizmit ndërkombëtar, me të cilin emërtim i kanë mashtruar kryengritësit e Francës, pastaj edhe Ataturkun, e nëpërmjet asaj kryengritje pastaj e kanë përhapur në tërë rruzullin tokësor. Ata interesohen vetëm për këtë botë dhe fenë e lënë në tërësi pas shpine. Nëse një fe bie ndesh me epshin apo me këtë botë, ajo fe duhet të eliminohet.

*Kjo ka qenë domosdoshmëri në kohën e errësirës shkencore në Evropë, kur kisha ka refuzuar çdo kënaqësi të kësaj bote. Ky problem nuk ka ekzistuar në islam, që të çrrënjosë kënaqësinë e kësaj bote për fitimin e botës tjetër. "****Dhe kërko atë që Allahu ta ka dhënë hise për në botën tjetër, e mos e harro hisen tënde të kësaj bote. Dhe bën mirë, ashtu siç të ka bërë mirë Allahu ty." (EL-KASAS)***

Lus Allahun që të bëjë dobi nga ky angazhim i këtij djaloshi bashkëkohor dhe profesorëve të tij dhe shtoi dituri për Allahun. Lus Allahun që Shejhit të nderuar t'i japë shëndet, lumturi në jetë.

Dr. Ibrahim Muhamed Betaviju KAJRO 13 DHUL Kaëde 1402
Ish profesor I universitetit të Ez-herit 1 Shtator 1982
DARUL-INSAN KAJRO

VETËPRANIMI DHE VETËDORËZIMI NDAJ ALLAHUT

Pyetje: Vetëpranimi dhe vetëdorëzimi ndaj Allahut; cila është rruga e cila të shpie deri aty?

Përgjigjja: Kur njeriu i ka në dispozicion shkaqet e ndryshme të jetesës, e harron shkakvendosësin dhe mendon se është vet njeriu ai, i cili i ka sjellë ato shkaqe me angazhimin dhe punën e tij. Për këtë Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Jo, kurrsesi jo. Nuk ka dyshim se njeriu e tejkalon dhe bën krim (që nga momenti) kur e sheh veten se është i pavarur".** Po sikur ta kujtonte njeriu se për çdo shkak, shkakvendosës është Allahu i Lartmadhëruar; ky është vetpranim dhe vetëdorëzim ndaj shkaqeve, kur njeriu sheh se në krahasim me veten e tij, të gjithë njerëzit janë më të mirë se ai në punë të mira, ndërsa vet bën më së shumti punë të këqija. Çdo njeri e di se e keqja është e keqe, por ai mendon se edhe të tjerët bëjnë të këqija.

O keqbërës, mos u krekos me atë se edhe të tjerët bëjnë punë të këqija. Ti shiko çdo njeri me vlera dhe thuaj: Ai është më i vlefshëm dhe më i mirë se unë. Nëse shikon dhe sheh njeri të poshtër dhe me të këqija, ta dish se ti ke të këqija më shumë se ai. Kjo të ndihmon që të mos e mashtrosh veten tënde. Je mashtruar nëse ti mendon se je më i mirë se të tjerët. Me një fjalë, vetëpranim dhe vetëdorëzim ndaj Allahut është që ti të kesh bindje të plotë se nuk ka forcë e as fuqi që dikush të ndryshojë diçka pos Allahut. Dhe ta ushtrosh veten në fjalën e Zotit të Lartmadhëruar: **"Asnjë njeri (apo popull) mos ta nënçmojë tjetrin, duke menduar se ai është më i mirë prej të tjerëve".** Allahu për t'ia tërhequr vëmendjen njerëzve, i jep atij i cili nuk mashtron, që të habitet ai i cili mashtron. Mirëpo, Zoti i Lartmadhëruar këtë çështje nuk e bën absolute, apo të përgjithshme, se atëherë të gjithë njerëzit do t'i kishin pasuar vetëm shkaqet.

Pra, ne duhet që gjithmonë të kujtojmë se Allahu i Lartmadhëruar është shkakvënës dhe dhurues i shkaqeve. A është e qartë tani çka do të thotë vetëpranim dhe vetëdorëzim ndaj Allahut.

EL-LIANË (MALLKIMI)

Pyetje: Çka është Liani?

Përgjigjja: Lian quhet atëherë kur burri e akuzon bashkëshorten për tradhti të kurorës, e nuk ka dëshmitarë, pos vetes. Kështu ai dëshmon dhe përbetohet katër herë se është e vërtetë dhe ai vet e flet të vërtetën, ndërsa të pestën herë përbetohet se nëse gënjen dhe nuk e flet të vërtetën, mallkimi i Zotit qoftë mbi të.

Pas kësaj, në çfarë situate të mbesë gruaja? A të marrin me këtë vendim të prostitucionit? Nëse hesht ndaj përbetimit të burrit të saj, vërtetohet se ajo ka tradhtuar kurorën e saj. Mirëpo, nëse dëshmon dhe përbetohet në Zotin katër herë dhe në të pestën thotë: Nëse ai e flet të vërtetën, mallkimi i Zotit qoftë mbi veten e saj. Kështu ajo e mbron akuzimin. Vetëm se jeta bashkëshortore mes tyre përfundon dhe bëhet ndarja mes tyre, e cila quhet ndarje liani (mallkimi). Kështu mes tyre çdo gjë mer fund dhe llogaria është te Allahu.

Ajeti i Lianit (mallkimit) ka zbritur atëherë kur njëri prej sahanëve e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s.: Nëse unë hyj në shtëpi dhe takoj një burrë me gruan time, a t'i lejoj në atë pozitë deri sa t'i sjell katër dëshmitarë? Atëherë ka zbritur ajeti i Lianit.

Ne vërejmë se ndonjë njeri e mallkon veten, duke thënë: Mallkimi i Zotit qoftë mbi veten time, nëse gënjen, ndërsa gruaja thotë: mallkimi i Zotit qoftë mbi veten time, nëse burri i saj e flet të vërtetën. Kjo nga shkaku se akuzimi në gruan për prostitucion është me e rëndë se akuzimi në burrin, sepse prostitucioni i gruas është shkak i të ngatërruarit apo përzierjes së trashëgimtarit.

DËRGON SALAVATE PËR PEJGAMBERIN

Pyetje: Pse të dërgoj salavate për të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. dhe si të dërgojmë?

Përgjigjja: Allahu i Lartmadhëruar i ka urdhëruar robërit besimtarë për të dërguar salavate për Pejgamberin s.a.v.s. kur ka thënë: **"Është e vërtetë se Allahu dhe Melekët e Tij dërgojnë salavate për Pejgamberin. O ju që keni besuar, dërgoni salavate për të dhe përshëndeteni me selam". (El-Ahzabë, 56)**

Rrënja e fjalës "Salavat" është lutje, mirëpo kur të cilësohet, atëherë merr emër terminologjik, e ajo është falja apo namazi, i cili i ka fjalët (lutjet) e posaçme, të cilat i fillojmë me tekbir dhe i përfundojmë me teslim.

Ti nuk e thirr njeriun, përpos kur atij t'ia dëshirosh të mirën dhe nuk e thirr askënd tjetër pos atë, i cili ka mundësi për të ta sjellë atë të mirë. Nëse ai të cilit i lutet ka mundësi për të të sjellë të mirë, ai të jep të mirën menjëherë. Për këtë arsye salavati (lutja) prej Allahut është mëshirë e përnjëhershme, sepse Allahu nuk lut askënd për t'i dhënë dikujt diçka, mirëpo Ai vetë është dhënësi. Për këtë arsye lutja e Allahut është mëshirë e përnjëhershme, që do të thotë se kuptimi "Ai lutet (jusalij) për ju" është: "Ai ju mëshiron ju".

Lutja e melekëve është lutje e pranuar, sepse duaja e tyre është e pastër dhe nuk refuzohet. Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: "Dhe lutu për ta, se vërtet lutja jote është qetësim për ta", ka pasur për qëllim: "Lute Allahun për umetin tënd, sepse duaja e Pejgamberit për umetin e tij do të jetë qetësim për ta.

Ndërsa, salavatet tona për të Dërguarin s.a.v.s. nuk janë për t'i sjellë të mira atij, por për të sjellë mirësi në vehten tonë, sepse çdo e mirë që i shkon Pejgamberit s.a.v.s. ajo mirësi kthehet te umeti i tij. Kjo do të thotë: Që kur dërgojmë salavate për të, ne lutemi për të mirën tonë. Nëse ti dërgon salavate një herë, Allahu t'i sjellë dhjetë të mira. Kur kërkojmë që Muhamedi s.a.v.s. të arrijë shkallën e lartë (mekamin mahmur) dhe shefaatin, ne kërkojmë që të përfitojmë prej asaj shkalle, sepse Pejgamberi s.a.v.s. me atë shkallë do të ndërmjetësojë për ne në botën tjetër, që Allahu të na sjellë të mira. Për këtë arsye kur të lutem për Pejgamberin s.a.v.s. jam lutur për veten time.

Sa i përket formës së salavatit, për të kryer obligueshmërinë, mjafton të thuhet: "Allahume sal-li alen-nebij ve sel-lim". Kjo formë është formë e tekstit të Kur'anit fisnik. Ndërsa, sa i përket asaj se ti ke ndjenja dhe dëshiron

që Pejgamberin s.a.v.s. ta nderosh edhe më shumë, përshëndete si të duash, dhe çka ndien ti se është mirë. Ne e kemi parë se si ka qenë i ndikuar për Pejgamberin s.a.v.s., kur ka thënë një njeri: "O Zoti im, për shkak të respektit që ka te Ti, për shkak të vendit që ka te Ti, për shkak të dashurisë që ka te Ti dhe dashurisë që ke te ai, si dhe të fshehtat që i keni mes vete (e ne nuk i dimë), të lutemi për salavate dhe selame për të, për familjen e tij, shokët e tij. O Zoti im, shtoje dashurinë time ndaj tij, më mëso për personalitetin dhe gradën e tij, më bashko me të, më bën të kënaqem me shikimin në të, më afro me të, më përgatit që të flas me të, dhe largoi nga unë perdet, pengesat dhe sendet që qëllojnë mes meje dhe tij. Forcoje dëgjimin tim, që ta dëgjoj dhe ta përjetoj kënaqësinë e të folurit të tij, më përgatit të takohem me të dhe të përfitoj prej tij. Dërgimin e salavatit tim bëje dritë shpërthyese, e cila fshin çdo errësirë dhe padrejtësi, çdo dyshim, çdo idhujtari, çdo shpifje dhe çdo padituri para se ta përfundoj këtë dua.

Disa thonë: "O Zoti im! Dërgo salavate për zotërinë tonë, Muhamedin, çdo salavat të cilën Ti dëshiron t'ia dërgojmë dhe në çdo kohë. O Zoti im, dërgo selame për zotërinë tonë Muhamedin dhe çdo selam që Ti dëshiron t'i dërgohet dhe në çdo kohë, salavate dhe selame të përgjithmonshme, aq sa vetëm ti di, vlerësoje aq sa vetëm ti di, me vlera të shumëfishta".

Ne veç e dimë se si një arab i influencuar, i cili, përderisa i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ishte ulur me të, duke e kujtuar Allahun, i thotë Pejgamberit s.a.v.s.: "O zotëria ynë, o i Dërguar i Allahut, unë nuk di të lutem me lutjen si lutesh ti dhe si lutet Muhadh bin Xhebeli, unë e di vetëm këtë: La ilahe il-lall-llah, Muhamedun resulull-llah. Muhamedi s.a.v.s. i thotë: Po edhe ne rreth kësaj çështje lutemi. Për këtë arsye mjafton të themi: Allahume sal-li alen-nebij ve sel-lim".

KADAJA DHE KADERI

Pyetje: Çfarë dallimi ka Kadaja prej Kaderit?

Përgjigjja: Kadaja është vendim për të cilën nuk kam të drejtë zgjedhjeje apo dëshirë në të, ndërsa kader do të thotë se t'i ke paraparë që t'i ndodhë kjo dhe çështjet ndodhin ashtu siç e ke paraparë. Nëse ministri i bujqësisë shkruan raport për pambukun ku, në mes të tjerash, thotë: Ne do të mbjellim kaq fidane, një fidan do të japë kaq fryte, prodhimi mesatar i fidanit është kaq, kemi planifikuar që sivjet rezultati i prodhimit do të jetë kaq. Ai planifikon, sepse e ka ditur, ndërsa dijetari mund t'ia qëllojë, e mund të gabojë në kushte dhe rrethana, të cilat nuk i ka ditur. Mirëpo, kur Zoti i Lartmadhëruar përcakton dhe planifikon, ajo edhe ashtu ndodh dhe çështjet në gjithësi ndodhin vetëm ashtu siç ka përcaktuar dhe planifikuar Allahu.

Kadaja është një çështje, në të cilën nuk kam të drejtë zgjedhjeje, si p.sh. sëmundja dhe vdekja. Kur Zoti i Lartmadhëruar ka planifikuar të veprojë në punë prej çështjeve, në të cilat kam të drejtë zgjedhjeje, Ai nuk më ka detyruar ta kryejë, mirëpo Ai e ka planifikuar dhe e ka ditur me diturinë e Tij të përhershme pa fillim se unë do ta zgjedhë atë rrugë.

Nëse unë e dërgoj shërbëtorin që të blejë për ty një gotë, e të them ty: Ai është vonuar, sepse në rrugë ka takuar një djalë dhe ka luajtur me të, e duke luajtur i ka humbur të hollat, dhe tani ai frikësohet të vijë. Unë e them këtë, përderisa gjatë gjithë kohës kam qenë me ty në dhomë, e pas kësaj vjen shërbëtori. E kur e pyesim, ai na përgjigjet: saktësisht ashtu siç kam thënë. Tani pasi që të kam treguar se çfarë do të ndodhë dhe ashtu ka ndodhur, a mos kam dërguar ndonjë forcë për të treguar çka ka vepruar. Atë që kam thënë e kam thënë se i kam ditur gjërat më herët, mirëpo nuk e kam detyruar të veproj atë që të kam thënë.

Kështu (Allahu është shëmbëlltyra më e larta), Allahu e ka ditur nga herët, se si do të jetë puna me robin e tij dhe e ka shkruar, por jo me detyrim, por në bazë të diturisë së Tij, se si do të jetë puna me robin e Tij. Ky është kaderi i tij.

Dallimi në mes të dy formave është se dituria njerëzore është ndryshe nga dituria e Allahut. Është e mundur që unë të di se si vepron ky shërbëtor, mirëpo kësaj radhe mund të lajthitem për shkak të rrethanave të tjera, si f.v. ndonjë automjet e shkel, e ai shkon në spital dhe nuk realizohet ajo çka kam

thënë unë për të. Ky është gabim i diturisë sime. Mirëpo, Allahu i Lartmadhëruar me diturinë e Tij nuk gabon kurrë. Qoftë i lartësuar Ai me cilësitë dhe emrat e Tij. Nuk ka zot tjetër pos Tij.

GODITJA E FATKEQËSISË

I nderuari Imam, çka do të thotë "Musab" dhe, në kuptimin e vërtetë të fjalës, çka do të thotë "fatkeqësi". Dhe sikur e dimë, është lutur i Dërguari i Allahut s.a.v.s., sipas tekstit, i cili është gjurmuar prej tij: ***"O Zoti ynë, mos lejo fatkeqësi në fenë tonë, mos lejo që jeta në këtë botë të jetë qëllim kryesor. Na bën që në jetën tonë të na shtohen të gjitha të mirat, na bën që vdekja jonë të jetë e qetë ndaj çdo të keqeje".*** Dëshirojmë dhe shpresojmë që imami i nderuar të na e sqarojë këtë çështje; paraprakisht lusim Zotin ta shpërblejë me të gjitha të mirat.

Përgjigjja: Në hadithi kudsij Zoti i Lartmadhëruar thotë: ***Pasha krenarinë dhe madhërinë Time, nuk e kisha nxjerrë robin në këtë botë pa ia dëshiruar atij të mirën dhe derisa mos ta kisha paraparë që ta shpërblej për të mirat; dhe për ta pastruar prej të këqijave të tij, i sjell atij sëmundje në trup, pakësim në pasuri dhe humbje në fëmijë dhe kur t'i mbetet vetëm një e keqe, pastrohet me agoninë e vdekjes, që në ditën e kiametit të paraqitet para meje i pastër prej gabimeve, sikur atë ditë kur e ka lindur nëna e tij. Pasha krenarinë dhe madhërinë Time, nuk e kisha nxjerrë robin tim në këtë botë për t'ia dashur të keqen, pos asaj të keqe, e cila është kompensim për veprat e këqija, duke i dhënë shëndet në trupin e tij, shtim të pasurisë dhe të fëmijëve. E, kur t'i mbetet vetëm një e mirë, e peshon agonia e vdekjes, ashtu që në ditën e kiametit nuk do të ketë me vete asnjë të mirë.***

Për këtë arsye, kur Pejgamberi s.a.v.s. është pyetur për atë, të cilin e godet ndonjë fatkeqësi, ai përgjigjet: ***Nuk është fatkeqësi ajo që ju po mendoni, por fatkeqësi është kur ti je i pashpërblyer, apo i penguar prej shpërblimit.***

Ndërsa, atë që e godet ndonjë fatkeqësi, e ai duron me vendosmëri, a mund të quhet fatkeqësi? Natyrisht se jo. Përkundrazi, ajo fatkeqësi është shpërblim për të.

POLEMIKA DHE DISKUTIMI I TYRE ËSHTË MËSHIRË

Pse katër medhhebe (katër drejtime) dhe ndryshimi në mes tyre?

Allahu i Lartmadhëruar e ka zbritur Islamin për të vendosur programin e aktivitetit jetësor. Vendi në të cilin ka zbritur është vendi i sundimit të aktivitetit të jetës, pra për të vendosur aktivitetin e jetës së njeriut, e sa i përket gjallesave dhe çështjeve pas njeriut, ata i nënshtrohen ligjit të domosdoshmërisë dhe nuk mund të ndryshojnë asgjë.

Cili është shkaku dhe arsyeja që për njeriun është vendosur programi. Vepro, ose mos vepro, ndërsa të gjitha çështjet tjera i janë të nënshtruara ligjit vepro, pra programit pa të drejtë zgjedhjeje, sepse njeriu posedon mjetet e zgjedhjes dhe mjetin shqyrtues (zgjedhës), e ai mjet është mendja. Kuptimi "zgjedhje" dhe "shqyrtim" do të thotë se ka çështje të ndryshme dhe të llojllojshme, e mendja e zgjedh njërën prej tyre. Pra mjeti shqyrtues – zgjedhës (mendja) dhe në mes janë sendet që duhen zgjedhur ekzistojnë. Kur nuk ka mjete për të zgjedhur nuk ka vend për zgjedhje, e kur të gjenden mjete për të zgjedhur, nuk ka vend për zgjedhje, e kur të gjenden mjete për të zgjedhur, nuk ka mendje, si p.sh. i çmenduri, atëherë nuk ka edhe kërkim për obligueshmëri, pra ai i cili nuk është i pjekur psikikisht! Pra, në zgjedhje patjetër duhet të jenë dy anët: mjetet të cilat duhet zgjedhur dhe mjeti i cili zgjedh (zgjedhës). Po ashtu, njeriu duhet që të jetë i lirë në zgjedhje mes mjeteve, pa qenë i detyruar. Nëse gjendet ndonjë forcë, e cila e detyron të veprojë diçka pa dëshirë dhe pa lënë alternativë për të zgjedhur, ne themi se për të nuk gjykohet dhe nuk i merret parasysh.

Kur Zoti i Lartmadhëruar ka vendosur sheriatin Islam që i ngarkuari me obligime të ketë të drejtë zgjedhjeje të njeriut, janë vërejtur dy çështje. Në një anë është i detyruar, e në anën tjetër jo. Çështjet kryesore të përgjithshme Allahu i ka bërë obligative me vendim, e nuk i ka lënë hapësirë njeriut për të zgjedhur. Këtë e ka bërë se njëllojshmëria është qëllimi se vetëm ashtu është në rregull, p.sh. Lëvizjen e trupave qiellor në gjithësi. Atë çka Allahu ka dëshiruar të jetë e qartë e ka bërë të përpiktë. Në ta nuk ka kundërshtime. I ka bërë obligative pesë kohët e namazit. Këtë askush nuk e kundërshton. Askush nuk ka thënë se janë katër, e tjetri të thotë p.sh. shtatë. E, pastaj ka thënë: Sabahu i ka dy rekate. Në këtë askush nuk ka kundërshtuar. Pra, në çështjet kryesore obligative Allahu nuk ka lënë hapësirë për hulumtim (ixhtihad), por

ka dhënë urdhër të prerë.

Kjo prezanton anën e domosdoshmërisë te njeriu, ai është i obliguar të jetë ashtu. Allahu ashtu ka vendosur, pa i lejuar njeriut të bëjë ixhtihad. Gjithashtu, Zoti i Lartmadhëruar në çështje të brendshme të vendimeve ka lënë hapësirë për ixhtihad (hulumtim). Kështu që çdo gjë që ka zgjedhur njeriu, është ajo çka ka dashur Zoti i Lartmadhëruar. P.sh. Nëse fëmijës tim ia jap një lirë sterline (xhunejl) dhe kërkoj prej tij të blejë pemë, mirëpo unë atij i kam lejuar të zgjedhë ose mandarinë, ose portokaj të thartë ose portokaj të ëmbël, se çfarë do që të blejë ai, nuk ka dalë jashtë kornizave të kërkesës sime. Mirëpo ai nuk ka të drejtë të blejë banane, çaj ose sheqer, sepse ai atëherë ka dalë jashtë kornizave të kërkesës sime. Për këtë arsye nuk ka çka të mendojë dikush se dijetarët (imamët) kanë kundërshtuar në çështjet bazore që Allahu i ka dëshiruar të jenë të pakontestueshme. Atë që Allahu ka dëshiruar të jetë e pakontestueshme, aty kurrë nuk do të ketë mospajtime. Çështjen e pakontestueshme e ka lënë ashtu, sepse po mos të ishte ashtu, do të prishej çështja në tërësi. Ndërsa çështja, e cila në të dy mënyrat është në rregull, apo në tri mënyra e më shumë, e ka lënë të paqartësuar për t'i lënë njeriut lirinë e zgjedhjes në të, sepse Allahu është ai, i cili ka krijuar njeriun, dhe nuk ka dashur që njeriut t'ia imponojë çështjet sekondare, por ia ka lejuar që të zgjedhin dhe të bëjnë hulumtim dhe ixhtihad në suaza të tekstit të përgjithshëm. Po ashtu edhe sahabët kanë prezantuar me Pjegamberin s.a.v.s. në bazë të kushteve dhe rrethanave të secilit prej tyre, në kohë të ndryshme të ditës e të natës, dhe që të gjithë nuk janë bashkuar që të prezantojnë në një kohë të caktuar, ashtu siç është në shkollë, në të cilën dyert hapen në mëngjes dhe mbyllen në mbrëmje dhe secili prej studentëve arrin shkallë të diturisë në bazë të aftësisë së tij. Mirëpo, secili prej sahabëve ka përfituar diçka, tjetri diçka tjetër, varësisht prej kohës, në të cilën ka qenë prezent te i Dërguari i Allahut s.a.v.s. Nëse ndonjëri prej sahabëve ka prezantuar në kohën kur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka vepruar në këtë mënyrë, ndërsa tjetri thotë se Pejgamberi s.a.v.s. ka vepruar në këtë mënyrë. Mirëpo, çështja është se Pejgamberi s.a.v.s. a ka veprua siç thotë ky sahabe, dhe nuk ka vepruar siç thotë sahabiu tjetër.

Për këtë arsye përkrahësit e dijetarëve thonë se kanë transmetuar për atë çështje se kanë prezantuar te Pejgamberi s.a.v.s. në kohëra të ndryshme. Është e mundur se kjo lejon që dispozita apo mënyra si ka vepruar i Dërguari i Allahut s.a.v.s. është dispozita apo mënyrë, të cilën Allahu e ka lejuar për

robërit që të zgjedhin, të hulumtojnë dhe të bëjnë ixhtihad për të.

Kështu pra, mendimet e ndryshme janë rezultat që Ligjvënësi i ka lënë me qëllim në ato çështje; argument për këtë kemi se Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Po të ktheheshin te Ai (Allahu) dhe te i Dërguari i Tij, si dhe te ata, të cilët janë emëruar udhëheqës për ta prej tyre, do ta kishin mësuar ata se çka ka rezultuar prej tyre".**

Kur Pejgamberi s.a.v.s. e ka përfunduar betejën "Ahzabë" dhe kur nuk i pati ndërruar ende rrobat e luftës, i thonë: shko te fisi Beni Kurejdha, mos i hiq fare rrobat e luftës, dhe bëje përgatitjen luftarake, përderisa t'i nënshtrosh dhe t'i edukosh ata. Atëherë Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: ***"Kush beson në Allahun dhe të Dërguarin e Tij, mos ta falë ikindinë pa arritur te fisi Beni Kurejdhaj".*** Pastaj, Sahabët kanë kundërshtuar mes vete: Disa kanë thënë: Namazi i ikindisë nuk lejohet askund tjetër, pos në fisin Beni Kurejdha, mirëpo gjatë rrugës, pasi dielli ishte afër perëndimit, disa të tjerë kanë thënë: I dërguari i Allahut s.a.v.s. vet ka dashur të na shpejtojë, mirëpo ne, pasi që jemi vonuar dhe nuk kemi arritur atje, duhet ta falim ikindinë me kohë. Kështu që disa e falin ikindinë pa arritur te fisi Kurejdha, ndërsa të tjerët e falin në rrugë, pasi që arrijnë te fisi Beni Kurejdha. Kështu, ky argument dëshmon se që të dy mënyrat janë të lejuara. Mirëpo, nuk ka dyshim se të gjithë dëshirojnë ta falin namazin, edhe pse kanë ndodhur mospajtime për kohë dhe vend. Kur Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë që falja të bëhet vetëm te fisi Beni Kurejdha, ai ka përcaktuar vendin. Kur të tjetër kanë parë se dielli veç do të perëndojë, para se të arrijnë në atë vend, koha kaloi në elementin kohor jo të vendit. Kështu që disa shikuan elementin e kohës, të tjerët elementin e vendit. Kur i kanë treguar Pejgamberit s.a.v.s. se si kanë vepruar, ai e ka lejuar edhe të parën, edhe të dytën.

Për këtë arsye, edhe ka qenë ixhtihadi i dijetarëve, sepse Allahu ka dëshiruar që ne të bëjmë ixhtihad. Allahu nuk ka dëshiruar që të gjitha dispozitat të jenë të padiskutueshme, e të mos i lejojë njeriut liri të ideve dhe të mendimit, e që të mos ketë dijetarë për të hulumtuar e për të bërë ixhtihadë, pasi që veç e ka lejuar ixhihadin. Shembull për këtë kemi ajetin e abdesit, kur Zoti i Lartmadhëruar thotë: **"Kur të falni namazin, pastroni fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla".**

Kur Zoti i Lartmadhëruar e ka bërë obligim pastrimin e fytyrës, nuk e ka caktuar deri ku. Parashtrohet pyetja pse? Për arsye se arabët asnjëherë nuk kanë kundërshtuar në përcaktimin e fytyrës, mirëpo dorën po. Disa mendojnë

se dorë quhet pjesa deri në unazën e shuplakës, të tjerët e quajnë dorë tërë pjesën deri në qafë, pra tërë krahun; disa të tjerë e quajnë deri në shpatulla, mirëpo Allahu ka dëshiruar deri në bërryla. Pra, kur Allahu dëshiron të përcaktojë diçka, Ai përcakton dhe i mbyll dyert e kundërshtimeve. Po nëse Allahu nuk do ta kishte përcaktuar deri në bërryla dhe secili dijetar do të bënte ixhtihad, secilit muxhtehid ne do t'i thoshim: Ixhtihadi i juaj është në rregull. Zoti i Lartmadhëruar thotë: "Lëmoni në kokat tuaja". Kështu ka kaluar prej pastrimit, i cili është përfshirja e fytyrës me ujë në mes-h (lëmim), por pa përfshirje dhe stërpikje të tërësishme. Pse Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: "Lëmoni në kokat tuaja?" Sepse po të kishte thënë: "Lëmoni kokat tuaja", nuk do të kishte pasur vend dhe hapësirë për ixhtihad.

Po të kishte dashur Allahu lëmimin e një të dytës së kokës apo një të katërtës së saj, do ta kishte thënë këtë. Mirëpo, Ai e ka përdorur pjesëzën "në", e cila lejon kuptime të ndryshme dhe secili që i jep një kuptim prej kuptimeve të shumta të pjesëzës "në", ai veç iu ka përmbajtur tekstit kur'anor.

Pra, kur dijetarët bëjnë ixhtihad, ata shikojnë në atë çka nënkupton teksti, pra në të kuptuarit e vetë tekstit.

Ndërsa, sa i përket pasimit (përmbajtjes së këtyre medhhebeve), themi: Ai i cili ka mundësi të kuptojë çdo rregull, ai të mos i përmbahet vetëm një medhhebi të caktuar, por ashtu siç e parasheh vet ai prej tekstit dhe t'i japë përparësi atij vendimi, përderisa është i aftë për të bërë ixhtihad dhe posedon mjetet e ixhtihadit prej diturisë së përfituar nga Kur'ani, si dhe diturisë së fituar nga suneti. Mirëpo, ai i cili nuk është i aftë dhe nuk ka mundësi të ixhtihadit, ai pason atë medhheb, të cilit i beson me diturinë e tij. Medhhebi i tij është medhheb i muftisë së tij, sepse kur ndonjëri e di se dikush është emëruar në post të asaj detyre, apo njerëzit e dinë se ai është i specializuar në atë drejtim, e pyet për çështjet e fesë së tij.

Mirëpo, janë paraqitur katër medhhebet dhe i kanë përfshirë të gjitha çështjet. Andaj, askush më nuk ka pasur mundësi të bëjë ixhtihad dhe e kanë pasuar vetëm një medhheb, si dhe të gjithë kanë dhënë mendim prej tekstit, në të cilin kanë bërë ixhtihad. Përderisa Ligjvënësi ka lënë hapësirë dhe vendos ligj për të bërë ixhtihad, atëherë ligji, vendimi, është prej tij dhe çdo gjë që arrin muxhtehidi është e vërtetë, si p.sh. shembulli i portokallit. Përderisa jemi pajtuar për atë që është bazë, ndërsa për sekondaren e kemi lënë të pasqaruar, atëherë atë çka e arrin muxhtehidi, është e rregullt. Vallahu teala

ealem.

BISEDA ME SHPIRTRA

Pyetje: Çka mendon Shejh Shaëraviju në lidhje me kontaktimin me shpirtra dhe shërimin me shpirtra?

Përgjigjja: Duke sqaruar Shejh Shaëraviju këtë çështje thotë: Kush i ka mësuar ata se ata janë shpirtra? A mos e dinë ata shpirtin para se t'u vijë atyre. Thonë: Këto janë shpirtra të cilat i dimë dhe i njohim.

Ata mund të thonë: Atyre u vjen një forcë e fshehtë, ndërsa shpirtra jo. Kjo është e papranuar. Më këtë çështje janë marrë njerëzit prej kohërave të lashta. Kjo veprimtari nuk ka ndodhur përnjëherë, përkundër asaj se shkencat tjera janë zhvilluar dhe kanë përparuar vrullshëm, çka tregon se ata hulumtojnë në terr dhe pa fakte, sepse hulumtimi shkencor ka nevojë për përvojë dhe eksperiencë, ndërsa kësaj veprimtarie nuk i nevojitet as përvoja, as eksperienca.

Ai, i cili thotë se kontakton me shpirtra nëpërmjet Kur'anit fisnik, ai është gënjeshtar i kulluar dhe mashtrues. E gjithë kjo arrihet nëpërmjet fallit, magjisë duke kontaktuar xhinë.

Pastaj, imami i nderuar vazhdon e thotë: Ata të cilët thonë këtë për veten e tyre dhe thonë se bisedojnë me shpirtra, shohim se janë më të vështirët, më injorantët, më të këqijtë në jetën e tyre dhe asnjëri prej tyre nuk vdes me të mira. Pasurinë e tyre e merr ai, të cilin ata nuk e njohin. Ky është argumenti më i forti se ata nuk mund t'i bëjnë dobi as vetes së tyre. Pastaj, veprimtaria e tyre me njerëz i lodh ata. Njerëzit duhet t'i dinë dhe t'i kuptojnë aftësitë e tyre dhe duhet ta dinë se Allahu e ka fshehur të fshehtën prej tyre, prej mëshirës që ka për ta. Nëse njëri e di se do t'i ndodhë ndonjë fatkeqësi, ai do të pëlcasë, do ta zmadhojë atë fatkeqësi dhe tërë jetën e tij do ta bëjë të keqe dhe të vështirë. Ai, i cili më tregon dhe më informon për një fshehtësi, të cilën nuk mund ta tejkalojë, çka përfitoj unë atëherë prej asaj informate?!

ISTIGFARI, HAXHI DHE FSHIRJA E MËKATEVE

A duhet kërkuar falje për çdo mëkat veç e veç, apo të kërkohet falje për të gjitha mëkatet në përgjithësi?

Dhe sa është e vërtetë fjala: Haxhi i fshin të gjitha mëkatet, sepse haxhiu kthehet i pastër prej mëkateve, ashtu siç ka lindur prej nënës së tij?

Përgjigjja: I nderuari Shejh Shaëraviju thotë: Jo, ai duhet të kërkojë falje për secilin mëkat veç e veç, mirëpo ndonjëherë i kujtohet gabimi, e ndonjëherë nuk i kujtohet ndonjë gabim. Atëherë kur nuk i kujtohen, kërkon falje për të gjitha gabimet. Çdo herë kur qan për ndonjë gabim, ai gabim i shndërrohet në punë të mirë dhe çdo herë kur e lëndon gabimi, apo ndien dhimbje për atë gabim dhe kërkon falje, i shndërrohet në punë të mirë. Kjo është domethënia: Allahu punët e këqija të tyre ua shndërron në punë të mira. Mirëpo, duhet ta dimë se Allahu i fal gabimet, të cilat janë bërë ndaj Tij, ndërsa gabimet, të cilat kanë të bëjnë me robërit e Tij, patjetër duhet pastruar me robërit.

Ndërsa, mëkatet, të cilat nuk i kujtohen, që i ka bërë ndaj robërve, ne e kemi mësuar se duhet të bëjë këtë lutje: "Kërkoj falje nga Allahu i madhërishëm për mua, për prindërit e mi dhe për ata, të cilëve u kam bërë padrejtësi".

MËKATET E VOGLA DHE MËKATET E MËDHA

Çka është mëkati i vogël, e çka i madhi dhe a është e mundur që mëkati i vogël të bëhet i madh ndonjëherë?

Përgjigjet Shejh Shaëraviju: Mëkat i madh është idhujtaria, pirja e alkoolit, prostitucioni, vjedhja, vrasja, mosrespektimi i prindërve, shpifja ndaj grave të ndershme, ndërsa të tjerat, përpos këtyre, quhen mëkate të vogla.

Përsëritja me qëllim dhe i vazhdueshëm i mëkatit të vogël është mëkat i madh, pra përsëritja dhe vazhdimësia. Kjo është sikurse ti të kesh vendosur për të mos e dëgjuar Allahun. Ky mosdëgjim bëhet edhe në mëkatin e vogël, i cili pastaj bëhet i madh, sepse ka kaluar prej kundërshtimit të vendimit në rebelimin e atij vendimi.

"FLETËT NUK PRANOJNË TË SHKRUHET NË TO, LAPSAT KANË PUSHUAR SË SHKRUARI DHE JANË NGRITUR"

Pyetje: Çfarë kuptimi kanë fjalët: "Lapsat janë ngritur, e fletët janë terur"?

Imami i mirënjohur, Shaëraviju thotë: *"Lapsat janë ngritur, e fletët janë terur"* ka kuptimin se çdo gjë, e cila ka për të ndodhur deri në ditën e Kiametit, është shkruar në libra dhe nuk mund të ndodhë diçka tjetër, pos ajo çka është shkruar. "Janë palosur dhe janë terë fletët" ka kuptimin se në to nuk ka për t'u rikthyer e të përmirësohet diçka, të shkruhet diçka e re, apo diçka tjetër. Mirëpo, çdo gjë çka do të jetë në ekzistencë është e shkruar në fletë, sepse Zoti i Lartmadhëruar e ka ditur se çka do të ndodhë në gjithësi. Edhe pse njeriu është i vullnetshëm, ndërsa vendimi në çështjen e vullnetit është argument për diturinë e Tij gjithëpërfshirëse, e nuk e ka kuptimin e të imponuarit, por e ka shkruar se e ka ditur se ashtu ka për të vepruar.

MJETET E MËKATIMIT

Çfarë kuptimi ka fjala e Zotit të Lartmadhëruar: "Atë ditë kur do të dëshmojnë kundër tyre gjuhët e tyre, duart e tyre e këmbët e tyre për atë që kanë punuar"?

Përgjigjja: Mëkati mund të jetë ose me fjalë, ose me vepër.

Mëkati me fjalë është mëkatimi i gjuhës. Mëkati me vepër është mëkatimi me duar, nëse ajo vepër bëhet me duar, pasi që të qëllon pranë. Nëse është larg dhe ti duhet të shkosh në këmbë, është mëkatimi i këmbëve. Këto janë mjetet e krimit dhe të mëkatit. Gjuha, duart dhe këmbët dëshmojnë kundër njeriut, edhe pse vet ato pjesë janë kryerëse (bashkëpjesëmarrëse) të drejtpërdrejtë të asaj vepre.

Në këtë botë Allahu na ka dhuruar preparatet e trupit. Ata u janë të nënshtruara dëshirave tona, veprojnë sipas dëshirës sonë; ata nuk pengojnë në kryerje të veprimit, pasi që i janë të nënshtruara dëshirës sonë. Mirëpo, në ditën e Kiametit ne nuk do të kemi mbizotërim mbi ta, që të veprojmë sipas dëshirës sonë. Dëshira kalon në tërësi te Zoti i Lartmadhëruar. Allahu na ka

dhënë trupin si mjet ndihmës tonin në këtë jetë, që të veprojmë me të çka të dëshirojmë, që të kemi kompetencë të veprojmë me ta çka të dëshirojmë, mirëpo në ditën e Kiametit askush mbi asgjë nuk do të ketë kompetencë për ta ndihmuar të veprojë çka dëshiron. Për këtë Zoti i Lartmadhëruar, në ditën e Kiametit, thotë: I kujt është sundimi sot? Vetëm i Allahut të vetëm, mposhtës dhe mbizotërues (mbi gjithçka). Kështu dëshirën e njeriut mbi pjesët ia heq, ndërsa pjesët (organet) e tij dhe preparatet pranojnë gjithçka kanë vepruar.

Dënimi nuk bie mbi këto pjesë (organe), por njeriu ndëshkohet me ta dhe atëherë ata janë mjet i ndëshkimit të mëkatimit. Shkenca bashkëkohore ka zbuluar dhe ka vërtetuar se dhimbjet nuk ndihen në vet pjesën e trupit, mirëpo në shpirt. Argument i kësaj është se njeriu ndien dhimbje në çdo pjesë të trupit, mirëpo kur mjeku e merr përsipër të sëmurin për ta operuar, ai nuk ndien kurrfarë dhimbje gjatë operimit.

NËSE JANË TË VARFËR, ALLAHU I PASURON

Cili është mendimi i Shejh Shaëravijut: Nëse dëshiroj të martohem me një vajzë, e cila i ka të gjitha ato çka dëshiron një djalë t'i ketë vajza, pra është fetare, e moralshme dhe e bukur, vetëm se ajo është e varfër, e shokët më kështillojnë që ta zgjedh një grua tjetër, që është e pasur, e cila më ndihmon me pasurinë e saj që t'i tejkaloj problemet e jetës?

Përgjigja: Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

"Dhe martoni të pamartuarat (të pamartuarit) edhe robërit e robëreshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme. Nëse janë të varfër, All-llahu i begaton nga mirësitë e Tij, All-llahu është bujar i madh, i gjithëdijshëm".(En-Nur, 32)

Pra, mos lejo që pasuria të jetë peshojë në zgjedhje të bashkëshortes, por bëje që të jetë çelës i furnizimit. Në këtë ajet Zoti i Lartmadhëruar ka treguar kushtin dhe përgjigjen kur ka thënë: "Nëse janë të varfër, Allahu i pasuron". Atë që e thotë Allahu, ajo patjetër duhet të ndodhë. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. na ka tërhequr vërejtjen për këtë, kur ka thënë: "Kush martohet me një grua që ka famë, fama e saj do t'i kundërvihet, që do të thotë: Nëse qëllimi i atij njeriu ka qenë që të martohet me një femër me famë,

që të përfitojë prej famës së saj, atëherë në mes tyre do të ndodhin pakënaqësi dhe armiqësi. E ai e ka zgjedhur në duel armikun e fortë. Kush e zgjedh femrën për pasuri dhe për të përfituar prej pasurisë së saj, do ta përjetojë se ajo do të jetë e ngritur, kryelart dhe gjithmonë e pakënaqur, e cila do ta shpjerë që të poshtërohet, për shkak të pasurisë së saj dhe pasuria e saj do t'ia helmojë dhe do t'ia shkatërrojë jetën.

Pastaj, ajeti sjell sqarimin "Allahu është i Gjerë (Gjithëfurnizues), i Pasur dhe i ditur". Ky ajet tregon se çka është më e përshtatshme dhe më e leverdishme. Përderisa fjala është për atë që ka nevojë njeriu dhe për pasuri Allahu është i Pasur. Atij kurrë nuk i pakësohet pasuria, që do të thotë se, edhe nëse supozojmë se të gjithë njerëzit dëshirojnë të martohen me vajza të varfra, premtimi i këtij ajeti do të realizohet. Allahu do t'i jepte pasuri secilit prej tyre. Mirëpo, ne nuk shohim se njerëzit e dëshirojnë këtë. Nëse një njeri i pasur u jep të tjerëve prej pasurisë së tij, ne shohim se të tjerët pikëllohen se këtij njeriu do t'i pakësohet pasuria duke iu dhënë të tjerëve.

SHERIATI DHE DREJTËSIA

Pyetje: Cili është dallimi në mes të sheriatit dhe drejtësisë?

Përgjigjje: Sheriat ka për qëllim që ti të veprosh një çështje, e cila ta heq një vështërsi. Dispozita është paralel me ty (nevojat tua). Para se ta falësh namazin, ti, në rend të parë, merr abdest, pastaj falesh. Të gjithë ne të kemi parë kur e ke kryer obligimin dhe askush nuk thotë asgjë tjetër, pos atë që ka parë. Mirëpo, a e ke falur namazin ashtu siç dëshiron Allahu prej teje, apo me atë nijet, të cilin Allahu të ka obliguar dhe ka dëshiruar prej teje? Kur ke marrë abdest dhe je falur, ti i ke kryer në bazë të normave të sheriatit dhe në bazë të formës së kërkuar në namaz. Mirëpo, qëllimi yt a ka qenë të kryerit e një obligimi ndaj Allahut, apo vetëm që të proklamohesh? Drejtësi është ta respektosh dhe t'i kryesh normat e sheriatit dispozitivisht dhe ashtu qysh kërkohet, që qëllimi të jetë i kryer ashtu siç ka dëshiruar Ligjëvënësi.

Sheriati është kryerja e obligimeve në aspekt të jashtëm (formalisht), ndërsa drejtësi është ta kryesh në aspekt të brendshëm (esencialisht). Drejtësia është sekret mes robit dhe Zotit të tij? A i kryen ashtu siç ka ligjësuar dhe siç

ka dëshiruar Allahu, apo ai dëshiron ta kryejë vetëm formalisht. Pra, drejtësi është të arrish në bërthamë të obligimit dhe të thuhet ajo çka është ligjësuar, e nëse nuk është arritur qëllimi i atij ligjësimi, është hipokrizi. Në kohën e pejgamberit s.a.v.s hipokritët janë ulur në rreshtat e parë; ata, nga aspekti sheriatik i kanë kryer obligimet, ndërsa e vërteta ka qenë krejt ndryshe.

Pra, drejtohu në kryerjen e obligimeve të Allahut, ashtu siç do Allahu dhe ashtu siç e ka paraparë, e jo ashtu siç veprojnë të tjerët; edhe ti të veprosh si ata, sikurse një kryetar i përpiktë në punën e tij, i cili ka ndaluar të ngrënit e të pirit gjatë orarit të punës dhe për çdo thyerje të rregullit ka paraparë dënime. Pastaj, shohim punëtorin që vjen në kohë, i përmbahet të gjitha rregullave të parapara. Ai u është përmbajtur rregullave nga aspekti i jashtëm dhe formalisht, e jo në esencë, pra kryerjen e punës, e cila kërkohet prej tij. Kështu pra, sheriati është forma e jashtme e adhurimit, ndërsa e vërteta është qëllimi i Ligjëvënësit. Ai i cili i përmbahet sheriatit, ai mund të mashtrojë njerëzit, por nuk mund të mashtrojë Ligjëvënësin. Për këtë arsye, ai i cili i përmbahet formalisht sheriatit, prej tij nuk dalin rrezet e shkëlqimit, ndërsa ai i cili përmbahet thelbësisht, ai shkëlqen, prej tij burojnë rrezet e dritës.

IMANI DHE EPSHI

Imani ndikon drejtëpërsëdrejti në edukimin shpirtëror dhe të ndjenjave të brendshme. Cili është roli i tij? A nuk bien në konflikt në mes vete kërkesat e epshit njerëzor, besimit dhe karakterit të lartë të tij? A nuk është ky faktor permanent për t’i dalluar njeriu se cilat janë kërkesat e trupit dhe cilat janë kërkesat e shpirtit.? Shpresojmë që Imami i mirënjohur do të na sqarojë, që të na qetësohet mendja.

Përgjigjje: Imani është çështja, e cila dirigjon, i organizon dhe i ngrit ndjenjat, e nuk çrrënjos, sepse po të ishte ashtu, atëherë do të bëhej pyetja: pse Allahu i ka krijuar ndjenjat? Pra, ndjenjat e kanë rolin e tyre, e islami nuk e bën që besimtari të ketë zemër të vdekur, ashtu që të përqëndrohet vetëm në një çështje. Çështja e vetme, të cilën e kemi përmendur edhe më herët, është t’i nënshtrohet Allahut dhe t'i dorëzohet programit të Allahut, e pas kësaj nuk e gurëzon, por Ai i dëshiron t'i ketë ndjenjat, e ato ndjenja t'i lartësojë, por

tjetërkush mos t'ia dëmtojë. Ia ndrit ndjenjat për të pasur pasuri dhe për ta udhëhequr atë, e askush tjetër mos ta okupojë. Ia ngrit ndjenjat e epshit për t'u martuar, që shoqëria të jetë e pastër dhe e ndershme. Ia ngrit ndjenjat për të kërkuar forcë, që të mos të jetë i nënshtruar. Ia ngrit ndjenjat për të kundërzbuluar, që të mos jetë i spiunuar dhe për t'u mos u ndjekur të metat e njerëzve. Pra, për çdo ndjenjë prej ndjenjave të njeriut Islami është për ta zhvilluar, e jo për ta ngurtësuar, sepse zhvillimi i ndjenjave e ka rolin e tyre. Kur njeriu e shikon këtë çështje, beson se është nje fuqi më e lartë se ai, e cila e ka organizuar këtë çështje, sepse ajo është fuqi absolute. Është ajo, e cila më ka krijuar, e cila më ka pajisur me fuqi. Kur njeriu ballafaqohet me ndonjërën çështje të tyre, nuk do të thotë që ai të qëndrojë i plogësht, por t'i thuhet atij: Ndonjëherë bëhu i rreptë, ndonjëherë i mëshirshëm. Pra, fuqinë e tij ai nuk e përdor gjithmon me fuqi absolute, por as me mëshirë, sepse po të ishte vetëm i fortë e i rreptë, e ka raste kur nevoja e kërkon mëshirësinë, po të ishte vetëm i lartë e i ashpër, e ka raste kur nevoja kërkon butësi, po të kishte vetëm një lloj të cilësisë, ateherë do të kishte qenë i penguar të ketë cilësi tjetër, e cila është e rëndësishme në jetën e tij.

Zoti i Lartëmadhëruar thotë: "Të butë për besimtarët, të fortë e të ashpër për pabesimtarët." Pra, ata kanë element, nëpërmjet të cilit mund të jenë të fortë, por edhe element tjetër, me të cilin mund të jenë të butë. Por, kur do të jenë të fortë, e kur të butë? Kjo është në kompetencën e të drejtës së tyre. "Bëhuni të butë për vëllezërit tuaj besimtarë dhe të fortë për pabesimtarët." "Të fortë për pabesimtarët, të mëshirshëm mes vete".

Pra, Islami nuk krijon besimtarë vetëm të një lloj cilësie, sepse secila cilësi e ka rolin e vet. Patjetër duhet të ekzistojë fuqi mposhtëse, intelekte dhe urtësi, të cilat i vënë në binarë këto çështje.

GJUHA, ARGUMENT PËR ARGUMENTIMIN E EKZISTIMIT TË ALLAHUT

Pyetje: A mund të jetë gjuha argumentim për ekzistimin e Allahut?

Përgjigjje: Përderisa të gjitha argumentet, si argumentimi logjik, argumentimi shoqëroro-historik, argumenti i ekzistimit të vet njeriut, janë argument se ekziston një forcë më e lartë. Është edhe një çështje tjetër, e cila rrallë dëgjohet dhe rrallë flitet për të. Unë habitem se si argumentuesit nuk e kanë marrë këtë argument për ekzistimin e Zotit, përderisa është argument. Po, për të gjithë popujt, për të gjitha mendjet, për të gjitha kategoritë e njerëzve. Argumentimin gjuhësor nuk mund ta mohojë askush. Besimi në Zotin është domosdoshmëri gjuhësore. Gjuha është dukuri e kërkuar e njeriut për të jetuar në shoqëri, sepse në shoqërinë civilizuese, normalisht është domosdoshmëri të ketë gjuhë, me të cilën kuptohen. Po të ishte vetëm një njeri, nuk do të kishte pasur nevojë për gjuhë (të folurit). Çdo gjë që i kishte shkuar ndërmend, e kishte vepruar. Mirëpo ai, në raport me të tjerët, patjetër duhet t'i përcjellë idetë e tij te të tjerët dhe të dëgjojë idetë e të tjerëve. Pra, gjuha është e patjetërsueshme. Kjo gjuhë e ka rolin e saj që të kuptohemi me të.

Ne nuk mund të kuptohemi në mes vete pa gjuhë, e ajo gjuhë të jetë që folësi dhe dëgjuesi të pajtohen mes vete në kuptimin e fjalëve. Pra, është domosdoshmëri, sepse, nëse folësi e thotë një fjalë, e dëgjuesi nuk e di kuptimin e asaj fjale, nuk arrihet te rezultati. Kjo do të thotë se, nëse një njeri vjen dhe flet gjuhën arabe, mund ta dijë dhe ta flasë çdo fjalë të kësaj gjuhe, e dëgjuesi ta kuptojë çdo fjalë të tij. Përkundrazi, duhet të dihet kuptimi i fjalës para se të flitet, në rend të parë, e pastaj vjen fjala, e cila është arabe. Mirëpo, ai nuk kupton asgjë. Të gjithë dimë për literaturën e gjuhës dhe të letërsisë.

Ne e dimë rastin e një personi, i cili ka sfiduar gjuhtarin e specializuar të quajtur ALKAM, duke iu drejtuar më fjalë të rralla (të panjohura). Kush është ai i cili ua ka mësuar atë nivel që ta kuptojë? Ebu Alkame, edhe pse ishte gjuhëtar, është tronditur dhe nuk ka kuptuar asgjë prej atyre fjalëve. Ebu Alkam zgjohet në mesnatë, e thërret djaloshin dhe i thotë: O djalosh: Këtë djaloshi e ka kuptuar, por kur i thotë: "*Escakte Tearifë"* këtë çështje nuk e ka kuptuar. Mirëpo, djaloshi dëshiroi që t'i japë një mësim Alkames. Për ta sfiduar, sepse ai për së tepërmi krekosej, ia kthen: "*Dhekialijmë"*. Ndodhi për

herë të parë që Alkame të habitet dhe nuk e kuptoi çfarë kuptimi ka kjo fjalë. Dhe i thotë: O djalosh.

NGJYRA E ADEMIT A.S.

Pyetje: Ku ka jetuar Ademi a.s., çfarë ngjyre ka pasur; të bardhë, të zezë apo të kuqrremtë dhe si janë ndarë popujt që e kanë një burim prej Ademit a.s.? Shpresojmë se do të na përgjigjeni.

Përgjigjja: Kësaj pyetjeje mund t'i përgjigjemi me një fjalë: dituri e padobi, mosdituri e padëmshme. Po të kishte qenë e nevojshme për mua, Allahu nuk e kishte lënë pa e sqaruar. Pra, ky është vetëm mendim dhe pyetje prej së cilës nuk mund të arrihet te ndonjë rezultat. Kundërpyetja do të ishte: Po ta kishte ditur, çka do të përfitoje prej saj? Çdo çështje, të cilën nuk e di, është bërë me qëllim që ti mos ta dish. Ai, i cili më ka mësuar për krijesat dhe njerëzit është Allahu, e atë që nuk ma ka mësuar, sikur nuk është e nevojshme për mua. Sa i përket racave, ne e dimë shumë mirë ndikimin e diellit, lagështise së ajrit në një shoqëri dhe në një mes, të cilët banojnë në një vend, dhe si ka ndikuar në ndarjen e racave njerëzore, në të zi, të bardhë, të verdhë etj. Allahu e di më së miri.

DISA I KEMI DALLLUAR SHUMË ME GRADA TË LARTA

Pyetje: I nderuari Imam, çfarë kuptimi ka ajeti: **Ne i kemi ngritur disa në shkallë më të lartë se të tjerët, që të shfrytëzojnë njëri-tjetrin në shërbime.** Çfarë ndërlidhje ka ky ajet me ajetin, i cili thotë: **Mos të tallet një njeri (apo populll) në atë mënyrë, sepse ata janë më të mirët prej tyre?** A ka ndonjë çështje, e cila i bashkon këto dy ajete? Shpresojmë se do t'na sqaroni. Ju falënderojmë.

Përgjigjje: Ti jeton në shoqëri. Nevoja jote për individët e shoqërisë është e njëjtë, sikur edhe nevoja e individëve të shoqërise për ty. Nëse dëshiron që shoqëria t'i kryejë obligimet dhe të plotësojë nevojat për ty, mos kërko të drejta prej shoqërisë, pa i kryer obligimet tua ndaj shoqërisë. Për këtë

arsye pejgamberi s.a.v.s ka thënë: ***Shembull i besimtarëve në dhembshuri mes vete dhe mëshirësi e butësi mes vete, si shembull i një trupi të vetëm.*** Mos konsidero veten si tërësi e pavarur prej shoqërisë. Islami kërkon nga ti që ta konsiderosh veten pjesë të tërësisë.

Përderisa pjesa është në tërësi atëherë pjesët kanë nevojë për njëra-tjetrën, për ta kompletuar tërësinë. Pejgamberi s.a.v.s ka dëshiruar që çështjen personale në shoqëri ta bëjë çështje të tërësishme dhe çështjen e personave të shoqërisë të pjesërishme. Parashtrohet pyetja: pse? Për të mos menduar askush se mund të jetë i vetmuar dhe i pavarur ndaj shoqërisë. Për këtë arsye ka thënë: ***Sikurse një trup, që kur të lëngojë një pjesë, të gjitha pjesët e atij trupit rënkojnë dhe ndiejnë dhimbje.*** Nëse ti e shikon shoqërinë, e sheh se shoqëria kërkon aktivitet jetësor, ndërsa aktiviteti i jetës nuk është vetëm i një natyreje. Shoqëria kërkon aktivitet të shumëllojshëm dhe që t'i mbulojë të gjitha nevojat. Shoqëria nuk dëshiron që të gjithë të jeni mjek, ose të gjithë ekonomist, ose të gjithë gjykatës, e as që të gjithë të jenë elektricistë, sepse shoqëria nuk duhet të jetë vetëm e një drejtimi, por e të gjitha drejtimeve. Zoti i Lartëmadhëruar *dëshiron* që të gjithë individët e shoqërisë të jenë një trup, ku secila pjesë e atij trupi ta kryejë detyrën e vet. Kështu, edhe jeta e çdo individi të ketë detyrë të posaçme. Ndonjëherë individi mund të zgjerohet dhe të ketë prirje për kryerjen e detyrave të shumta. Atëherë, ai mbulon një sektor prej sektorëve të shoqërisë. Shoqëria nuk zhvillohet nëse zhvillohet vetëm në një drejtim. Përderisa shoqëria nuk zhvillohet vetëm në një drejtim, atëherë edhe dhuntitë duhet të jenë të llojllojshme. Patjetër duhet të shpërndahen ndjenjat dhe prirjet, patjetër duhet të shpërndahen punët dhe vullnetet për punë. Mëshira e Zotit është se na ka dhënë dhunti të llojllojshme dhe vullnete të llojllojshëm të drejtimeve. Ky ka vullnet për këtë, tjetri për atë, ky dëshiron këtë, e tjetri atë etj. dhe kjo pa u planifikuar prej njeriut. Pra, është çështje instiktive te çdo njeri veç e veç.

Nuk ka qytet prej qyteteve që të tubohen të gjithë e të thonë: Ky qytet ka nevojë për kaq shitore, për kaq tregëtarë të mëndafshit, për kaq rrojtore, për kaq mjekë, për kaq avokatë. Këtë askush nuk e ka thënë dhe muk është bërë një planifikim i tillë. Mirëpo, ne shohim se dhuntitë vijnë vetvetiu. Secila dhunti për një çështje vjen pa planifikuar prej askujt, për të mbuluar nevojat jetësore, pa menduar askush. Po, nëse njeriu dëshiron të hyjë në ato çështje me mendjen e tij, do të ishte çrregulluar. Për këtë arsye duhet shikuar në profesionistin në shoqëri, e jo në profesione, sepse nuk ka punë më të mirë se

puna e tjetrit, por puna profesionale më e mirë se puna e tjetrit të të njëjtit profesion. Pra, secila punë mbulon një hapësirë prej hapësirave të jetës, e cila kërkohet. Njeriu i sinqertë duhet ta marrë të drejtën, vlerën dhe nderimin e tij në ekzistencë, e jo atë të cilën ia zgjedh dhe ia imponon njeriu. Kjo është veprimtaria (profesioni) e lehtë, madhështore dhe fisnike, ndërsa veprimtaria (profesioni), të cilën ia zgjedh dhe ia imponon njeriu, është e poshtër dhe nënçmuese. Këto çështje nuk ekzistojnë në fe, por ekziston punëtor i këtij profesioni, apo punëtor i atij profesioni. Vlera e secilit prej tyre varet praj asaj si e kryen, me ndërgjegjje dhe përsosmëri, sepse punëtori profesionist kryen një pjesë prej pjesëve të jetës, e kjo është domosdoshmëri. Çdo njeri ka nevojë për tjetrin. Për këtë arsye, kur Kur'ani thotë: "**Mos të tallet një njeri (apo një popull) në atë mënyrë se ndoshta ata janë më të mirë prej tyre." (EL-HUXHURAT, 11).** Nuk e thotë: Sepse kur një njeri nënçmon tjetrin, ai e ka nënçmuar veten dhe është nënçmuar prej vet atij; sepse ai sheh një pjesë prej pjesëve, e nuk i ka parë pjesët tjera. Kur'ani thotë: Mos e nënçmo atë, sepse për atë ndoshta ajo është dhunti e tij, apo ka profesion i cili është i nevojshëm dhe më i vlefshëm për ty. Nëse e sheh një njeri, i cili ka të njëjtin profesion si tëndin, por është më i dobët, ti kërkoje dhe hulumtoje çfarë profesioni të përkryer tjetër ka ai njeri për ta mbuluar mangësinë, të cilën e ka në atë profesion. Atëherë patjetër duhet të jetë një përsosmëri në një çështje për t'ia mbuluar mangësinë në tjetrën, e patjetër duhet që unë të kem mangësi në atë profesion, për ta kompenzuar atë përsosmëri, sepse askush nuk është djalë i Zotit, por për Allahun që të gjithë ne jemi të barabartë. Për këtë arsye gabojnë ata, të cilët i ndajnë njerëzit në kategori. Në Islam nuk ka kategori të njerëzve, por ka profesione dhe veprimtari të njerëzve; secili kryen një sektor të punës së tij. Islami e vlerëson punën e çdonjërit, i cili e kryen me nder, përgjegjësi dhe me përsosmëri. Për këtë arsye ne shohim se njeriu autoritativ, i ngritur dhe i pasur, kur hyn në shtëpi dhe ndien erë të keqe, pyet për arsyen e asaj ere të keqe, e i tregojnë se gypat e kanalizimit janë mbyllur,ose për ndonjë arsye tjetër, e ai thotë: Pse nuk e sillni mjeshtrin e gypave të kanalizimit? Ata përgjigjen: Nuk e dimë se ku është. Ai, me gjithë famën dhe autoritetin e tij, del për të kërkuar mjeshtër. Mirëpo, kur ta takojë dhe i thotë që t'ia rregullojë gypat e kanalizimit, mjeshtri ia kthen: Nuk kam kohë se jam i nxënë, sepse ai mundohet menjëherë ta mashtrojë me të holla. Pra, këtu njeriu me famë ka rënë në pikën ku nuk mund ta rregullojë, e shkon te ai i cili ia rregullon. Për këtë arsye Zoti i Lartëmadhëruar ka thënë: "**Ne kemi ngritur**

disa në shkallë më të lartë se të tjerët, që të shfrytëzojnë njëri-tjetrin në shërbime." Nuk duhet ta marrim sipërfaqësisht këtë çështje ashtu që ne të mos merremi me asgjë. Nuk duhet ta kuptojmë se çdo njeri është i ngritur ndaj tjetrit vetëm për shkak të pasurisë. Jo! Por, çdo individ në shoqëri është i përulur edhe i lartësuar. Individi në shoqëri është i përulur me atë aftësi dhe mjeshtëri, të cilën e disponon, por edhe secili prej nesh është i çmuar për diçka tërë jetën. I çmuari e konsideron jo të çmuar në profesionin dhe veprimtarinë e tij çdo individ, pra a nuk do të thotë kjo "që ta konsideroni njëri-tjetrin të nënçmuar?" Këtë nuk duhet ta marrim një kategori njerëzish ndaj një kategorie tjetër. P.sh. Dijetari ia ka kushtuar tërë jetën diturisë, ai njëzet vjet ka shfletuar libra për të nxjerrë në dritë një ligj prej ligjeve të Allahut. E pasi të arrijë nivelin e duhur të diturisë, derisa ai është në rrugë, i vjen një kalimtar dhe e pyet për ndonjë çështje e ai i përgjigjet. Pyetësi mendon se ai është përgjigjur kalimthi. Aty për aty i ka ardhur aftësia për të dhënë përgjigjje, mirëpo po ta dinte se ai dijetari njëzet vjet ka lodhur veten e tij, që të tubojë material për t'i dhënë përgjigje asaj çështjeje, ai në çastin e pas njëzet viteve do ta kishte konsideruar veten të nënçmuar para atij, i cili posedon vetëm një profesion, ndërsa njerëzit tjerë posedojnë profesione tjera. Kështu, në profesionin që e ka, të cilin e zotëron mirë dhe ka përvojë, ai është i ngritur dhe i çmuar me të. Ai është nënçmues në shërbim të tjerëve, të cilët nuk e kanë këtë dhunti. Po ashtu, edhe të tjerët kanë dhunti tjera, të cilat janë të dobishme, kështu që dhuntitë kompletojnë tërësinë e jetës, me fjalë të tjera, kompletojnë njëra-tjetrën. Pra, ky është mbizotërues në këtë, tjetri mbizotërues në atë. Për këtë arsye edhe Kur'ani e ka theksuar preciz: **"Ne kemi caktuar ndër ta gjendjen dhe mënyrën e jetës në këtë botë; Ne kemi ngritur disa në shkallë më të lartë se të tjerët, që të shfrytëzojnë njëri-tjetrin në shërbime".(ZUHRUF-32)**

Çka do të thotë: dhe ne kemi ngritur? Disa dinë çka nuk dinë të tjerët, e këta nuk dinë çka dinë ata? Pra, çdo njeri është i ngritur për diçka dhe jo i ngritur për diçka. Po të ndodhë që në një sektor të shoqërisë të përmbushet numri i profesionistëve, e pastaj të vijë edhe një tjetër, atëherë bëhet një analizë për secilin profesionist veç e veç dhe çdonjërit i jepet shkalla e aftësisë. Atëherë shuma e të gjithëve është e barabartë me aftësinë e çdo njeriu, mirëpo dallimi dhe ndryshimi qëndron në përsosmërinë e atij profesioni. Kështu, shoqëria harmonizohet e nuk çrregullohet; kështu bëhet bashkëpunimi dhe këmbimi i përvojave të kundërta. Po të kishim qenë të

gjithë njerëz të një profesioni, atëherë ata do ta largonin dhe dëbonin njëri-tjetrin. Mirëpo, ja, unë kam nevojë për ty, ti ke nevojë për mua, që të dy ne kemi nevojë për të tjerët. Pra, është bërë ndërlidhmëria e nevojave ose e ambicieve, ose pasurive, të cilat ekzistojnë te njerëzit dhe të cilat janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, sepse pamundësinë dhe paaftësinë e këtij e kompleton mundësia dhe aftësia e tjetrit. Pra, duhet që të ekzistojë rotacioni i edukimit, sepse njeriu është njësi e rotacionit në shoqëri. Kjo njësi (ky individ) patjetër duhet ta ketë veçorinë e tij. Mirëpo, dëshira duhet të jetë prej meje. Dëshira duhet të përputhet me arritje të përsosmërisë së asaj dhuntie në punë. Mirëpo, kur puna nuk arrin në përkryerjen e asaj dhuntie, atëherë unë nuk e dëshiroj. Për këtë arsye, kur puna e kryer harmonizohet me dhuntinë, atëherë vjen dëshira për atë punë. Pra, peshorja kryesore, me të cilën duhet të dallohemi dhe të matemi, është "Nuk ka dyshim se më i fisnikëruar dhe më i nderuar prej jush te Allahu është më i devotshmi". E pas kësaj, Allahu na kalon neve në çështjen prej vëllazërisë së besimit në vëllazërinë njerëzore. E kjo, po ashtu, duhet të jetë veçori kryesore në edukim dhe arsimim.

URTËSIA E BOTËS TJETËR

Pyetje: Dita e botës tjetër është ditë e llogaritjes për ditën e kësaj bote. **"Dhe, kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë." (SURETU-ZELZELE, 8)**

Këtë po e dimë, mirëpo a ka urtësi tjetër, të cilën ne nuk e dimë për çështjen esenciale të botës tjetër? Shpresojmë se Imami me famë do të na përgjigjjet për këtë. Zoti e shpërbleftë me të gjitha të mirat!

Përgjigjja: Çështja e botës tjetër dhe e ditës së gjykimit është çështje e Imanit dhe besimit se ti do ta takosh Allahun dhe do të të marrë në pyetje. Besimtarit kur t'i vijë vdekja, shpirti i tij është i qetë dhe i bindur. Parashtrohet pyetja: Pse? Për arsye se ai e di se do ta takojë Allahun dhe do të japë përgjigjje para Tij. Ndërsa, pabesimtari, kur të jetë para vdekjes, i tronditet shpirti, zemra e tij i mbushet me frikë dhe trishtim. Parashtrohet pyetja: Pse? Sepse ai në brendi, në vetvete, e di se do ta takojë Allahun, mirëpo dëshiron ta fshehë realitetin, të cilin do t'ia zbulojë vdekja. Po mos të

kishte qenë Allahu i Lartëmadhëruar sundimtar i ditës së gjykimit, atëherë njeriu i drejtë nuk do të kishte mundur as të lëvizë në këtë jetë. Pse? Sepse, nëse aktiviteti yt iu kishte përmbajtur programit, do t'i kishte sjellë dobi tjetrit, i cili nuk i përmbahet atij programi, e ti nuk do të kishe pasur dobi në botën tjetër. Pra, ti ke gabuar, sepse tjetri e ka kundërshtuar Allahun dhe ia ka kthyer shpinën Allahut. Po mos të kishte qenë Allahu i Lartëmadhëruar sundimtar i ditës së gjykimit, atëherë kjo botë do të kishte qenë botë ku të fuqishmit do t'i shkelnin të dobëtit dhe të padrejtit do të mbizotëronin ndaj të drejtëve. Mirëpo, Zoti i Lartëmadhëruar të qetëson, kur thotë: "Unë jam sundimtar absolut i ditës së gjykimit. Qetësohu, e mos u brengos". Kjo është arsyeja dhe urtësia pse është dita e botës tjetër, e cila është çështje esenciale e drejtësisë së kësaj bote. Ajo është dita e të sqaruarit të të drejtës ndaj të padrejtës, në mes të besimtarit dhe pabesimtarit, në mes të mirit dhe të keqit, në mes të fjalës së drejtë e të vërtetë dhe fjalës së padrejtë e gënjeshtrës, dita, në të cilën Allahu askujt nuk i bën padrejtësi. Lusim Allahun që atë ditë ta bëjë të dobishme dhe të bekuar për ne, ditë të mirë të përfundimit të punëve tona dhe ditë të mirë të takimit tonë me Të. Amin.

PËRKUJTONI TË MIRAT E TË VDEKURVE TUAJ

Çka do të thotë "Përkujtoni të mirat e të vdekurve tuaj? Dhe cila është urtësia gjatë kësaj duaje, e melaqet thonë: "Amin"?

Përgjigjje: Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë: Qëllimi i lutjes "Përkujtoni të mirat e të vdekurve tuaj" është që dëgjuesi mos të dëgjojë se ndonjëri ka vepruar keq, e ai ta marrë si shembull, pastaj edhe vet vepron keq. Por, kur t'ia përmendim vetëm të mirat ndonjë personi, i cili ka vdekur, atëherë dëgjuesi i merr shembëlltyrë vetëm veprat e mira dhe i vepron ato. Mirëpo, kur njeriu dëgjon se i vdekuri ka vepruar edhe keq, edhe mirë, atëherë ai nuk mund ta paramendojë veten e tij që të veprojë keq, pasi që ai mendon se të gjithë njerëzit bëjnë keq, e nuk është i vetmi ai, i cili bënë keq. Mirëpo, kur të dëgjojë vetëm vepra të mira, atëherë në mendjen e tij përqëndrohet ideja se e mira është duke dominuar. Ndërsa, sa i përket pjesës: melaqet thonë "Amin", gjatë asaj lutjeje, melaqet bëjnë dua për punët e mira.

Zoti i Lartëmadhëruar thotë: **Ai është i cili ju bën mirë juve (ju bekon) dhe, po ashtu, edhe melaqet (luten dhe ju bekojnë juve).** Kështu, melaqet vazhdimisht janë në kontakt me ne, e duaja e tyre është që të jemi mirë ne. Për këtë arsye thuhet: Asnjë ditë nuk lind dielli, e që dy melaqe mos të të jenë pranë; njera të thotë: O Zot, shtoja pasurinë atij që jep, e tjetra: O Zot, zvogëloja pasurinë atij që nuk jep.

Pra, kur melaqja thotë: O Zot, shtoja pasurinë atij që jep, kuptohet se është lutje për të, por si të lutë për dorështrënguarin, që t'iu falen gabimet, kur dihet se melaqet luten vetëm për mirësi?

Nëse shikojmë të vërtetën, kuptojmë se melaqja, kur thotë: O Zot, shtoja pasurinë atij që jep, është lutur për mirësi, sepse ai ka vepruar mirë. Ndërsa, atij, i cili nuk jep, melaqja ia siguron dhe ia ruan pasurinë e tij, sepse është lutur për t'iu zvogëluar pasuria, e mos t'i ndodhë fatkeqësi, e kjo është lutje e mirë për të dhe themi: Ju mendoni se ai është lutur keq për të, e jo mirë për të. Por, melaqja është lutur që e mira të shpërblehet me të mirë. Njerëzit duhet ta shikojnë patjetër fundin e rezultatit, e jo vetëm fillimin. E fundi i rezultatit, a është në këtë botë a në botën tjetër?

PËRPARËSIA E BURRIT NDAJ GRUAS

Pyetje: Zoti i Lartëmadhëruar thotë:

"Burrat janë përgjegjës për gratë, ngase All-llahu ka graduar disa mbi disa të tjerë dhe ngase ata kanë shpenzuar nga pasuria e tyre. Prandaj, me atë që All-llahu i bëri të ruajtura, gratë e mira janë respektuese, janë besnike ndaj të fshehtës. E, ata që ua kanë drojën kryelartësisë së tyre, këshilloni, madje largohuni nga shtrati, (e më në fund) edhe rrahni (lehtë, nëse nuk ndikojnë këshillat as largimi), e nëse ju respektojnë, atëherë mos u sillni keq ndaj tyre. All-llahu është më i larti, më i madhi".(EN-NISA 3,4)

Çka do të thotë: përparësi e burrit ndaj femrës? A mos do të thotë kjo se Allahu e ka vlerësuar apo e ka ngritur mashkullin ndaj femrës?

Përgjigjja: Imami i mirënjohur, Shejh Shaëraviju, thotë:

Nëse thuhet se filani ka marrë përsipër çështjet e filanit, çka do të

thotë? Kjo do të thotë se njëri është ulur, e tjetri në këmbë. Kuptimi: përparësi ndaj grave është se ato janë të ngarkuar që të përkujdesen ndaj tyre dhe angazhohen që të jenë në shërbim të tyre për çdo çështje. Pra, përparësi do të thotë detyrë dhe obligueshmëri e burrit.

Ndërsa, pjesa e ajetit: Me atë çka Allahu ka dalluar disa prej disave. Nuk është ashtu, siç mendojnë disa, se Allahu i ka dalluar meshkujt prej femrave, sepse, po të kishte dashur Allahu ashtu, do të kishte thënë: "Me atë çka Allahu i ka dalluar burrat prej grave". Por, ka thënë: "Me atë çka Allahu i ka dalluar disa prej disave". Kjo do të thotë se e ka përdorur termin "disa prej disave", pra të papërcaktuar. Pra, kuptimi i ajetit është se "përparësia" është çështje, e cila obligon angazhim dhe mund më të madh në anën e burrit për të siguruar pasuri përballë asaj, sepse ajo (femra) ka vlerë dhe dallohet në anën tjetër, e ajo është se femra ka rol, të cilin mashkulli nuk mund ta ketë. Pra, ajo është dalluar prej tij, ngaqë mashkulli nuk mbetet shtatëzënë, nuk lind, nuk ka menstruacione. Për këtë arsye në ajet Zoti i Lartëmadhëruar ka thënë: **Dhe mos lakmoni atë që Allahu e ka dalluar me diçka ndaj tjetrit.** Kujt i është drejtuar më këtë fjalë? U është drejtuar të gjithëve. Edhe në këtë pjesë të ajetit Zoti i Lartëmadhëruar ka treguar vlefshmërinë e disave ndaj disave, që do të thotë se disa janë më të dalluar se të tjerët. Nuk mund të bëhet krahasimi në mes të dy personave, të cilët kanë role dhe veprimtari të ndryshme, por krahasimi bëhet në mes të roleve dhe veprimtarive, e nëse bëhet ai krahasim, atëherë shohim se ata dy janë të kompletuar si tërësi e përbashkët. Mashkulli ka përparësi në angazhim dhe mundim, ndërsa simpatia, dhembshuria mungojnë te ai, për arsye se ai është i preokupuar me çështjet e tij. Për këtë arsye Zoti i Lartëmadhëruar e ka rezervuar femrën që ta kryejë rolin dhe detyrën e saj. Nuk e ka ngarkuar me obligim për t'ia marrë kohën në punë të rënda, të cilat mund t'i kryejë tjetri në vend të saj.

Ligjëvënësi na ka vërtetuar neve se si mashkulli duhet t'i ndihmojë femrës. Pejgamberi s.a.v.s. kur ka hyrë në shtëpi dhe ka parë familjen se është angazhuar në diçka, i ka ndihmuar, gjë që tregon se roli dhe detyra e gruas është rol i rëndësishëm dhe që burri duhet t'i ndihmojë asaj.

Femra bashkëpunon dhe vepron me llojin më të përsosur, pra me njeriun, sepse ajo edukon njeriun, i cili është udhëheqës në ekzistencë, ndërsa vepron me sendet e ngurta, me dheun, bimët, gurët e me shtazët.

TRASHËGIMIA PARA VDEKJES

Një grua, para vdekjes, ka lënë testament ta trashëgojë tërë pasurinë e saj një e afërt e saj. A lejohet një gjë e tillë me sheriatin Islam?

Përgjigjja: Shejh Shaëraviju thotë: Më së shumti përfitohen atëherë kur lënë vasijet te ndonjëri prej të afërmëve (trashigimtarë), i cili vendim ua merr të drejtën legjitime, e kjo është gjë e urrejtur, sepse nuk lejohet t'ia ndalosh të drejtën e trashigimisë një njeriu, të cilën të drejtë ia ka lejuar Allahu. Përderisa Allahu ia ka lejuar, ai është i afërti nga të tjerët. E, nuk lejohet të lësh vasijet (testament) më shumë se një të tretën e pasurisë së tij. Ndërsa, dy të tretat janë e drejtë e Allahut dhe duhet vepruar ashtu si ka dëshiruar Ai dhe si i ka paraparë Ai normat e trashëgimisë.

Zoti i lartëmadhëruar thotë: **Baballarët tuaj dhe fëmijët tuaj; asnjëri prej jush nuk mund ta dijë se cili prej tyre është më i afërt dhe më i dobishëm. Obligim prej Allahut.**

Pasurinë time nuk ia lë atij që e dua, por atij që Allahu ka dashur t'ia japë. Përderisa njeriu ka ardhur në këtë botë dhe nuk ka pasur asgjë më vete, ashtu Allahu e merr, pa i lënë asgjë më vete, e ai nuk ka të drejtë në pasurinë e tij më shumë se në një të tretën, ndërsa pjesën tjetër ia lë atyre, të cilëve u takon. Po ashtu, duhet që një e treta të jetë testament për jotrashigimtarët. Nëse i lihet testament trashigimtarit në atë pjesë, patjetër duhet të pajtohen që të gjithë trashigimtarët.

ZGJEDHJA E BASHKËSHORTES

Në kohën e sotme, pra në kohën bashkëkohore, i riu ballafaqohet me vështërsi në shumë çështje, e prej tyre është martesa me vajza të pasura, me qëllim që të përfitojë jetë luksoze. Ai as që brengoset dhe nuk ia vë veshin karakterit shpirtëror dhe fetar, sepse ai shikon vetëm nga këndi i lumturisë në këtë botë. Për këtë arsye veprimet e tilla dështojnë plotësisht, sepse dita-ditës, në vend se ditët të shkojnë në favor të jetës së tij, ato shkojnë në disfavor të jetës së tij. Ky veprim është i gabueshëm në llogaritje, është veprim i palogjikshëm dhe veprim i mendjes së pazhvilluar. Ata, edhe pse arsyetohen për këtë, duhet patjetër të shikojnë në aspektin fetar dhe moral para çdo

çështjeje.

Për këtë Shejh Shaëraviju thotë: Mos e bëjë pasurinë peshojë të bashkëshortësisë. Kjo është këshillë e të rinjve dhe e djemve të sotëm. Kjo është këshilla më e mira dhe më e shtrenjta. Pastaj Shejh Shaëraviju vazhdon duke treguar ajetin e librit fisnik ku Zoti i Lartëmadhëruar thotë: **Dhe martoni të pamartuarat (të pamartuarit) edhe robërit e robëreshat tuaja që janë të ndershëm e të ndershme. Nëse janë të varfër, All-llahu i begaton nga mirësitë e Tij, All-llahu është bujar i madh, i gjithdijshëm. (En-Nur, 32)**

DËSHMIA E RREJSHME

Pyetje: Cila është dispozita e dëshmisë së rrejshme në Islam, përderisa ne e dimë se kur ka dëshmi të rrejshme, ka njeri dëmtues dhe të dëmtuar, e dëmi mund të arrijë edhe te shkalla më e lartë, që do të thotë deri te vrasja apo dënimi me vdekje?

Përgjigjja: Imami i mirënjohur, Mumahed Muteveli Shaëraviju, thotë: Dëshmia e rrejshme është prej mëkateve më të mëdha. Kur Muhamedi s.a.v.s. i ka përmendur mëkatet e mëdha, ka përmendur edhe dëshminë e rrejshme dhe ka thënë: pra edhe dëshmia e rrejshme, ka vazhduar, duke u përsëritur, sa që sahabët kanë menduar se nuk do të ndalet dhe kanë thënë: Ah. po t'ishte ndalur. Kjo ka ndodhur nga shkaku se dëshmia e rrejshme ngërthen në vete tërë padrejtësinë. Ai i cili i bën shok, rival Allahut, ka dëshmuar rrejshëm. Te ai dëshmia e rrejshme ka filluar prej Imanit e kështu me radhë. Për këtë arsye, Zoti i Lartëmadhëruar, kur ka përmendur cilësitë e robërve të të gjithëmëshirshmit, ka thënë: **Ata të cilët nuk dëshmojnë rrejshëm. Asnjë njeri nuk mund të hyjë në adhurim te Allahu, përderisa nuk bëhet prej atyre, të cilët nuk dëshmojnë rrejshëm.** Prej fatkeqësive të këtij krimi është se jo vetëm që bëhet padrejtësia, por e legjitimon dhe ligjëson padrejtësinë; sepse gjykatësi merr vendim në bazë të dëshmive. Nëse dëshmitë janë të rrejshme, ato gjykatësin e shpiejnë në humbje (për të mos gjykuar drejt).

Kështu, në krahasimet e rëndomta në mes të njerëzve dhe pa shikuar aspak çështjen e fesë, shikojmë çka është ajo që të bën ty të mendosh ndryshe

nga të tjerët, nëse i përkrah tjerët në çështje negative, si psh. në dëshminë e rrejshme, t'ia ngritësh kokën kundërshtarit me dëshminë e tij dhe t'ia shkelësh nderin me këmbët e tua. Dëshmitari i rrejshëm është dashur të jetë i indinjuar që nga momenti kur kërkohet një gjë e tillë prej tij, sepse përcaktimi që ai të dëshmojë rrejshëm, nuk është detyrë e tij që ai patjetër ta pranojë. Ndoshta, ai është i kënaqur me ty, kur ti pranon që të dëshmosh rrejshëm në dobi të tij, për t'ia plotësuar ndonjë nevojë, mirëpo, nëse analizon më thellë, do ta kuptosh se ai nuk do të të besojë ty asnjëherë, edhe nëse e flet të vërtetën, sepse ai të ka sprovuar, ai e ka vërtetuar se ti je tradhëtar dhe jobesnik, edhe nëse ndonjëherë tjetër është në dobi të tij.

Ndërsa, sa i përket të dëmtuarit në raport me Zotin, dijetarët për këtë thonë: po ta dinte dëmtuesi se çfarë të mira i sjell të dëmtuarit, ai nuk do ta dëmtonte, sepse, nëse ti e dëmton një njeri, ta dish se i ke marrë diçka që Allahu ia ka dhënë, e me këtë ti nuk je kundër atij personi, por kundër atij, i cili ia ka dhënë atë të drejtë, e atëherë ka filluar armiqësia në mes teje dhe Allahut. Për këtë arsy nuk ka perde (pengesë) në mes të lutjes së të dëmtuarit (atij, të cilit i është bërë padrejtësi) dhe Allahut. Dëmtuesi nuk ka arritur ta dëmtojë aspak tjetrin me padrejtësinë e tij. Përkundrazi, e ka shpërblyer, sepse Allahu e ka bërë në anën e tij, e me këtë dëmtuesit i ka dhënë të mirë të madhe. Allahu e ka lejuar që i dëmtuari të thotë në veten e tij dhe mos ta fshehë padrejtësinë, e cila i është bërë, nëse ajo padrejtësi e mundon. Zoti i Lartëmadhëruar ka thënë: **"O ju që besuat, vazhdimisht të jeni dëshmues të drejtë për hirë të All-llahut edhe nëse është kundër (interesit) vetvetes suaj, kundër prindërve ose kundër të afërmve, le të jetë ai (për të cilin dëshmohet) pasanik ose varfnjak, pse All-llahu di më mirë për ta. Mos ndiqni pra emocionin e t'i shmangeni drejtësisë. Nëse shtrëmbëroni ose tërhiqeni, All-llahu plotësisht di ç'ka punoni." (EN NISA,135)**

Poeti ka thënë: Ankesa duhet të bëhet patjetër për të hidhurën, e cila të keqëson, të brengos (hidhërimin), të mundon, ose të lëndon. Ndërsa, ai i cili e fsheh tërbimin, ka shkallë edhe më të lartë. Nëse e bëjmë një vështrim të kësaj çështjeje në Kur'an, shohim se Zoti i Lartëmadhëruar ka thënë: **"Të cilët japin kur janë shlirë edhe kur janë në vështirësi dhe që e frenojnë mllefin, që u falin (keqen) njerëzve, e All-llahu i do bamirësit. (ALI IMRAN, 134)**

Kjo do të thotë se hidhërimi është në gjoks dhe brendësi të njeriut, mirëpo i dëmtuari dhe i hidhëruari, nëse ka mundësi ta mbajë në vete atë

hidhërim, ka gradë të lartë, është më i fisnikëruar dhe më i ngritur, e pas kësaj vjen shkalla tjetër, falja e gabimit, e kjo shkallë është mirësia. Islami mirësinë e ka bërë më të ngritur dhe më shpërblyese. Islami ka lejuar që njeriu ta nxjerrë prej zemrës së tij hidhërimin, por nëse nuk mundet, ajo është çështje vetjake, që ai ta shpalosë që të qetësohet dhe të pushojë zemra e të dëmtuarit. E, shkalla e Imanit ngritet me mirësi në atë mënyrë, që i dëmtuari t'i dhurojë shpërblim dëmtuesit.

MARTESA ME TË AFËRMIT

Pyetje: Një djalosh dëshiron të martohet, çka është më së miri për të, por a të martohet në brendi të familjes me farefis, apo me e dobishme për të është që të martohet me ndonjë vajzë, e cila është sa më e largët. Cila është urtësia e mosmartesës me të afërt? Kërkojmë nga Imami i nderuar të na sqaroj. Zoti e shpërbleftë!

Përgjigjja: I dërguari i Allahut s.a.v.s na ka këshilluar që të largohemi e të mos martohemi me farefis, kur ka thënë "martohuni me vajza sa më të largëta, e mos u dobësoni", sepse martesa me të afërmet rezulton pasardhës të dobët. Ndërsa, martesa me të largëtat, rezulton me pasardhës të fuqishëm. Shkencërisht është vërtetuar me biologji se kur kanë bërë bashkdyzimin e bimëve të dy llojeve të ndryshme, rezultati i prodhimit ka dalë i shumëfisht se sa më parë. Kjo metodologji quhet "bashkëdyzim i të largëtave (të llojeve meshkuj dhe femra)". Sa më të largëta të jenë çiftet, rezultati është më i fuqishëm. Pra, shkencërisht është vërtetuar përse Kur'ani ka ndaluar martesën me nënat e vajzat dhe ndalesat tjera. Kjo, me qëllim që të krijohen pasardhës të fuqishëm, sepse njeriu sa më shumë që të largohet në martesë prej farefisit, pasardhësi i tij do të jetë më i fuqishëm. Pejgamberi s.a.v.s ka thënë: "Martohuni me të largëtat, e mos u dobësoni", pra mos lejoni që të krijoni pasardhës të dobët. Për këtë është përhapur poezia e poetit, ku thotë:

Këshilloj Largpamësit që të mos martohen me fëmijët e axhallarëve.

Po ashtu sepse nuk mund të shpëtojë nga të metat dhe dobësia. Po ashtu, përshkruajmë të fuqishmin dhe guximtarin. Kështu: Djaloshi trim, të cilin nuk e ka lindur vajza e axhës, farefis, do të kishte qenë i dobët, e

dobësimin e sjell martesa me të afërmit. Përderisa Kur'ani dhe suneti na orientojnë dhe na sqarojnë këtë, është vertejtur se çështja e parë në edukimin e fëmijës është që ai të ketë dhunti prej Allahut, të ketë veçori dhe specifika të veçanta, që do të thotë t'i ketë të përmbledhura të gjitha cilësitë e një lloji, e jo të jetë i vetmuar, vetëm i një fisi, në lloj si ai që martohet me të afërmen. Mirëpo, kur ai martohet me të largtën, ai vet i ka marrë dhe përfituar cilësitë e fuqishme nga aty dhe cilësitë e fuqishme nga atje dhe kështu rezulton fëmijë i fuqishëm.

SHPJEGIM I SURETU JUSUF

I nderuari Shejh: Në suretu Jusuf ka ndodhur konflikti në mes vëllezërve të Jusufit dhe Jusufit, konflikt ky i cili ka shpënë deri te marrëveshja e tyre për ta lajkatuar Jusufin. Si të ndodhë kjo kur babai i tyre ka qenë pejgamber? Dëshirojmë të na sqaroni: çfarë e keqe ka ndërhyrë në shpirtat e vëllezërve të Jusufit? Si ta quajmë atë?

Përgjigjja: Disa analiza i ka paraqitur Kur'ani në paraqitjen e tregimit në suretu Jusuf: **"Jusufi dhe vëllai i tij po janë më të dashur te baba i ynë se sa te ne, ndërsa ne jemi grup i fuqishëm".** Pra, dashuria në një person ndikon që te të tjerët të rezultojë nyja e të metës. Kjo nyje ndikon pastaj që ai njeri të paraqitet i palogjikshëm, joparimor e jonjerëzor. Për këtë arsye, kur e kanë dëgjuar vëllezërit e Jusufit se Jusufi dhe vëllai i tij janë më të dashurit te baba i tyre, kanë filluar të mendojnë që të çlirohen nga ajo dashuri, sipas mënyrës së tyre, duke thënë "ne jemi grup i fuqishëm". Ata sikur të kishin kuptuar pak, do të kishin ditur të bënin një dallim në mes të dashurisë dhe fuqisë së tyre, sepse ai (Jusufi) ka qenë i vogël, e ju mos vendosni dhe mos krahasoni simpatinë dhe dashurinë ndaj tij me simpatinë dhe dashurinë ndaj jush, sepse ju e keni kaluar fazën, në të cilën bën dobi dhembshuria dhe dashuria. Çdo njëri prej nesh i do më të vegjëlit. Pse? Sepse ai me moshën e tij, në krahasim me vëllezërit tjerë, është më i vogli, e ai, për shkak të paaftësisë së tij, ka nevojë për më shumë dashuri. Sikur ta kuptonin vëllezërit e mëdhenj këtë raport, nuk do ta kishin akuzuar babain e tyre dhe nuk do ta kishin marrë si shkak për ta urrejtur vëllain e tyre të vogël. Jusufi dhe vëllai i

tij po janë më të dashur te vëllai ynë, ndërsa ne jemi grup i fuqishëm. Pra, ju kemi thënë "ju jeni grup" që do të thotë shoqëri e fortë dhe fuqishme, e pra nuk paskemi nevojë për ledhatim e dhembshuri dhe për atë dashuri. Pas kësaj çka ka ndodhur? Ndodhi ajo çka ka ndodhur. Kanë thënë "Vriteni Jusufin". Mirëpo, pos kësaj është paraqitur ndjenja shpirtërore, na paraqitet elementi i të mirës, kur të mendohet e keqja, dhe elementi i të keqes, kur të mendohet për të mirë. Ata djem të pejgamberit, është e vërtetë se janë të reflektuar prej ndjenjave njerëzore, kanë filluar ta dëmtojnë Jusufin. Mirëpo, shikoni, planifikimi i dëmtimit ka arritur në shkallën e maksimumit apo të minimumit, pasi që është reflektuar dukuria e dashurisë së prindit te Jusufi më e madhe se te ata. Ka filluar propozimi i parë, i cili ka qenë: "Hidheni në fund të ndonjë pusi, e pastaj do ta marrë atë ndonjë karvan udhëtarësh". Pra, të menduarit menjëherë ka reflektuar, kur kanë thënë "ose të hidhet në ndonjë vend (qytet) tjetër. Pra, ata kanë lëshuar pe prej idesë së mbytjes "që dashuria e babait të kthehet te ju". Pas kësaj dhe pas arsyetimeve ka ardhur faza e ekzekutimit: "Hidheni në fund të ndonjë pusi, e pastaj do ta marrë ndonjë karvan udhëtarësh".

Kjo tregon që nëse mendohet e mira, kur kihet për qëllim e keqja, e keqja nuk ngritet shumë, por zbret poshtë. Pasi që kanë menduar për ta mbytur, kanë menduar për ta dërguar në një vend të largët, e pastaj kanë menduar që ta hedhin në një pus që ta marrë ndonjë karvan njerëzish. Pra, është zbutur çështja. Për këtë arsye, kur dikush thotë: Vëllezërit e Jusufit kanë qenë kështu e ashtu, kanë menduar për të keqen kriminale. Ne u kundërpërgjigjemi: Kanë menduar keq, sepse i ka përfshirë pluhuri i të keqes, por pastaj te ta ka reflektuar arsyeja. Shikoni se a ka arritur ajo shkallë e të keqes në vepër kriminale, të mbytjes, apo kanë zbritur në minimumin e dëmtimit. Kjo natyrshmëri tregon se kanë pasur mirësi në zemrat e tyre. Ajo çka tregon këtë është se nyja, e cila lidhet te njeriu, çfarëdo qoftë ajo nyje, ka reflektim të veçantë në ndjenja, përqëndrohet në zemër, e mbizotëron dhe e kontrollon atë, e pastaj sjelljet nuk mund të kontrollohen, pasi që mendja e tij është e mpirë (dehur). Shikoni, pasi që Jusufi është bërë ministër i ekonomisë, bujqësisë dhe i financave, kanë shkuar vëllezërit te ai. E, Jusufi, për ta ndalur për vete vëllain e tij, i vë në grackë; çka kanë thënë ata? "Nëse ka vjedhur, edhe më parë, poashtu, vëllai i tij ka vjedhur". Ende ka vazhduar esenca, pra reflektimi i brendshëm. Për këtë arsye kur islami parashtron rrugën e edukimit në mes të fëmijëve, e paraqet barazimin në mes tyre, ose në mes të

nxënësve, ose në mes të edukimit të një grupi njerëzish. Po, mund të jetë që disa të duhen, e disa të tjerë mos të duhen, mirëpo në çështjen e edukimit duhet të jenë të barabartë. Mirëpo, këtë lloj të edukimit e quajmë që dikush ka dhunti të veçantë nga Lart dhe ne i marrim të paaftit e i ngritim në nivelin e atyre, të cilëve u është dhënë dhunti e veçantë. Për këtë arsye nxënësit dallohen nga njëri- tjetri. ALLAHU E DI MË SË MIRI.

E DREJTA E FQINJIT NË ISLAM

Cilat janë të drejta e fëmijës në Islam?

I kanë treguar të dërguarit të Allahut s.a.v.s. për një grua, e cila agjëron vazhdimisht, jep sadaka, mirëpo i ofendon fqinjtë e saj, e Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: Ajo është në zjarr. Pastaj i kanë treguar se filanja pak falet, pak agjëron, pak jep sadaka, mirëpo nuk i ofendon fqinjtë e saj. E Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: Ajo është ne xhenet. (AHMEDI)

Ajsha r.a. i ka thënë Muhamedit s.a.v.s: I kam dy fqinj afër, cilit t'i jap më parë dhuratë? Muhamedi s.a.v.s ka thënë: Cili prej tyre është me derë më afër derës tënde. (BUHARIU)

PLANPROGRAMI EDUKATIV NË ISLAM

Pyetje: Cila është metodologjia më e mirë për t'i edukuar njerëzit me edukatë Islame?

Përgjigjja: Ta analizojmë hadithin e të dërguarit të Allahut s.a.v.s., ku thotë: ***"Çka është në atë tuajin, i cili e bënë këtë e këtë".*** Shohim se ai nuk akuzon vepruesin për atë vepër, që mos ta nxjerrë prej taktit, e kur e nxjerr prej taktit, e turpëron. Këtë e bëri, sepse dëshiroi që atë ta nderojë si pjesë të shoqërisë. Mjafton që njeriu ta dijë vet se ka të metë, e të tjerët mos ta dinë se ai ka atë të metë. Pas kësaj, i dërguari i Allahut s.a.v.s. tregon rrugën bazore në edukim, e ajo rrugë është që edukuesi të pasojë rrugën që të edukuarin ta sjellë te edukimi nëpërmjet rrugës sa më të shkurtër, për çfarëdo çështje prej

çeshtjeve. Disa çështje është vështirë t'i vulosësh me mendje të të tjerëve, mirëpo edukuesi duhet të ketë përgatitje profesionale dhe t'i vendosë të gjitha mjetet në disponim për të ndikuar te i edukuari, te e vërteta, të cilën e dëshiron në mënyrën më të lehtë dhe rrugën më të shkurtër.

Imam Ahmedi dhe *Bajhekiu* në librin e tij "Degët e Imanit" kanë regjistruar hadithin nga Ebi Umamete r.a. se një djalosh ka shkuar te pejgamberi s.a.v.s dhe i ka thënë: O i dërguari i Allahut, më lejo që t'i dashuroj gratë. Disa njerëz deshën ta dëbonin, por Muhamedi s.a.v.s tha: Silleni, silleni më afër. Pastaj, i tha të ulet dhe ai është ulur. E, pejgamberi s.a.v.s e pyet: ***A dëshiron që të tjerët ta dashurojnë nënën tënde?*** Ai thotë: Jo, për Zotin, po unë do të sakrifikohesha për të. ***Po ashtu edhe të tjerët i duan nënat e veta (që mos t'i dashurojë askush).*** Pastaj pejgamberi s.a.v.s. e pyet: ***Po a dëshiron që vajza jote të jetë ashtu?*** Jo, për Zotin, po unë do të sakrifikohesha për të. ***Po ashtu, edhe të tjerët i duan vajzat e tyre (që mos t'i dashurojë askush)***. Pastaj, i dërguari i Allahut s.a.v.s e pyet: ***Po a dëshiron që motra jote të jetë ashtu?*** Jo, për Zotin, po unë do të sakrifikohesha për të. ***Po ashtu, edhe të tjerët i duan motrat e tyre (që mos t'i dashurojë askush).*** Pastaj i dërguari i Allahut .s.a.v.s. e pyet: ***Po a dëshiron që halla jote të jetë ashtu?*** Jo, për Zotin, po unë do të sakrifikohesha për të. ***Po ashtu, edhe të tjerët i duan hallat e tyre (që mos t'i dashurojë askush).*** Pastaj, i dërguari i Allahut .s.a.v.s e pyet: ***Po a dëshiron që tezja jote të jetë ashtu?*** Jo, për Zotin, po unë do të sakrifikohesha për të***. Po ashtu, edhe të tjerët i duan tezet e tyre (të mos i dashurojë askush).*** Pastaj i dërguari i Allahut s.a.v.s. e vendos dorën në kraharorin e tij dhe thotë: O Zot falja gabimet, pastroja zemrën dhe bëje të moralshëm. Pas këtij rasti, ai djalosh nuk ka shikuar diçka tjetër dhe ka thënë: Për Zotin, çdo herë kur epshi im anonte të bëjë një mëkat të atij lloji, më kujtohej sikurse do ta bëj më nënën time, me vajzën time dhe për atë jam larguar.

Pra, i dërguari i Allahut s.a.v.s e ka sjellë çështjen aq afër që të shohë ai fisnikrinë e tij, ndjenjat e tij, vendin e tij dhe pozitën e tij. E, kur dëshiron të bëjë një gjë të tillë, ta kujtojë se çka është të veprosh. Kjo është metodologjia më e mirë për të arritur fisnikërinë, të cilën na e ka mësuar i dërguari i Allahut s.a.v.s se si të këshillosh më së miri dhe si ndikon te të tjerët kur të depërtojë e vërteta në zemrën dhe natyrshmërinë e njeriut. Po, pra. Këshillë e mirë dhe logjikë e shëndoshë.

ASKUSH NUK E BART BARRËN E TJETRIT

Kemi ajetin Kur'anor: **“Dhe askush nuk e bart barrën e tjetrit”.** Po ashtu, edhe ajetin tjetër: **“Për t'u ngarkuar me barrat e tyre në ditën e kiametit dhe me barrat e atyre, të cilët kanë devijuar pa kurrfarë diturie”.**

I nderuari ynë, a nuk janë në kundërshtim mes veti këto dy ajete? Ju lutemi, të na sqaroni. Zoti ju shpërbleftë!

Përgjigjja: Kuptimi i ajetit: **“Dhe askush nuk ngarkohet me barrën e tjetrit'”** është drejtësi e Allahut, është të mos e dënoj të pafajshmin (jomëkatarin) për mëkatin e tjetrit, pra nuk ka dënim në ndërmjetësim. Mirëpo, pastaj vjen ajeti tjetër Kur'anor ku thotë: **“Për t'iu ngarkuar me barrat e tyre në ditën e kiametit dhe barrat e atyre, të cilët kanë devijuar pa kurrfarë diturie”.** Për këtë ajet themi: Nuk është në kundërshtim me ajetin e parë, sepse ata jan ngarkuar me barrën e atyre, të cilën barrë e kanë krijuar duke i humbur apo devijuar të tjerët, pra me barrën e devijimit të të tjerëve. Pra, barra e parë, barra e vetëdevijimit, ndërsa barra e dytë, barra e devijimit të tjetrit.

TRADITA DHE IBADETI

Çfarë faji ka ai i cili jeton në një vend, ku shoqëria është e keqe dhe çka është puna me atë, i cili jeton në një shoqëri të mirë, ku i riu rritet në ambient të përshtatshëm, të fesë së prindërve të tij dhe nuk e devijon askush?

Përgjigjje: Shejh Shaëraviu përgjigjjet: Përderisa njeriu bëhet i pavarur dhe i logjikshëm, ai edhe pyet për çdo gjë dhe kërkon sqarime për çdo gjë. Ai e zgjedh rrobën (pallton) për veten e tij dhe shikon çfarë rezultati ka arritur në shkollë të mesme, për të pasur sukses në fakultetin, të cilin e dëshiron.

Atëherë, pse po ekzistuaka dëshira vetjake për të zgjedhur çështjet, e mos të ketë dëshirë (të drejtë) vetjake për të njohur fenë e tij. Ai i cili merret me një çështje, interesohet për të. Argumentimi qëndron në atë se shumica e atyre që jetojnë në ato vende, e njohin fenë e tyre dhe i përmbahen fesë së tyre. Mirëpo, e vërteta është e kundërt, sepse shumica e atyre, të cilët rriten në

një vend të mirë, bëhen të këqij. Për këtë arsye, i dërguari i Allahut s.a.v.s ka thënë: "Zoti e bekoftë njeriun, i cili ka dëgjuar fjalën time, pastaj e mban në vete dhe ia përcjell atij që nuk e ka dëgjuar, apo nuk e di". Kjo është për shkak të kompletimit të asaj, të cilën ai e ka mësuar, pastaj ia përcjell tjetrit, që edhe tjetri të përfitojë prej saj. Kjo, gjithashtu, është mirësi edhe për vet besimtarin, sepse, nëse unë e mësoj, e edukoj një njeri, kam arritur një të mirë, e cila do të më rikthehet në jetë. Por, nëse e lë të keqen ashtu siç është, do të më përfshijë fatkeqësia e asaj të keqeje. Është në interesin tim që të ndikoj me mirësinë time dhe ajo e mirë pastaj të kalojë te tjetri, ndërsa në dëm timin është e keqja të kalojë te tjetri.

Pra, në interesin tim është që i dituri t'ia mësoj të mirën tjetrit, e ai tjetri të sillet mirë me mua. Kjo është thuajse jam duke bërë mirësi për veten time. Për këtë arsye, i dërguari i Allahut s..a.v.s. ka thënë: **"Nuk ka besuar askush prej jush deri sa mos ta dojë për vëllain e vet atë që e do për vete".** Kjo, pra, kthehet në dashuri të ndërsjelltë njerëzore. Nëse unë jam besnik, e mira e besnikërisë sime do të qarkullojë në rrethin tim dhe do të më besojnë për atë çka kanë nevojë. Ndalesa në një mes tjetër, nëse është hajn, e keqja e atij hajni do të më kaplojë mua, kur të ma vjedh pasurinë time, ndërsa e mira shkon *te ata.*

Pra, për të përfituar të mirën e tyre, duhet t'ua përcjell patjetër të mirën time atyre.

DITËLINDJA E MUAHMEDIT A.S.

Çka mendon Imami i nderuar në lidhje më manifestimin e ditëlindjes së Muhamedit s.a.v.s me zbukurime dhe ëmbëlsira?

Përgjigjje: Manifestimi i ditëlindjes së pejgamberit është pasimi me ata çka dëshiron i manifestuari. Imami i nderuar pastaj shton: Sa më shumë që manifestojmë këtë ditë, aq më pak përfitohet prej atij manifestimi. Nëse për çdo manifestim të ditëlindjes së Muhamedit s.a.v.s. bëhet që të gjallërohet një simbol prej simboleve të fesë së tij, feja e tij do të përforcohej në çdo vend. Mirëpo, siç shihet, ne vetëkënaqemi me pjesën e jashtme të manifestimit, pra me ato çka na e ka ëndja neve, me ushqim vjetor, ëmbëlsira, pamje të bukur.

Feja e Allahut është shumë larg prej pamjeve të jashtme.

Nëse shohim zbukurimet, të cilat bëhen në këtë festë, do ta kuptojmë se sa e duan njerëzit këtë fe. Por, nëse hymë nëpër shtëpitë e atyre, të cilët i bëjnë këto zbukurime, do ta kuptonim se sa larg janë ata nga feja e tyre.

Është e vërtetë se ditëlindja e Muhamedit s.a.v.s është ngjarja më e rëndësishme në këtë botë, bile më e rëndësishme se vet kjo botë, sepse Muhamedi s.a.v.s ka sjellë programin për për ta harmonizuar tërë këtë gjithësi. Ditëlindja e pejgamberit s.a.v.s është mostra e mirësisë së tërë ekzistencës. Njeriu nuk duhet t'i bëjë krim vetes. Por, shtrohet pyetja se si i bën njeriu krim vetes? Atëherë kur ka mundësi t'i sjell dobi vetes, e nuk e bën. Kur i shkëlqeu drita, e nuk udhëzohet në të.

Për këtë arsye, në ditëlindje duhet të koncentrohemi në atë çka e dëshiron manifestuesi i ditëlindjes (dhe atë çka e dëshiron Krijuesi i atij të lindurit).

Islami nuk ka nevojë për ambalazh, që do të thotë t'ia tërheqë vëmendjen tjetrit, ta pranojë vetëm për shkak të ambalazhit. Ndjenja në esencën e çështjes është origjinaliteti, ndërsa ndjenja në sipërfaqen (ambalazhin) e çështjes është origjinaliteti.

Nuk duhet ta anashkalojmë ditëlindjen e të dërguarit s.a.v.s nga programi i tij. Le t'i përmbledhim ngjarjet e fesë, të cilat na perkufizojnë në praktikimin e programit fetar.

FORMA E MBULESËS ISLAME

Pyetje: A ka kushte të tjera, të cilat duhet plotësuar për të qenë mbulesa islame?

Përgjigje: Po, ka kushte të tjera që patjetër duhet plotësuar, e ato janë:

- Që vet rroba mos të jetë zbukurim, e kjo kuptohet nga fjala e Zotit të Lartmadhëruar: **"Dhe mos t'i paraqesin stolitë (zbukurimin) e tyre."** Dhe fjala e Zotit të Lartmadhëruar: **"Dhe qëndroni nëpër shtëpitë tuaja dhe mos u zhvishni me të zhveshurit e kohës së mëparme të injorancës."**
- Që të jetë e trashë, jo tepër e hollë. Ky kusht kuptohet nga thënia e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: ***"Në fazën e fundit të umetit tim do të ketë gra***

të veshura me rroba të tejdukshme dhe kokat e tyre do të jenë të qethura. Mallkoni ato se edhe ashtu janë të mallkuara”.

- Që të mos jetë e ngjitur për trupi, sa të shihet i tërë trupi.
- Që të mos jetë e parfumuar. Ky kusht shihet qartë në thënien e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: ***“Çdo grua, e cila parfumohet dhe shkon e kalon nëpër një turmë njerëzish për ta ndierë erën e saj, ajo është (nxitje) prostitutë”.***
- Po ashtu, gruaja nuk guxon t’i ngjasojë meshkujve. Kjo kuptohet te thënia e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.: ***“Nuk është prej nesh gruaja, e cila dëshiron t’i ngjasojë mashkullit, e as mashkulli i cili dëshiron t’i ngjasojë femrave.”***
- Gjithashtu, rroba të mos i përngjajë rrobave të pabesimtarëve, sepse në shumë ajete kërkohet që muslimanët të mos i pasojnë epshet e pabesimtarëve.
- Të mos jetë rroba për t’u krekosur dhe lavdëruar. I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: ***“Kush e vesh në këtë botë rrobën e kryelartësisë, Allahu do ta veshë me rrobën e nënçmimit në Ditën e Kiametit, e pastaj e hedh me atë rrobë në zjarr.”*** I Dërguari i Allahut s.a.v.s. e ka folur të vërtetën.

MBULESA ISLAME

Janë paraqitur pyetje të shumta nga shumë vende rreth formës së mbulesës së femrës në Islam.

Sa i përket formës së mbulesës së femrës në Islam, Shejh Shaëraviju thekson se Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. All-llahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata.

Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme, le të vënë shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt, përveç burrave të vet,

baballarëve të vet, ose baballarëve të burrave të vet, djemve të vet, ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet, ose djemve të vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (që u përmendën) dhe robëreshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve nga meshkujt, të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat, ose fëmijët që nuk e kanë arritur pjekurinë për gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për ta zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë te All-llahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim." (En-Nur, 30-31)

Shami do të thotë mbulim i kokës dhe i ballit, pjesës së qafës dhe gjoksit. Kërkohet që të mbulohet koka, qafa dhe gjoksi. Si bëhet kjo? Ky është mbulimi i pjesës së epërme. Po, cila është pjesa e mbulimit të pjesës së poshtme? Zoti i Lartmadhëruar thotë:

"Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre se kjo është më e pastër për ta. All-llahu është i njohur hollësisht për atë që bëjnë ata.

Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, t'i ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre përveç atyre që janë të dukshme, le të vënë shamitë mbi kraharorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt, përveç burrave të vet, baballarëve të vet, ose baballarëve të burrave të vet, djemve të vet, ose djemve të burrave të vet, vëllezërve të vet, ose djemve të vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (që u përmendën) dhe robëreshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve nga meshkujt, të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat, ose fëmijët që nuk e kanë arritur pjekurinë për gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për ta zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë te All-llahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim." (En-Nur, 30-31)

Bukuria e këmbëve janë deri te zogu i këmbës, pasi që i mbulonin me rroba të ngjyrosura, ashtu siç e tregon ajeti fisnik, sepse në atë kohë ato i binin tokës me këmbët e tyre për t'u parë bukuria e këmbëve të tyre prapa tyre.

Kur Esma, e Bija e Ebu Bekri Sidikit, hyri një herë te Muhamedi s.a.v.s., Muhamedi s.a.v.s. i thotë: ***"Oj Esma, femra kur arrin pubertetin, prej momentit kur t'i paraqiten menstruacionet, nuk lejohet t'i shihet (nga trupi), pos kësaj dhe kësaj, dhe ka sinjalizuar Pejgamberi s.a.v.s. në zogun e këmbës së tij dhe fytyrës së tij."***

Zonja Aishe tregon: “Gratë e besimtarëve shkonin në xhami dhe e falnin namazin e sabahut me të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. të mbuluara me mbulesat e tyre dhe kthehesin në shtëpitë e tyre, pasi e përfundonin namazin, pa i njohur askush.

MË TË SPROVUARIT

Pyetje: A është e vërtetë se njeriu sprovohet varësisht prej fesë së tij? Apo fatkeqësitë dhe sprovat e njëpasnjëshme janë si rezultat i hidhërimit të Zotit ndaj robit të Tij? Dhe këto sprovime a i fshijnë mëkatet apo ato janë çështje në vete?

Përgjigje: Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. se cilët njerëz sprovohen më së shumti, e ai është përgjigjur: ***“Pejgamberët, e pastaj të ngjashmit me ta. Sprovohet njeriu varësisht prej fesë së tij. Nëse është i dobët në fe, sprovohet aq sa është i dobët; nëse është i fortë në fe, sprovohet aq sa është i fortë. Njeriun vazhdimisht e përcjellin fatkeqësitë derisa të ecën nëpër tokë pa pasur asnjë gabim.”(Transmeton Ahmedi, e ka vërtetuar Tirmidhiu)***

DALLIMI NË MES ANALFABETIT DHE INJORANCËS

Cili është dallimi në mes të fjalës analfabet dhe fjalës injorancë? Me fjalë tjera, çfarë kuptimi ka fjala e parë, e çfarë kuptimi ka fjala e dytë?

Përgjigje: Dijetarët mendjelehtë dhe të cekët mendojnë se fjala “injorancë” ka kuptimin e mosditurisë dhe se ajo fjalë e ka të njëjtin kuptim siç e ka fjala “analfabet”. Jo nuk është ashtu! Injorancë ka kuptim në vete, analfabetizmi ka kuptim në vete. Analfabet quhet kur njeriu nuk di diçka. Për atë njeri thuhet “nuk e di”, ashtu siç nuk ka ditur në ditën kur ka lindur prej nënës së tij. Ashtu siç thotë Zoti i Lartmadhëruar: **“Allahu ju ka nxjerrë prej barqeve të nënave tuaja kur nuk keni ditur asgjë.”** Pastaj i ka përmendur mjetet e diturisë: dëgjimin, shikimin dhe mendjen. Pra, analfabet

është ai i cili nuk di diçka se prej çfarë është ose nuk e di për një çështje se prej cilës çështje (përbërje) është, ose të mos e dijë një argument prej argumenteve. Mirëpo, injoranca nuk është kështu. Injorancë është ta dish një çështje gabimisht, për këtë arsye të shëruarit e injorancës është shumë më e vështirë se të shëruarit e analfabetizmit. Sepse te injoranti, në rend të parë, duhet çrrënjosur atë që e ka mësuar gabimisht, e pastaj përballë saj duhet vendosur të pagabuarën, pra të vërtetën.

EMRI I MIRË ËSHTË E DREJTË E FËMIJËS

A është e drejtë e ime që prindi të ma zgjedh emrin e mirë, të cilin e mbaj gjatë tërë jetës, të jem krenar para bashkëkohësve e që të mos jem mjet i humorit, nëse e kam emrin e keq, i cili nuk më ndahet as kur jam i vetmuar, as kur jam me shokë, as në gjumë e as zgjuar, sa që emri bëhet barrë e rëndë gjatë tërë jetës e deri në vdekje, të cilin nuk e dua. Ky është një problem i cili më mundon. A mund të marr përgjigje të kënaqshme? Shpresoj në këtë. Zoti ju bekoftë!

Përgjigje: I Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: ***"Emërtohuni me emra të bukur, sepse ju në Ditën e Kiametit do të thirreni me emrat tuaj."*** I Dërguari i Allahut s.a.v.s. këtë e ka praktikuar edhe në jetë, sa që edhe vendi, i cili nuk ka pasur kuptim të mirë, nuk ka kaluar andej. Ishte duke kaluar nëpër një rrugë, e cila ishte në mes të dy kodrave. Ka pyetur për emrat e kodrave dhe i tregojnë. Kjo kodër quhet "Pikëllim", kjo tjetra "Kodra e Turpit", ndërsa Muhamedi s.a.v.s. nuk ka kaluar në mes të atyre dy kodrave. Ai dëshironte ta mjelë një dele, i thërret shokët që ta mjelin dhe u thotë: "Kush dëshiron ta mjelë?" Një njeri tha: "Unë." Pejgamberi s.a.v.s. e pyet: "Si e ke emrin?" I thotë: "Ithtësirë". Këtij i thotë: "Ulu". Pastaj lajmërohet tjetri dhe i thotë: "Si e ke emrin?" Ai i thotë: "Hurb – Sulmues". I thotë: "Emrin e kam Jeton". I thotë: "Ti mile".

Nga kjo tregohet se e drejtë e fëmijës është që baba t'i zgjedhë emër të mirë.

LIBRAT AUTORIAL TË PËRKTHYESIT (Dr. Musli Vërbanit)

1. “Besimi në Zotin”
2. “Melaqet e Zotit”
3. “Besimi në Librat e Zotit”
4. “Pejgamberët e Zotit”
5. “Besimi në Ditën e Kijametit”
6. “Besimi në Kaderin e Zotit”
7. “Tregime nga jeta e Muhamedit a.s.”
8. “Fikhu i Namazit”
9. “Fikhu i Zekatit”
10. “Fikhu i Agjërimit”
11. “Fikhu i Haxhit”
12. “Emërtoni fëmijët tuaj me emra të bukur”
13. “Dëshmorët e 9 Prillit në Rakoc dhe Lagje të Re”
14. “Shkruaj, lexo dhe mëso shkronjat e Kur'anit
15. “Nata e dhëndërisë”
16. “Fadil Çaka – Komandant Sharri”
17. “Dita e vdekjes dhe e varrimit”
18. “(Pa)mundësia e përkthimit të Kur’anit”.
19. “Dëshiroj të jem ai që nuk duhet të jem”.
20. “Texhvidi – Shkenca e të lexuarit (kënduarit) të përpiktë të Kur’anit”.
21. “Texhvidi i muslimanit të vogël”.
22. “Morali i muslimanit të vogël”.
23. “Vasijeti”
24. “Ixhtihadi”.
25. “Trashëgimia”.
26. “Usuli Fikhu Islam”.
27. “Lutjet e jetës nga Kur’ani Fisnik”.
28. “Vakëfi”.

PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE

1.“Këshilltari fisnik për djem dhe vajza” (nga autori Muhamed Sajim);
2.“Islami dhe Politika” (nga autori Jusuf Kardavi);
3.“Mrekullitë numerike në Kur'anin Fisnik” (nga autori Abdurrëzak Nufel);
4.“Për Kushtetutën Islame” (Dr. Muhamëd Sejid Ahmed El- Musejer);
5.“Kryesore në terminologjinë e Hadithit” (nga autori Abduhu Abas El-Velidi)
6.“Vlera e kohës” (nga autori Amer Halid);
7.“Vëllazëria muslimane” (nga autori Amër Halid);
8.“Vëllazëria në islam dhe zemra e shëndoshë” (nga autori Amër Halid);
9. “Pendimi” (nga autori Amër Halid);
10.“Pasojat e mëkateve” (nga autori Amër Halid);
11.“Vendosmëria në rrugën e Allahut (nga Amër Halid);
12.“Mjetet e vendosmërisë në rrugën e Allahut (nga Amër Halid);
13.“Shkurtimi i thonjve në dritën sunetit dhe mjekësisë” (nga autorët Ebul Vefa Abdul Ahar dhe Jahja Nasir).
14.“101 Tregime për ta arritur kulminacionin e mirësisë dhe përsosmërinë e devotshmërisë” (nga autori Muhamed Eminë Xhundi).
15. “Fetavatë e Shaëravijut”.
16.Fjalë të arta të më të mirit të njerëzimit,Muahmedit a.s.
17.“Usuli fikhu Islam I -“Ligjet e sheriatit” ” të autorit Vehbetu Zuhejli.
18.“Usuli fikhu Islam II -“Përpilimi i ligjeve prej teksteve të sheriatit” ” të autorit Vehbetu Zuhejli.

Përmbajtja:

PJESA E PARË 2
HYRJE 3
SHAËRAVIJU DHE SËMUNDJET NGJITËSE 9
KANCERI DHE DHEMBJET E TIJ 10
POZITIVITETI I MASHKULLIT DHE NEGATIVITETI I FEMRËS 11
MJETET E MOSSHTATZËNISË 13
FEMRA DHE MBULESA 14
BARAZIA E FEMRËS DHE MASHKULLIT NË PUNË 16
SUNETIA DHE HAFADI 17
PASTRIMI PREJ XHENABETIT 18
FËMIJA I EPRUVETËS 20
MARTESA MUT 'ATUN (E PËRKOHSHME) 22
MARTESA URFIJ (TRADICIONALE) 24
DHURIMI I VETVETES 24
SHKURORËZIMI DHE POLIGAMIA 25
USHQIMI (MISHI) PREJ IMPORTIT 26
DHËNIA E GJAKUT GJATË OPERACIONIT DHE PAS OPERACIONIT 27
NDALESA E ALKOOLIT 27
DROGA, AFIONI DHE HAPAT PËR GJUMË 30
JASHTËQITJA E NJERIUT DHE E KAFSHËVE 31
A MARTOHEN BANORËT E XHENETIT? 31
XHINËT JANË TË KRIJUAR PREJ ZJARRIT, PRA SI DËNOHEN NË ZJARR? 34
KRIJIMI I SË KEQES 36
TESAVUFI 36
HULUMTIMET E BESIMIT DHE HULUMTIMET SHKENCORE 37
SIHRI DHE NËNSHTRIMI I XHINËVE, DHE SHEJTANËVE 37
DHE NUK KA SUKSES MAGJIA NGA DO QË VJEN 38
ZILIA DHE SHËRIMI PREJ SAJ 40
TELEVIZIONI, HALLALL APO HARAM? 41
PSE DHE SI? 42
PLOTËSIMI I KËRKESAVE TË TRUPIT 43
KULMINACIONI I SHKATËRRIMIT DHE TRAZIRAVE 43
KONTAKTI SEKSUAL TE NJERIU DHE KAFSHËT 45
NDALIMI I MISHIT TË DERRIT 46
ÇËSHTJA E LIGJIT TË DOMOSDOSHMËRISË DHE ZGJEDHJES 47
TEVESUL (SHËRIMI) ME PEJGAMBERËT DHE NJERËZIT E MIRË 48

LIRIA DHE PARIMI I FESË 49
ISRAJA ME TRUP APO ME SHPIRT 51
MARKSIZMI DHE OPIUMI I POPUJVE 52
ISLAMI DHE SOCIALIZMI 53
RIZKU 54
PSE NUK E SHOHIM ALLAHUN 56
LUTJA 57
BANKAT ME KAMATË DHE INVESTITUESE 58
ISTIHAREJA DHE ËNDRRA E MIRË 64
SIGURIMI NË ISLAM 65
LEJLETUL KADRI 66
DHE KUR IBRAHIMI NGRITI THEMELET E QABES 67
KTHEHU TE ZOTI YT 68
SHEMBULLI I DRITËS SË TIJ 70
FEMRA, TRASHËGIMIA DHE TESTAMENTI PËR TRASHËGIMTARIN 70
LYPËS QUHET EDHE NËSE ËSHTË NË KALË TË SHALËS 71
NAMAZI DHE FALJA E TYRE PASI TË I KALOJË KOHA (NAMAZET KADA) 72
NAMAZI PARA KRIJUESIT 72
TATIMET DHE ZEKATI 74
PYETJE DHE PËRGJIGJE 75
RRUGA PËR NË SHOQËRINË ISLAME 77
HAXHI DHE DOBITË E TIJ 78
PËRFUNDIM DHE PËRKUSHTIM 78
PJESA E DYTË 80
HYRJE 81
ASKUSH NUK POSEDON “BËHU” DHE “U BË” 87
A JEP PËRGJEGJËSI NJERIU PËR MËKATIN, PËR SHKAK TË HARRESËS 87
LUTJA E PRANUAR DHE E REFUZUAR 89
SHIKIMI SHQISOR DHE SHIKIMI SHPIRTËROR 90
PSE ËSHTË E LEJUAR POLIGAMIA PËR MESHKUJT E JO PËR FEMRAT 91
DËNIMI I PAPËRCAKTUAR – TEAZIRI NË ISLAM 92
A SHPËRBLEHET NJERIU PËR MUNDIMET DHE VËSHTIRËSITË QË I PËRJETON NGA PROFESIONET (PUNIMET) E LEJUARA 93
AGJËRIMI I PASINQERTË 94

A KONSIDEROHET MOSFALËSI PABESIMTAR 95
KUR LIROHET NJERIU NGA OBLIGIMET 96
CILAT JANË TË MIRAT E XHUMASË 97
IHRAMI I FEMRËS 98
MUSLIMANËT DHE KRISHTERËT 98
NUK KA DHUNË NË FE 99
PUTHJA E AGJËRUESIT 100
KUSH VDES DHE KA VAXHIB AGJËRIMIN E PËRBETIMIT 101
AGJËRIMI VULLNETAR 101
KUSH HA DHE PI ME HARRESË NË RAMAZAN 102
XHAMI E PARË E NDËRTUAR PËR NJERËZIT 102
A FLENË BANORËT E XHENETIT 102
NUK PAKËSOHET PASURIA DUKE DHËNË SADAKA 103
GRUAJA MUSLIMANE UDHËTARE 103
CILËT I URREN ALLAHU 104
DHE AI (ALLAHU) E KA SHKATËRRUAR POPULLIN AD TË HERSHËM (TË PARË) 105
A DËNOHET KRIMINELI MENJËHERË NË KËTË BOTË 105
SHTYLLAT E ISLAMIT DHE ANGAZHIMI PËR JETË 106
A LEJOHET BASHKËPJESËMARRJA NË KURBAN 107
PËRPOS ZEKATIT A KA OBLIGIME TJERA TË PASURISË 107
ISLAMI, IMANI DHE IHSANI 108
KUSH ZGJOHET XHUNUB AGJËRUESHËM 108
NDJENJAT E BRENDSHME DHE AGJËRIMI 108
PSE NUK KA QENË VETËM MIËRAXHI 109
PSE ALLAHU I KA KRIJUAR SHEJTANËT 110
SI NA KA KRIJUAR ALLAHU PREJ NJË SHPIRTI 111
NE IA KEMI PARASHTRUAR EMANETIN 112
ISLAMI DHE ZHVILLIMI (MODERNIZIMI) 113
SI E URDHËRON SHEJTANI JOBESIMTARIN 114
KTHIMI NË PABESIM PA E DITUR 114
KUSH JANË FASIKËT 115
RRUGA E TRASUAR E IBLISIT NË MËKATE 116
EPSHI DHE SHEJTANI 116
KUR'ANI IA KA TEJKALUAR EDHE KËTIJ SHEKULLI 118
PËR ÇDO POPULL PREJ JUVE KEMI PARAPA LIGJ DHE PLANPROGRAM 118
SHPËRBLIMI I SHKENCËTARËVE 120

PSE ALLAHU E KA KRIJUAR KËTË BOTË 120
TË PADUKSHMET DHE BESIMI NË TA 122
KRIJIMI PREJ ASGJËJE 124
SHKAQET DHE SPROVAT 125
MUËXHIZJA DHE KERAMETI 126
FUQIA ABSOLUTE 127
PËRMBAJTJA E PLANPROGRAMIT DHE VËSHTIRËSIA E OBLIGIMEVE 128
A KRYEJNË NEVOJË PERSONALE BANORËT E XHENETIT 129
KUR'ANI DHE LEXIMI I TIJ I CILI KONSIDEROHET ADHURIM 130
PJESA E TRETË 131
HYRJE 132
ALKOOLI DHE PIJET ENERGJIKE 135
MBAJTJA E QENVE 136
SI E TREGON VAJZA DËSHIRËN E SAJ PËR MARTESË 137
TË FEJUARIT DHE KOHA BASHKËSHORTORE 138
TË ZBULUARIT TË ORGANEVE GJENITALE NË MES TË BASHKËSHORTËVE 138
A KONTAKTOJMË SEKSUALISHT ME GRATË TONA NË XHENET . 138
A PASTROHET PROSTITUTI ME EKZEKUTIMIN E TIJ 139
VEZORJA E FEMRËS 141
KU ËSHTË DALLIMI NË MES TË DITURIT DHE DIJETARIT? 142
ÇKA THOTË ISLAMI PËR MISHIN E KAFSHËS SË ÇMENDUR? 142
ABORTIMI SIPAS MJEKËSISË DHE FESË 143
STERILITETI ME QËLLIM DHE SPIRALJA PËR MOSSHTATZËNI 145
PËRDORËZIMI I MASHKULLIT ME FEMRËN 146
RREGULLIMI (HEQJA E QIMEVE) I VETULLAVE TË FEMRËS 146
ZGJATIMI I THONJVE 147
NJË FEMRËS TË CILËS I PËLQEN NJË MASHKULL 148
SHOQËRIMI I BASHKËSHORTIT ME BASHKËSHORTEN NË UDHËTIM 148
ZËRI I FEMRËS 148
A LEJOHET QË PRINDI ME FEJUA VAJZËN E TIJ 149
SHKURTIMI I FLOKËVE 149
DËGJIMI I KËNGËVE 149
DUAJA MË E MIRA 150
BURRI I SËMURË PSIKIKISHT 150
FOTOGRAFIMI 151

NGRËNIA HAPTAS DITËN NË RAMAZAN 151
USHQIMI I PARË I BANORËVE TË XHENETIT 152
DËNIMI NË VARR PËR TË PËRMBYTURIT NË UJË, TË DJEGURIN DHE TË COPËTUARIN (TË CILËT NUK VARROSEN) 152
NAMAZI I MESËM 153
VLERA E DITËS SË XHUMASË 153
ZEKATI I FITRIT 154
URINA NË VENDURINIM (FSHIKËZ) 155
PUTHJA E HAXHERUL ESVEDIT 156
DËNIMI ME BURG NË ISLAM 156
TË NDALUARIT E ARIT DHE MËNDAFSHIT PËR MESHKUJT 157
NJË MASHKULL KONTAKTON SEKSUALISHT ME NJË FEMËR E PASTAJ MARTOHET ME TË 158
PRANIMI I ADHURIMIT DHE SHEJTANËT 158
GJUHA E KUR'ANIT A ËSHTË PO E NJËJTA GJUHË E ALLAHUT 161
DREJTËSIA ËSHTË BAZË E SUNDIMIT 162
PERSONALITETI I MUSLIMANIT NË ISLAM 164
DËSHIRA DHE FUQIA 166
LIDHJET DHE FRYRJET NË NYJE 166
TË PYESIN 169
LUTJE 170
PJESA E KATËRT 171
HYRJE 172
HAXHI PARA ISLAMIT 175
UMREJA A ËSHTË SUNET APO FARZ? 176
HAXHI PËR TJETRIN 176
KONTAKTIMI SEKSUAL NGA PRAPA 177
FILLIMI I SHPALLJES 177
BOTA TJETËR DHE KJO BOTË 178
FEMRA E MARTUAR DY HERË ME CILIN BURRË DO TË JETË NË XHENET 179
SUNDIMI DHE SUNDIMET 179
NËSE RROBA NDOTET ME GJAKUN E MENSTRUACIONIT 180
AFATI I LEHONISË (NIFASËS) 180
SHENJA E PARË E KIJAMETIT 181
MREKULLIA E ISRASË DHE MIËRAXHIT 182
MARTESA DHE SHKURORËZIMI 183
NË MES TË SHTIMIT DHE TË PAKËSIMIT 183

NDJENJAT E BRENDSHME 184
MAGJIA E POPULLIT TË FIRAUNIT DHE SHKOPI I MUSASË A.S. ... 184
PSE NAMAZI HAPTAZI DHE FSHEHTAZI 187
KU ËSHTË SHKURORËZIMI I TRETË 187
SHKURORËZIMI I TRIHERSHËM NË TË NJËJTËN KOHË 188
SUKSESI DHE LUMTURIA NË JETË 188
TË SHKURORËZUARAT LE TË PRESIN TRI KOHËRA TË MENSTRUACIONEVE 190
ISLAMI ËSHTË SIMBOL, EMËR DHE CILËSI 191
PARAQITJA E BURRIT TË PARË 193
NUK DO TË ARRINI VETËM SE ME FUQI 193
NAMAZI I BASHKËSHORTES ME BASHKËSHORTIN E SAJ 195
NUK I NGJASON ASGJË 195
PRANGOSJA E SHEJTANËVE NË RAMAZAN 197
PËRBETIM PËR MOSKONTAKTIM SEKSUAL ME GRUAN 198
LUTJA PËR ZOTIN TIM DHE PËR MUA 199
PREJ DUAVE TË NAMAZIT 199
SHPIRTI 200
ISLAMI DHE EDUKIMI I EPSHIT-NDJENJAVE 200
JA RAB (O ZOT !) DHE DËSHIRA ABSOLUTE 201
INSPIRIMI (NGULITJA NE ZEMËR-MENDJE) 203
ËSHTË PREJ KADERIT TË ALLAHUT 203
TOKA ËSHTË XHAMI DHE E PASTËR 204
EPSHI I KAFSHËS 205
FOTOGRAFIA E XHAMISË NË QIBRIT 206
A PYETET I DËRGUARI I ALLAHUT S.A.V.S. NË DITËN E KIAMETIT? 206
PJESA E PESTË 208
HYRJE 209
PËRZIERJA E DJEMVE ME VAJZA 213
E DREJTA E TË ÇMENDURIT 215
SHFUQIZIMI I LIGJIT PARA OBLIGUESHMËRISË 216
QETËSIMI I SHPIRTIT NË MARTESË DHE PREJ TIJ KA BË BASHKËSHORTEN E TIJ 218
EL-MEDHIJ 218
FAZA E OBLIGUESHMËRISË 219
PRAKTIKIMI I SHERIATIT 220
TË NDALUARIT E VRASJES SË BESIMTARIT 220

CILI ËSHTË MË I HERSHËM PABESIMI APO BESIMI 221
PSE NË KUR'AN KA AJETE TË PAQARTA 222
KULMINACIONI I ADHURIMIT NDAJ ALLAHUT 223
FEMRA DHE XHIHADI NË RRUGËN E ALLAHUT 224
LOGJIKA DHE ROLI I SAJ 225
FILLIMI I SUREVE ME SHKRONJA TË ALFABETIT 226
ME GURALECË ËSHTË MUNDUR USHTRIA E EBREHESË 226
HIPOKRITËT DHE DËNIMI I TYRE 227
PUNA E CILA TË SHPIE NË XHENET DHE PUNA E CILA TË SHPIE NË XHEHENEM 228
SUFEHATË-MENDJELEHTËT 228
RRUGA E VULLNETIT DHE E VETËDËSHIRËS DHE RRUGA E PAVULLNETIT DHE IMPONIMIT 229
IMPONIMI DHE LIRIA E VEPRIMIT - DËSHIRA DHE ZGJEDHJA E VEPRIMIT 230
BARAZIA E MASHKULLIT ME FEMRËN 231
TRASHËGIMIA E MASHKULLIT DHE TRASHËGIMIA E FEMRËS 231
USHQIMI I VËRTETË 232
FJALA ALLAH NË GJUHËT E NJERIUT 233
A KA PAS POLIGAMI PARA ISLAMIT ? 234
MJEKIMI 234
NDALIMI I IDHUJTARISË 235
PROKLAMIMI 236
PSE SUREJA IHLAS PAS SURES KJAFIRINË NASR DHE MESED 237
BUJQËSIA DHE OBLIGUESHMËRIA 238
NË NAMAZET E TYRE JANË PËRTACË 239
VLERA E XHEMATIT 239
ZEKATI DHE ZHVILLIMI – SHTIMI I PASURISË 240
PENDIMI 241
NË PAAFTËSI KA URTËSI 242
FAJI I PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE ÇËSHTJA E SPROVIMIT TË TYRE 242
MESXHIDI AKSAJA E DIKURSHME 244
PREJ MESXHIDI HARAMIT NË MESXHIDI AKSA 246
ÇKA ËSHTË SIDRETUL MUNTEHA? 247
ËNDRRA DHE JOËNDRRA 249
PSE POPULLI ANALFABET ËSHTË PËRGATIT PËR TA PRANUAR MISIONIN E ISLAMIT? 250

HURITË E XHENETIT 251
SI DO TE VEPROJ ZOTI ME NEVE KUR TA SHOHIM ATË 252
HAXHI I FËMIJËS PËR PRINDIN E TIJ 253
MES-HI I MESTEVE 253
CILI ËSHTË NAMAZI MË I VLEFSHMI? 254
CILI AJET I KUR'ANIT ËSHTË MË MADHËSHTORI? 254
ÇKA I LEJOHET BURRIT ME VEPRUA ME GRUAN E TIJ DERI SA AJO TË JETË NË FAZËN E MENSTRUACIONIT 255
VEPRAT E MIRA TË PËRGJITHMONSHME 255
PJESA E GJASHTË 256
HYRJE 257
USHQIMI I KËSAJ BOTE DHE USHQIMI I XHENETIT 258
KU ËSHTË DALLIMI NË MES TË "VE MA EDRAKE" DHE "VE MA JUDRIKE"? 259
SHËRIMI (NDËRMJETËSIMI) ME KUR'AN 260
DALLIMI I DISA SUREVE DHE I AJETEVE PREJ DISA SUREVE DHE AJETEVE TË TJERA NË KUR'AN 261
A I FSHIN PENDIMI MËKATET? 261
SËMUNDJET E ZEMRËS DHE SHËRIMI I TYRE 264
CILIN LLOJ TË XHINËVE MUND TA NËNSHTROJË NJERIU? 266
DITËT E ALLAHUT 267
PO TË MOS KISHIM PËRFORCUAR TY 270
TEORIA E DARVINIT DHE SHAËRAVIJUT 270
MËNYRA E HAXHIT 272
SADAKAJA E GRUAS PA LEJEN E BURRIT TË SAJ 273
MËKATET E VOGLA DHE MËKATET E MËDHA 274
KU TË TË KËRKOJ NË DITËN E KIAMETIT? 275
PSE I DËRGUARI NUK E KA KOMENTUAR KUR'ANIN NË TËRËSI 276
NAMAZI NË ANIJE 277
AGJËRIMI PAS MUAJIT RAMAZAN 277
NE E KEMI KRIJUAR NJERIUN NË VËSHTIRËSI 278
QIELLI DHE TOKA QAJNË 279
SI PAGUHEN KOPPRRACËT NË KËTË BOTË 280
ISLAMI DHE FEMRA 281
RISKU A DO TË THOTË VETËM PASURI APO KA KUPTIM GJITHËPËRFSHIRËS? 285
SI ËSHTË BËRË TAKIMI I MUHAMEDIT S.A.V.S. ME PEJGAMBERËT TJERË KUR AI KA QENË I GJALLË, NDËRSA ATA TË VDEKUR 286

NJË E TRETA, POR EDHE NJË E TRETA ËSHTË SHUMË 288
A ËSHTË XHENETI I ADEMIT XHENETI I BOTËS TJETËR 288
LARGIMI NGA FRONTI NË BETEJËN E TEBUKUT 289
UDHËZON CILINDO, E HUMB CILINDO 290
KOMENTIMI SHKENCOR NË KUR'AN 292
DRITA E PEJGAMERIT S.A.V.S 294
DUAJA GJATË VIZITËS SË VARREVE 295
SHTYLLAT E SHKURORËZIMIT 296
PSE NJË VARG PEJGAMBERËSH? 296
DUAJA E PAPRANUAR 297
ZËVENDËSIMI I BURRIT NË GJUAJTJEN E GURALECAVE 298
PJESA E SHTATË 299
HYRJE 300
XHINËT DHE MAGJIA 302
PASI QË RIZKU-FURNIZIMI ËSHTË I CAKTUAR, PSE TË PUNOHET? 303
DREJTËSIA E VËRTËTË 305
PROBLEMI MJEKËSOR I MASTURBIMIT (VETËKËNAQËSIA) 305
PASTRIMI I NDËRSJELLTË BASHKËSHORTOR 306
PËRGOJIMI 307
HAXHI I GRUAS PA LEJEN E BURRIT TË SAJ 307
E KANË PARË KUR'ANIN DHE NUK I KANË BESUAR 308
DITA E MARTË DHE DITA E ENJTE 309
SHKURTIMI I FLOKËVE TË FEMRAVE 309
ÇKA KA PARË I DËRGUARI I ALLAHUT NATËN E ISRASË DHE MIRAXHIT 310
ZËRI I FEMRËS 313
SOT E HEQIM PERDEN E SYVE 314
AI ËSHTË PENG I BORXHIT TË TIJ 314
INVESTIMI NË MJETE TË CILAT SHPENZOHEN NË KAMATË 315
LLOJET E IDETEVE 316
MIRËSIA NDAJ PRINDËRVE PAS VDEKJES SË TYRE 316
KALIMI I MENDJES DIKU TJETËR GJATË NAMAZIT 317
KY ËSHTË KOMPENZIM (KEFARET) YT 319
KOMPENZIMI (KEFARETI) I ATIJ QË KONTAKTON ME BASHKËSHORTEN GJATË MENSTRUACIONIT 319
KANË REFUZUAR TË MARRIN PËGJEGJËSINË... A DO TË THOTË KJO MËKAT DHE KUNDËRSHTIM? 320

LEXUESI I FILXHANIT 321
BOTA E PADUKSHME 322
ËNDRRAT E VËRTETA 324
XHENETI NËN KËMBËT E NËNAVE TUAJA 326
DHURIMI I GJAKUT 328
LINDJA E VËSHTIRË FSHIN MËKATET 328
HAXHI PREJ LLOGARIVE BANKARE 329
TË JETUARIT ME VRASËSIN 329
ABDESI - FAZA E PARË E ADHURIMIT 330
JU I DINI MË SË MIRI ÇËSHTJET E JETËS SUAJ 331
PËR TË TRIUMFUAR (PËR T'U PARAQITUR) MBI TË GJITHA FETË 334
FEJA DHE SHKENCA 335
SHPIFJA NDAJ ISLAMIT 336
DALLIMI NË MES TË DITURISË DHE EDUKATËS 337
IDHUJTARIA E HAPUR 338
VENDET KU NUK PËRMENDET EMRI I ALLAHUT 339
INSTIKTIVITETI I GJUMIT 339
HALLALLET E ARIT TË FEMRAVE 340
BOTA TJETËR 341
PJESA E TETË 342
HYRJE 343
NJERËZIT JANË THESAR 344
SHOQËRIA IDEALE 344
KONTRATA PROFITABILE 345
GJENIALITETI I MUHAMEDIT 346
NË MES TË SHPIRTIT DHE TRUPIT 347
MOS TA KTHEFTË ALLAHU TË HUMBURËN 348
DHJETË DITËT E FUNDIT TË RAMAZANIT 350
GJËRAT E NËNSHTRUARA PËR NJERIUN 351
BOTA E VËSHTIRËSIVE 352
DALLIMI NË MES TË "PROGRAMIT" DHE "PROGRAMIT" 353
ABIDËT DHE UBADËT (ROBËRIT DHE TË ROBËRUARIT) 354
VETËM PËR MESHKUJT 355
PËRSËRITJA E UMRES DHE E HAXHIT 356
DHUNTI SPECIFIKE DHE ANGAZHIMI PËR DHUNTI 356
SHAËRAVIJU DHE EDUKIMI 358
DHE I SHËRON ZEMRAT E BESIMTARËVE 360
O JU, TË CILËT BESUAT 361

PSE SHTËPIA E SHENJTË DHE MUAJI I SHENJTË 362
KUPTIMI I BESIMIT RRETH GURIT TË ZI HAXHERUL ESVED 364
CILA DUA PRANOHET MË SË SHUMTI DHE KUR? 364
KËMBIMI I TË MIRËS ME TË KEQEN 365
SHIKIMI I TË FEJUARËS 366
PROSTITUTI DHE PROSTITUTA 367
TË GËNJYERIT NDAJ BASHKËSHORTES 368
SADAKAJA PËR TË VDEKURIN 368
ISLAMI DHE LAICIZMI 369
DEVOTSHMËRIA DHE ADHURIMI 370
NATYRSHMËRIA NUK PRANON IDHUJTARINË 371
ÇKA PËR SUNETIN E PEJGAMBERIT S.A.V.S. 373
DËGJOJENI ALLAHUN DHE TË DËRGUARIN 375
SHOQËRIA PARAZITE 376
DHE JENI NË LUFTË ME ALLAHUN 378
NATALITETI I MADH 379
ARMA E KARAKTERIT (MORALIT) 380
LEJOHET SHFRYTËZIMI I MJETEVE TEKNOLOGJIKE 381
ABESE VE TEVELA – "U VRENJT DHE KTHEHU SHPINËN" 383
VETËVRASJA 384
I FSHEHIN TË MIRAT E BURRIT 385
KUJTIMI I VDEKJES 385
AGJËRIMI ËSHTË I PLOTË EDHE PSE AGJËRUESI ËSHTË XHUNUB (I PAPASTËR) 386
MJEKU I GRAVE 386
PJESA E NËNTË 387
HYRJE 388
ARTET E BUKURA 390
PSE ALLAHU E KA CAKTUAR SULEJMANIN QË TË JETË MBRET? 391
DHE NUK KA BËRË KUFËR (NUK KA KALUAR NË PABESIM) SULEJMANI 392
DHE SECILI PREJ JUSH DO TË SILLET NË TË 393
SHPIRTI DHE MATERIA 394
VLERA E LEXIMIT TË KUR'ANIT 395
ATA TË CILËT DO TË SHPËRBLEHEN ME TË MIRA EDHE MË SHUMË SE KJO 397
DHE NE I KEMI NËNSHTRUAR ATA 398
NE E KEMI ORIENTUAR RRUGËN 399

MES’HI MBI KOKË 399
MREKULLIA E KRIJIMIT 400
LEXIMI I KUR'ANIT PA E KUPTUAR 400
FOTOGRAFITË ME KAFSHË NË SHTËPI 401
FJALA PËRFUNDIMTARE 401
AGJËRIMI I TËRË VITIT 402
RUBIKONI I KURBANIT 403
EDHE NËSE ËSHTË E PAKTË 403
NJË SHKURORËZIM 403
CILA ËSHTË E DREJTA E SECILIT PREJ KËTYRE 404
A PËRGJIGJET SHPIRTI NË VARR? 404
ENA E TIGANISUR NË TË CILËN ËSHTË TTIGANISUR MISHI I DERRIT 405
UTHULLA PREJ ALKOOLIT 405
FALLTARËT 406
SHARJA E PRINDËRVE 406
NDËRPRERJA E LIDHJEVE FAREFISNORE 407
ISRAJA DHE MIËRAXHI 407
ISRAJA DHE MIËRAXHI 409
SHAËRAVIJU DHE LËMIA MEKANIKE 411
LOGJIKA (METODOLOGJIA) E THIRRJES NË BESIM 411
ISLAMI EMËR, CILËSI DHE SIMBOL 414
FUQIA E TË DOBËTVE NË DASHURI 415
CILËSITË E HYRIVE TË XHENETIT 416
KUR'ANI BAR DHE SHËRIM I SHOQËRIVE 417
HARRESA, SËMUNDJE E NJERIUT 418
MËKATI I NJERIUT DHE MËKATI I SHEJTANIT 418
SEXHDEJA DIKUJT TJETËR POS ALLAHUT 420
MUSLIMANI EMIGRANT (REFUGJAT) 420
VEPRIMI PARALEL (I NDËRSJELLË) 421
ARDHMËRIA E SUKSESSHME 422
MËSHIRA E PALOGJIKSHME (E ÇORODITUR) 424
OBDUKSIONI 424
TË DJEGURIT E KUFOMAVE 425
SHOKËT E XHENETIT 425
EZANI DHE CËSHTJET RRETH TIJ 426
PSE QUHET RAMAZAN 426
DITË TË CAKTUARA 428

ALLAHU DËSHIRON T'JU LEHTËSOJË JUVE E NUK DËSHIRON T'JU VËSHTËRSOJË 429
NDERIMI I TË VDEKURIT 429
BOTA E NUMRAVE DHE BOTA E EKZISTENCËS 430
ATË DITË KUR NJERIU IKËN PREJ VËLLAIT TË TIJ 431
SHPËRBLIMI DHE DËNIMI 432
E ZGJERON KRAHARORIN TIM 433
PJESA E DHJETË 434
HYRJE 435
PERPILIMI I FETFAVE 436
VETËPRANIMI DHE VETËDORËZIMI NDAJ ALLAHUT 438
EL-LIANË (MALLKIMI) 439
DËRGON SALAVATE PËR PEJGAMBERIN 440
KADAJA DHE KADERI 442
GODITJA E FATKEQËSISË 443
POLEMIKA DHE DISKUTIMI I TYRE ËSHTË MËSHIRË 444
BISEDA ME SHPIRTRA 448
ISTIGFARI, HAXHI DHE FSHIRJA E MËKATEVE 449
MËKATET E VOGLA DHE MËKATET E MËDHA 449
“FLETËT NUK PRANOJNË TË SHKRUHET NË TO, LAPSAT 450
MJETET E MËKATIMIT 450
NËSE JANË TË VARFËR, ALLAHU I PASURON 451
SHERIATI DHE DREJTËSIA 452
IMANI DHE EPSHI 453
TË ALLAHUT 455
NGJYRA E ADEMIT A.S. 456
DISA I KEMI DALLLUAR SHUMË ME GRADA TË LARTA 456
URTËSIA E BOTËS TJETËR 460
PËRKUJTONI TË MIRAT E TË VDEKURVE TUAJ 461
PËRPARËSIA E BURRIT NDAJ GRUAS 462
TRASHËGIMIA PARA VDEKJES 464
ZGJEDHJA E BASHKËSHORTES 464
DËSHMIA E RREJSHME 465
MARTESA ME TË AFËRMIT 467
SHPJEGIM I SURETU JUSUF 468
E DREJTA E FQINJIT NË ISLAM 470
PLANPROGRAMI EDUKATIV NË ISLAM 470
ASKUSH NUK E BART BARRËN E TJETRIT 472

TRADITA DHE IBADETI.....472
DITËLINDJA E MUAHMEDIT A.S.....473
FORMA E MBULESËS ISLAME.....474
MBULESA ISLAME 475
MË TË SPROVUARIT 477
DALLIMI NË MES ANALFABETIT DHE INJORANCËS.....477
EMRI I MIRË ËSHTË E DREJTË E FËMIJËS 478
LIBRAT AUTORIAL TË PËRKTHYESIT (Dr. Musli Vërbanit) 479
PËRKTHIMET NGA GJUHA ARABE.....480